



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE - FLORA

Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL
MINISTARSTVO ZA REGIONALNI RAZVOJ
MINISTRY OF REGIONAL DEVELOPMENT

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE - FLORA

Prishtinë, 2025

Ky dokument është produkt i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe i njëjti duhet të shërbejë për nevojat e këtij institucioni, ministrive të linjës dhe akterëve tjerë relevant, lidhur me hartimin dhe zhvillimin e programeve me ndikim në zhvillim socio-ekonomik rajonal.

Dokumenti u hartua nga:

Shyhrete Kastrati, Drejtore e Departamentit për Performancë dhe Analiza Rajonale

Qefserë Bajrami, Udhëheqëse e Divizionit për Analiza Socio – Ekonomike Rajonale

Xhevat Sefaj, Zyrtar për Zhvillim Socio-Ekonomik

Blinda Bytyçi, Zyrtare për Zhvillim Rajonal të Balancuar

Konsultuar dhe mbështetur nga:

Besim Kamberaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal

Kontribut profesional i veçantë:

Prof. Dr. Elez Krasniqi, Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Lektoroi: **Ma. Liridona Zhubi**

Falënderojmë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Institutin për Mbrojtjen e Natyrës që kontribuan në realizimin e këtij dokumenti.

Përmbajtja:

Hyrje	4
Përkufizime:	5
Resurset natyrore	7
Roli dhe rëndësia e resurseve natyrore – Flora	8
Shtatë (7) Rajonet Zhvillimore	9
01- Rajoni Zhvillimor Qendër	10
02- Rajoni Zhvillimor Veri	27
03- Rajoni Zhvillimor Perëndim	37
04- Rajoni Zhvillimor Jug	105
05- Rajoni Zhvillimor Juglindje	162
06- Rajoni Zhvillimor Lindje	205
07- Rajoni Zhvillimor Jugperëndim	213
Referencat	262

Me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve drejt zbatimit të Ligjit 08/L-190, Ministria e Zhvillimit Rajonal mban përgjegjësi për zhvillimin e politikave dhe programeve për zhvillim rajonal dhe të bashkëpunimit ndër rajonal për të reduktuar pabarazitë rajonale.

Synimi i MZHR-së është që përmes hartimit të strategjive, implementimit të programeve, përgatitjes së analizave dhe hartimit të dokumenteve të ndryshme, të kontribuojë në vazhdimësi në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, me qëllim të ndikimit në zvogëlimin e pabarazive rajonale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. MZHR operon me politikat e implementimit të programeve të saj në shtatë (7) rajone zhvillimore me (38) komuna përbërëse. Bazuar në Strategjinë për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030, Objektivi Strategjik: 3 Shfrytëzimi i resurseve natyrore, kulturore dhe humane në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal, Objektivi specifik 3.1 Resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe të promovuara, Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale (DPAR), ka përgatitur dokumentin: “Pasqyrimi i Resurseve Natyrore Sipas Rajoneve Zhvillimore”. Ministria e Zhvillimit Rajonal MZHR/DPAR në koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Institutin për Mbrojtjen e Natyrës, përmes hartimit të këtij dokumenti, synon të paraqesë një pasqyrë të resurseve natyrore për shtatë (7) rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar ku numri i rajoneve zhvillimore është në përputhje me numrin e shtatë (7) rajoneve statistikore sipas klasifikimit NUTS-3.

Qëllimi i dokumentit: është të ndihmojë hartuesit e politikave në zhvillimin e tyre kundrejt vetëdijësimit, mbrojtjes së resurseve ekzistuese natyrore dhe shfrytëzimit të tyre për fusha tjera, si: zhvillimi ekonomik/turizmi dhe ndikimi drejt një zhvillimi socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Metodologjia: në hartimin e këtij dokumenti janë përdorur burimet e të dhënave sekondare bazuar në gjetjet nga publikimet, raportet e ndryshme nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/ Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

“Kosova ende nuk ka ndonjë inventar të plotë të biodiversitetit andaj edhe të dhënat e pasqyruara në këtë dokument nuk përbëjnë tërësinë e kësaj kategorie. Të dhënat nga flora të pasqyruara në shtatë (7) rajone zhvillimore janë vetëm të dhënat e identifikuara sipas komunës/rajonit të bazuara në dokumentet zyrtare “Libri i Kuq i Florës Vaskulare i Republikës së Kosovës” i vitit 2013 nga MMPHI, nga referenca të viteve të fundit të autorëve Krasniqi, E. et al. (2019, 2020, 2021, 2023), Berisha N. et al. (2020), si dhe të dhëna nga plotësimet e fundit nga disa baza të dhënash të rendësishme për taksonet bimore (https://euoplusmed.org/cdm_dataportal/taxon, <http://ww2.bgbm.org/EuroPlusMed>, <https://floraveg.eu/taxon>, etj.

Dokumenti është konsultuar nga strukturat e brendshme të MZHR-së, MMPHI-së/ IKMN-së dhe Qendrat për Zhvillim Rajonal.

Përkufizime:

Rajon zhvillimor - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal të balancuar, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin përkatës dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial.

Zhvillimi rajonal i balancuar- nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturor e mjedisor, ndërmjet rajoneve të ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor.

Pabarazi rajonale - nënkupton gjendjen kur evidentohen dallime substanciale në mes të rajoneve zhvillimore sipas indikatorëve socio-ekonomik.

Politikat e zhvillimit rajonal të balancuar - nënkuptojnë kornizën e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal të balancuar me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të zbatohen për arritjen e synimit të zhvillimit rajonal të balancuar.

Lista e shkurtesave:

MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal;

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

IKMN – Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;

FShMN – Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore;

UP – Universiteti i Prishtinës;

QZHR- Qendrat për Zhvillim Rajonal;

SZHR – Strategjia për Zhvillim Rajonal ;

RZHQ- Rajoni Zhvillimor Qendër;

RZHV - Rajoni Zhvillimor Veri;

RZHP - Rajoni Zhvillimor Perëndim;

RZHJ - Rajoni Zhvillimor Jug;

RZHJL - Rajoni Zhvillimor Juglindje;

RZHL - Rajoni Zhvillimor Lindje;

RZHJP - Rajoni Zhvillimor Jugperëndim;

DPAR - Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale;

NUTS - nënkupton “Nomenklaturën e Njësive Territoriale Statistikore” të përcaktuar nga Agjencia Statistikore Evropiane si një sistem hierarkik i ndarjes së territorit ekonomik të Bashkimit Evropian për qëllimet e mbledhjes, zhvillimit dhe harmonizimit të rajoneve evropiane statistikore dhe analizës socio-ekonomike të rajoneve. **NUTS-3** nënkupton rajonet e vogla për qëllime specifike njëqind e pesëdhjetë mijë (150.000) deri në tetëqind mijë (800.000) banorë.

Resurset natyrore

Resurset natyrore përfaqësojnë bazën materiale të zhvillimit socio-ekonomik dhe janë ndër faktorët kyç që ndikojnë në mirëqenien e popullatës dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Ato përfshijnë elementë dhe materiale që gjenden në natyrë dhe që mund të shfrytëzohen nga njeriu për nevoja të ndryshme jetësore, ekonomike dhe teknologjike. Këto resurse përfshijnë ujin, tokën pjellore, ajrin, biodiversitetin, pyjet, mineralet, dhe burimet e energjisë.

Në aspektin funksional dhe ekologjik, resurset natyrore klasifikohen në dy kategori kryesore:

Resurset e rinovueshme janë burime që mund të ripërtërihen natyrshëm në një periudhë të arsyeshme kohore, për aq kohë sa ritmi i shfrytëzimit nuk tejkalon kapacitetin e tyre të rikuperimit. Këtu përfshihen uji i ëmbël, biomasa, energjia diellore, era, flora dhe fauna. Menaxhimi i kujdesshëm i këtyre burimeve është thelbësor për ruajtjen e ekosistemeve dhe për garantimin e sigurisë mjedisore në afat të gjatë.

Resurset jo-rinovueshme janë burime natyrore me rezerva të kufizuara, që nuk mund të ripërtëriten brenda një periudhe të shkurtër kohore, siç janë mineralet, nafta, gazi natyror dhe qymyri. Shfrytëzimi intensiv i këtyre burimeve ka pasojë të dukshme në mjedis, duke përfshirë ndotjen, degradimin e tokës dhe humbjen e biodiversitetit.

Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, ruajtja dhe menaxhimi i përgjegjshëm i resurseve natyrore janë parakushte për balancimin e nevojave ekonomike me mbrojtjen e ekosistemeve.

Florën e Republikës së Kosovës e përbëjnë algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat të cilat janë bazë e jetës, formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e organizmave shtazor dhe njeriut. Pa mohuar rëndësinë e asnjë grupi bimor që kanë për jetën në planetin tonë, e në kuadër të kësaj edhe për jetën në Kosovë; bimët vaskulare, në veçanti bimët me farë (farëzhveshurat dhe farëveshurat) kanë rolin kryesor në vegetacionin e Kosovës i cili ka ndikim direkt në klimën, ajrin, ujin dhe tokën e Kosovës. Edhe pse janë bërë hulumtime të florës dhe vegetacionit të Kosovës nga autor të ndryshëm vendor dhe nga shtetet e ndryshme të Evropës ende nuk është bërë një inventarizim i florës dhe nuk dihet numri i saktë i taksoneve bimore në Kosovë. Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet se në Kosovë janë prezent afro 2800-3000 lloje të florës vaskulare ¹.

¹ Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

Roli dhe rëndësia e resurseve natyrore – Flora

Resurset natyrore përbëjnë një komponent thelbësor në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, duke ndikuar drejtpërdrejtë në sektorë si bujqësia, energjia, industria, shëndetësia dhe turizmi. Përveç potencialit të tyre ekonomik, këto resurse luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit dhe funksionimin e ekosistemeve natyrore.

Roli i këtij dokumenti është një pasqyrim i detajuar të resurseve natyrore me fokus në florë, të ndarë sipas shtatë rajoneve zhvillimore të Kosovës duke ofruar një bazë të vlefshme për identifikimin e potencialeve natyrore në nivel komunal dhe rajonal, duke u shërbyer si referencë investitorëve, institucioneve publike dhe grupeve të interesit në planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Përdorimi pa kriter i resurseve natyrore rrezikon shkatërrimin e habitateve, humbjen e specieve dhe degradimin e mjedisit. Prandaj, është e domosdoshme që të gjitha palët e përfshira, përfshirë investitorët, komunitetet lokale, organizatat mjedisore dhe autoritetet qeveritare, të veprojnë në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të garantuar që këto resurse të mbeten të disponueshme edhe për gjeneratat e ardhshme.

Lista e aseteve të resurseve natyrore (florës) është pasqyruar me:


- emërtimin e bimës;
- përshkrimin botanik;
- përhapjen e përgjithshme;
- llojin e habitatit;
- përhapja në Kosovë (komuna) shpërndarjen në secilin rajon zhvillimor;
- trendi i popullatës dhe kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN.

Këto informacione ofrojnë një pasqyrë të qartë për analizë strategjike dhe ndërhyrje të bazuara në evidencë. Bazuar në të dhënat nga “Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, Kosova është e pasur me një diversitet të florës në rajone të ndryshme zhvillimore. Rajoni më i pasur është Rajoni Zhvillimor Jug i pasur me përhapje dhe llojllojshmëri të florës. Në këtë rajon gjenden lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore njëvjeçare, shumëvjeçare, shkurre, gjysmëshkurre, bimë shumëvjeçare tufore, myshqe, shumëvjeçare me rozetë bazale, bimë kacavjerrëse, bimë me kërcell zvarritës, bimë drunore, dru, etj. Rajoni Zhvillimor Perendim është rajoni i dytë më i pasur sa i përket florës përfshirë bimë barishtore një vjeçare, dy vjeçare dhe shumë vjeçare, shkurre, gjysmë shkurre etj. Gjithashtu të pasur me florë janë edhe rajoni Jugperendim dhe Juglindje të cilat kanë një diversitet të florës. Rajonet më pak të pasura për diversitet të florës janë: Rajoni Zhvillimor Veri, Rajoni Zhvillimor Lindje dhe Rajoni Zhvillimor Qendër.

Shtatë (7) Rajonet Zhvillimore

Rajonet zhvillimore sipas fushëveprimtarisë së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal:

- 1) Rajoni Zhvillimor Qendër
- 2) Rajoni Zhvillimor Veri
- 3) Rajoni Zhvillimor Perëndim
- 4) Rajoni Zhvillimor Jug
- 5) Rajoni Zhvillimor Juglindje
- 6) Rajoni Zhvillimor Lindje
- 7) Rajoni Zhvillimor Jugperëndim



01- Rajoni Zhvillimor Qendër

Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga shtatë (7) komuna: **Prishtinë, Podujevë, Graçanicë, Obiliq, Fushë Kosovë, Glogoc, Lipjan**. Ky rajon është i pasur me resurse natyrore. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 22 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore shumëvjeçare, drunjë, bimë drurore shkurre dhe gjysmëshkurre.

Në formë tabelare është paraqitur lista e aseteve të resurseve natyrore (flora).




Figura 1. Tulipa kosovarica



Tabela 1. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Qendër

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I . Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR – QENDËR							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Kategoria e kërcënueshmë-risë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Colchicum hungaricum</i> Janka Emri shqip: <i>Xhërrokull i Hungarisë</i> Familja: Colchicaceae [Liliaceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), bulbi 2-3x1-2 cm, gjatë me tunikë të murrme, si letër deri gati lëkurorë dhe me një qafë të shkurtër. Gjethet dy deri tre, 3-6 (-10) cm në lulëzim, deri 20x12 cm në pjekuri, vizake-heshtore, majëmprehta, me qerpikë të rrallë në buzë dhe me faqen e sipërme të mbuluar tërësisht ose pjesërisht me qime të shkurtra. Lulet (1-) 3-6 (-8). Tapalet deri 30x6-7 mm, purpurorë ose të bardha, eliptike, të ngushta, majëmprehta. Fillet deri 10 mm; antaret 23.5 mm, të purpura-të zeza. Shtyllëzat të drejta ose pak të përkulura në majë. Kapsula rreth 10 mm, gati rruzullore. Lulëzon XII-IV. Frytton IV (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Hungari, Maqedoni, Kroaci, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbi (Tutin, T. G. et al. 1980; Polunin, O. 1997; Saric, M. et al. 1986).	Në Kosovë (Gadime dhe Guranë) rritet në substrat të thatë me bazë shkëmbore gëlqerore dhe serpentine. Në Gadime (Kodra ku ndodhet Shpella e Mermertë e Gadimës) rritet në kullotë me bazë shkëmbore gëlqerore në një hapësirë të vogël në ekspozicionin jugperëndimor. Shfaqet nga llojet: <i>Crocus chrysanthus</i> , <i>Helleborus odoratus</i> , <i>Tulipa sylvestris</i> , <i>Muscari racemosum</i> , <i>Gagea lutea</i> , <i>Bellis perennis</i> , <i>Capsella bursa-pastoris</i> , <i>Poa bulbosa</i> , <i>Potentilla tommasiniana</i> [P. cinerea], <i>Ranunculus millefoliatus</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Veronica jacquinii</i> , <i>Teucrium chamaedrys</i> , <i>Saxifraga bulbifera</i> , <i>Teucrium montanum</i> , <i>Xeranthemum annuum</i> , <i>Trifolium arvense</i> etj. Në Guranë, rritet në kullota-shpate shkëmbore me natyrë serpentine	Për florën e Kosovës përmendet në lokalitetin Gadime, (Hundozi, B. dhe Krasniqi, F. 1995). Më 18.03.2011 u konstatua dhe u vlerësua gjendja e Popullacionit të llojit edhe në Guranë-lokalitetin i ri në Kosovë (F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Janë hulumtuar dy popullacione të këtij lloji në Kosovë të konstatuara deri me tani. Popullacioni i këtij lloji në Guranë ka areal shumë të vogël (<500 m2) dhe numër të vogël të individëve maturë (<100). Popullacioni i këtij lloji në Gadime ka areal shumë të kufizuar (<400 m2) dhe numri i individëve maturë është (<100).	I rrezikuar në mënyrë kritike.

2	<i>Quercus robur</i> subsp. <i>pedunculiflora</i> (K. Koch) Menitsky Emri shqip: <i>Rrënjë</i> Familja: Fagaceae	Dru deri 30 m i lartë (Fanerofite P). Gjethet me vriguj të dalluar mirë e bukur. Vrigujt e nuk mbarojnë kurrë me një halëz të hollë e të gjatë, vetëm ndonjëherë me një si thumb të vogël rreth 1 mm të gjatë. Gjethet me dej drejt gjijve (të paktën me 1 ose 2 dej të tillë) me vriguj zakonisht të gjatë të ndarë me gjijë të thellë. Sythet me mëlluga jo në trajtë fijesh. Bishtat e gjetheve përfundi pa ndajgjethe të qëndrueshme ose me të tilla të qëndrueshme por vetëm te bishtat e gjetheve të majës së degëve. Frytet e arrira në degët e sivjetme. Degët e sivjetme (njëvjeçare) të shogëta. Gjethet me bishta të shkurtër deri 1 cm. Frytet me bishta të dalluar mirë e bukur. Gjethet të rënëshme, të rriturat përposh me push të hollë e të shkurtër ose me qime yllore dhe të blerta në të përhimë ose të bardhërreme. Llapa 8-13 (17) cm e gjatë, 6-9 cm e gjërë, me 4-5 palë vriguj dhe me 5-6 palë dejë anësorë. Mëllugat e gishtjes me gungëza dhe me qime formojnë rreth e qark saj rrathë të ngritur. Lulëzon IV-V-. Frytton IX-X (Mitrushi, I. 1966).	Evropë Juglindore (Bullgari, Greqi, Rumani, Rusi (Kaukaz), Turqi Gadishulli Ballkanik, Kaukaz, Azi e Vogël, Krime (Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997).	Ky nënloj deri më tani në Kosovë është konstatuar vetëm në Rrafshin e Drenicës, në livadhe hapësirat e të cilave zakonisht nuk vërshohen dhe afër vendbanimeve. Në Negrofc (Negrofc-Arllat) (630 m l. m. d.) dhe Llapushnik (637 m l. m. d.) gjendet në livadhe të cilat nuk vërshohen, kositen ndërsa në zonën përreth ka agrokultura (Agrofitocenoza për momentin në degradim e sipër). Shoqërohet nga llojet: <i>Achillea millefolium</i>, <i>Bellis perennis</i>, <i>Cichorium intybus</i>, <i>Colchicum autumnale</i>, <i>Linaria vulgaris</i>, <i>Ononis spinosa</i>, <i>Plantago lanceolata</i>, <i>Poa pratensis</i>, <i>Potentilla reptans</i>, <i>Ranunculus millefoliatus</i>, <i>Tanacetum vulgare</i>, <i>Taraxacum officinale</i>, <i>Trifolium pratense</i>, <i>Mentha longifolia</i>, <i>Mentha pulegium</i>. etj. Në zonën rrëzë Malit Drenicë (Nekofo-Krojmir) (mbi 600 m l. m. d.) rritet në zonë urbaneana e majtë e rrjedhës së Lumit Drenicë.	Deri tani ky nënloj nuk përmendet për Kosovë. Gjendja e llojit është vlerësuar më 21.05.2011 dhe 14.09.2013 në Rrafshin e Drenicës-rrëzë Malit Drenicë (Negrofc, Llapushnik, Nekofo-Krojmir), Drenas.	Ky takson në Kosovë formon subpopullacione të vogla në Rrafshin e Drenicës të cilat karakterizohen me numër shumë të vogël të individëve maturë (1-3 individë).	I rrezikuar në mënyrë kritike.
---	--	---	--	--	--	--	---------------------------------------

3	<i>Tulipa kosovarica</i> Shuka, L., Tan, K. & Krasniqi, E. Emri shqip: <i>Tulipani Kosovar</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 15-30 (40) cm mbi tokë. Bulbi (qepujka) 34 x 1.5 cm. Tunika ngjyrë kafe e shogët. Kërccoli i shogët, i drejtë, i pa degëzuar me 3-5 gjethe. Gjethet heshtore, të këmbyera 10-15 cm X 0.8- 2cm me këllëf në bazë. Lulet e vetmuara, me periant ngjyrë të kuqe të përbërë nga 6 fletëza (Tepale). Bazat e fletëzave e bardhë pa njollë të zezë, nganjëherë ngjyrë gështenjë dhe e purpurtë, të jashtmet 3.5– 5.0 × 1.5–2.3 cm, të brendshmet vezake me madhësi 3.0–4.7 × 1–2 cm, me majucë. Thekë 6; filli rreth 1 cm (10-13 mm) i bardhë ndërsa antera gjithashtu rreth 1 cm (8-12 mm) e gjatë gështenjë e mbylltë. Gineceu tre pjesësh me gjatësi gati sa thekët. Fruti kapsulë (3.0-3.5 x 1.5-2.2 cm). Farat 7-8x6 mm. Për herë të parë është gjetur në rajonin e Mirushës në terrene serpentine nga E. Krasniqi më 11.05.2002. Lulëzon V-VI. Frytton VI-VIII (Shuka, L. et al. 2012).	Kosovë (Stenoendemi ke).	Ky lloj në Kosovë është i përhapur vetëm në substrat serpentitor në kuadër të pyllit të përzier të bungëbutës-<i>Quercus pubescens</i> dhe boshtres-<i>Forsythia europaea</i> (<i>Quercetalia pubescentis</i>) si dhe në kullota serpentine (<i>Halacsyetalia sendtneri</i>). Në Rajonin e Mirushës (400 m l. m. d.) gjendet në kuadër të pyllit të dushkut (<i>Quercetum pubescentis cerris</i>) në shoqëri me llojet: <i>Quercus pubescens</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Juniperus oxycedrus</i>, <i>Aristolochia merxmülleri</i>, <i>Potentilla astracanica</i> [P. hirta], <i>Filipendula hexapetala</i>, <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Genista hassertiana</i>, <i>Sanguisorba minor</i>, <i>Plantago subulata</i>, <i>Paramoltkia doerfleri</i> (<i>Moltkia doerfleri</i>), etj. Në Guriq (660 m l. m. d.) dhe në Llapushnik (732 m l. m. d.) gjendet në kullota serpentine (<i>Halacsyetalia sendtneri</i>) bashkë me llojet: <i>Tulipa sylvestris</i>, <i>Sanguisorba minor</i>, <i>Plantago subulata</i> etj.	Rajoni i Mirushës (Llapqevë - Mrasor), Guriq. (Shuka, L. et al. 2012), Llapushnik (Mali Drenicë)- lokalitet i ri për Kosovë (E. Krasniqi 27.04.2013).	Ky lloj në Kosovë formon tre popullacione që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë brenda këtyre popullacioneve. Sipërfaqja e përhapjes së këtij lloji në rajonin i Mirushës është <2700 m2 kurse numri i individëve maturë është < 65. Sipërfaqja e përhapjes së këtij lloji në lokalitetin Guriq është <4000 m2, kurse numri i individëve maturë është <30. Në lokalitetin Llapushnik janë konstatuar <20 individ maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
---	---	---	---------------------------------	---	--	---	---------------------------------------

4	<i>Adonis vernalis</i> L. Emri shqip: <i>Adonisi pranveror</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-40 cm e lartë, me rizomë te fuqishme me ngjyrë gështenje të mbyllët. Kërçelli i drejt i padegëzuar ose i degëzuar pa qime në pjesën e poshtme me hulli. Gjethet e kërçellit pabisht, 2-4 herë pendore të ndara me rezhde të holla lineare pa qime ose rrallë me qime. Lulet e vetmuar, të verdha më diametër 3-7 cm. Sepale 5, petale 10-20 të ngushta pykore të plota anash ose të dhëmbëzuara. Fryti 4-5 mm i gjatë gati i rrumbullakët, i rrudhur në formë rrjetore, me qime, afër bazës i zgjatur dhe me errëm. Lulëzon V-VI. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. (Rexhepi, F.2003).	Evropë, Azi Perëndimore.	Rritet në çeltira pyjesh termofile dhe në kullota të thata në kuadër të asoc. Carpinetum orientalis scardicum, dhe Quercetum pubescentis cerris e shoqëruar nga llojet: Iris reichenbachii, Iris florentina, Carpinus orientalis, Quercus pubescens, Paconia decora, Malus florentina, Acer tataricum etj.	Rajoni i Gllarevës, (Krasniqi, E. 2003), Gazimestan, Gllamë (Gjilan).	Popullacioni më i rëndësishëm i këtij lloji në Kosovë shtrihet në substrat gëlqeror në rrethinën e Gllarevës. Ky popullacion shtrihet në rrethinën e Gllarevës, Gjurgjevikut të Madhë, Pogragjë dhe shkon deri afër fshatit Buroj (Skënderaj). Ky lloj është i përhapur nëpër çeltira të pyllit të dushkut dhe shkozës si individ ose shpesh në tufa. Në disa lokalitete e kemi konstatuar afër rrugës gjë që dëshmon se është bartur fara gjatë ndërtimeve të rrugëve. Popullacionet në Gazimestan dhe Gllamë (Gjilan) kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
5	<i>Allium pendulinum</i> Ten. Emri shqip: <i>Qepë</i> Familja: Amaryllidaceae [Alliaceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 10-20 cm e lartë, e terë bima e gjelbër e përhitur. Qepujka zakonisht një ovale, e mbështjellur me mbështjellës ngjyrë të errët. Gjethet mishnore tri anësh. Lëpusha me dy flegra, që shpesh bien herët lulesa e shprishur e përbërë nga 2-8 lule. Bishtat e luleve të kthyer poshtë dhe disa herë me të gjatë së perigoni. Fletëzat e perigoni 4-8 mm të gjata, të gjelbra ose të bardheme me ngjyrë të blertë në nervura të perigoni. Fillet e thekeve me të shkurtër se fletëzat e	Pirineje , Itali, Ballkan, Afrikë veriore.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror nga 560-610 m lartësi mbidetare, në kuadër të asoc. Carpinetum orientalis scardicum e shoqëruar nga llojet: Carpinus orientalis, Quercus pubescens, Quercus frainetto, Acer monspessulanum, Helleborus odoratus, Cornus mas, Evonymus verrucosus, Sorbus torminalis, Cyclamen neapolitanum, Waldsteinia geoides, Anemone apennina, Eryngium palmatum, Polygonatum officinale, Fragaria vesca, Dactylis glomerata, Stellaria holostea, Symphytum tuberosum, Melica Foto: Elez Krasniqi (2013), Grabovc uniflora etj.	Sipas Krasniqi, F. (1972), Josifovic, M. et al. (1975), dhe Blečić, V. et al. (1968) është e përhapur në rrethinën e fshatit Grabovc – Dobroshec. Fushë Kosovë.	Popullacioni i këtij lloji në afërsi të fshatit Grabovc ka areal shumë të kufizuar por ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Ky lokalitet është i frekuentuar nga njerëzit e fshatit të cilët duke prerë pyllin dëmtojnë edhe individët e këtij lloji brenda popullacionit.	I rrezikuar.

		perigonit. Lulëzon IV-V. Frytëzon VI. Riprodhohet me farë dhe bulb.					
6	<i>Crocus kosaninii</i> Pulevic Emri shqip: Shafraan i Koshaninit Familja: Iridaceae	Bimë shumëvjeçare, deri në 15 cm (Gjeofite G). Qepujka deri në 1 cm e gjërë, e mbuluar me një tunikë të thurur. Gjethe kërcellore 4(5), gjethe 2(3) deri në 4 mm të gjëra. Spathet bazale në fund të kërcellit dhe me brakte në fundin e lules. Nuk ka brakteole. Lulet të vetme, rrallë dy, ngjyrë vjollce të lehtë, ose krejtësisht të bardhë. Gypi i perigonit deri në 12 cm i gjatë, me shenja ngjyrë vjollce të errët në pjesën e sipërme të cilat vazhdojnë edhe mbi petale. Qafa (Fyti) i perigonit ngjyrë të verdhë. Petalet me 1.5- 2.5 cm gjatësi dhe 0.6- 1.5 cm gjërësi. Thekët me 1.1-1.7 cm gjatësi: fijet të verdha. Stili (Pjesë e pistilit) zakonisht më i gjatë se thekët. Fryti ka shumë fara në kapsulë, relativisht i plotë (gjërë). Farat të plota, rrethore- vezake, ngjyrë kafe. Lulëzon II-III. Frytmon IV-VI (Randjelovic, N. et al. 1990).	Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë (Randjelovic, N. et al. 1990; Tutin, T. G. et al. 1980; Rexhepi, F. 1994).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrate silikate dhe serpentine të zonës së dushkut (<i>Quercetalia pubescentis</i> respektivisht <i>Quercion frainetto</i>) dhe në kullota kodrinore i shoqëruar nga llojet: <i>Quercus frainetto</i> , <i>Quercus cerris</i> , <i>Crataegus monogyna</i> , <i>Viola odorata</i> , <i>Helleborus odoratus</i> , <i>Muscari botryoides</i> etj.	Kaçanik, Brezovicë, Blinajë. Sipas Kosaninit (1926) gjendet edhe afër Vushtrrisë (Randjelovic et al. 1990, Krasniqi, F. 1998). Përveç rrethinës së Kaçanikut, ky lloj është konstatuar dhe vlerësuar edhe në një lokalitet të ri (Guranë 18.03.2011) nga F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala.	Popullacionet e llojit janë me numër të konsiderueshëm të individëve maturë, por kanë areal të kufizuar të shtrirjes. Në veçanti areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë ka popullacioni i këtij lloji në Guranë.	I rrezikuar.

7	<i>Daphne cneorum</i> L. Emri shqip: <i>Hollokuq i shkurtër,</i> <i>Xerxele knerore</i> Familja: Thymelaeaceae	Gjysmëshkurre përherë e blertë (Kamefite Ch) me degë zakonisht të shtrira ose të përpietje, të gjata, të holla, të drejta e të lëmuara. Bisqet e reja pushlore, të përhimë. Gjethet 10-18 (-25) x (-2) 3-5 (-6) mm, zakonisht 3-4 herë më të gjata se të gjëra , gjatore të përmbysët ose vizake-heshtore të përmbysta, shyte, nganjëherë me thumb, pabisht, të shogëta, jo të grumbulluara në tufëza në krye të degëve. Lulet të merme, ngjyrë trëndafili, gati të pabisht, në kaptinëza, 6-10 (-20) së bashku, me brakte të ngjashme me gjethet, por më të vogla. Hipanti 6-10 mm, zakonisht i mbuluar me qime të bardha. Nënpetlat 4-6 mm, shyte. Frytët bërthokla si të murrme- të verdha, të mbështjella nga hipianti, deri në pjekje, të ngurtësuar dhe pa tul më në fund. Lulëzon V-VI. Frytton VIII-IX (Qosja, Xh. et al. 1992).	Evropë (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat karbonat por edhe në serpentin, në vende me bar ose shkëmbinji. Në Koritnik (2047 m l. m. d.) rritet në shpatijet verilindore në shkëmbinji gëlqeror në shoqëri me llojet: Ranunculus thora, Juniperus sibirica, Foto: Elez Krasniqi (2012), Koritnik Dianthus integer, Dryas octapetala, Minuartia verna, Ranunculus oreophilus, Coronilla vaginalis, Pulsatilla narcissiflora, Myosotis alpestris, Salix reticulata etj. Millaku, F dhe Krasniqi, E. me 24.04.2012 këtë lloj e konstatuan dhe e vlerësuan edhe në Golesh (843 m l. m. d.), në kullosa serpenine e shoqëruar nga llojet: Fritillaria mesanensis, Galium gerardii, Muscari botryoides, Carduus nutans, Forsythia europaea, Plantago argentea, Quercus pubescens, Potentilla visianii, Iris reichenbachii, Euphorbia glabriflora, Alyssum markgrafi, Sedum ochroleucum, Primula veris, Trinia glauca etj.	Sipas F. Rexhepit (1986, 1994) dhe Randjelovic, N. & Rexhepi, F. (1984) lloji gjendet në Kopaonik, Koritnik dhe Pashtrik. Një popullacion i llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe në Golesh (lokalitet i ri për Kosovë) më 24.04.2012 (F. Millaku dhe E. Krasniqi).	Lloji rritet në popullacione të vogla dhe me numër jo të madh të individëve maturë, sidomos popullacioni në Golesh i cili në dy vitet e fundit ka numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
8	<i>Gladiolus illyricus</i> W.D.J. Koch Emri shqip: <i>Gladiolë e Ilirisë</i> Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) 25-50 cm. Këllëfet bazale të gjelbër, ndonjëherë me nuanca të kuqe zakonisht gjatë nervurave. Gjethet 4-5 (-10-40) cm të gjata dhe 4-10 mm të gjëra. Kallinj të me 3-10 lule, nganjëherë të degëzuar pak a shumë. Rreth lulja është e kuqe deri e kuqërremte e purpurt, segmentet 25-40x616 cm vezake përmbysët, rombike ose heshtore përmbysët. Anteret më të shkurtra se fillet në lule me segmente vezake përmbysët, por të barabarta me ato në lulet me segmente rombike ose heshtorë përmbysët. Kapsula vezake përmbysët ose eliptike, farat me flatra.	Evropë, Kaukaz.	Rritet në livadhe, kullota dhe vende me shkurre në kuadër të asociacioneve: Polygalo-Forythietum europaea dhe Astero-Juniperetum Oxycedri. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Anthemis montana, Tulipa sylvestris, Minuartia verna, Linum tauricum, Cotinus coggygria, Forsythia europaea etj.	Sipas Josifovic, M., et al.(1976) ky lloj është i përhapur në Obrançë (Podujevë). Gjatë viteve 2011-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Llapçevë, Bokat e Morinës dhe Maja e Zezë, Kaznik (Krasniqi, E. 2021).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të popullacionit në Bokat e Morinës që ka numër të konsiderueshem të individëve maturë.	I rrezikuar.

		Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytmon VII. (Vangjeli, J. et al. 2000).					
9	<i>Narcissus poeticus</i> subsp. <i>radiiflorus</i> (Salisb.) Baker Emri shqip: <i>Selikal, Narcis, Lulëxheneti, lulëdremiqare</i> Familja: Amaryllidaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite (G)), me bulb të gjatë 50-60 mm dhe të gjërë 15-25 mm, me mbështjellë ngjyrë kafe. Kërçelli 20-40 (60) cm i lartë me dy brinjë të sheshta. Gjethet 2-5 lineare, me 5-8 mm, të gjëra, të sheshta, pak a shumë të rimta ose të gjelbra me të shkurtra se kërçelli. Zakonisht në maje të kërçellit një lule rrallë 2 ose me shumë. Segmentet e rrethlules 22-30 mm, të bardha, në fillim të lulëzimit të bardha në të verdhë, gati vezake e përmbysët-pykore, me thonjëz pak a shumë të dallueshëm pak a shumë me kinde. Korona 2-2.5 x 8-10 mm, cilindrike. Të gjithë thekët gati të një madhësie dalin pjesërisht jashtë rrethlules. Lulëzon V-VI. Frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe bulb. Vangjeli, J. et al. (2000).	Alpe të Evropës, Karpate, Ballkan.	Në Kosovë rritet në livadhe me lagështirë që kositen të zonës kodrinore dhe malore e shoqëruar nga llojet: <i>Taraxacum officinale</i> , <i>Galium verum</i> , <i>Alnus glutinosa</i> , <i>Bellis perenis</i> , <i>Ranunculus millefoliatus</i> , <i>Silene viscaria</i> , <i>Ajuga genevensis</i> , <i>Trifolium pratensae</i> , <i>Plantago mayor</i> , <i>P. lanceolata</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Poa pratensis</i> , <i>Fetuca sp.</i> , <i>Galium cruciata</i> , <i>G. palustrae</i> . Në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut) ky lloj është konstatuar në zonën e Ahut dhe rrobullit në 1710 m lartësi mbi detare e shoqëruar nga llojet: <i>Lilium albanicum</i> , <i>Fritillaria messanensis</i> , subsp. <i>gracilis</i> , <i>Asphodelus albus</i> , <i>Achillea abrotanoides</i> , <i>Gentiana lutea</i> , <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Acer pseudoplatanus</i> etj.	Sipas Hundozi, B. (1980), Josifovic et al. (1975) dhe Krasniqi, E. et al. (2020) është e përhapur në rrethinën e Kaçanikut, Dumnicë, Ferizaj, Dobroshevc, Miradi e Ulët, livadhe të Llabjanit (afër Artanës), Brezovicë (Rexhepi, F.1978). Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N., me 19.05.2013 e konstatuan një popullacion të këtij lloji në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut - 1710 m). Është lokaliteti i parë i këtij lloji i konstatuar në Alpet Shqiptare.	Popullacionet e këtij lloji Kosovë kanë areal të kufizuar. Areali e këtyre popullacioneve po shkojnë në vazhdimësi duke u zvogëluar sipas pasojë e ndërtimeve të rrugëve dhe qendrave urbane gjatë 10 vitet e fundit. Popullacioni më interesant i këtij lloji është Popullacioni i konstatuar në Majën e Vjellakut - Alpet Shqiptare. Ky popullacion ka një areal shumë të kufizuar dhe dallon nga lokalitetet tjera në aspektin e diversitetit floristik.	I rrezikuar.
10	<i>Paeonia mascula</i> (L.) Mill. Emri shqip: <i>Bozhure mashkull</i> Familja: Paeoniaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërçep zhardhokor, me rrënjë të mishta. Gjethet dyfishtrëshe ose me disa gjethet pak të ndara; segmentet 9-16, ngushtësisht deri gjërësisht eliptike ose vezake, përposh të shogëta. Lulet me diametër 8-14 cm, të kuqe. Rrëshketet 3-5, zakonisht pushlore, të rumbulluara në majë, 2-4 cm, me krezë pabisht. Lulëzon V-VI, polenizimi kryhet me insekte, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe zhardhok. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropa Jugore, Kretë deri në Azi të vogël.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në vende me bar dhe në pyje në kuadër të asociacioneve: <i>Quercetum montanum</i> , <i>Ostryo-Carpinetum orientalis</i> , <i>Fagetum submontanum</i> , <i>Fagetum montanum</i> , <i>Luzulo-Fagetum</i> , dhe <i>Ostryo Fagetum</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Ostrya carpinifolia</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Quercus trojanae</i> , <i>Q. petraea</i> , <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Acer pseudoplatanus</i> , <i>Acer obtusatum</i> , <i>Evonymus verrucosus</i> , <i>Geranium sanguineum</i> , <i>Stachys scardica</i> , <i>Cardamine bulbifera</i> , <i>Geum urbanum</i> , <i>Arum maculatum</i> , <i>Anemone ranunculoides</i> , <i>Anemone nemorosa</i> , <i>Lilium martagon</i> , <i>Lathyrus venetus</i> , <i>Aristolochia pallida</i> etj.	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Kosovë (nuk cekën lokalitetet). Millaku, F. me 24 05. 2007 në Bjeshkët e Istogut, mbi fshatin Synë e konstatoi një popullacion shumë të vogël të këtij lloji në kuadër të asociacionit <i>Ostryo Fagetum</i> . Popullacionet e këtij lloji janë hulumtuar edhe në Pashtrik, Koritnik, Gërmi dhe Bjeshka e Mushtishtit (shpati i Manastirit).	Në Kosovë popullacionet e hulumtuara kanë qenë me areal të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Popullacionet në Pashtrik, Bjeshket e Mushtishtit dhe në Malet e Istogut (mbi fshatin Synë) kanë areal shumë të kufizuar dhe janë të rrezikuara sipas pasojë e degradimit të habitateve dhe prerjes së pyllit.	I rrezikuar.

11	<i>Galatella albanica</i> Degen [<i>Aster albanicus</i> (Degen) Degen] Emri shqip: - [<i>Aster shqiptar</i>] Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-35 cm e lartë. Kërçelli i përpjetëm deri i ngritur, me qime të mërimangëta-tufore përposh. Gjethet heshtoret përmbysta deri pallake, gjëndërore, me qime të mërimangëta-leshtore. Kaptinëzat në vastak të çlirët ose të vetmuara, me bisht të gjatë. Braktetë e pësthtjellës në tri radhë, të jashtmet e të mesit vizake-heshtore, me majë të fëndyellitë, të brendshmet majëmprehta, me buzë të gjëra cipëthata. Lulet llapore 12-14, vjollcë. Qimet e xhufkës të pabarabarta. Lulëzon VII-IX, frytëzon IX-X. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike (Subendemike), Kosovë, Shqipëri. Sipas Tutin et al. (1976) është i përhapur në malet midis Shqipërisë dhe Kosovës.	Rritet në substrate serpentine dhe kullota të zonës malore në kuadër të asoc. <i>Aster-Juniperetum oxycedrii</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus oxycedrus</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Aristolochia merxmulleri</i>, <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Echium rubrum</i>, <i>Halacsysa sendtneri</i>, <i>Genista hassertiana</i>, <i>Sedum serpentini</i>, <i>Sedum hispanicum</i>, <i>Veronica andrazovszkyi</i>, <i>Gladiolus illyricus</i>, <i>Sanguisorba albanica</i>, <i>Linum tauricum</i>, <i>Potentilla astracantha</i> [P. hirta].	Sipas Krasniqi, E. (2003, 2006), Josifovic, M. et al. (1975), Blečić V., et al. (1969), Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. & Millaku, F. (2004), Krasniqi, E. et al. (2012), Rexhepi, F. Foto: Fadil Millaku (2013), Mushtisht (2000) është e përhapur në serpentine të Kosovës (Rajoni i Mirushës, Mrasorit, Llapçevës, serpentinët e Mushtishtit (Bokat e Mushtishtit, Grejkocit dhe Korishit), Qafë Prush, Pllanik-Morinë. Sipas Rexhepit (2000) është e përhapur në Planik, Çeret, Luginë të Ibrit, Koprivë, Gllanasellë-Godanc, Kramavik, Koznik dhe Çerret.	Në Kosovë popullacionet e këtij lloji gjenden afër vendbanimeve dhe nën ndikimin e kullotjes intensive. Në lokalitet ku rritet ku lloji shpesh takohen deponi të mbeturinave dhe gurthyes të cilët dëmtojnë habitatin e këtij lloji.	I përkeqë-suar
12	<i>Centaurea albertii</i> Rexhepi Emri shqip: <i>Kokoçeli i Albertit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 150 cm e gjatë, me rrënjë të fuqishme boshtore. Kërçelli i drejtë, cilindrik, me qime të pakta, pak i degëzuar vetëm në pjesën e sipërme. Çdo degë përfundon me kaptinë të rrumbullakët-vezake, të gjatë 6-3 cm dhe të gjërë 1.8-2.6 cm. Gjethet e poshtme janë në rozetë 10-27 cm të gjata, dy herë të ndara, segmentet janë lineare dhe të gjëra 1.5-2.5 mm. Në fund të kërçellit mbesin pjesë të gjetheve të vjetra. Në pjesën e sipërme të kërçellit gjethet janë pabisht. Kaptinat janë të vetmuara (rrallë 1-4) në bishta të gjatë.	Kosovë, Stenoendemik e (Rexhepi, F. 2000).	Rritet në vende të thata shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore deri në 1000 m lartësi mbidetare, vetëm në substrate serpentine (Halacsysetalia sendtneri). Shoqërohet nga llojet: <i>Stachys scardica</i>, <i>Hypericum barbatum</i>, <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Galium gerardii</i>, <i>Plantago subulata</i>, <i>Bromus fibrosus</i>, <i>Linum tauricum</i>, <i>Filipendula vulgaris</i>, <i>Brachypodium pinnatum</i>, <i>Stipa pennata</i>, <i>Potentilla visianii</i>, <i>Iris reichenbachii</i>, <i>Artemisia lobelii</i>, <i>Potentilla australis</i>, <i>Euphorbia barrelieri</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Podospermum laciniatum</i> [<i>Scorsonera laciniata</i>] etj.	Devë, Golesh, Koznik (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Millaku, F. et al. 2008, Rexhepi, F. 1982, 1985, 1986, 2000, Saric, M. et al. 1986, Krasniqi, E. 2003, 2011, Krasniqi, F. 1998). Është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e llojit edhe në Bokat e Morinës më 18.09.2012 (F.Rexhepi dhe E.Krasniqi). Konsiderojmë se ky lloj është i përhapur edhe në serpentinët e Shqipërisë (ndoshta e përshkruar si <i>Centaurea candalebrum</i> ?).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje më të mirë në Golesh, ndërsa përhapje të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë në veçanti popullacionet në Koznik dhe Devë-Morinë (Çafa e Morinës).	I përkeqësuar

		Involukrumi është i rumbullakët-vezak, 1.5-2.0 cm i gjatë dhe po aq i gjërë. Braktet e involukrimit janë të blerta verdhake, 7-10 mm të gjata, me pak qime, në buzë dhe në maje të murrme, me shtojcë trekëndore-heshtore ngjyrë të zezë, nga çdo anë me 10-15 qerpikë të murrme të mbuluar me qime të shkurtra. Shtojca (appendix) përfundon me një qerpik gjëmbor të gjatë deri 3 mm. Lulet janë të purpurta, ato skajore nuk janë radiale. Akeni është i mbuluar me qime, më i shkurtër se xhufka, i gjatë 2.5-4 mm. Xhufka e gjatë 5-6 mm, e bardhë. Lulëzon VI-VII. Frytnon VIII (Rexhepi, F. 1986, 2000).					
13	<i>Malus florentina</i> (Zucc.) C.K. Schneider [Syn.: <i>Sorbus florentina</i> Nym.] Emri shqip: Mollë florentine Familja: Rosaceae	Shkurre ose dru i vogël (Fanerofite P), deri 5 m. i lartë, me kurorë të rumbullakët dhe lëvore të plasarit. Degët e reja të kuqe në të kafet, me qime, pa gjemba. Gjethet vezake të gjëra , 3-6 x 2-4 cm, me majë të mprehtë, të cinguara ose si zemër në bazë, me push të bardhë në faqen e poshtme, me bishtak 1,5 – 2,5 cm, me buzë të vrigulluara ose dhëmbë-dhëmbë të parregullt, të ngjashme me gjethet e murrizit dhe të vodhëviçes. Lulesa vastakore me 5-8 lule, me bishta me qime. Lulet me diametër 1,5 – 2 cm, të bardha. Shtrati i lules dhe sepalet me qime të dendura, të përhimë në të bardha; sepalet të gjata 3-4 mm, të rënshme. Shtyllëza 5, të bashkangjitura në bazë. Thekë rreth 20, të gjatë po aq sa shtyllëzat. Fryti elipsoid i gjërë, rreth 1 cm i gjatë, i kuq të paktën në një anë, me	Itali, Maqedoni, Greqi Veriore, Shqipëri, Kosovë (Paleoendemi ke e Ballkanit dhe Apenineve).	Rritet në pyje gjethegjera termofile dhe mezotermofile të dushkut (Quercetum farnetocerris scardicum Krasn.) si dhe në pyje të shkozës së zezë (Carpinetum orientalis scardicum Krasn.) e shoqëruar nga llojet: Quercus farnetto, Q. cerris, Q. petraea, Sorbus domestica, S. torminalis, Fraxinus ornus, Colutea arborescens, Viburnum lantana, Cornus Foto: Elez Krasniqi (2011), Pashtrik mas, Comandra elegans, Paeonia decora, Lithospermum purpureocoeruleum, Physospermum aquilegifolium etj.	Sipas Pajazitaj Q. (2012), Krasniqi, F. (1972), Josifovic, M. et al. (1972), është e përhapur në: Gërmi, Gllarevë, Blinajë, Qyqavicë, Malin Drenicë, Carralevë, Malet e Suharekës (Bokat e Baçevcit, Bokat e Korishit), Radavc dhe Pashtrik.	Popullacionet e këtij lloji në të gjitha lokalitetet e konstatuara kanë numër shumë të vogël të individëve maturë. Zakonisht në të gjitha lokalitetet takohen individ të vetmuar ose në numër shumë të vogël.	I përkeqë-suar

		qeliza gurore. Fara zakonisht 10, ngjyrë gështenje, 2 x 6 mm. Lulëzon:IV-V. Frytton: VIII-IX. (Qosja, Xh. et al. 1992).					
14	<i>Paeonia peregrina</i> Mill. [<i>Paeonia decora</i> G. Anderson.] Emri shqip: Bozhure shtegtare Familja: Paeoniaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërcëp zhardhokor, me rrënjë të mishta. Kërçelli i fuqishëm i shogët. Gjethet dyfishtrëshe, përpos pak leshtore ose të shogëta. Gjethëzat trepjesëshe, segmentet e gjethëzave të ndara në 3 vriguj në formë heshtore. Lulet e mëdha, ngjyrë të kuqe të mbyllët. Rrëshethe 2-3 (-4) me qime të bardheme. Fara ngjyrë purpurt e mbyllët e shkëlqyeshme. Lulëzon V, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe zhardhok. Paparisto, K. et al. (1988).	Ballkan deri Azi e Vogël.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrate gëlqerore, silikate dhe serpentinore. Rritet zakonisht në vende me bar në kuadër të asociacioneve: Quercetum pubescentis cerris (Gllarevë), Quercetum frainetto cerris scardicum (Gërmi) dhe Cratogeomomum spinosae (Gazimestan). Rritet e shoqëruar nga llojet: Quercus cerris, Q. pubescens, Acer monspessulanum, Acer tataricum, Prunus tenella, Crataegus monogyna, Sorbus torminalis, Viburnum lantana, Evonymus verrucosus, Dictamnus albus, Adonis vernalis, Filipendula hexapetala, Carpinus orientalis, Stachys scardica, Verbascum phoeniceum, Helleborus odoratus etj.	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Kosovë (nuk ceken lokalitetet). Gjatë vitit 2011-2012, Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F. & Krasniqi, E. kanë hulumtuar Foto: Fadil Millaku (2012), Gllarevë popullacionet e këtij lloji në Malet e Gllarevës, Gjurgjevikut të Madh deri të fshati Llapçevë, rajonin e Mirushës, Gazimestan, Gërmi dhe Blinajë (Lipjan).	Popullacioni i këtij lloji në rrethinën e Malit të Gllarevës që arrinë deri të Gjurgjevikut i Madh, fshati Llapçevë dhe rajoni i Mirushës është më i madhi dhe më i pasuri me numër të individëve maturë. Pas viteve të 2000-ta në këtë habitat janë ndërtuar 5 gurthyes të cilët janë duke shkatërruar dhe degraduar seriozisht habitatin e këtij lloji. Popullacionet në Gazimestan dhe Gërmi kanë areal të kufizuar por janë më pak të ndikuara nga faktori negativ antropogjen.	I përkeqësuar

15	<i>Haplophyllum suaveolens</i> (De Cand.) G. Don Emri shqip: <i>Haplofil erëmirë</i> Familja: Rutaceae	Shumëvjeçare (Kamefite Ch). Kërcejtë barishtor të drejtë ose gati të drejtë, të padegëzuar, me gjatësi 10-40 cm, të gjelbër ose gjelbër-kaltër, të mbuluara ose jo me qime kaçurrele. Gjethet e poshtme me bisht të shkurtër, tjerat të ulura, të shogëta, të mbuluara me qime të shkurtra, heshtore, të ngushta heshtore ose ovale eliptike, në majë kreshtake, me numër të madh të gjëndrave. Lulesa vastak. Bishtat e luleve me qime të shkurtra. Kupa pesë anëtarëshe. Sepalet zakonisht ovale, të dhëmbëzuara ose jo, kreshtake në majë, të shogëta ose të mbuluara me qime, leshtore përgjatë buzëve, të gjata 2-2.5 mm, mbeten në bimë. Kurora qëndron gjatë e lulëzuar, e verdheme. Petalet 7-10 mm, ovale, në majë të rrumbullakëta, buzë të plota, të shogëta ose në anën e jashtme me vija (linja) të zeza dhe të mbuluara me qime dhe gjëndra. Thëkë 10, me filamente të lira. Fryti i ndarë në 5 pjesë, në secilën pjesë nga 4 fara. Lulëzon VII. Frynon VIII (Josifovic, M. et al. 1973).	Evropë Juglindore nga Maqedonia deri në Ukrainën lindore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1973).	Në Kosovë rritet në vende të thata me bazë shkëmbore serpentine por edhe Vojtesh gëlqerore. Gjendet në shoqëri me llojet: <i>Convolvulus cantabricus</i> , <i>Sideritis montana</i> , <i>Potentilla tommasiniana</i> , <i>Orlaya grandiflora</i> , <i>Crupina vulgaris</i> , <i>Silene vulgaris</i> , <i>Sedum ochroleucum</i> , <i>Artemisia lobelii</i> , <i>Vincetoxicum huteri</i> , <i>Scleranthus perennis</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Onosma aucherianum</i> , <i>Sedum acre</i> , <i>Sedum serpentinum</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Ziziphora capitata</i> , <i>Orlaya grandiflora</i> , <i>Asyneuma limonifolium</i> etj.	Për herë të parë prezencën e këtij lloji në Kosovë (Zatriq) shënohet si <i>H. suaveolens f. ciliatum</i> më 1990 (Krasniqi, F. et al. 1990). Gjendja e një Popullacioni është vlerësuar në lokalitetin Vojtesh (relacioni Braboniq-Skenderaj) më 25.06.2013 (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Gërmi dhe Gallushë (Suharekë) dhe Kaznik (Krasniqi, E. 2021).	Popullacionet e këtij lloji kanë përhapje të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në veçanti numri i individëve është shumë i vogël në lokalitetin Vojtesh. Për momentin subpopullacionet e tjera të këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.
16	<i>Paramoltkia doerfleri</i> (Wettst.) Greuter & Burdet [<i>Moltkia doerfleri</i> Wettst.] Emri shqip: - [<i>Moltke e Dërflerit</i>] Familja: Boraginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcej 30-50 cm, të ngritur, të thjeshtë, të mbuluara me kreshtëza të rrasura; kërcejtë dalin nga një rizomë simpodial horizontal të trashë. Gjethet heshtore të mprehta të mbuluara me kreshtëza të shpërndara të rrasura, si edhe me qerpikë; kupa rreth 10 mm, me vriguj rënës. Kurora 19-25 mm, e zgjeruar gradualisht në pjesën e sipërme, e	Pjesa jugore e Ballkanit. Sipas Carni, A. et al. (2009) është e përhapur në pyjet termofile gjethërenëse të Evropës jugore (Quercion confertae dhe Carpinion orientalis).	Në Kosovë ky lloj rritet në kuadër të disa asociacioneve që i takojnë aleances Quercion frainetto. Në rajonin e Mirushës dhe në Bokat e Morinës është konstatuar edhe në kuadër të asociacionit Forsythio Quercetum petraeae si dhe Polygalo Forsythietum europaeae e shoqëruar nga llojet: <i>Quercus frainetto</i> , <i>Quercus petraeae</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Gladiolus illyricus</i> , <i>Potentilla alba</i> , <i>Juniperus oxycedrys</i> etj.	Boka të Baqevcit, Duhel, Blinaj, afër Kaçanikut, Guri i Zi, Novobërdë, Rajoni i Mirushës, Koznik, Bokat e Morinës. Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë, me përjashtim të Popullacionit të këtij lloji në Blinaj dhe rajonin e Mirushës që janë të pasura me individë maturë dhe të rinj. Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës	Gati i rrezikuar.

		purpurt e errët. Fijet 1.5-2 mm; pjalmoret 2.5-3 mm, me dy majucë, të përmbyllura brenda gypit. Akenet rreth 4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë dhe rizomë. Qosja, Xh. et al. (1996).				numëron <100 individ maturë.	
17	Potentilla visianii Panc. Emri shqip: Potentillë e Visianit Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj lulorë deri 40 cm, pushlore me qime të gjata e të hapura dhe gjëndërore. Gjethet pendore me 11-17 gjethëza; gjethëzat pykore-vezake të përmbysta, 4-25 x 3.5-16 mm, me 2-7 dhëmbë. Lulet zakonisht të shumta, në cima të çlirëta skajore. Këmbëzat zakonisht 10 mm ose me shumë. Nënpetlat trekëndëshe-heshtore. Kupëza me vriguj. Lulëzon VII-VIII. Fytënon VIII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi)	Në Kosovë rritet mbi substrat serpentiner, rrallë gëlqeror (Pashtrik), në kuadër të asociacioneve: Quercetum pubescentis cerris, Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea, Astero-Juniperetum oxycedrii; e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Juniperus oxycedrus, Forsythia europaea, Halacsya sendtneri, Euphorbia glabriflora, Polygala doerfleri, Stachys scardica, Centaurea kosanini, Alyssum markgrafii, Prunus mahaleb, Thesium dollineri etj. Në Pashtrik rritet në shkëmbinj gëlqeror ose në kullota subalpine e shoqëruar nga llojet: Achillea holosericea, Isatis tinctoria, Dianthus cruentus, Dianthus sylvestris, Helianthemum canum, Medicago sp., Anthemis montana, Anthyllis aurea, Stachys alpina, Gentiana lutea, Globularia cardifolia, Aster alpinus etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Krasniqi, E. (2003, 2021), Krasniqi, E.& Millaku, F. (2007), Rexhepi, F.(2000) është e përhapur në Pashtrik, Koprivnik, Rogozna, Lugina e Ibrit dhe rajon të Mirushës. Sipas Josifovic et al.(1972) gjendet në Koprivnik. Sipas Saric et al. Foto: Fadil Millaku (2013), Pashtrik (1986) në Kopaonik, Golesh, Pashtrik. Janë konstatuar edhe popullacione me areal të kufizuar (të vogla) edhe në Badovc, Gubavc, Bokat e Baqevcit, Korishit (Mushtisht) dhe Koznik (Llapçevë).	Të gjitha popullacionet në këtëj lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël. Shumica e popullacioneve gjenden në substrate serpentimore ku verat janë të nxehta dhe të thata. Popullacioni në Koprivnik (Gubavc) ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve. Popullacioni i këtëj lloji në Pashtrik shtrihet mbi substrat karbonat dhe ka areal të kufizuar, është me stabili dhe më i pasuri me individ maturë në krahësim me lokalitetet tjera.	Gati i rrezikuar.

18	<i>Centaurea kosaninii</i> Hayek. Emri shqip: <i>Kokoçel i Koshaninit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë deri 70 cm, pak të degëzuar në pjesën e sipërme. Gjethet të shogëta, zakonisht dyfish pendore të çara; segmentet jo më shumë se 1 mm të gjërë, ngushtësisht vizakë. Pëshjtjella me diametër rreth 15 mm; shtojcat të ngushta, kinde-kinde deri me dhëmbë të shkurtër, të verdhërreme. Lulet manushaqe ose të kuqe të errëta. Akenët 3.5 mm, sa 1/2 e gjatësisë së xhufkës. Lulëzon VI. Frynnon VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni-endemike (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Rexhepi, F. 1994, 2000; Krasniqi, F. 1982, 1987, Tutin, T. G. et al. 1976; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë rritet në vende të thata shkëmbore e kullota me natyrë serpentinore (Halacsyetalia sendtneri) por edhe gëlqerore të zonave malore. Shoqërohet nga llojet: <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Stachys recta</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Halacsya sendtneri</i>, <i>Stachys scardica</i>, <i>Campanula lingulata</i>, <i>Astragalus onobrychis</i>, <i>Potentilla visianii</i>, <i>Melanpyrum cristatum</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Veronica andrasovszkyi</i>, <i>Aster albanicus</i> subsp. <i>albanicus</i>, <i>Scabiosa fumaroides</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Sanguisorba albanica</i>, <i>Genista hassertiana</i>, <i>Serratula radiata</i>, <i>Jurinea mollis</i>, <i>Dianthus cruentus</i> etj. Foto: Elez Krasniqi (2013), Pashtrik	Brezovicë, Koznik, Godanc, Gllanasellë, Badovc (Rexhepi, F. 1978, 1979, 1985, 1994, 2000, Josifovic, M. et al. 1975, Blečić, V. et al. 1969, 1971; Silic, C. 1988), Rajoni i Mirushës, Mali Drenicë (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua edhe në Gubavc më 06.06.2011 (F. Millaku, Xh. Mala), në Pashtrik më 21.07.2011 (F. Millaku, E. Krasniqi, Xh. Mala) dhe në lokalitetin Qafa e Prushit më 18.06.2011 dhe 18.09.2012 (F. Millaku, F. Rexhepi, Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Bokat e Morinës dhe rritet në bashkësi me llojin <i>Sanguisorba albanica</i>.	Popullacionet kanë përhapje të kufizuar por me numër të madh të individëve me përjashtim të Popullacionit në Malin Drenicë (Javor-Luzhnicë) i cili paraqet popullacion me numër shumë të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile me përjashtim të lokalitetit Badovc.	Më pak i rrezikuar.
19	<i>Forsythia europaea</i> Deg. et Bald. Emri shqip: <i>Boshtër e Evropës</i> Familja: Oleaceae	Bimë durorë-shkurre (Fanerofite P), e lartë deri 3m. Degëzat dhe njëjet janë me palcë dhe kthina. Gjethet të thjeshta dhe eliptike ose vezake të shogëta. Gjethet e degëve pa lule të dhëmbëzuara deri në ura, ato të degëve me lule buzëplota, 5-8 cm të gjata. Lulet të verdha me kupë rreth 3 mm dhe me kororë -15 mm të gjatë. Kapsula 1.2-1.5 cm. Riprodhohet me farë, Lulëzon IV-V, Frynnon VIII-IX. (Rexhepi, F. 2000)	Kosovë, Shqipëri.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore-serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Zakonisht rritet në shoqërim me llojet: <i>Cornus mas</i>, <i>Quercus pubescens</i>, <i>Quercus cerris</i>, <i>Acer monspessulanum</i>, <i>Fraxinus ornus</i>, <i>Sanguisorba minor</i>, <i>Centaurea montana</i>, <i>Viola sylvestris</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Filipendula hexapetala</i>, <i>Crataegus monogyna</i>.	Sipas Deg. et Doerfler (1897), Rexhepi (2000), Josifovic, M. et al. (1973), Blečić et Krasniqi (1971), Krasniqi, E. (2021) ky lloj është i përhapur në serpentinët e Shqipërisë veriore (regjioni i Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi dhe në këto lokalitete të Kosovës: Gubavc, Koznik, rajoni i Mirushës deri afër Rahovecit, Qafa e Prushit, Bokat e Morinës dhe Golesh.	Popullacionet e këtij lloji në Golesh dhe në rrethinën e Koznikut (Zatriq, Mirushë) janë në gjendje më të mirë në krahasim me popullacionet e këtij lloji në Qafë Prush, Qafë të Morinës dhe Gubavc. Popullacionet më të degraduara dhe më pak individë maturë janë popullacionet në Gubavc (Pejë) dhe Bokat e Morinës. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

20	<i>Halacsya sendtneri</i> (Boiss.) Dorbl. Emri shqip: <i>Halaçë e Sendtnerit</i> Familja: <i>Boraginaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-25 cm, me sistem rrënjor të gjatë dhe të fuqishëm. Kërçelli është i ngritur i padegëzuar i mbuluar me qime të ashpra dhe mbaron me një lulesë cimozike. Gjethet janë të thjeshta, me buzë të plota, në bazë të kërcellit janë lineare-heshtore, ato të kërcellit janë më të vogla të mbuluara me qime të ashpra. Lulet janë hermafrodite diçka zigomorfe. Kupa me 5 gjethtëza të ngjitura. Kurora është e verdhë-ari në formë hinke, në bazë 5 kupore. Thekë janë 5 të ngjitur për gypin e kurorës. Pistili me 1 shtyllëz dhe 1 vezore të mbitëshme, katër kthinore dhe në çdo kthinë nga 1 ovulë. Fryti është tetra-aken. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Rexhepi, F. 2000)	Bimë endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi, Kabas, et al. 2013).	Ky lloj rritet në vende me bar dhe shkëmbore mbi substrat serpentiner, e shoqëruar nga llojet: <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Euphorbia borrelieri</i> , <i>Hypericum barbatum</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Quercus petraea</i> , <i>Silene vulgaris</i> , <i>Centaurea kosaninii</i> , <i>Stachys recta</i> , <i>Prunus mahaleb</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (1978, 1979), Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021) është e përhapur në Golesh, Gubavc, Koznik dhe Llapçevë. Është konstatuar edhe në Bokat e Morinës, Qafë Prush, Guriq, Serpentinët e Mushtishtit (Bokat e Baçevcit, Bokat e Grejkovcit, Bokat e Korishit).	Popullacionet e këtij lloji në Golesh, Llapçevë, Koznik, Bokat e Morinës dhe Qafë Prush janë në gjendje të mirë dhe mjaft të pasura me individë maturë. Popullacioni i këtij lloji në Gubavc ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
21	<i>Linum flavum</i> L. Emri shqip: <i>Lin i verdhë</i> Familja: <i>Linaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me kërcëj të ngritur pak të degëzuar sipër, që dalin nga një rozetë e ngjeshur 20-60 cm dhe me pak ose pa rozeta jo lulembajtëse. Gjethet me 3 (-5) nervura, të poshtmet heshtore të përmbysta-pallake, 40-60×10-12 mm, të sipërmet heshtore, pabisht 20-40×7-11 mm, me 2 gjëndra në bazë. Lulesa e degëzuar, zakonisht me 25-40 lule. Sepalet 5-6 (-8) mm, heshtore, të thepëta me karenë e gjëndra në bazë. Petalet të verdha, 20-22×1113 mm, me llapë vezake të përmbysta dhe me thonjëz relativisht të shkurtër. Kapsula 5-6 mm me sqep afër 1 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1992).	Juglindore-Pontike.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në substrate serpentimore në kuadër të rendit <i>Halascietalia sendtneri</i> . Në Bokat e Morinës, Koznik dhe Mirush ky lloj takohet në biotope të njëjta me llojet <i>Linum tauricum</i> e me rrallë me llojin <i>Linum elegans</i> . Lloje tjera bimore që e shoqërojnë këtë lloj janë edhe: <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Halascia sendtneri</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Gladiolus illyricus</i> , <i>Linaria dalmatica</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Fraxinus ornus</i> etj.	Sipas literaturës ekzistuese (Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021) etj., është e përhapur në: Koznik, Mirushë, Brezovicë, Novobërdë, Gërmi, Oshlak. Gjatë vitit 2012-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Pashtrikun e Poshtëm, Bokat e Krevenikut, Bokat e Morinës, Gubavc dhe në Qafë Prush.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në Bokat e Morinës dhe në Koznik. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

22	<i>Polygala doerfleri</i> Hayek Emri shqip: <i>Poligalë e Dërflerit</i> Familja: Polygalaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e ngritur me kërcëp të drunjëzuar. Kërcejtë rreth 40 cm, të padegëzuar. Gjethet vizake heshtore, të mprehta , të shogëta. Vilet skajore ovoide-gjatore, të dendura në frytëzim të sheshta. Braktet pak më të gjata se këmbëzat. Lulet të trëndafilta. Flatrat 7-9 mm (11 mm në frytëzim), vezake përmbysët të gjëra me nervaturë të ndërthurura. Gypi i kurorës rreth 6 mm, gati i barabartë me petlat e sipërme. Gjinofori shumë i shkurtër. Kapsula me e shkurtër dhe me e ngushtë së flatrat. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit.	Rritet në substrate serpentinore, kullota dhe vende me bar, shpesh edhe në çeltira të pyllit të zonës malore në kuadër të asociacioneve: Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea dhe Polygalo-Genistetum hassertianae e shoqëruar nga llojet: Forsythia europaea, Aster albanicus, Euphorbia glabriflora, Hypericum barbatum, Potentilla visianii, Euphorbia barrelieri, Linum tauricum, Plantago argentea, Artemisia lobelii, Salvia ringens, Quercus pubescens, Forsythia europaea, Stachys scardica, Juniperus oxycedrus, Centaurea kosaninii, Scabiosa fumaroides, Genista hassertiana, Sanguisorba albanica etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2008), Josifovic et al. (1973), Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. (2003, 2021) është e përhapur në serpentine në rajonin e Mitrovicës dhe Koznikut, Alpe Shqiptaret (Gubavc), Bokati e Morinës, Qafë Prush, Rajoni i Mirushës, Koznik, Golesh, Rajoni i Mushtishtit (Greikoc, Korishë, Manastir), Guranë, Gradicë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë në afërsi të vendeve urbane dhe janë nën ndikim të faktorit zoootropogjen. Popullacionet në rajonin e Mirushës-Koznikut dhe rajonin e Morinës-Qafë Prush janë me areal më të gjërë dhe me numër të madh të individëve maturë. Popullacionet tjera kanë areal më të kufizuar dhe janë me shumë të ndikuara nga faktorët negativ që dëmtojnë habitatin dhe zvogëlojnë sipërfaqen e banimit të këtij lloji. Për momentin shumica e popullacioneve /subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	---	--	------------------------------	---	--	--	----------------------------

02- Rajoni Zhvillimor Veri

Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga shtatë (7) komuna: **Mitrovicë, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok, Skënderaj, Vushtrri, Leposaviq**. Ky rajon është i pasur me resurse natyrore. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 11 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore shumëvjeçare, shkurre dhe gjysmëshkurre.

Në formë tabelare është pasqyruar lista e aseteve të resurseve natyrore.




Figura 2. Polygala doerfleri



Tabela 2. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Veri

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I . Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR – VERI							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Daphne blagayana</i> Freyer Emri shqip: <i>Xerxele e Bllagajt</i> Familja: Thymelaeaceae	Gjysmëshkurë e përherë e blertë deri 30 cm (Kamefite Ch) me kërcëj të gjatë, të shtrirë, të degëzuar e të hapur, me gjethe vetëm në krye. Gjethet 3-6 cm, vezake të përmbysëta deri eliptike të zgjatura, shyte, të pabisht, të shogëta, lëkurorë. Lulet të bardha-krem, 15-18 mm, të merme, të pabisht, në kaptinëza, 10-15 së bashku. Braktetë të zbehta e pushbuta përposh, rreth 10 mm. Hipanti 15-20 mm, i ngushtë, me pak qime të mëndafshita. Nënpetlat 6 mm, shyte, të shtrira. Frytet bërthokla të bardhëme. Lulëzon IV-VI. Frytton VIII (IX). (Qosja, Xh. et al. 1992).	Gadishulli Ballkanik, e përhapur në pjesët veriore të Sllovenisë dhe në Karpatet Jugore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat serpentini, në pyje, kullota e shpate me bazë shkëmbore serpentine. Në Morinë (962 m l. m. d.) gjendet në vende shkurre me boshtër (F. europaea) në subsrat serpentini e shoqëruar në llojet: Forsythia europaea, Quercus petraea, Doronicum columnae, Erythronium dens-canis, Galium sylvaticum, Pulmonaria mollissima, Luzula sylvatica, Euphorbia amygdaloides, Primula veris etj. Në lokalitetin Kodra e Lartë (Kopaonik) (1530 m l. m. d.) gjendet në shpatije të zhveshura në substrat serpentini në kuadër të fitocenozës Daphno-Genistetum radiatae [Daphno-Cytisanthetum radiatae Foto: Elez Krasniqi (2011), Morinë serpentinicum. Në këto terrene gjendet në shoqëri me llojet: Genista radiata, Betula verrucosa, Rosa spinosissima, Dorycnium herbaceum, Polygala vulgaris, Polygala comosa, Dianthus cruentus, Euphorbia glabriflora, Echium rubrum, Ornithogalum umbellatum, Helianthemum nummularium, Scorsonera rosea etj.	Kopaonik (Kodra e lartë) (Rexhepi, F. 1994, 1985, 1986; Randjelovic, N. et al. 1979; MMPH 2008). Përpos vlerësimit të gjendjes në Kodrën e lartë (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi-14.06.2013), gjendja e Popullacionit të llojit u konstatua dhe u vlerësua në Morinë-lokaliteti “Lana e Madhe” më 19.04.2013 (F. Millaku dhe E. Krasniqi). Një popullacion i llojit gjendet edhe rrëzë Lubotenit-Vataj (18.03.2011, F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacionet në Kopaonik dhe Morinë janë me të pasura me individ maturë. Popullacioni në rrëzat e Lubotenit ka areal shumë të kufizuar dhe <100 individë maturë. Konsiderojmë se ky lloj mund të jetë i përhapur edhe në ndonjë lokalitet tjetër të ngushtë në Kosovë.	I rrezikuar.

2	Genista hassertiana (Bald.) Buchegger Emri shqip: Gjineshtra e Hasertit Familja: Fabaceae	Bimë gjysmëshkurre (Kamefite Ch), deri 40 cm e lartë e degëzuar dendur. Degët janë të shkurtra të mbuluara me qime të palosura. Braktet janë 1-2 mm të gjëra gati vizake. Lulesat janë në vile skajore, nga 2-4. Braktëzat janë 1 mm ose më të shkurtra. ``Flamuri`` është rreth 8 mm, nga posht i mbuluar me qime të dendura mëndafshi. Riprodhohet me farë, Lulëzon VI-VII. Frytton VIII. (Rexhepi, F. 2000).	Badlacci, ex Busheger (1912), në punimin e tyre e përmendin për Shqipërinë dhe Kosovën.	Ky lloj është i përhapur mbi substrat serpentini, në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore-malore, në kuadër të asociacionit Polygalo-Genistetum hassertianae Rritet në shoqërim nga llojet: Forsythia europaea, Polygala doerfleri, Aster albanicus, Echium rubrum, Tulipa sylvestris, Sedum serpentini, Salvia ringens, Gladiolus illyricus, Fumana bonapartei, Plantago subulata, Stachys scardica, Potentilla astracanica, Quercus pubescens, Centaurea kosanini.	Sipas Krasniqi, E. (2003, 2021), Rexhepi, F. (1979, 2000), është e përhapur në Luginën e Ibrit, Mitrovicë Koznik, Mrasor dhe Llapçevë, Malishevë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në lokalitetet Koznik, dhe në Luginë të Ibrit.	I rrezikuar.
3	Genista radiata (L.) Scop. Emri shqip: Gjineshtë rrezake Familja: Fabaceae	Shkurre (Fanerofite P), e ngritur deri 1 m me degë të kundrejta gati në çdo nyje. Gjethet janë me 3 brakte të kundrejta në çdo nyje, braktet janë 5-20×2-4 mm, heshiore të përmbysëta përfundi me qime të mëndafshita, përsipër gati të shogëta. Lulet janë në sqetullën e gjethëve të sipërme nga 4-12 bashkë në lemshekë skajore. Lulet më të poshtme kanë brakte të thjeshta, cipëthata, pak të çara trish dhe më të shkurtra se lulet tjera, braktezat 1-3 mm. Kupa është 4-6 mm me buzë gati aq sa gypi. Kurora është e verdhë, me karene 10-11 mm, flamuri vezak 9×6 mm dy vrigujsh në maje, i shogët ose me qime të mëndafshita në nervurën e mesit. Bishtaja është vezake 4-5×3 mm me 1-2 fara. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VIII. (Rexhepi, F.	Evropa Juglindore.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentini dhe gëlqeror; në vende shkëmbore të zonës malore deri në zonën alpine. Në substrat serpentini është konstatuar në kuadër të asociacionit Daphno-Genistetum radiatae. Kurse në substrat karbonat është konstatuar në shkëmbinj ose në kullota të thata e shoqëruar nga llojet: Iris reichenbachii, Fritillaria messanensis subsp. gracilis, Achillea frassii, Daphnolepides, Plantago argentea, Euphorbia myrsinites, Gentiana lutea, Arctostaphylos uva-ursi, Viola zoysii etj.	Sipas Randjelkovic, N. & Rexhepi, F. (1979), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1972), ky lloj është i përhapur në lokalitetet: Kodra e Lartë, Kopronik, Koprivnik, Lipë, Pejë (Alpet Shqiptare). Millaku, F. me 19.05 dhe 20.06.2013 e konstatoi edhe nën Majën e Vjellakut në lartësi mbidetare nga 1700-1913 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar, mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i konsiderueshëm, me përjashtim të Popullacionit në Koprivnik, që ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të Popullacionit.	I rrezikuar.

4	<i>Haplophyllum boissierianum</i> Vis. et Panc. Emri shqip: <i>Haplofil i buasierit</i> Familja: Rutaceae	Bimë gjysmë shkurre (Kamefite Ch). Kërcejtë janë me gjatësi 6-25 cm, me push të përdredhur, pak a shumë leshtore në pjesën e lulesës. Gjethet janë të thjeshta 1040×1.5-3 mm heshtore deri heshtore të përmbyseta, të holluara poshtë me pak qime ose të shogëta. Lulesa është pak a shumë e dendur, sepalet janë vizake-heshtore. Kapsula është pushlore në faqen e brendshme afër majës me gjëndra të rralla pak a shumë zhardhokore poshtë, në çdo vrigull me nga një shtojcë konike me majë, që nganjëherë e ndarë në zhardhokë më të vegjël. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Vendet Ilire (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë)	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentinor në vende të thata me barë dhe shkëmbore të zonës kodrinoro-malore. Në pjesën me të madhe të habitateve ku është takuar ky lloj rritet i shoqëruar nga llojet: <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Dorycnium pentaphyllum</i> , <i>Campanula lingulata</i> , <i>Alyssum markgrafi</i> , <i>Quercus petraea</i> , <i>Salvia ringens</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Thalictrum minus</i> , <i>Sedum serpentinum</i> , <i>Sedum telephium</i> , <i>Forsythia europaea</i> etj.	Sipas Josifovic, M., et al. (1973, Krasniqi, E. 2021) është e përhapur në Luginën e Ibrit, Rogozna, Gubavc, Qafa e Prushit, Koznik. Gjatë viteve 2011-2013, Rexhepi, F. Pajazitaj, Q. Millaku, F. Krasniqi, E. dhe Mala, Xh. e konstatuan edhe në Bokat e Morinës (Ponoshec), Krevenik (Elez Han) Bokat e Baqevcit (Mushtisht), Gubavc (Koprivnik).	Edhe pse ky lloj në Kosovë ka përhapje të gjërë dhe formon disa popullacione; këto popullacione kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël, me përjashtim të popullacioneve në Qafë Prush dhe Bokat e Morinës që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
5	<i>Galatella albanica</i> Degen [Aster albanicus (Degen) Degen] Emri shqip: - [Aster shqiptar] Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-35 cm e lartë. Kërçelli i përprjetëm deri i ngritur, me qime të mërimangëta-tufore përposh. Gjethet heshtoret përmbysta deri pallake, gjëndërore, me qime të mërimangëta-leshtore. Kapitinëzat në vastak të çlirët ose të vetmuara, me bisht të gjatë. Braktetë e pështjellës në tri radhë, të jashtmet e të mesit vizake-heshtore, me majë të fëndyellët, të brendshmet majëmprehta, me buzë të gjëra cipëthata. Lulet llapore 12-14, vjollcë. Qimet e xhufkës të pabarabarta. Lulëzon VII-IX, frytëzon IX-X. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike (Subendemike), Kosovë, Shqipëri. Sipas Tutin et al. (1976) është i përhapur në malet midis Shqipërisë dhe Kosovës.	Rritet në substrate serpentine dhe kullota të zonës malore në kuadër të asoc. <i>AsteroJuniperetum oxycedrii</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Aristolochia merxmulleri</i> , <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Echium rubrum</i> , <i>Halacsya sendtneri</i> , <i>Genista hassertiana</i> , <i>Sedum serpentinum</i> , <i>Sedum hispanicum</i> , <i>Veronica andrazovszkyi</i> , <i>Gladiolus illyricus</i> , <i>Sanguisorba albanica</i> , <i>Linum tauricum</i> , <i>Potentilla astracanica</i> [P. hirta].	Sipas Krasniqi, E. (2003, 2006), Josifovic, M. et al. (1975), Blečić V., et al. (1969), Blečić al. (1968), Krasniqi, E. & Millaku, F. (2004), Krasniqi, E. et al. (2012), Rexhepi, F. Foto: Fadil Millaku (2013), Mushtisht (2000) është e përhapur në serpentine të Kosovës (Rajoni i Mirushës, Mrasorit, Llapçevës, serpentinete e Mushtishtit (Bokat e Mushtishtit, Grejkocit dhe Korishit), Qafë Prush, Planik-Morinë. Sipas Rexhepit (2000) është e përhapur në Planik, Çerret, Luginë të Ibrit, Koprivë, Gllanasellë-Godanc, Kramavik, Koznik dhe Çerret.	Në Kosovë popullacionet e këtij lloji gjenden afër vendbanimeve dhe nën ndikimin e kullotjes intensive. Në lokalitet ku rritet ku lloj shpesh takohen deponi të mbeturinave dhe gurthyes të cilët dëmtojnë habitatin e këtij lloji.	I përkeqësuar.

6	Ramonda serbica Pancic Emri shqip: Ramondë e Serbisë Familja: Gesneriaceae	Shumëvjeçare me rozetë bazale, 15-20 cm e lartë (Hemikriptofite H). Gjethet 3.5x1.3 cm, të thjeshta, përsipër të kreshpëta, përposh leshore të murrme, pa ndajgjethëza, vezake të përmbysëta, të ngushta, kunjore në bazë, me buzë ura-ura ose dhëmbëdhëmbë; bishtaku zakonisht i shkurtër, me qime. Shtija 6-8 cm, me 1-3 lule, 5 pjesëshe, pothuajse aktinomorfe. Kurora si tas, me diametër 2.5-3 cm, me vriguj të drejtë-të hapur, lila deri manushaqe. Pjalmoret manushaqe-blu. Krezat të kokët. Fryti kapsulë septicide, më i gjatë se kupa. Lulëzon VI. Frynon VII. (Tutin, T. G. et al. 1972).	Serbi, Maqedoni, Mali i Zi, Shqipëri, Kosovë, Epir dhe Bullgari (Tutin, T. G. et al. 1972; Josifovic, M. et al. 1974; Jordanov, D. et al. 1995; Polunin, O. 1997; Vladimirov, V. et al. 2007; Gashi, B. 2013).	Në Kosovë rritet në të çarat e shkëmbinje gëlqeror me hije të zonave malore deri subalpine (500-1800 m l. m. d.) në shoqëri nga llojet: Achillea ageratifolia, Hieracium racemum, Hedera helix, Arabis verna, Asplenium ruta-muraria, Ceterach officinarum, Sedum album, Campanula versicolor, Hieracium waldsteinii, Arabis caucasica, Phyllitis scolopendrium, Polypodium vulgare, Saxifraga rotundifolia, Oxalis acetosella, Silene saxifraga, Sempervivum tectorum, Pimpinella saxifraga, Saxifraga sempervivum, Valeriana montana, Sedum telephium, Calamintha acinos etj.	Alpet Shqiptare-Gryka e Zhlebit, Radac, Gryka e Sushicës, Gryka e Rugovës, Gryka e Koprivnikut, Malet e Sharrit - Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Oshlak, Gryka e Rusenicës, Guri i Matosit, Shkëmbi i Përgjakur, Gryka e Dollocit, Pashtrik, rritet edhe në Luginën e Ibrit (Gashi, B. 2013; Gashi, B. et al. 2012; Josifovic, M. et al. 1974; Zeneli, L. 1975; Krasniqi, F. 1982, 1998; Millaku, F. 1993, 1997, MMPH 2008).	Popullacionet shtrihen në lartësinë mbidetare 530-1651 m. Kanë përhapje të kufizuar. Popullacione me numër të vogël të individëve janë ato në Radac dhe në Grykën e Koprivnikut. Popullacionet në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, Grykën e Rugovës, Radac dhe në Grykën e Zhlebit janë të ndikuara nga urbanizimi dhe ndotja. Këto popullacione mund të rrezikohen edhe nga njeriu, sepse gjenden në zona turistike, ku faktori antropogjen ka ndikim. Popullacionet janë të rrezikuara edhe nga gërryerja e masiveve shkëmbore nga kompanitë që merren me prodhimin e rërës (lokalitetet: Gryka e Rusenicës dhe Gryka e Lumit Sushicë).	I përkeqësuar.
---	---	--	--	---	---	---	----------------

7	<i>Haplophyllum suaveolens</i> (De Cand.) G. Don Emri shqip: <i>Haplofil erëmirë</i> Familja: Rutaceae	Shumëvjeçare (Kamefite Ch). Kërcejtë barishtor të drejtë ose gati të drejtë, të padegëzuar, me gjatësi 10-40 cm, të gjelbër ose gjelbër-kaltër, të mbuluara ose jo me qime kaçurrele. Gjethet e poshtme me bisht të shkurtër, tjerat të ulura, të shogëta, të mbuluara me qime të shkurtra, heshtore, të ngushta heshtore ose ovale eliptike, në majë kreshtake, me numër të madh të gjëndrave. Lulesa vastak. Bishtat e luleve me qime të shkurtra. Kupa pesë anëtarëshe. Sepalet zakonisht ovale, të dhëmbëzuara ose jo, kreshtake në majë, të shogëta ose të mbuluara me qime, leshtore përgjatë buzëve, të gjata 2-2.5 mm, mbeten në bimë. Kurora qëndron gjatë e lulëzuar, e verdheme. Petalet 7-10 mm, ovale, në majë të rrumbullakëta, buzë të plota, të shogëta ose në anën e jashtme me vija (linja) të zeza dhe të mbuluara me qime dhe gjëndra. Thëkë 10, me filamente të lira. Fryti i ndarë në 5 pjesë, në secilën pjesë nga 4 fara. Lulëzon VII. Frynon VIII (Josifovic, M. et al. 1973).	Evropë Juglindore nga Maqedonia deri në Ukrainën lindore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1973).	Në Kosovë rritet në vende të thata me bazë shkëmbore serpentine por edhe Vojtesh gëlqerore. Gjendet në shoqëri me llojet: Convolvulus cantabricus, Sideritis montana, Potentilla tommasiniana, Orlaya grandiflora, Crupina vulgaris, Silene vulgaris, Sedum ochroleucum, Artemisia lobelii, Vincetoxicum huteri, Scleranthus perennis, Fumana bonapartei, Onosma aucherianum, Sedum acre, Sedum serpentinum, Sanguisorba minor, Ziziphora capitata, Orlaya grandiflora, Asyneuma limonifolium etj.	Për herë të parë prezenca e këtij lloji në Kosovë (Zatriq) shënohet si H. suaveolens f. ciliatum më 1990 (Krasniqi, F. et al. 1990). Gjendja e një Popullacioni është vlerësuar në lokalitetin Vojtesh (relacioni Braboniq-Skenderaj) më 25.06.2013 (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Gërmë dhe Gallushë (Suharekë).	Popullacionet e këtij lloji kanë përhapje të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në veçanti numri i individëve është shumë i vogël në lokalitetin Vojtesh. Për momentin subpopullacionet e tjera të këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.
---	--	--	--	---	--	--	--------------------------

8	Potentilla visianii Panc. Emri shqip: Potentillë e Visianit Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj lulorë deri 40 cm, pushlore me qime të gjata e të hapura dhe gjëndërore. Gjethet pendore me 11-17 gjethëza; gjethëzat pykore-vezake të përmbysta, 4-25 x 3.5-16 mm, me 2-7 dhëmbë. Lulet zakonisht të shumta, në cima të çlirëta skajore. Këmbëzat zakonisht 10 mm ose me shumë. Nënpetlat trekëndëshe-heshtore. Kupëza me vriguj. Lulëzon VII-VIII. Fytënon VIII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi).	Në Kosovë rritet mbi substrat serpentinor, rrallë gëlqeror (Pashtrik), në kuadër të asociacioneve: Quercetum pubescentis cerris, Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea, Astero-Juniperetum oxycedrii; e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Juniperus oxycedrus, Forsythia europaea, Halacsya sendtneri, Euphorbia glabriflora, Polygala doerfleri, Stachys scardica, Centaurea kosanini, Alyssum markgrafii, Prunus mahaleb, Thesium dollineri etj. Në Pashtrik rritet në shkëmbinj gëlqeror ose në kullota subalpine e shoqëruar nga llojet: Achillea holosericea, Isatis tinctoria, Dianthus cruentus, Dianthus sylvestris, Helianthemum canum, Medicago sp., Anthemis montana, Anthyllis aurea, Stachys alpina, Gentiana lutea, Globularia cardifolia, Aster alpinus etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Krasniqi, E. (2003), Krasniqi, E.& Millaku, F. (2007), Rexhepi, F.(2000) është e përhapur në Pashtrik, Koprivnik, Rogozna, Lugina e Ibrit dhe rajon të Mirushës. Sipas Josifovic et al.(1972) gjendet në Koprivnik. Sipas Saric et al. Foto: Fadil Millaku (2013), Pashtrik (1986) në Kopaonik, Golesh, Pashtrik. Janë konstatuar edhe popullacione me areal të kufizuar (të vogla) edhe në Badovc, Gubavc, Bokat e Baqevcit, Korishit (Mushtisht) dhe Koznik (Llapçevë).	Të gjitha popullacionet në këtë lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël. Shumica e popullacioneve gjenden në substrate serpentinore ku verat janë të nxehta dhe të thata. Popullacioni në Koprivnik (Gubavc) ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik shtrihet mbi substrat karbonat dhe ka areal të kufizuar, është me stabili dhe më i pasuri me individë maturë në krahasim me lokalitetet tjera.	Gati i rrezikuar.
9	Sedum serpentini Janch. Emri shqip: Rrushqyqe e serpentinite Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore hollake, e shogët, me kërcëj shterpë. Kërçelli lulor 8-12 cm. Gjethet gjatore-cilindrike, 2-4 mm, shyta. Lulesa vastakore. Sapalet vezake-heshtore, pak shyta deri gati të mprehta. Petalet 3.5-4 mm, të mprehta, ngjyrë purpur. Thëkë 10. Rrëshikthet të ngritura, të trëndafilta. V-VIII. (Paparisto et al. 1988).	Shqipëri, Kosovë, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemike-Ballkanike).	Ky lloj është i përhapur në substrat serpentinor nga zona kodrinore deri të zona alpine (Maja e Pashallarëve). Zakonisht rritet e shoqëruar nga llojet: Centaurea kosaninii, Juniperus oxycedrus, Fraxinus ornus, Euphorbia glabriflora, Polygala doerfleri, Halacsya sendtneri, Alyssum sp., Stachys scardica, Campanula lingulata, Stipa sp., Haplophyllum boesierianum, Thesium dolineri, Scorsonera austriaca, Vincetoxicum sp., Astragalus onobrychis, Potentilla visiani. Në Pashallarë rritet së bashku me llojin endemik Bornmuellera dieckii.	Brezovicë, Ostrovicë, Pllanik, Bokat e Morinës, Llapçevë, Mrasor, Koznik, Gubavc (Koprivnik), Lugina e Ibrit.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura në shumicën masivëve malor me natyrë serpentine. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i vogël.	Gati i rrezikuar.

10	<i>Polygala doerfleri</i> Hayek Emri shqip: <i>Poligalë e</i> <i>Dërflerit</i> Familja: Polygalaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e ngritur me kërcëp të drunjëzuar. Kërcejtë rreth 40 cm, të padegëzuar. Gjethet vizake heshtore, të mprehta, të shogëta. Vilet skajore ovoide-gjatore, të dendura në frytëzim të sheshta. Braktet pak më të gjata se këmbëzat. Lulet të trëndafilta. Flatrat 7-9 mm (11 mm në frytëzim), vezake përmbysët të gjëra me nervatura të ndërthurura. Gypi i kurorës rreth 6 mm, gati i barabartë me petlat e sipërme. Gjinofoi shumë i shkurtër. Kapsula me e shkurtër dhe me e ngushtë së flatrat. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit.	Rritet në substrate serpentinore, kullota dhe vende me bar, shpesh edhe në çeltira të pyllit të zonës malore në kuadër të asociacioneve: Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea dhe Polygalo-Genistetum hassertianae e shoqëruar nga llojet: Forsythia europaea, Aster albanicus, Euphorbia glabriflora, Hypericum barbatum, Potentilla visianii, Euphorbia barrelieri, Linum tauricum, Plantago argentea, Artemisia lobelii, Salvia ringens, Quercus pubescens, Forsythia europaea, Stachys scardica, Juniperus oxycedrus, Centaurea kosaninii, Scabiosa fumaroides, Genista hassertiana, Sanguisorba albanica etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2008), Josifovic et al. (1973), Blecic et al. (1968), Krasniqi, E. (2003, 2021) është e përhapur në serpentine në rajonin e Mitrovicës dhe Koznikut, Alpe Shqiptaret (Gubavc), Bokat e Morinës, Qafë Prush, Rajoni i Mirushës, Koznik, Golesh, Rajoni i Mushtishtit (Greikoc, Korishë, Manastir), Guranë, Gradicë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë në afërsi të vendeve urbane dhe janë nën ndikim të faktorit zooantropogjen. Popullacionet në rajonin e Mirushës-Koznikut dhe rajonin e Morinës-Qafë Prush janë me areal me të gjërë dhe me numër të madh të individëve maturë. Popullacionet tjera kanë areal me të kufizuar dhe janë me shumë të ndikuara nga faktorët negativ që dëmtojnë habitatin dhe zvogëlojnë sipërfaqen e banimit të këtij lloji. Për momentin shumica e popullacioneve /subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
11	<i>Scabiosa fumarioides</i> Vis. et Panc. Emri shqip: <i>Skabiozë si fomi</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë shumëvjeçare (Kamefite CH) me rrënjë të trasha, gati të drunjëzuara, nga dalin disa kërcëj të përpjetë, disa herë të degëzuar; degët të gjata, të gjelbra - kaltroshe, poshtë me qime të mbështetura ose të shogëta. Gjethet e poshtme në rozetë bazale të dendur, me bishtak, të prera në segmente rezhdore-trishe-pendore; segmentet gjatore-vizake, shytë, me një kreshtë pak a shumë të gjatë në majë, me buzë të përvjelur, me një dell; gjethet e kërcellit pabishtak me segmente pendore ose dyfish pendore të ndara thellësisht, segmentet të gjata dhe të qëndrueshme. Këmbëzat e kaptinëzave të gjata, të holla dhe pa gjethe. Braktet e pështjellës	Siujdhesa Ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Ky lloj në Kosovë gjendet i përhapur në substrate shkëmbore serpentinore dhe gëlqerore. Në substrate serpentinore të Kosovës gjendet në kuadër të asociacioneve Astero-Juniperetum oxycedri, Polygalo-Forsythietum europaea, Polygalo-Genistetum hassertianae (Blecic, V., Krasniqi, F. 1972) dhe Onosma-Scabietosum fumaroides (Rexhepi, 1978). Në Pashtrik gjendet në substrat gëlqeror në kullota të zones malore (1450 m) e shoqëruar nga llojet: Centaurea kosaninii, Serratula radiata, Plantago argentea, Koeleria gracilis, Ostrya carpinifolia, Amelanchier ovalis, Trifolium alpestre, Asphodelus albus, Jurinea mollis, Veratrum nigrum, Teucrium montanum, Eryngium palmatum, Dianthus cruentus, etj.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në Koznik, Mirushë, Mali i Drenicës (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021), Gryka e Duvnes, Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Lugina e Ibrit (Mitrovicë), Bokat e Morinës, Brod (shpati jugor i lumit).	Popullacionet e këtij lloji në Pashtrik, Grykë te Lumëbardhit të Prizrenit dhe Mirushë edhe pse kanë areal të kufizuar janë me të pasura me individë maturë krahasuar me popullacionet tjera prezentë në Kosovë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

vizake-gjatore, më të
shkurtra se kaptinëzat,
shumë a pak me qime të
shkurtra të mbështetura.
Kaptinëzat tophore, në
kohen e frytënimit
vezake. Lulet të verdha,
së jashtmi me qime të
rralla. Korona me 8
brinjë gjator, të mbuluar
me qime të rralla, në
bazë me qime të
dendura, me majë
cipëthatë, të zgjeruar,
me 30 dejë. Kupa pa
këmbëz, e murrme, me
5 dhëmbë, dhëmbët
trekëndorë të ngushtë,
me kreshtë shumë të
shkurtër ose pa të.
Lulëzon VI-VII.
Frytton VII-VIII.
(Qosja, Xh. et al.1996).

03- Rajoni Zhvillimor Perëndim

Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga katër (4) komuna: **Pejë, Istog, Klinë, Deçan**. Rajoni Perëndim është shumë i pasur me përhapje dhe llojllojshmëri të florës. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 104 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore njëvjeçare, dyvjeçare dhe shumëvjeçare, shkurre, gjysmëshkurre, bimë shumëvjeçare tufore, myshqe, shumëvjeçare me rozetë bazale etj.

Në formë tabelare është paraqitur lista e aseteve të resurseve natyrore.




Figura 3. Wulfenia bleicii



Figura 4. Erigeron epiroticus



Tabela 3. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Perëndim

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I . Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR - PERËNDIM							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Crepis bertscea</i> Jav. Emri shqip: <i>Shmangë bertsce</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me kërcëj 50-60 cm, të degëzuar afërsisht nga mesi. Gjethet të shëgëta me përjashtim të dellit kryesor i cili përposh është pushlor; gjethet e bazës gjatore të përmbysëta, majëmprehta, lirake me prerje të thella të kthyera drejt bazës, gjirake, të dhëmbëzuara, me dhëmbë ngushtësisht gjatë të përmbysët ose vizakë; kërcelloret e poshtme 15-19x3-6 cm, eliptike, majëmprehta, gati lirake-pendore, të çara, pjesa fundore jo tërësisht e segmentuar dhe me dhëmbë të thepët, segmentët anësorë të shumtë, të ngjeshur, vizake-heshtore, të thepët, të dhëmbëzuar ose të plotë, gradualisht të zvogëluar në gjatësi nga maja në bazë e gjethes; kërcelloret e sipërme vizake, të thepëta, të plota, të pabisht, kërcellpështjellëse. Pështjella 10-12x7-9 mm; braktetë vizake-heshtore, majëmprehta, të jashtmet sa 1/3 e	Shqipëri, Kosovë (Rexhepi, F. 2000, 1994, 1986, Tutin, T. G. et al. 1976, Kovats, D. 2000).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat karbonat, në vende të thata shkëmbore të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea fraasii</i> , <i>Hieracium waldsteinii</i> , <i>Rhamnus orbiculata</i> , <i>Hesperis matronalis</i> , <i>Ramonda serbica</i> , <i>Peucedanum austriacum</i> , <i>Centaurea Zhleb atropurpurea</i> etj.	Alpet Shqiptare-Gryka e Sushicës (Josifovic, M. et al. 1975; Rexhepi, F. 1986, 1997, 2000; Krasniqi, F. 1998). Me 23.06.2013, F. Millaku dhe Xh. Mala e konstatuan dhe e vlerësuan gjendjen e Popullacionit të llojit edhe në Zhleb në lartësi mbidetare nga 1325-1400 m. Zhleb, Pejë.	Deri me tani janë konstatuar dy popullacione të këtij lloji në Kosovë (Gryka e Sushicës dhe Zhleb). Popullacioni i këtij lloji në Grykën e Sushicës ka areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji në Zhleb ka areal shumë të kufizuar (<1 km ²) dhe numri i individëve maturë është <50.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		gjatësisë së të brendshmëve, të përhimta-pushbuta. Lulet janë të verdha. Akenët 5.57.5x0.8 mm, kafe të errët, gjatore të përmbysët ose boshtorë, të ngushtuar në një sqep të shkurtër, me 13-18 brinjë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).					
2	<i>Delphinium elatum</i> L. Emri shqip: <i>Gjuhënuse</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur, të lartë 40200 cm. Gjethet me bishta të gjatë, të çara në segmente gishtore (3-7), gjatoke të dhëmbëzuara si sharrë, të shogëta, nga kundërfaqja me qime përgjatë nervave. Lulesa vile, shpesh e e degëzuar. Braktet lineare, të plota ose të poshtme të ndara. Bishtat e luleve të shogëta ose me qime. Lulet të kaltra ose vjollcë. Fletëzat e periantit (9-) 13-22 mm të gjata, vezake. Shpori i trashë, gati sa dyfishi i këmbëzës. Gjethet mjaltore 4, dy të epërmet me shpor. Fryti 12-15 mm i gjatë dhe 3-5 mm i gjërë. Farat me linja të gjata 3-4 mm. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII.	Evropë, Azi.	Ky lloj në Kosovë rritet buzë pyllit të ahut ose ahut me bredh (Abieti-Fagetum) e shoqëruar nga llojet: <i>Fagus sylvatica</i>, <i>Rhamnus fallax</i>, <i>Tanacetum macrophyllum</i>, <i>Digitalis ambigua</i>, <i>Ribes alpinum</i>, <i>Acer heldreichii</i>, <i>Hesperis dinarica</i> etj.	Millaku, F. & Mala, Xh. me 04.08.2013 këtë lloj e konstatuan në Zhleb në lartësi mbidetare 1389 m. Zhleb, Pejë	Popullacioni i këtij lloji në Alpet Shqiptare (Zhleb) ka areal shumë të kufizuar, dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Ky lloj shtrihet buzë pyllit në anën e majtë të Rrugës Pejë-Rozhajë afër kufirit me Malin e Zi.	Taksoni nuk është përfshirë në Listën e Kuqe të florës së Evropës
3	<i>Digitalis viridiflora</i> Lindley. Emri shqip: <i>Luletojëzi lulegjelbërt</i> Familja: Plantaginaceae [Scrophulariaceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pushlore 50-80 cm me kërcell të ngritur të thjeshtë. Gjethet gjatore-heshtore deri eliptike, me buzë dhëmbëza-dhëmbëza. Vilet të dendura shumëlulëshe. Vrigujt e kupës heshtorë,	Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, Bullgari, Serbi, Turqi (E).	Në Kosovë është konstatuar në substrat gëlqeror në kuadër të Pyllit (Abieti Fagetum) ose buzë rrugëve të pyllit e shoqëruar nga llojet: <i>Urtica dioica</i>, <i>Potentilla montenegrina</i>, <i>Origanum vulgare</i>, <i>Hypericum perforatum</i>, <i>Knautia dinarica</i>, <i>Fagus sylvatica</i>, <i>Abies alba</i>, <i>Picea abies</i> etj. Në Maqedoni sipas Carni, A. et al. (1997) takohet në kuadër të	Alpe Shqiptare (Zhleb, Josifovic, M. et al. 1974). Zhleb, Pejë	Popullacioni i këtij lloji në Zhleb, ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		majëmprehtë. Kurora 11-20 mm, gjelbëroshe e verdhë, me nervura të dallueshme; buza e poshtme pak më e gjatë së e sipërmja. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VIII-IX, riprodhohet me farë. (Qosja, Xh. et al. 1996).		asociacioneve nitrofile (Urtico-Geranium aristati).			
4	<i>Fibigia clypeata</i> (L.) Medik. Emri shqip: <i>Fibigë me mburojë</i> Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare, e mbuluar me qime të dendura yjore të përhimëta. Kërçelli 30-70 cm. Gjethet gjatore të përmbysta-pykore, të plota ose gjirake me dhëmbë. Nënpetlat anësore me gungë në fund. Petalet të verdha, të plota rreth 2 herë sa sepalet. Fijet e thekëve të gjata me flatra në fund. Fryti silikëz, 15-25 x 10-13 mm, eliptike, pushbutë, me këmbëz 4-5 herë me të shkurtër; shtyllëza e shkurtër; kthinat me 8-10 fara me flatra të gjëra . Lulëzon IV-VI, frytton VII-VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al.(1988).	Apenine, Ballkan, Turqi, Azia e Vogël, Afrikë Veriore. Sipas Shuka et al. (2007) është e përhapur në Shqipëri.	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat karbonat, vende të ekspozuara dritës (Carpinetum orientalis ose Quercetum pubescentis cerris) me gurë afër rrugëve të pyllit ose në shkëmbinj të izoluar dhe të rrethuar nga drunjtë termofil dhe shkurret. Në syne është konstatuar në shoqëri me llojet: <i>Ostrya carpinifolia</i>, <i>Carpinus orientalis</i>, <i>Crataegus monogyna</i>, <i>Quercus pubescens</i>, <i>Linaria peleonnesiaca</i>, <i>Colchicum autumnale</i> etj.	Sipas Stevanovic, V. et al. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Mali Mokna). Millaku, F. gjatë vitit 2012-13 këtë lloj e ka konstatuar mbi fshatin Syne (Istog).	Popullacioni i këtij lloji në Malet e Istogut (mbi fshatin Syne) ka areal shumë të kufizuar Foto: Fadil Millaku (2013), Mbi Syne (Istog) dhe numër të vogël të individëve maturë brenda këtij popullacioni.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
5	<i>Helleborus purpurascens</i> W.et K. Emri shqip: <i>Shpendra purpuroscente</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H, Geofite G), deri 35 cm e gjatë Gjethet bazale nuk dimërojnë, janë dy të ndara pëllëmbore me 5 vriguj. Vrigujt thellë në mes janë prapë të ndarë në 2-5 vriguj të vogël të cilët nga ana e poshtme janë në fillim me qime. Lulet 3.5-7 cm në diametër, braktet e periantit nga ana e jashtme kanë ngjyrë vjollce të mbyllët, nga ana e brendshme kanë ngjyrë të blertëvjollce. Shtyllëza e drejtë. Riprodhohet me	Evropë. Sipas Neacsu, C. et al. (2011) është e përhapur në Rumani.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në vende me shkurre dhe çeltira pyjesh të zonës subalpine dhe alpine në kuadër të asociacionit <i>Helleboro-Pinetum heldreichii</i>, e shoqëruar nga llojet: <i>Primula elatior</i>, <i>Primula veris</i>, <i>Pinus heldreichii</i>, <i>Daphne mezereum</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Crocus vernus</i>, <i>Scilla bifolia</i>, <i>Lilium albanicum</i>, <i>Daphne oleoides</i>, <i>Campanula foliosa</i> etj.	Sipas Millaku,F.(1999) është e përhapur në Majën e Strelcit. Millaku, F. me 30.06. 2012 këtë lloj e konstatoi edhe në Pleçe (Alpe Shqiptare) në lartësi mbidetare nga 1650-2100 m. Deçan	Në Kosovë deri me tani është konstatuar një popullacion në Bjeshkën e Strelcit dhe një subpopuacion në Pleçe. Edhe pse ky popullacion ka areal të kufizuar ka numër të Foto: Fadil Millaku (2012), Pleçe konsiderueshëm të individëve maturë. SubPopullacioni në Pleçe ka areal të kufizuar dhe numër me të vogël të individëve matur krahasuar me popullacionin e këtij lloji në Bjeshkën e Strelcit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		farë dhe rizomë. Lulëzon III-IX. Frytmon V. (Josifovic, M., et al. 1977)					
6	Lamium garganicum subsp. striatum (Sm.) Hayek Emri shqip: Hithëbutë e bigezuar Familja: Lamiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli është i shogët, i shtrirë për tokën, me degë të ngritura. Gjethet janë të shogëta ose me pak qime të vogla, me bisht të shkurtër, veshkore ose në formë të zemrës, me buzë të dhëmbëzuara. Qerthujt janë me 2-4 lule. Dhëmbët e kupës janë trekëndor, me majë të shkurtër. Kurora është e gjatë 2.5 cm, gypi është i drejt, më i gjatë se kupëza, zgjerohet kah gryka, në anën e brendshme është i shogët, nga jashtë me qime ngjyrë trëndafilverdhë. Anterat janë me tufa qimesh. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VIII. Frytmon VII-VIII.	Pjesa jugore e Ballkanit.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në shkëmbinj gëlqeror, vende ku shemben shkëmbinjtë ose vende të thata me bar të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Scrophularia laciniata, Sedum album, Cerastium decalvans, Potentilla apennina, Achillea abrotanoides, Achillea clavennae, Pedicularis verticillata, Salix retusa, Valeriana tripteris etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Millaku, F. (1999), Josifovic, M. et al. (1977) ky lloj është i përhapur në Koprivnik (Alpet Shqiptare). Deçan.	Në Kosovë deri me tani është konstatuar vetëm një popullacion i vogël i këtij lloji në Koprivnik (Alpe Shqiptare). Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
7	Leontopodium nivale subsp. alpinum (Cass.) Greuter [Leontopodium alpinum Colm. ex Cass.] Emri shqip: - [Ylli i alpeve] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-20 (-30) cm e gjatë. Kërçelli është i ngritur, i thjesht me qime formë pushi (leshi). Gjethet në bazë janë të plota, nga sipër më pak, ndërsa nga poshtë më shumë qime të dendura heshtore. Gjethet e rozetës dhe gjethet e poshtme janë të përmbysta-heshtore, me maje. Gjethet e sipërme janë lineare-gjatore, pa majë. Kaptina janë 1-10 (zakonisht 5-6) terminale në lulesa cimozike të mbështjella në formë ylli me brakte horizontale, 5-15, trekëndoreheshtore me	Evropë, Azi.	Ky lloj në Kosovë rritet në shkëmbinj gëlqeror të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Trifolium noricum, Trifolium badium, Ranunculus thora, Asperula doerfleri, Achillea clavennae, A. abrotanoides, Valeriana montana, Pinus mugo, Saxifraga serpemvivum etj.	Majën e Rusolisë dhe Hajlë, Pejë.	Në Kosovë ky lloj formon dy popullacione (Rusoli dhe Hajlë) që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit. Një pjesë e popullacionit të këtij lloji ka shtrirje jashtë kufijve të Kosovës – Mal të Zi.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		qime të bardha leshore. Të gjitha kaptinat në mes janë me lule gypore dyseksore, jo të dallueshëm dhe me lule femërore më skaj të hollë gypore-pejzore. Ndonjëherë disa kaptina janë vetëm me lule femërore ose vetëm me lule dyseksore. Gjethet e involukrumit janë të renditura si tjegullat në pullaz, me bazë të murrme lëkurore. Lulet janë të verdha-bardha. Xhufka është me qime të thjeshta. Akeni është i gjatë 1 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VII-IX. Frynnon VIII-IX. (Rexhepi, F., 1986).					
8	Malcolmia illyrica Hayek, [M. orsiniana (Ten.) Ten. subsp. illyrica Hayek] Emri shqip: Malkolmë ilirike Familja: Brassicaceae	Bimë njëvjeçare (Terofite T), me qime si mëqik ose rrezake 3-4 herë të çara. Kërcelet i degëzuar në bazë, me qime me 2-4 rreze. Gjethet gjatore të përmbysta ose vezake të përmbysta, pykore. Lulet trëndafil ose purpur; të poshtmet me brakte. Sepalet me qime si mëqik, 5-10 mm; të brendshmet me gungë të fortë në fund. Petalet 10-16 x 2-5 mm, majëngrëna. Silika 35-60 x 1-2 mm; kreza rreth 2 mm. Lulëzon VI-VII, frynnon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al.(1988).	Endemike e Ballkanit.	Në Grykën e Sushicës është konstatuar në të çara të shkëmbinjve gëlqeror të zonës malore e shoqëruar nga llojet: Hieracium bifidum, Crepis sp., Geranium robertianum, Calamintha acinos, Campanula sp., Geranium robertianum etj.	Mala, Xh. me 28.06.2012 këtë lloj e konstaton në Malet e Sharrit (mbi burimin e Lumëbardhit të Prizrenit) në lartësi mbidetare 2100 m. Millaku, F. me 09.06. 2012 këtë lloj e konstatoi në Grykën e Sushicës në shkëmbinj gëlqeror në ekspozicion verior në lartësi mbi detare 980 m. Pejë.	Mala, Xh. me 28.06.2012 këtë lloj e konstaton në Malet e Sharrit (mbi burimin e Lumëbardhit të Prizrenit) në lartësi mbidetare 2100 m. Millaku, F. me 09.06. 2012 këtë lloj e konstatoi në Grykën e Sushicës në shkëmbinj gëlqeror në ekspozicion verior në lartësi mbi detare 980 m.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

9	<i>Petasites doerfleri</i> Hayek Emri shqip: <i>Llapua i Dërflerit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me gjethe rrotullare-në trajtë zemre, pa deje anësore që kufizojnë gjirin, përsipër pushbuta; vrigujt bazalë të larguar; buzët rregullisht të dhëmbëzuara. Shtjjet me 4 ose me shumë luspa gjethore, të poshtmet pothuaj miellore në bazë, ato të mesit rreth 1.5 cm. Kaptinëza 3-10; pështjell 8-10 mm; braktetë të purpura, pushlore, me majë të plotë deri nganjëherë me kinde. Kreza 1.5-2 mm, jo e çarë deri në bazë. Lulet të verdha të zbehta ose të kuqërreme. Gjuhëzat e luleve mashkullore 5-6 mm. Lulëzon VII-VIII, polenizimi kryhet me insekte, frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).	Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi (Rakaj, M. 2009, Shuka, L. 2007, Vangjeli, J. et al. 2000, Stevanović, V. 1996).	Në Alpet Shqiptare (Liqenak) rritet në shkëmbinj gëlqeror me lagështirë në 1945 m lartësi mbidetare, e shoqëruar nga llojet: Valeriana montana, V. panicicii, Geum bulgaricum, Anthemis montana, Achillea abrotanoides, Edraianthus graminifolius, Arabis alpina, Trifolium noricum, Aconitum vulparia, Aquilegia bleicicii, Dianthus sylvestris etj.	Alpet Shqiptare-Liqenak (Millaku, F. et al. 2008). Millaku, F. me 23. 07.2009 e vlerësoi gjendjen e llojit në Alpe Shqiptare (Liqenak), në shkëmbinj me lagështirë (ekspozicion verior) në 1945 m lartësi mbi detare. Pejë.	Popullacioni në Alpet Shqiptare të Kosovës (Liqenak) është i përbërë nga < 80 individë maturë dhe zënë një sipërfaqe me <100 m ² . Ky lloj në këtë lokalitet rritet vetëm në të çara të shkëmbinjve me lagështirë, në ekspozicion verior.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
10	<i>Viola dacica</i> Borbás Emri shqip: <i>Manushaqe e Dacisë</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-40 cm, me kërcell gati të shogët ose lehtësisht leshtakë. Gjethet 2-4 cm, vezake ose eliptike, me buzë ura- ura, të shogëta ose nganjëherë të qerpikët në buzë; llapa aq sa ose më e gjatë se bishtaku. Ndajgjethëzat gati sa gjysma e gjatësisë së gjethëve, vezake-heshtore të pjerrëta, të ndara pendore deri ½ e gjërësisë së tyre ose të prera të sharruara. Lulet 2-3 cm. Petlat manushaqe ose të verdheme, anësoret të	Evropë	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat, në lëndinë buzë pyllit të përzier të halorëve në zonën subalpine e shoqëruar nga llojet: Picea abies, Pinus peuce, Angelica archangelica, Rubus idaeus, Urtica dioica, Rumex alpinus, Hypericum perforatum, Epilobium angustifolium etj.	Millaku, F. me 17.05.2013 këtë lloj e konstatoi në grykën e Lloqanit, Deçanë në afërsi të Kurvallës në lartësi 1635 m. Është lloj ri për florën e Kosovës.	Në Kosovë është konstatuar vetëm një popullacion i këtij lloji që ka areal shumë të kufizuar dhe më shumë individë maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		drejtuara nga lart. Shpori shumë i shkurtër, aq sa ose pak më i gjatë se shtojcat e kupes. Shtyllëza bërrylake në bazë e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. (Qosja, Xh. et al. 1992).					
11	<i>Acer heldreichii</i> Orph. ex Boiss. Emri shqip: Panjë e Heldraihit Familja: Sapindaceae [Aceraceae]	Dru (Fanerofite P) deri në 25 m, me degëza të murrme me ngjyrë të kuqe të errët. Gjethet 5-14 cm, 5 vrigullore, përposh të rimita dhe me pak push përgjatë dejeve ose gati të shogëta kur mbarojnë rritjen, përsipër të blerta, të errëta, të shkëlqyeshme, me vrigullin e mesit të lirë deri afër buzës; vrigujt të mprehtë, me dy ose tre dhëmbë të gjërë në çdo anë. Lulet njëseksore mjaft të pakta, të verdheme, në melthe gati të përpjeta, bishtgjata që dalin bashkë me gjethet. Frytet shojza të shogëta, 2-3 cm, me flatra të harkuara këndgjera. Lulëzon V-VI. Frytmon IX-X. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovë në, Mali i Zi, Greqi, Maqedoni, Bullgari).	Në Kosovë Ky lloj rritet kryesisht në substrat gëlqeror, rrallë në silikate;në zonën e ahut ose ahut me bredh (Abieti Fagetum), në zonën e arnenit dhe të hormoqit dhe në pyje të përziera nga 1200-2200 m eshoqëruar nga llojet: Pinus peuce, Picea abies, Abies alba, Fagus sylvatica, Vaccinium myrtillus, Sambucus racemosa, Acer pseudoplatanus, Salix caprea, Sorbus aucuparia, Senecio nemorosa, Doronicum austriacum etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), është i përhapur në Malet e Sharrit, Alpe Shqiptare dhe Malin Mokna. Sipas Millaku, F. (1999) A. heldreichii, subsp. visianii K. Maly. është i përhapur në Alpe Shqiptare (Maja e Foto: Fadil Millaku (2013), Maja e Rusolisë Rusolisë, Zhleb dhe Malin Mokna). Sipas Josifovic et al. (1973) subsp. visianii ky lloj rritet në Zhleb. Ky lloj është i përhapur edhe në vendin e quajtur Ujërat e Humbura (Malet e Sharrit), në lartësi 1680 m dhe në lokalitetin Përroi i Durlit ku arrin të jetë prezent edhe në zonën alpine. Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) ky lloj është i përhapur: në Oshlak, Ujërat e Humbura, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Jalovarnik.	Në Zhleb, Maje të Rosulisë dhe Malin Mokna Popullacioni i këtij lloji është mirë i ruajtur dhe i pasur me individ maturë dhe individ të rinj. Në Malet e Sharrit (Ujërat e Humbura) Popullacioni i këtij lloji ka areal shumë të kufizuar dhe përbëhet nga individ të rrallë (<50) të cilët janë prezent në vende ku pylli i bredhit dhe hormoqit janë të prerë ose në skaje të pyllit.	I rrezikuar.

12	<i>Achillea fraasii</i> Sch. Bip. [<i>Plarmica fraasii</i> Nym.] Emri shqip: <i>Barpezmi i Frazit</i> Familja: <i>Compositae</i> [<i>Asteraceae</i>]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Pushbutë e mëndafshhtë. Kërcejtë deri 50 cm, të thjeshtë, të ngritur. Gjethet dyfishpendore të çara, vrigujt heshtorë; bazalet 2-10 cm, me bishtak; kërcelloret 1-3 x 0.3-0.8 cm, pabisht. Vastakët me rreth 15 kaptinëza; bishtat 3-10 mm.. Pëstjella 4-6 (-9) mm në diametër; braktet 4-5 mm, heshtore, shyte, me buzë të ngushta, kafe të zbehta. Lulet llapore (5-7) të bardha; 2-3 mm, me të gjëra së të gjata ose sa të gjëra dhe të gjata. Lulëzon VI-VII, polenizimi kryhet me anë të erës ose me insekte, frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi, Greqi, Turqi (A), Sipas Sekovski Z. et al. (1999), është e përhapur në Maqedoni në rrethinën e Prilepit (1100 m l.m.d.).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror të zonës subalpine në lartësi mbidetare nga 1500 -1950 m. Rritet kryesisht në shkëmbinjtë gëlqeror që janë të ekspozuar diellit. Në lokalitetin Syne (Istog) rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Plantago argentea</i>, <i>Sedumochroleucum</i>, <i>Micromeria sp.</i>, <i>Calamintha nepeta</i>, <i>Vincetoxicum hirundinaria</i>, <i>Stachys recta</i>, <i>Stachys alopecurus</i>, <i>Rhamnus falax,aria</i>. Në Zhleb është konstatuar e shoqëruar nga llojet: <i>Centaurea atropurpurea</i>, <i>Delphiium fissum</i>, <i>Crepis bertscea</i>, <i>Eryngium palmatum</i>, <i>Ostrya carpinifolia</i> etj. Në Majën e Vjellakut është konstatuar në shkëmbinjtë gëlqeror e shoqëruar nga llojet: <i>Genista radiata</i>, <i>Liliumalbanicum</i>, <i>Fritillaria messanensis</i> subsp. <i>gracilis</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Viola zoysii</i>, <i>Gentiana lutea</i>, <i>Potentilla speciosa</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000, 1986) është e përhapur në Malet e Istogut mbi fshatin Syne, Mokna. Me 19.05. 2013 Millaku, F. i shoqëruar nga Bekim Gashi dhe Naim Berisha këtë lloj e konstatuan në Majën e Vjellakut në lartësi mbidetare nga 1710 -1950 m. Me 23.06.2013 Millaku, F., Mala, Xh. dhe Berisha, N. e konstatuan edhe në Zhleb në lartësi mbidetare 1325 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë (Mbi Syne, në Majën e Vjellakut dhe në Zhleb) kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Mbi fshatin Syne (Istog) ky lloj rritet në të dy anët e rrugës prej fshatit Syne në drejtim të Malit Mokna. Kjo specie zakonisht haset në tufa rrallë hasen individë të vetmuar.	I rrezikuar.
13	<i>Achillea grandifolia</i> Friv., [A. peucedanifolia Gris.] Emri shqip: <i>Barpezmi gjethemadh</i> Familja: <i>Compositae</i> [<i>Asteraceae</i>]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë 30-100 cm, të ngritur të degëzuar në pjedën e sipërme. Gjethet kërcellore të mesit rreth 10 x 5 cm, vezake, të sheshta, pendore të çara thellë deri pendore të prera, me segmente pendor të çarë pushlore; segmentet kryesorë 20-40 mm, heshtorë, segmentet e dytë heshtor të shkurtër, gati majëmprehtë. Vastakët me shumë kaptinëza. Pëstjella rreth 4 x3 mm; braktetë e brendshme pushlore. Lulet llapore të bardha. Lulëzon VI-VIII. Polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Serbi) dhe Azi e Vogël.	Në Kosovë rritet në Pyje ose çeltira pyjesh, të zonës malore në kuadër të asociacionit Abieti-Fagetum ose Ostryo-Fagetum (Zhleb) e shoqëruar nga llojet: <i>Fagus sylvatica</i>, <i>Abies alba</i>, <i>Picea abies</i>, <i>Acer obtusatum</i>, <i>Ostrya carpinifolia</i>, <i>Evonymus verrucosus</i>, <i>Asphodeline lutea</i>, <i>Rosa canina</i>, <i>Dorycnium columnae</i>, <i>Corylus columnae</i>, <i>Geranium lucidum</i>, <i>Lapsana communis</i> dhe <i>Lunaria telekiana</i>.	Sipas Millaku, F. et al. (2012, 1999), është e përhapur në Pashtrik, Maje te Rusolisë dhe Grykë te Deçanit. Sipas Saric, M. et. al. (1986) është prezente në Alpe Shqiptare (Gryka e Deçanit). Sipas Josifovic, M. et al. (1975) në Zhleb.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është shumë i vogël.	I rrezikuar.

14	Adonis vernalis L. Emri shqip: Adonisi pranveror Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-40 cm e lartë, me rizomë te fuqishme me ngjyrë gështenje të mbyllët. Kërçelli i drejt i padegëzuar ose i degëzuar pa qime në pjesën e poshtme me hulli. Gjethet e kërçellit pabisht, 2-4 herë pendore të ndara me rezhde të holla lineare pa qime ose rrallë me qime. Lulet e vetmuar, të verdha më diametër 3-7 cm. Sepale 5, petale 10-20 të ngushta pykore të plota anash ose të dhëmbëzuara. Fryti 4-5 mm i gjatë gati i rumbullakët, i rudhur në formë rrjetore, me qime, afër bazës i zgjatur dhe me errëm. Lulëzon V-VI. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. (Rexhepi, F.2003).	Evropë, Azi Perëndim ore	Rritet në çeltira pyjesh termofile dhe në kullota të thata në kuadër të asoc. Carpinetum orientalis scardicum, dhe Quercetum pubescens cerris e shoqëruar nga llojet: Iris reichenbachii, Iris florentina, Carpinus orientalis, Quercus pubescens, Paeonia decora, Malus florentina, Acer tataricum etj	Rajoni i Gllarevës, (Krasniqi, E. 2003), Gazimestan, Gllamë (Gjilan)	Popullacioni më i rëndësishëm i këtij lloji në Kosovë shtrihet në substrat gëlqeror në rrethinën e Gllarevës. Ky popullacion shtrihet në rrethinën e Gllarevës, Gjurgjevikut të Madhë, Pogragjë dhe shkon deri afër fshatit Buroj (Skenderaj). Ky lloj është i përhapur nëpër çeltira të pyllit të dushkut dhe shkozës si individ ose shpesh në tufa. Në disa lokalitete e kemi konstatuar afër rrugës gjë që dëshmon se është bartur fara gjatë ndërtimeve të rrugëve. Popullacionet në Gazimestan dhe Gllamë (Gjilan) kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
15	Amphoricarpos neumayerianus (Vis.) Greuter [Amphoricarpos neumayeri Vis.] Emri shqip: Amforikarp i Neumajerit Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërçep të shkurtër të drunjëzuar; kërçelli i drejtë i thjeshtë, në pjesën e poshtme me gjethe, në pjesën e lartë pa gjethe. Gjethet heshtore deri eliptike gjatore, të thepëta deri gati shyte përsipër të gjelbërta pushbutë të bardha përposh, me buzë të sheshta, që ngushtohen gradualisht në një bishtak të shkurtër. Kaptinat 1.5-2.5 (3) cm në diametër, të vetmuara. Involukrumi në disa radhë, i shogët. Lulet me të jashtme femërore, të tjerat hermafrodite. Kurora me 5 vriguj, ngjyrë trëndafili ose në të bardhë. Thekët me një shtojcë	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mali Zi, Bosnjë & Hercegovina, Kroaci), Sipas Tutin et al. subsp. neumayeri rritet në JP të Malit të Zi, Hercegovina në. Sipas Vangjeli, J. et al. (2000) në Shqipëri është prezent subsp. murbeckii Bosnjak.	Ky lloj në Kosovë rritet kryesisht në shkëmbinj gëlqeror të zonës subalpine dhe alpine të Alpeve Shqiptare në kuadër të asociacionit Potentillo-Amphoricarpetum neumayeri e shoqëruar nga llojet: Potentilla speciosa, P. apennina, Gnaphalium pichleri, Anthyllis aurea, A. vulneraria, Achillea abrotanoides, Edraianthus montenegrinus, Valeriana pancicii, V. montana etj. Në grykën e Koprivnikut është konstatuar në kuadër të vegjetacionit të shkëmbinjve e shoqëruar nga llojet: Ramonda serbica, Daphne oleoides dhe Gnaphalium roeseri. Nën Majën e Vjellakut rritet në lartësi 1750 m e shoqëruar nga llojet Ramonda serbica, Genista radiata, etj.	Sipas Rakaj, M. (2009) është i përhapur në vendin e quajtur Qafa e Pejës në lartësi 1600 m. Sipas Rexhepi, F. (2000) është i përhapur në Koprivnik, Liqenak dhe Lumbardh. Sipas Millaku, F. (1999) në Koprivnik dhe Grykë të Rugovës, sipas Josifovic, M. et al. (1975) rritet në Liqenak dhe Grykë të Rugovës. Millaku, F. Krasniqi, E. & Rexhepi, F. me 29.07.2012 e hulumtuan Popullacionin e këtij lloji edhe në	Në Liqenak dhe Milishevc, numri i individëve në kuadër të Popullacionit është zvogëluar si pasojë e zjarreve në 3 vitet e fundit. Në grykën e Koprivnikut Popullacioni i këtij lloji shtrihet në lartësi mbidetare nga 900-2100 m dhe është në gjendje të mirë me përjashtim të subPopullacionit që gjendet në Grykën e Koprivnikut i cili ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë që rrezikohen nga shembja e gurëve dhe rrëshqitja e borës. Popullacioni në Grykën e Sushicës dhe nën majën Vjellakut ka areal shumë të kufizuar	I rrezikuar.

		bishtngjashme. Akenët leshatakë deri gati të shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë.			Milishevc. Me 19.05.2013 Millaku, F., Gashi, B. & Berisha, N. këtë lloj e konstatuan edhe nën Majën e Vjellakut (mbi Grukën e Sushicës) në lartësi mbidetare 1750 m dhe në Grykën e Sushicës (986 m).		
16	Campanula albanica Witasek Emri shqip: Lulekambanë shqiptare Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), (6-) 8-15 (-24) cm, të përjetëm deri ngritur, të shogët. Gjethet e bazës si zemër, të sharruara, që mungojnë gjatë kohës së lulëzimit, kërceloret eliptike të ngushta deri vizake, pak a shumë buzë plota, kryesisht majëmprehta. Lulet të vetmuara, rrallë nga 2-3 së bashku. Vezorja me puprri, rrallë e lëmuar. Dhëmbët e kupës deri 12 mm, trekëndësh të ngushtë deri vizake. Kurora 14-18 (-22) mm, blu deri manushaqe. Kapsula (6-) 7-8 mm, si fugë, e varur. Lulëzon VI. Frytton VIII (Qosja. Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik-pjesa Jugperëndimore (Tutin, T. G. et al. (1976).	Lulekambana shqiptare (Krasniqi, F. et al. 2003) në Kosovë rritet në shkëmbinj silikat (Crepidetalia dinaricae respektivisht Campanulion albanicae) ose në kullota të thata të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Silene pusilla, Polygonum alpinum, Senecio wagneri, Cryptogramma crispa, Cerastium alpinum, Helianthemum nummularium, Hieracium pilosella, Senecio doronicum subsp. glaberrimus, Geranium subcaulescens, Campanula alpina, Potentilla doerfleri, Armeria alpina, Sempervivum macedonicum, Juncus trifidus, Saxifraga tridactylites etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000, 1986, 1982), Diklic, N. & Nikolic, V. (1981) dhe Saric, M. et al. (1986) gjendet në Malet e Sharrit (Shtëpia e StojkutÇukat e Liqenit), Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Hajlë, Maja e Ropsit). Popullacione të vogla të këtij lloji gjatë viteve 2011-2013 u konstatuan edhe në Brezovicë, Qukat e Jazhincës, Vracë, Pashallarë dhe Koritnik (Rexhepi,F., Pajazitaj, Q.,Millaku, F, Krasniqi, E & Mala, Xh). Pejë	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Zakonisht rriten në grupe të vogla, ndërsa për nga habitusi ngjajnë shumë me llojin C. scheuchzeri.	I rrezikuar.
17	Centaurea atropurpurea Waldst. et Kit. Emri shqip: Kokoçel purpur i errët Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H).Kërcejtë (30-) 100-150 (-200) cm, pak të degëzuar në gjysmën e sipërme, me gjethe në pjesën e sipërme. Gjethet 1 (-2) fish pendore të prera, gati të shogëta, jo lirake; segmentet 2-3 (-20) mm të gjëra,	Evropë Juglindore (Gadishulli Ballkanik, Rumani, Greqi) (Greuter, W. & E. von RaabStraube 2008; Tutin, T.	Në Kosovë rritet në shpate të thata barishtore me tokë jo të thellë dhe me bazë shkëmbore gëlqerore të zonës malore. Shoqërohet nga llojet: Dianthus cruentus, Stachys officinalis, Galium verum, Trifolium alpestre, Potentilla erecta, Rhamnus frangula, Plantago media, Cephalaria pastricensis etj.	Ky lloj u konstatua nga Rexhepi, F (1978), në Malet e Istogut. Popullacione të llojit u konstatuan dhe u vlerësuan edhe në Pashtrik gjatë ekspeditave për periudhën 2011-2013 (F. Millaku, E.	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka numër të konsiderueshëm të individëve maturën në veçanti në Pashtrikun e Poshtëm. Popullacionet tjera të këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve sidomos	I rrezikuar.

		vizakeheshtore. Pështjella me diametër 20-30 mm, rruzullore; braktetë e pështjellës me shtojca rreth 10 mm; shtojcat trekëndore-heshtore, kafe të errëta, që mbulojnë plotësisht braktetë; këndet të bardhëreme, të ngritura menjëherë. Lulet purpur të errëta, rrallë të verdha, të jashtmet rrallë më të gjata se të brendshmet. Akenet rreth 4 mm, pushpak, kafe; xhufka rreth 4mm, kafe e errët. Lulëzon VI. Frytmon VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	G. et al. 1976; Polunin, O. 1997).		Krasniqi dhe Xh. Mala). Me 21.08.2012 është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e popullacioneve të llojit në Lubinjë të Epërme.	në lokacionin afër fshatit Lubinje e Epërme.	
18	Centaurea kotschyana Heuff. Emri shqip: Kokoçel i Koshit Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 50-100 cm, zakonisht të thjeshtë. Gjethet me qime kaçurrele; bazalet heshtore, me dhëmbë të larguara; kërcelloret lirake të prera; segmentet gjatorë deri vizakë-heshtorë, të dhëmbëzuar ose të vrigulluar. Pështjella 20-30 mm në diametër; shtojcat vezake-trekëndore, kafe-të errëta ose të zeza, që mbulojnë tërësisht braktetë; kindet 3-5 mm, të bardha në majë. Lulet purpur të errëta, të jashtmet aq të gjata sa të brendshmet. Akenët 4-5 mm, pushpak; xhufka 4-5 mm. Lulëzon VI. Frytmon VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	Karpate Lindore, Evropë Juglindore (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Bullgari, Bosnjë dhe Hercegovë në, Serbi, Mali i Zi) (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Tutin, T. G. et al. 1976; Petrova, A. & Vladimirov , V. 2010, Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet në kullota të thata me tokë jo të thellë me bazë shkëmbore gëlqerore të zonës malore deri alpine, kryesisht në ekspozicionet veriore dhe verilindore. Gjendet edhe në kuadër të pyllit të kërlekes (Pinus mugo) e shoqëruar nga llojet: Achillea alexandri-regis, Polygala major, Onobrychis scardica, Pedicularis brachyodonta, Senecio wagneri, Linum capitatum, Lilium albanicum, Rubus saxatilis, Phyteuma confusum, Anthyllis vulneraria, Hypochaeris maculata, Hypochaeris uniflora, Centaurea splendens, Trollius europaeus, Gentiana lutea, Vaccinium myrtillus, Knautia dinarica, Stachys alpina, Astrantia major etj.	Përmendet për Kosovë-Kobilicë, Maja e Zezë Pejë (Rexhepi, F. 1986, 1994; Diklic, N. & Nikolic, V. 1978). Më 09.07.2011 dhe 11.08.2011 është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e llojit në Oshlak (F. Millaku, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi dhe Xh. Mala). Lloji është konstatuar dhe vlerësuar edhe në Brod, Dragash (Malet e Sharrit) dhe në Bjeshkët e Lumëbardhit në Prizren (Alpet Shqiptare). Me 21.08.2012 është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e llojit në Lubinjë të Epërme në kullosa rrëzë ahishtave në lartësinë mbidetare 1300 m. (E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji rriten në grupe të vogla dhe me pak individë. Në veçanti popullacionet në Oshlak dhe në Brod kanë areal të kufizuar dhe me numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

19	<i>Cephalaria pastricensis</i> Doerfler et Hayek Emri shqip: <i>Cefalare e Pashtrikut</i> Familja: Dipsacaceae	Shumëvjeçare deri 200 cm e lartë (Hemikriptofite H). Gjethet 18-30x8-15 cm, pendore të prera, të shogëta ose të qerpikta, me 4-7 palë vriguj heshtorë ose gjatorë, të sharruar ose dhëmbë-dhëmbë, vrigujt e sipërm të stërzgjatur gjatë nervurës së mesit. Braktetë e pështjellës 5-7x4-5 mm, vezake-heshtore gati majëmprehta, të purpurta të zeza në majë. Lusat e shtratis lulor 6-8x3-4 mm, pallake të thepëta, të qerpikta, të shogëta ose me push të rrasur, të purpurta-të zeza në majë. Kurora rreth 14 mm, e verdhë. Pështjellëza rreth 8 mm në frytëzim, me 8 kënde, me 4 kreshta sa ¼ e gypit e 4 më të shkurtër ndërmjet tyre. Lulëzon VI. Frytton IX (Qosja, Xh., et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik (Kosovë, Shqipëri) (Rexhepi, F. 1986, 1994, 2000; Tutin, T. G. et al. 1976). Sipas Radovic, D. (2007), është e përhapur në Serbi (Tara) ?.	Ky lloj në Kosovë rritet në sustat gëlqeror me toka jo të thella, në kullota dhe çeltira pyjesh të zonave malore në Pashtrik dhe në Alpet Shqiptare (Syne, Bjeshka e Kaliqanit). Në Syne (1823 m l. m. d.) gjendet në kulloso subalpine në zonën e fitocenozës Abieti-Fagetum bashkë me llojet: Dianthus cruentus, Stachys officinalis, Galium verum, Trifolium alpestre, Potentilla erecta, Rhamnus frangula, Plantago media, Centaurea atropurpurea. Në Pashtrik (1733 m l. m. d.) rritet në kullota Foto: Elez Krasniqi (2011), Pashtrik subalpine, shoqërohet nga llojet: Sorbus aria, Amelanchier ovalis, Trifolium velenovskyi, Stachys alpina, Aster alpinus, Lilium albanicum, Trifolium alpestre, Dianthus cruentus, Trifolium badium, Campanula glomerata, Paeonia officinalis, Stachys scardica, Veratrum nigrum etj.	Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit-Maja e Madhe, Zhleb, Maja e Rusolisë, Pashtrik (Rexhepi, F. 1982, 1986, 2000; Krasniqi, F. 1987, 1998, Millaku, F. 1993, 1997, 1999; Silic, C. 1988; Zeneli, L. 1975; Josifovic, M. et al. 1973). Popullacionet e llojit u konstatuan dhe u vlerësuan edhe në Bjeshkën e Kaliqanit më 30.08.2013 (F. Millaku dhe E. Krasniqi). Lloji është konstatuar edhe në relacionin Kosharisht- Syne (Malet e Istogut).	Në të gjitha lokalitetet popullacionet e llojit janë të rralla dhe kanë numër të vogël të individëve sidomos në Alpet shqiptare. Popullacionet e këtij lloji në Malet e Istogut (Kaliqan-Syne) kanë areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal me të gjërë dhe numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Ky lloj në Pashtrik është i përhapur prej zonës subalpine mbi Gorozhup, kufiri me Shqipërinë dhe vazhdon edhe në Pashtrikun e Poshtëm dhe zbritet deri në 980 m lartësi mbidetare.	I rrezikuar.
20	<i>Crepis albanica</i> (Jav.) Babcock [C. baldaccii subsp. albanica Jav.] Emri shqip: <i>Shmangë shqiptare</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare; kërcëjtë 3-4, deri 35 cm, me 1-10 degëza (Hemikriptofite H). Gjethet të shogëta ose pushuake të rralla; gjethet e bazës 10-15x2.5-3 cm, të shumta, heshtore, të përmbysta, majëmprehta, me prerje të thella jo të rregullta të kthyer në drejtim të bazës, pendore të çara deri lirake-pendore, me vriguj të mëdhenj fundorë me dhëmbë të mprehtë dhe me vriguj anësorë të larguar, shumë të reduktuar, majëmprehtë, të ngushtuar në bazë; gjethet e jashtme lëkurore të ngjashme	Shqipëri, Kosovë, Mali Zi, Greqi (Tutin, T. G. et al. 1976; Josifovic, M. et al. 1975, Rexhepi, F. 1994).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqerorë dhe silikat të zonës subalpine e alpine i shoqëruar nga llojet: Campanula foliosa, Sempervivum macedonicum, Campanula Foto: Elez Krasniqi (2011), Vracë spatulata, Geum montanum, Vaccinium myrtillus, Vaccinium uliginosum, Veratrum album, Jasione orbiculata, Phyteuma pseudorbiculare, Centaurea nervosa, Ajuga pyramidalis, Lilium albanicum, etj.	Alpet Shqiptare (Bjeshkë të Lumëbardhit, Koprivnik, Gryka e Rugovës) (Josifovic, M. et al. 1975, Rexhepi, F. 1982, 1986, 1997, 2000). Konstatimi dhe vlerësimi i gjendjes së llojit është realizuar gjatë viteve 2011-2013 edhe në Malet e Sharrit (Liqenet e Jazhincës, Piribreg, Livadhishtë, Bistër, Brod, Shutman, Vracë) (F. Millaku, Q.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit edhe pse me shtrirje bukur të gjërë, numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël. Zakonisht takohen individ të vetmuar.	I rrezikuar.

		me ato të bazës; të sipërmet vizake-heshstore të thepëta. Kaptinëzat të pakta deri të shumta. Pështjella 11-14x7-9 mm; braktetë vizake-heshstore, majëmprehta, të jashtëmet sa 2/3 e gjatësisë së të brendshmeve, të përhimë-pushbuta dhe me qime të shkurtra gjëndërore, pushlore në faqen e brendshme. Lulet me ngjyrë të verdhë. Akenët 6.57.75 x 0.7-0.8 mm, të kuqërremtë-kafë, boshtorë, të holluar në majë, me 20 brinjë. Lulëzon VI-VIII. Frytmon IX (Vangjeli, J. et al. 2000).		Pajazitaj, E. Krasniqi, Xh. Mala).			
21	<i>Diphasiastrum alpinum</i> (L.) J. Holub, [Diphasium alpinum (L.) Rothm.] Emri shqip: Difaz i alpeve Familja: Lycopodiaceae	Bimë me kërcell zvarritës, 60-100 cm (Kamefite Ch). Degët anësore rre drejta, të shpeshta, në formë buçe katërfaqësore ose pak të shtypura dhe me gjërësi 1.5-2 mm. Gjethet në degët shterpa i ka në 4 rreshta. Gjethet anësore lineare-ovale janë të ngjitura në mes veti dhe me degë deri në mes. Gjethet e poshtme të palosura për degë, mishtore, lineare me bisht. Sporofilet lineare të mprehta. Strobilusët 5-15 mm të gjata, pabisht, mezi i kalojnë degët anësore sterile. Sporet janë në formë të rrjetës. VII-IX (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi Veriore dhe Perëndim ore, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Haeupler, H.& Myer, Th. 2007).	Rritet në substrat silikat në vende me barë e më rrallë shkëmbore të zonës subalpine e alpine mbi 1500 m l.m.d. (Bruckenthalio-Juniperetum) në shoqëri me llojet acidofile: Juniperus sibirica, Bruckenthalia spiculifolia, Vaccinium uliginosum, Empetrum nigrum etj.	Alpet Shqiptare (Bogiqë, Bjeshka e Belegut, Maja e Ropsit, Ishtedim), Malet e Foto: Fadil Millaku (2013), Bjeshka e Belegut Sharrit (Vracë, Bistër, Millaku, F. 1999, Rexhepi, F. 1986, Saric, M. et al. 1992). Ky lloj është konstatuar edhe në lokalitetin Përroi i Durlit në lartësi mbidetare 2100 m.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
22	<i>Euphorbia montenegrina</i> (Bald.) K.Maly Emri shqip: Qumështorja malazeze	Bimë barishtore shumëvjeçare hemikriptofite (H) me rizomë të degëzuar. Kërcelli është i ngritur i mbuluar me qime të rralla. Gjethet janë eliptike ose eliptike-	Kosovë, Mali i Zi, Hercegovina në.	Rritet në shkëmbinj të freskët të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Potentilla montenegrina, Geranium coeruleatum, Primula halleri, Veratrum album etj	Sipas Millaku,F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Kurvallë), Maja e Vjellaku (Millaku, F. 19.05.2013).	Ky lloj në Kosovë formon dy popullacione të vogla të cilat kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

	Familja: Euphorbiaceae	heshtore (lineare), me buzë të ngushtuara shumë, pabisht të dhëmbëzuara në formë të sharrës me qime qerpikore. Gjethet e sipërme të rrumbullakëta kah baza të ngushtuara gati pabisht ose me bishta të shkurtër. Kapsula është e mbuluar me lytha pejzore të kuqërremta. Fara është 2.5 mm e gjatë me pika të vogla. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frynnon VI-VII. (Josifovic, M. et al., 1977)					
23	<i>Fritillaria messanensis</i> subsp. <i>gracilis</i> (Ebel) Rix Emri shqip: <i>Fritilare mesineze</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërcell të lartë 15-35 cm. Gjethet 710, vizake, më të poshtmet 4-9 x 0.3- 1 cm, gjethet e sipërme të këmbyera. Rrethlulja kambanore e gjërë me ngjyrë të verdhë ose të murrme nga jashtë, jo e zgjeruar të goja, rrallë më njolla si tabela e shahut; Tepalet e brendshme zakonisht rrotullare në majë. Riprodhohet me farë dhe me bulb. Lulëzon V-VI. Frynnon VI-VII. (Vangjeli, J. et al., 2000)	Evropa Jugore.	Fritillaria messanensis subsp. messanensis në Kosovë rritet kryesisht në substrat serpentiner. Fritillaria messanensis subsp. gracilis në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në shkurre, çeltira pyjesh dhe kullota të thata të zonës malore dhe subalpine nga 600-1900 m) e shoqëruar nga llojet: Ostrya carpinifolia, Juniperus communis, Corydalis cava, Helloborus odoratus, Primula veris etj. Në Majën e Rusolisë dhe në Majën e Vjellakut ky takson është takuar në shoqëri nga llojet: Achillea abrotanoides, Lilium albanicum, Gentiana lutea, Achillea fraasii, A. lingulata, Plantago argentea etj.	Kaliqan dhe Vrellë (Istog). Millaku, F. Gashi, B. me 09.05. 2013 e konstatuan edhe mbi fshatin Syne në lartësi mbidetare 1420 m. Millaku, F. me 19.05. 2013 e konstatoi në Majën e Vjellakut në ekspozicion lindor nga 1700-1900 m. , Millaku, F. dhe Berisha, N. me 11.06.2013 e konstatuan edhe në Maje të Rusolisë në ekspozicion verior në lartësi mbidetare nga 1700-1900 m. Ky lloj është takuar edhe në Grykën e Rugovës (Mala, Xh. & Millaku, F. 2013).	Sipas studimeve tona të bëra në terren ky lloj në Kosovë formon tri popullacione. Një popullacion që shtrihet nga Gryka e Rugovës deri në Majën e Rusolisë (Zhleb), dhe Popullacioni i dytë që shtrihet prej Bjeshkës së Kaliqanit dhe vazhdon deri afër Malit Mokna. Në kuadër të Popullacionit të parë janë konstatuar 3 subpopullacione (Grykë të Rugovës, Maja e Vjellakut dhe Rusoli) që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në kuadër të Popullacionit të dytë janë konstatuar dy subpopullacione (Kaliqan-Vrellë dhe mbi fshatin Syne-Kosharishtë), që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Popullacioni i tretë është i përhapur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Edhe ky popullacion ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

24	<i>Genista radiata</i> (L.) Scop. Emri shqip: Gjineshtër rrezake Familja: Fabaceae	Shkurre (Fanerofite P), e ngritur deri 1 m me degë të kundrejta gati në çdo nyje. Gjethet janë me 3 brakte të kundrejta në çdo nyje, braktet janë 5-20×2-4 mm, heshtore të përmbysëta përfundi me qime të mëndafshita, përsipër gati të shogëta. Lulet janë në sqetullën e gjetheve të sipërme nga 4-12 bashkë në lemshukë skajore. Lulet më të poshtme kanë brakte të thjeshta, cipëthata, pak të gara trish dhe më të shkurtra se lulet tjera, braktezat 1-3 mm. Kupa është 4-6 mm me buzë gati aq sa gypi. Kurora është e verdhë, me karnë 10-11 mm, flamuri vezak 9×6 mm dy vrigujsh në maje, i shogët ose me qime të mëndafshita në nervurën e mesit. Bishtaja është vezake 4-5×3 mm me 1-2 fara. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VIII. (Rexhepi, F.	Evropa Juglindore .	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentitor dhe gëlqeror; në vende shkëmbore të zonës malore deri në zonën alpine. Në substrat serpentitor është konstatuar në kuadër të asociacionit Daphno-Genistetum radiatae. Kurse në substrat karbonat është konstatuar në shkëmbinj ose në kullota të thata e shoqëruar nga llojet: Iris reichenbachii, Fritillaria messanensis subsp. gracilis, Achillea frassii, Daphnac oleoides, Plantago argentea, Euphorbia myrsinites, Gentiana lutea, Arctostaphylos uva-ursi, Viola zoysii etj.	Sipas Randjelkovic, N. & Rexhepi, F. (1979), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1972), ky lloj është i përhapur në lokalitetet: Kodra e Lartë, Kopaonik, Koprivnik, Lipë, Pejë (Alpet Shqiptare). Millaku, F. me 19.05 dhe 20.06.2013 e konstatoi edhe nën Majën e Vjellakut në lartësi mbidetare nga 1700-1913 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar, mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i konsiderueshëm, me përjashtim të Popullacionit në Koprivnik, që ka areal shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të Popullacionit.	I rrezikuar.
25	<i>Gentiana pneumonanthe</i> L. subsp. <i>nopcsae</i> (Jav.) T. Wraber Emri shqip: Gencianë pneumonanta, Gencianë e Nopçes Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-65 cm, pa gjethe bazale, me rizomë të shkurtër. Gjethet lëkurore, pabisht (2.5-3.5X1-1.5 cm), vezake-heshtore maje mprehta, me vendosje të kundrejt dhe pak me të gjata se ndërnyjat. Lulet në lulesa ose rrallë në sqetulla të brakteve, me këmbëza të shkurtër ose gati të pabisht; kupa me gyp deri 1 cm me dhëmbë gati heshtorë majëmprehtë ose të thepët 1/2 deri 2/3 më e shkurtër së kurora.	Sipas Javorka et al. (1926) ky takson është i përhapur në Shqipëri. Sipas Vangjeli, etj.	Ky takson në Kosovë rritet në substrat serpentitor. Në lokalitetin Qafa e Morinës lajmërohet në substrate serpentitore në lartësi rreth 500-600 m, ku dominojnë llojet si: Forsythia europaea, Acer tataricum dhe Sanguisorba albanica. Në Gubavc (afër Pejës) rritet në vende me lagështirë në ekspozicion lindor nga 800-1053 m; në kuadër të pyllit të përzier të dushkut (Quercus petraea, Q. Cerris), lajthisë (Coryllus avellana dhe boshtrës (Forsythia europaea). al. (1995) është i përhapur në Rrethin i Tropojës. Në Kosovë është konstatuar në Boka të Morinës dhe Gubavc	Sipas Wraber, T. (1990) është e përhapur në serpentine të rrethit të Qafës së Morinës (Përroi i Begut dhe Gropa e Zezë), sipas Amidjic, L. & Pankovic, B. (2003), është e përhapur në Alpet Shqiptare. Me 16.08.2013, Millaku, F., dhe Berisha, N. konstatuan një popullacion të vogël të këtij lloji në Gubavc. Gentiana	Në Kosovë janë konstatuar dy popullacione, në lokalitetet Bokat e Morinës dhe Gubavc. Këto popullacione kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve.	I rrezikuar.

		Kurora kambanore blumanushaqe e errët, me gyp konik dhe me vriguj të mprehtë. Theket të bashkuara, pushlore. Pistili nga dy thela. Fruti kapsulë. Farat jo të flatruara. Lulëzon VI-IX; polenizimi kryhet me insekte (entemofilia).Riprodho het me farë. Qosja, Xh. (1994).		(Koprivnik). Endemike e Kosovës dhe Shqipërisë.	pneumonanthe L. është konstatuar edhe në serpentine e Mushtishtit (Mala, XH., Millaku, F. 21.09. 2012) por në këtë lokalitet nuk ishte prezent Gentiana pneumonanthe L. subsp. nopsae (Jav.) T. Wraber.		
26	<i>Gentianella crispata</i> (Vis) Holub. Emri shqip: Gencianeza kaqurrele Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore dyvjeçare e shogët (Hemikriptofite H), kërcelli është i thjeshtë ose i degëzuar 4-15 (-20) cm. Gjethet janë më të gjata se ndërnjet, të poshtmet vezakepërmbysta-pallakejanë shyte, të sipërmet heshtore. Lulesa vastakore. Lulet 5 pjesëshe. Kupa 6-8 mm, me vriguj gati të barabartë ndërmjet tyre, të shogët, me buzë kaçurrele e të zeshkëta. kurora 15-20 mm, blumanushaqe ose bardhëreme, me gyp 2-3 herë me të gjatë se kupa. Kapsula me bisht të shkurtër. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al (1996).	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Mali Zi, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari).	Rritet në kullosa të thata, pyje të hormoqit të zonës subalpine dhe alpine (Abieti-Picetum) e shoqëruar nga llojet: Onobrychis scardica, Daphne oleoides, Gentiana asclepiadea, Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum etj.	Alpet Shqiptare (Pleçe, Peklen).	Në kuadër të Alpeve Shqiptare janë konstatuar dy subpopullacione të vogla (Pleçe, Peklen) që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të Foto: Xhavit Mala (2012), Pleçe individëve maturë.	I rrezikuar.
27	<i>Geranium reflexum</i> L. Emri shqip: Kamaroshe e përthyer Familja: Geraniaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me rizomë të shkurtër e të trashë. Kërcelli është i gjatë 40-70 cm me shumë qime gjëndërore të gjata. Gjethet janë 6-15 cm të gjëra, me llapë të ndar me 5-17 vriguj pendorë të çarë. Lulet janë shumë në lulesa pak a shumë të çlirët, bishtat e luleve janë të sipërveshura gjatë pjekjes së frytit. Sepalet janë 8-9 mm. me halë shpesh të	Ballkan.	Në Kosovë ky lloj rritet në livadhe, çeltira pyjesh dhe shkurre të zonës subalpine dhe alpine. Në Koritnik është konstatuar në kuadër të asociacionit Pinetum heldraichi typicum. Në Malet e Sharrit është e përhapur kryesisht në kuadër të vegjetacionit të shkurreve subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Vaccinium myrtillus, Juniperus sibirica, Crepis pannonica, Rubus idaeus, Achillea chrysocoma, Veronica	Sipas Josifovic et al. (1977) ky lloj është i përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkë të Lumëbardhit, Peklën) dhe në Koritnik. Ky lloj është konstatuar edhe në Vracë dhe në Brod.	POPULLACIONET: Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni në gjendje me të mirë është në Koritnik dhe Bjeshkë të Lumëbardhit.	I rrezikuar.

		zhdukur ose me thimth. Petalet janë 7-9×2.5-4 mm ngjyrë jorgovani të mbylltë gjatore shumë të sipërveshura në kohën e lulëzimit. Merikarpet janë të kreshpëta me 2-4 brinjë të thelluara tërthore poshtë shtyllëzës. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frynnon VII-IX. Qosja, Xh. et al. (1992).		officinalis, Veronica orsiniana, Epilobium angustifolium etj.			
28	Haplophyllum boisserianum Vis. et Panc. Emri shqip: Haplofil i Buasierit Familja: Rutaceae	Bimë gjysmë shkurre (Kamefite Ch). Kërcejtë janë me gjatësi 6-25 cm, me push të përdredhur, pak a shumë leshtore në pjesën e lulesës. Gjethet janë të thjeshta 1040×1.5-3 mm heshtore deri heshtore të përmbysëta, të holluara poshtë me pak qime ose të shogëta. Lulesa është pak a shumë e dendur, sepalet janë vizake-heshtore. Kapsula është pushlore në faqen e brendshme afër majës me gjëndra të rralla pak a shumë zhardhokore poshtë, në çdo vrigull me nga një shtojcë konike me majë, që nganjëherë e ndarë në zhardhokë më të vegjël. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frynnon VII. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Vendet Ilire (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovina në)	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentinor në vende të thata me barë dhe shkëmbore të zonës kodrinoro-malore. Në pjesën me të madhe të habitateve ku është takuar ky lloj rritet i shoqëruar nga llojet: Fraxinus ornus, Dorycnium pentaphyllum, Campanula lingulata, Alyssum markgrafi, Quercus petraea, Salvia ringens, Polygala doerfleri, Sanguisorba minor, Thalictrum minus, Sedum serpentinum, Sedum telephium, Forsythia europaea etj.	Sipas Josifovic, M., et al. (1973) është e përhapur në Luginën e Ibrit, Rogozna, Gubavc, Qafa e Prushit, Koznik. Gjatë viteve 2011-2013, Rexhepi, F. Pajazitaj, Q. Millaku, F. Krasniqi, E. dhe Mala, Xh. e konstatuan edhe në Bokat e Morinës (Ponoshec), Krevenik (Elez Han) Bokat e Baqevcit (Mushtisht), Gubavc (Koprivnik).	Edhe pse ky lloj në Kosovë ka përhapje të gjërë dhe formon disa popullacione; këto popullacione kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël, me përjashtim të popullacioneve në Qafë Prush dhe Bokat e Morinës që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

29	<i>Hesperis dinarica</i> Beck Emri shqip: <i>Hesperidë dinarike</i> Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e gjatë deri 1 m. Kërçelli është i mbuluar me qime të thjeshta gjëndërore. Gjethet janë të blerta të mbuluara me qime gjëndërore. Gjethet e poshtme janë vezake-heshtore me bisht të shkurtër, të sipërmet heshtore në bazë pak të ngushtë Kurora është 17-20 mm e gjatë, e bardhë. Silika është 7-10 cm e gjatë, e shogët. Riprodhohet me farë . Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Paparisto, K. et al. (1988).	Ballkan.	Rritet në kuadër të pyllit të ahut ose pyllit të përzier të ahut me bredh (Abieti Fagetum) ose të bredhit me hormoq (Abieti-Picetum). Në Zhleb dhe në Maje të Rusolisë rritet e shoqëruar nga llojet: Acer heldreichii, Senecio othonnae, Fagus sylvatica, Ramnus falax, Tanacetum macrophyllum, Digitalis ambigua.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al (1986), Josifovic, M., et al (1972) ky lloj është i përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb dhe Maje të Rusolisë) dhe në Malet e Sharrit (Ujërat e Humbura).	Ky lloj në Kosovë formon dy popullacione: një në Alpet Shqiptare dhe një në Malet e Sharrit. Popullacioni në Alpet Shqiptare është i përbërë nga dy subpopullacione të vogla. Popullacionet e këtij lloji ë Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare kanë areal shumë të kufizuar, dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre dy popullacioneve është shumë i vogël.	I rrezikuar.
30	<i>Jacobaea othonnae</i> (M.Bieb) C.A.Mey. [Senecio othonnae Bieb.] Emri shqip: - [Pulith e Otonit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 80-200 cm. Kërçepi i shkurtër me stolone të gjata. Kërcejtë të ngritur, të degëzuar vetëm në lulesë, të shogët. Gjethet e bazës dhe ato më të poshtme kërcellore 30-60 x 12-35 cm, pendore të prera, me segment gjatë të përmbysët-heshtorë, të prerë-të sharruar, të shogëta përsipër, me qime kaçurrele-pushpake përposh; gjethet e sipërme kërcellore me segment pak a shumë të dhëmbëzuar. Kaptinëzat të shumta, 5-15 mm në diametër, në vastakë. Pështjella 57 mm, me push shajakor të rrallë, me 1-4 brakte shtesë; braktetë shpesh të zeza në majë. Lulet llapore 1-2, të verdha, 8-12 mm. Akenët 3-6 mm, me qime të dendura të rrasura. VI-VIII. Vangjeli, J. et al. (2000)	Endemike Ballkanik e (Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Mali i Zi, Bullgari).	Ky lloj në Kosovë (Zhleb dhe Maje të Rusolisë) është i përhapur në pyje (Fagetum montanum dhe Abieti Fagetum) dhe kullota të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Acer heldreichii, Hesperis dinarica, Lunaria telekiana, Fagus sylvatica, Rhamnus fallax, Tanacetum macrophyllum, Digitalis ambigua etj. Në Pashtrik ky lloj është konstatuar në kuadër të pyllit të ahut (Fagus sylvatica) dhe në kuadër të pyllit të përzier.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb, Rusoli). Sipas Josifovic, M. et al. (1975) është e përhapur në Zhleb. Millaku, F. me 23.07.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrik në kuadër të pyllit të ahut dhe pyllit të përzier të ahut me lajthi (Coryllus columna) në lartësi mbidetare 1320 m.	Popullacioni e këtij lloji në Zhleb-Maje të Rusolisë ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit. Ky lloj në këtë lokalitet shtrihet edhe buzë malit në anën e majtë të rrugës Pejë-Rozhajë. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal shumë të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të këtij Popullacioni është i konsiderueshëm.	I rrezikuar.

31	<i>Kitaibela vitifolia</i> Willd. Emri shqip: <i>Kitabelia gjetherrushi</i> Familja: Malvaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 3 m e gjatë pak e degëzuar me qime të bardha gjembore. Gjethet janë të mëdha, 18 cm të gjata në bishta të gjatë me qime të rralla zemërore, pak të ndara formë pëllëmbore në 5-7 vriguj trekëndore, pa maje, buzëve të sharrëzuara. Lulet janë sjetullore nga 2-4, bashkë. Braktet e kupës së jashtme janë vezake të mprehta pak janë më të gjata dhe më të gjëra se sepalet. Petalet janë pak më të gjata se sepalet (2.5×2 cm) të bardha ose të verdha. Fryti është shizokarp ndahet në shumë fryte të thjeshta me qime dhe ngjyrë të murrme. Riprodhohet me farë. Lulëzon VII-VIII. Frytton VIII-IX. (Josifovic, M., et. al. 1973).	Ballkan, Rumani, Sub-ballkanike.	Ky lloj rritet në çeltira pyjesh ose buzë rrugëve nga zona kodrinore deri në zonën montane (900-1200m) e shoqëruar nga llojet: Fagus moesiaca, Digitalis grandiflora, Scrophularia nodosa, Rubus sp., Acer platanoides, Corylus avellana, Campanula trachelium, Prunus avium, Pteridium aquilinum, Verbascum sp. etj.	Sipas Millaku, F. (1999) rritet në zonën kodrinore-malore në Bjeshkën e Lumëbardhit (Alpe Shqiptare), në afërsi të Grykës së Rugovës. Janë konstatuar edhe disa individ të pakt afër fshatit Dobrushë (Zhur). Sipas Tomovic, G. et al. (2007) është e përhapur në rrethinën e Pejës.	Popullacioni i këtij lloji në Bjeshkën e Lumëbardhit (Alpet Shqiptare) shtrihet nga 900 – 1200 m lartësi mbidetare në kuadër të pyllit të ahut. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji afër Zhurit ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
32	<i>Knautia midzorensis</i> Formánek Emri shqip: <i>Knautia e Mixhorensit</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Rrënja vertikale e fortë. Kërçelli i drejtë në pjesën e poshtme i mbuluar me qime të kthyer teposhtë, rrallë i shogët, në pjesën e sipërme me qime të gjata ose rrallë i shogët. Gjethet janë shumë a pak lëkurore eliptike-heshtore, të ngushta heshtore, të plota në maje janë të mprehta. Gjethet e poshtme janë me qime, më të gjëra në mesin e tyre. Gjethet e sipërme janë të shogëta. Kërçelli është i mbuluar me qime dhe gjëndra. Lulesat janë të	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgari).	Rritet në livadhe, kullosa, shkurre, pyje të zonës subalpine dhe alpine (Seslerio-Pinetum heldreichii). Rritet në shoqëri me llojet: Fagus moesiaca, Abies alba, Ulmus montana, Sorbus aucuparia, Lonicera nigra, Betula pendula, Acer platanoides, Ribes alpinum, Rhamnus fallax.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1973) është e përhapur në Malin Mokna, Bjeshkët e Lumëbardhit, Liqenak, Rrasë të Zogut, Zhleb. Në Malet e Sharrit gjendet në Oshlak dhe Malet e Mushtishtit (Pashallarë).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Mushtishtit (Pashallarë) dhe në Oshlak janë në gjendje të mirë, ndërsa popullacionet e këtij lloji në Malin Mokna dhe Alpet Shqiptare kanë një shtrirje më të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

		mëdha të gjëra 3-4 cm. Lulet të purpurta, të verdha. (Rexhepi, 1986).					
33	<i>Lilium jankae</i> A. Kern. [<i>Lilium carniolicum</i> subsp. jankae (A. Kern.) Asch. & Graebn.] Emri shqip: <i>Zambaku i Jankut</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 30-90 (-120) cm. Bulbi i madh oval 3.5-6 (8) cm i përbërë prej shumë gjetheve mishnore gjatore-heshtore, të verdha me majë. Rrënjët janë të shumta. Kërcelli fort, i drejtë, i shogët me diametër 5-15 mm, në pjesën e poshtme pak a shumë pa gjethe me 1-2 brakte membranore të lartë me shumë gjethe pak a shumë të shpërndara njësoj deri te lulesa. Gjethet të drejta, të këmbjera heshtore ose heshtore-gjatore, kah baza dhe kah maja të ngushtuara. Gjethet bazale të gjata 8-9 (14) cm, kah pjesa e sipërme gjithnjë më të vogla. Lulesa terminale me (1) 2-4 ose më shumë lule në bishta të gjatë. Lulet në diametër janë 4-6 cm ngjyrë fosfori ose të verdha-ari nga ana e brendshme me vija vjollcë të mbyllët ose me pika. Braktet e perigonit janë gjatore-heshtore, të gjata 57 cm dhe të gjëra 8-13 mm, në bazë të ngushtuara në thua. Thekët më të shkurtra se perigoni, fillet e thekëve të gjata 22-28 mm, anteret të kuqe-portokalli ose të kuqërremta, të gjata 10-15 mm. Pistili gjator-trevigullor i gjatë 13-25 dhe i gjërë 4 mm. Shtyllëza e gjatë 12-14 mm gradualisht zgjerohet kah maja dhe	Kosovë, Bullgari, Rumani.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrat gëlqeror dhe silikat. Rritet në livadhe, kullosa malore dhe shkurre subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>Picea abies</i> , <i>Geum montanum</i> , <i>Luzula sylvatica</i> , <i>Hypericum</i> sp. etj.	Është konstatuar në Malet e Sharrit (Guri i Dellocit, Studenicë - Therandë te antena) dhe në Malin Mokna.	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit dhe në Malin Mokna kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

		kalon në stigma. Kapsula e gjatë 30-45 mm dhe i gjërë 20-30 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII.					
34	Lunaria telekiana Jäv. Emri shqip: Barhënë e Telekit Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli i degëzuar qysh nga baza. Gjethet kanë bishta të gjatë, janë vezake të dhëmbëzuara ura-ura. Lulet të purpura vjollce. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Riprodhohet me farë. (Vangjeli, J. et al. 1995)	Ballakan (Kosovë, Shqipëri).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në kuadër të pyllit të ahut ose në pyje të përziera, rrallë haset në çeltira pyjesh dhe vende shkëmbore. Në Pashtrik është konstatuar në 1420 m lartësi mbidetare në kuadër të Asociacionit Columno-Ostryetum dhe Fagetum montanum e shoqëruar nga llojet: Fagus moesiaca, Corylus colurna, Ostrya carpinifolia, Cardamine enneaphyllos, Cardamine bulbifera, Sanicula europaea, Oxalis acetosella, Daphne mezereum, Scrophularia nodosa, Pulmonaria rubra, Prenanthes purpurea, Primula veris. Në Zhleb është konstatuar në 1325 m lartësi mbidetare në kuadër të asociacionit Ostryo Fagetum e shoqëruar nga llojet: Achillea grandifolia, Delphinium fissum, Hesperis matronalis, Crepis bertiacea.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur në Pashtrik, Koprivnik. Millaku, F., Mala, Xh. dhe Berisha, N. me 23.06.2013 e konstatuan edhe në Zhleb në lartësi mbidetare 1325 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve; me përjashtim të Popullacionit në Pashtrik që ka numër të mjaftueshëm të individëve maturë.	I rrezikuar.
35	Narcissus poeticus subsp. radiiflorus (Salisb.) Baker Emri shqip: Selikal, Narcis, Lulëxheneti, lulëdremiqare Familja: Amaryllidaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite (G)), me bulb të gjatë 50-60 mm dhe të gjërë 15-25 mm, me mbështjellës ngjyrë kafe. Kërçelli 20-40 (60) cm i lartë me dy brinjë të sheshta. Gjethet 2-5 lineare, me 5-8 mm, të gjëra , të sheshta, pak a shumë të rimta ose të gjelbra me të shkurtra se kërçelli. Zakonisht në majë të kërçellit një lule rrallë 2 ose me shumë. Segmentet e rrethlules 22-30 mm, të bardha, në fillim të lulëzimit të bardha në të verdhë, gati vezakepërmbysët-	Alpe të Evropës, Karpate, Ballkan.	Në Kosovë rritet në livadhe me lagështirë që kositen të zonës kodrinore dhe malore e shoqëruar nga llojet: Taraxacum officinale, Galium verum, Alnus glutinosa, Bellis perenis, Ranunculus millefoliatus, Silene viscaria, Ajuga genevensis, Trifolium pratensis, Plantago mayor, P. lanceolata, Sanguisorba minor, Poa pratensis, Fetuca sp., Galium cruciata, G. palustrae. Në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut) ky lloj është konstatuar në zonën e Ahut dhe rrobullit në 1710 m lartësi mbi detare e shoqëruar nga llojet: Lilium albanicum, Fritillaria messanensis, subsp. gracilis, Asphodelus albus, Achillea abrotanoides, Gentiana lutea,	Sipas Hundozi, B. (1980), Josifovic et al. (1975) dhe Krasniqi, E. et al. (2020) është e përhapur në rrethinën e Kaçanikut, Dumnicë, Ferizaj, Dobroshevc, Miradi e Ulët, livadhe të Llabjanit (afër Artanës), Brezovicë (Rexhepi, F.1978). Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N., me 19.05.2013 e konstatuan një popullacion të	Popullacionet e këtij lloji Kosovë kanë areal të kufizuar. Arealet e këtyre popullacioneve po shkojnë në vazhdimësi duke u zvogëluar si pasojë e ndërtimeve të rrugëve dhe qendrave urbane gjatë 10 vitet e fundit. Popullacioni më interesant i këtij lloji është popullacioni i konstatuar në Majën e Vjellakut - Alpet Shqiptare. Ky popullacion ka një areal shumë të kufizuar dhe dallon nga lokalitetet tjera në aspektin e diversitetit floristik.	I rrezikuar.

		pykore, me thonjës pak a shumë të dallueshëm pak a shumë me kinde. Korona 2-2.5 x 8-10 mm, cilindrike. Të gjithë thekët gati të një madhësie dalin pjesërisht jashtë rrethlules. Lulëzon V-VI. Frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe bulb. Vangjeli, J. et al. (2000).		Pinus heldreichi, Acer pseudoplatanus etj.	këtij lloji në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut - 1710 m). Është lokaliteti i parë i këtij lloji i konstatuar në Alpet Shqiptare.		
36	<i>Paeonia mascula</i> (L.) Mill. Emri shqip: <i>Bozhure mashkull</i> Familja: Paeniaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërcëp zhardhokor, me rrënjë të mishta. Gjethet dyfishtrëshe ose me disa gjethe pak të ndara; segmentet 9-16, ngushtësisht deri gjërësisht eliptike ose vezake, përposh të shogëta. Lulet me diametër 8-14 cm, të kuqe. Rrëshekhthet 3-5, zakonisht pushlore, të rrumbulluara në majë, 2-4 cm, me krezë pabisht. Lulëzon V-VI, polenizimi kryhet me insekte, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe zhardhok. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropa Jugore, Kretë deri në Azi të vogël.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në vende me bar dhe në pyje në kuadër të asociacioneve: Quercetum montanum, Ostryo-Carpinetum orientalis, Fagetum submontanum, Fagetum montanum, Luzulo-Fagetum, dhe Ostryo Fagetum e shoqëruar nga llojet: Ostrya carpinifolia, Fraxinus ornus, Quercus trojanae, Q. petraea, Fagus sylvatica, Acer obtusatum, Evonymus verrucosus, Geranium sanguineum, Stachys scardica, Cardamine bulbifera, Geum urbanum, Arum maculatum, Anemone ranunculoides, Anemone nemorosa, Lilium martagon, Lathyrus venetus, Aristolochia pallida etj.	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Kosovë (nuk cekën lokalitetet). Millaku, F. me 24 05. 2007 në Bjeshkët e Istogut, mbi fshatin Syne e konstatoi një popullacion shumë të vogël të këtij lloji në kuadër të asociacionit Ostryo Fagetum. Popullacionet e këtij lloji janë hulumtuar edhe në Pashtrik, Koritnik, Gërmi dhe Bjeshka e Mushtishtit (shpati i Manastirit).	Në Kosovë popullacionet e hulumtuara kanë qenë me areal të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Popullacionet në Pashtrik, Bjeshket e Mushtishtit dhe në Malet e Istogut (mbi fshatin Syne) kanë areal shumë të kufizuar dhe janë të rrezikuara si pasojë e degradimit të habitateve dhe prerjes së pyllit.	I rrezikuar.
37	<i>Potentilla montenegrina</i> Pant. Emri shqip: <i>Potentillë e Malit të Zi</i> Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj lulorë 30-80 cm, anësorë, shumë të kreshpët me qime të dendura. Gjethet trishe; gjethëzat vezake të përmbysta deri vezake të përmbysta- gjatore, 35-80 x 20-40 mm, të sharruara ose të sharruara uraura, të gjelbra, me push në nervurën e mesit të faqes së poshtme;	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë & Hercegovina, Mali i Zi, Maqedoni, Bullgari).	Në Kosovë rritet në substrate gëlqerore (Pinion mugo) rrallë në silikate, në kullota, pyje ose vende shkëmbore të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Geum bulgaricum, Anthemis montana, Achillea abrotanoides, Edraianthus graminifolius, Pedicularis brachyodonta, Aconitum vulparia, Onobrychis scardica, Dianthus sylvestris, Ribes petraeum etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit), Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në EN - B1ab(ii,iii)+2ab(ii,iii) - I rrezikuar. Bjeshkën e Lumëbardhit, Bister dhe Prevallë. Sipas	Subpopullacionet në Zhleb, Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit dhe Kurvallë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Edhe popullacionet në Oshlak dhe Bister kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

		gjethëza skajore me bishtalec të qartë. Lulet të shumta. Nënpetlat trekëndore-heshtore deri vezake, majëmprehta. Kupëza me vriguj gjatorë, shytë ose gati majëmprehtë, më të shkurtër ose aq sa sepalet. Petalet 10-12 mm,të verdha, gati 2 herë me të gjata se sepalet . shtyllëza konike si fill, gati skajore. Akenët të shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).			Krivosej, Z. et al. (1995) është e përhapur edhe në pjesën veriore të Oshlakut në kuadër të formacioneve me Pinus mugo. Millaku, F. me 17.07. 2013 i shoqëruar nga Isa Elezaj e konstatoi këtë lloj edhe në Kurvallë në lartësi mbidetare 2110 m e shoqëruar nga llojet Primula halleri, Gentiana lutea dhe Euphorbia montenegrina. Millaku, F. dhe Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan edhe në Zhleb në çeltira të pyllit të Hormoqit (Abieti Piceetum).		
38	Quercus robur L. subsp. robur Emri shqip: Rrënjë Familja: Fagaceae	Dru 30-40 (-45) m i lartë (Fanerofite P) me lëvore të murrme të errët, me brazda të gjëra për së gjati dhe të çara të cekëta të tërthorta, me kurorë vezë - konngjashme. Degët njëvjeçare të shogëta, rrallë me pak qime, të blerta, të përhimë ose të murrme të kuqërreme. Sythet vezëngjashëm ose gati rrozullor, shytë, rrallë majëmprehtë, 5-7 mm. Gjethet rrënjëse, zakonisht vezake të përmbysët ose gjatore-vezake të përmbysët, të shogëta, ose kur janë të reja përposh me push të paktë, me 5-7 palë vriguj, me po aq nervura kryesore si dhe me mjaft nervura të ndërmjetme, 5-15(-20) x 2.5-5(-10) cm me bishtak 2-5(10) mm.	Native dhe dominonte kryesisht në tokat e kafta ("brown soils") në pjesën më të madhe të Evropës duke përfshirë edhe disa pjesë veriore si dhe disa pjesë të Mesdheut (Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet vetëm në ultësira të lumenjve (Drini i Bardhë, Morava e Binçës) në substrat aluvial i shoqëruar nga llojet: Acer campestre, Ulmus campestris, Prunus armeniaca, Prunus spinosa, Crategus monogyna, Lonicera caprifolium, Clematis vitalba, Ranunculus millefoliatus, Melanpyrum arvense, Trifolium pratense, Trifolium campestre, Galium verum, Phleum pratense, Rumex crispus, Verbascum phoeniceum, Centaurea cyanus, Sambucus ebulus etj.	Zallq, Terbuhoc, Saradran, Klonë, Nashec, Zllakuqan, Klinë Drobesh (Krasniqi, E. et al. 2011; Isufi, F. et al. 2011, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua më 21.05.2011 në Drobesh (E. Krasniqi); gjithashtu në Zllakuqan dhe Zallq më 21.05.2011 (E. Krasniqi).	Lloji gjendet shumë rrallë, vetëm si individë në pesë lokalitete në Rrafshin e Dukagjinit dhe në një lokalitet në Anamoravë. Në lokalitetet e lartpërmendura numri i individëve maturë është 1 me përjashtim në Zallq ku janë hasur më shumë se një individ.	I rrezikuar.

		Lulet mashkull me 4-7(8) thekë, në lulesa 2-5 cm; lulet femër me nga 3 kreza të kuqe të zezërreme në lulesa me bishta 4-5 cm. Frytet piqen në vitin e parë, të vetmuara ose 2-5 në një bisht të përbashkët me gjatësi 3-6(-10) cm. Gishtja e lëmuar me mëlluga të sheshta, pushpaka, të ngjitura, me përjashtim të majave. Lëndët 2-4x 2-3 cm. Lulëzon IV-V. Frytton IX-X (Paparisto, K., et al. 1988).					
39	<i>Ribes alpinum</i> L. Emri shqip: <i>Ribes alpine</i> Familja: <i>Grossulariaceae</i>	Shkurre (Fanerofite P) deri 2,5 m, pa gjemba, me degë të shogëta ose gati ashtu. Gjethet me 3-5 vriguj, me dhëmbë, të shogëta ose me pak qime, 2-6 cm; bishtaku shumë më i shkurtër se lla, me gjëndërore qepallore. Bimë dioike, me lule njëseksore, me mbeturina të seksit tjetër, në vile të ngritura; boshtet lulore pushpakgjëndërore, të vendosura në sqetull të brakteve heshtore, të shogëta ose me qerpikë, pak më të gjata se bishti dhe lulet. Sepalet të shogëta, pa qerpikë, të hapura ose të kthyera nga poshtë. Petalet të blertërreme, pallake, 4-5 herë më të shkurtra se sepalet. Fryti rrushk i kuq, i shogët, pa shije. Lulëzon IV-VI, Frytton VI-VII. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropë, Azi perëndimore.	Në Kosovë rritet në pyje e vende me gurë të zonës subalpine dhe alpine kryesisht mbi substrat gëlqerorë ose edhe mbi silikate kristalore. Në Zhleb dhe Maje të Rusolisë rritet në zonën e pyllit të kërlekës (dredhakut) Wulfenio Pinetum mugo ose në kuadër të pyllit të përzier të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Acer heldreichii, Pinus heldreichii, Pinus peuce, Pinus mugo, Acer platanus, Linum capitatum, Picea abies, Abies alba etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Zhleb, Maje të Rusolisë dhe Koritnik.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë (Koritnik, Zhleb dhe Maje të Rusolisë) kanë areal shumë të kufizuar dhe në të shumtën e rasteve ky lloj takohet në vende shkëmbore ose në kuadër të pyllit, në numër të vogël të individëve maturë. Në Zhleb dhe Maje të Rusolisë ky lloj rritet në kuadër të pyllit të përzier nga 1500-1800 m.	I rrezikuar.

40	<i>Ribes uva-crispa</i> L. [<i>Ribes grossularia</i> L.; <i>Grossularia reclinata</i> (L.) Miller.] Emri shqip: <i>Ribes</i>, <i>Rrush serezi</i> Familja: <i>Grossulariaceae</i>	Shkurre (Fanerofite P) 80-150 cm, shumë e degëzuar, me gjemba treshe tek nyja, shumë më rrallë pa gjemba. Gjethet pëllëmbore, me 3-5 vriguj, të shogëta ose pushpaket, 3-5 cm të gjëra. Lulet sqetullore, të vetmuara ose nga 2-3 së bashku; bishtat me qime gjëndërore, me brakteza. Sepalet të verdhmë ose të kuqërreme, të kthyera nga poshtë, pushpaka, pa gjëndra, 5-7 mm. Petalet 3 herë më të shkurtra se sepalet, të bardha, me qime. Vezorja me qime gjëndërore. Fryti rrushk i blertë, i verdhemë ose i kuqërremë, me diametër rreth 10 mm, i ëmbël. Lulëzon IV-VI. Frytton VI-VIII. Paparisto, K. et al. (1988).	Pothuaj në tërë Evropën, Kaukaz, Azinë qendrore, Afrikën veriore. Në viset jugore ka shtrirje të kufizuar vetëm në zonën malore.	Në Kosovë është konstatuar në substrate gëlqerore. Në Malet e Istogut (mbi fshatin Syne), Rusoli dhe Malin Mokna rritet në zonën e ahut ose në shkurreta të zonës malore e shoqëruar nga llojet: <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Acer platanus</i> , <i>Pinus heldraichii</i> , <i>Sambucus racemosa</i> , <i>Ostrya carpinifolia</i> , <i>Cephalaria pastricensis</i> , <i>Delphinium fissum</i> , etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Malin Mokna dhe Zhleb. Millaku, F. me 09.05.2013 e konstatoi edhe në bjeshkët e Istogut (mbi fshatin Syne dhe në Bjeshkën e Kaliqanit) e shoqëruar nga lloji <i>Cephalaria pastricensis</i> . Me 11.06.2013 Millaku, F. dhe Berisha, N. e konstatuan në Majën e Rusolisë në lartësi 1650 m në ekspozicion lindor jo larg tëbanave.	Popullacionet e këtij lloji në Zhleb, Maje të Rusolisë, Malet e Istogut dhe Malin Mokna kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është shumë i vogël.	I rrezikuar.
41	<i>Saxifraga federici-augusti</i> subsp. <i>grisebachii</i> (Degen et Dörfler) D.A.Webb Emri shqip: <i>Iriqëz e Grisebahut</i> Familja: <i>Saxifragaceae</i>	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H), me kërcëz gjethore shterpë të shkurtër që mbarojnë me rozeta gjethore. Kërcëz të lulorë të ngritur ose të përprjetëm, 10-20 cm, me gjethë të shumta, të mbuluar mbi gjithë gjatësinë me qime gjëndërore. Gjethet e rozetës pallake ose heshtore, 25-40 x 3-7 mm, shya ose me thumb, me buzë të ngushtë kërcore, me shumë hidatoda; kërcelloret të kuqërreme me majë të gjelbër, pallake-vizake, 10-20 x 2-4 mm, me thumb në majë, me hidatoda të pakta. Lulet purpur, në vile sa 1/3 ose 1/4 e kërcellit, me	Siujdhesa Ballkanik e (Kosovë, Maqedoni – Matevski, V. et.al. 2007).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinjtë gëlqerorë (Vegjetacioni i shkëmbinjve) e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>Ramonda serbica</i> , <i>Mycelis muralis</i> , <i>Cyclamen hederifolia</i> , <i>Asplenium rutamuraria</i> , <i>Galium lucidum</i> , <i>Ceterach officinarum</i> , <i>Sedum album</i> , <i>Campanula versicolor</i> , <i>Lamium garganicum</i> , <i>Leontodon hispidus</i> , <i>Cardamine glauca</i> , <i>Hieracium waldsteini</i> , <i>Eryssium helvetica</i> etj.	Sipas Saric et al. (1986) rritet në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Sipas Josifovic et al. (1977) subsp. montenegrina rritet në Malet e Sharrit (Oshlak). Millaku, F. me 09.05.2013 e konstatoi në shkëmbinjtë gëlqeror në vendin e quajtur Kosharishtë (Istog- mbi fshatin Syne) në 1407 m. Millaku, F. Pajazitaj, Q. dhe Mala, Xh. me 05.06.2013 këtë lloj e konstatuan edhe në Pashtrik në shkëmbinjtë	Popullacionet e këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe në Oshlak kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni në Bjeshkët e Istogut është shumë i vogël dhe janë konstatuar <20 individ maturë. Ky është lokaliteti i parë i këtij lloji i konstatuar në Alpet Shqiptare (Kosovë) dhe Bjeshkët e Istogut. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është <30.	I rrezikuar.

		15- 25 lule. Sepalet 4-6 x 1.5-2 mm. petalet 1.5-2 x rreth 1 mm, sipër shpesh me dhëmbë të çrregullt. VI-VII. (Paparisto, K. et al. 1988)			gëlqeror të zonës subalpine.		
42	<i>Scrophularia bosniaca</i> G.Beck. Emri shqip: <i>Sarushtë bosnjake</i> Familja: <i>Scrophulariac eae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rrënjë të drunjëzuar, të trasha. Kërçelli 50-80 cm, i përpjetë, pa gjethë në bazë, i purpurt, me qime të pasura gjëndërore, i gjethuar deri në majë. Gjethet e poshtme të përkundrejta, të sipërmet të këmbëra, të gjitha me bishtak, gjethet e mesit të kërçellit në drejtim të majës, gjithnjë më të vogla dhe me bishtak më të shkurtër; të poshtmet 8-10 x 3-4.5 cm, të gjëra , në bazë të cunguara, me bishtak gati 2 herë më të shkurtër se llapa; gjethet e mesit gjatore vezake, me majucë; gjethet e tjera heshtore, menjëherë të ngushtuara në bishtak të shkurtër, të gjitha në buzë me dhëmbë të dyfishtë rezhdor, në të dy faqet, posaçërisht në bishtak, me qime gjëndërore. Lulesat dalin nga sqetullat e gjetheve; këmbëzat si dhe braktetë e tyre me qime gjëndërore, më vonë lakohen poshtë. Sepalët vezake, pothuaj gati të mprehta, të shogëta ose me gjëndra të rralla, të imta, me buzë të gjelbra ose jo. Kurora 3-4 herë më e gjatë se kupa, e gjelbër-e murrme. Staminodit	Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovit në, Dalmaci (subende miki)	Në Kosovë është e përhapur zakonisht në shkëmbinj karbonat dhe silikat të zonës subalpine dhe alpine nga 1500-2300. Në shkëmbinj silikat rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Lamium galeobdolon</i> , <i>Jovibarba heuffeli</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Senecio rupestris</i> , <i>Rosa pendulina</i> , <i>Anthemis montana</i> . Në substrat gëlqeror shoqërohet nga llojet: <i>Potentilla</i> Foto: Fadil Millaku (2013), <i>Pashtrik speciosa</i> , <i>Rhamnus pumilla</i> , <i>Achillea holosericea</i> , <i>Isatis tinctoria</i> , <i>Sedum rubens</i> , <i>Jovibarba heuffeli</i> , <i>Globularia cardifolia</i> , <i>Lamium garganicum</i> , <i>Campanula versicolor</i> , <i>Sedum dasyphyllum</i> , <i>Reseda luteola</i> , <i>Corydalis ochroleuca</i> , <i>Geranium lucidum</i> , <i>Micromeria cristata</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkë te Lumëbardhit, Maje te Rusolisë). Millaku, F. Pajazitaj, Q., Krasniqi, E. & Mala, Xh. me 21.07.2011 këtë lloj e konstatuan në Pashtrik, Millaku, F. dhe Mala, Xh. me 06.07. 2011 e konstatuan në Malet e Mushtishtit (Rusenice), Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. me 31.07.2011 e konstatuan në Malet e Sharrit (Guri i Zi).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit kanë areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve.	I rrezikuar.

		shkurtër, vezak-përmyset. Fillet e thekeve me gjëndra të shumta. Shtyllëza e shogët, kreza me puprri. Kapsula tophore, ngushtohet në drejtim të krezës. VI-VII. (Qosja, Xh. et al. 1996).					
43	<i>Selaginella selaginoides</i> (L.) Link [Selaginella spinulosa A. Braun] Emri shqip: Selaginellë si selaginëz Familja: Selaginellaceae	Bimë e vogël me pamje të myshqeve, me kërcëj zvarritës e rrënjëlëshues, me degëza të holla, me simetri rrezore, 3-15 cm, të ngritura. Gjethet 1-3 mm, të gjitha të ngjashme, me renditje spiralore, me 1-5 dhëmbë të mëdhenj në çdo anë. Kalliret sporbajtës 1-5 cm, të trasha, të verdheme. Riprodhohet gjatë VII-IX. (Pajazitaj, Q. 2004).	Në malet e Evropës: (Pirineje, Alpeve, Karpate, Ballkan), Kaukazit, Siberisë, Kamçatkë s, Amerikës Veriore (Arkto-Alpikë).	Në Kosovë ky lloj rritet në vende me lagështirë të zonës alpine, kryesisht në kuadër të pyllit të kërlekës (Pinus mugo) ose në vende moçalore e shoqëruar nga llojet: Parnasia palustris, Sanguisorba officinalis, Veratrum album Potentilla palustris, Veratrum album dhe lloje nga gjinia Carex sp. ose Juncus sp.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Saric et al. (1986), Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984), Randjelovic, et al. (1983), Josifovic et al. (1977), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit, Koprivnik) dhe Malet e Sharrit (Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Luboten, Guri i Pavllovit).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit dhe Koprivnik) dhe Malet e Sharrit (Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Luboten, Guri i Pavllovit) kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
44	<i>Tephrosieris papposa</i> (Rchb.) Schur [Senecio procerus (Gris.) Boiss.] Emri shqip: - [Pulith i lartë] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të përjetë, në fillim leshtak, më vonë i shogët. Gjethet e reja leshatake, nga sipër pothuaj bëhen të shogëta, të gjelbraerët, të lëmuara, nga poshtë pak a shumë leshatake ose të shogëta. Gjethet e bazës të mëdha, vezake ose heshtore-vezake, ngushtohen në bishtak të shkurtër; gjethet e kërcellit gjatore ose vizake; gjethet e mesit të kërcellit pak a shumë të barabarta me ndërnjat. Kaptinëza 3-5 cm në diametër, rrezore, në lulesë të çlirët vastakore, të thjeshtë ose të përbërë, me	Siujdhesa Ballkanik e (Kosovë, Shqipëri, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovë), Bullgari - Endemike - Ballkanik e).	Është e përhapur në substrat gëlqeror, serpentin dhe silikat në vende barishtore dhe shkëmbore në bashkësitë: Lamieto-Brometum erecti, Semperviveto-Seslerietum argenteae), në pyje (Fageto-hyrcaneto-columnetum, Piceetum excelsae dhe Sorbetomughetum - në shkëmbinjtë gëlqerorë). Në Pashallarë është konstatuar në zonën subalpine të pyllit të kërlekës (Pinetum mugo) e shoqëruar nga llojet: Bornmuelleria diecki, Pinus mugo, Lilium albanicum, Gentiana punctata dhe Gentiana lutea.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) është e përhapur në Malet e Sharrit (Bistra, Pashallarë) dhe Alpet Shqiptare (Zhleb-Rusoli).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Bistra) dhe Alpet Shqiptare (Zhleb-Rusoli) kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

		shumë kaptinëza; këmbëzat e kaptinëzave 2-10 herë më të gjata se ato. Braktetë e pështjellë ngjyrë kafe, leshatake deri të shogëta. Lulet të verdha; lulet gjuhëzore 10-15 mm të gjata. Xhufka më e gjatë se tub ii kurorës dhe i akenit. Akeni i shogët. Lulëzon V-VIII, frytton VIII-IX.					
45	<i>Taxus baccata</i> L. Emri shqip: Tisi Familja: Taxaceae	Shkurre ose dru (Fanerofite P) deri 15- 20 m, me kurorë piramidore të gjërë. Degët të këmbëza në mënyrë të çrregullt. Halat vizake, me majucë, përposh me dy ripthas gojëzash të blerta të zbehta, përsipër të blerta e të shndritshme, 10-30 x 2- 3 mm. Lulet mashkull të përbëra prej 6-14 luspash me 4-8 qeskëza pjalmore në faqen e poshtme. Lulja femër përbëhet nga një bosht i shkurtër i mbuluar me luspa, në majën e të cilit qëndron një vezës e vetme. Fryti rrushk i rremë, me mish të kuqërremë (aril). Farat 6-7 x 4-5 mm, me dy, rrallë me tre ose me katër brinjëza për së gjati. Lulëzon III-IV. Frytton VIII-IX (Paparisto, K. et al. 1988).	Evropë veriore, Spanjë, Mediterran , Bellorusi dhe Kaukaz (Tutin, T. G. et al. 1964, Josifovic, M. et al. 1970, Polunin, O. 1997, Vladimiro v, V. et al. 2007).	Në Kosovë rritet në pyje me ah dhe me bredh në kuadër të fitocenozave: AbietiFagetum moesiaca dhe Pinetum heldreichii typicum. Në lokalitetin Belle (Alpet Shqiptare-Njësia Menaxhuese “Pleqe Qëli”) gjendet në kuadër të fitocenozës Pinetum heldreichii typicum. Është identifikuar vetëm 1 individë i tisit në shoqëri me llojet: Pinus heldreichii, Pinus peuce, Abies alba, Pinus sylvestris. Në lokalitetin Baballoq (Alpet Shqiptare-Njësinë Menaxhuese “Kozhnër Roshkodol”) gjendet në pyllin e ahut me bredh. Janë identifikuar 2 individë të tisit bashkë me llojet: Abies alba, Fagus sylvatica, Pinus peuce. Në Lybeniq (Alpet Shqiptare- “Koprivnik”-Pejë) gjendet Foto: Fadil Millaku (2011), Koritnik gjithashtu në pyllin e ahut me bredh. Është lokaliteti me shtrirje më të madhe sipërfaqësore dhe numër të trungjëve të tisit në Kosovë. Është identifikuar mbi fshatin Lybeniq në vendin e quajtur Tëbanet e Osës. Tisi paraqitet individualisht apo në grupe të vogla, në distancë të ndryshme nga njëra tjetra në një sipërfaqe prej afro 3 ha. Llojet shoqëruese: Abies alba, Fagus sylvatica, Pinus peuce. Në	Alpet shqiptare (Malet e Deçanit, Bjeshkë e Junikut, Maja e Rusolisë, Belle, Baballoq, Lybëniq), Koritnik (Shabanaj, H., et al. 2008, Rexhepi, F. 1994, 1997, MMPH (2008)). Gjendja e llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe në Malet e Mushtishtit (lokalitetet: Vrellë, “Guri i Musës” në numër të vogël të individëve).	Edhe pse haset në disa lokalitete në Alpet Shqiptare, Koritnik dhe Malet e Mushtishtit; poplacionet e këtij lloji kanë numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

				Koritnik (Njësisë Menaxhuese "Koritnik I") gjendet në kuadër të pyllit të ahut me bredh. Janë identifikuar 2 individë të tist bashkë me llojet: Abies alba, Fagus sylvatica, Pinus peuce.			
46	Tozzia alpina L. subsp. carpatica (Woloszczak) Dostal Emri shqip: Tozia Familja: Orobanchaceae	Bimë shumëvjeçare, gjysmëparazite, e degëzuar (Hemikriptofite H). Kërçelli 8-35(50) cm e lartë, e drejtë, lehtë këputet. Gjethet të përkundrejta, të lëmuara, të trasha, në pjesën e sipërme të plotë, në pjesën e sipërme të kërçellit me dhëmbëz të imët. Lulet të vetmuara të cilat grumbullohen në lulesë në maje të degëve, bishti i lules 3-6 mm i gjatë, kupa 4-7 mm e verdhë e bardhmë. Thekët 0.5-1 mm të gjatë. Fruti tophthor njëpjesësh me vriguj, ka 1-2 fara. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Stevanovic, V. et al. 1999).	Evropë (Tutin, T. G. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në luginë me rrjedhë uji të zonës subalpine deri alpine. Shohet nga llojet: Trollius europaeus, Caltha palustris, Cirsium appendiculatum, Gymnadenia frivaldii, Veratrum album, Geum coccineum etj.	Malet e Sharrit (Gjimibeg, Vracë, Shutman, Piribreg, Përroi i Durlit), Alpet Shqiptare (Koprivnik) (Stevanovic, V. et al. 1999).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
47	Viola grisebachiana Vis. Emri shqip: Manushaqe e Grisebakut Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pa kërçell 3-10 cm. Gjethet vezake – rrotullare 1.5-3 cm, shytë, të plotë ose lehtësisht ura-ura, gati të shogëta, që ngushtohen menjëherë në një bishtak relativisht të gjatë. Ndajgjethëzat si gjethet por me të vogla. Lulet rreth 2 cm, bazale, ngjyrë manushaqe. nënpetlat të gjëra shytë. Petlat anësore të drejtuara nga lartë. Shpori 3-4 mm, shytë me i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza berrylake në bazë, e kokët, me një të hapur	Ballkanik e (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Greqi, Serbi).	Në Kosovë ky lloj është i përhapur në shkëmbinj gëlqeror rrallë në kullota të thata të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Potentilla apennina, Saxifraga aizoon, Minuartia doerfleri, Thlaspi bellidifolium, Dryas octopetala etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) Josifovic, M. et al. (1972) është e përhapur në Malet e Sharrit (Koritnik, Livadhishtë, Luboten, Koblicë, Piribreg) dhe në Alpet Shqiptare të Kosovës (Maja e Rusolisë).	Edhe pse në Kosovë ky lloj formon disa popullacione/subpopullacione të vogla në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare; popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë janë me areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve/subpopullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.

	të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në frytnim, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).						
48	<i>Gentiana lutea</i> L. Emri shqip: <i>Sanëza</i> Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me rizomë shumë të shkurtër e cila degëzohet në 2-10 rrënjë të gjata dhe të trasha. Kërccoli është i thjesht 60-90 (100) cm i gjatë. Gjethet janë vezake të mëdha me nervura. Gjethet e poshtëme me bisht, të sipërmet pabisht. Lulet të vendosura në qerthuj. Kurora e verdhë, me të ndara shumë më të gjata se tubi. Riprodhohet me fare. Lulëzon VI-VIII. Frytëzon VII-IX. (Rexhepi, F. 1986).	Evropa, Azia e Vogël.	Rritet në kullosa, në qafa të maleve të zonave subalpine dhe alpine, në substrat gëlqeror, silikat dhe serpentinorë. Është konstatuar në kuadër të asociacioneve të ndryshme e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Onobrychis scardica, Achillea alexandriensis, Polygala major, Senecio wagneri, Pinus mugo, Valeriana officinalis, Veratrum album, Lilium albanicum etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) gjendet në Pashtrik, sipas Millaku, F. (2005) gjendet në Alpet Shqiptare (Gjeravicë), Rexhepi, F. (1986) e përshkruan në Zhleb dhe Mokna. Gjatë viteve 2010-2013 këtë lloj e kemi konstatuar në shumë lokalitete në Alpet Shqiptare (Maja e Rusolisë, Bjeshka e Lumëbardhit, Liqenak, Bjeshkë të Strelcit, Pleçe, Bjeshkët e Istogut (mbi syne, Bjeshkë të Kaliqanit), Lipë, Maja e Vjellakut, LlazBelapaç, dhe në Malet e Sharrit (Brod, Vracë, Rudokë, Gjimbeg, Malet e Mushtishtit, Pashallarë, Balka e Madhe, Koritnik, Oshlak, Përroi i Durlit, Shtëpia e Malorëve etj.).	Edhe pse ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione; ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në kuadër të Maleve të Sharrit, Popullacioni i këtij lloji në gjendje më të mirë ka qenë në Bjeshkët e Mushtishtit (Pashallarë). Edhe ky popullacion është dëmtuar si pasojë e zjarreve që kanë ndodhur në dhjetë vitet e fundit. Në kuadër të Alpeve Shqiptare popullacionet e këtij lloji në Majën e Vjellakut, Majën e Rusolisë dhe në Bjeshkën e Lumëbardhit janë me të mirat dhe në dhjetë vitet e fundit vërehet një ripërtëritje natyrore shumë e mirë e këtij lloji.	I përkeqësuar.

49	<i>Gentianella bulgarica</i> (Vel.) Holab. Emri shqip: Gencianëza bulgare Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore dyvjeçare, e gjatë 1-7-(-20) cm. Lulet me bisht të shkurtër. Kërcejtë të degëzuar me 4-8 ndërnjye. Gjethet kërcellore janë gjatore heshtore, gati shyte. Bishtat e luleve më të gjata se gypi i kupës, vrigujt e kupës gati të barabartë ndërmjet tyre, vizak të sheshtë ose pak të sipërveshur. Kurora është 12-20 mm, e bardhë ose manushaqe e zbehtë. Kapsula është me bisht. Qosja, Xh. et al. (1996)	Karpate (Rumani) dhe Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bullgari).	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me shkurre, kullosa dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Sempervivum macedonicum, Trifolium alpestre, Dianthus cruentus, Knautia dinarica, Salix retusa, Juncus trifidus, Hieracium pilosella, Trifolium alpestre.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkën e Lumëbardhit, Hajlë, Kurvallë, Majën e Kunorës, Rrasë të Zogut). Në Malet e Sharrit (Koritnik, Shutman, Vracë, Pashallarrë). Millaku, F. me 16.08. 2013 këtë takson e konstatoi edhe në lokalitetin Maja e Çetajve (Koprivnik) në lartësi mbidetare 2470 m.	Edhe pse ky takson në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji në Pashallarrë (Ostrovicë) gjendet në substrat serpentini në lartësi 1832 m dhe në vitet e fundit është duke u zvogëluar numri i individëve maturë si pasojë e demtimit prej zjarreve.	I përkeqësuar.
50	<i>Malus florentina</i> (Zucc.) C.K. Schneider [Syn.: Sorbus florentina Nym.] Emri shqip: Mollë florentine Familja: Rosaceae	Shkurre ose dru i vogël (Fanerofite P), deri 5 m. i lartë, me kurorë të rrumbullakët dhe lëvore të plasurit. Degët e reja të kuqe në të kafet, me qime, pa gjemba. Gjethet vezake të gjëra, 3-6 x 2-4 cm, me majë të mprehtë, të cinguar ose si zemër në bazë, me push të bardhë në faqen e poshtme, me bishtak 1,5 – 2,5 cm, me buzë të vrigulluara ose dhëmbë-dhëmbë të parregullt, të ngjashme me gjethet e murrizit dhe të vodhëvices. Lulesa vastakore me 5-8 lule, me bishta me qime. Lulet me diametër 1,5 – 2 cm, të bardha. Shtrati i lules dhe sepalet me qime të dendura, të përhimë në të bardha; sepalet të gjata 3-4 mm, të rënshe. Shtyllëza 5, të bashkangjitura në bazë. Thekë rreth 20, të gjatë po aq sa shtyllëzat. Fryti elipsoid i gjërë, rreth 1 cm i gjatë, i kuq të paktën në një anë, me	Itali, Maqedoni, Greqi Veriore, Shqipëri, Kosovë (Paleoend emike e Ballkanit dhe Apenineve)	Rritet në pyje gjethegjera termofile dhe mezotermofile të dushkut (Quercetum farnetocerris scardicum Krasn.) si dhe në pyje të shkozës së zezë (Carpinetum orientalis scardicum Krasn.) e shoqëruar nga llojet: Quercus farnetto, Q. cerris, Q. petraea, Sorbus domestica, S. torminalis, Fraxinus ornus, Colutea arborescens, Viburnum lantana, Cornus Foto: Elez Krasniqi (2011), Pashtrik mas, Comandra elegans, Paeonia decora, Lithospermum purpureocoeruleum, Physospermum aquilegifolium etj.	Sipas Pajazitaj Q. (2012), Krasniqi, F. (1972), Josifovic, M. et al. (1972), është e përhapur në: Gërmi, Gllarevë, Blinajë, Qyqavicë, Malin Drenicë, Carrallevë, Malet e Suharekës (Bokat e Bacevcit, Bokat e Korishit), Radavc dhe Pashtrik	Popullacionet e këtij lloji në të gjitha lokalitetet e konstatuara kanë numër shumë të vogël të individëve maturë. Zakonisht në të gjitha lokalitetet takohen individ të vetmuar ose në numër shumë të vogël.	I përkeqësuar.

		qeliza gurore. Fara zakonisht 10, ngjyrë gështenjë, 2 x 6 mm. Lulëzon:IV-V. Frytton: VIII-IX. (Qosja, Xh. et al. 1992).					
51	<i>Paeonia peregrina</i> Mill. [<i>Paeonia decora</i> G. Anderson.] Emri shqip: <i>Bozhure shtegtare</i> Familja: Paeoniaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërçep zhardhokor, me rrënjë të mishta. Kërçelli i fuqishëm i shogët. Gjethet dyfishtreshe, përposh pak leshtore ose të shogëta. Gjethëzat trepjeshëse, segmentet e gjethëzave të ndara në 3 vriguj në formë heshtore. Lulet e mëdha, ngjyrë të kuqe të mbyllët. Rrëshekthe 2-3 (-4) me qime të bardheme. Fara ngjyrë purpurt e mbyllët e shkëlqyeshme. Lulëzon V, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe zhardhok. Paparisto, K. et al. (1988).	Ballkan deri Azi e Vogël.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrate gëlqerore, silikate dhe serpentimore. Rritet zakonisht në vende me bar në kuadër të asociacioneve: Quercetum pubescentis cerris (Gillarevë), Quercetum frainetto cerris scardicum (Gërmi) dhe CrategoPrunetum spinosae (Gazimestan). Rritet e shoqëruar nga llojet: Quercus cerris, Q. pubescens, Acer monspessulanum, Acer tataricum, Prunus tenella, Crataegus monogyna, Sorbus torminalis, Viburnum lantana, Evonymus verrucosus, Dictamnus albus, Adonis vernalis, Filipendula hexapetala, Carpinus orientalis, Stachys scardica, Verbascum phoeniceum, Helleborus odorus etj.	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Kosovë (nuk ceken lokalitetet). Gjatë vitit 2011-2012, Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F. & Krasniqi, E. kanë hulumtuar Foto: Fadil Millaku (2012), Gillarevë popullacionet e këtij lloji në Malet e Gillarevës, Gjurgjevikut të Madh deri të fshatit Llapçevë, rajonin e Mirushës, Gazimestan, Gërmi i dhe Blinajë (Lipjan).	Popullacioni i këtij lloji në rrethinën e Malit të Gillarevës që arrinë deri të Gjurgjevikut i Madh, fshatit Llapçevë dhe rajoni i Mirushës është më i madh dhe më i pasuri me numër të individëve maturë. Pas viteve të 2000-ta në këtë habitat janë ndërtuar 5 gurthyes të cilët janë duke shkatërruar dhe degraduar seriozisht habitatin e këtij lloji. Popullacionet në Gazimestan dhe Gërmi kanë areal të kufizuar por janë më pak të ndikuara nga faktori negativ antropogjen.	I përkeqësuar.
52	<i>Primula halleri</i> (Gmelin) Honck. Emri shqip: <i>Aguliqe e Hallerit</i> Familja: Primulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 12-18 cm e lartë, miellore. Gjethet 28 x 0.5-3 cm, gjatore-vezake të përmbysëta deri heshtore të përmbysëta, përposh miellore, me dhëmbëz të imtë. Shtija 8-18 cm, me 2-12 lule. Braktetë 5-10 mm. Këmbëzat 5-10 mm. Kupa 8-12. Kurora me diametër 15-20 mm, ngjyrë jargavani, me gyp 20-30 mm, 2-3 më e gjatë se kupa. Kapsula cilindrike, aq sa ose më e gjatë se kupa. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me	Alpe, Karpate, Ballkan (Endemik e Evropjano juglindore – Kaukazike)	Në Kosovë rritet në substrat silikat, kullota ose vende shkëmbore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Dianthus sylvestris, Rhodiola rosea, Lilium albanicum, Potentilla montenegrina, Geranium coeruleum, Knautia dinarica, Gentiana lutea, Veronica orsiniana, Silene roemerii etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e përhapur në Malet e Sharrit (Maja e Zezë, Restelicë, Vracë, Rajoni Brodit 2250 m). Me 21. 07. 2009 Millaku e konstatoi në Gjeravicë në shkëmbinj silikat ekspozicion Jugor, në 2370 m lartësi mbi detare. Me 17.07. dhe 18.07. 2013 Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj e konstatuan edhe në Kurvallë (ekspozicion	Subpopullacionet në Majën Zezë, Restelicë dhe Vracë, kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është i vogël. Populacioni në Alpet Shqiptare përbehet nga dy subpopullacione që kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është i vogël.	I përkeqësuar.

		farë dhe në mënyrë vegjetative. Qosja, Xh. et al. (1996).			Jugor) dhe Pllaçicë të Junikut (Ekspozicion Verior) në 2150 m lartësi mbidetare. Millaku, F. me 13.08.2013 e konstatoi edhe në Marjash në zonën alpine në lartësi mbidetare 2157 m.		
53	Ramonda serbica Pancic Emri shqip: Ramondë e Serbisë Familja: Gesneriaceae	Shumëvjeçare me rozetë bazale, 15-20 cm e lartë (Hemikriptofite H). Gjethet 3.5x1.3 cm, të thjeshta, përsipër të kreshpëta, përposh leshtore të murrme, pa ndajgjethëza, vezake të përmbysëta, të ngushta, kunjore në bazë, me buzë ura-ura ose dhëmbë-dhëmbë; bishtaku zakonisht i shkurtër, me qime. Shtija 6-8 cm, me 1-3 lule, 5 pjesëshe, pothuajse aktinomorfe. Kurora si tas, me diametër 2.5-3 cm, me vriguj të drejtë-të hapur, lila deri manushaqe. Pjalmoret manushaqe- blu. Krezat të kokët. Fryti kapsulë septicide, më i gjatë se kupa. Lulëzon VI. Frynon VII. (Tutin, T. G. et al. 1972).	Serbi, Maqedoni, Mali i Zi, Shqipëri, Kosovë, Epir dhe Bullgari (Tutin, T. G. et. al. 1972; Josifovic, M. et. al. 1974; Jordanov, D. et al. 1995; Polunin, O. 1997; Vladimiro v. V. et al. 2007; Gashi, B. 2013).	Në Kosovë rritet në të çarat e shkëmbinjtë gëlqeror me hije të zonave malore deri subalpine (500-1800 m l. m. d.) në shoqëri nga llojet: Achillea ageratifolia, Hieracium racemum, Hedera helix, Arabis verna, Asplenium ruta- muraria, Ceterach officinarum, Sedum album, Campanula versicolor, Hieracium waldsteini, Arabis caucasica, Phyllitis scolopendrium, Polypodium vulgare, Saxifraga rotundifolia, Oxalis acetosella, Silene saxifraga, Sempervivum tectorum, Pimpinella saxifraga, Saxifraga sempervivum, Valeriana montana, Sedum telephium, Calamintha acinos etj.	Alpet Shqiptare- Gryka e Zhlebit, Radac, Gryka e Sushicës, Gryka e Rugovës, Gryka e Koprivnikut, Malet e Sharrit - Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Oshlak, Gryka e Rusenices, Guri i Matosit, Shkëmbi i Përgjakur, Gryka e Dollocit, Pashtrik, rritet edhe në Luginën e Ibrit (Gashi, B. 2013; Gashi, B. et al. 2012; Josifovic, M. et al. 1974; Zeneli, L. 1975; Krasniqi, F. 1982, 1998; Millaku, F. 1993, 1997, MMPH 2008).	Popullacionet shtrihen në lartësinë mbidetare 530- 1651 m. Kanë përhapje të kufizuar. Popullacione me numër të vogël të individëve janë ato në Radac dhe në Grykën e Koprivnikut. Popullacionet në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, Grykën e Rugovës, Radac dhe në Grykën e Zhlebit janë të ndikuara nga urbanizimi dhe ndotja. Këto popullacione mund të rrezikohen edhe nga njeriu, sepse gjenden në zona turistike, ku faktori antropogjen ka ndikim. Popullacionet janë të rrezikuara edhe nga gërryerja e masiveve shkëmbore nga kompanitë që merren me prodhimin e rërës (lokalitetet: Gryka e Rusenices dhe Gryka e Lumit Sushicë).	I përkeqësuar.
54	Tephrosieris papposa subsp. wagneri (Degen) B. Nord. [Senecio wagneri Deg.] Emri shqip: - [Pulith i Wagnerit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngjitur, në fillim me qime të merimangëta leshtore, më vonë pothuaj të shogët. Gjethet nga sipër pak a shumë të lëmuara, me qime të merimangëta leshtore nga poshtë. Gjethet e bazës gjatë – eliptike, gradualisht të ngushtuara në bishtak, të dhëmbëzuara; gjethet	Siudhesa Ballkanik e (Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari)- Endemike Ballkanik e.	Në Kosovë rritet në substrat silikat me rrallë në substrat gëlqeror, në vende me barë dhe shkëmbore të zonave të larta subalpine dhe alpine ose në vende me bar dhe lëndinë të pyllit të kërkles (Pinus mugo) e shoqëruar nga llojet: Geranium sylvaticum, Jasione orbiculata, Geum montanum, Juniperus sibirica, Pedicularis verticillata, Armeria alpina, Sesleria nitida, Hypericum alpinum, Veronica bellidifolia, Dianthus	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është e përhapur në Majën e Rusolisë, Kurvallë, Gjeravicë, Liçenak dhe Hajlë. Sipas Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Vracë, Livadhishtë,	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Popullacioni i këtij lloji në Gjeravicë është në gjendje të mirë dhe i pasur me individ maturë në krahasim me popullacionet e këtij lloji	I përkeqësuar.

		e kërcellit gjatore-heshtore, të ngushtuara në bazë, pabishtak; gjethet e sipërme vizake. Kaptinat jo rrezore, 1.5 cm në diametër, në vastak të thjeshtë me 5-10 kaptinëza. Pështjella e purpurtë në të kafët. Lulet me ngjyrë intensive të verdhë. Lulet llapore mungojnë. Xhufka pakz më e gjatë se kurora. Akenët të shogët. Lulëzon IV-VIII, frytton VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000).	cruentus, Onobrychis scardica, Polygonatum bistorta, Trifolium badium, Stachys alpina etj.	Luboten, Oshlak, Koritnik).	në lokalitetet tjera në Kosovë.		
55	<i>Stachys tymphaea</i> Hauskn. [<i>Stachys reinertii</i> Heldr.] Emri shqip: - [<i>Sarushë e Reinertit</i>] Familja: Lamiaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur, më shpesh të padegëzuar, me qime kaçurrele të buta e të gjata, pa gjëndra. Gjethet vezake ose gjatore, me majë të rrumbulluar ose të mprehtë; gjethet e poshtme me bishtak, në bazë si zemër; të mesmet pabishtak, të gjitha me qime të dendura, të buta të përhimëta. Braktetë heshtore-vezake, pabishtak. Qerthujt e rremë në grupe të dendura e të afruara njëra me tjetrën. Kupa dendësisht me qime të gjata; dhëmbët trekëndorë-heshtorë, me majucë që përfundon me një kreshtë, me qime gjëndërore, më vonë shpërvëshën ose lakohen anash. Kurora e kuqe; gypi me unazë qimesh përbrenda; buza e sipërme e plotë, me qime leshtore. Thekët lakohen jashtë kurorës. VI-VII.	Siujdhesa ballkanike (Endemik e-Ballkanik e).	Rritet në vende shkëmbore, pyje (Pinion mugi) dhe kullota të zonës alpine dhe subalpine e shoqëruar nga llojet: Achillea lingulata, Pinus mugo, Senecio subalpinus, Lilium albanicum, Vaccinium myrtillus, Juniperus sibirica, Ranunculus montanus, Geum montanum etj.	Sipas Millaku,F. (1999), Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Koprivnik, Liqenak.	Ky lloj në Kosovë formon dy subpopullacione të vogla në kuadër të Alpeve Shqiptare. Këto subpopullacione kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I përkeqësuar.

56	<i>Achillea clavenae</i> L., var. <i>argentea</i> Vis., syn. [Ptarmica clavenae DC.] Emri shqip: <i>Barpezmi çomage e argjendte</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) pak a shumë pushbutë e mëndafshhtë. Kërcejtë deri 40 cm, të thjeshtë, të ngritur ose të përpjetëm. Gjethet pendore të çara, vriguj pak (2-4 në të dy anët), kryesisht të plotë, shytë; gjethet bazale deri 8 cm, me bishtak të gjatë, kërceloret rreth 2 x 1 cm, pabisht. Vastakët me 6-25 kaptinëza. Pështjella 4-8 mm në diametër; braktet 3-5 mm, vezake, shyte ose majëmprehta, me buzë të gjëra, kafe. Lulet llapore 4-6 mm, vezake, të bardha. Akenët 2 mm të përhimëta. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytton VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike Alpino-Dinarike (Kosovë, Shqipëri, Greqi, Mali Zi, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovina, Slloveni). Sipas Tutin et al. (1976) lloji është i përhapur edhe në Itali.	Rritet në substrat gëlqeror të zonës subalpine dhe alpine në kuadër të Rendit Amphoricarpetalia dhe Aleances Potentillion caulescens e shoqëruar nga llojet: Cerastium decalvans, Saxifraga scardica, Valeriana pancicii, Valeriana montana, Armeria canescens, Geum bulgaricum, Achillea abrotanoides, Silene micrantha, Saxifraga aizoides, Edraianthus graminifolius, Ranunculus thora etj.	Sipas Millaku, F. (1999) ky takson është e përhapur në Alpe Shqiptare (Maja e Rusolisë, Liqenak, Rrasë e Zogut, Hajlë), në Bjeshkën e Lumëbardhit gjendet var. intercondens. Sipas Josifovic et al. (1986, 1975) var. argentea është i përhapur në Liqenak dhe Malin Mokna, kurse var. intercondens në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Oshlak). Me 16.08.2013, Millaku, F. këtë takson e konstatoi edhe në Pleçe (2200 m) dhe në Majën e Çetës (Koprivnik, 2470 m)	Popullacionet e këtij taksoni në Kosovë kanë përhapje mjaft të gjërë në kuadër të Alpeve Shqiptare mirëpo taksoni A. clavenae, var. argentea ka areal më të kufizuar. Ky takson haset kryesisht në tufë rrallë si individ në të çara të shkëmbinjve së bashku me mjaft lloje të rralla dhe endemike. Në Malet e Sharrit subpopullacionet e taksonit Achillea clavenae, var. intercondens kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
57	<i>Armeria canescens</i> (Host) Boiss. Emri shqip: <i>Armerie e përhimtë</i> Familja: Plumbaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-60 cm e lartë, me kërçep pak të degëzuar. Gjethet majëtopitura, dytrajtëshe; të jashtmet 2-3 (-6) mm të gjëra, vizakegatipallake të sheshta; të brendshmet 1-2 mm të gjëra, vizake ose vizake heshtore, të sheshta rrallë buzëkëthyer. Shtijet të ngritura ose të harkuara, me këllëf 7-30 mm të gjatë. Koka (lulesa) 15-25 cm e gjërë. Braktet e jashtme të pështjelljes me të shkurtra ose aq sa të brendshmet. Të brendshmet shyte ose me thimth me buzë cipëthata. Kallithet	Evropë.	Rritet në substrat gëlqeror ose granit, kullota e livadhe të zonës subalpine e alpine e shoqëruar nga llojet: Stachys alpina, Botrychium lunaria, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Hypericum alpigenum, Juniperus sibirica, Antennaria dioica, Myosotis alpestris etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) në Alpe Shqiptare është konstatuar në Dervish Kom, Foto: Fadil Millaku (2012), Kurvallë Bogiçë, Liqenak, Rusoli, Gjeravicë, Bjeshka e Lumëbardhit. Sipas Josifovic et al. (1972) rritet në Dervish Kom, Bogiçë, Liqenak. Sipas Saric et al. (1986) në kuadër të Maleve të Sharrit rritet në Majën e Zezë, Guri i Pavllorit dhe Koçinak led. Millaku, F. me	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Dervish Kom, Pllaçicë të Junikut, Bjeshkë të Dobroshit (Rupë), Bogiçë, Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit) dhe në Malet e Sharrit (Majën e Zezë, Guri i Pavllorit dhe Koçinak led) janë të vogla dhe me areal të kufizuar. Zakonisht rritet e vetmuar ose në tufa të vogla. Shpesh rritet në habitate të njëjta me llojin Armeria alpina.	Gati i rrezikuar.

		pabisht ose gati pabisht; braktet aq sa kupa (6-10 mm). Halëzat 1-2 mm. Kurora e trëndafil të deri e kuqërremtë e purpurt ose e bardhërreme. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë.			17.07.2013 këtë lloj e konstatoi në Kurvallë.		
58	Barbarea balcana Panc. Emri shqip: Barbare e Ballkanit Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët. Kërceceli deri 70 cm. Gjethet e poshtme lirake pendore të çara, me vrigullin skajor si zemër-vezak dhe me 0-2 palë vriguj anësor; të sipërmet pendore të çara. Lulet të verdha, në vile vastakore, pa brakte. Petalet 7-15-25 mm; këmbëzat të hapura, 6-8 mm; flegelat jo me nervurën e mesit të dallueshme; shtyllëza 2-4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemik e Ballkanit)	Rritet në vende me lagështi ose pran burimeve dhe përrrenjve të zonës alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: Pinguicula sp., Gymnadenia frivaldii, Parnasia palustris, Caltha palustris, Veratrum album, Narthecium scardicum, Cardamine pratensis, Saxifraga stellaris, Saxifraga rotundifolia etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve tona ky lloj është e përhapur në Malet e Gjeravicë Sharrit (Luboten, Bistër, Guri i Zi, Brod, Shtëpia e Malorëve) dhe Alpet Shqiptare (Gryka e Lloqanit, Kurvallë, Pllaçicë e Vokshit, Pllaçicë e Junikut, Gjeravicë, Bjeshka e Dobroshit).	Shumica e popullacioneve /subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël me përjashtim të Popullacionit në Gjeravicë dhe Pllaçicë që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
59	Cerastium grandiflorum Waldst. et Kit. [Cerastium. nodosum Buschm.] Emri shqip: Cerast lulemadh Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore, 15-30 (-50) cm, pushbutë e bardhë deri e përhimët. Gjethet 25-70 x 0.5-1.5 mm, vizake të ngushta, gati të mprehta, me buzë shumë të shpërveshura. Lulesa cime, me degëza tufëzore të ngritura, me 7-15 lule, me këmbëza 1-4 cm. Braktetë vezake deri gjërësisht heshtore, me buzë dhe maje cipëthatë të gjërë. Nënpetlat 6-8 mm, gati shyta, pushbuta, me buzë cipëthatë. Petlat deri 18 mm, të ngushtuara gradualisht drejt bazës, rreth 3 herë sa kupa. Vezorja dhe kapsula pushbuta, të paktën në	Pjesa perëndimore të Gadishullit Ballkanik (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Bosnë dhe Hercegovina, Kroaci (Tutin, T. G. et al. 1976; Polunin, O. 1997; Josifovic, M. et. al. 1970).	Në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në vende shkëmbore të zonës subalpine, kryesisht në ekspozicione veriore të ftohta dhe nën ndikimin e erërave. Në lokalitetin Shutman (1914 m l.m.d.) gjendet në vende shkëmbore të zonës subalpine në shoqëri me llojet: Dianthus doctoides, Hieracium pilosella, Euphrasia rotskoviana, Luzula forsteri, Primula veris, Stachys alpina, Scabiosa leucophylla, Trifolium alpestre, Gentianella bulgarica, Geranium subcaulescens etj.	Alpet Shqiptare-Zhleb (Millaku, F. 1999, Josifovic, M. et. al. 1970, Silic, C. 1988). Në lokalitetin Shutman (Malet e Sharrit) në kullosa subalpine është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e popullacioneve të llojit nga F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala më 01.08.2011). Gjendja e popullacioneve të llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe gjatë viteve 2012-2013 në disa lokalitete në	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël. Në veçanti Popullacioni i konstatuar në Shutman ka <50 individë maturë.	Gati i rrezikuar.

		bazë. Kapsula e drejtë, deri dy herë sa kupa; dhëmbët të sheshtë, të hapur. Lulëzon VI. Frytton VII (Paparisto, K. et al. 1988).			Malet e Sharrit (Livadhishtë, Bistër, Karanikollë dhe Lumi i Thatë-afër tre kufirit.		
60	<i>Crepis incarnata</i> (Wulf.) Tausch subsp. <i>dinarica</i> (Beck) Hayek [Crepis <i>froelichiana</i> subsp. <i>dinarica</i> (Beck) Gutermann, <i>Crepis rubra</i> L.] Emri shqip: Shmangë Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare 8-30 (-60) cm e gjatë. Rizoma e shtrirë, e shkurtër, cilindrike. Kërcelli i shogët ose me pak qime, i drejtë, pa gjethe ose rrallë me një gjethe heshtore deri ovale. Gjethet të blujeshile, pak të trasha, në të dy faqet me qime, formojnë rozetë, deri 8 cm të gjata, ovale-heshtore më të ngushta afër bazës. Kaptinëzat 2-5 (subsp. <i>dinarica</i> 1-4). Invulokrumi cilindrik 12-15 mm i gjatë (subsp. <i>dinarica</i> 10-12 mm), braktet shumë të ngushta me vijë të bardhë, të jashtmet të holla pykore trekëndore përgjysmë më të shkurtra se të brendshmet. Lulet jargavan i zbehtë, të kuqe ose të bardha (nganjëherë të verdha), më të gjata se involukrumi. Papusi i bardhë. Akenët pak të ngushtë në maje me brinjë, 4-5 mm të gjatë të gjelbër-ulliri. Lulëzon V-. Frytton VI-VII (Josifovic, M. et al. 1975).	Alpe (ish-Jugosllavi), Vendet Ilire (Millaku, F. 1999; Josifovic, M. et al. 1975). Sipas Vladimirov, V. et al. (2006) është e përhapur në Alpet Shqiptare.	Në Kosovë ky takson rritet në livadhe-kullosa të freskëta në zonat e larta malore. Shoqërohet nga llojet: <i>Linum capitatum</i> , <i>Polygala major</i> , <i>Achillea lingulata</i> , <i>Scabiosa columbaria</i> , <i>Silene roemerii</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Lotus corniculatus</i> etj.	Alpet Shqiptare (Zhleb, Bjeshkët e Lumëbardhit, Pllaçicë, Kurvallë, Maja e Liqenakut, Bjeshkët e Lloqanit, Maja e Rusolisë, Ishtedim, Koprivnik, Rrasë e Zogut) (Millaku, F. 1999; Rexhepi, F. 1997; Diklic, N. & Nikolic, V. 1961; Josifovic, M. et al. 1975, Silic, C.	Popullacionet/ subpopullacionet e këtij taksoni në Kosovë kanë përhapje vetëm në Alpet Shqiptare. Ky takson edhe pse në Alpet Shqiptare ka përhapje të gjërë; subpopullacionet kanë numër të vogël të individëve maturë. Zakonisht takohen pak individë të cilët mund të jenë në tufë ose të vetmuar.	Gati i rrezikuar.

61	<i>Erigeron epiroticus</i> (Vierh) Halacsy Emri shqip: <i>Erigeroni i Epirit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 3-8 cm, me kërcell të përjetshëm leshor, pa gjëndra, i thjeshtë me një kaptinë. Gjethet bazale janë 3-8×0.3-1.4 cm vizake deri pallake me bisht dhe pak a shumë majëmprehta. Gjethet në kërcell 1.22.5×0.3 cm, vizake, pabisht, majëmprehta. Kaptina është me diametër 1.5 mm me pështjellë kambanore 7×6 cm. Lulet janë tri trajtëshe ato llapore të purpurta, 9 mm të gjata. Braktet e pështjellës janë shumë pushlore. Riprodhohet me fare. Lulëzon VI-VIII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).	Bimë endemike e Ballkanit.	Ky lloj në Kosovë rritet në kullosa të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Cerastium decalvans</i> , <i>Pimpinella saxifraga</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Valeriana montana</i> , <i>Edraianthus graminifolius</i> , <i>Achillea abrotanoides</i> , <i>Valeriana tripteris</i> , <i>Erigeron uniflorus</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Gentiana nivalis</i> .	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M. et al. (1975) është e përhapur në Koprivnik, Maje të Rusolisë, Marjash, Pllaçicë, Kurvallë, Gjeravicë.	Popullacioni i këtij lloji në Alpet Shqiptare përbëhet nga gjashtë subpopullacione të cilat kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
62	<i>Gentiana dinarica</i> Beck Emri shqip: <i>Gencianë dinarike</i> Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-8 cm e gjatë. Gjethet janë të grupuara drejt bazës së kërcellit, shtija është e ngritur, me një lule të vetme skajore. Gjethet bazale në rozetë, dy të poshtmet eliptike ose vezake-eliptike 19-32×11-19 mm, me 3 nervura. Gjethet në bazë janë qelqore kërcelloret janë 10-13×7-8 mm, vezake të thepëta. Kupa është me gyp me kënde dhe dhëmbë të thimthuar. Kurora blumanushaqe, pa njolla me grykë me gyp 30-40 mm e vriguj shytë të përkulur nga jashtë. Filli 1 cm i zgjeruar në bazë, pjalmoret janë 6 mm, të verdha. Kreza është 1.5-2 mm si elpazë. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII.	Alpet, Dinariket, Karpatet Jugore, Kosovë, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror dhe silikat, në kuadër të kullotave të thata të zonës alpine rrallë haset edhe në zonën subalpine të Alpeve Shqiptare dhe Malet e Sharrit. Rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Vaccinium uliginosum</i> , <i>Gentiana verna</i> , <i>Gentiana utriculosa</i> , <i>Gentiana koschiana</i> , <i>Cerastium decalvans</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Dianthus integer</i> etj.	Në bazë të dhënave nga literatura dhe hulumtimeve tona në terren ky lloj është i përhapur në: Koritnik, Bjeshkët e Lumëbardhit, Greben, (Rexhepi, 1986), Gjeravicë, Pllaçicë e Junikut, Kurvallë, Dervish Kom, Bjeshkë e Dobroshit (Çuka e Gërrbave), Bjeshkë te Belegut, Marjash.	Popullacionet /subpopullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare janë me të ruajtura dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Koritnik popullacioni i këtij lloji ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	Gati i rrezikuar.

		Frytnon VII-VIII. (Rexhepi 1986, Qosja, Xh. et al. 1996).					
63	<i>Geum bulgaricum</i> Pantic Emri shqip: Melaka e Bullgarisë Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). me kërcell të gjatë 30-50 cm, me qime të vogla dhe gjëndërore, gjethet kanë qime të buta. Gjethet bazale janë pendore me shumë gjethë të vogla anësore. Gjethëza terminale 10-15 cm e gjatë veshkorezeme. Lule 3-7 në lulesa gati simpodiale (cimoziqe) rreth 25 mm në diametër. Bishtat e luleve të gjatë të mbuluara me qime gjëndërore si dhe kupa. Gjethëzat e kupës të gjëra, vezake-heshtore me maje të blertë të cektë. Petalet janë trekëndore, të bardha ose të verdha të çeltë. Fryte ka shumë. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytnon VII-VIII. (Rexhepi, F. 1986).	Ballkan (Kosovë, Bullgari).	Rritet në substrat gëlqeror; në çeltira pyjesh, shkëmbinj dhe në kuadër të asociacionit Wulfenio-Pinetum mugo e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Wulfenia blecicii, Aquilegia vulgaris, Daphnae oleoides, Plantago gentianoides, Anthemis montana, Aconitum vulparia, Onobrychis scardica, Edraianthus graminifolius, Primula veris, Primula elatior, Juniperus sibirica etj.	Sipas Millaku, F. (1999, 1993) Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al.(1972) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb, Rusoli, Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Koprivnik, Hajlë). Gjatë viteve 2012-2013 Millaku, F. këtë lloj e konstatoi edhe në Majën e Vjellakut, Milishevcë dhe Pleçe.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë (Alpet Shqiptare) edhe pse kanë areal të kufizuar, numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i konsiderueshëm. Popullacionet e këtij lloji në Rusoli, Liqenak dhe Bjeshkë të Lumëbardhit janë në gjendje të mirë edhe pse një pjesë e habitatit të këtij lloji në Liqenak është dëmtuar nga zjarri.	Gati i rrezikuar.
64	<i>Gnaphalium pichleri</i> Murb., [Omalotheca pichleri (Murb.) .] Emri shqip: - [Omalotekë e Piklerit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 5-20 cm. Gjethet gjatore të përmbysëta deri vizake-heshtore; gjethet kërcellore 40-100 x 2-4 mm, me një dell, që ngushtohen gradualisht në drejtim të majës. Lulesa shumë e çlirët dhe e ndërprerë. Kaptinëza 4 mm, me të poshtmet me bisht me të gjatë se kaptinëzat. Braktetë e pështjellës shytë; të jashtmet sa 1/3 e gjatësisë së pështjellës majëmprehta; të brendshmet me push të butë e të dendur nga ana kurrizore, si vll në	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovë, Greqi).	Ky lloj në Kosovë rritet në shkëmbinj të zonës subalpine dhe alpine. Në Koprivnik ky lloj është konstatuar në substrat gëlqeror në vendin e quajtur shkëmbi i dallëndyshe në lartësi 2100 e shoqëruar nga llojet: Cerastium decalvans, Silene macrantha, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Potentilla apennina, Valeriana pancicii, Edraianthus Foto: Fadil Millaku (2012), Pllaçicë e Junikut graminifolius, Achillea abrotanoides, Salix retusa etj. Në Grykën e Milishevcit është konstatuar në shkëmbinj gëlqeror së bashku me llojet: Ramonda serbica, Amphoricarpus neumayeri, Silene macrantha eti.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1975) në kuadër të Alpeve Shqiptare është prezent në: Kurvallë, Pllaçicë, Dervish Kom dhe Koprivnik. Millaku, F. & Krasniqi, E. me 09.08.2012 e konstatuan një popullacion të vogël të këtij lloji edhe në Grykën e Milishevcit.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile në shumicën e lokaliteteve.	Gati i rrezikuar.

		kohën e pjekjes së fryteve. Lulet femër të pakta, hermafroditet 3-3.5 mm, të shumta, me vriguj të kurorës deri 0.5 mm. Akenet 1.5 mm, me qime të dendura dhe të rrasura, që shtrihen rreth majës dhe mbulojnë bazën e xhufkës. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).					
65	<i>Gymnadenia frivaldii</i> Rchb. Emri shqip: <i>Salepremmë i Frivaldit</i> Familja: Orchidaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite H), me zhardhokë të ndarë thellë me vriguj të gjatë dhe rrënjë të holla. Kërçelli i gjatë deri 20 cm në bazë me gjethe të ngjashme me këllëf. Gjethe 3-4 gjatore-heshtore, të sipërmet si brakte. Lulesa e shkurtërboshtore, e ngjeshur. Braktet janë heshtore me 1 nervurë të gjatë sa lulet. Lulet të vogla të bardha ose vjollce të zbehtë. Të gjitha gjethëzat e perigonit përveç buzës njëra kah tjetra të lakuara formojnë helmetën. Gjethëzat e jashtme të perigonit janë gjatore-vezake, të brendshmet janë gjatore, të gjata sa të jashtmet dhe pak më të ngushta. Buza është më e shkurtër se gjethëzat tjera të perigonit e plotë ose tre vrigullore, e lakuar teposhtë. Shpori penjësor, kah maja i mprehtë, i gjatë sa 1/2 e pistilit. Riprodhohet me farë.	Evropë, Grenlandë , Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me lagështirë të zonës subalpine dhe alpine ose me rrallë mund të takohet edhe në kullota ose shkurra të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë kryesisht rritet në kuadër të asociacionit Pinguiculo Narthecium scardici e shoqëruar nga llojet: Pinguicula balcanica, Narthecium scardicum, Caltha palustris, Eriophorum angustifolia, Alchemilla hybrida, Veratrum album, Phyteuma pseudorbiculare, Orchis maculata, Trollius europaeus, Geum coccineum, Ranunculus platanifolius dhe lloje të ndryshme të gjinisë Carex, etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1976) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Liqenak, Ploçicë) dhe Malet e Sharrit Foto: Fadil Millaku (2012), Liqenet e Jazhincës (Prevallë, Piribreg, Konjushë, Livadhishtë). Millaku, F., Krasniqi, E. Malaj, Xh. me 11.07.2013 e konstatuan edhe mbi Shtëpinë e Malorëve (Brezovicë), dhe në lokalitetin Përroi i Durlit. Millaku, F. me 16.06. 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Malin Mokna në lartësi mbidetare 1445 m. Millaku ,F. gjatë 17-20 korrik 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në: Kurvallë (1974 m lartësi mbidetare).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të popullacioneve në Gjeravicë dhe Bjeshkë të Dobroshit (Rupë). Këto dy popullacione te këtij lloji edhe pse kanë areal shumë të kufizuar; kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.

					Pllaçicë të Vokshit, Pllaçicë të Junikut (1831 m), Bjeshkë të Tropojës (Kosovë- 2259 m), Bjeshkë të Dobroshit (2049 m) dhe në Qafë të Bogiqës (2002 m).		
66	<i>Lamium garganicum</i> L. Emri shqip: <i>Hithëbuta e garganit</i> Familja: Lamiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-60 cm. Gjethet 19-70×10-40 mm, si zemër-vezake me qime të dendura deri gati të shogëta, ura-ura deri ura-ura të sharrëzuara. Kupa është 7.5-18 mm, me gyp zakonisht gati sa dhëmbët. Kurora 25-40 mm me ngjyrë nga e trëndafiltë deri e purpurtë, e rrallë dhe e bardhë. Gypi është 15-25 mm, i drejtë, shumë më i gjatë se kupa, buza e sipërme 10-15 mm e çarë dysh ose zakonisht me dhëmbë të cekët, vrigujt anësorë të shkurtër, trekëndorë. Buza e poshtme 10-15 mm zemër përmbysët. Anterët leshtake. Riprodhohet me farë. Lulëzon IV-VIII. Frytton V-IX. (Qosja, Xh. et al. 1966).	Bimë Ballkanike-Mediterrane (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Bullgari)	Rritet në shkëmbinj, pyje të zonës malore (Fagetum montanum), pranë rrugëve malore e shoqëruar nga llojet : Scrophularia bosniaca, Trifolium badium, Anthemis montana, Asplenium rutamuraria, Silene vulgaris, Ceterach officinarum, Fraxinus ornus, etj.	Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Oshlak, Rusenicë, Vracë, Luboten, Kurvallë, Gryka e Deçanit, Koprivnik, Gryka e Sushicës.	Ky lloj në Kosovë formon popullacione në Malet e Sharrit dhe në Alpet Shqiptare. Këto popullacione kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve brenda këtyre popullacioneve është i konsiderueshëm me përjashtim të Popullacionit në Vracë që ka numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
67	<i>Narthecium scardicum</i> Kosanin Emri shqip: <i>Nartecë e Sharrit</i> Familja: Nartheciaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e lartë 9-27 cm, me rizomë. Gjethet distike, shpatëngjashme, me 4-10 deje, të sipërmet më të vogla se të poshtmet. Vilet të dendura, fundore, me 5-13 lule të vogla. Segmentet e rrethlules të verdhë, 4-5 mm, të lirë, të qendrueshëm yllorë gjatë lulëzimit dhe të	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Mali Zi, dhe Maqedoni (Matevski, V. & Kostadino vski, M. (1996), Micevski &	Në Malet e Sharrit dhe Alpe Shqiptare rritet në vende me lagështirë, afër burimeve (vende moçalike) të zonës alpine në kuadër të asociacionit Pinguicula Narthecium scardici dhe Carici-Narthecium scardici e shoqëruar nga llojet: Pinguicula balcanica, Pinguicula vulgaris, Barbarea balcana, Juncus trifidus, Cardamine pratensis, Carex cariophyllea, Carex goodenowii, Alchemilla hybrida, Veratrum album etj.	Sipas Millakut (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) në kuadër të Alpeve Shqiptare është prezent në: Kurvallë, Pllaçicë, Bogiqë, Maja e Rusolisë, Gjeravicë, Stanet e Erenikut, Qafa malore në mes të Ishtedimit dhe	Në kuadër të Alpeve Shqiptare është konstatuar në 8 lokalite. Popullacioni në Gjeravicë përbëhet nga 4 subpopullacione të cilat janë të pasura edhe me lloje tjera endemike. Popullacionet tjera në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar mirëpo janë të pasura me individë maturë.	Gati i rrezikuar.

		ngritura gjatë frytëzimit. Këmbëzat 47 mm. Thekët me pjalmore vizake, bazëngjitur; fillet leshtake. Vezorja ngushtohet në një shtyllëz të shkurtër e me një krezë të vogël trevrigujshe. Kapsula 8-10 mm, ovoide, me çahje lokulicide. Farat të shumta. Lulëzon V-VII. Frynjon VII-VIII. Vangjeli, J. et al. (2000).	Matevski (1987).		Hajlës, Kroj i Mbretit (B. e Belegut). Në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Pribreg, Livadhishtë, Liqenet e Jazhincës). Me 16.07. 2011 Millaku, F., Krasniqi, E., Rexhepi, F. & Mala, Xh. e konstatuan në Luboten. Millaku, F. me 19.07.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në disa lokalitete të Alpeve Shqiptare (Bjeshka e Dobroshit- Rupë (2049 m) dhe Qafa e Bogiqës (2120m).		
68	<i>Pinguicula balcanica</i> Casper Emri shqip: <i>Pinguikulë e Ballkanit</i> Familja: <i>Lentibulariaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare dimëruese (Hemikriptofite H), me sythe. Gjethet pranverore 20-30 x 15-20 mm, vezake të gjëra ; gjethet e verës 20-50 x 10-20 mm, eliptike-gjatore. Këmbëzat 1-5, gjëndërore, 4-8 (10) cm. Vrigujt e kupës vezakë të gjërë, sa të gjatë dhe të gjërë, rrallë me të gjatë se të gjërë, buza e poshtme e ndarë dysh deri 1/3 e gjatësisë së saj. Kurora 14-19 mm, blu lila, me njolla të bardha në bazë; vrigujt e buzës së poshtme vezake-gjatore. Shpori 3-4 (7) mm, cilindrik, i drejtë. Kapsula ovoide. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit	Rritet në vende me lagështirë (afër burimeve) të zonave subalpine dhe alpine në kuadër të asociacionit <i>Pinguiculo-Narthecietum scardici</i> dhe <i>Orphanideo-Cirsietum appendiculati</i> shoqëruar nga llojet: <i>Narthecium scardicum</i> , <i>Gymnadenia frivaldii</i> , <i>Parnasia palustris</i> , <i>Polygonatum bistorta</i> , <i>Alchemilla hybrida</i> , <i>Saxifraga rotundifolia</i> , <i>Barbarea balcana</i> , <i>Cardamina pratensis</i> , <i>Veratrum album</i> dhe lloje nga gjinia <i>Carex</i> sp. dhe <i>Juncus</i> sp.	Sipas Millaku, F. (1999) në Alpe Shqiptare është e përhapur në Majën e Rusolisë, NT – Gati I rrezikuar. Koprivnik dhe Gjeravicë. Sipas Rexhepi, F. (2000) dhe Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare (nuk ceken lokalitetet). Gjatë vitit 2011-2012; Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F., Mala, Xh. dhe Krasniqi, E. i hulumtuan popullacionet e këtij lloji në: Luboten (1894 m), Bistër (2186 m), Brezovicë (2010 m) Përroi i	Popullacionet në kuadër të Alpeve Shqiptare janë të vogla dhe me areal shumë të kufizuar por kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Edhe në Malet e Sharrit janë disa popullacione që kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Në shumicën e popullacioneve ky lloj rritet së bashku me llojin <i>Narthecium scardicum</i> dhe <i>Gymnadenia frivaldi</i> .	Gati i rrezikuar.

					Durlit, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Liqenet e Jazhincës, Livadhishtë.		
69	<i>Plantago reniformis</i> Beck. Emri shqip: <i>Gjethedell si veshkë</i> Familja: Plantaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me një rozetë gjethesh. Gjethet 5-17 (30) x 2.5-10 cm, llapa vezake si zemër gati rrotullore dhe e cinguar në bazë ura - ura deri më dhëmbë pak a shumë me qime të përdredhura, bishtaku 1/2 -2 herë me i gjatë së llapa. Shtijet i kalojnë gjethet përposh gati të shogëta, përsipër me qime të dendura të shtrira, kallinj të 2-6 cm të dredhura. Braktetë 2-2.5 mm, vezake-heshtore zakonisht pushlore. Sepalet 2-2.5 mm gati të barabarta, pothuaj të lira gjelberoshe-kafe ose purpur. Gypi i kurorës 2 mm, i shogët, vrigujt 1-1.5 mm, vezak, majëmprehtë ose shyt. Thekët 4 mm dalin mbi kurorë. Kapsula 3 mm. Lulëzon V-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit (Ks, Al, B&H, Mz).	Rritet në kullota, vende me lagështirë dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Trifolium repens, Lotus corniculatus, Alchemilla hybrida, Pimpinella saxifraga, Onobrychis scardica, Pedicularis verticillata, Gentiana nivalis, Ranunculus montanus, R. oreophyllus, Geum montanum, Potentilla crantzii etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është prezent në Rrasë te Zogut dhe Liqenak. Sipas Josifovic et al. (1974), Lakusuc, R. (1970) është prezentë në Alpe Shqiptare (Liqenak, Hajlë dhe Koprivnik). Millaku, F. me 30.06.2012 e konstatoi edhe në Pleçe në lartësi 1884 m, me 18-19 07. 2013 në Gjeravicë (1870 m), dhe Pllaçicë të Junikut. Është e përhapur edhe në Luboten.	Popullacionet në Liqenak, Koprivnik, Gjeravicë, Pllaçicë e Junikut kanë areal shumë të kufizuar, dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël.	Gati i rrezikuar.
70	<i>Potentilla speciosa</i> Willd. Emri shqip: <i>Potentillë e bukur</i> Familja: Rosaceae	Barishtore shumëvjeçare (Kamefite CH), me kërcej lulorë deri 30 (40) cm, me qime pushlore të bardha ose të përhimëta. Gjethet trishe; gjethëzat vezake të përmbysta, deri eliptike-vezake të përmbysta, 15 x 30 mm, ura-ura-dhëmb-dhëmb, të paktën në 2/3 e sipërme përposh me qime pushlore të	Ballkanik e (Kosovës, Shqipëri, Greqi, Bosnjë & Hercegovina, Kroaci, Mali Zi).	Rritet në shkëmbinj gëlqeror ose në vende me gur të zonës subalpine dhe alpine. Në Alpet Shqiptare (Liqenak) rritet e shoqëruar nga llojet Potentilla apennina, Amphoricarpus neumayeri, Anthyllis aurea, Globularia cardifolia dhe Arctostaphylos uva ursi. Në Koritnik dhe Pashtrik rritet e shoqëruar nga llojet: Ptilotrychum rupestre, Edraianthus graminifolius, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Potentilla	Sipas Millaku, F. et al. (2008), Rexhepi, F. (2000), Rexhepi, F., Millaku, F. (1996), Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1977,1972) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Liqenak), Koritnik, Pashtrik, Oshlak. Millaku, F. me 19.05.2013	Popullacionet në Liqenak (Alpe Shqiptare), Koritnik, Pashtrik dhe Oshlak kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël. Popullacioni nën Majën e Vjellakut (mbi grykën e Sushicës) ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në këtë lokalitet ky lloj takohet në habitatin e	Gati i rrezikuar.

		bardha. Lulet të shumta. Nënpetlat vezake të gjëra . Kupëza me vriguj vizakë, aq ose me të gjatë së nënpetlat. Pjalmoret gjatore. Shtyllëza gati skajore, konike si fill, e shogët, e rënshme. Shtrati lulorë shumë leshtor. Akenet pushlor. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).		apennina, Scabiosa graminifolia, Rhamnus pumilla, Achillea holosericea, Sedum rubens, Jovibarba heuffelii, Anthyllis aurea, Globularia cardifolia, Arctostaphylos uvaursi etj.	i shoqëruar nga Bekim Gashi dhe Naim Berisha këtë lloj e konstatuan edhe nën Majën e Vjellakut në lartësi mbidetare nga 17101913 m.	njëjtë me llojet e rralla dhe endemike të Ballkanit Amphoricarpus neumayeri, Achillea fraasii dhe Saxifraga scardica.	
71	Potentilla visianii Panc. Emri shqip: Potentillë e Visianit Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj lulorë deri 40 cm, pushlore me qime të gjata e të hapura dhe gjëndërore. Gjethet pendore me 11-17 gjethëza; gjethëzat pykore-vezake të përmbysta, 4-25 x 3.5-16 mm, me 2-7 dhëmbë. Lulet zakonisht të shumta, në cima të çlirëta skajore. Këmbëzat zakonisht 10 mm ose me shumë. Nënpetlat trekëndëshe-heshtore. Kupëza me vriguj. Lulëzon VII-VIII. Fytënon VIII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovina, Serbi)	Në Kosovë rritet mbi substrat serpentiner, rrallë gëlqeror (Pashtrik), në kuadër të asociacioneve: Quercetum pubescentis cerris, Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea, Astero-Juniperetum oxycedrii; e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Juniperus oxycedrus, Forsythia europaea, Halacsya sendtneri, Euphorbia glabriflora, Polygala doerfleri, Stachys scardica, Centaurea kosanini, Alyssum markgrafii, Prunus mahaleb, Thesium dollineri etj. Në Pashtrik rritet në shkëmbinjtë gëlqeror ose në kullota subalpine e shoqëruar nga llojet: Achillea holosericea, Isatis tinctoria, Dianthus cruentus, Dianthus sylvestris, Helianthemum canum, Medicago sp., Anthemis montana, Anthyllis aurea, Stachys alpina, Gentiana lutea, Globularia cardifolia, Aster alpinus etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Krasniqi, E. (2003), Krasniqi, E.& Millaku, F. (2007), Rexhepi, F.(2000) është e përhapur në Pashtrik, Koprivnik, Rogozna, Lugina e Ibrit dhe rajon të Mirushës. Sipas Josifovic et al.(1972) gjendet në Koprivnik. Sipas Saric et al. Foto: Fadil Millaku (2013), Pashtrik (1986) në Kopaonik, Golesh, Pashtrik. Janë konstatuar edhe popullacione me areal të kufizuar (të vogla) edhe në Badovc, Gubavc, Bokac e Baqevcit, Korishit (Mushtisht) dhe Koznik (Llapçevë).	Të gjitha popullacionet në këtë lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël. Shumica e popullacioneve gjenden në substrate serpentinerore ku verat janë të nxehta dhe të thata. Popullacioni në Koprivnik (Gubavc) ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik shtrihet mbi substrat karbonat dhe ka areal të kufizuar, është me stabilitet dhe më i pasuri me individë maturë në krahasim me lokalitetet tjera.	Gati i rrezikuar.

72	<i>Sedum serpentini</i> Janch. Emri shqip: <i>Rrushqyqe e serpentinite</i> Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore hollake, e shogët, me kërcëj shterpë. Kërçelli lulor 8-12 cm. Gjethet gjatore-cilindrike, 2-4 mm, shyta. Lulesa vastakore. Sepalet vezake-heshtore, pak shyta deri gati të mprehta. Petalet 3.5-4 mm, të mprehta, ngjyrë purpur. Thëkë 10. Rrëshikthet të ngritura, të trëndafilta. V-VIII. (Paparisto et al. 1988).	Shqipëri, Kosovë, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemik e-Balkanik e).	Ky lloj është i përhapur në substrat serpentinor nga zona kodrinore deri të zona alpine (Maja e Pashallarëve). Zakonisht rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Centaurea kosaninii</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Halacsya sendtneri</i> , <i>Alyssum</i> sp., <i>Stachys scardica</i> , <i>Campanula lingulata</i> , <i>Stipa</i> sp., <i>Haplophyllum boesierianum</i> , <i>Thesium dolineri</i> , <i>Scorsonera austriaca</i> , <i>Vincetoxicum</i> sp., <i>Astragalus onobrychis</i> , <i>Potentilla visiani</i> . Në Pashallarë rritet së bashku me llojin endemik <i>Bornmuellera dieckii</i> .	Brezovicë, Ostrovicë, Pllanik, Bokati e Morinës, Llapçevë, Mrasor, Koznik, Gubavc (Koprivnik), Lugina e Ibrit.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura në shumicën masivëve malor me natyrë serpentine. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i vogël.	Gati i rrezikuar.
73	<i>Sempervivum kosaninii</i> Praeger Emri shqip: <i>Burgull i Koshaninit</i> Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-20 cm, me stolone deri 12 cm të gjata. Rozeta me diametër 6-8 cm. Gjethet e rozetës heshtore përmbysët, me majucë, 15-30 x 7-9 mm, në të dy faqet me qime gjëndërore, shumë të trasha, në buzë me qepalla gjëndërore, të gjelbra-errët, me majë të kuqe, në bazë të bardhërreme. Kërçelli lulor i fuqishëm, me qime të dendura gjëndërore. Gjethet e kërçellit vizake, me majë, mishtake, me qime gjëndërore, 20-35 x 5-8 mm. Lulesa e dendur, me qime gjëndërore. Lulet gati pabishtak, 13-14 anëtarëshe, purpur. Kupa me qime gjëndërore, 7-9 mm, segmentet heshtore-vizake, gati të mprehë, 4-5 mm. Petalet vizake, 10-12 x 1 mm, nga sipër purpur, buzët të bardhërreme, poshtë të gjelbra, në buzë dhe faqen e poshtme me qime gjëndërore.	Kosovë, Maqedoni (Endemik e), Micevski & Matevski (1987). Foto: Fadil Millaku (2013), Dervish Kom	gëlqerorë dhe silikate të zonave të larta subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Vaccinium uliginosum</i> , <i>V. myrtillus</i> , <i>Luzula sylvatica</i> , <i>Sedum</i> sp. etj.	Sipas Millaku, F. (2005), Krasniqi, F. (1987), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Bogiçë, Pllaçicë, Gjeravicë, Dervish Kom, Zhleb, Koprivnik, Rusoli, Liqenak, Lumbardhë. Është konstatuar edhe në mes Lubotenit dhe Livadhishës.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare janë të vogla dhe kanë areal të kufizuar. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Në rajonin e Gjeravicës gjenden tri subpopullacione (Gjeravicë, Pllaçicë dhe Dervish Kom). Popullacioni në Bogiçë ka areal shumë të kufizuar. Në kauder të popullacioneve të këtij lloji në Alpet Shqiptare janë takuar edhe forma hibride.	Gati i rrezikuar.

		Thekët 6-7 mm, fillet në bazë pakz të zgjeruar, anterët të kuqe-të hapët. Karpelet 6-7 mm, shtyllëza e kuqërreme, 3-3.5 mm.VI-VII.					
74	Silene asterias Griseb. Emri shqip: Klokëz yllorë Familja: Caryophyllac eae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët, e rimtë. Kërcejtë deri 100 cm, të thjeshtë, veshullorë sipër. Gjethet e bazës pallake; kërcelloret të pakta, heshlore, zakonisht të kundërngjitura. Lulesa rruzullore, me brakte vemesore. Kupa 12-15 mm, cilindrike-si çomangë, e shogët, e kuqërremtë, me dhëmbë të mprehtë. Petalet me llapë gjatore, të plotë, purpur të mbyllët. Kapsula 7-10 mm, gjatore, aq ose pak më e gjatë se karpofori i shogët. VI-VII. Paparisto, K. et al. (1988).	Siujdhesa Ballkanik e (Endemik e Ballkanik e).	Në Kosovë ky lloj është konstatuar në zonën e pyllit të kërlekës (Pinion mug), në vende me lagështi të zonës subalpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: Rumex alpinus, Veratrum album, Alchemilla hybrida, Heracleum sp., Mentha longifolia, Cardamine tuberosa, Cardamine pratensis, Ajuga pyramidalis, Geum coccineum, Geum rivale, Valeriana officinalis etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Stevanovic, V. Jankovic, M. (1984), Josifovic et al. (1970), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Koprivnik), Malet e Sharrit (Piribreg, Ujërat e Humbura, Liqenet e Jazhincës, Livadhishtë, Maja e Pashallarëve, Studenicë (Therandë).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar. Popullacioni në Studenicë (Therandë afër antenës) është mjaft mirë i zhvilluar dhe ka mjaft individë maturë në kuadër të popullacionit. Popullacionet tjera në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në Alpet shqiptare (Koprivnik) është konstatuar vetëm një popullacion me areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
75	Wulfenia bleicii Lak. Emri shqip: Vulfenie e Bleqiqit Familja: Plantaginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të fortë horizontale (Gjeofite G). Gjethet bazale me formë të ndryshme- të rrumbullakëta, të përmbysta-ovale, lopatore, të përmbusta-vezake, eliptike ose heshlore, buzëve dy herë të dhëmbëzuara deri cekët të çara, nga ana e sipërme të shogëta ose me qime të rralla, nga poshtë e sidomos në nervura të mbuluara me qime. Gjethet në kërcell janë shumë më të vogla, gjatore-vizake. Lulesa është terminale, e ngjeshur ose e rrallë, me shumë lule në bishta të shkurtër. Kupa dv	Kosovë - endemike e Alpeve Shqiptare (Rexhepi, F. 2000).	Në Kosovë rritet në vende barishtore, pyje e shkurre të zonës subalpine dhe alpine në kuadër të fitocenozës Wulfenio-Pinetum mug, në shoqëri me llojet: Pinus mugo, Pinus peuce, Aquilegia vulgaris, Valeriana pancicii, Geum bulgaricum, Anthemis montana, Achillea abrotanoides, Arabis alpina, Valeriana montana, Pedicularis brachyodonta, Trifolium noricum, Aconitum vulparia, Dianthus sylvestris, Hypericum alpigenum etj.	Alpet Shqiptare (Bogiçë, Gjeravicë, Dervish Kom, Ishtedim, Hajlë, Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Milishevc, Pleçe, Maja e Rusolisë, Koprivnik , Maja e Vjellakut (Saric, M. et al. 1986; Millaku, F. 1993, 1997, 1999, 2005; Rexhepi, F. 2000).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura vetëm në kuadër të Alpeve Shqiptare. Subpopullacionet në lokalitetet Rusoli, Hajlë, Liqenak dhe Gjeravicë kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacionet tjera kanë numër me të vogël të individëve maturë në kuadër të subpopullacioneve.	Gati i rrezikuar.

	herë më e shkurtër se kurora, me pak qime ose e shogët, me 5 segmente linearo-heshiore, pa maje. Kurora ngjyrë vjollce të errët ose vjollce të çeltë. Gypi i kurorës 3-9 mm, i shogët. Thëkët janë 2 të vendosur në krye të gypit të kurorës. Pistili me krezë të zgjeruar. Fryti është kapsulë katërkthine e shogët ose me qime gjëndërore. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 2000).						
76	<i>Asperula doerfleri</i> Wettst. Emri shqip: <i>Njëgjire e Dorflerit</i> Familja: Rubiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë 2-9 cm, tufor të shogët ose rrallë leshtor në bazë. Gjethet 5-8x1-2 mm, heshiorë, me qime leshtore të hapura e të rralla veçanërisht në buzë dhe nervurën qendrore. Bishti lulor i kapteinëzës zakonisht sa gjysma e gjethëve mbajtëse. Kurora gjërësisht gypore-hinkëngjashme, e trëndafiltë; gypi 2-3.5 mm; vrigujt 1-2 mm, leshtorë ose të shogët. Fryti rreth 2 mm, i shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et. al. (1996).	Endemike (Subendemike): Kosovë, Shqipëri, Mali Zi, Maqedoni. Sipas Qosja, Xh. et. al. (1996) është e përhapur në kullota ose shkëmbinjtë të zonës subalpine dhe alpine të Shqipërisë së Veriut. Sipas Tutin et al. (1976) është e përhapur në Shqipëri dhe Mal të Zi. Sipas Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996), Micevski	Rritet në substrate gëlqerore (në të çara të shkëmbinjve) të zonës alpine dhe në kullota të thata, e shoqëruar nga llojet: <i>Dryas octopetala</i>, <i>Minuartia baldaci</i> subsp. <i>doerfleri</i>, <i>Minuartia verna</i>, <i>Edraianthus graminifolius</i>, <i>Potentilla speciosa</i>, <i>Helianthemum canum</i>, <i>Armeria alpina</i>, <i>Saxifraga scardica</i>, <i>Saxifraga sempervivum</i>, <i>Thlaspi bellidioides</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e pranishme në Zhleb dhe Luboten. Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Zhleb, Maje të Rusolisë, dhe LC – Më pak i rrezikuar. Rrasë të Zogut. Sipas Josifovic et al. (1973) është prezentë në vende shkëmbore të zonave të larta malore në Zhleb. Sipas Saric et al. (1986) në Oshlak dhe Konjushka. Millaku, F., Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Krasniqi, E. & Mala, Xh. gjatë vitit 2012 i hulumtuan popullacionet e këtij lloji edhe në Koritnik, dhe Balkë të Madhe, Pleçe, Bjeshkë të Lumëbardhit, Liqenak dhe Milishevc.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maje të Rusolisë, dhe Rrasë të Zogut) kanë areal shumë të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë në disa nga këto popullacione është në numër të konsiderueshëm. Në Malet e Sharrit (Koritnik, Oshlak dhe Konjushkë) popullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar, dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është me i vogël në krahasim me popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare.	Më pak i rrezikuar.

			& Matevski (1987) është e përhapur edhe në Maqedoni.				
77	<i>Campanula foliosa</i> Ten. Emri shqip: <i>Lulekambanë gjetheshumë</i> Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-50 cm kërcell të ngritur, të thjeshtë, cilindrik, pushlor përposh. Gjethet pak a shumë pushlore; të bazës me llapë 3-6 x 2.5 cm, vezake të gjëra , si zemër ose rrotullare në bazë, me buzë të sharruara e me bishtak 4-8 cm pak të flatruar; kërcelloret zakonisht të ngushtuara në bazë, eliptike-vezake, me buzë të sharruara, të gjata sa lulet, me bishtak të shkurtër, ndërsa kërcelloret më të sipërme pothuajse pabisht. Lulesa kaptinëz skajore. Dhëmbët e kupës si fëndyell , të qerpikët, më të shkurtër se gypi i kurorës. Kurora 20-35 mm, manushaqe. Lulëzon VI. Frytnon VIII (Qosja, Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik, Apenine-pjesa qendrore dhe jugore (Tutin, T. G. et al. 1976).	Në Kosovë rritet në substrate silikate, serpentine dhe gëlqerore në pyje, livadhe malore, kullota subalpine e alpine e shoqëruar me llojet: <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Pinus mugo</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Centaurea nervosa</i> , <i>Ajuga pyramidalis</i> , <i>Geranium sylvaticum</i> , <i>Ranunculus platanifolius</i> , <i>Trollius europaeus</i> , <i>Knautia dinarica</i> etj.	Alpet Shqiptare (Liqenak, Maja e Rusolisë, Ishtedim, Hajlë, Bogaj, Maja e Strelcit, Gjeravicë, Bjeshka e Tropojës, Pllaçicë e Vokshit, Pleçe, Malet male e Deçanit, Kurvallë) dhe Malet e Sharrit (Bistër, Luboten, Brezovicë, Oshlak, Vracë, Shtëpia e Malorëve, Gryka e Durlit (Durllov potok) (Rexhepi, 2000, 1986, 1982, 1994; Millaku, F. 2005, 1999, 1993; Josifovic, M. et al. 1974, Diklic, N. & Nikolic, V. 1961, 1978; Zeneli, L. 1975).	Popullacionet/subpopullacionet kanë shtrirje të gjërë në Alpet shqiptare dhe në Malet e Sharrit. Popullacionet/subpopullacionet edhe pse kanë shtrirje të gjërë, rritet në grupe me numër të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

78	<i>Centaurea kosaninii</i> Hayek. Emri shqip: <i>Kokoçel i Koshaninit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë deri 70 cm, pak të degëzuar në pjesën e sipërme. Gjethet të shogëta, zakonisht dyfish pendore të çara; segmentet jo më shumë se 1 mm të gjërë, ngushtësisht vizakë. Pëstjtjella me diametër rreth 15 mm; shtojcat të ngushta, kinde-kinde deri me dhëmbë të shkurtër, të verdhërreme. Lulet manushaqe ose të kuqe të errëta. Akenët 3.5 mm, sa 1/2 e gjatësisë së xhufkës. Lulëzon VI. Frytton VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni -endemike (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Rexhepi, F. 1994, 2000; Krasniqi, F. 1982, 1987, Tutin, T. G. et al. 1976; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë rritet në vende të thata shkëmbore e kullota me natyrë serpentinore (Halacsyetalia sendtneri) por edhe gëlqerore të zonave malore. Shohërohet nga llojet: <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Stachys recta</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Halacsya sendtneri</i>, <i>Stachys scardica</i>, <i>Campanula lingulata</i>, <i>Astragalus onobrychis</i>, <i>Potentilla visianii</i>, <i>Melanpyrum cristatum</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Veronica andrasovszkyi</i>, <i>Aster albanicus</i> subsp. <i>albanicus</i>, <i>Scabiosa fumaroides</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Sanguisorba albanica</i>, <i>Genista hassertiana</i>, <i>Serratula radiata</i>, <i>Jurinea mollis</i>, <i>Dianthus cruentus</i> etj.	Brezovicë, Koznik, Godanc, Gillanasellë, Badovc (Rexhepi, F. 1978, 1979, 1985, 1994, 2000, Josifovic, M. et al. 1975, Blecic, V. et al. 1969, 1971; Silic, C. 1988), Rajoni i Mirushës, Mali Drenicë (Krasniqi, E. 2003, 2006, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua edhe në Gubavc më 06.06.2011 (F. Millaku, Xh. Mala), në Pashtrik më 21.07.2011 (F. Millaku, E. Krasniqi, Xh. Mala) dhe në lokalitetin Qafa e Prushit më 18.06.2011 dhe 18.09.2012 (F. Millaku, F. Rexhepi, Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Bokat e Morinës dhe rritet në bashkësi me llojin <i>Sanguisorba albanica</i>.	Popullacionet kanë përhapje të kufizuar por me numër të madh të individëve me përjashtim të popullacionit në Malin Drenicë (Javor-Luzhnicë) i cili paraqet popullacion me numër shumë të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile me përjashtim të lokalitetit Badovc.	Më pak i rrezikuar.
----	---	---	--	--	---	---	----------------------------

79	<i>Dianthus superbus</i> L. Fl. Suec. Emri shqip: Karafil me balluke Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me kërcell të gjatë 30-65 (90) cm me buca të rralla dhe me bisqe sterile dhe fertile. Kërcelli në pjesën e poshtme është pak i kërrusur, cilindrik i shogët, në pjesën e sipërme është i degëzuar. Gjethet janë lineare të gjata, të gjelbra, të shogëta. Lulet janë në melthe të rralla, shumë aromatike. Luspas e kupës së dytë janë 2-4, lëkurore, ovale, me maje, arrijnë 1/4-1/3 e gjatësisë së kupës. Kupa është 15-30 mm e gjatë dhe 3-6 mm e gjërë, gradualisht ngushtohet kah maja. Fletëzat e kurorës janë 20 mm të gjata, me ngjyrë të bardhëtrëndafili deri në të kuqe, rrallë e bardhë, në formë të çrregullt. e ndarë në pjesë që arrijnë deri te më tepër se gjysma e saj (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi deri në Kore dhe Japoni (Tutin, T. G. et al. 1964; Josifovic, M. et al. 1970, Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet në në kuadër të klasës Vaccinio-Piceetea ose në vende të hapura barishtore-kullota me lagështi të zonës subalpine dhe alpine në shoqëri me llojet: Deschampsia flexuosa, Veratrum album, Plantago gentianoides, Valeriana officinalis, Parnasia palustris, Eriophorum angustifolium, Sanguisorba officinalis etj.	Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Guri i Zi, Liqenet e Jazhincës, Vracë, Oshlak), Alpe Shqiptare-Hajlë, Ishtedim, Mokna (Josifovic, M. et al. 1970; Rexhepi, F. 1986; Millaku, F. 1999).	Popullacionet kanë përhapje të gjërë por me numër të vogël të individëve maturë. Lloji rritet në grupe, zakonisht në vende të lagështa. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
80	<i>Forsythia europaea</i> Deg. et Bald. Emri shqip: Boshhtë e Evropës Familja: Oleaceae	Bimë durore-shkurre (Fanerofite P), e lartë deri 3m. Degëzat dhe nyjet janë me palcë dhe kthina. Gjethet të thjeshta dhe eliptike ose vezake të shogëta. Gjethet e degëve pa lule të dhëmbëzuara deri në ura, ato të degëve me lule buzëplota, 5-8 cm të gjata. Lulet të verdha me kup rreth 3 mm dhe me kurorë -15 mm të gjatë. Kapsula 1.2-1.5 cm. Riprodhohet me farë, Lulëzon IV-V, Frytton VIII-IX. (Rexhepi, F. 2000)	Kosovë, Shqipëri.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore-serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Zakonisht rritet në shoqërim me llojet: Comus mas, Quercus pubescens, Quercus cerris, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Sanguisorba minor, Centaurea montana, Viola sylvestris, Popygala doerfleri, Filipendula hexapetala, Crataegus monogyna.	Sipas Deg. et Doerfler (1897), Rexhepi (2000), Josifovic, M. et al. (1973), Blečić et Krasniqi (1971), Krasniqi, E. (2021), ky lloj është i përhapur në serpentinete Shqipërisë veriore (regjioni i Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi dhe në këto lokalitete të Kosovës: Gubavc, Koznik, rajoni i Mirushës deri afër Rahovecit, Qafa e Prushit, Bokat e Morinës dhe Golesh.	Popullacionet e këtij lloji në Golesh dhe në rrethinën e Koznikut (Zatriq, Mirushë) janë në gjendje më të mirë në krahasim me popullacionet e këtij lloji në Qafë Prush, Qafë të Morinës dhe Gubavc. Popullacionet më të degraduara dhe më me pak individë maturë janë popullacionet në Gubavc (Pejë) dhe Bokat e Morinës. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

81	<i>Gentiana punctata</i> L. Emri shqip: <i>Gentiana me pika</i> Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) me rizomë të trashë dhe rrënjë të degëzuar të gjatë deri 1 m. Kërçelli është 20-60 cm i thjeshtë pak këndorë. Gjethet e poshtme janë të shkurtëra deri 2 cm të gjata, me bisht. Gjethet në pjesën e sipërme të kërçellit janë të kundrejta, pabisht ovale ose eliptike, të gjata 6-9(-12-29) cm, të gjëra 2-6 cm, në bazë janë të ngjitura në këllëf të shkurtër, zakonisht me 3-7 (5) nervura. Lulet janë të dallueshme, pabisht, të vendosura në krye të kërçellit, në formë kaptinore ose formë qerthullore, në sqetullen e gjetheve të sipërme. Kupa është këmbanore, kurora gjithashtu këmbanore me 5-8 vriguj të shkurtër, oval të rrumbullakët të gjatë 8-11 mm. Kurora e bardhë-verdhë me njolla vjollce të mbyllta. Riprodhohet me fare. Lulëzon VIII-X..Frytton IX-X. (Rexhepi, 1986).	Evropë.	Kritet në substrate silikate, karbonate dhe serpentine; në vende me barë, kullosa, shkurre ose çeltira të pyjeve halore e shoqëruar nga llojet: Geum montanum, Juniperus sibirica, Vaccinium myrtillus, Pinus mugo, Gentiana lutea, Armeria alpina, Sempervivum macedonicum, Scabiosa leucophylla, Knautia dinarica, Anemone narcissiflora, Phyteuma pseudorbiculare, Senecio subalpinus etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve në terren, ky lloj është i përhapur gjërësisht në Alpet Shqiptare (Zhleb, Rusoli, Lipë, Bjeshkët e Rugovës, Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit, Roshkodol, Bjeshka e Strellcit, Koprivnik, Bjeshkë të Belegut, Bjeshkë të Dobroshit, Rupë, Bjeshkë të Junikut, Baballoçit, Gjeravicë, Rrasë të Zogut etj.) dhe Malet e Sharrit (Luboten, Livadhishtë, Piribreg, Brezovicë, Përroi i Durlit, Bister, Oshlak, Koritnik, Bjeshkët e Opojes etj).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal mjaft të gjërë si në Malet e Sharrit ashtu edhe në Alpet Shqiptare të Kosovës. Numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është duke rënë si pasojë e grumbullimit si bimë mjekësore për treg. Në bazë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë brenda 10 viteve të fundit popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë zvogëluar mirëpo shumica e subpopullacioneve për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
82	<i>Halacsya sendtneri</i> (Boiss.) Dorbl. Emri shqip: <i>Halacë e Sendtnerit</i> Familja: Boraginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-25 cm, me sistem rrënjor të gjatë dhe të fuqishëm. Kërçelli është i ngritur i padegëzuar i mbuluar me qime të ashpra dhe mbaron me një lulesë cimozike. Gjethet janë të thjeshta, me buzë të plota, në bazë të kërçellit janë lineare-heshtore, ato të kërçellit janë më të vogla të mbuluara me qime të ashpra. Lulet janë hermafrodite diçka zigomorfe. Kupa me 5 gjethëza të ngjitura. Kurora është e verdhë-	Bimë endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi, Kabas, et al. 2013).	Ky lloj rritet në vende me bar dhe shkëmbore mbi substrat serpentiner, e shoqëruar nga llojet: Euphorbia glabriflora, Euphorbia borrelieri, Hypericum barbatum, Polygala doerfleri, Juniperus oxycedrus, Fraxinus ornus, Quercus petraea, Silene vulgaris, Centaurea kusaninii, Stachys recta, Prunus mahaleb etj.	Sipas Rexhepi, F. (1978, 1979), Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021) është e përhapur në Golesh, Gubavë, Koznik dhe Llapçevë. Është konstatuar edhe në Bokat e Morinës, Qafë Prush, Guriq, Serpentinët e Mushtishtit (Bokat e Baçevcit, Bokati e Grejkovcit, Bokati e Korishit).	Popullacionet e këtij lloji në Golesh, Llapçevë, Koznik, Bokati e Morinës dhe Qafë Prush janë në gjendje të mirë dhe mjaft të pasura me individë maturë. Popullacioni i këtij lloji në Gubavë ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

	ari në formë hinke, në bazë 5 kupore. Thekë janë 5 të ngjitur për gypin e kurorës. Pistili me 1 shtyllëz dhe 1 vezore të mbitëshme, katër kthinore dhe në çdo kthinë nga 1 ovulë. Fryti është tetra-aken. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytmon VII. (Rexhepi, F. 2000).						
83	<i>Hieracium waldsteinii</i> Tausch. Emri shqip: <i>Këmashna e Valdshajnit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-25 cm. Kërçelli në pjesën e poshtme është i mbuluar me qime të dendura leshtore, në pjesën e sipërme është me qime të zakonshme. Gjethet në fund të kërçellit thahen, tjerat janë të shumta, zakonisht afër bazës janë shumë dhe duken si rozetë, janë të verdha me qime kreshtore, të shkurtra, leshtore ovale të përmbysëta deri eliptike. Lulesa është melth i rrallë me 1-7 (-25) kaptina. Involukrumi është 9-13 mm i gjatë i trashë, tophor me gjëndra. Lulet janë të verdha. Akeni është 3-4 mm i verdhë në të murrmë. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytmon VII. (Rexhepi, 1986).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bullgari)	Rritet në vende shkëmbore të zonës malore deri alpine. Në Kosovë rritet në kuadër të asociacioneve të ndryshme e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea ageratifolia</i>, <i>Sedum album</i>, <i>Arabis caucasica</i>, <i>Sedum telephium</i>, <i>Mycelis muralis</i>, <i>Asplenium trichomanes</i>, <i>Silene tomasini</i>, <i>Ramonda serbica</i>, <i>Polypodium vulgare</i>, <i>Lamium album</i>, <i>Aruncus dioicus</i>, <i>Valeriana montana</i> etj.	Alpe Shqiptare (Peklen, Gryka e Sushicës, Gryka e Rugovës, Gryka e Koprivnikut, Rusoli, Zhleb, Bjeshka e Belegut, Marjash, Bjeshkët e Istogut, Mokna, Bjeshkët e Deçanit. Bjeshka e Lumëbardhit, Koprivnik) Malet e Sharrit (Oshlak, Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Gryka e Rusenicës), Koritnik, Pashtrik.	Ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione. Këto popullacione-subpopullacione edhe pse kanë areal të gjërë, numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve/subpopullacioneve është i vogël. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

84	<i>Iberis sempervirens</i> L. Emri shqip: <i>Iberis qjithmonblertë</i> Familja: Brassicaceae	Bimë gjysmëshkurre 10-25 (-30) cm e gjatë (Kamefite Ch). Gjethet 2.5-5 mm të gjëra, shyte me buzë të plota, të zgjatura, mishtake. Lulesat vile, bishtat e luleve pa qime. Petalet të bardha. Silikëzat në vile rrotullore-vezake, 6-7 mm të gjata me vriguj gati shyt. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frynnon VII-IX. (Mitrushi, 1966).	Evropa Jugore (Mediterran – Submediteran)	Rritet në substrat gëlqeror në të çara shkëmbinjsh ose në vende gurishtore prej zonës malore deri në atë alpine. Rritet e shoqëruar nga llojet: Anthyllis aurea, Lilium albanicum, Aster alpinus, Juniperus sibirica, Helianthemum alpestre, Onobrychis scardica, Dryas octopetala, Antennaria dioica, Scutellaria alpina etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Josifovic, M. et al. (1972), ky lloj është i përhapur në: Koprivnik, Rrasë të Zogut, Bjeshkë të Belegut, Qafë të Bogiçës, Leqinak, Bjeshkë të Deçanit, afër Pejës (Gryka e Rugovës) dhe në Malet e Sharrit (Luboten, Oshlak, Koxhabalkan, Koritnik). Millaku, F. me 19.07. 2013 e konstatoi edhe në Bjeshkën e Dobroshit (Quka e Gërrbave) në lartësi mbidetare 2250 m, pastaj në Pllaçicë të Junikut në 2352 m e shoqëruar nga Potentilla speciosa dhe Saxifraga scardica. Millaku, F. gjatë 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrik në lartësi mbidetare 1570 m dhe në Majën e Rusolisë (2100 m)	Ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare. Këto popullacione/subpopullacione kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë me përjashtim të Popullacionit në Pashtrik dhe Koritnik. Këto dy popullacione edhe pse kanë areal të kufizuar kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. SubPopullacioni në Pllaçicë të Junikut shtrihet në lartësi 2352 m lartësi mbidetare dhe ka areal shumë të kufizuar. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
85	<i>Knaulia dinarica</i> (Murb.) Borb. Emri shqip: <i>Knaucia e Dinarideve</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli është i mbuluar me qime të dendura të kthyer teposhtë. Gjethet e poshtme janë në rozetë eliptike deri eliptike-heshtore. Gjethet e kërçellit janë heshtore ose lineare-heshtore me buzë të dhëmbëzuara ose të sharrëzuara të mbuluara me qime të palosura.	Ballkan (Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrate të ndryshme; në livadhe, kullosa, vende me shkurrë dhe çeltira pyjesh të zonës subalpike dhe alpike. Në shumicën e lokaliteteve rritet e shoqëruar nga llojet: Achillea multifida, Geum montanum, Leucanthemum vulgare, Pinus heldreichii, Linum capitatum, Pinus mugo, Lilium albanicum, Gentiana lutea, Campanula glomerata, Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum, V. myrtillus etj..	Sipas Rexhepi, F. (1986), Saric et al (1986), Josifovic, M., et al. (1973), Lakusic, R. (1970) është e përhapur në: Alpet Shqiptare (Koprivnik, Hajlë, Kurvallë, Mokna) dhe në Malet e Sharrit (Liqenet e Jazhincës dhe Prevallë). Ky lloj	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Zakonisht takohen individ të vetmuar ose grupe të vogla. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

		Bishtat e lulesave janë të mbuluara me qime dhe gjëndra. Gjethëzat që pëshqjellin lulesën janë ovale heshtore dhe gjëndërore. Lulesa është e gjërë 2-3 mm. Lulet janë të kuqe-vjollcë ose të ngjyrë hirta. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).		është i përhapur edhe në lokalitetin Përroi i Durlit dhe Piribreg.			
86	<i>Lilium albanicum</i> Griseb. [<i>Lilium carniolicum</i> subsp. <i>albanicum</i> (Griseb.) Hayek] Emri shqip: <i>Zambaku shqiptar</i> Familja: <i>Liliaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G). Bulbi (qepa) ka madhësi mesatare ngjyrë të mishit. Kërcealli është i drejtë 20-50-60 cm, në bazë i shogët, pa gjethe, në maje me 1 lule rrallë më shumë. Gjethet kanë vendosje të këmbyer, shumë a pak janë të afuara mes veti, lineare-heshtore, në maje të mprehta, të gjata 7 cm, me qerpikë vetëm në buzë. Lulet janë të verdha-ari ose portokalli (pa njolla) me diametër 3.5 cm. Gjethëzat e perigonit janë heshtore. Kapsula është 2.5-3.5 cm. Riprodhohet me fara dhe bulb. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).	Bimë endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovë, Mali i Zi, Bullgari, Serbi)	Rritet në vende me bar, shkurre, shpate shkëmbore të freskëta të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet : <i>Sempervivum macedonicum</i>, <i>Geum montanum</i>, <i>Vaccinium myrtillus</i>, <i>Pinus peuce</i>, <i>Vaccinium uliginosum</i>, <i>Polygala major</i>, <i>Achillea alexandri-regis</i>, <i>Gentiana lutea</i>, <i>Trollius europaeus</i>, <i>Rubus idaeus</i> etj. Në Bokat e Morinës ky lloj është konstatuar në substrat serpentini në kuadër të disa asociacioneve nga 630-1100 m lartësi mbidetare e shoqëruar nga llojet: <i>Gladiolus illyricus</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Asphodelus albus</i>, <i>Potentilla alba</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Sanguisorba albanica</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999), Rexhepi, F. (2000), Saric, et al. (1986) është e përhapur në: Koritnik, Luboten, Malet e Sharrit (Shtëpia e malorëve, Bistra-Prevallë, Pashallarë, Oshlak, Orman, Piribreg, Ujërat e Humbura, Konjushkë, Qukat e Jezercit), Alpet Shqiptare (Mokna, Koprivnik, Zhleb, Bjeshket e Lumëbardhit, Rusoli, Pllacicë, Gjeravicë, Liçenak, Stanet e Erenikut dhe në Majën e Kunorës). Gjatë viteve 20112012 këtë lloj e kemi takuar edhe në Pashtrik, Pleçe, Milishevc, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Kurvallë, Dervish Kom, Bjeshkë të Dobroshit, pastaj në Malet e Sharrit(Përroi i Durlit, Liqenet e Jazhincës, Livadhishtë, Studenicë (Therandë),	Ky lloj gati në të gjitha lokalitetet e cekura formon popullacione-subpoulacione që kanë pak a shumë një areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve-subpoulacioneve. Është bimë dekorative andaj edhe popullacionet e saj shpesh herë dëmtohen nga adhuruesit e natyrës. Rritet në kuadër të kullotave subalpine dhe alpine me përjashtim të popullacionit të këtij lloji në Bokat e Morinës andaj shpesh dëmtohen nga bagëtia si dhe nga barinjte të cilët i kallin shkurret e kësaj zone për të krijuar kullota të reja. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

					Bjeshkë të Bukoshit, Bjeshkë të Opojës etj. Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj me 16.05.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Bokat e Morinës në ekspozicion verior nga 630- 1100 m lartësi mbidetare. Është rasti i parë i njohur deri me tani që ky lloj të konstatohet në lartësi mbidetare 630 m.		
87	<i>Linum flavum</i> L. Emri shqip: <i>Lin i verdhë</i> Familja: Linaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me kërcëj të ngritur pak të degëzuar sipër, që dalin nga një rozetë e ngjeshur 20-60 cm dhe me pak ose pa rozeta jo lulembajtëse. Gjethet me 3 (-5) nervura, të poshtmet heshtore të përmbysta-pallake, 40-60×10-12 mm, të sipërmet heshtore, pabisht 20-40×7-11 mm, me 2 gjëndra në bazë. Lulesa e degëzuar, zakonisht me 25-40 lule. Sepalet 5-6 (-8) mm, heshtore, të thepëta me karenë e gjëndra në bazë. Petalet të verdha, 20-22×1113 mm, me llapë vezake të përmbysta dhe me thonjzë relativisht të shkurtër. Kapsula 5-6 mm me sqep afër 1 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1992).	Juglindore -Pontike.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në substrate serpentimore në kuadër të rendit Halascietalia sendtneri. Në Bokat e Morinës, Koznik dhe Mirush ky lloj takohet në biotope të njëjta me llojet <i>Linum tauricum</i> e me rrallë me llojin <i>Linum elegans</i> . Lloje tjera bimore që e shoqërojnë këtë lloj janë edhe: <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Halascia sendtneri</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Gladiolus illyricus</i> , <i>Linaria dalmatica</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Fraxinus ornus</i> etj.	Sipas literaturës ekzistuese (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021) etj., është e përhapur në: Koznik, Mirushë, Brezovicë, Novobërdë, Gërmi, Oshlak. Gjatë vitit 2012-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Pashtrikun e Poshtëm, Bokat e Krevenikut, Bokat e Morinës, Gubavc dhe në Qafë Prush.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në Bokat e Morinës dhe në Koznik. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
88	<i>Melampyrum scardicum</i> Wettst. Emri shqip:	Bimë barishtore njëvjeçare (Terrofite T), e butë (15) 20-40 cm, me kërcell të ngritur të pa degëzuar, rrallë të	Endemik i Ballkanit Jugor. Sipas Hayek,	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat në vende me shkurre (<i>Vaccinium myrtillus</i> dhe <i>Juniperus sibirica</i>), dhe pyje të amenit (<i>Pinus peuce</i>)	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Rexhepi, F. (2000), Josifovic et al. (1974) është	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Dervish Kom, Bjeshkë të Tropojës (Kosovë),	Më pak i rrezikuar.

	Grurëzi i Sharrit Familja: Orobanchaceae [Scrophulariaceae]	degëzuar. Gjethet në pjesën e poshtme gjatore heshtore, buzë plota 20-30 mm, në pjesën e sipërme gati trekëndore, me majë dhe me dhëmbë. Lulet në lulesa të shpërndara në vile njëanësore; nervurat e kupës me qime të ashpra shumëqelizore, ndërsa midis nervurave e shogët ose me qime të shkurtër. Dhëmbët e kupës 6-7 mm të gjatë gati sa gypi i kurorës. Kurora 10-17 mm e gjatë, e verdhë; mbi bazë qartë e shtrembëruar anash, me grykë gjysmë të hapur. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VIII-IX, riprodhohet me farë.	(1929), Soo & Webb. (1972), Tutin, T. G. et al. (1964-1980) është e përhapur në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Bullgari dhe Maqedoni (Matevski, V. & A. Teofilovs ki,2004)	ose në pyje të përziera të halorëve. Në Alpet Shqiptare (Kosovë) rritet e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Vaccinium myrtillus, V. uliginosum, Pinus peuce, Dianthus integer, Silene roemerii, Campanula foliosa, Cerastium decalvans, Lilium albanicum etj.	e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Bogiçë, Gryka e Lloqanit, Liqenak). Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur edhe në Malet e Sharrit (Maja e zezë). Sipas Matevski & Teofilovski (2004), Soo (1927), Mayer (1969) është e përhapur në Rudokë. Millaku, F. me 18.07.2013 e konstatoi në Dervish Kom, kurse me 19.07.2013 në Bjeshkë të Tropojës (Kosovë) dhe Bjeshkë të Dobroshtit (Rupë).	Bjeshkë të Dobroshtit, Gryka e Lloqanit dhe Liqenak) kanë areal të kufizuar mirëpo janë të pasura me individë maturë. Në Malet e Sharrit (Maja e Zezë) gjendet vetëm një popullacion që ka areal të kufizuar mirëpo ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin popullacionet /subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	
89	Minuartia bosniaca (Beck) K.Maly Emri shqip: Minuarte e Bosnës Familja: Caryophyllaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcej lulebartës të shumtë, deri 20 cm. Gjethet 8-15 x 0.2 mm, kreshtake në formë filli. Cimat me nga 3 deri shumë lule. Këmbëzat të shogëta, zakonisht 2-4 herë sa nënpetlat. Nënpetlat 3-4 mm, të thepëta, të shogëta, cipëthata deri gati pranë nervurës se vetme të mesit. Petlat gati sa nënpetlat. Gjëndrat në bazën e thekëve të jashtëm të zgjatura dhe të ndara dysh. Kapsula paksa me e gjatë se nënpetlat. Farat 0.8 mm, me kokrriza të mprehta. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al. (1988).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni, Serbi, Bullgari,).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrate gëlqerorë (shkëmbinj dhe vende të thata). Në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit gjendet në të dy anët e lumit e shoqëruar nga llojet: Achillea ageratifolia, Amelanchier ovalis, Campanula versicolor, Micromeria albanica, Hieracium waldsteinii, Convolvulus cantabrica, Corydalis ochroleuca, Petrorhagia saxifraga, Pistacia terebinthus, Ruta graveolens, Salvia ringens, Scabiosa fumaroides, Tremastelma palestinum, Trinia glauca etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1970) është e përhapur në Grykën e Lloqanit dhe Koprivnik. Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në grykën e Lumëbardhit të Prizrenit.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë (Alpe Shqiptare dhe në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit) kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Popullacioni në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit është nën ndikim direkt të ndotjes nga zhurma dhe gazrat që lirohen nga automjetet. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

90	<i>Pedicularis brachyodonta</i> Schlos.et Vuk. Emri shqip: <i>Pedikulare dhëmbëshkurt</i> er Familja: Orobanchaceae [Scrophulariaceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur ose të përprjetëm. Gjethet pushlore, heshtore, dyfishpendore te prera me segmente vizake gjatore, me majucë e të sharruara. Braktetë pendore pak a shumë leshtor të prera deri në tre vriguj. Gypi i kupës leshtor vetëm në nervura; dhëmbët e kupës si deltë, buzëplotë, të qerpiktë. Kura 20-25 cm, e verdhë e zbehtë; buza e poshtme e shogët, me vriguj të sharrëzuar dhe 2 zharrdhokë pranë buzës. Kapsula ovoide, me majucë, që del pak nga kupa. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi)	Rritet në kullota të zonës subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea chrysocoma</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Jovibarba heuffelii</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>H. Alpestre</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Senecio wagneri</i> <i>Stachys alpina</i> , <i>Botrychium lunaria</i> , <i>Nigritella nigra</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Daphne cneorum</i> , <i>Myosotis alpestris</i> , <i>Achillea atrata</i> , <i>Hypericum alpinum</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999) dhe Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Alpe Foto: Xhavit Mala (2012), Luboten Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë, Bjeshkë të Lloçanit, Maja e Rusolisë), sipas Saric et al. 1986 është e përhapur në Malet e Sharrit (Oshlak, Piribreg, Luboten, Konjushë). Ky lloj është konstatuar edhe në Bjeshkë të Lumëbardhit, Koritnik dhe Pashtrik.	Popullacionet në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë, Bjeshkë të Lloçanit, Maja e Rusolisë) dhe Malet e Sharrit (Oshlak, Piribreg, Luboten, Konjushë) kanë areal të kufizuar, por numër të konsiderueshëm të individëve brenda popullacioneve. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
91	<i>Phyteuma pseudorbiculare</i> Pant Emri shqip: <i>Fiteumë e rrumbullakët e rreme</i> Familja: Campanulaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-50 cm, me kërcell të ngritur ose të përprjetëm, i shogët, rrëvaga-rrëvaga. Gjethet bazale pak a shumë gatirrotullore, me bishtak të shkurtër; kërcelloret eliptike të gjëra, të sipërmet me bishtak. Lulesa kaptinëz gjysmërruzullore, me diametër 3 cm. Braktetë vezake të gjëra, shpesh si zemër në bazë, me buzë të sharruara. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit. Sipas Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996) është e përhapur në Maqedoni.	Ky lloj në Kosovë rritet në kullota e shkëmbinj të zonës subalpine e alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit e shoqëruar nga llojet: <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Oxytropis campestris</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>Aster alpinus</i> , <i>Achillea chrysocoma</i> , <i>Helianthemum alpestre</i> , <i>Alchemilla plicatula</i> , <i>Campanula patula</i> , <i>Geum coccineum</i> , <i>Nigritella nigra</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Campanula foliosa</i> , <i>Trifolium badium</i> etj.	Sipas Millakut (1999) rritet në Alpe Shqiptare (Maja e Rusolisë, Kurvallë, Pllaçicë, Liqenak, Gjeravicë) sipas Josifovic et al. (1974) është prezentë Pllaçicë, Majë të Rusolisë. Sipas Saric et al. (1986) është prezentë në Malet e Sharrit (Luboten, Piribreg, Bistra, Liqenet e Jazhinces, Koblicë) dhe Alpe Shqiptare (Liqenak dhe Dervish Kom).	Në kuadër të Alpeve Shqiptare janë konstatuar 6 subpopullacione të vogla që kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Edhe në Malet e Sharrit janë konstatuar 5 subpopullacione me areal të kufizuar por me numër të konsiderueshëm të individëve në kuadër të popullacioneve. Në shumicën e popullacioneve takohen edhe individë të vetmuar. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

92	<i>Pimpinella serbica</i> (Vis.) Bentham et Hooker [Pancicia serbica Vis.] Emri shqip: <i>Pimpinellë e Serbisë</i> Familja: Apiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), rreth 50 cm, e shogët, me kërcell të rrumbullakët, rruga-rrvaga, të degëzuar në pjesën e sipërme. Gjethet e poshtme si zemër, të sharruara, me bishtak të gjatë; të tjerat vijuese thellësisht të vrigullta; të sipërme pëllëmbore të ndara deri në bazë në segmente të shumta kreshtake. Ombrellat me 10-15 rreze. Brakte 5-8, vizake, të ashpra. Brakteza 5. Fryti 3-4 mm, ovoid, me brinjë me flatra shumë të ngushta. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë ose rizomë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit. Sipas Vladimirov, V. et al. (2007) është e përhapur edhe në Maqedoni.	Ky lloj në Kosovë rritet në kullota dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Helianthemum nummularium</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>Anthyllis vulneraria</i> , <i>Dianthus integer</i> , <i>Cerastium decalvans</i> subsp. <i>dolineri</i> , <i>Scorsonera villosa</i> , <i>Polygala major</i> , <i>Dianthus cruentus</i> , <i>Gentiana utriculosa</i> , <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Ranunculus montanus</i> , <i>Campanula patula</i> , <i>Trifolium velenovski</i> , <i>Nigritella nigra</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit), sipas Josifovic, M. et al. (1973) në Zhleb, Mali Mokna, Koritnik dhe Malet e Sharrit (Oshlak). Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Ujërat e Humbura, Liqenet e Jazhincës, Jallovarnik). Në Malet e Sharrit është konstatuar edhe në: Balkë e Madhe, Lëndina e Staneve (1448 m), Përroi i Durlit etj.	Popullacionet në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Mali Mokna), Koritnik dhe Oshlak kanë areal të kufizuar. Edhe pse popullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar edhe në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare janë të pasura me individ maturë. Konsiderojmë se ky lloj mund të jetë i përhapur edhe në ndonjë lokalitet tjetër. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
93	<i>Plantago gentianoides</i> Sibth. et. Sm. Emri shqip: <i>Gjethedell si sanzë</i> Familja: Plantaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me një rozetë gjethesh. Gjethet 2-6 (10) x 1-3.5 cm, llapa vezake deri eliptike, gati e plotë me 3-5 (7) nervura, e shogët ose me qime të rralla, bishtaku sa 1/2 e gjatësisë së llapës. Shtijet shumë me të gjata së gjethet. Kallinjë 1-3.5 (4) cm. Braktetë rreth 2 mm, vezake-rrrotullare, të shogëta, nganjëherë me qerpikë të imët. Nënpetlat 2 mm pothuaj të lira. Gypi i kurorës rreth 2 mm, i shogët; vrigujt 1-1.5 mm, vezakë, shyte. Thekët dalin 3-5 mm jashtë kurorës, pjalmoret të verdheme. Kapsula 3 mm. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Evropë Qendrore dhe Lindore, Ballkan.	Rritet në kullota subalpine dhe alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit e shoqëruar nga llojet: <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>V. uliginosum</i> , <i>Bruckenthalia spiculifolia</i> , <i>Senecio nemorensis</i> , <i>Antennaria dioica</i> , <i>Polygonatum bistorta</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Jasione orbiculata</i> , <i>Achillea chrysocoma</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1974) është i përhapur në Alpe Shqiptaret (Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Dervish Kom). Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Luboten, Qukat e Jezercit, Liqenet e Jazhinces, Konjushë, Bistër, Karanikollë (Opojë).	Në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit popullacionet e këtij lloji janë të vogla, kanë areal të kufizuar por numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

94	<i>Polygala doerfleri</i> Hayek Emri shqip: <i>Poligalë e Dërflerit</i> Familja: Polygalaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e ngritur me kërcëp të drunjëzuar. Kërcejtë rreth 40 cm, të padegëzuar. Gjethet vizake heshtore, të mprehta, të shogëta. Vilet skajore ovoide-gjatore, të dendura në frytëzim të sheshta. Braktet pak me të gjata se këmbëzat. Lulet të trëndafilta. Flatrat 7-9 mm (11 mm në frytëzim), vezake përmbysët të gjëra me nervatura të ndërthurura. Gypi i kurorës rreth 6 mm, gati i barabartë me petlat e sipërme. Gjinofoori shumë i shkurtër. Kapsula më e shkurtër dhe më e ngushtë së flatrat. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit	Rritet në substrate serpentinore, kullota dhe vende me bar, shpesh edhe në çeltira të pyllit të zonës malore në kuadër të asociacioneve: Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea dhe Polygalo-Genistetum hassertianae e shoqëruar nga llojet: Forsythia europaea, Aster albanicus, Euphorbia glabriflora, Hypericum barbatum, Potentilla visianii, Euphorbia barbelieri, Linum tauricum, Plantago argentea, Artemisia lobelii, Salvia ringens, Quercus pubescens, Forsythia europaea, Stachys scardica, Juniperus oxycedrus, Centaurea kosaninii, Scabiosa fumaroides, Genista hassertiana, Sanguisorba albanica etj	Sipas Millaku, F. et al. (2008), Josifovic et al. (1973), Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. (2003, 2021) është e përhapur në serpentine në rajonin e Mitrovicës dhe Koznikut, Alpe Shqiptaret (Gubavc), Bokat e Morinës, Qafë Prush, Rajoni i Mirushës, Koznik, Golesh, Rajoni i Mushtishtit (Grekoc, Korishë, Manastir), Guranë, Gradicë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë në afërsi të vendeve urbane dhe janë nën ndikim të faktorit zooantropogjen. Popullacionet në rajonin e Mirushës-Koznikut dhe rajonin e Morinës-Qafë Prush janë me areal me të gjërë dhe me numër të madh të individëve maturë. Popullacionet tjera kanë areal me të kufizuar dhe janë me shumë të ndikuara nga faktorët negativ që dëmtojnë habitatin dhe zvogëlojnë sipërfaqen e banimit të këtij lloji. Për momentin shumica e popullacioneve/subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
95	<i>Potentilla apennina</i> Ten. Emri shqip: <i>Potentillë e Apenineve</i> Familja: Rosaceae	Barishtore shumëvjeçare (Kamefite CH), me kërcej lulorë deri 20 cm, me qime pushlore të bardha. Gjethet trishe; gjethëzat gjatore-vezake të përmbysta, 7-15 x 3-5 mm, gati të plota ose me 2-3 dhëmbë në majë, përsipër me qime të mëndafshita. Lulet 1-5 (7) gati pabisht. Nënpetlat vezake. Petlat 8-10 mm, më të gjata se nënpetlat, të bardha. Pjalmoret gjatore. Shtyllëza gati skajore, konike si fill, e shogët, e rënshme. Shtrati lulor shumë leshtor. Akenët zakonisht pushlor. Lulëzon VII-VIII, frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Apenine Qendrore, Ballkan.	Rritet në vende shkëmbore (të çara të shkëmbinjve) ose në vende me gur të zonës alpine dhe subalpine e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Helianthemum canum, Ptilotrychum rupestre, Edraianthus graminifolius, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Anthyllis aurea, Anthyllis vulneraria, Minuartia baldaccii subsp. doerfleri, Potentilla speciosa dhe Amphoricarpus neumayeri.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Liqenak, Bjeshkë te Lumëbardhit, Bjeshkë te Strelloit, Bjeshkë te Lybeniqit, Marjash, Rrasë të Zogut, Bogiçë, Koprivnik, Sushicë, Hajlë). Sipas Saric et al. (1986) rritet në Koprivnik. Sipas Josifovic et al. (1972) është prezentë në Bogiçë dhe Liqenak. Është e përhapur edhe në Pleçë dhe Koritnik.	Popullacionet në Alpe Shqiptare kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë por për momentin janë njëjaft stabile. Në Koritnik popullacioni është me areal të kufizuar por numri i individëve brenda këtij popullacioni është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

96	Salix reticulata L. Emri shqip: Shelq i rrjetëzuar Familja: Salicaceae	Gjysmëshkurre (Kamefite CH) 30-40 cm, me kërcell zvarritës, rrënjëzues. Degëzat me kënde, të shogëta dhe me pak gjethe. Gjethet eliptike deri vezake- rrotullare, shyte ose lehtësisht majëngrëna, në bazë si zemër ose më rrallë pykore, të plota, lëkurore, përsipër të gjelbra të errtë, gati të shogëta, me nervurë të futur, përposh të bardheme, gati të shogëta, me nervurë të dala të rrjetëzuara, me llapë 1.5-5 cm, me bishtak 5-15 mm. Ndajgjethëzat mungojnë. Gathët në krye të degëve me gjethe, me bishta deri 25 cm, dalin pas gjetheve. Gathët 2-3 cm; ato mashkull rreth 2 cm, ato femër deri 3 cm. Braktet të murrme të çelëta, vezake, të përmbystë, me qime të gjata përbrenda. Thekë 2, me qime nga mesi e poshtë; vezorja pushbutë, pa këmbëz dhe me shtyllëz të shkurtër. Lul. VI-VII; Fryt. VII- VIII. 9. Paparisto, K. et al. (1988).	Në malet e larta të Evropës, deri në zonën polare, Azi Qendrore, Amerikë Veriore.	Në Kosovë ky lloj është i përhapur kryesisht në substrate silikate, me rrallë në substrate gëlqerore, në vende shkëmbore, kullota dhe çakëllishte të zonës subalpine dhe alpine, ku shpesh formon fitocenozë me bimët tjera alpine dhe mbron tokën nga erozioni. Në Kosovë rritet e shoqëruar nga llojet: Salix herbacea, S. retusa, Juncus trifidus, Homogyne alpine, Vaccinium myrtillus, Geum montanum, Hypericum alpigenum, Achillea abrotanoides, Veratrum album, Pedicularis verticillata, Phyteuma confusum, Jasione orbiculata, Arctostaphylos uva-ursi, Alliaria petiolata, Sempervivum macedonicum, Plantago media, Centaurea nervosa etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Hajlë, sipas Saric et al. (1986) & Josifovic, M. et, al. (1972) në Koritnik, Luboten, Bister, Shtëpia e Malorëve, Piribreg dhe Livadhishtë. Me 18.08.2013 Millaku, F., dhe Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan edhe në Vracë në lartësi mbidetare 2210 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar, mirëpo janë të pasura më individë maturë që dominojnë në këto biotope dhe kanë rëndësi shumë të madhe në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	--	---	--	---	--	---	----------------------------

97	<i>Saxifraga scardica</i> Griseb. Emri shqip: <i>Iriqëz e Sharrit</i> Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H) e dendur, me kërcëj gjethorë, 4-7 cm, gati të drunjëzuar në bazë, shumë të degëzuar, si rozeta ose si shtylla, me gjethë të ngjeshura. Kërcejtë lulorë të ngritur ose të përjetëm, 3-10 cm, me gjethë të çlirëta me qime gjëndërore. Gjethet e kërcëjve të hapura të shpërveshura; në faqen e sipërme konkave; në faqen e poshtme konvekse - me karenë; në gjysmën e sipërme të plota, të shogëta; në gjysmën e poshtme me dhëmbë të imët ose me qerpikë, gjatore-pallake ose heshtore-gjatore, 4-16 x 1.5-4.5 mm, me majë të mprehtë, shpesh me hidatoda. Gjethet e kërcëjve lulorë gjatore-pallake, 4-8 x 1.3-2 mm, të mprehta me thumb. Lulesa vastakore ose vastakore-melthore, me 3-11 lule. Sepalet vezake ose vezake-gjatore, 2.3-4 x 1.5-1.9 mm, shpesh majëmprehta, me qime gjëndërore, si purpur. Petalet gjërësisht vezake të përmbysëta, 5-9 x 2.5-4.5 mm, të bardha ose trëndafil. Thëkët më të shkurtër se petalet. Vezorja e nëntëshme, me qime gjëndërore. Karpetet 4-6 mm. farat 0.8 mm, të murrme, me rrudha. VI-VIII. (Paparisto, K. et al. 1988).	Siujdhesa ballkanike (Endemik e-Ballkanik e).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinj gëlqeror të zonave alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Minuartia baldaci</i>, <i>Minuartia verna</i>, <i>Edraianthus graminifolius</i>, <i>Armeria alpina</i>, <i>Achillea chrysocoma</i>, <i>Asperula doerfleri</i>, <i>Jovibarba heuffeli</i>, <i>Saxifraga paniculata</i>, <i>Saxifraga sempervivum</i>, <i>Thlaspi bellidioides</i>, etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Krasniqi, F. (1987) është prezentë në Koprivnik, Guri i Kuq (Bjeshka e Lumëbardhit), Dervish Kom dhe Liçenak. Sipas Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1977) është prezentë edhe në Malet e Sharrit (Livadhishitë, Luboten, Brod, Balka e Madhe), Koritnik. Millaku, LC – Më pak i rrezikuar. . F. me 30.06. 2012 e konstatoi edhe në Pleçe (Alpe Shqiptare) në të çara të shkëmbinjve në ekspozicion verior në lartësi mbidetare 2467 m. Më 19.05.2013 Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N. e konstatuan edhe nën Majën e Vjellakut (Pejë) dhe mbi grykën e Shushicës nga 1710-1913 m lartësi mbidetare.	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Livadhishitë, Luboten, Koritnik) dhe në Alpet Shqiptare (Koprivnik, Liçenak, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Pleçe, Maja e Vjellakut, Gryka e Sushicës) kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është i vogël. Popullacionet e këtij lloji për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	---	--	--	--	--	---	----------------------------

98	<i>Saxifraga sempervivum</i> C. Koch [<i>Saxifraga media</i> S.S.] Emri shqip: <i>Iriqëz përherë e gjelbër</i> Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore e dendur, me kërcëj gjethorë shterpë, që mbarojnë me rozeta gjethore. Kërcejtë lulorë pak dredhakë, 5-12 (-15) cm, me gjethe të dendura, me qime të hapura gjëndërore. Gjethet e bazës në rozeta me diametër 1-2 cm, shumë a pak me karenë në anën e poshtme, të rimta, të shogëta, ose vetëm me pak qërpikë në fund, vizake ose vizake-heshiore, të mprehta ose gati majëgjata-të fëndyellta, 0.8-1.6 cm, me buzë kërcore, me shumë hidatoda anëve. Kërçelli lulor 8-14 mm, lulet purpur të hapur, 2-2.5 x 1-1.5 mm. VI-VII.	Pjesët jugore të Siudhesa Ballkanik e (Endemik e-Ballkanik e).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinj gëlqeror, silikat dhe serpentit në zonave malore shoqëruar nga llojet: Ramonda nathalie, Saxifraga scardica, Minuartia baldacii, Minuartia verna, Edraianthus graminifolius, Armeria alpina, Achillea chrysocoma, Asperula doerfleri, Jovibarba heuffelii, Globularia cardifolia etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999) është e përhapur në Gjeravicë, Rrasë te Zogut, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Majën e Strelleit, Bjeshkën e Lybeniqit, Bjeshkën e Lumëbardhit dhe në Liçenak. Sipas Saric et al. (1986) në Malet e Sharrit është prezentë në: Piribreg, Oshlak, Koxhaballkan, Koblicë, Livadhishtë, Luboten, Rusenicë. Millaku, F. dhe Gashi, B. me 11.05.2013 e konstatuan edhe në Gotovush (Shterrpë) në 1134 m lartësi mbi detare dhe në afërsi të Gilloboqicës (Elez Han) si lloj shoqërues i bimës endemike Ramonda nathalie.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë shtrirje të gjërë. Edhe pse ky lloj në kuadër të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit ka një shtrirje të gjërë, popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar por në disa lokalitete të pasura me individë maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
99	<i>Jovibarba heuffelii</i> (Schott) Á. Löve & D. Löve [<i>Sempervivum heuffelii</i> Schott.] Emri shqip: <i>Burgull i Heufelit</i> Familja: Crassulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rozetë 5-7 (-12) cm në diametër, pa stolone. Gjethet janë 25-60 mm të gjata dhe 10-15 mm të gjëra, gjatore vezake përmbysta në maje në formë gjembi të blertambyllë ose të blerta – të përhimëta, me buzë të verdha dhe të mbuluara me qime të forta-qerpikore. Kërçelli lulor është 10-20 cm i gjatë në pjesën e sipërme me qime gjëndërore. Gjethet në kërçell janë ovale në bazë formë zemre, pak e	Ballkan, Rumani (Sub-Ballkanik e).	Ky lloj rritet në vende të thata me bar ose në shkëmbinj të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Achillea chrysocoma, Armeria alpina, Helianthemum canum, Pedicularis brachyodonta, Globularia cardifolia, Festuca koritniensis, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Juniperus sibirica, Daphne cneorum, Myosotis alpestris etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liçenak, Bjeshkë të Lumbardhit dhe Koprivnik), është konstatuar edhe në Kurvallë. Në Malet e Sharrit është e përhapur në Koxhaballkan (Rusenicë, Pashallarë, Livadhet e Çehajës), Luboten.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

		mbështjellin, kërcelli me vijë dhe qime gjëndërore. Sepalet janë pjatore-lineare me gjëndra dhe qime. Petalet janë 10-12 mm të gjata, dyherë me të gjata se sepalet, të verdha-zbehta, në buzë kanë qerpik. Shtyllëza është 2 mm e gjatë. Josifovic, M., et. al. (1972).					
100	<i>Jacobaea subalpina</i> (W. D. J. Koch) Pelser & Veldkamp [Senecio subalpinus Koch.] Emri shqip: - [Pulith subalpin] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 30-70 cm, me kërcëj të ngritur, zakonisht të degëzuar vetëm në lulesë, me gjethe kudo, gati të shogëta. Gjethet gradualisht të zvogëluara në madhësi në drejtim të kërcellit; gjethet e bazës dhe ato të poshtme kërcellore 3-6 (-10) x 3-6 (-8) cm, si zemër-deri trekëndore-vezake, të shogëta përsipër, të shogëta ose me qime të rralla dhe të blerta përposh; gjethet kërcellore të mesit shpesh me 1 ose më shumë çifte vrigujsh në bishtak ose pak a shumë lirake; gjethet e sipërme kërcellore të rripëzuara ose gati pendore të prera dhe me veshëza në bazë. Kaptinëza (3-)5-20, me diametër 25-40 mm, në vastak. Pështjella 6-8 mm, me qime të merimangëta leshtore ose gati e shogët, me 5-10 brakte shtesë afërsisht sa 1/3 e gjatësisë së pështjellës. Lulet llapore 12-21, 10-15 mm, të verdha ose portokalli-të verdha. Akenët rreth 3.5 mm, të shogët. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000).	Siujdhesa Ballkanik e (me përjashtim të Maqedoni së)Alpet Lindore, Karpate (Alpikë Karpatike)	Në Kosovë është e përhapur në substrat silikat rrallë në substrat karbonat në çeltira të pyllit dredhakut (Pinus mugo), ose në vende me lagështi, buzë përrenjve, burimeve të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Campanula foliosa, Ranunculus montanus, Geum montanu, Alchemilla hybrida etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999) Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) është e përhapur në Malet e Sharrit (Kobilicë) dhe Alpe Shqiptare (Gjeravicë, Ishtedim, Liqenak, Gryka e Lloçanit, Koprivnik (Maja e Qetes), Roshkodol).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare kanë areal të kufizuar por shumica e subpopullacioneve janë stabile dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	Më pak i rrezikuar.

101	<i>Trollius europaeus</i> L. Emri shqip: <i>Trol evropian</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10—70 cm e lartë me kërcell zakonisht të padegëzuar, të shogët, me një lule (rrallë me 2-3 lule). Gjethet janë pëllëmbore, të çara në 3-5 pjesë, të poshtmet janë me bishtë, të sipërmet pabisht. Lulet janë relativisht të mëdha, rruzullore, me fletëza të kupës si petale të verdha. Lulëzon VII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 1986; Paparisto, K., et al. 1988).	Evropë, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Saric, M. et al. 1992; Polunin, O. 1997, Jordanov, D. et al. (1970).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqeror, silikat dhe serpentini. Zakonisht takohet në çeltira pyjesh, vende me lagështirë, buzë burimeve të zonave të larta në Malet e Sharrit dhe në Alpet Shqiptare. Është mjaft i përhapur në kuadër të fitocenozave të ndryshme si: Wulfen-Pinetum mug, Abieti-Fagetum, Seslerio-Pinetum heldreichii, Achilleo-Pinetum mug dhe Pinetum mugo serpentinicum. Gjendet në shoqëri me llojet: Valeriana officinalis, Geum coccineum, Pinus mugo, Pinus peuce, Juniperus sibirica, Polygala major, Onobrychis scardica, Pedicularis brachyodonta, Linum capitatum, Anthyllis vulneraria, Liliun albanicum etj.	Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut, Pleçe, Mokna, Koritnik, Malet e Sharrit (Përroi i Durlit, Brezovicë, Shtepia e Malorëve, Oshlak, Pashallarë, Livadhishtë (Josifovic, M. et al. 1970; Rexhepi, F. 1986, 1994; MMPH 2008).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura kryesisht në vende me lagështi apo me rrjedha uji. Edhe pse lloji ka shtrirje mjaft të gjërë, popullacionet nuk janë shumë të mëdha dhe janë nën ndikim të faktorit antropogjen. Popullacionet me të pasura me individ maturë në kuadër të Alpeve Shqiptare janë: në Malin Mokna dhe Pleçe. Në Malet e Sharrit janë disa subpopullacione të cilat janë të pasura me individë maturë.	Më pak i rrezikuar.
102	<i>Viola calcarata</i> L. subsp. <i>zoysii</i> (Wulfen) Murb. Emri shqip: <i>Manushaqe e Zoisit</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj shumë të shkurtër. Gjethet vezake të gjëra deri rrotullare, 1-4 cm, me buzë ura-ura, të shogëta ose lehtësisht leshtore të buzët. Bishtaku aq sa ose më i gjatë se lla e gjethes. Ndajgjethëza 0.5-1.5 cm gjatore, të plota ose dhëmbë-dhëmbë, me 1-2 rripëza të shkurtra në majë. Bishtat lulorë shumë të shkurtër; kërcëjtë njëlulësh. Lulet 2-4 cm të gjata dhe deri 3 cm të gjëra, zakonisht të verdha. Petlat shumë të gjëra, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 8-15 mm, gati i barabartë me petlat, i drejtë ose i përkulur nga sipër. Shtyllëza bërlylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezoze. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët.	Alpe (Karavane), Kosovë, Shqipëri, Malet Dinarike, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi.	Në Kosovë është konstatuar në kullota të thata, shkëmbinj dhe vende gurishte të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Plantago argentea, Iris reichenbachii, Euphorbia myrsinites, Achillea fraasi, Onosma sp. Genista radiata, Fritillaria gracilis etj,	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Majën e Rusolisë, Koprivnik, Dervish Kom dhe Gjeravicë. Sipas Millaku, F. (2005, 1999) përveç këtyre lokaliteteve të njohura është e përhapur edhe në: Majën e Qenit, Bjeshkën e Lumëbardhit dhe në Grykën e Sushicës. Millaku, F. me 19.05.2013 e konstatoi edhe në pjesën juglindore të Majës së Vjellakut në lartësi 1878	Edhe pse në Kosovë ky lloj formon disa popullacione/subpopullacione; ato kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i vogël. Edhe pse këto popullacione/subpopullacione kanë areal të kufizuar për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

		Lulëzon V-VI. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).					
103	Viola elegantula Schott. Emri shqip: Manushaqe pak elegante Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10- 30 cm, e shogët ose pak pushlore. Gjethet 1-2 (- 3) cm, të poshtmet rrotullare, të sipërmet vezake-heshtore ose heshtore. Ndajgjethëzat sa 1/2-3/4 e gjatësisë së gjethëve, vezake, të ndara pendore, me 4-10 segmente në anën e jashtme dhe 2-4 segmente në anën e brendshme. Lulet 2-2.5 cm. Petlat jo shumë të gjëra , ngjyrë manushaqe ose të verdha, rrallë të bardha ose të trëndafilta, anësoret të drejtura nga lart. Shpori 5-8 mm, i drejtë ose lehtësisht i përkulur. Hollak, tri herë më i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërrylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Gadishulli Ballkanik (Subende mike).	Në Kosovë Ky lloj është konstatuar në kullota të thata, dhe vende gurishtore të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Campanula spatulata, Veratrum album, Geranium subcaulescens, Poa violacea, Juniperus sibirica, Rumex alpines, Chenopodium bonus- henricus etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Malet e Sharrit (Koritnik, Bistër, Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Livadhishtë, Luboten) dhe në Alpet Shqiptare të Kosovës (Maja e Rusolisë, Zhleb, Liqenak, Gjeravicë, Pllaçicë, Kurvallë).	Popullacionet/subpopullac ionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar por numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve/subpopull acioneve është i konsiderueshem. Edhe pse këto popullacione kanë areal të kufizuar për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

104	<i>Viola orphanidis</i> Boiss. Emri shqip: <i>Manushaqe e Orfanidit</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) leshtake deri 50 cm me kërcëj të shumtë, të përprjetëm. Gjethet 2-4 cm, vezake ose rrotullare, nganjëherë gati si zemër, me buzë ura-ura ose të sharruara, leshtake kryesisht gjatë nervurave dhe në buzët; llapa e barabartë ose me e gjatë se bishtaku. Ndajgjethëzat 1-2 cm, vezake të pjerrëta, thellësisht të dhëmbëzuara ose të ndara gati-pendore me segmentin skajor me të madh se të tjerat. Lulet rreth 2 cm. Petlat blu, e poshtmjia me një njollë të verdhë, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 4-5 mm, hollak i përkulur, dy herë me i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërrylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Gadishulli Ballkanik (endemike Ballkanike)	Në Kosovë është konstatuar në livadhe, afër tëbanëve dhe buzë pyjeve halore, të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Cyrsium appendiculatum</i>, <i>Geranium sylvaticum</i>, <i>Veratrum album</i>, <i>Rubus idaeus</i>, <i>Potentilla hirta</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Rhododendron ferrugineum</i>, <i>Rumex alpinus</i>, <i>Geum coccineum</i> etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Liqenet e Jazhincës, Ujrat e Humbura dhe Livadhishtë). Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Bjeshkën e Deçanit, Koprivnik (Pejë), Gryka e Lloqanit, Kurvallë. Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur edhe në Majën e Rusolisë. Millaku, F., Krasniqi, E. Mala, Xh. Berisha, N. me 11.07.2013 ketë lloj e konstatuan edhe në Perroin e Durlit dhe mbi Shtëpinë e Malorëve në 2052 m lartësi mbidetare.	Ky lloj formon disa popullacione/subpopullacione në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare që kanë areal shumë të kufizuar, mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
-----	---	---	---	--	---	--	----------------------------

04- Rajoni Zhvillimor Jug

Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga katër (4) komuna: **Prizren, Mamushë, Suharekë, Dragash**. Rajoni Jug është rajoni më i pasur në Kosovë me përhapje dhe llojllojshmëri të florës. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 116 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore njëvjeçare, shumëvjeçare, shkurre, gjysmëshkurre, bimë shumëvjeçare tufore, myshqe, shumëvjeçare me rozetë bazale, bimë kacavjerrëse, bimë me kërcell zvarritës, bimë drunore, dru, etj.

Në formë tableare është paraqitur lista e aseteve të të gjitha resurseve natyrore.




Figura 5. Cynoglossum krasniqii



Figura 6. Achillea alexandri-regis Bornm



Tabela 4. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Jug

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I. Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR – JUG							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Katego-ria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Juniperus foetidissima</i> Willd. Emri shqip: Bërshen Familja: Cupressaceae	Dru deri 18 m, monoik ose dioik, me trung të drejtë dhe kurorë të ngushtë konike. Degëzat katërkëndëshe, rreth 1 mm të trasha. Gjethet mëllagore, të vendosura kryq, të moçmet vezake-romboike, me majë të lirë të thepët, rreth 1.5 mm, me erë të rëndë kur fërkohen. Boçat rruzullore, sa janë të reja me pluhurizë, kur piqen, të murrme të kuqërreme deri gati të zeza, 7-12 mm; piqen vitin e dytë dhe përmbajnë 1 ose 2 (rrallë 3) fara vezëngjashme, ngjyrë gështenjë. Frytton IX-XI. Shumohet me farë. (Paparisto, K. et al. (1988).	Kosovë (e zhdukur), Shqipëri, Maqedoni, Greqi, Bullgari, Turqi, vende afër Mesdheut, Azi e vogël-Siri, Krime, Kaukaz.	Në vende tjera të rajonit ky lloj haset zakonisht në ekzemplar të vetmuar në vende të thata, me gurë, mbi substrat karbonat. Sipas Rudsi (1934) ka qenë i përhapur afër fshatit Mushnikovë. Hulumtimet e bëra në të njëjtin lokalitet (lindje fshatit Mushnikovë) gjatë vitit 2012, tregojnë se ky lloj është zhdukur. Në konsiderojmë se ky lloj ka pasur areal me të gjërë mirëpo është zhdukur si pasojë e përfshirjes nga zjarri të habitatit ku ky lloj ka qenë prezent.	Sipas Rexhepi, F. (1997), Rudski (1934), Stevanovic V. et al. (1999), ka qenë e pranishme në Malet e Sharrit (në lindje të fshatit Mushnikovë). (Mushnikovë) Prizrenë	Konsiderojmë se në të kaluarën në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit duke përfshirë edhe lokalitetin Mushnikovë kanë ekzistuar me shumë individ të këtij lloji por që janë zhdukur si pasojë e kalljes së shkurreve nga barinjtë për të krijuar me shumë hapësirë (kullosa) për bagëtinë.	Ky lloj është i zhdukur në natyrë. Pika në hartë tregon habitatin e tij të fundit të njohur (Mushnikovë).
2	<i>Salvia officinalis</i> L. Emri shqip: Sherebelë mjekësore Familja: Lamiaceae	Gjysmëshkurre (Kamefite Ch), 20-40 (60) cm, e hirtë-pushbutë, me kërcell të drunjëzuar në bazë. Kërcelli i përpjetë, cilindrik, poshtë pak a shumë ngjyrë vjollce, me bisqe sterile që dalin nga sqetullat e gjethëve. Gjethet me bisht 10-15 mm dhe llapë heshtore, 2-3 x 1 cm, shyte, ura-ura, pushlore të bardha përposhtë, të gjelbra sipër, dendësisht pushlore kur janë të reja. Qerthujt e rremë me 5-10 lule, pak a shumë njëanësore. Kupa me gyp 5-7 mm dhe dhembë 4-6 mm. kurora manushaqe (më rrallë e trëndafiltë ose e zbardhur), me gyp 10-15 mm dhe me buzën e sipërme 7-10 mm. V-VII. (Qosja, Xh. et al. 1996).	Në pjesën mesdhetare të Evropës nga Spanja, Azi e Vogël, Siri.	Në Kosovë ekzistojnë të dhëna se është rritur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit (Duvska klisura) në substrat të thatë e shkëmbor, zakonisht gëlqerore e flishore. Gjatë periudhës 2011-2013 nuk kemi arritur ta konstatojmë në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit por kemi konstatuar afro 7 ekzemplar që mund të jenë aksidental ose të kultivuar në rrethinën e Vermicës (Prizren) dhe afro 30 ekzemplar mbi fshatin Syne (Istog). Si bimë mjekësore kultivohet në disa lokalitete (Istog, Prizren, Rahovec).	Sipas Saric et al. (1986) ka qenë e përhapur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit (Duvska Klisura).	Nuk kemi arritur të konstatojmë ndonjë popullacion të egër në Grykën e Lumëbardhit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

3	<i>Achillea alexandri-regis</i> Bornm. & Rudsky Emri shqip: Barpezmi i Aleksandrit Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite, H), 20-50 cm, me rizomë të zhvilluar dhe kërcell të drejtë të mbuluar me qime të gjata të mëndafshita deri leshatake me shumë gjethe të dhëmbëzuara e të mbuluara me qime si kur edhe kërcelli. Lulet në lulesa kaptinë të vendosura në majë të kërcellit që mund të jetë edhe i degëzuar. Bishtat e kaptinave të shkurtër dhe të mbuluar me qime leshatake. Involukrumi me qime të rralla ose i shogët. Braktet e involukrimit të jashtëm gjatore, majëngrëna ngjyrë gështenj të errët. Lulet llapore ngjyrë të verdhë, majëngrëna të gjata sa gjysma e involukrimit ose edhe me të vogla. Lulëzon VII-VIII. Polenizimi kryhet me insekte (entemofilia). Frytmon VIII-IX. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës ose në mënyrë vegjetative me rizomë. (Rexhepi, F., 1986).	Stenoendemik e e Kosovës (Maleve të Sharrit-Oshlak, Pashtrik).	Ky lloj rritet në substrat gëlqeror në vende me bar dhe kullota të zonës alpine (2050-2212 m), në kuadër të asociacionit <i>Achillea alexandri-regis</i> - <i>Onobrychis scardica</i> si dhe në vende me bar në kuadër të asociacionit <i>Achillea</i> - <i>Pinetum mugo</i> e shoqëruar ngallojet: <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Polygala major</i> , <i>Arctostaphylos uva-ursi</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Senecio wagneri</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Linum capitatum</i> , <i>Centaurea kochiana</i> , <i>Helicanthemum canum</i> , <i>Phyteuma confusum</i> , <i>Trollius europaeus</i> , <i>Gentiana lutea</i> etj.	Në Kosovë (Oshlak) ky lloj rritet në grupe ose individë (1-15 individë në 20m ²). Popullacioni i këtij lloji në Oshlak është i vogël me areal shumë të kufizuar dhe ka <1000 individë maturë. Ky popullacion shtrihet në një sipërfaqe shumë të kufizuar. Është konstatuar edhe në Pashtrik (Krasniqi, E. et al. 2020).	Sipas Rexhepi, F. (2000), Stevanovic, V. et al. (1999, 1995), Diklic et al. (1991), Rudski (1934, 1936), Bommüller & Rudski (1935), është e përhapur në Malet e Sharrit – Oshlak në shkëmbinjtë gëlqeror ("solo calcareo").	I rrezikuar në mënyrë kritike.
4	<i>Achillea clypeolata</i> Sibth. & Sm Emri shqip: Barpezmi me mburojë Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me push të butë të shkurtër. Kërcejtë deri 60 cm, të ngritur të thjeshtë. Gjethet pendore të prera, të sheshta me pikla gjëndërore të pakta; bazalet deri 15 cm, me bishtak; vrigujt vezakë, me dhëmbë si sharrë deri pendorë të çara me dhëmbë majëmprehtë; kërcelloret të gjitha pak a shumë të larguara, rreth 2 herë me të gjata se ndëmyja, të sipërmet 1-2 cm, pabisht. Vastaket me shumë kaptinëza; bishtat rreth 2 mm pushbutë. Pëstjella rreth 3 mm në diametër; braktet rreth 1.5 mm. Lulet llapore 1 mm të verdha. Lulëzon VI-VII, frytmon VIII-IX. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Greqi, Rumani, Turqi)	Rritet në vende shkëmbore, kullota të thata dhe çeltira të thata të pyllit të shkozës së zezë (<i>Carpineum orientalis</i>) e shoqëruar nga llojet: <i>Carpinus orientalis</i> , <i>Pistacia terebinthus</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Prunus tenella</i> , <i>Ziziphora capitata</i> , <i>Ranunculus illyricus</i> , <i>Ranunculus pedatus</i> , <i>Hesperis tristis</i> , <i>Tremastelma palestinum</i> , <i>Ajuga chamaecypitys</i> etj. Sias Carni, A. et al. (2009) është përhapur në pyjet termofile gjithëpërfshirë të Evropës jugore (<i>Pruno tenelle</i> - <i>Syringion</i> dhe <i>Syringo-Carpinion</i>).	Vlerësimi është bazuar në Sipërfaqen e Përhapjes (EOO), në Zonën e Zënës (AOO) dhe numrin e lokaliteteve. Sipërfaqja e Përhapjes (EOO) është <50 km ² , Zona e Zënës (AOO) është <10 km ² dhe numri i lokaliteteve është 1. Gallushë, Suharekë (Therandë).	Popullacioni i këtij lloji në Gallushë ka areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë brenda këtij popullacioni është i konsiderueshëm. Habitat i këtij lloji në Gallushë është i degraduar dhe në disa vende i mbuluar nga mbeturinat e qytetit të Therandës dhe fshatrave të afërme. Konsiderojmë se popullacioni i këtij lloji ka tendencë të zvogëlimit të arealit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

5	Adonis microcarpa DC Emri shqip: Adonisi frytvogël Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore njëvjeçare (Terofite T), e gjatë 10-40 cm. Gjethet të ndara 3 herë pendore me gjethëza të ngushta lineare pak të mprehta. Lulet 1.5-2.5 cm në diametër. Sepalet të shogëta, vezake, të kreshpëta. Petale 5-8, të zgjatura, pa majë me ngjyrë të kuqe të mbylltë. Karpelet të zgjatura piramidale. Fryti i gjatë 3-4 mm, me sqep horizontal, dhëmbët me sqep të topitur. Lulëzon V-VI, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë	Evropë Jugore, Azi e vogël.	Është konstatuar rrëzë Pashtrikut në substrat gëlqeror, në çeltira të pyllit ose lëndina të vogla në kuadër të asoc. Quercetum trojanae dukagjini, e shoqëruar nga llojet: Quercus trojana, Quercus pubescens, Pyrus eleagrifolia, Rosa canina, Crataegus pentagyna, Teucrium chamaedrys, Sanguisorba minor, Teucrium polium, Helleborus odoratus, Convolvulus althaeoides, Eryngium palmatum, Acanthus balcanicus, Stachys scardica, Hypericum rumelicum, Scabiosa fumaroides, Ruta graveolens etj	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur rrëzë Pashtrikut (mbi fshatin Plane dhe Gorozhup) në lartësi 730-840 m. Prizrenë.	Popullacioni rrëzë Pashtrikut (mbi fshatin Plane dhe mbi fshatin Gorozhup) ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve është i vogël. Ky lloj është në ndikimin e vazhdueshëm të faktorit zoantropogjen.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
6	Arabis bryoides Boiss. Emri shqip: Arabëz myshknqjashëm Familja: Brassicaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore, pushbutë. Kërçelli 2-6 cm, pa gjethe. Gjethet e bazës vezake-pallake, të ngushtuara në fund, majëgjata, zakonisht me qime të dendura me qerpikë në majë. Numri i luleve 3-6. Petlat të bardha, 6-7 mm. Silikët 10-20 x 1,5 mm. Këmbëzat të hapura, 3-4 mm; shtyllëza 1mm. Lulëzon V-VI, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al. (1988).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, Peloponez).	Rritet në substrat gëlqeror, në kuadër të vegetacionit të shkëmbinjeve të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Potentilla speciosa, P. apennina, Scutellaria alpina, Ptilotrichum rupestre, Edraianthus graminifolius, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum etj.	Sipas Krivosej, Z. et al. (1998) është e përhapur në Oshlak, përtej rrugës Virova në shkëmbinj të zonës alpine (2000 m) në ekspozicion veriperëndimor. Sipas Horvat (1937) gjendet edhe në Koritnik ? në të çara të shkëmbinjve e shoqëruar nga lloji Potentilla speciosa. Oshlak (Virovi) Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Oshlak ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
7	Berberis vulgaris L. Emri shqip: Mëlqinjë e rëndomtë Familja: Berberidaceae	Shkurre 1.3-3 m, e shogët. Gjethet dy llojesh; ato të filizave të gjatë të shndërruara në gjemba, zakonisht të çarë tresh; gjethet e tjera të thjeshta, 25-55 mm, rënëse, eliptike-vezake të përmbysët, të sharruara me gjembshta. Lulet në vile të kërrusura, 30-50 mm me (12) 15-30 lule. Gjethet mjaltore zakonisht 6, 5-6 mm, paksa me të gjata se segmentet e brendshme të rrethlules. Thëk 6. Fryti rrushk, 10x5 mm, gjator, ngjyrë portokalli-të kuqe dhe i ndritshëm. Fara 1-3. Lulëzon V-VI, Frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropë, Azi Mediteran, Maqedoni (Matevski, V. et al. 2008). Sipas Carni, A. et al. (2009) është e përhapur në pyet termofile të Evropës jugore (Quercion confertae, Syringo-Carpinion orientalis, Carpinion orientalis & Fraxino orniostryion carpinifoliae).	Në Kosovë (Pashtrik), rritet në substrat gëlqeror në ekspozicion lindor (1622 m). Është konstatuar në kuadër të shkurreve dhe kullotave të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Achillea canescens, A. chrysocoma, Isatis tinctoria, Lilium albanicum, Potentilla visianii, Sorbus aria, Cerastium decalvans etj.	Pashtrik (Rexhepi, F. 1997). Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Zakonisht takohen individë në grup e shumë rrallë të vetmuar. Individë të rrallë gjenden edhe në Malin Çyçavicë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

8	<i>Centranthus longiflorus</i> subsp. <i>junceus</i> (Boiss. et Heldr.) I. B. K. Richardson. Emri shqip: <i>Centrantë lulegjatë</i> Familja: <i>Valerianaceae</i>	Shumëvjeçare (Kamefite - Ch.) me kërcëj 40-200 cm, të drejtë ose të përjetëm, të degëzuar përsipër. Gjethet 40-100 (120) x 2-35 mm, vizake deri vezake; të plotë. Kurora trëndafilë ose vjollcë; gypi i kurorës 12-18 mm; shpori (8-) 10-14 mm. Lulëzon V. Frytton VII (Tutin, T. G. et al. 1976, Qosja, Xh., et al. 1996)	Greqi, Maqedoni, Shqipëri, Kosovë, (endemike e Ballkanit) (Polunin, O. 1997; Tutin, T. G. et al. 1976).	Në Kosovë rritet në Malet e Sharrit, në vende shkëmbore të zonës subalpine (shëmtira të shkëmbinje karbonat). Në lokalitetin Oshlak-Maja e Rrobullit, rritet në shëmtirë të shkëmbinje, në tufa të vetmuara, në zonën e pyllit të rrobullit (SeslerioPinetum heldreichii), në ekspozicion juglindor. Në zonën a afërme shoqërohet nga llojet: <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Salix caprea</i> , <i>Corylus avellana</i> , <i>Ostrya carpinifolia</i> , <i>Pteridium aquilinum</i> , <i>Chamaenerion angustifolium</i> etj.	Malet e Sharrit – Oshlak (Stevanovic, V. et al. 1999). Më 29.07.2013 E. Krasniqi & Naim Berisha e konstatuan një Popullacioni të vogël në Oshlak - Maja e Rrobullit në lartësi mbidetare 1654 m. Prizren.	Popullacioni ka përhapje tepër të kufizuar. Janë konstatuar vetëm 5 tufa (buca) me nga 22-50 individë. Popullacioni gjendet vetëm në shëmtirë të shkëmbinje në zonën e ngushtë në shoqëri vetëm me <i>Chamaenerion angustifolium</i> , hapësirë kjo mjaft e papërshtatshme për zhvillimin e llojeve bimore.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
9	<i>Cerastium neoscardicum</i> Niketic Emri shqip: <i>Cerasti i Maleve të Sharrit</i> Familja: <i>Caryophyllaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare, 12-30 cm, (Kamefite Ch), me kërcell të zhvilluar i pasur me qime të gjata të buta; pak a shumë të drunjëzuar në pjesën e poshtme nga e cila zhvillohen bisqe sterile. Gjethet e kërcellit 0.7- 3(4cm) cm eliptike të zgjatura ose heshtore, rrallë të poshtmet lineare heshtore me maje, të gjelbra me qime të buta ose edhe me qime gjëndërore. Lulesa dikaze e përbërë nga 3-10 (15) lule. Bishtat e luleve me qime të dredhura shpesh tufore. Sepalet vezake-zgjatura (7-9 mm), të mprehta me qime të dendura të kthyer lart shpesh me qime gjëndërore. Petalet e bardha dy herë me të gjata së sepalet në majë të vrigulluara. Lulëzon VI-VIII, polenizimi kryhet me insekte (entomofilia) ose vetpolenizimi (autogamia). Frytton VIII-IX. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës ose shpendëve (ornithothoria).	Stenoendemik e e Kosovës e Maleve të Sharrit - Ostrovicë (Maja e Pashallarëve).	Rritet në substrat serpentiner, vende me bar, pyll ose kullota të zonës subalpine dhe alpine nga 1450-2092 m. Është konstatuar edhe në kuadër të pyllit të kërkës (Pinusmugo). Rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Pinus mugo</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Gentiana lutea</i> , <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Linum capitatum</i> , <i>Hypochoeris maculata</i> , <i>Borrmuelleria dieckii</i> , <i>Gentiana asclepiadea</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Filipendula ulmaria</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>V. lobelianum</i> , <i>Geum rivale</i> , <i>Valeriana tripteris</i> , etj.	Sipas Niketic (1994) ky lloj është i përhapur në shkëmbin serpentiner në Ostrovicë (Maja e Pashallarëve), Prizren	Popullacioni në Pashallarë (Ostrovicë) ka areal shumë të kufizuar (<10 km ²). Ky lloj zakonisht rritet në tufë e rrallë i vetmuar. Ky popullacion është i përbërë nga një numër relativisht i mirë i individëve maturë (mbi 4000 individë). Numri i individëve gjatë 10 vjetëve të fundit është zvogëluar si pasojë e zjarrit sidomos në pjesën verilindore të Pashallarëve ku është i përhapur ky lloj.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

10	<i>Coronilla vaginalis</i> Lam. (C. minima Jacq.) Emri shqip: <i>Milëz me mill</i> Familja: Fabaceae	Gjysmëshkurre 5-25 cm, e rimitë, e shogët (Kamefite Ch). Gjethet tekpendore, me 7-11 gjethëza 4-10 mm të gjata, vezake-eliptike ose vezake të përmbyseta deri gati rrotullare me buzë cipëthata; ndajgjethëzat 3-8 (-10) mm, të bashkuara, rënese. Kokat me 4-6 (-10) lule dhe bisht lulor 2-3 herë më të gjatë se gjethja mbajtëse; këmbëzat 2-3 mm. Kupa me gyp 2 mm dhe dhëmbë të shkurtër, shytë. Kurora 8-9 mm, e verdhë. Bishtaja 2-4 cm, me 4-8 segmente, me 6 kënde shytë, 4 nga të cilat me flatra. Lulëzon IV. Frynnon VII (Qosja, Xh. et al. 1992).	Rajonet malore të Evropës Qendrore, Itali, ish-Jugosllavi dhe Shqipëri (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1972; Polunin, O. 1997.	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqeror, në çeltira pylli dhe kullota subalpinealpine në Koritnik dhe Pashtrik. Gjendet në shoqëri të llojeve: Juniperus sibirica, Daphne cneorum, Ranunculus thora, Cerastium dinaricum, Dianthus integer, Dryas octapetala, Minuartia verna, Potentilla arenaria, Helianthemum canum, Phleum alpestre, Poa alpina, Ranunculus oreophyllus, Pulsatilla narcissiflora, Edrianthus graminifolius, Centaurea triumfeti, Lilium albanicum etj.	Koritnik (Hundozi, B. dhe Krasniqi, F. 1995). Gjendja e popullacionit të llojit është vlerësuar në Koritnik (02.07.2011) dhe në Pashtrik, Prizren më (18.07.2013) (F. Millaku, F.	Popullacionet e këtij lloji në Koritnik dhe Pashtrik shtrihen në ekspozicion verior, në zonën subalpine-alpine dhe kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit, në veçanti popullacioni i këtij lloji në në Pashtrik.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
11	<i>Crepis macedonica</i> Kitan. Emri shqip: <i>Shmangë macedonase</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 7-11 cm, zakonisht të degëzuar. Gjethet të përhimëta-pushbuta; gjethet e bazës 4x11 x 0.8-2cm, të shumta heshiore të përmbysta, me prerje të thella jo të rregullta të kthyer në drejtim të bazës, pendore të çara deri lirake pendore, me vriguj fundor të mëdhenj dhe vriguj anësorë shumë të reduktuar, majëmprehtë; gjethet kërcellore zakonisht 2, të poshtmet të ngjashme me ato të bazës, të sipërmet braktengjashme. Kaptinëzat të pakta. Pështjella 10-20 x 5-8 mm; braktetë vizake-heshiore, të thepëta, të përhimtapushbita, të jashtmet 3/4 deri 5/6 e gjatësisë së të brendshmeve. Akenët 5.5 x 0.7 mm, të verdhemë, cilindrikë, por lehtësisht të ngushtuar në majë dhe në bazë, me 15 brinjë. Lulëzon VII-VIII. Frynnon VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000).	Shqipëri, Kosovë, Maqedoni (Kitanov, B., 1950) .	Në Kosovë ky lloj rritet në vende shkëmbore (bimë hazmofite), në të çara të shkëmbinjve të zonës subalpine në kuadër të rendit Potentilletalia speciosae e shoqëruar nga llojet: Malcolmia maritima, Campanula versicolor, Achillea ageratifolia, Saxifraga sempervivum, Saxifraga scardica etj.	Sipas Stevanovic, V. et al. (1999), është e përhapur në Malet e Sharrit (Brod-Guri i Qytetit), Dragash.	Deri me tani është konstatuar një popullacion i vetëm i këtij lloji në Brod (Guri i Qytetit). Popullacioni i këtij lloji në këtë lokalitet ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë (< 50).	I rrezikuar në mënyrë kritike.

12	<i>Cyanus triumfettii</i> subsp. <i>axillaris</i> (Čelak.) Štěpánek [Cyanus <i>lingulatus</i> (Lag.) Holub, <i>Centaurea lingulata</i> Lag.] Emri shqip: - [Kokoqel si gjuhëz] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me rizomë të gjatë të nyjësuar horizontale. Kërcejtë deri 30 (35) cm, të ngritur, të thjeshtë. Gjethet gjatore pushbutë ose heshitore, të bardha leshlore të dendura – anjherë me të gjëra se 1cm dhe ato të fundit kërcellore gati e mbërrijnë mbajtësin e lulesës. Pështjella me diametër 1030mm, si vezë ose cilindrike, shtojcat zbrithëse, kafe, kindet 1-4 herë më të gjata se gjërësia e buzës, kafe të zbehtë, të bardha ose të argjendta në majë. Lulet e brendshme manushaqe; gjithashtu edhe të jashtmet manushaqe. Akenët 3-5mm, xhufka 0.5-3 mm, rrallë mungon. Lulëzon VI-VII. Frynnon VIII.	Spanjë dhe Gjibraltar.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrat serpentitor në kuadër të kullotave të thata të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: <i>Tephrosia longifolia</i> (Senecio ovirensis), <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>Pinus mugo</i> , <i>Vaccinium uliginosum</i> , <i>Ranunculus montana</i> , <i>Dianthus integer</i> , <i>Dianthus superbus</i> , <i>Silene roemerii</i> etj.	Malet e Sharrit (Qafa e Sevcit - Pashallarë), Prizren. Është lloj i ri i florës së Kosovës, Ballkanit dhe Evropës Juglindore.	Popullacioni e këtij lloji në Malet e Sharrit (Qafa e Sevcit-Maja e Pashallarëve) ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtij Popullacioni është <50.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
13	<i>Dianthus barbatus</i> L. Emri shqip: Karafil <i>lulebukur</i> Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 60 cm, gati e shogët, rrallë me qime vetëm poshtë, me kërcej të përpjetëm, të trumbullakët. Gjethet heshitore ose vezake-heshitore 10-20 mm të gjëra , me dhëmbëza të ashpra, pabishta, të poshtmet shytja; të sipërmet të mprehta ose të thepëta. Këllëfi i gjethes zakonisht sa i gjatë i gjërë. Lulet të shumta, në lulesë si kokë, me këmbëza të shkurtra. Braktet barishtore, të hapura ose të përveshura, të gjata sa lulet. Kupa e shogët, zakonisht e gjelbërt. Llapa e petaleve purpur, rrallë deri në të bardhë, dhëmbë-dhëmbë, me qime të shkurtra, rrallë e shogët. Lulëzon V-VII, frynnon VII-VIII. (Paparisto, K. et. al 1988).	Evropë, Azi.	Në Kosovë (Oshlak) ky lloj rritet në substrat karbonat në vende me bar të zonës subalpine (<i>Achillea</i> Pinetum mugi) e shoqëruar nga llojet; <i>Centaurea kochiana</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Leucanthemum vulgare</i> , <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Trifolium alpestre</i> , <i>Linum capitatum</i> , <i>Hypericum perforatum</i> , <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>Knautia dinarica</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Astrantia major</i> etj.	Malet e Sharrit (Oshlak), Prizren.	Në Kosovë është takuar vetëm një popullacion natyror i këtij lloji (Millaku, F. & Mala, Xh. me 11.08.2011) në Oshlak në ekspozicion verior, në lartësi mbidetare 1883 m. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë (< 90).	I rrezikuar në mënyrë kritike.
14	<i>Ficus carica</i> L. Emri shqip: Fik Familja: Moraceae	Bimë drunore (Fanerofita P), 7-8 m (i kultivuar) dhe deri 5 m (i egër). Lëvorja e kërcellit e hollë dhe e lëmuar. Gjethet janë të rënshme dimrit me nervura të gishtëzuara me 3-5 vriguj, rrallë të pavrigëlluara. Gjethet në bazë vezake ose në trajtë zemre të zgjeruar, 8-10 cm të gjata, 6-18 cm të gjëra. Lulet janë një ose dyseksore, brenda në shtratin lulorë në formë dardhe. Frytet janë të lëngshme, me shark e fara të ëmbla. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-IX. Frynnon VI-X. (Mitushii, 1966).	Vendet përreth Mesdheut.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror të zonës kodrinore e shoqëruar nga llojet : <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>Agrimonia eupatoria</i> , <i>Calamintha alpina</i> , <i>Anthericum lilago</i> , <i>Convolvulus cantabrica</i> , <i>Corydalis ochroleuca</i> , <i>Odontites lutea</i> , <i>Muscari tenuiflorum</i> , <i>Amelanchier ovalis</i> , <i>Teucrium polium</i> , <i>Convolvulus althaeoides</i> etj.	Sipas Rexhepi (1999, 2003), Krasniqi, E., et al. (2011), ky lloj rritet në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit si lloj i cili rritet i lirë në natyrë.	Ky lloj në Kosovë ka një areal shumë të ngushtë dhe si natyror është konstatuar vetëm në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Ky lloj rritet në grupe të individëve që tregojnë se dikur ka qenë më i përhapur. Popullacioni i këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit është shumë i vogël dhe	Ky lloj është vlerësuar në kategorinë “Më pak i rrezikuar.”

						pa mundësi të ripërtëritjes dhe përhapjes së mëturjes si pasojë e ndikimit të faktorit antropogjen dhe biotopit që është shkëmbor.	
15	<i>Fritillaria graeca</i> Boiss et Sprun. Emri shqip: <i>Fritilare greke</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore (Gjeofite G) me 5-12 gjethe, nganjëherë të rimta, të poshtmet janë të kundrejta ose gati të kundrejta, të sipërmet në qerthuj trish. Lule janë 1-2 (-3) me vile të ngjeshur. Rrethlulja është kambanore e prerë, me petale 28-38 mm, e çarë trish. Kapsula është pa flatra. Riprodhohet me farë dhe me bulb. Lulëzon IV-VI. Frynnon V-VII.	Ballkan (Bimë endemike).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në shkurre, çeltira pyjesh dhe kullota të thata të zonës malore dhe subalpine e shoqëruar nga llojet: <i>Asphodelus albus</i> , <i>Sorbus aria</i> , <i>Ostrya carpinifolia</i> , <i>Primula veris</i> , <i>Peucedanum austriacum</i> , <i>Rosa sp.</i> , <i>Thalictrum elatum</i> , <i>Plantago argentea</i> , <i>Laserpitium siler</i> , <i>Paeonia officinalis</i> etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) ky lloj është i përhapur në Pashtrik, Prizren.	Deri me tani është konstatuar vetëm një popullacion i vogël i këtij lloji në Pashtrik. Ky popullacion shtrihet kryesisht në zonën malore dhe subalpine ka areal shumë të kufizuar. Numri i individëve maturë brenda Popullacionit është i vogël.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
16	<i>Fritillaria macedonica</i> Bornm. Emri shqip: <i>Fritilare e Maqedonisë</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërcell të lartë 7-15 cm. Gjethe 5-6, më të poshtmet 4-6 (-8) x 0.5-1 (1.6) cm, gjatore deri heshtore, majëshyte, gati të përkundrejt; të sipërmet tre në një sqetull. Rrethlulja kambanore e gjërë, ngjyrë lila, me njolla purpurë si tabela e shahut; gjethëzat e jashtme të perigonit 30-14 mm të gjëra , të dhëmbëzuara në buzët. Fillet 10 mm, të lëmuar. Shtyllëza 12 mm, e çarë trish. Kapsula jo e flatëruar. Riprodhohet me farë dhe me bulb. Lulëzon V-VI. Frynnon VI-VII. (Vangjeli, J. et al., 2000)	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni.	Në Kosovë rritet në substrat silikat, në vende me barë të zonës alpine (2172 m), në ekspozicion verilindor. Zakonisht takohen individë të vetmuar ose në grupe të vogla e shoqëruar nga llojet: <i>Geum montanum</i> , <i>Stachys alopecurus</i> , <i>Plantago atrata</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Ranunculus montanus</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Verbascum heterophyllum</i> , <i>Veronica orsiniana</i> etj.	Sipas Stevanovic, V. et al. (1999), është e përhapur në Malet e Sharrit (Bister ? dhe Liqenet e Jazhincës), Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në lokalitetin Liqenet e Jazhincës ka areal shumë të kufizuar dhe Foto: Fadil Millaku (2013), Liqenet e Jazhincës numër shumë të vogël të individëve maturë (< 80). Në lartësi mbidetare 2172 m, janë konstatuar 15 individë, dhe në afërsi të liqenit janë konstatuar numër i vogël i individëve të vetmuar.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
17	<i>Haplophyllum coronatum</i> Griseb. [<i>Ruta coronata</i> (Griseb.) Nyman] Emri shqip: <i>Haplofil i kurorëzuar</i> Familja: Rutaceae	Bimë gjysmë shkurre (Kamefite Ch). Kërcëjtë me gjatësi 12-35 cm, me push të imët të përdredhur, të bardhë leshtorë në pjesën e lulesës. Gjethet të ndryshme; gjethet e mesit të kërcëje ose gjethëzat qendrore 8-25 x 1-4 mm. Lulesa e dendur, sepalet vizake-heshtore. Kapsula pushlore në faqen e brendshme pranë Majës Zhardhok ngjashme-gjendërore, me 8 brirë	Kosovë, Shqipëri.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në vende të thata me bar dhe shkëmbore të zonës kodrinoro-malore e shoqëruar nga llojet: <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Dorycnium pentaphyllum</i> , <i>Campanula lingulata</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Salvia ringens</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Thalictrum minus</i> , <i>Pistacia terebinthus</i> etj.	Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit (Mala, Xh. 20.05.2012).	Popullacioni i këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

18	<i>Juniperus sabina</i> L. Emri shqip: <i>Jermësinë,</i> <i>Sominë</i> Familja: Cupressaceae	Gjysmëshkurre ose shkurre deri 3m, dioike. Degëzat me gjethe me katër qoshëza të dalluara mirë, 06-08 mm të trasha. Gjethet të gjitha mëllagore, të vendosura kryq; ato të arrirat 1-1.25 mm, shyta ose gati majëmprehta, me nga një gjëndër eliptike në shpinë, me buzë jocopë e thatë me erë shumë të rëndë kur fërkohen ose shtypen. Boçëzat 4-6 mm, në trajtë ruazash, zakonisht të shtypura, ngjyrë blurreme të zezë, me pluhurizë, me bisht të shkurtër të lakuar; piqen në vjeshtë të vitit të parë ose pranverë të vitit të dytë. Fara 2, rrallë 1 ose 3-4. Lulëzon IV-V. Frytmon X. Riprodhohet me farë. (Paparisto, K. et al. 1988).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Azi e Vogël.	Ky lloj në Kosovë (Malet e Sharrit - Brod) rritet në substrat silikat në vende me shkurre të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Scabiosa fumaroides, Rhannus fallax, Hieracium waldsteini, Teucrium montanum, Teucrium chamaedrys, Stachys anisochila, Stachys alpina, Asyneuma limonifolium, Daphne oleoides, Juniperus sibirica etj.	Malet e Sharrit (Brod), Dragash, Krasniqi E. dhe Mala, Xh. (11.08.2013). Është lloj i ri për florën e Kosovës.	Në Kosovë (Brod) ky lloj formon vetëm një popullacion të vogël të përbërë nga < 10 individë maturë që rriten afër njëri tjetrit në formë të shkurrave.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
19	<i>Klasea radiata</i> (Waldst. & Kit.) A. Löve [<i>Serratula radiata</i> (Waldst. et Kit.) Bieb.] Emri shqip: - [<i>Serratulë rrezore</i>] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare deri 60 cm e lartë (Hemikriptofite), me kërcell hollak, të ashpër dhe pa gjethe në pjesën e sipërme ose përafërsisht kështu. Gjethet pendore të çara thellë, në trajtë shkallësh, me vriguj të plotë ose me dhëmbë të rrallë me vendosje jo të rregullt, të ashpra vetëm në buzë dhe në deje, rrallherë pothuajse të lëmuara; vrigujt skajorë paksa më të mëdha se ato anësorët. Kaptinëza (20-)25-30 x 10-20 mm, kambanore e vetmuar ose 2-4 në vile gati vastakore. Braktetë e jashtme të pështjellës mbliidhen në mënyrë të menjëhershme në një gjemb të shkurtër, braktetë e brendshme me majë gjembore, paksa bërrylakë, rrallë pothuaj me gremça. Lulet të purpurta. VII-VIII. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Siudhesa Ballkanike, Rumani, Kaukaz, Siberi Perëndimore.	Në Pashtrik rritet në substrat gëlqeror, në vende shkëmbore dhe kullosa të zonës malore (1423 m) e shoqëruar nga llojet: Centaurea kosaninii, Scabiosa fumaroides, Plantago argentea, Koeleria gracilis, Ostrya carpinifolia, Amelanchier ovalis, Trifolium alpestre, Asphodelus albus, Jurinea mollis, Veratrum nigrum, Veronica jacquinii, Teucrium montanum, Eryngium palmatum, Laserpitium siler, Dianthus cruentus etj.	Pashtrik, Prizren, Kaznik (Krasniqi, E. 2021).	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik shtrihet në afërsi të zonës kufitare me Shqipërinë (mbi fshatin Gorozhup). Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit. Më se shpeshti takohen nga 1 ose 2 individë maturë në vende me bar ose çeltira pyjesh.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
20	<i>Malcolmia illyrica</i> Hayek, [<i>Malcolmia orsiniana</i> (Ten.) Ten. subsp. <i>illyrica</i> Hayek,] Emri shqip: <i>Malkolmë ilirike</i> Familja: Brassicaceae	Bimë njëvjeçare (Terofite T), me qime si mëqik ose rezake 3-4 herë të çara. Kërçelli i degëzuar në bazë, me qime me 2-4 reze. Gjethet gjatore të përmbysta ose vezake të përmbysta, pykore. Lulet trëndafil ose purpur; të poshtmet me brakte. Sepalet me qime si mëqik, 5-10 mm; të brendshmet me gungë të fortë në fund. Petalet 10-16 x 2-5 mm, majëngrëna. Silika 35-60 x 1-2 mm; kreza rreth 2 mm. Lulëzon VI-VII, frytmon	Endemike e Ballkanit.	Në Grykën e Sushicës është konstatuar në të çara të shkëmbinje gëlqeror të zonës malore e shoqëruar nga llojet: Hieracium bifidum, Crepis sp., Geranium robertianum, Calamintha acinos, Campanula sp., Geranium robertianum etj.	Mala, Xh. me 28.06.2012 këtë lloj e konstaton në Malet e Sharrit (mbi burimin e Lumëbardhit të Prizrenit) në lartësi mbidetare 2100 m. Millaku, F. me 09.06. 2012 këtë lloj e konstatoi në Grykën e Sushicës në shkëmbin gëlqeror në ekspozicion verior në lartësi mbi detare 980 m.	Mala, Xh. me 28.06.2012 këtë lloj e konstaton në Malet e Sharrit (mbi burimin e Lumëbardhit të Prizrenit) në lartësi mbidetare 2100 m. Millaku, F. me 09.06. 2012 këtë lloj e konstatoi në Grykën e Sushicës në shkëmbin gëlqeror në ekspozicion verior	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		VII/VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al.(1988).			në lartësi mbi detare 980 m.		
21	Malcolmia orsiniana Ten. subsp. angulifolia (Boiss. & Orph.) Stork Emri shqip: Malkolmë orsiniane Familja: Brassicaceae	Bimë njëvjeçare (Terofite T), me qime si mëqik ose rrezake 3-4 herë të çara. Kërcelli i degëzuar në bazë. Gjethet me bishtak; ato të bazës si zemër, thahen dhe zhduken shpejt; të tjerat me dhëmbë deri të rripëzuara, gati rrotullore deri vezake. Lulet trëndafil; të poshtmet me brakte vezake dhëmbë-dhëmbë. Sepalet (4) 6-10 mm, me shumicën e qimeve 3-4 herë të çara. Petalet (7) 11-25 mm. Silikët 40-50 mm, të përkulur si hark, me këmbëza 5-10 mm. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al.(1988).	Endemike e Ballkanit.	Ky lloj në Pashtrik është konstatuar në të çara të shkëmbinjeve gëlqeror të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Scabiosa graminifolia, Rhamnus pumila, Achillea holosericea, Dianthus sylvestris, Sedum rubens, Trifolium wettsteinii, Jovibarba heufeli, Anthyllis aurea, Globularia cardifolia, Arctostaphylos uva ursi etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur në Pashtrik, Prizrenit.	Është konstatuar vetëm një popullacion me areal shumë të kufizuar në shkëmbinjtë gëlqeror të zonës subalpine në Pashtrik. Numri i individëve maturë brenda këtij Popullacioni është <90.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
22	Micromeria cristata (Hampe) Griseb. Emri shqip: Bishtmiu kreshtak Familja: Lamiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-20 cm, me kërcëj të shumtë të ngritur, hollakë, të thjeshtë dendësisht pushlor me qime të shkurtra e të hapura. Gjethet 5-7 (12) x 0.5-1.5 (3) mm; të poshtmet gjatore ose eliptike; të tjerat vizake pushpak ose pushlore me qime të rratura të vendosura njëra mbi tjetrën gati në gjithë kërcëllin, me buzë të spërveshura. Qerthuj te rremë me (2) 6 (10) lule me bishta dhe këmbëza pak sa me të shkurtra se gjethet mbajtëse. Kupa 3-4 mm pushlore, leshore në grykë; dhëmbët sa ¼-1/2 e gypit, heshitore deri vezake heshitore, paksa të pabarabartë. Kurora 4-6 mm si purpur. Akenët të thepet. Lulëzon V-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë.	Endemike e Ballkanit (Turqi).	Rritet në substrat shkëmbor gëlqeror. Në Grykën e Rusenicës ky lloj rritet në kuadër të asociacionit Daphne Juniperetum oxycedri e shoqëruar nga llojet: Daphnae oleoides, Lamium garganicum, Scrophularia bosniaca, Potentilla sulphurea, Sorbus aria, Sedum dasyphyllum, Reseda luteola, Corydalis ochroleuca, Geranium lucidum, Sempervivum hirtum, Silene saxifraga, Campanula versicolor, Cerastium decalvans etj.	Sipas Saric, M. et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit -Koxha Ballkan. Mala, CR - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I rrezikuar në mënyrë kritike. Xh. & Millaku, F., me 06.07.2011 e konstatuan në Grykën e Rusenicës në shkëmbinjtë gëlqeror në lartësi mbidetare 1003 m. Prizren.	Popullacioni në Grykën e Rusenicës shtrihet në shkëmbinjtë gëlqeror, ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
23	Onosma visianii G. C. Clementi Emri shqip: Çikllë e Vizianit Familja: Boraginaceae	Bimë barishtore dy ose shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-50 cm, me rrënjë të zgjatur e të shëndoshë. Me rozetë gjethesh dhe një shtije qendrore të ngritur shumë e degëzuar në bazë. Kërcëjtë dhe gjethet me kreshta të zgjatuara të vendosura mbi zhardhokë të shogët; midis këtyre shpërndahen qime të holla të shkurtra. Gjethet e poshtme 10-20 cm, vezake ose vizake heshitore. Lulesa shumë e degëzuar; këmbëzat 1-5 mm; braktetë e poshtme gati sa kupa.	Evropë.	Në Pashtrik është konstatuar në substrat gëlqeror në 1330 m lartësi mbi detare, në kullota të thata dhe vende me gurë të zonës malore. Është konstatuar e shoqëruar nga llojet: Jurinea mollis, Centaurea atropurpurea, Iris sp., Centaurea kosaninii, Anthyllis aurea, Ranunculus illyricus dhe Stipa sp. etj.	Më datë 29.05.2013 Millaku, F. e konstatoi në Pashtrik në kullota të thata në lartësi mbi detare 1330 m. Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal të kufizuar dhe në Pashtrikun e Poshtëm afër Qafës së Mullarit janë konstatuar më pak se 80 individë maturë që zakonisht rriten të vetmuar dhe në distancë nga njëri tjetri.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

		Kupa 13-17 mm në lulëzim dhe 18-22 mm në frytëzim, me 2-3 nënpetla të ngjitura deri në mes ose deri gati në majë; të tjerat leshtake me qime të shkurtra. Merikarpet 4-5 mm. Lulëzon V-VI, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).					
24	Saussurea alpina (L.) DC. [Serratula alpina L.] Emri shqip: Sausurea alpine Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rizomë të fuqishme, horizontale, të errët. Kërçelli 2-50 cm, i pajisur me gjethe të dendura ose të rralla. Gjethet heshtore ose heshtore-vezake, 3-6 herë më të gjata se të gjëra , sipër të gjelbra, të shogëta, përposhtë me qime të bardha si rrjetë e merimangës, buzëplote ose me dhëmbë të imtë të rrallë; ato të sipërmet pabishtak, të poshtmet me bisht me flatra të ngushta. Kaptina cilindrike-vezake, 1.5-2 cm të gjata, në formë vastakore ose fshese. Braktet e mbështjellës me qime leshtake të mbështetura, më rrallë të shogëta, shytë ose me majë të patheksuar. Kurora e kuqe, e vjollcë ose e kaltër-trëndafilore. Xhufka 10-12 mm, me 2 rende qimesh; i jashtmi të gjata, i brendshmi të shkurtra, rënëse. Lulëzon VII-VIII, frytton VIII-IX.	Bimë arkto-alpine evropiane, e përhapur në gjithë Evropën Veriore, si dhe në Pirineje, Alpe, Karpate dhe bjeshkët e Ballkanit Qendror.	Në Kosovë rritet në kullota alpine dhe shpate gurishtore, me bazë kryesisht silikate (vende ku qëndron bora). Në Vracë, Maje te Zezë dhe Kobilicë është konstatuar në zonën alpine (2300-2500 m) në kuadër të vegjetacionit të kullotave alpine dhe shkëmbinjeve e shoqëruar nga llojet: Senecio glaberrima, Gentiana lutea, Gentiana punctata, Geranium subcaulescens, Armeria alpina, Senecio carpatia, Gentianella bulgarica, Scabiosa leucophylla, Anthemis monchanus, Senecio carpatius, Juncus trifidus, Trifolium badiu, Adenostyles alliaria, Potentilla crantzii, Saxifraga paniculata, Saxifraga tridactyla, Erigeron alpinus, Pedicularis verticillata, Lamium galeobdolon, etj.	Sipas Stevanovic et al. (1999), Rexhepi, F. (1994), Saric et al. (1986), Horvat, I. CR - B2ab(i,ii,iii,iv) – I rrezikuar në mënyrë kritike. (1952) është e përhapur në zonën alpine në Malet e Sharrit (shpate veriore të Kobilicës). Ky lloj formon popullacion shumë të vogël edhe në Vracë. Konsiderojmë së ky lloj është i përhapur edhe në Majën e Zezë. Prizren dhe Dragash.	Popullacionet e këtij lloji në Vracë dhe Kobilicë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

25	<i>Silene pusilla</i> subsp. <i>candavica</i> (H. Neumayer) Greuter & Burdet Emri shqip: Klokëz kandavice Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 12-20 cm, me kërcëj të shumtë, të butë, të ngritur ose të shtrirë, të padegëzuar ose të degëzuar në pjesën e sipërme. Pjesa e sipërme dhe e mesme e bimës me qime gjëndërore njëqelizore të shumta, ngjyeshë. Gjethet kërcellore 1-4 cm të gjata dhe 1-2 (3mm) të gjëra, lineare të zgjatura, m qime gjëndërore ose buzëve me qepalla. Lule pak, dikaze me bishta dhe kupë me qime gjëndërore. Kupa 2-6 mm e gjatë, kambanore. Kurora e bardhë, lamina deri 1/3 e çarë në 2-6 thela. Parakurora e përbërë nga 2 ose 4 brakte. Kapsula e rrumbullakët-vezake, nuk del jashtë kupës ose e kalon vetëm 2 mm. Antofori i gjatë 0.5-1 (2) mm, 2.5-4 herë me i shkurtër së kapsula. Farat rreth 1 mm në diametër, të pasura me pupri 2-4 herë me të shkurtra se diametri i tyre. Lulëzon VII-VIII, polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytton VIII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës.	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni.	Rritet në substrat karbonat, në të çara të shkëmbinjve në kuadër të rendit Potentilletalia speciosae e shoqëruar nga llojet: Saxifraga sempervivum, Alchemilla alpigena, Scrophularia laciniata, Campanula versicolor, Hieracium waldsteinii etj.	Sipas Stevanovic, V. et. al (1999), është e përhapur në Malet e Sharrit (Brod, Gryka e lumit Dushka).	Popullacioni i këtij lloji në Brod (Lumi Dushka) Dragash. Shtrihet në lartësi mbidetare 1430 m, ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
26	<i>Cynoglossum krasniqi</i> T. Wraber [<i>Solenanthus krasniqi</i> Wraber] Emri shqip: Gjuhëqen i Krasniqit [<i>Solenantë Krasniqi</i>] Familja: Boraginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me gjethë dhe bisqe sterile. Kërçelli i ngritur, me shumë gethe, në fillim leshtor, me vonë i shogët. Para lulëzimit i gjatë 22-40 cm, gjatë frytnimit deri 80 cm. Gjethet bazale heshtore qe gradualisht kalojnë në bisht. Gjethet e kërcellit lineare-heshtore ose lineare 8-16 cm; gjethet e majës rrethojnë lulese ngjat fazës së lulëzimit. Kupa 6-7 mm e gjatë, deri në bazë e ndarë, me shumë qime nga ana e jashtme dhe e brendshme. Kurora 7-8 mm e gjatë; gypi i kurorës i shogët. Thëkët dalin mbi kurorë, 5-7 mm. Fillet të ngjituta për kurorë gati në terë gjatësinë. Antheret të verdha, 1 mm. Shtyllëza 1315 mm. Lulëzon IV-V, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë.	Kosovë, Shqipëri (stenoendemik e e Pashtrikut).	Në Kosovë është konstatuar në substrat karbonat, në ekspozicion juglindor në lartësi mbidetare 1540 m, në vende me barë të zonës subalpine ku me parë ka qenë pyll i përzier ose ka dominuar asociacioni Columno-Ostryetum carpinifoliae, qe tani është pyll i degraduar. Është takuar i shoqëruar nga llojet: Acer platanus, Ostrya carpinifolia, Sorbus aria, Lilium albanicum, Gentiana lutea etj.	Pashtrik, mbi fshatin Gorozhup, 1520 m (Millaku, F. et al. 2012, Wraber, T., 1986) Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik shtrihet në lartësi mbidetare 1540 m, dhe ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë (<20). Sipas Millaku, F. et al. (2012) janë konstatuar vetëm 11 individ maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

27	<i>Stachys serbica</i> Pancic Emri shqip: <i>Sarushë e serbisë</i> Familja: Lamiaceae	Bimë njëvjeçare (Terofite T), 10-25 cm, e ngritur, e kreshpët. Gjethet 10-40 x 8-25 mm, gjatore-vezake deri gjërësisht trekëndore-vezake, shyte, si zemër ose të rumbullakuara në bazë, ura-ura deri ura-ura të sharruara. Qerthujt e rremë me nga 4-6 lule, të ngjeshur në trajtë kaptinëze të dendur, rrallë me një qerthull të rremë të larguar. Braktëzat gati si kupa. Kupa 7-14 mm, dendësisht e kreshpët; dhëmbët gati sa gypi, të spërveshur në frytëzim. Kurora 10-20 mm, e kuqërremtë-purpur; gypi gati sa kupa; buza e sipërme 4-5 mm, e plotë, e poshtmtja 3.5-4 mm. V-VI. Qosja, Xh. et al. (1996)	Siujdhesa ballkanike (Endemike-Ballkanike): Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Mal të Zi, Greqi, Maqedoni, Serbi.	Në Kosovë (Pashtrik) është konstatuar në substrat gëlqeror, në vende me bar të zonës malore e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea canescens</i> , <i>Ziziphora capitata</i> , <i>Ferulago monticola</i> , <i>Sorbus aria</i> , <i>Potentilla visianii</i> , <i>Erysimum sylvaticum</i> , <i>Centaurea kosaninii</i> , <i>Serratula radiata</i> , <i>Viola tricolor</i> , <i>Peucedanum officinale</i> etj.	Sipas Krasniqi, F. et al (1979-1980, 1987), është e përhapur në Vlashnjë (Prizren). Sipas Stevanovic, V. et al. është lloji i zhdukur edhe në Pashtrik. Millaku, F. dhe Mala, Xh. me 05.06. Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
28	<i>Thalictrum alpinum</i> L. Emri shqip: <i>Pipanollë e alpeve</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me rizomë të shkurtër dhe pak të degëzuar, të shtrirë. Kërçelli 5-15(-20) cm, në bazë me mbetje të gjetheve të thata, zakonisht pa gjethe ose rrallë me një gjethë të vetme. Gjethet zakonisht të gjitha përtokë të vendosura në rozetë, trepjesëshe, dy deri tre herë të ndara pendore; gjethëzat të rumbullakëta ose gati ovale me 3-5 lobe, të shogëta, lëkurore, në faqe të blerta-bardheme, në kundërfaqe të blerta të ndritshme deri lila. Lulet të vogla, të blerta-lila të vetmuara ose të grupuara në lulesë. Gjethëza të periantit 4, lineareheshiore, të rëna, pa nektar. Mbështjellësi i lules më i shkurtër se thekët. Thekët të shumtë më të gjatë se gjethëzat e periantit. Filamentet e thekëve më të hollë se anteret, të cilat nuk janë të prera (ndara). Frutesa në një vend me 2-3 (-5) fryte (aken) ovale të zgjatura (Stevanovic, V. et al. 1999).	Evropë, Alaska, Amerikë Veriore, Grenlandë, Islandë, Karpate, Kaukaz, Himalaje. (Tutin, T. G. et al. 1964, Stevanovic, V. et al. 1999).	Në Kosovë rritet në vende shkëmbore të zonës subalpine-alpine në substrat kryesisht silikat. Shogërohet nga llojet: <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>Achillea abrotanoides</i> , <i>Rumex scutatus</i> , <i>Cerastium decalvans</i> , <i>Saxifraga sempervivum</i> etj.	Malet e Sharrit (Brod-Gjimibeg, Duka reka, Leva reka) (Stevanovic, V. et al. 1999). Gjendja e llojit u vlerësua në lokalitetin Duka reka më 11.08.2013 (E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacioni i këtij lloji në rrethinën e Brodit ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë; në veçanti Popullacioni në Brod (Duka reka) i cili numëron <50 individë maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
29	<i>Triglochin palustris</i> L. Emri shqip: <i>Triglokin kënete</i> Familja: Juncaginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë hollake e me stolone (Gjeofite G). Kërçelli 30-- 70 cm, i fuqishëm, i thjeshtë, i shogët. Gjethet deri 2 mm të gjëra , bazale, hollake, mishtore, millore në bazë. Lulet hermafrodite, lulesa vile, 2-3 mm. Thekë 6. Fryti 7-10 mm, i çomagët, i halluar dhe në bazë gati si trung. Lulëzon VI-VII. Frynjon VIII. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi, Epir dhe Bullgari (Tutin, T. G. et al. 1972; Josifovic, M. et al. 1974; Polunin, O. 1997; Jordanov, D. et al. (1963).	Në Kosovë rritet në moçale e vende me lagështi në shoqëri me llojet: <i>Salix caprea</i> , <i>Rhamnus fallax</i> , <i>Saxifraga aizoides</i> , <i>Parnassia palustris</i> , <i>Equisetum palustre</i> , <i>Pinguicula sp.</i> , <i>Cirsium appendiculatum</i> , <i>Mentha longifolia</i> , <i>Eriophorum angustifolium</i> etj.	Malet e Sharrit – Brod, Stevanovic, V. et al. (1999). Gjendja e llojit është vlerësuar në Brod më 11.08.2013 (E. Krasniqi dhe Xh. Mala), Dragash.	Popullacioni i këtij lloji në Kosovë (Malet e Sharrit-Brod) ka përhapje shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë, numëron më < 50 individë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

30	<i>Verbascum scardicola</i> Bornm. Emri shqip: <i>Barpeshku i Sharrit</i> Familja: Scrophulariaceae	Bimë barishtore dyvjeçare ose shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e gjatë 22-45 cm. Kërçelli i thjeshtë, cilindrik, me gjethe, i kuqremtë, me qime verdhake dhe filxhanore, me gjëndra në bishta të gjatë, në majë me një lulesë të vetme vile. Të gjitha gjethet nga sipër janë verdhake të blerta, të mbuluara me qime të degëzuara, shumë a pak të thurura me gjëndra në bishta të gjatë, nga poshtë të mbuluara me qime filxhanore dhe të dendura verdhake, të hirta ose me ngjyrë ndryshku. Gjethet e poshtme janë me bishta të ngushtë, 1-5cm, llapa 5-15cm me 1,5cm ovale gjatore ose ovale heshtore në buzë me dhëmbë të cekët, në bazë në formë pyke. Gjethet pak më lartë se të poshtmet janë të njëjta me to ose pak më të ngushta, gjethet tjera janë më të vogla, pabisht, shumë a pak të ngushta, heshtore me dhëmbë. Boshti lulor është i mbuluar me qime të hirta ose verdhake – filxhanore, me pak ose shumë gjëndra me bishta. Grupet prej 1 deri 4 lulesh e përbëjnë lulesën e ngjeshur vile. Braktet janë me gjëndra nga sipër e poshtë të mbuluara me qime filxhanore. Bishtat e luleve janë me qime filxhanore të gjata 3-9mm. Kupa 4,5-7mm e gjatë, nga jashtë e ashpër e mbuluar me qime dhe gjëndra zakonisht në bishta të gjatë. Kurora e verdhë në diametër 2025mm, nga jashtë me qime filxhanore, nga brenda me qime qerpikore. Fillet e dy thekëve janë të gjata, në pjesën e sipërme të shogëta, fillet e 3 thekëve të shkurtër nga të gjitha anët janë me qime. Anteret janë veshkore. Kapsula 5-7mm e gjatë, eliptike, e gjërë pa maje, me qime të dendura, e gjatë se kupa. Rexhepi, F. (1986)	Ballkan (Kosovë, Maqedoni).	Rritet në kullosa të thata të zonës alpine, e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea linguata</i>, <i>Gentiana punctata</i>, <i>Potentilla temata</i>, <i>Geum montanum</i>, <i>Vaccinium uliginosum</i>, <i>Ranunculus montanus</i>, <i>Polygonum viviparum</i>, <i>Helianthemum alpestre</i>, <i>Campanula alpina</i>, <i>Nardus stricta</i>, <i>Veronica orsiniana</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Ligusticum mutelina</i> etj.	Kobilicë, Xhavit Mala (10 Gusht 2011), Oshlak ? (Rexhepi, 1986, 2000), Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Kosovë (Kobilicë) ka areal shumë të kufizuar, kurse numri i individëve maturë është më i vogël se 50. Në literaturë ceket të jetë prezent edhe në Oshlak mirëpo gjatë viteve 2011-2013 nuk kemi arritur ta konstatojmë (autorët).	I rrezikuar në mënyrë kritike.
----	---	---	------------------------------------	---	--	--	---------------------------------------

31	Veronica <i>saturejoides</i> Vis. Emri shqip: Veronikë trumzëngjash me Familja: Plantaginaceae [Scrophulariaceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-30 cm. Kërcejtë të shtrirë, të drunjëzuar dhe pa gjethe përposh, pushlor përsipër. Gjethet 6-9 (-15) mm, gati rrotullore deri heshtore të përmbyset, buzëplota, të tulta të afëruara, pak a shumë me qime leshtore në buzët. Vilet si kokë në lulëzim, deri 3 cm në frytëzim, me 6-12 lule, me qime leshtore, jogjendërore; këmbëzat 1 mm. Braktetë 3 mm, heshtore të përmbyset. Kupa 2.5-3 mm, me (4-) 5 segment gjatëorë, i pesti shumë i vogël. Kurora me diametër rreth 7 mm, blu e shndritshme. Thëkët të dalura. Kapsula 3.5-4 mm, zemërpërmbyset, me qime leshtore; shtyllëza 5-6 mm. Lulëzon VI-VII. Frytton VIII. (Qosja, Xh. et al.1996).	Ballkan (Endemike Ballkanike).	Rritet në substrat gëlqeror, shkëmbinjtë ose vend me gurë të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Saxifraga scardica, Saxifraga marginata, Saxifraga paniculata, Salix reticulata, Edreianthus graminifolia, Silene sp., Saxifraga trichocalycina, Veronica aphylla etj.	Koritnik, Prizren.	Koritnik Popullacioni i këtij lloji në Koritnik ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
32	Viola <i>dukadjinica</i> W. Becker et Kosanin Emri shqip: Manushaqe e Dukagjinit Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufove, e shogët, me kërcell të shtrirë 5-10 cm. Gjethet vizake ose gjatore-pallake, 1,5-3 cm, të plota. Bishtaku i shkurtër. Ndajgjethëzat si gjethe, por më të shkurtra, të plota, mallë me 1-2 ripëza në majë. Lulet të mëdha, rreth 2 cm të gjëra, të verdha. Petlat anësore të drejtuara nga lart. Shpori 10-20 mm, hollak, i verdhë ose manushaqe. Shtyllëza bërnylake, në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur, në pjekuri e shogët. Lulëzon VI. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike (Shqipëri, Kosovë).	Në Kosovë është konstatuar në kuadër të pyllit të dredhakut (Pinus mugo), kullota dhe shkëmbinjtë serpentiner të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Juniperus sibirica, Veratrum album, Lilium albanicum, Gentiana lutea, Campanula glomerata, Linum capitatum, Hypochaeris maculata, Cerastium neoscardicum, Bormmuellera dieckii, Armeria alpina, Sedum serpentinum, Pedicularis brachyodonta.	Sipas Stevanovic, V. et. al. (1999) është e përhapur në Majën e Pashallarëve (Ostrovicë), Prizren.	Në Kosovë është konstatuar vetëm një popullacion në Bjeshkët e Mueshtishtit (Pashallarë - Ostrovicë) në lartësi nga 1800-2050 m. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është i vogël. Në dhjetë vitet e fundit është zvogëluar edhe areali dhe numri i individëve maturë si pasojë e përfshirjes nga zjarri të këtij masivi.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
33	Abies borisii-regis Mattf. Notizbl. Emri shqip: Bredh maqedonas Familja: Pinaceae	Dru (Fanerofite P), deri 30 m, me kurorë piramidale të gjërë. Degëzat njëvjeçare pushlore, sythët rrëshinorë. Halat zakonisht të hapura rreth e qark degëve, mallë të shtrira horizontalisht, 20-30 x 1.5-2 mm, pjesërisht majëngreña ose shyta dhe pjesërisht majëmprehta. Boçet 10-18 x 3-3.5 (4) cm. Lulëzon IV-V. Frytton IX. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al.(1988).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Greqi).	Në Kosovë ky lloj rritet në ekspozicion lëndor nga 1200-1800 m. dhe formon Asoc. Abietum-borisii regis. Rritet e shoqëruar nga llojet: Fagus moesiaca, Carpinus betulus, Acer pseudoplatanus, Lonicera xylosteum, Melanpyrum pretense, Prenanthes purpurea, Plantago media, Evonymus verrucosus, Calamintha grandiflora, Solidago virgaurea, Salix caprea, Leucanthemum vulgare, Campanula rapunculoides, Pirola secunda, Sorbus aucuparia, Lilium martagon, Dentaria bulbifera, Melica uniflora, Telekia speciosa.	Në Kosovë sipas literaturës ekzistuese ky lloj është i përhapur vetëm në një lokalitet në afërsi të fshatit Restelicë (K.K. Dragash) – Rexhepi, F. (1994).	Në Kosovë gjendet vetëm një popullacion i këtij lloji, që shtrihet në afërsi të fshatit Restelicë. Ky popullacion ka areal të kufizuar, është mjaft mirë i ruajtur dhe i pasur me individë maturë dhe për momentin është në gjendje të mirë.	I rrezikuar.

34	<i>Acer heldreichii</i> Orph. ex Boiss. Emri shqip: <i>Panjë e Heldrahit</i> Familja: Sapindaceae [Aceraceae]	Dru (Fanerofite P) deri në 25 m, me degëza të murrme me ngjyrë të kuqe të errët. Gjethet 5-14 cm, 5 vrigullore, përposh të rimta dhe me pak push përgjatë deje ose gati të shogëta kur mbarojnë rritjen, përsipër të blerta-të errëta të shkëlqyeshme, me vrigullin e mesit të lirë deri afër buzës; vrigujt të mprehtë, me dy ose tre dhëmbë të gjërë në çdo anë. Lulet njëseksore mjaft të pakta, të verdheme, në melthe gati të përpjeta, bishtgjata që dalin bashkë me gjethet. Frytet shojza të shogëta, 2-3 cm, me flatra të harkuara këndgjera. Lulëzon V-VI. Frytmon IX-X. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Greqi, Maqedoni, Bullgari)	Në Kosovë Ky lloj rritet kryesisht në substrat gëlqeror, rrallë në silikate; në zonën e ahut ose ahut me bredh (Abieti Fagetum), në zonën e armenit dhe të hormoqit dhe në pyje të përziera nga 1200-2200 m e shoqëruar nga llojet: Pinus peuce, Picea abies, Abies alba, Fagus sylvatica, Vaccinium myrtillus, Sambucus racemosa, Acer pseudoplatanus, Salix caprea, Sorbus aucuparia, Senecio nemorosa, Doronicum austriacum etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), është i përhapur në Malet e Sharrit, Alpe Shqiptare dhe Malin Mokna. Sipas Millaku, F. (1999) A. heldreichii, subsp. visianii K. Maly. është i përhapur në Alpe Shqiptare (Maja e Foto: Fadil Millaku (2013), Maja e Rusolisë Rusolisë, Zhleb dhe Malin Mokna). Sipas Josifovic et al. (1973) subsp. visianii ky lloj rritet në Zhleb. Ky lloj është i përhapur edhe në vendin e quajtur Ujërat e Humbura (Malet e Sharrit), në lartësi 1680 m dhe në lokalitetin Përroi Durlit ku arrin të jetë prezent edhe në zonën alpine. Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) ky lloj është i përhapur: në Oshlak, Ujërat e Humbura, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Jalovarnik.	Në Zhleb, Maje të Rosulisë dhe Malin Mokna Popullacioni i këtij lloji është mirë i ruajtur dhe i pasur me individ maturë dhe individ të rinj. Në Malet e Sharrit (Ujërat e Humbura) Popullacioni i këtij lloji ka areal shumë të kufizuar dhe përbëhet nga individ të rrallë (<50) të cilët janë prezent në vende ku pylli i bredhit dhe hormoqit janë të prerë ose në skaje të pyllit.	I rrezikuar.
35	<i>Achillea chrysocoma</i> Friv. Emri shqip: <i>Barpezmi balukeartë</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pushbutë deri e mëndafshët. Kërcejtë deri 40 cm, të ngritur të thjeshtë. Gjethet pak a shumë cilindrike me përjashtim të me të sipërmeve; bazalet deri 8 cm, me bishtak të shkurtër, dyfishpendore të prera; vrigujt vizakë; gjethet e sipërme kërcellore pabisht, kryesisht njëfishpendore të ndara. Vastaket me 12-15 ose me shumë kaptina; bishtat 2-5 mm. Pështjella 3-5mm në diametër. Braktetë 3-4 cm, me buzë ngjyrë kafe-të errëta. Lulet llapore rreth 3 mm, të verdha të shndritshme. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytmon VII-VIII. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës ose insekteve. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Maqedoni, Greqi, Serbi).	Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore ose kullota me bar të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Armeria alpina, Jovibarba heuffeli, Lilium albanicum, Helianthemum canum, Festuca koritniensis, Stachys alpina, Botrychium lunaria, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Myosotis alpestris etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e përhapur në Luboten. Sipas Saric, M. et al. (1986), Josifovic, M. et al. (1977) në Livadhishitë, Kobilicë, Luboten dhe Koritnik. Millaku, F. & Mala, Xh. me 26.07.2011 e konstatuan në lokalitetin Liqenet e Jazhincës në lartësi mbidetare 1995 m, në kuadër të kullotave alpine dhe subalpine, kurse në Brezovicë me 26.07.2011, në kuadër të kullotave alpine në lartësi 2350 m. Përveç lokaliteteve të cekura	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura vetëm në kuadër të Maleve të Sharrit. Këto popullacione kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve.	I rrezikuar.

					në kuadër të Maleve të Sharrit janë hulumtuar edhe popullacionet e këtij lloji në Pashtrik, Restelicë, Vracë, Piribreg, Bistër, Maja e Zezë, Vërtop dhe Karanikollë.		
36	<i>Achillea fraasii</i> subsp. <i>canescens</i> Form. Emri shqip: <i>Barëpezmi i Frazit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare e lartë, (Hemikriptofite H), deri 50 cm, me kërcell të drejt të mbuluar me qime të hirta merimangore. Gjethet të mbuluara me qime të mëndafshita, të poshtmet kërcellore të gjëra -heshtore, dy herë pendore me segmente të shkurtra heshtore; në pjesën e sipërme të kërcellit të gjata heshtore, pendore. Kaptinat 12-15 mm të gjëra , në bishta të gjatë që formojnë vastak. Gjethëzat e involukrumit me qime, në skaje të murrme në të verdhë. Lulet llapore 5-7, të bardha formë ovale. Lulëzon VII/VIII. Polenizimi kryhet me anë të erës ose me insekte. Frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Maqedoni, Shqipëri).	Në Koritnik dhe Pashtrik rritet kryesisht në vende të thata ose shkëmbinj gëlqerorë zonave malore deri alpine e shoqëruar nga llojet: Scabiosa graminifolia, Potentilla speciosa, Rhamnus pumilla, Potentilla visianii, Isatis tinctoria, Trifolium velenovski, Jovibarba heufeli, Anthyllis aurea, Globularia cardifolia, Arctostaphylos uva ursi, Fritillaria graeca.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Rexhepi,F. (2000), Josifovic et al. (1977), Saric et. al. (1986) në Kosovë është e përhapur në Pashtrik Priyren dhe Koritnik, Dragash.	Në Kosovë deri me tani janë konstatuar dy popullacione. Një popullacion në Pashtrik që ka areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve matur në kuadër të popullacionit dhe popullacioni në Koritnik që është me areal shumë të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni në Pashtrik edhe pse ka areal të kufizuar është në gjendje të mirë, i ruajtur dhe me i pasur me individë maturë në krahasim me popullacionin e këtij lloji në Koritnik.	I rrezikuar.
37	<i>Achillea grandifolia</i> Friv. Emri shqip: <i>Barpezmi gjethemadh</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë 30-100 cm, të ngritur të degëzuar në pjecën e sipërme. Gjethet kërcellore të mesit rreth 10 x 5 cm, vezake, të sheshta, pendore të çara thellë deri pendore të prera, me segmente pendor të çarë pushlore; segmentet kryesorë 20-40 mm, heshtorë, segmentet e dytë heshtor të shkurtër, gati majëmprehtë. Vastakët me shumë kaptinëza. Pështjella rreth 4 x3 mm; braktetë e brendshme pushlore. Lulet llapore të bardha. Lulëzon VI-VIII. Polenizimi kryhet me insekte (entemofilia). Frytton VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Serbi) dhe Azi e Vogël.	Në Kosovë rritet në Pyje ose çeltira pyjesh, të zonës malore në kuadër të asociacionit Abieti-Fagetum ose Ostryo-Fagetum (Zhleb) e shoqëruar nga llojet: Fagus sylvatica, Abies alba, Picea abies, Acer obtusatum, Ostrya carpinifolia, Evonymus verrucosus, Asphodeline lutea, Rosa canina, Dorycnium columnae, Corylus colurna, Geranium lucidum, Lapsana communis dhe Lunaria telekiana.	Sipas Millaku, F. et al. (2012, 1999), është e përhapur në Pashtrik, Maje te Rusolisë dhe Grykë te Deçanit. Sipas Saric, M. et al. (1986) është prezente në Alpe Shqiptare (Gryka e Deçanit). Sipas Josifovic, M. et al. (1975) në Zhleb.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është shumë i vogël.	I rrezikuar.

38	<i>Achillea holosericea</i> Sm. Emri shqip: <i>Barpezmi gjethe mëndafshë</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë 15- 60 cm, të ngritur, të thjeshtë pushlorë. Gjethet pendore të çara, të mëndafshita; bazalet 3-20 cm me bishtak, heshtore; vrigujt vezake deri heshtore, pak a shumë me dhëmbë si sharrë; kërceloret 1-3 cm, të sheshta, pabisht, vrigujt me buzë pak a shumë të plota. Vastakët me 10 deri shumë kaptinëza; bishtat 2-5 mm. Pështjella rreth 5 mm në diametër; braktetë rreth 4 mm, vezake, shyte, me buzë të ngushta ngjyrë kafë. Lulet llapore 1.2-2.5 mm, rrotullare, të verdha. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entemofilia), frytton VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës. Vangjeli, J. et al. 2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Greqi, Maqedoni). Sipas Tutin et al. (1976) Ky lloj është i përhapur në pjesën J & JP të Ballkanit. Është e përhapur në Maqedoni (Matevski, V. et al. 2011, Sekovski Z. et al. 1999).	Në Kosovë ky lloj rritet në vende gurishtore ose shkëmbinjtë gëlqeror të zonave malore deri alpine. Në grykën e Rusenicës rritet në kuadër të asociacionit DaphneJuniperetum e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Daphne oleoides, Ostrya carpinifolia, Achillea ageratifolia, Cerastium decalvans, Scabiosa lucida, Thesium dolineri, Scabiosa crenata, Minuartia verna, Eryssimum helveticum, Hieracium wetsteinii. Në Pashtrik dhe Koritnik rritet në kullota të thata ose shkëmbinjtë gëlqeror e shoqëruar nga llojet: Potentilla speciosa, Rhamnus pumilla, Potentilla visianii, Isatis tinctoria, Trifolium velenovskii, Jovibarba heuffelii, Anthyllis aurea, Globularia cardifolia, Arctostaphylos uva ursi.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur në Pashtrik. Sipas Rexhepi, F. (2000) rritet në Pashtrik dhe Koritnik. Sipas Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Pashtrik, sipas Saric et al. (1986) në Malet e Sharrit (Koxha Ballkan). Millaku, F. & Mala, Xh. me 06.07.2011 e kanë konstatuar në Malet e Mushtishtit (Rusenicë) në shkëmbinjtë gëlqeror në lartësi mbidetare 1055 m.	Popullacionet e këtij lloji në Koritnik dhe Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar, kurse numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël dhe nën ndikimin e faktorit zoootropogjen. Popullacioni në Grykën e Rusenicës ka areal shumë të kufizuar dhe <100 individë maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar.
39	<i>Achillea pindicola</i> subsp. <i>corabensis</i> (Heimerl) Greuter Emri shqip: <i>Barëpezëm i Korabit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë deri 30 cm, gjethet me pak të dhëmbëzuara ose të plota. Gjethet bazale deri 7cm, pallake – vezake- përmbysët, që ngushtohen drejt bishtakut me majë shyte. Kërceloret rreth 2x1 cm, pabisht. Vastakët jo më shumë se 10 kaptinëza, bishtat e luleve 5-25 mm. Pështjella 4-7 mm në diametër, braktetë 3-5 mm, vezake, shyte ose majë mprehta, me buzë të gjëra, kafë të errëta. Lulet llapore 4-6 mm vezake të bardha, akenet 2mm. Lulëzon VII-VIII, Frytton VIII-IX.	Endemike e Ballkanit - Kosovë, Maqedoni (Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996). Sipas Matevski V. (2000-2001) ky lloj është i përhapur në Bistër, Medenicë, Korab, Deshat, Malet e Sharrit - Ceripash, Stogovë, Shqipëri dhe Greqi Veriperëndimore.	Ky lloj në Kosovë rritet kryesisht në shkëmbinjtë karbonat ose silikat, në vende të thata ose shkëmbinjtë të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Saxifraga scardica, Salix reticulata, S. retusa, Achillea abrotanoides, Silene saxifraga, Arabis alpina etj. Ndërsa në Brod rritet e shoqëruar nga llojet: Silene pamassica, Crepis macedonica, Silene multicaulis etj.	Sipas Stevanovic, V., Niketic, M. (1988), ky lloj është i përhapur në Brod, Dragash. Me 18.08.2013 Millaku, F. dhe Mala, Xh. takuan një popullacion të këtij lloji edhe në Vracë në shkëmbinjtë gëlqeror dhe në lartësi mbi detare nga 2201 – 2500 m.	Popullacioni i këtij lloji në Vracë ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të Popullacionit. Në Vracë (Malet e Sharrit) ky lloj shtrihet nga 2201 m lartësi mbidetare dhe arrin deri afër majës. Ky popullacion gjendet në një lokalitet që nuk është shumë larg nga Malet e Korabit, ku gjendet ky lloj dhe prej nga e ka marrë emrin.	I rrezikuar.

40	Alkanna scardica Griseb. Emri shqip: Alkënë e Sharrit Familja: Boraginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), jo gjëndërore, kreshtake – e grathët me qime të shkurtra. Kërcejt 10-30 cm, të përpjetëm ose të ngritur. Gjethet bazale 4-5 x 0.8-1.2 cm, heshtore të përmbysëta; kërceloret gjatore-heshtore. Braktetë afërsisht 2 herë me të gjata së kupa, heshtore. Kupa rreth 5 mm në frytëzim. Kurora blu e shogët ose leshtake nga ana e jashtme; gypi 2 herë me i gjatë se kupa; llapa me diametër 8-11 mm. Akenët me diametër rreth 2 mm, të rrjetëzuar, me kokrriza të imta. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi).	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat, në vende shkëmbore dhe me barë të zonave subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Lilium albanicum, Gentiana lutea, Veronica orsiniana, Vaccinium myrtillus, Anthemis montona, Silene roemer, Geranium coeruleatum, Potentilla montenegrina, Silene parnassica etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Kurvallë (Alpe Shqiptare). Millaku, F. me 18. 06. 2013 e konstatoi edhe në Dervish Kom në lartësi 2190 m. Në Malet e Sharrit është e përhapur në lokalitetin e quajtur Qafa e Hormoqit (afër Përroit të Durlit), Gjakovë.	Popullacioni i këtij lloji në Kurvallë dhe subPopullacioni në Dervish Kom shtrihen në lartësi mbidetare nga 1980 - 2300 m. Popullacionet i këtij lloji lokalitetin Qafa e Hormoqit dhe në Kurvallë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. SubPopullacioni i këtij lloji në Dervish Kom ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është shumë i vogël.	I rrezikuar.
41	Phyllolepidium rupestre (Sweet) Trinajstić [Aurinia rupestris (Sweet)] Cullen & T.R.Dudley] Emri shqip: - Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore. Gjethet të përhitura, bazalet heshtore, të tjerat lineare. Kupa 5 mm e gjatë. Fryti vezak i përmbysët ose i rumbullakët, 6 mm i gjatë, shpatuk, me qime në formë ylli ose i shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë.	Itali, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në vende të thata me gurë ose në shkëmbinj të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Minuartia baldaci subsp. doerfleri, Potentilla apenina, Potentilla speciosa, Viola elegantula, V. grisebachiana etj.	Sipas Josifovic, M. et al (1972), Saric et al. (1986) është e përhapur në Koritnik, Dragash Luboten, Kaçanik.	Popullacionet e këtij lloji në Koritnik dhe Luboten kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Koritnik ky lloj takohet përgjatë kurizit afër kufirit me Shqipërinë.	I rrezikuar.
42	Barbarea longirostris Velen. Emri shqip: Barbare sqepqjatë Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e grathët. Kërçelli i degëzuar deri 50 cm. Gjethet e poshtme lirake pendore të prera, me segmentim skajor të madh rrotullar-vezak të përmbysët dhe me 2-3 palë vriguj anësorë; të sipërmet pendore të çara me vriguj vizake-heshtorë, me veshëza në fund. Lulet të verdha në vile të zgjatura, pa brakte. Petalet 6-9 mm. Lulesa vile e zgjatur. Silikët të grathët, 10-20 mm, të hapur; këmbëzat 4-6 mm; shtyllëzat 3-5 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë.	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Bullgari, Greqi, Maqedoni - Endemike e Ballkanit).	Rritet në vende me lagështi ose pran burimeve dhe përrrenje të zonës alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: Pinguicula sp., Gymnadenia frivaldii, Parnasia palustris, Caltha palustris, Veratrum album, Narthecium scardicum, Cardamine pratensis, Saxifraga stellaris, S. rotundifolia etj.	Sipas Josifovic, M. et al (1977), është e përhapur në Malet e Sharrit (Ujërat e Humbura, Dovedonicë, Liqenet e Jazhincës), Prizren.	Popullacioni i këtij lloji në Malet e Sharrit ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar.

43	<i>Campanula albanica</i> Witasek Emri shqip: Lulekambanë shqiptare Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), (6-) 8-15 (-24) cm, të përjetëshme deri ngritur, të shogët. Gjethet e bazës si zemër, të sharruara, që mungojnë gjatë kohës së lulëzimit, kërceloret eliptike të ngushta deri vizake, pak a shumë buzë plota, kryesisht majëmprehta. Lulet të vetmuara, rrallë nga 2-3 së bashku. Vezorja me puprri, rrallë e lëmuar. Dhëmbët e kupës deri 12 mm, trekëndësh të ngushtë deri vizake. Kurora 14-18 (-22) mm, blu deri manushaqe. Kapsula (6-) 7-8 mm, si fuge, e varur. Lulëzon VI. Frytton VIII (Qosja. Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik-pjesa Jugperëndimor e (Tutin, T. G. et al. (1976).	Lulekambana shqiptare (Krasniqi, F. et al. 2003) në Kosovë rritet në shkëmbinj silikat (Crepidetalia dinaricae respektivisht Campanulion albanicae) ose në kullota të thata të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Silene pusilla, Polygonum alpinum, Senecio wagneri, Cryptogramma crispa, Cerastium alpinum, Helianthemum nummularium, Hieracium pilosella, Senecio doronicum subsp. glaberrimus, Geranium subcaulescens, Campanula alpina, Potentilla doerfleri, Armeria alpina, Sempervivum macedonicum, Juncus trifidus, Saxifraga tridactylites etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000, 1986, 1982), Diklic, N. & Nikolic, V. (1981) dhe Saric, M. et al. (1986) gjendet në Malet e Sharrit (Shtëpia e Stojkut Çukut e Liqenit), Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Hajlë, Maja e Ropsit). Popullacione të vogla të këtij lloji gjatë viteve 2011-2013 u konstatuan edhe në Brezovicë, Qukat e Jazhincës, Vracë, Pashallarë dhe Koritnik (Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F., Krasniqi, E. & Mala, Xh). Prizren dhe Dragash.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Zakonisht rriten në grupe të vogla, ndërsa për nga habitusi ngjajnë shumë me llojin C. scheuchzeri.	I rrezikuar.
44	<i>Centaurea atropurpurea</i> Waldst. et Kit. Emri shqip: Kokoçel purpur i errët Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë (30-) 100-150 (-200) cm, pak të degëzuara në gjysmën e sipërme, me gjethe në pjesën e sipërme. Gjethet 1 (-2) fish pendore të prera, gati të shogëta, jo lirake; segmentet 2-3 (-20) mm të gjëra, vizakeheshore. Pështjella me diametër 20-30 mm, rruzullore; braktetë e pështjellës me shtojca rreth 10 mm; shtojcat trekëndore-heshore, kafe të errëta, që mbulojnë plotësisht braktetë; këndet të bardhërore, të ngritura menjëherë. Lulet purpur të errëta, rrallë të verdha, të jashtmet rrallë më të gjata se të brendshmet. Akenet rreth 4 mm, pushpak, kafe; xhufka rreth 4mm, kafe e errët. Lulëzon VI. Frytton VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	Evropë Juglindore (Gadishulli Ballkanik, Rumani, Greqi) (Greuter, W. & E. von RaabStraube 2008; Tutin, T. G. et al. 1976; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet në shpatë të thata barishtore me tokë jo të thellë dhe me bazë shkëmbore gëlqerore të zonës malore. Shoqërohet nga llojet: Dianthus cruentus, Stachys officinalis, Galium verum, Trifolium alpestre, Potentilla erecta, Rhamnus frangula, Plantago media, Cephalaria pastricensis etj.	Ky lloj u konstatua nga Rexhepi, F. (1978), në Malet e Istogut. Popullacione të llojit u konstatuan dhe u vlerësuan edhe në Pashtrik gjatë ekspeditave për periudhën 2011-2013 (F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala). Me 21.08.2012 është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e popullacioneve të llojit në Lubinj të Epërme të Prizrenit.	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë në veçanti në Pashtrikun e Poshtëm. Popullacionet tjera të këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadr të popullacioneve sidomos në lokacionin afër fshatit Lubinje e Epërme.	I rrezikuar.

45	<i>Centaurea kotschyana</i> Heuff. Emri shqip: <i>Kokoçel i Koshit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 50-100 cm, zakonisht të thjeshtë. Gjethet me qime kaçurrele; bazalet heshtore, me dhëmbë të larguara; kërcelloret lirake të prera; segmentet gjatë deri vizakë-heshtorë, të dhëmbëzuar ose të vrigulluar. Pëshjtjella 20-30 mm në diametër; shtojcat vezake-trekëndore, kafë-të errëta ose të zeza, që mbulojnë tërësisht braktetë; kindet 3-5 mm, të bardha në majë. Lulet purpur të errëta, të jashtmeq atë gjata sa të brendshmet. Akenët 4-5 mm, pushpak; xhufka 4-5 mm. Lulëzon VI. Frynion VIII (Vangeli, J. et al. 2000).	Karpate Lindore, Evropë Juglindore (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Bullgari, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi) (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Tutin, T. G. et al. 1976; Petrova, A. & Vladimirov, V. 2010, Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet në kullota të thata me tokë jo të thellë me bazë shkëmbore gëlqerore të zonës malore deri alpine, kryesisht në ekspozicionet veriore dhe verilindore. Gjendet edhe në kuadër të pyllit të kërkëles (Pinus mugo) e shoqëruar nga llojet: Achillea alexandri-regis, Polygala major, Onobrychis scardica, Pedicularis brachyodonta, Senecio wagneri, Linum capitatum, Lilium albanicum, Rubus saxatilis, Phyteuma confusum, Anthyllis vulneraria, Hypochaeris maculata, Hypochaeris uniflora, Centaurea splendens, Trollius europaeus, Gentiana lutea, Vaccinium myrtillus, Knautia dinarica, Stachys alpina, Astrantia major etj.	Përmendet për Kosovë-Kobilicë, Maja e Zezë (Rexhepi, F. 1986, 1994; Diklic, N. & Nikolic, V. 1978). Më 09.07.2011 dhe 11.08.2011 është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e llojit në Oshlak (F. Millaku, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi dhe Xh. Mala). Lloji është konstatuar dhe vlerësuar edhe në Brod, Dragash (Malet e Sharrit) dhe në Bjeshkët e Lumëbardhit në Prizren (Alpet Shqiptare). Me 21.08.2012 është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e llojit në Lubinje të Epërme në kullosa rrëzë ahishtave në lartësinë mbidetare 1300 m. (E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji rriten në grupe të vogla dhe me pak individë. Në veçanti popullacionet në Oshlak dhe në Brod kanë areal të kufizuar dhe me numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
46	<i>Cephalaria pastricensis</i> Doerfler et Hayek Emri shqip: <i>Cefalare e Pashtrikut</i> Familja: Dipsacaceae	Shumëvjeçare deri 200 cm e lartë (Hemikriptofite H). Gjethet 18-30x8-15 cm, pendore të prera, të shogëta ose të qerpikta, me 4-7 palë vriguj heshtorë ose gjatë, të sharruar ose dhëmbë-dhëmbë, vrigujt e sipërm të stërzgatur gjatë nervurës së mesit. Braktetë e pëshjtjellës 5-7x4-5 mm, vezake-heshtore gati majëmprehta, të purpurta të zeza në majë. Luspat e shtatit lulor 6-8x3-4 mm, pallake të thepëta, të qerpikta, të shogëta ose me push të masur, të purpurta-të zeza në majë. Kurora rreth 14 mm, e verdhë. Pëshjtjellëza rreth 8 mm në frytëzim, me 8 kënde, me 4 kreshta sa ¼ e gypit e 4 më të shkurtra ndërmjet tyre. Lulëzon VI. Frynion IX (Qosja, Xh., et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik (Kosovë, Shqipëri) (Rexhepi, F. 1986, 1994, 2000; Tutin, T. G. et al. 1976). Sipas Radovic, D. (2007), është e përhapur në Serbi (Tara) ?.	Ky lloj në Kosovë rritet në sustat gëlqeror me toka jo të thella, në kullota dhe çeltira pyjesh të zonave malore në Pashtrik dhe në Alpet Shqiptare (Syne, Bjeshka e Kaliqanit). Në Syne (1823 m l. m. d.) gjendet në kullosa subalpine në zonën e fitocenozës Abieti-Fagetum bashkë me llojet: Dianthus cruentus, Stachys officinalis, Galium verum, Trifolium alpestre, Potentilla erecta, Rhamnus frangula, Plantago media, Centaurea atropurpurea. Në Pashtrik (1733 m l. m. d.) rritet në kullota Foto: Elez Krasniqi (2011), Pashtrik subalpine, shoqërohet nga llojet: Sorbus aria, Amelanchier ovalis, Trifolium velenovskii, Stachys alpina, Aster alpinus, Lilium albanicum, Trifolium alpestre, Dianthus cruentus, Trifolium badium, Campanula glomerata, Paeonia officinalis, Stachys scardica, Veratrum nigrum etj.	Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit-Maja e Madhe, Zhleb, Maja e Rusolisë, Pashtrik (Rexhepi, F. 1982, 1986, 2000; Krasniqi, F. 1987, 1998, Millaku, F. 1993, 1997, 1999; Silic, C. 1988; Zeneli, L. 1975; Josifovic, M. et al. 1973). Popullacionet e llojit u konstatuan dhe u vlerësuan edhe në Bjeshkën e Kaliqanit më 30.08.2013 (F. Millaku dhe E. Krasniqi). Lloji është konstatuar edhe në relacinin Kosharisht-Syne (Malet e Istogut).	Në të gjitha lokalitetet popullacionet e llojit janë të rralla dhe kanë numër të vogël të individëve sidomos në Alpet shqiptare. Popullacionet e këtij lloji në Malet e Istogut (Kaliqan-Syne) kanë areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal me të gjërë dhe numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Ky lloj në Pashtrik është i përhapur prej zonës subalpine mbi Gorozhup, kufiri me Shqipërinë dhe vazhdon edhe në Pashtrikun e Poshtëm dhe zbret deri në 980 m lartësi mbidetare.	I rrezikuar.

47	<i>Crepis albanica</i> (Jav.) Babcock [<i>C. baldaccii</i> subsp. <i>albanica</i> Jav.] Emri shqip: <i>Shmangë shqiptare</i> Familja: <i>Compositae</i> [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare; kërcëjtë 3-4, deri 35 cm, me 1-10 degëza (Hemikriptofite H). Gjethet të shogëta ose pushuake të rralla; gjethet e bazës 10-15x2.5-3 cm, të shumta, heshtore, të përmbysta, majëmprehta, me prerje të thella jo të rregullta të kthyer në drejtim të bazës, pendore të çara deri lirake-pendore, me vriguj të mëdhenj fundorë me dhëmbë të mprehtë dhe me vriguj anësorë të larguar, shumë të reduktuar, majëmprehtë, të ngushtuar në bazë; gjethet e jashtme lëkurore të ngjashme me ato të bazës; të sipërmet vizake-heshtore të thepëta. Kaptinëzat të pakta deri të shumta. Pështjella 11-14x7-9 mm; braktetë vizake-heshtore, majëmprehta, të jashtmet sa 2/3 e gjatësisë së të brendshmeve, të përhimapushbuta dhe me qime të shkurtra gjëndërore, pushlore në faqen e brendshme. Lulet me ngjyrë të verdhë. Akenët 6.57.75 x 0.7-0.8 mm, të kuqërremtë-kafe, boshtorë, të holluar në majë, me 20 brinjë. Lulëzon VI-VIII. Frytton IX (Vangjeli, J. et al. 2000).	Shqipëri, Kosovë, Mali Zi, Greqi (Tutin, T. G. et al. 1976; Josifovic, M. et al. 1975, Rexhepi, F. 1994).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqerorë dhe silikat të zonës subalpine e alpine i shoqëruar nga llojet: <i>Campanula foliosa</i>, <i>Sempervivum macedonicum</i>, <i>Campanula</i> Foto: Elez Krasniqi (2011), Vracë spatulata, <i>Geum montanum</i>, <i>Vaccinium myrtillus</i>, <i>Vaccinium uliginosum</i>, <i>Veratrum album</i>, <i>Jasione orbiculata</i>, <i>Phyteuma pseudorbiculare</i>, <i>Centaurea nervosa</i>, <i>Ajuga pyramidalis</i>, <i>Lilium albanicum</i>, etj.	Alpet Shqiptare (Bjeshkë të Lumëbardhit, Koprivnik, Gryka e Rugovës) (Josifovic, M. et al. 1975, Rexhepi, F. 1982, 1986, 1997, 2000). Konstatimi dhe vlerësimi i gjendjes së llojit është realizuar gjatë viteve 2011-2013 edhe në Malet e Sharrit (Liçenet e Jazhincës, Piribreg, Livadhishtë, Bistër, Brod, Shutman, Vracë) (F. Millaku, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi, Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit edhe pse me shtrirje bukur të gjërë, numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël. Zakonisht takohen individ të vetmuar.	I rrezikuar.
----	---	--	--	---	---	--	---------------------

48	<i>Daphne cneorum</i> L. Emri shqip: <i>Hollokuq i shkurtër,</i> <i>Xerxele knerore</i> Familja: Thymelaeaceae	Gjysmëshkurre përherë e blertë (Kamefite Ch) me degë zakonisht të shtrira ose të përpjetme, të gjata, të holla, të drejta e të lëmuara. Bisqet e reja pushlore, të përhimë. Gjethet 10-18 (-25) x (-2) 3-5 (-6) mm, zakonisht 3-4 herë më të gjata se të gjëra, gjatore të përmbysët ose vizake-heshore të përmbysta, shyte, nganjëherë me thumb, pabisht, të shogëta, jo të grumbulluara në tufëza në krye të degëve. Lulet të merme, ngjyrë trëndafili, gati të pabisht, në kaptinëza, 6-10 (-20) së bashku, me brakte të ngjashme me gjethet, por më të vogla. Hipanti 6-10 mm, zakonisht i mbuluar me qime të bardheme. Nënpetlat 4-6 mm, shyte. Frytet bërthokla si të murme- të verdha, të mbështjella nga hipianti, deri në pjekje, të ngurtësuar dhe pa tul më në fund. Lulëzon V-VI. Frytton VIII-IX (Qosja, Xh. et al. 1992).	Evropë (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat karbonat por edhe në serpentini, në vende me bar ose shkëmbinj. Në Koritnik (2047 m l. m. d.) rritet në shpatjet verilindore në shkëmbinj gëlqeror në shoqëri me llojet: <i>Ranunculus thora</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, Foto: Elez Krasniqi (2012), Koritnik <i>Dianthus integer</i>, <i>Dryas octapetala</i>, <i>Minuartia verna</i>, <i>Ranunculus oreophilus</i>, <i>Coronilla vaginalis</i>, <i>Pulsatilla narcissiflora</i>, <i>Myosotis alpestris</i>, <i>Salix reticulata</i> etj. Millaku, F dhe Krasniqi, E. me 24.04.2012 këtë lloj e konstatuan dhe e vlerësuan edhe në Golesh (843 m l. m. d.), në kullosa serpinine e shoqëruar nga llojet: <i>Fritillaria mesanensis</i>, <i>Galium gerardii</i>, <i>Muscari botryoides</i>, <i>Carduus nutans</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Quercus pubescens</i>, <i>Potentilla visianii</i>, <i>Iris reichenbachii</i>, <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Alyssum markgrafi</i>, <i>Sedum ochroleucum</i>, <i>Primula veris</i>, <i>Trinia glauca</i> etj.	Sipas F. Rexhepit (1986, 1994) dhe Randjelovic, N. & Rexhepi, F. (1984) lloji gjendet në Kopaonik, Koritnik dhe Pashtrik. Një popullacion i llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe në Golesh (lokalitet i ri për Kosovë) më 24.04.2012 (F. Millaku dhe E. Krasniqi).	Lloji rritet në popullacione të vogla dhe me numër jo të madh të individëve maturë, sidomos Popullacioni në Golesh i cili në dy vitet e fundit ka numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
49	<i>Dioscorea balcanica</i> Kosanin Emri shqip: <i>Groshë e egër,</i> <i>Dioskorea ballkanike</i> Familja: Dioscoreaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare me zhardhokë cilindrikë (Gjeofite G). Kërcejtë deri 60 cm, të hapur ose të përpjetëm, të padegëzuar, Gjethet deri 7 x 6 cm, pak si zemër në bazë, të këmbëra ose gati të përkundërta, majëprehta, me 9 nervura të degëzuara, me bishtak të gjatë deri 7 cm. Lulet rreth 2 mm, në lëmshtë tuforë të përbërë nga kallit të çlirët, të gjelbërme. Rrethlulja e luleve mashkullore kambanore; thekë 6. Rrethlulja e luleve femërore me 6 vriguj të thellë; shtyllëzat të shkurtra, me krezat të para dysh. Kalliri frytor deri 7 cm, i varur. Kapsula 2-2.5 cm në diametër, me 3 flatra. Farat të sheshta, me flatra vemesore. Lulëzon IV. Frytton V. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi (Rexhepi, F. 2000; Tutin, T. G. et al. 1980; Josifovic, M. et al. 1976).	Në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në vende shkurre e pyje të malla rrëzë Pashtrikut dhe rrëzë Koritikut në kuadër të fitocenozës <i>Dioscoreo-Carpinetum orientalis</i> ku lloje dominante dhe edifikatore janë <i>Carpinus orientalis</i>, <i>Fraxinus omus</i>, <i>Rubus caesius</i>, <i>Cornus mas</i>, <i>Clematis flammula</i> etj.	Rrethina e Zhurit (Krasniqi, F. 1972, 1982, 1987, 1998; Diklic, N. & Nikolic, V. 1961; Josifovic, M. et al. 1976), rrëzë Koritikut dhe Pashtrikut (Rexhepi, F. 2000, Rexhepi, F. & Randjelovic, N. 1984, Rexhepi, F. & Ruzic, M. 1985, Silic, C. 1988, MPMH 2008). Më 02.07.2011 është vlerësuar gjendja e popullacioneve të llojit në rrethinën e Zhurit (F. Millaku, F. Rexhepi, Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është konstatuar dhe vlerësuar edhe mbi fshatin Kuzhnin (Millaku, F. 24.05.2013). Kaznik (Krasniqi, E. 2021)	Popullacioni i këtij lloji në Koritnik edhe pse ka areal të kufizuar, ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Popullacioni në Malin e Pashtrikut nuk është uniformë dhe ky lloj takohet në hapësira të vogla dhe në numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

50	<i>Diphasiastrium alpinum</i> (L.) J. Holub, [Diphasium alpinum (L.) Rothm.] Emri shqip: <i>Difaz i alpeve</i> Familja: Lycopodiaceae	Bimë me kërcell zvarritës, 60-100 cm (Kamefite Ch). Degët anësore rreth drejta, të shpeshta, në formë buçe katërfaqësore ose pak të shtypura dhe me gjërësi 1.5-2 mm. Gjethet në degët shterpa i ka në 4 rreshta. Gjethet anësore lineare-ovale janë të ngjitura në mes veti dhe me degë deri në mes. Gjethet e poshtme të palosura për degë, mishtore, lineare me bisht. Sporofilet lineare të mprehta. Strobilluset 5-15 mm të gjata, pabisht, mezi i kalojnë degët anësore sterile. Sporet janë në formë të rrjetës. VII-IX (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi Veriore dhe Perëndimore, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Hacupler, H. & Myer, Th. 2007).	Rritet në substrat silikat në vende me barë e më rrallë shkëmbore të zonës subalpine e alpine mbi 1500 m l.m.d. (Bruckenthalio-Juniperetum) në shoqëri me llojet acidofile: Juniperus sibirica, Bruckenthalia spiculifolia, Vaccinium uliginosum, Empetrum nigrum etj.	Alpet Shqiptare (Bogiqç, Bjeshka e Belegut, Maja e Ropsit, Ishtedim), Malet e Foto: Fadil Millaku (2013), Bjeshka e Belegut Sharrit (Vracë, Bistër, Millaku, F. 1999, Rexhepi, F. 1986, Saric, M. et al. 1992). Ky lloj është konstatuar edhe në lokalitetin Përroi i Durlit në lartësi mbidetare 2100 m.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
51	<i>Drypis spinosa</i> L. Emri shqip: <i>Dripis</i> Familja: Caryophyllaceae	Është bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) dendësisht tufore, 8-30 cm. Kërcejtë janë të ngritura, shumë të degëzuara, të shogët, katërkëndorë. Gjethet janë të ngushta lineare, të forta, me majë dhe me ferrë (gjemb) në fund. Lulesa është dikaze, e ulur në formë kaptine. Braktet e sipërme janë heshtore ose ovale me gjemb të gjatë terminal, shumë më të gjata se lulet ose me gjemb të shkurtër, pak më i gjatë se lulet. Kupa ka formë gypore- kambanore me 5 dhëmbë shumë a pak lëkurore. Fletëzat e kurorës janë shumë të ngushta të ndara thellë në dy pjesë, me një parakurorë të ngushtë. Thëkë ka 5. Kapsula është ovale-eliptike, çilet me kapak. Lulëzon VI-VII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 1986).	Shqipëri, Greqi, Itali, (Bimë Illo-Adriatike) (Tutin, T. G. et al. 1964; Rexhepi, F. 1986; Josifovic, M. et al. (1970)).	Në Kosovë (Koritnik dhe Luboten), rritet në shkëmbinjtë gëlqeror (shëmtira të shkëmbinjtë) të zonës subalpine (Drypetum spinosae). Shfaqet nga llojet: Trifolium noricum, Rumex scutatus, Senecio rupestris, Scutellaria alpina etj.	Koritnik, Luboten. (Rexhepi, F. 1986, 1997; Diklic, N. & Nikolic, V. 1961).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar (vetëm në vendet ku shemben shkëmbinjtë).	I rrezikuar.

52	<i>Fritillaria messanensis</i> subsp. <i>gracilis</i> (Ebel) Rix Emri shqip: <i>Fritilare mesineze</i> Familja: <i>Liliaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërcell të lartë 15-35 cm. Gjethe 710, vizake, më të poshtmet 4-9 x 0.3- 1 cm, gjethet e sipërme të këmbëra. Rrethlulja kabanore e gjërë me ngjyrë të verdhë ose të murme nga jashtë, jo e zgjeruar të goja, rrallë më njolla si tabela e shahut; Tepalet e brendshme zakonisht rrotullare në majë. Riprodhohet me farë dhe me bulb. Lulëzon V-VI. Frynjon VI-VII. (Vangjeli, J. et al., 2000)	Evropa Jugore.	<i>Fritillaria messanensis</i> subsp. <i>messanensis</i> në Kosovë rritet kryesisht në substrat serpentinor. <i>Fritillaria messanensis</i> subsp. <i>gracilis</i> në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në shkurre, çeltira pyjesh dhe kullota të thata të zonës malore dhe subalpine nga 600-1900 m) e shoqëruar nga llojet: <i>Ostrya carpinifolia</i>, <i>Juniperus communis</i>, <i>Corydalis cava</i>, <i>Helloborus odoratus</i>, <i>Primula veris</i> etj. Në Majën e Rusolisë dhe në Majën e Vjellakut ky takson është takuar në shoqëri nga llojet: <i>Achillea abrotanoides</i>, <i>Lilium albanicum</i>, <i>Gentiana lutea</i>, <i>Achillea fraasii</i>, <i>A. lingulata</i>, <i>Plantago argentea</i> etj.	Kaliçan dhe Vrellë (Istog). Millaku, F. Gashi, B. me 09.05. 2013 e konstatuan edhe mbi fshatin Syne në lartësi mbidetare 1420 m. Millaku, F. me 19.05. 2013 e konstatoi në Majën e Vjellakut në ekspozicion lindor nga 1700-1900 m. , Millaku, F. dhe Berisha, N. me 11.06.2013 e konstatuan edhe në Majë të Rusolisë në ekspozicion verior në lartësi mbidetare nga 1700-1900 m. Ky lloj është takuar edhe në Grykën e Rugovës (Mala, Xh. & Millaku, F. 2013).	Sipas studimeve tona të bëra në terren ky lloj në Kosovë formon tri popullacione. Një popullacion që shtrihet nga Gryka e Rugovës deri në Majën e Rusolisë (Zhleb), dhe Popullacioni i dytë që shtrihet prej Bjeshkës së Kaliqanit dhe vazhdon deri afër Malit Mokna. Në kuadër të Popullacionit të parë janë konstatuar 3 subpopullacione (Grykë të Rugovës, Maja e Vjellakut dhe Rusoli) që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në kuadër të Popullacionit të dytë janë konstatuar dy subpopullacione (Kaliqan-Vrellë dhe mbi fshatin Syne-Kosharishtë), që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Popullacioni i tretë është i përhapur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Edhe ky popullacion ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
----	--	---	-----------------------	---	--	--	---------------------

53	Geranium reflexum L. Emri shqip: Kamaroshe e përthyer Familja: Geraniaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me rizomë të shkurtër e të trashë. Kërçelli është i gjatë 40-70 cm me shumë qime gjëndërore të gjata. Gjethet janë 6-15 cm të gjëra, me llapë të ndarë me 5-17 vriguj pendorë të çarë. Lulet janë shumë në lulesa pak a shumë të çlirët, bishtat e luleve janë të sipërveshura gjatë pjekjes së frytit. Sepalet janë 8-9 mm, me halë shpesh të zhdukur ose me thimth. Petalet janë 7-9×2.5-4 mm ngjyrë jorgovani të mbylltë gjatore shumë të sipërveshura në kohën e lulëzimit. Merikarpet janë të kreshpëta me 2-4 brinjë të thelluara tërthore poshtë shtyllëzës. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frytton VII-IX. Qosja, Xh. et al. (1992).	Ballkan.	Në Kosovë ky lloj rritet në livadhe, çeltira pyjesh dhe shkurre të zonës subalpine dhe alpine. Në Koritnik është konstatuar në kuadër të asociacionit Pinetum heldraichi typicum. Në Malet e Sharrit është e përhapur kryesisht në kuadër të vegjetacionit të shkurreve subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Vaccinium myrtillus, Juniperus sibirica, Crepis pannonica, Rubus idaeus, Achillea chrysocoma, Veronica officinalis, Veronica orsiniana, Epilobium angustifolium etj.	Sipas Josifovic et al. (1977) ky lloj është i përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkë të Lumëbardhit, Peklën, Pejë) dhe në Koritnik. Ky lloj është konstatuar edhe në Vracë dhe në Brod, Dragash.	POPULLACIONET : Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni në gjendje me të mirë është në Koritnik dhe Bjeshkë të Lumëbardhit.	I rrezikuar.
54	Geum reptans L. Emri shqip: Mëlakë zvarranike Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 1-1.5 cm me rizomë të drunjëzuar. Stolonet janë zvarritëse me gjethe të larguara. Gjethet bazale janë pendore me shumë brakte gati të njëjta, të sharrëzuara ose të ndara pendore. Brakte terminale nuk është e madhe. Kërçelli është i vogël me një lule. Sepalet janë lineare-heshtore, 14 mm të gjata. Petalet janë 5-8 mm ngjyrë të verdhë-ari. Shtyllëza nuk është e artikulluar, ka qime qerpikore. (Rexhepi, 1986). Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII. (Rexhepi, 1986)	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Serbi).	Ky lloj rritet në substrat silikat, në të çara të shkëmbinjeve të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Silene lerchenfeldiana, Saxifraga scardica, Potentilla doerfleri, Achillea abrotanoides, Arabis alpina, Cardamine acris, Selaginella selaginoides, etj	Sipas Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1977), është e përhapur në Livadhishtë, Bister, Maja e Zezë, Piribreg. Me 07.08. 2012 Krasniqi, E., Millaku, F. & Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan edhe në Vracë në kuadër të shkëmbinjeve të zonës alpine.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura vetëm në Malet e Sharrit dhe kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
55	Gladiolus illyricus W.D.J. Koch Emri shqip: Gladiola e Ilirisë Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) 25-50 cm. Këllëfët bazale të gjelbër, ndonjëherë me nuanca të kuqe zakonisht gjatë nervurave. Gjethet 4-5 (-10-40) cm të gjata dhe 4-10 mm të gjëra. Kallinjtë me 3-10 lule, nganjëherë të degëzuar pak a shumë. Rreth lulja është e kuqe deri e kuqërremte e purpur, segmentet 25-40×616 cm vezake përmbysët, rombike ose heshtore përmbysët. Anteret më të shkurtra se fillet në lule me segmente vezake përmbysët, por të barabarta me ato në lulet me segmente rombike ose heshtorë përmbysët. Kapsula vezake	Evropë, Kaukaz.	Rritet në livadhe, kullota dhe vende me shkurre në kuadër të asociacioneve: Polygalo-Forythietum europaea dhe Astero-Juniperetum Oxycedri. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Anthemis montana, Tulipa sylvestris, Minuartia verna, Linum tauricum, Cotinus coggygia, Forsythia europaea etj.	Sipas Josifovic, M., et al.(1976) ky lloj është i përhapur në Obrançë (Podujevë). Gjatë viteve 2011-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Llapçevë, Bokat e Morinës dhe Maja e Zezë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të Popullacionit në Bokat e Morinës që ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	I rrezikuar.

		përmbysët ose eliptike, farat me flatra. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Vangjeli, J. et al. 2000).					
56	<i>Gladiolus palustris Gaudin</i> Emri shqip: <i>Gladiolë kënetash</i> Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 25-50 cm. Millet bazale të gjelbërt, ndonjëherë me nuanca të kuqe zakonisht gjatë nervurave. Gjethet janë 10-40 cm x 4-10 mm të gjata dhe 4-10 mm të gjëra, zakonisht vetëm një gjethe kërcellore braktengjashme me dy gjethe bazale. Kalliri njëanësor deri me 6 lule. Rrëthlulja e kuqe deri e kuqe-purpur. Segmentet e rrëthlules 25 x 40 x 6-16 mm, të sipërmit gati të barabartë, vezakepërmbysët, anësoret rombikë, të poshtmit rrëth 1/3 e gjatësisë të të sipërmeve, gjatorë-pykorë; thonjëza aq sa llapa. Riprodhohet me farë dhe bulb. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Evropë.	Rritet në livadhe ose kullota me lagështi. Në Brezovicë rritet në livadhe të cilat me parë kanë qen pyje të verit (Alnetum glutinosae) e shoqëruar nga llojet: Alnus glutinosa, Fraxinus angustifolia, Taraxacum officinale, Galium verum, Bellis perennis, Ranunculus millefoliatus, Trifolium pratensis, Poa pratensis, Plantago major, Equisetum arvensae etj.	Brezovicë, Llabjan (Novobërdë), Rexhepi, F. (1978), Llopushnik (Dragash).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të Popullacionit në Brezovicë që është me i ruajturi në krahësim me popullacionet tjera.	I rrezikuar.
57	<i>Jacobaea othonnae (M.Bieb) C.A.Mey. [Senecio othonnae Bieb.]</i> Emri shqip: <i>Pulith e Otonit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 80-200 cm. Kërcepi i shkurtër me stolone të gjata. Kërcejtë të ngritur, të degëzuar vetëm në lulesë, të shogët. Gjethet e bazës dhe ato më të poshtme kërcellore 30-60 x 12-35 cm, pendore të prera, me segment gjatorë të përmbysët-heshtorë, të prerë-të sharruar, të shogëta përsipër, me qime kaçurrele-pushpake përposh; gjethet e sipërme kërcellore me segment pak a shumë të dhëmbëzuar. Kaptnëzat të shumta, 5-15 mm në diametër, në vastakë. Pëshjtella 57 mm, me push shajakor të rrallë, me 1-4 brakte shtesë; braktetë shpesh të zeza në majë. Lulet llapore 1-2, të verdha, 8-12 mm. Akenët 3-6 mm, me qime të dendura të rrasura. VI-VIII. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike Ballkanike (Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Mali i Zi, Bullgari).	Ky lloj në Kosovë (Zhleb dhe Maje të Rusolisë) është i përhapur në pyje (Fagetum montanum dhe Abieti Fagetum) dhe kullota të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Acer heldreichii, Hesperis dinarica, Lunaria telekiana, Fagus sylvatica, Rhamnus fallax, Tanacetum macrophyllum, Digitalis ambigua etj. Në Pashtrik ky lloj është konstatuar në kuadër të pyllit të ahut (Fagus sylvatica) dhe në kuadër të pyllit të përzier.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb, Rusoli). Sipas Josifovic, M. et al. (1975) është e përhapur në Zhleb. Millaku, F. me 23.07.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrik në kuadër të pyllit të ahut dhe pyllit të përzier të ahut me lajthi (Coryllus columna) në lartësi mbidetare 1320 m.	Popullacioni e këtij lloji në Zhleb-Maje të Rusolisë ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit. Ky lloj në këtë lokalitet shtrihet edhe buzë malit në anën e majtë të rrugës Pejë-Rozhajë. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal shumë të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të këtij popullacioni është i konsiderueshëm.	I rrezikuar.

58	<i>Kitaibela vitifolia</i> Willd. Emri shqip: <i>Kitabelia gjetherrushi</i> Familja: Malvaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 3 m e gjatë pak e degëzuar me qime të bardha gjembore. Gjethet janë të mëdha, 18 cm të gjata në bishta të gjatë me qime të rralla zemërore, pak të ndara formë pëllëmbore në 5-7 vriguj trekëndore, pa maje, buzëve të sharrëzuara. Lulet janë sqetulllore nga 2-4, bashkë. Braktet e kupës së jashtme janë vezake të mprehta pak janë më të gjata dhe më të gjëra se sepalet. Petalet janë pak më të gjata se sepalet (2.5×2 cm) të bardha ose të verdha. Fryti është shizokarp ndahet në shumë fryte të thjeshta me qime dhe ngjyrë të murme. Riprodhohet me farë. Lulëzon VII-VIII. Frytmon VIII-IX. (Josifovic, M., et al. 1973).	Ballkan, Rumani, Sub-ballkanike.	Ky lloj rritet në çeltira pyjesh ose buzë rrugëve nga zona kodrinore deri në zonën montane (900-1200m) e shoqëruar nga llojet: <i>Fagus moesiaca</i> , <i>Digitalis grandiflora</i> , <i>Scrophularia nodosa</i> , <i>Rubus</i> sp., <i>Acer platanoides</i> , <i>Corylus avellana</i> , <i>Campanula trachelium</i> , <i>Prunus avium</i> , <i>Pteridium aquilinum</i> , <i>Verbascum</i> sp. etj.	Sipas Millaku, F. (1999) rritet në zonën kodrinore-malore në Bjeshkën e Lumëbardhit (Alpe Shqiptare), në afërsi të Grykës së Rugovës. Janë konstatuar edhe disa individ të pakt afër fshatit Dobrushë (Zhur). Sipas Tomovic, G. et al. (2007) është e përhapur në rrethinën e Pejës.	Popullacioni i këtij lloji në Bjeshkën e Lumëbardhit (Alpet Shqiptare) shtrihet nga 900 – 1200 m lartësi mbidetare në kuadër të pyllit të ahut. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji afër Zhurit ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
59	<i>Knautia macedonica</i> Griseb. Emri shqip: <i>Knautia e Maqedonisë</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore e çlirët, me rozetë gjethesh dhe kërcëj lulore, zakonisht me stolone nëntokësore. Kërçelli është deri 70 cm i lartë, pak a shumë i kreshpat me pak qime. Gjethet janë të vendosura të kreshpëta, bazalet të gjelbra, të përmbysta që zakonisht thahen në kohën e lulëzimit, ndërsa gjethet kërcellore janë heshtore deri vezake të ngushta. Zakonisht lirake-pendore me 4-12 vriguj anësor dhe një vrigull skajor vezak e me buzë ura-ura si sharrë. Kaptinëzat janë me diametër 1.5-3 cm. Kupa është si gishtje me (6-) -8 (-10) halëza. Kurora është zakonisht e kuqe e errët, nganjëherë blu ose trëndafili. Lulëzon V-VII. Frytmon VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996). Rexhepi, F. (1978).	Ballkan, Rumani, Turqi.	Rritet në livadhe kodrinore (Thymo- Knautietum macedonicae, Rexhepi, F. (1978), Hundozi, B. (1980), e shoqëruar nga llojet: <i>Thymus tosevi</i> , <i>Primula columnae</i> , <i>Trifolium alperstre</i> , <i>Knautia arvensis</i> , <i>Polygalla comosa</i> , <i>Leucanthemum vulgare</i> , <i>Leontodon hispidus</i> , <i>Lotus corniculatus</i> , <i>Onobrychis arenaria</i> , <i>Filipendula vulgaris</i> .	Sipas Saric et al. (1986), Hundozi, B. (1980), Rexhepi, F. (1978) është e përhapur në: Përlepnice, Mirushë, Oshlak, Virovi, Liqenet e Jazhincës	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni i këtij lloji në afërsi të Mirushës është afër zhdukjes si pasojë e ndërtimeve në habitatin e këtij lloji.	I rrezikuar.
60	<i>Knautia midzorensis</i> Formánek Emri shqip: <i>Knautia e Mixhorensit</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Rrënja vertikale e fortë. Kërçelli i drejtë në pjesën e poshtme i mbuluar me qime të kthyera teposhtë, rrallë i shogët, në pjesën e sipërme me qime të gjata ose rrallë i shogët. Gjethet janë shumë a pak lëkurore eliptike-heshtore, të ngushta heshtore, të plota në maje janë të mprehta. Gjethet e poshtme janë me qime, më të gjëra në mesin e tyre. Gjethet e sipërme	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgari).	Rritet në livadhe, kullosa, shkurre, pyje të zonës subalpine dhe alpine (Seslerio-Pinetum heldreichii). Rritet në shoqëri me llojet: <i>Fagus moesiaca</i> , <i>Abies alba</i> , <i>Ulmus montana</i> , <i>Sorbus aucuparia</i> , <i>Lonicera nigra</i> , <i>Betula pendula</i> , <i>Acer platanoides</i> , <i>Ribes alpinum</i> , <i>Rhamnus fallax</i> .	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1973) është e përhapur në Malin Mokna, Bjeshkët e Lumëbardhit, Liqenak, Rrasë të Zogut, Zhleb. Në Malet e Sharrit gjendet në Oshlak dhe Malet e Mushtishtit (Pashallarë).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Mushtishtit (Pashallarë) dhe në Oshlak janë në gjendje të mirë, ndërsa popullacionet e këtij lloji në Malin Mokna dhe Alpet Shqiptare kanë një shtrirje më të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në	I rrezikuar.

		janë të shogëta. Kërçelli është i mbuluar me qime dhe gjëndra. Lulesat janë të mëdha të gjëra 3-4 cm. Lulet të purpurta, të verdha. (Rexhepi, 1986).				kuadër të popullacioneve.	
61	<i>Lilium jankae</i> A. Kern. [<i>Lilium carniolicum</i> subsp. jankae (A. Kern.) Asch. & Graebn.] Emri shqip: <i>Zambaku i Jankut</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 30-90 (-120) cm. Bulbi i madh oval 3.5-6 (8) cm i përbërë prej shumë gjetheve mishnore gjatore-heshtore, të verdha me majë. Rrënjët janë të shumta. Kërçelli i fortë, i drejtë, i shogët me diametër 5-15 mm, në pjesën e poshtme pak a shumë pa gjethe me 1-2 brakte membranore të lartë me shumë gjethe pak a shumë të shpërndara njësoj deri te lulesa. Gjethet të drejta, të këmbëra heshtore ose heshtore-gjatore, kah baza dhe kah maja të ngushtuara. Gjethet bazale të gjata 8-9 (14) cm, kah pjesa e sipërme gjithnjë më të vogla. Lulesa terminale me (1) 2-4 ose më shumë lule në bishta të gjatë. Lulet në diametër janë 4-6 cm ngjyrë fosfori ose të verdha-ari nga ana e brendshme me vija vjollcë të mbyllët ose me pika. Braktet e perigonit janë gjatore-heshtore, të gjata 57 cm dhe të gjëra 8-13 mm, në bazë të ngushtuara në thua. Thëkët më të shkurtra se perigoni, fillet e thëkëve të gjata 22-28 mm, anetë të kuqe-portokalli ose të kuqërremta, të gjata 10-15 mm. Pistili gjator-trevigullor i gjatë 13-25 dhe i gjërë 4 mm. Shtyllëza e gjatë 12-14 mm gradualisht zgjerohet kah maja dhe kalon në stigma. Kapsula e gjatë 30-45 mm dhe i gjërë 20-30 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII.	Kosovë, Bullgari, Rumani.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrat gëlqeror dhe silikat. Rritet në livadhe, kullosa malore dhe shkurre subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>Picea abies</i> , <i>Geum montanum</i> , <i>Luzula sylvatica</i> , <i>Hypericum</i> sp. etj.	Është konstatuar në Malet e Sharrit (Guri i Dellocit, Studenicë -Therandë te antena) dhe në Malin Mokna.	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit dhe në Malin Mokna kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

62	Lunaria telekiana Jäv. Emri shqip: Barhënë e Telekit Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli i degëzuar qysh nga baza. Gjethet kanë bishita të gjatë, janë vezake të dhëmbëzuara ura-ura. Lulet të purpurta vjollce. Lulëzon VI-VII. Frytmon VII-VIII. Riprodhohet me farë. (Vangeli, J. et al. 1995)	Ballakan (Kosovë, Shqipëri).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në kuadër të pyllit te ahut ose në pyje të përziera, rrallë haset në çeltira pyjesh dhe vende shkëmbore. Në Pashtrik është konstatuar në 1420 m lartësi mbidetare në kuadër të Asociacionit Columno-Ostryetum dhe Fagetum montanum e shoqëruar nga llojet: Fagus moesiaca, Corylus column, Ostrya carpinifolia, Cardamine enneaphyllos, Cardamine bulbifera, Sanicula europaea, Oxalis acetosella, Daphne mezereum, Scrophularia nodosa, Pulmonaria rubra, Prenanthes purpurea, Primula veris. Në Zhleb është konstatuar në 1325 m lartësi mbidetare në kuadër të asociacionit Ostryo Fagetum e shoqëruar nga llojet: Achillea grandifolia, Delphinium fissum, Hesperis matronalis, Crepis bertscea.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur në Pashtrik, Koprivnik. Millaku, F., Mala, Xh. dhe Berisha, N. me 23.06.2013 e konstatuan edhe në Zhleb në lartësi mbidetare 1325 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve; me përjashtim të Popullacionit në Pashtrik që ka numër të mjaftueshëm të individëve maturë.	I rrezikuar.
63	Tripleurospermum caucasicum (Willd.) Hayek [Matricaria caucasica (Willd.) Poir. Matricaria brevirostrata (Ledeb.) Rauschert] Emri shqip: - [Matrikarije e Kaukazit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë 15-50 cm, të thjeshtë. Gati të shogët, të ngritur ose të përpjetëm nga një rizomë e shkurtër zvarritëse. Gjethet të shogëta; kërcelloret e poshtme 4-7 x 1.5 – 2.5 cm, dyfishpendore të prera në segment mjaft majëmprehtë. Kaptinëza 1 (-3), 3-5 cm në diametër; gjuhëzat 1.5-2 cm; braktet e pëstjtjellës gati trekëndore deri gjatë, me buzë të gjëra cipëthata, të errëta-kafë. Akenët rreth 2.5 x 1mm, me 1-2 brinjë; gjëndra rreshinore 2, të vogla, rrethore; xhufka 0.3-0.5 mm, e zbehtë vemesore, e plotë ose didi e vrigulluar. Lulëzon VII-VIII. Polenizimi kryhet me insekte (entemofilia). Frytmon VIII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës. Vangeli, J. et al. (2000).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Bullgari (subendemike), Azi e vogël.	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat në kuadër të kullotave të thata alpine. Rritet e shoqëruar nga llojet: Rumex alpinus, Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum, Hypericum alpinum, Veratrum album, Stachys alpina etj.	Gjatë viteve 2011-2013 këtë lloj e kemi konstatuar në kullota të zonës alpine në Bjeshkë të Opojës (Karanikollë) dhe Restelicë (Lumi i thatë) afër kufirit me Shqipërinë.	Popullacioni e këtij lloji në rrethinën e Opojës (Karanikollë) gjendet në zonën kufitare me Maqedoninë. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Në Restelicë (Lumi i thatë) afër kufirit me Shqipërinë kemi konstatuar < 30 individë maturë.	I rrezikuar.

64	<i>Micromeria albanica</i> (K. Maly) Silic Emri shqip: Bishtmiu shqiptar Familja: Lamiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Kamefite Ch), me rrënjë dhe pjesë të poshtme të kërcellit të drunjëzuar. Kërcej shumë dhe të degëzuar, 20-40 cm. E terë bima e mbuluar me qime të bardha të hirta. Gjethet ovale, shyte, (10-21 x 5,5-12 mm), të ngushtuara në bisht të shkurtër 3-8 mm. Gjethet me 3 (4) nervura, në të dy anët mbuluar me qime të shpeshta dhe të shkurtra kurse në kundërfaqe qime gjëndërore shumë të imta. Lulet në lulesa terminale të degëzuara në pjesën e poshtme. Bishtat e luleve 2,5-4 mm. Braktet lineare, me majë. Kupa e përhitur, rreth 3 mm e gjatë me 5 dhëmbë dhe 13 nervura. Kurora 6-7 mm, me tub pak të lakuar, nga jashtë me qime ngjyrë të bardhë. Akenët me ngjyrë të murme në të verdhë, në maje me qime (1-1.3 mm). Lulëzon VII-IX. Frytëzon IX-X. Riprodhohet me farë.	Subendemike (Shqipëri, Kosovë).	Ky lloj rritet në substrate shkëmbore gëlqerore të nxehta. Në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit takohet edhe në mjedise ku është prezent fiku (<i>Ficus carica</i>). Rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>Amelanchier ovalis</i> , <i>Campanula versicolor</i> , <i>Carpinus orientalis</i> , <i>Colutea arborescens</i> , <i>Hieracium waldsteinii</i> , <i>Convolvulus cantabrica</i> , <i>Corydalis ochroleuca</i> , <i>Euphorbia myrsinites</i> , <i>Iris reichenbachii</i> , <i>Laser trilobum</i> , <i>Petrorhagia saxifraga</i> , <i>Pistacia terebinthus</i> , <i>Ruta graveolens</i> , <i>Salvia ringens</i> , <i>Scabiosa crenata</i> , <i>Scabiosa fumaroides</i> , <i>Teucrium montanum</i> , <i>Teucrium polium</i> , <i>Tremastelma palestinum</i> etj.	Sipas Krasniqi, E. et al. (2011), Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Mala, Xh. me 15.08.2012 këtë lloj e konstatoi në shkëmbinj gëlqeror të Ura e Fshejtë (Xërxë).	Sipas Krasniqi, E. et al. (2011), Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Mala, Xh. me 15.08.2012 këtë lloj e konstatoi në shkëmbinj gëlqeror të Ura e Fshejtë (Xërxë).	I rrezikuar.
65	<i>Minuartia baldaccii</i> (Hal.) Mattf., subsp. <i>doerfleri</i> Hayek Emri shqip: <i>Minuartia e Baldaçit</i> Familja: Caryophyllaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rizoma të trasha, të drunjëzuar, deri 20 cm, të mbushura me gjethë të dendura. Kërcejtë relativisht të shkurtër me ndërmje shumë të ofruara; ata lulebartës 4-6 cm të gjatë, me push gjëndëror sipër. Gjethet 5-9 mm të gjelbra, vizake të mprehta shpesh të njëanshme, me qerpikë të vegjël, me push gjëndëror ose të shogëta me një nervurë. Lulesa nga 13 lule. Sepalet 4-5 mm të gjata. Petalet vezake të përmbystë; 11-12 mm të gjata. Kapsula sa nënpetlat. Lulëzon VI-VIII. Frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë dhe rizoma. Paparisto, K. et al. (1988).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Greqi).	Ky takson rritet në Kullota dhe substrate shkëmbore gëlqerore të zonave të larta malore. Popullacioni i këtij lloji në Luboten ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në Koritnik gjendet një popullacion me areal shumë të kufizuar që shtrihet në zonën alpine kryesisht në ekspozicionin verior dhe verilindor. Pjesa më e madhe e individëve të Popullacionit shtrihet përgjatë kurrizit të Koritnikut në lartësi 2390 m e shoqëruar nga llojet: <i>Aster alpinus</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Aster alpinus</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>Ptilotrichum rupestre</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Edreianthus graminifolia</i> , <i>Saxifraga scardica</i> , <i>Saxifraga sempervivum</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Josifovic, M. et al. (1977) subsp. <i>doerfleri</i> është e përhapur në Koritnik dhe Luboten.	Popullacioni i këtij lloji në Koritnik shtrihet në substrate gëlqerore në zonën alpine ka areal shumë të kufizuar dhe numri më i madh i individëve është konstatuar përgjatë kurrizit të këtij masivi malor (afër kufirit me Shqipërinë). Popullacioni i këtij lloji në Luboten ka areal me të kufizuar dhe numër me të vogël të individëve, krahasuar me Popullacionin në Koritnik.	I rrezikuar.

66	<i>Paeonia mascula</i> (L.) Mill. Emri shqip: Bozhure mashkull Familja: Paeniaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), me kërcëp zhardhokor, me rrënjë të mishta. Gjethet dyfishteshe ose me disa gjethe pak të ndara; segmentet 9-16, ngushtësisht deri gjërësisht eliptike ose vezake, përposh të shogëta. Lulet me diametër 8-14 cm, të kuqe. Rrëshekthet 3-5, zakonisht pushlore, të rumbulluara në majë, 2-4 cm, me kreze pabisht. Lulëzon V-VI, polenizimi kryhet me insekte, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe zhardhok. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropa Jugore, Kretë deri në Azi të vogël.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në vende me bar dhe në pyje në kuadër të asociacioneve: Quercetum montanum, Ostryo-Carpinetum orientalis, Fagetum submontanum, Fagetum montanum, Luzulo-Fagetum, dhe Ostryo Fagetum e shoqëruar nga llojet: Ostrya carpinifolia, Fraxinus ornus, Quercus trojanae, Q. petraea, Fagus sylvatica, Acer pseudoplatanus, Acer obtusatum, Evonymus verrucosus, Geranium sanguineum, Stachys scardica, Cardamine bulbifera, Geum urbanum, Arum maculatum, Anemone ranunculoides, Anemone nemorosa, Lilium martagon, Lathyrus venetus, Aristolochia pallida etj.	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Kosovë (nuk cekën lokalitetet). Millaku, F. me 24.05.2007 në Bjeshkët e Istogut, mbi fshatin Syne e konstatoi një popullacion shumë të vogël të këtij lloji në kuadër të asociacionit Ostryo Fagetum. Popullacionet e këtij lloji janë hulumtuar edhe në Pashtrik, Koritnik, Gërmi dhe Bjeshka e Mushtishtit (shpati i Manastirit).	Në Kosovë popullacionet e hulumtuara kanë qenë me areal të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Popullacionet në Pashtrik, Bjeshket e Mushtishtit dhe në Malet e Istogut (mbi fshatin Syne) kanë areal shumë të kufizuar dhe janë të rrezikuara si pasojë e degradimit të habitateve dhe prerjes së pyllit.	I rrezikuar.
67	<i>Paeonia officinalis</i> L. Emri shqip: Bozhure mjeksore Familja: Paeniaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 40-70 cm, me kërcëp zhardhokor, me rrënjë të mishta. Gjethet e poshtme të ndara në 17-30 segmente, përposh pushlore, përsipër të shogëta; bishtaket me hullizë të thellë në faqen e sipërme. Kupa e përhershme, 5 anëtarshë e gjelbër ose rrallë si kurora. Kurora e kuqe rrallë roze, prej 58 petaleve. Lulet në formë kupe, me diametër 7-13 cm. Fijet e thekëve të kuqe. Rrëshekthe 2-3, zakonisht pushbuta rrallë të shogëta 2-3.5 cm. Lulëzon IV-V, polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytëzon VI. Riprodhohet me farë ose në mënyrë vegjetative me rizomë. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropë Jugore, Azi e vogël, Amerikë.	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në Pashtrik në substrat gëlqeror në lartësi mbidetare nga 1300-1900 m, në kuadër të kullotave të zonës subalpine, me rrallë në vende me bar në kuadër të asociacionit Collurno-Quercetum cerris ose në pyllin e përzier. Rritet e vetmuar ose në tufë e shoqëruar nga llojet: Ostrya carpinifolia, Corylus colurna, Quercus cerris, Cephalaria pastricensis, Veratrum nigrum, Vicia sp., Scorsonera villosa, Valeriana tuberosa, Linaria dalmatica, Dianthus cruentus, Stachys recta, Hypericum rumelicum, Calamintha acinos etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur në Pashtrik, Prizren.	Në Kosovë është konstatuar vetëm një popullacion i këtij lloji në Pashtrik, që ka areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të popullacionit është në numër të konsiderueshëm. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik është i përhapur në të gjitha ekspozicionet.	I rrezikuar.

68	<i>Pedicularis hoermannian</i> a K. Maly Emri shqip: <i>Pedikulare hoermaniane</i> Familja: Orobanchaceae [Scrophulariaceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 30-100 cm, me kërcell të ngritur, zakonisht e mbuluar me gjethe. Gjethet dyfishpendore, me vriguj pendor të thellë, dhe të sharrëzuar buzëve të gjetshit. Braktet në pjesën e poshtme të lulesës të ngjashme me gjethet e kërcellit dhe shumë me të gjata se lulet. Kupa formë kambane, me 5 dhëmb të shkurtër, e mbuluar me qime të shkurtra kaçurrele. Kurora e madhe, 2 cm e gjatë, ngjyrë e verdhë e çelet; buza e sipërme gati e drejtë kurse maja e rrumbullakët e topitur, nga jashtë e mbuluar me qime të buta. Lulëzon VI-VIII. Josifovic, M. et al. (1974).	Kosovë, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi, Bullgari.	Rritet në substrate gëlqerore dhe kullota të thata të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: <i>Lilium albanicum</i> , <i>Potentilla ternata</i> , <i>Senecio scopoli</i> , <i>Senecio bosniaca</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Myosotis alpestris</i> , <i>Asphodelus albus</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Ranunculus montanus</i> , <i>Hypochoeris maculata</i> etj.	Millaku, F. me 29.05. 2013 e konstatoj në Pashtrikun e Poshtëm në kullota të zonës subalpine. Ekzistojnë shënime se ky lloj është i përhapur edhe në Alpet Shqiptare por nuk ceken lokalitetet. Në Malet e Sharrit është hasur në rajonin e Koxhaballkanit (afër tre kufirit midis komunave; Prizren, Therandë, Shtërpçë)	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik është shumë i vogël dhe janë konstatuar gjithsej më pak se 20 individë maturë. Edhe popullacioni në Koxhabalkan ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
69	<i>Potentilla calabra</i> Ten. Emri shqip: <i>Potentillë e Kalabrisë</i> Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), zakonisht e shtrirë me kërcëj lulorë deri 20 (30) cm, dendësisht pushlorë. Gjethet të gishtëzuara; gjethtëzat zakonisht 5, me dy deri 3 vriguj shytë, 10-30 x 5-15 mm, të përhimëta të gjelbra deri të bardha përsipër, dendësisht pushbuta përposh. Lulet të shumta. Sepalet vezake. Kupëza me vriguj vizak, aq sa edhe nënpetlat. Shtyllëza konike si fill, gati skajore. Karpelet të verdha të errëta ose portokalli në të verdhë, të shogëta. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Itali, Ballkan, Turqi.	Në Kosovë rritet në Malet e Sharrit në substrate shkëmbore ose vende të thata dhe me gur të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Silene lichenfeldiana</i> , <i>Lamium galeobdolon</i> , <i>Jovibarba heuffelii</i> , <i>Polygonum alpinum</i> , <i>Trifolium velenovskyi</i> , <i>Anthemis montana</i> , <i>Gentiana punctata</i> , <i>Geranium subcaulescens</i> , <i>Potentilla doerfleri</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Senecio carpatia</i> , <i>Gentianella ciliata</i> , <i>Sempervivum macedonicum</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e përhapur në Malet e Sharrit (Guri i Zi-Restelicë). Me 07.08. 2011 Millaku, F., Krasniqi, E. & Mala, Xh. Këtë lloj e konstatuan në shkëmbinj Foto: Fadil Millaku (2011), Vracë silikat mbi fshatin Brod në lartësi 1866 m. Me 07.08 2011 Millaku, F., Krasniqi, E. & Mala, Xh. e konstatuan në rrethin e Shutmanit, mbi Brod (Guri i Qytetit) dhe në Vracë në zonën alpine (2200-2500m), Dragash.	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Guri i Zi, mbi fshatin Brod dhe Vracë) shtrihen nga 1800 – 2500 m. Këto popullacione kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.

70	Potentilla doerfleri Wettst. Emri shqip: Potentillë e Dorflerit Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 30 cm e lartë, me kërcell të mbuluar me qime të gjata (1-2 mm), shpesh edhe me qime gjëndërore. Gjethet pëllëmbore me 5 gjethëza të gjata 15-40 mm, vezake të dhëmbëzuara ose sharrëzuara, me majë të vogël, me qime ngjyrë të blertë ose të blertë të hirtë. Lulet të shumta. Sepalet trekëndore-heshtore. Nënpetlat (kupa e dytë) e ndarë në segmente lineareshtore, afërsisht e gjatë sa nënpetlat. Petlat 5-7 mm të gjata, të bardha, me të shkurtra se nënpetlat. Fillat e thekëve dendur të mbuluar me qime të palosura. Lulëzon VII-VIII, frytëzon VIII-IX, riprodhohet me farë.	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Maqedoni (Micevski & Matevski, 1987).	Rritet në kuadër të vegetacionit të shkëmbinje silikat të zonës alpine (Potentillo doerfleri-Juncetum trifidi), e shoqëruar nga llojet: Achillea abrotanoides, Anthemis montana, Saxifraga moschata, Sempervivum macedonicum, Veronica bellidoides, Gentianella bulgarica, Juncus trifidii, Armeria alpina, Saxifraga paniculata, Saxifraga tridactylites, Erigeron alpinus etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Saric, M. et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Prevallë, Maja e zezë, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Përroi i Durlit, Bistra, Maja e Zezë, Luboten). Me 07.08.2011 Millaku, F. & Krasniqi, E. e konstatuan edhe në Vracë në lartësi mbidetare 2200-2350 m. Me 11.07.2013 (Millaku, F., Krasniqi, E., Mala, Xh.) këtë lloj e konstatuan edhe në lokalitetin Liqenet e Jazhincës në 2172 m lartësi mbidetare.	Subpopullacionet e këtij lloji në Bistër dhe Majë të Zezë janë me të mëdha dhe me stabile në krahësim me subpopullacionet tjera në Malet e Sharrit. Popullacioni në Vracë dhe subpopullacioni në Piribreg kanë shtrirje shumë të kufizuara, numri i individëve maturë në të dy këto lokalitete është i vogël dhe rrezikohen nga shembja e shkëmbinjeve dhe koleksionuesit.	I rrezikuar.
71	Potentilla montenegrina Pant. Emri shqip: Potentillë e Malit të Zi Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell lulorë 30-80 cm, anësorë, shumë të kreshpët me qime të dendura. Gjethet trishe; gjethëzat vezake të përmbysta deri vezake të përmbysta-gjatore, 35-80 x 20-40 mm, të sharruara ose të sharruara uraura, të gjelbra, me push në nervurën e mesit të faqes së poshtme; gjethëza skajore me bishtalec të qartë. Lulet të shumta. Nënpetlat trekëndore-heshtore deri vezake, majëmprehta. Kupëza me vriguj gjatë, shtytë ose gati majëmprehtë, më të shkurtër ose aq sa sepalet. Petalet 10-12 mm, të verdha, gati 2 herë me të gjata se sepalet. shtyllëza konike si fill, gati skajore. Akenët të shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë & Hercegovinë, Mali i Zi, Maqedoni, Bullgari).	Në Kosovë rritet në substrate gëlqerore (Pinion mugo) rrallë në silikate, në kullota, pyje ose vende shkëmbore të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Geum bulgaricum, Anthemis montana, Achillea abrotanoides, Edraianthus graminifolius, Pedicularis brachyodonta, Aconitum vulparia, Onobrychis scardica, Dianthus sylvestris, Ribes petraeum etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit), Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në EN - Blab(ii,iii)+2ab(ii,iii) - I rrezikuar. Bjeshkën e Lumëbardhit, Bister dhe Prevallë. Sipas Krivosej, Z. et al. (1995) është e përhapur edhe në pjesën veriore të Oshlakut në kuadër të formacioneve me Pinus mugo. Millaku, F. me 17.07.2013 i shoqëruar nga Isa Elezaj e konstatoi këtë lloj edhe në Kurvallë në lartësi mbidetare 2110 m e shoqëruar nga llojet Primula halleri, Gentiana lutea dhe Euphorbia montenegrina. Millaku, F. dhe Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan edhe në Zhleb në çeltira të pyllit të Hormoqit (Abieti Piccetum).	Subpopullacionet në Zhleb, Liqenak, Bjeshkë të Kurvallë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të individëve maturë. Edhe popullacionet në Oshlak dhe Bister kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

72	<i>Quercus robur</i> L. subsp. <i>robur</i> Emri shqip: <i>Rrënjë</i> Familja: <i>Fagaceae</i>	Dru 30-40 (-45) m i lartë (Fanerofite P) me lëvore të murme të errët, me brazda të gjëra për së gjati dhe të çara të cekëta të tërthorta, me kurorë vezë - kongjashme. Degët njëvjeçare të shogëta, rrallë me pak qime, të blerta, të përhimë ose të murme të kuqërreme. Sythet vezëngjashëm ose gati rozullor, shytë, rrallë majëmprehtë, 5-7 mm. Gjethet rënëse, zakonisht vezake të përmbyset ose gjatore-vezake të përmbyset, të shogëta, ose kur janë të reja përposh me push të paktë, me 5-7 palë vriguj, me po aq nervura kryesore si dhe me mjaft nervura të ndërmjetme, 5-15(-20) x 2.5-5(-10) cm me bishtak 2-5(10) mm. Lulet mashkull me 4-7(8) thekë, në lulesa 2-5 cm; lulet femër me nga 3 kreza të kuqe të zezërreme në lulesa me bishta 4-5 cm. Frytet piqen në vitin e parë, të vetmuara ose 2-5 në një bisht të përbashkët me gjatësi 3-6(-10) cm. Gishtja e lëmuar me mëlluga të sheshta, pushpaka, të ngjitura, me përjashtim të majave. Lëndët 2-4x 2-3 cm. Lulëzon IV-V. Frytton IX-X (Paparisto, K., et al. 1988).	Native dhe dominonte kryesisht në tokat e kafta ("brown soils") në pjesën më të madhe të Evropës duke përfshirë edhe disa pjesë të Mesdheut (Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet vetëm në ultësira të lumenjve (Drini i Bardhë, Morava e Binçës) në substrat aluvial i shoqëruar nga llojet: <i>Acer campestre</i> , <i>Ulmus campestris</i> , <i>Prunus armeniaca</i> , <i>Prunus spinosa</i> , <i>Crataegus monogyna</i> , <i>Lonicera caprifolium</i> , <i>Clematis vitalba</i> , <i>Ranunculus millefoliatus</i> , <i>Melanpyrum arvense</i> , <i>Trifolium pratense</i> , <i>Trifolium campestre</i> , <i>Galium verum</i> , <i>Phleum pratense</i> , <i>Rumex crispus</i> , <i>Verbascum phoeniceum</i> , <i>Centaurea cyanus</i> , <i>Sambucus ebulus</i> etj.	Zallq, Terbuhoc, Saradran, Nashec, Zllakuqan, Drobesh (Krasniqi, E. et al. 2011; Isufi, F. et al. 2011, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua më 21.05.2011 në Drobesh (E. Krasniqi); gjithashtu në Zllakuqan dhe Zallq më 21.05.2011 (E. Krasniqi). Prizren.	Lloji gjendet shumë rrallë, vetëm si individë në pesë lokalitete në Rrafshin e Dukagjinit dhe në një lokalitet në Anamoravë. Në lokalitetet e lartpërmendura numri i individëve maturë është 1 me përjashtim në Zallq ku janë hasur më shumë se një individ.	I rrezikuar.
73	<i>Ranunculus illyricus</i> L. Emri shqip: <i>Zhabinë ilirike</i> Familja: <i>Ranunculaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rrënjë të shumta, disa me trashime vezake, disa të holla. Kërçelli 20-50 cm, i hollë, i padegëzuar ose me degë të pakta. E gjithë bima ka qime të shtrira, të hirta të argjendta. Gjethet e bazës me bishtak të gjatë, me tre segmente vizake heshiore, të plotë ose të ndarë në 2-3 vriguj. Gjethet e kërçellit të ndarë në tre segmente; të sipërmet të plota, heshiore vizake. Lulet të verdha, me diametër 1,5-3 cm. sepale 5 vezake të ngushta, me qime të dendura të hirta të argjendta, në kohën e lulëzimit të kthyer poshtë. Petalet 8-15 mm të gjata, vezake-përmbysta deri të rumbulluara, me nektarie të gjatë në bazë. Shtrati i lules gjator, i shogët. Akenët të shumtë, deri 3 mm të gjatë, sqepthi i mprehtë, i drejt. V- VI.	Europa, Azia jugperëndimore Submediterane-Pontike.	Në Kosovë rritet në vende të thata ranore, shpatije të thata, kullota dhe shkurreta, kryesisht në substrat serpentini dhe karbonat. Në pjesën lindore të Pashtrikut rritet në kuadër të asociacionit: <i>Quercetum trojanae</i> dukagjinii, e shoqëruar nga llojet: <i>Veronica jacquini</i> , <i>Artemisia lobeli</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Pyrus eleagnifolia</i> , <i>Cerintho minor</i> , <i>Astragalus onobrychis</i> , <i>Alyssum desertorum</i> , <i>Asphodelus albus</i> , <i>Helianthemum nummularium</i> , <i>Linum tenuifolium</i> , <i>Euphorbia myrsinites</i> , <i>Scabiosa fumaroides</i> , <i>Calamintha acinos</i> , <i>Stachys recta</i> etj. Në Pashtrikun e Poshtëm (Qafa e Mullarit) në 1487 m lartësi mbidetare rritet në kullota subalpine të thata së bashku me llojet: <i>Onosma visianii</i> , <i>Centaurea kosaninii</i> , <i>C. atropurpurea</i> dhe <i>Jurinea mollis</i> .	Gjatë vitit 2012 Pajazitaj, Q. Millaku, F., Krasniqi, E. & Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan në Pashtrik, në vende të degraduara të pyllit <i>Quercetum trojanae</i> dukagjini ose pyllit të ahut në lartësi 800-1430 m. Me 29.05.2013 Millaku, F. e konstatoi në Pashtrikun e Poshtëm (Qafa e Mullarit) në kuadër të kullotave subalpine në 1487 m lartësi mbi detare. Mala, Xh. dhe Rexhepi F. (25.05 2012) këtë lloj e konstatuan edhe në Gallushë (Theranë) dhe Artanë (Novobërd).	Dy subpopulacionet e këtij lloji në Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre dy subpopulacioneve është shumë i vogël, në veçanti në Pashtrikun e Poshtëm ku janë konstatuar < 40 individë maturë. Populacioni më i ruajturi i këtij lloji dhe me numër të konsiderueshëm të individëve maturë gjendet në Gallushë (Theranë). Populacionet tjera të këtij lloji kanë numër relativisht të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

74	Rhamnus orbiculata Bornm. Emri shqip: Pjerzë rrethore Familja: Rhamnaceae	Gjysmëshkurre (Nanofanerofite NF) deri 1 m, me degë të pajisura me gjemba të dendura, me lëvore të murrme të kuqërreme. Degët e reja në të shumtën të shogëta, me majë gjembake. Gjethet 1-3,5 cm, rrotullore ose rrallë herë vezake ose eliptike, me 3-4 palë dejë, me gjëndra të imta në buzë, me dhëmbë shytë, përposh të shogëta ose me qime të pakta ndër dejë. Gjethet me llapë të gjatë 7-20 mm; ndajgjethëzat 2-3 herë më të shkurtra se bishtakët. Lulet 4-pesëshe, në cima ombrellore, të ngjashme me ato të <i>R. catharticus</i>. Frytet bërthokla të zeza, çarëse kur piqen, rreth 7 mm të mëdha, zakonisht me dy fara. Lul. VI-VII; fryt. IX. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Hercegovinë, Dalmaci, Mal i Zi, Shqipëri, Maqedoni, Greqi veriore.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror (400 deri 1670 m), shkëmbinj dhe vende të thata nga zona kodrinore (Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit) deri në zonën subalpine. Areali i këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit është shumë i kufizuar. Në Koritnik rritet në shkëmbinj në zonën e pyllit <i>Pinetum Heldreichii typicum</i>. Në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit rritet në kuadër të asociacionit <i>Columno Ostryetum</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Campanula versicolor</i>, <i>Ficus carica</i>, <i>Achillea ageratifolia</i>, <i>Jurinea mollis</i>, <i>Scabiosa fumaroides</i>, <i>Convolvulus cantabrica</i>, <i>Convolvulus althaeoides</i>, <i>Anthyllis vulneraria</i>, <i>Pistacia terebinthus</i>, <i>Carduus nutans</i>, <i>Fraxinus ornus</i>, <i>Teucrium polium</i>, <i>Asphodeline libumica</i>, <i>Seseli rigidum</i>, <i>Colutea arborescens</i>, <i>Ruta graveolens</i>, <i>Salvia ringens</i>, <i>Onosma stellulata</i> etj.	Sipas Josifovic et al. (1973) është e përhapur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe Koritnik.	Popullacionet e këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe Koritnik kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
75	Rhamnus pumila Turra [Oreohertzogi a pumila (Turra) W.Vent] Emri shqip: Pjerzë kënece Familja: Rhamnaceae	Gjysmëshkurre zakonisht dioike (Nanofanerofite NF), më rrallë monoike, deri 20 cm. Degët drunore me lëvore të hirtë, të përkulura, zvarritëse mbi shkëmbinjë. Gjethet vezake të përmbysta, eliptike ose gati të rumbullakëta, me diametër 15-20 mm, rrallë deri 4-6 cm, shumë të ndryshme nga forma e madhësia, buzë-dhëmbëzuara, me 4-9 (-13) pale dellëzime anësore, me ndajgjethëza vizake, 4-5 mm, rënëse. Lulet të verdha në të gjelbër, me dhëmbë të mprehtë, 2 mm, 3-4 anëtarëshe, rrallë 5-anëtarëshe. Fryti rrushk i zi topthor, 6-8 mm, me 3-4 fara. Lulëzon V-VI. Frytton VIII-IX. Qosja, Xh. et al.(1992).	Në malet e Evropës së mesme dhe jugore: Alpe, Pirineje, Apenine, Sardine, Ballkan.	Në Kosovë është konstatuar në substrat gëlqeror, në të çara të shkëmbinjve të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Potentilla speciosa</i>, <i>Potentilla visiani</i>, <i>Scabiosa graminifolia</i>, <i>Scrophularia bosniaca</i>, <i>Achillea holosericea</i>, <i>Isatis tinctoria</i>, <i>Helianthemum canum</i>, <i>Sedum rubens</i>, <i>Jovibarba heufeli</i>, <i>Anthyllis aurea</i>, <i>Globularia cardifolia</i> etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Oshlak (mbi fshatin Mushnikovë). Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur edhe në Pashtrik. Është e përhapur edhe në Brod.	Popullacionet e këtij lloji në Brod, Oshlak dhe Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

76	<i>Rhodiola rosea</i> L. Emri shqip: <i>Rodiola trëndafilore</i> Familja: <i>Crassulaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare 15-20 cm me stolone deri 12 cm (Hemikriptofite H). Rozetat 6-12 cm në diametër. Gjethet e rozetës heshtore me majë të shkurtër 15-30 x 7-9 mm nga të dy anët me qime gjëndërore, mishtore, në buzë gjëndërore deri qerpikore, të blerta, të mbyllta, me majë të kuqe, në bazë pak a shumë të bardha. Kërcellit me qime të dendura gjëndërore. Gjethet e kërcellit lineare, me majë, mishtore, me qime gjëndërore, 20-35x5-8 mm. Lulesa me qime të dendura gjëndërore. Lulet gati pabisht, 13-14 pjesëshe, të purpurta. Kupa me qime gjëndërore 7-9 mm të gjata, fletëzat e saj lineare deri lineare-heshtore, gati të mprehta 4-5 mm të gjata. Fletëzat e kurorës lineare 10-12 x 1mm, nga sipër të purpurta, buzëve të bardhëme, nga poshtë të blerta, në buzë dhe nga poshtë me qime gjëndërore. Thekët me gjatësi 6-7 mm, fillet me pak qime në bazë, anteret me ngjyrë të kuqe të çelët. Karpelet janë 6-7mm të gjata, të blerta. Shtyllëza është me ngjyrë të kuqe me gjatësi 3-3.5 mm. Lulëzon VI. Frynon VIII. (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Josifovic, M. et al. 1977, Polunin, O. 1997).	Rritet në substrat silikat-kvarcit ose ndonjëherë edhe në substrate gëlqerore dhe vende gurishtore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Anthemis montana</i> , <i>Saxifraga scardica</i> , <i>S. tridactylites</i> , <i>S. aizoides</i> , <i>Silene quadridentata</i> , <i>Silene exarata</i> , <i>Silene pusilla</i> , <i>Asplenium viride</i> , <i>Gentianella bulgarica</i> , <i>Gnaphalium supinum</i> , <i>Scrophularia laciniata</i> etj.	Malet e Sharrit (Prevallë-Bistra, Josifovic, M. et al. 1977, Rexhepi, F. 1986, 1994). Alpet Shqiptare (Gjeravicë dhe Kurvallë). Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) është e përhapur në Livadhishtë, Piribreg, Qukat e Liqenit (Jazhincës) dhe Bistër.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni në Gjeravicë është mjaft mirë i ruajtur dhe ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacionet i këtij lloji në Kurvallë dhe ne Malet e Sharrit kanë areal të kufizuar dhe numër me të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
77	<i>Ribes alpinum</i> L. Emri shqip: <i>Ribes alpine</i> Familja: <i>Grossulariaceae</i>	Shkurre (Fanerofite P) deri 2,5 m, pa gjemba, me degë të shogëta ose gati ashtu. Gjethet me 3-5 vriguj, me dhëmbë, të shogëta ose me pak qime, 2-6 cm; bishtaku shumë më i shkurtër se llapa, me gjëndërore qepallore. Bimë dioike, me lule njëseksore, me mbeturina të seksit tjetër, në vile të ngritura; boshtet lulore pushpakgjëndërore, të vendosura në sqetull të brakteve heshtore, të shogëta ose me qerpikë, pak më të gjata se bishti dhe lulet. Sepalet të shogëta, pa qerpikë, të hapura ose të kthyer nga poshtë. Petalet të blertërreme, pallake, 4-5 herë më të shkurtra se sepalet. Fryti rrushk i kuq, i shogët, pa shije. Lulëzon IV-VI, Frytnon VI-VII. Paparisto, K. et al. (1988).	Evropë, Azi perëndimore.	Në Kosovë rritet në pyje e vende me gurë të zonës subalpine dhe alpine kryesisht mbi substrat gëlqerorë ose edhe mbi silikate kristalore. Në Zhleb dhe Maje të Rusolisë rritet në zonën e pyllit të kërlekës (dredhakut) <i>Wulfenio Pinetum mugo</i> ose në kuadër të pyllit të përzier të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: <i>Acer heldreichii</i> , <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Pinus mugo</i> , <i>Acer platanus</i> , <i>Linum capitatum</i> , <i>Picea abies</i> , <i>Abies alba</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Zhleb, Maje të Rusolisë dhe Koritnik.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë (Koritnik, Zhleb dhe Maje të Rusolisë) kanë areal shumë të kufizuar dhe në të shumtën e rasteve ky lloj takohet në vende shkëmbore ose në kuadër të pyllit, në numër të vogël të individëve maturë. Në Zhleb dhe Maje të Rusolisë ky lloj rritet në kuadër të pyllit të përzier nga 1500-1800 m.	I rrezikuar.

78	<i>Saxifraga federici-augusti</i> subsp. <i>grisebachii</i> (Degen et Dörfler) D.A.Webb Emri shqip: Iriqëz e Grisebahut Familja: <i>Saxifragaceae</i>	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H), me kërcëj gjetheore shterpë të shkurtër që mbarojnë me rozeta gjetheore. Kërcëjtë lulorë të ngritur ose të përpjetëm, 10-20 cm, me gjethe të shumta, të mbuluar mbi gjithë gjatësinë me qime gjëndërore. Gjethet e rozetës pallake ose heshtore, 25-40 x 3-7 mm, shyta ose me thumb, me buzë të ngushtë kërcore, me shumë hidatoda; kërcelloret të kuqërreme me majë të gjelbër, pallake-vizake, 10-20 x 2-4 mm, me thumb në majë, me hidatoda të pakta. Lulet purpur, në vile sa 1/3 ose 1/4 e kërcellit, me 15- 25 lule. Sepalet 4-6 x 1.5-2 mm. petalet 1.5-2 x rreth 1 mm, sipër shpesh me dhëmbë të ç' rregullt. VI-VII. (Paparisto, K. et al. 1988)	Siujdhesa Ballkanike (Kosovë, Maqedoni – Matevski, V. et.al. 2007).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinjtë gëlqerorë (Vegetacioni i shkëmbinjtë) e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>Ramonda serbica</i> , <i>Mycelis muralis</i> , <i>Cyclamen hederifolia</i> , <i>Asplenium ruta-muraria</i> , <i>Galium lucidum</i> , <i>Ceterach officinarum</i> , <i>Sedum album</i> , <i>Campanula versicolor</i> , <i>Lamium garganicum</i> , <i>Leontodon hispidus</i> , <i>Cardamine glauca</i> , <i>Hieracium waldsteini</i> , <i>Eryssium helvetica</i> etj.	Sipas Saric et al. (1986) rritet në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Sipas Josifovic et al. (1977) subsp. <i>montenegrina</i> rritet në Malet e Sharrit (Oshlak). Millaku, F. me 09.05.2013 e konstatoi në shkëmbinjtë gëlqeror në vendin e quajtur Kosharishtë (Istogut mbi fshatin Syne) në 1407 m. Millaku, F. Pajazitaj, Q. dhe Mala, Xh. me 05.06.2013 këtë lloj e konstatuan edhe në Pashtrik në shkëmbinjtë gëlqeror të zonës subalpine.	Popullacionet e këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe në Oshlak kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni në Bjeshkët e Istogut është shumë i vogël dhe janë konstatuar <20 individ maturë. Ky është lokaliteti i parë i këtij lloji i konstatuar në Alpet Shqiptare (Kosovë) dhe Bjeshkët e Istogut. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve matur është <30.	I rrezikuar.
79	<i>Saxifraga taygetea</i> Boiss.et Heldr. Emri shqip: Iriqëz e Tajgetit Familja: <i>Saxifragaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj të shkurtër, pa filiza shterpë. Kërcelli rreth 20 cm, i ngritur, i degëzuar sipër, me qime gjëndërore. Gjethet e bazës 15-25 mm të gjëra , me 5-11 ura të gjëra ose vriguj, veshkore-rrotullore, ose pesëkëndore, me bisht; kërcelloret të pakta. Lulesa vastakore. Sepalet të ngritura të hapura, të ndara deri në fund, jo të ngjitura me vezoren. Petalet rreth 8 mm, eliptike-heshtore, të bardha me pika të kuqe, tri herë sa kupa. Vezorja e lirë; kapsula vezake-gjatore, me shtyllëza divergjente. VI-VII. (Paparisto, K. et al. 1988.	Pjesët jugore të Siujdhesës Ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Ky lloj në Kosovë është e përhapur në shkëmbinjtë silikat të freskët të zonave alpine në kuadër të vegetacionit të shkëmbinjtë shoqëruar nga llojet: <i>Gnaphalium sylvaticum</i> , <i>Ranunculus crenatus</i> , <i>Saxifraga carpatica</i> , <i>S. aizoides</i> , <i>S. sempervivum</i> , <i>Silene macrantha</i> , <i>Edraianthus graminifolius</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic et al. (1977) në Alpet Shqiptare është e përhapur në Gjeravicë, dhe Dervish Kom kurse në Malet e Sharrit mbi fshatin Brod.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) – I rrezikuar. Popullacionin i këtij lloji në Alpet Shqiptare e përbëjnë dy subpopullacione të vogla Foto: Fadil Millaku (2013), Gjeravicë (Gjeravicë dhe Dervish Kom) të cilat kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni mbi fshatin Brod ka areal shumë të kufizuar dhe gjithashtu numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

80	<i>Lomelosia crenata</i> (Cirillo) Greuter & Burdet [<i>Scabiosa crenata</i> Luce, <i>Asterocephalus crenatus</i> Spreng.] Emri shqip: - [Skabiozë ura-ura] Familja: Dipsacaceae	Bimë shumëvjeçare (Kamefite Ch), tufore e drunjëzuar në bazë, me kërcell 12-25 cm, i thjeshtë ose i degëzuar që nga baza, me gjethe në pjesën e poshtme. Gjethet e poshtme pallake, dhëmbë-dhëmbë, të sipërmet njëfish deri dyfish pendore të prera me segmente vizakë heshtorë. Kaptinëza me diametër 2-4 cm, zakonisht e vetmuar. Braktetë e pështjellës rreth 4 mm, sa 1/3 e gjatësisë së luleve, eliptike-vezake, dendësisht leshtore. Korona 3-5 mm, më e gjatë se gyp i pështjellës, me 26-29 nervura. Kreshtat e kupës 2-3 herë më të gjata se korona. Kurora e luleve anësore (10-)13-16(-20) mm, qartësisht më e gjatë se ajo e luleve qendrore, e trëndafilëlilila. Anterët rreth 1.7-2mm.VI-VIII. (Qosja, Xh. et al.1996).	Pjesët jugore dhe perëndimore të Siujdhesës Ballkanike (OrofiteMesdh etarejugore).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat karbonat, në vende shkëmbore e toka të thata deri në zonën subalpine. Në Grykën e Rusenicës rritet në kuadër të asociacionit Daphne-Juniperetum oxycedrii në lartësi mbidetare 1350 m e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Daphne oleoides, Ostrya carpinifolia, Achillea ageratifolia, Cerastium decalvans, Scabiosa lucida, Echium stelulatum, Carum graeca, Eryssimum helveticum, Potentilla verna, Hieracium wetsteini, Alyssum saxatile, Asplenium ruta muraria, Leontodon hirsutus etj.	Sipas Josifovic et al. (1977), është e përhapur në Oshlak dhe në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Me 06.07. 2012 Millaku, F. & Mala, Xh. e konstatuan në Grykën e Rusenicës.	Subpopullacionet e këtij lloji në Oshlak dhe Grykë të Lumëbardhit të Prizrenit kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të subpulacioneve. Popullacioni në Grykën e Rusenicës ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
81	<i>Lomelosia graminifolia</i> (L.) Greuter & Burdet [<i>Scabiosa graminifolia</i> L.] Emri shqip: - [Skabiozë gjethebari] Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare tufore (Kamefite CH), me qime të mëndafshita-të argjendta, e drunjëzuar në bazë, me kërcell 20-30 cm. i përpyetëm dhe me gjethe në 1/3- 2/3 e poshtme. Gjethet 50-80 x 3-5 mm, vizake, majëmprehta, të ngritura e të karenuara. Kaptinëza me diametër 3-4 cm, e vetmuar. Braktetë e pështjellës 7-10(-14) mm, trekëndore-vezake, sa ½-2/3 të gjatësisë së luleve. Gypi i pështjellës 3.5-4 mm. korona 3-4 mm, gati aq ose pak më e shkurtër se gypi, me 22-28(-30) dejë. Kreshtat e kupës gati aq sa korona. Kurora me lulet anësore rreth 20 mm, gati 2 herë më e gjatë se ajo e luleve qendrore, ngjyrë kaltroshe-manushaqe. VI-VIII. (Qosja, Xh. et al. 1996).	Evropa Jugore, Siujdhesa Ballkanike. Sipas Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996) është e përhapur në Maqedoni, (Orofite-Evropianojugore).	Në Kosovë ky lloj është konstatuar vetëm në Pashtrik në substrat gëlqeror në kuadër të vegetacionit të shkëmbinjtë të zonës subalpine (Asplenietea rupestris). Rritet në komunitet me llojet: Potentilla speciosa, Scrophularia bosniaca, Rhamnus pumilla, Achillea holosericea, Dianthus sylvestris, Helianthemum canum, Sedum rubens, Jovibarba heuffelii, Anthyllis aurea, Globularia cardifolia, Arctostaphylos uva-ursi etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) është e përhapur në Pashtrik.	Në Kosovë është konstatuar vetëm një popullacion i vogël i këtij lloji në zonën subalpine të Pashtrikut në lartësi 1783 m afër kufirit me Republikën e Shqipërisë. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar por ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar.

82	<i>Scrophularia bosniaca</i> G.Beck. Emri shqip: <i>Sarushhtë bosnjake</i> Familja: <i>Scrophularia ceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rrënjë të drunjëzuar, të trasha. Kërçelli 50-80 cm, i përpijetë, pa gjethe në bazë, i purpurt, me qime të pasura gjëndërore, i gjetthuar deri në majë. Gjethet e poshtme të përkundrejta, të sipërmet të këmbyera, të gjitha me bishtak, gjethet e mesit të kërçellit në drejtim të majës, gjithnjë më të vogla dhe me bishtak më të shkurtër; të poshtmet 8-10 x 3-4.5 cm, të gjëra , në bazë të cunguara, me bishtak gati 2 herë më të shkurtër se llapa; gjethet e mesit gjatore vezake, me majucë; gjethet e tjera heshtore, menjëherë të ngushtuara në bishtak të shkurtër, të gjitha në buzë me dhëmbë të dyfishtë rezhdor, në të dy faqet, posaçërisht në bishtak, me qime gjëndërore. Lulesat dalin nga sqetullat e gjetheve; këmbëzat si dhe braktetë e tyre me qime gjëndërore, më vonë lakohen poshtë. Sepalët vezake, pothuaj gati të mprehta, të shogëta ose me gjëndra të rralla, të imta, me buzë të gjelbra ose jo. Kurora 3-4 herë më e gjatë se kupa, e gjelbër-e murme. Staminodi i shkurtër, vezak-përmbysët. Fillet e thekeve me gjëndra të shumta. Shtyllëza e shogët, kreza me puprri. Kapsula tophore, ngushtohet në drejtim të krezës. VI-VII. (Qosja, Xh. et al. 1996).	Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovinë, Dalmaci (subendemike)	Në Kosovë është e përhapur zakonisht në shkëmbinj karbonat dhe silikat të zonës subalpine dhe alpine nga 1500-2300. Në shkëmbinj silikat rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Lamium galeobdolon</i>, <i>Jovibarba heuffeli</i>, <i>Stachys alpina</i>, <i>Senecio rupestris</i>, <i>Rosa pendulina</i>, <i>Anthemis montana</i>. Në substrat gëlqeror shoqërohet nga llojet: <i>Potentilla</i> Foto: Fadil Millaku (2013), Pashtrik speciosa, <i>Rhamnus pumilla</i>, <i>Achillea holosericea</i>, <i>Isatis tinctoria</i>, <i>Sedum rubens</i>, <i>Jovibarba heufeli</i>, <i>Globularia cardifolia</i>, <i>Lamium garganicum</i>, <i>Campanula versicolor</i>, <i>Sedum dasyphyllum</i>, <i>Reseda luteola</i>, <i>Corydalis ochroleuca</i>, <i>Geranium lucidum</i>, <i>Micromeria cristata</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkë te Lumëbardhit, Maje te Rusolisë). Millaku, F. Pajazitaj, Q., Krasniqi, E. & Mala, Xh. me 21.07.2011 këtë lloj e konstatuan në Pashtrik, Millaku, F. dhe Mala, Xh. me 06.07. 2011 e konstatuan në Malet e Mushtishtit (Rusenice), Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. me 31.07.2011 e konstatuan në Malet e Sharrit (Guri i Zi).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit kanë numër shumë të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve.	I rrezikuar.
----	--	--	---	---	---	--	---------------------

83	Scutellaria alpina L. Emri shqip: Skutolare e Alpeve Familja: Lamiaceae	Gati gjysmëshkurre (Kamefite Ch), me kërcëj deri 30 cm, të përpjetëm, të thjeshtë ose të degëzuar, pak a shumë pushlore. Gjethet 1.5-3 cm, vezake, rrallë heshtore, ura-ura të sharruara, rrallë gati të plota, zakonisht shytë, pak a shumë pushlore; të poshtmet me bishtak 3-8 mm; të sipërmet pak a shumë të pabisht, buzët jo të sipërveshura. Lulesa e dendur, gjatore, 204 cm, pak a shumë 4-këndore. Braktetë heshtore të thepëta, 8-13 x 4-6 mm, të plota, e kalojnë kupën, të vendosura si tjegulla, të pabisht, si purpur, rrallë të gjelbra, pak a shumë pushlore. Kupa 5-6 mm. kurora 20-25 mm, purpur ose manushaqe, me gyp pak a shumë pushlore nga jashtë. VI-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996).	Evropa Qendrore dhe Jugore, Kaukaz, Azi e Vogël.	Në Kosovë janë konstatuar dy popullacione të vogla të këtij lloji që shtrihen në substrate gëlqerore dhe dolomit (në vende gurishtore e shkëmbore të pjerrëta) të zonave të larta malore. Në Luboten është konstatuar në lartësi mbidetare 1987 m e shoqëruar nga llojet: Anthyllis aurea, Juniperus sibirica, Helianthemum alpestre, Onobrychis scardica, Stachys alopecurus, Drypis spinosa, Teucrium montanum, Anthyllis vulneraria, Sedum acre, Trifolium badium etj. Në Koritnik rritet në 2386 m lartësi e shoqëruar nga llojet: Minuartia baldaci, M. verna, Thlaspi bellidioides, Edraianthus graminifolius, Helianthemum canum, Achillea chrysocoma, Jovibarba heuffeli, Saxifraga paniculata, Salix reticulata etj.	Luboten, Koritnik, Bjeshka e Opojës-Karanikollë (afër majës).	Popullacionet e këtij lloji në Luboten dhe Koritnik kanë areal shumë të kufizuar. Ky lloj në Luboten është i përhapur në ekspozicionin lindor të zonës subalpine-alpine në vende gurishtore. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe individët e këtij lloji zakonisht rriten në tufë në vende ku deponohen gurët e shembur nga maja e Lubotenit.	I rrezikuar.
84	Scutellaria orientalis L. Emri shqip: Skutolare e Lindjes Familja: Lamiaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj të shtrirë, pushbutë me qime të shpërndara, 10-30 cm. gjethet (0.5-) 1-1.5 (-3) x 0.5-2 cm, vezake-gjatore deri gjërësisht vezake, thellësisht ura-ura-dhëmbë-dhëmbë deri pendore të prera, me vriguj vezakësheshtorë ose vizakë, të cunguar në bazë, pushlore përsipër, pushbutë-të hirta përposh, me bishtak; buzët zakonisht të shpërveshura. Lulesa e dendur, gjatore zakonisht katërkëndore. Braktetë 5-12 mm, zakonisht e kalojnë kupën, të vendosura si tjegulla, vezake ose pak a shumë heshtore, të plota, të mprehta, disi cipëthata, si pluhur ose të verdha-të gjelbra, të shogëta deri pushlore. Kurora 15-30 (-35) mm, e verdhë, rrallë e trëndafilte; buza e poshtme shpesh e kuqërremtë. V-VII. Qosja, Xh. et al. (1996).	Siujdhesa Ballkanike.	Është e përhapur në vende të thata e shkëmbore zakonisht gëlqerore apo serpentine në kuadër të pyllit të degraduar të dushkut Quercetum pubescentis cerris dhe Quercetum trojanae dukagjini e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Quercus cerris, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Salvia ringens, Jurinea mollis, Onosma aucherianum, Anthericum liliago, Campanula lingulata, Sanguisorba minor, Silene vulgaris, Convolvulus cantabrica, Valerianella coronata, Potentilla astracanica, Hypericum barbatum etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Rexhepi, F. (1983, 1977) është e përhapur në Pashtrik, (Gorozhub, Vermicë) dhe Mirushë. Këtë lloj gjatë vitit 2013 e kemi konstatuar edhe në serpentine të Krevenikut (Elez Han).	Në Kosovë janë konstatuar tre popullacione të vogla të këtij lloji. Popullacionet e këtij lloji në Krevenik, Mirushë dhe Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.

85	<i>Selaginella selaginoides</i> (L.) Link [Selaginella spinulosa A. Braun] Emri shqip: <i>Selaginellë si selaginëz</i> Familja: <i>Selaginellaceae</i>	Bimë e vogël me pamje të myshqeve, me kërcëz zvarritës e rrënjëlëshues, me degëza të holla, me simetri rrezore, 3-15 cm, të ngritura. Gjethet 1-3 mm, të gjitha të ngjashme, me renditje spiralore, me 1-5 dhëmbë të mëdhenj në çdo anë. Kallirret spornbajtës 1-5 cm, të trasha, të verdheme. Riprodhohet gjatë VII-IX. (Pajazitaj, Q. 2004).	Në malet e Evropës: (Pirineje, Alpeve, Karpate, Ballkan), Kaukazit, Siberisë, Kamçatkës, Amerikës Veriore (Arkto-Alpikë).	Në Kosovë ky lloj rritet në vende me lagështirë të zonës alpine, kryesisht në kuadër të pyllit të kërkëkës (Pinus mugo) ose në vende moçalore e shoqëruar nga llojet: Parnasia palustris, Sanguisorba officinalis, Veratrum album Potentilla palustris, Veratrum album dhe lloje nga gjinia Carex sp. ose Juncus sp.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Saric et al. (1986), Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984), Randjelovic, et al. (1983), Josifovic et al. (1977), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit, Malet e Sharrit (Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Luboten, Guri i Pavllovit).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit dhe Malet e Sharrit (Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Luboten, Guri i Pavllovit).	I rrezikuar.
86	<i>Tephrosia crassifolia</i> (Schult.) Griseb. & Schenk [Senecio bosniacus Beck, Senecio crassifolia Willd.] Emri shqip: - [Pulith e Bosnjës] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur, me qime leshtore-të ndërthurura, më vonë bëhet e shogët. Gjethet e reja me qime të rralla leshtore-të ndërthurura, gati të shogëta. Gjethet e bazës gjatore-vizake, gradualisht ngushtohen në bishtak të shkurtër, buzëplote ose me dhëmbë harkorë; gjethet e kërcellit të shumta, gjatore-vizake, më të gjata se ndërrnyjat. Kaptinëzat në diametër 3-5 cm, vastakore, me 3-10 kaptinëza; këmbëzat 1-6 herë më të gjata se mbështjella. Braktetë e pështjellës të gjelbra, me qime leshtake. Lulet të verdha. Lulet llapore 10-20 mm të gjata, 2-3 herë më të gjata se pështjella. Xhufka gati sa tub i kurorës, shumë më e gjatë se fryti. Akeni i shogët ose me qime të rralla. Lulëzon VI-VII. Frymon VII-VIII.	Kosovë, Shqipëri, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi. (Ilirike)	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në kuadër të kullotave subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Achillea millefolium, Liliun albanicum, Aster alpinus, Dianthus sylvestris, Achillea chrysocoma, Armeria alpina, Edraianthus graminifolia, Sesleria nitida, Hieracium villosa, Galium constrictum, Vicia sp. etj.	Sipas Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1977, 1975) është e përhapur në Majën e Cerovës (Cerovacki vis) dhe Koritnik. Millaku, F. me 29.05.2013 e konstatoi në Pashtrik në zonën kufitare me Shqipërinë në kullota të zonës subalpine.	Popullacioni e këtij lloji në Koritnik shtrihet në zonën alpine dhe ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të Popullacionit.	I rrezikuar.
87	<i>Senecio doronicum</i> L. subsp. glaberrimus (Rochel) Simonkai Emri shqip: <i>Pulith doronike</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-60 cm. Kërçepi i shkurtër. Kërcejtë të trashë, të ngritur, të thjeshtë, rrallë të degëzuar në lulesë, me qime të mërimangëta ose të shogëta. Gjethet e bazës rrotullore ose pykore në bazë gati të shogëta përsipër, të trasha dhe lëkurore, eliptike deri vezake, me dhëmbë të imët deri gati të plota, gati majëmprehta, kërcelloret e poshtme të ngushtuara në bazë, të sipërmet të pakta gjatore të përmbysta deri vizake-heshtore të pabisht. Kaptinëzat 30-50 mm në diametër, të vetmuara ose rrallë në vastak. Pështjella	Evropa Jugore.	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat në vende shkëmbore ose në shëmtira të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Lamium garganicum, Potentilla calabra, Juncus trifidus, Geranium reflexum, Vaccinium uliginosum, Dryas octopetala, Campanula alpina, Crepis albanica, Geum reptans, Primula minima etj.	Gjatë vitit 2011-2013 këtë lloj e kemi konstatuar në Malet e Sharrit (Vracë dhe Maja e Zezë).	Ky lloj në Kosovë formon dy popullacione. Popullacioni i këtij lloji në Vracë ka areal të kufizuar por numri i individëve maturë është i konsiderueshëm. Popullacioni i këtij lloji në Majën e Zezë ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në këtë lokalitet ky takson arrin deri në 2580 m lartësi mbi detare.	I rrezikuar.

		10-15 mm, pak a shumë me qime të marimangëta-leshtore, me 12-20 brakte shtesë. Lulet llapore 12-20 mm, të verdha të zbehta. Akenet 5-7 mm, të shogët. Lulëzon VI-VIII. Frynjon VIII-IX.					
88	<i>Tephrosia papposa</i> (Rchb.) Schur [Senecio procerus (Gris.) Boiss.] Emri shqip: - [Pulith i lartë] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të përpjetë, në fillim leshtak, më vonë i shogët. Gjethet e reja leshtake, nga sipër pothuaj bëhen të shogëta, të gjelbërta - të errët, të lëmuara, nga poshtë pak a shumë leshtake ose të shogëta. Gjethet e bazës të mëdha, vezake ose heshtore-vezake, ngushtohen në bishtak të shkurtër; gjethet e kërcellit gjatore ose vizake; gjethet e mesit të kërcellit pak a shumë të barabarta me ndërnjat. Kaptinëza 3-5 cm në diametër, rrezore, në lulesë të çlirët vastakore, të thjeshtë ose të përbërë, me shumë kaptinëza; këmbëzat e kaptinëzave 2-10 herë më të gjata se ato. Braktetë e pështjellë ngjyrë kafe, leshtake deri të shogëta. Lulet të verdha; lulet gjuhëzore 10-15 mm të gjata. Xhufka më e gjatë se tub ii kurorës dhe i akenit. Akeni i shogët. Lulëzon V-VIII, frynjon VIII-IX.	Siujdhesa Ballkanike (Kosovë, Shqipëri, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari - Endemike-Ballkanike).	Është e përhapur në substrat gëlqeror, serpentin dhe silikat në vende barishtore dhe shkëmbore në bashkësitë: Lamieto-Brometum erecti, Semperviveto-Seslerietum argenteae), në pyje (Fageto-hyrcaneto-columetum, Piceetum excelsae dhe Sorbetomughetum - në shkëmbinjtë gëlqerorë). Në Pashallarë është konstatuar në zonën subalpine të pyllit të kërkles (Pinetum mugo) e shoqëruar nga llojet: Bommuelleria diecki, Pinus mugo, Lilium albanicum, Gentiana punctata dhe Gentiana lutea.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) është e përhapur në Malet e Sharrit (Bistra, Pashallarë) dhe Alpe Shqiptare (Zhleb-Rusoli).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Bistra) dhe Alpe Shqiptare (Zhleb-Rusoli) kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
89	<i>Senecio scopolii</i> Hoppe & Hornsch. [Senecio lanatus Scop.] Emri shqip: Pulith i Skopolit Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me kërcell të trashë. Gjethet bazale vezake, rrotullore ose pykore në bazë, pak a shumë të ngushtuara në një bishtak, gati të shogëta përsipër, me qime të merimangëta-leshtore përpos të holla dhe të buta. Kaptinëza me diametër 30-60 mm, e vetmuar. Pështjella 10-15 mm, me qime të merimangëta-leshtore, me 12-20 brakte shtesë afërsisht sa 1/2 e gjatësisë së pështjellës. Lulet llapore 12-17, të verdha të zbehta. Vangjeli, J. et al. (2000)	Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në kuadër të kullotave të thata subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Jovibarba heuffeli, Dianthus integer, Dianthus sylvestris, Achillea chrysocoma, Anthyllis aurea, Achillea canescens, Poa sp. etj.	Sipas Stevanovic, V. et al. (1999) është e përhapur në Koritnik dhe Pashtrik. Millaku, F. me 29.05.2013 e konstatoi këtë lloj në Pashtrikun e Poshtëm (1487 m).	Popullacioni e këtij lloji në Koritnik ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të pupulacionit. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik ka areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë, në veçanti në pjesën perëndimore të Majës së Pashtrikut (në drejtim të Pashtrikut të Poshtëm).	I rrezikuar.

90	<i>Silene retzendorffiana</i> (K. Maly) Neumayer subsp. nicolicii Seliger & Wraber Emri shqip: Klokëz e Retsderfit Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-20 cm, me kërcëj të shumtë, tufore, dëndesisht leshtake me qime gjëndërore të gjata dhe me qime jogjëndrore, me 4-8 palë gjethe. Gjethet vizake-heshtore deri vezake të përmbysta-heshtore. Kupa 4-6 mm me 10 nervura, kambanore, gjatë frytnimit deri 8 mm. Petlat të bardha; thonjëzat të shogëta. Kapsula ovoide, paksa më e gjatë se karpofori. Kreshta kurrizore e farës sa 1/5 e diametrit të saj. Lulëzon V-VI, polenizimi kryhet me insekte (entemofilia). Frynnon VII-VIII Riprodhohet në mënyrë vegjetative dhe me farë që përhapën me anë të erës. Paparisto, K. et al. (1988).	Kosovë, Shqipëri.	Rritet në substrat karbonat, në të çara të shkëmbinjve (bimë hazmofite), nga 500-1000 m lartësi mbidetare; e shoqëruar nga llojet: Saxifraga grisebachiana, Achillea ageratifolia, Corydalis ochroleuca, Rhamnus pumila, Rhaamnus orbiculatus etj.	Sipas Stevanovic, V. et. al (1999, 1993), është e përhapur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe në Oshlak (Mbi fshatin Sredska, Bogoshevë, Mushnikovë).	Popullacioni i këtij taksoni shtrihet nga Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe vazhdon deri në Oshlak. Zakonisht takohet në numër te vogël të individëve maturë të cilët paraqiten në tufa të vogla ose rrallë edhe si individ të vetmuar, që shtrihen në të çara të shkëmbinjve.	I rrezikuar.
91	<i>Taxus baccata</i> L. Emri shqip: Tisi Familja: Taxaceae	Shkurre ose dru (Fanerofite P) deri 15-20 m, me kurorë piramidore të gjërë. Degët të këmbëra në mënyrë të ç'rregullt. Halat vizake, me majucë, përpos me dy rriptha gojëzash të blerta të zbehta, përsipër të blerta e të shndritshme, 10-30 x 2-3 mm. Lulet mashkull të përbëra prej 6-14 luspash me 4-8 qeskëza pjalmore në faqen e poshtme. Lulja femër përbëhet nga një bosht i shkurtër i mbuluar me luspa, në majën e të cilit qëndron një vezëz e vetme. Fryti rrushk i rremë, me mish të kuqërremë (aril). Farat 6-7 x 4-5 mm, me dy, rrallë me tre ose me katër brinjëza për së gjati. Lulëzon IIIIV. Frynnon VIII-IX (Paparisto, K. et al. 1988).	Evropë veriore, Spanjë, Mediteran, Bellorusi dhe Kaukaz (Tutin, T. G. et al. 1964, Josifovic, M. et al. 1970, Polunin, O. 1997, Vladimirov, V. et al. 2007).	Në Kosovë rritet në pyje me ah dhe me bredh në kuadër të fitocenozave: AbietiFagetum moesiaceae dhe Pinetum heldreichii typicum. Në lokalitetin Belle (Alpet Shqiptare-Njësia Menaxhuese "Pleqe Qëli") gjendet në kuadër të fitocenozës Pinetum heldreichii typicum. Është identifikuar vetëm 1 individë i tisi në shoqëri me llojet: Pinus heldreichii, Pinus poeuce, Abies alba, Pinus sylvestris. Në lokalitetin Baballoq (Alpet Shqiptare-Njësinë Menaxhuese "Kozhnër Roshkodol") gjendet në pyllin e ahut me bredh. Janë identifikuar 2 individë të tisi bashkë me llojet: Abies alba, Fagus sylvatica, Pinus peuce. Në Lybeniq (Alpet Shqiptare-"Koprivnik"-Pejë) gjendet Foto: Fadil Millaku (2011), Koritnik gjithashtu në pyllin e ahut me bredh. Është lokaliteti me shtrirje më të madhe sipërfaqësore dhe numër të trungjëve të tisi në Kosovë. Është identifikuar mbi fshatin Lybeniq në vendin e quajtur Tëbanet e Osës. Tisi paraqitet individualisht apo në grupe të vogla, në distancë te ndryshme nga	Alpet shqiptare (Malet e Deçanit, Bjeshkë e Junikut, Maja e Rusolisë, Belle, Baballoq, Lybëniq), Koritnik (Shabanaj, H., et al. 2008, Rexhepi, F. 1994, 1997, MMPH (2008)). Gjendja e llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe në Malet e Mushtishtit (lokalitetet: Vrellë, "Guri i Musës" në numër të vogël të individëve).	Edhe pse haset në disa lokalitete në Alpet Shqiptare, Koritnik dhe Malet e Mushtishtit; popullacionet e këtij lloji kanë numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

				njëra tjetra në një sipërfaqe prej afro 3 ha. Llojet shoqëruese: Abies alba, Fagus sylvatica, Pinus peuce. Në Koritnik (Njësisë Menaxhuese “Koritnik I”) gjendet në kuadër të pyllit të ahut me bredh. Janë identifikuar 2 individë të tistit bashkë me llojet: Abies alba, Fagus sylvatica, Pinus peuce.			
92	Tozzia alpina L. subsp. carpatica (Woloszczak) Dostal Emri shqip: Tozia Familja: Orobanchaceae	Bimë shumëvjeçare, gjysmëparazite, e degëzuar (Hemikriptofite H). Kërçelli 8-35(50) cm e lartë, e drejtë, lehtë këputet. Gjethet të përkundrejta, të lëmuara, të trasha, në pjesën e sipërme të plota, në pjesën e sipërme të kërçellit me dhëmbëz të imët. Lulet të vetmuara të cilat grumbullohen në lulesë në maje të degëve, bishti i lules 3-6 mm i gjatë, kupa 4-7 mm e verdhë e bardhmë. Thekët 0.5-1 mm të gjatë. Fruti topthor njëpjesësh me vriguj, ka 1-2 fara. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Stevanovic, V. et al. 1999).	Evropë (Tutin, T. G. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në lugina me rrjedhë uji të zonës subalpine deri alpine. Shoqërohet nga llojet: Trollius europaeus, Caltha palustris, Cirsium appendiculatum, Gymnadenia frivaldii, Veratrum album, Geum coccineum etj.	Malet e Sharrit (Gjimibeg, Vracë, Shutman, Piribreg, Përroi i Durlit), Alpet Shqiptare (Koprivnik) (Stevanovic, V. et al. 1999).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
93	Trifolium wetsteinii Dorfler & Hayek Emri shqip: Trifil i Vetshtainit Familja: Fabaceae	Është bimë barishtore shumëvjeçare (Terofite T). Kërçelli i ngritur me qime të bardha të palosura. Gjethet të vogla, ovale, të përmbysta. Ndajgjethëzat në baze membranore, kah maja gjatore, pa majë, me nervura të dalluara të zgjatura, me dhëmbë të shkurtër. Kupa në bazë është e bardhë, e shoget, kah maja e kuqërremtë ndonjëherë me qime të rralla, dhëmbët e kupës janë të purpurtë, të mbyllët, të njëjtë me gjatësinë e tubit. Kurora është ngjyrë trëndafili. Kaptina është pabisht, më e shkurtër se gjethet e sipërme me 12-20 lule. Lulëzon VII. Frytton VIII. (Rexhepi, F. 1986).	Shqipëri, Kosovë (Rexhepi, F. 2000, Tutin, T. G. et al. 1968).	Në Kosovë (Pashtrik dhe në Malet e Sharrit - Oshlak) gjendet në kullota të thata e shkëmbinjtë gëlqeror subalpin-alpin në shoqëri me llojet: Potentilla visiani, Onosma echinoides, Potentilla speciosa, Aster alpinus, Thymus longicaulis, Genista sylvestris, Dianthus integer, Arctostaphylos uva-ursi, Cerastium decalvans etj.	Sipas Rexhepi, F. (1982, 1986, 1994, 2000), Saric, M. et al. (1986), Diklic, N. & Nikolic, V. (1980), Nuhui-Daka, M. (2006), Nuhui-Daka, M. et al. (2008) ky lloj gjendet në Pashtrik dhe në Malet e Sharrit (Oshlak, Cerevacki Vis, Virovi).	Popullacionet e këtij lloji në Pashtrik dhe Oshlak kanë përhapje të kufizuar me numër jo të shumtë të individëve maturë.	I rrezikuar.

94	Viola grisebachiana Vis. Emri shqip: Manushaqe e Grisebakut Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pa kërcell 3-10 cm. Gjethet vezake – rrotullare 1.5-3 cm, shytë, të plota ose lehtësisht ura-ura, gati të shogëta, që ngushtohen menjëherë në një bishtak relativisht të gjatë. Ndajgjethëzat si gjethet por me të vogla. Lulet rreth 2 cm, bazale, ngjyrë manushaqe. nënpetlat të gjëra shytë. Petlat anësore të drejtuara nga lartë. Shpori 3-4 mm, shytë me i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërnylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në frytnim, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Ballkanike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Greqi, Serbi).	Në Kosovë ky lloj është i përhapur në shkëmbinj gëlqeror rallë në kullota të thata të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Potentilla apennina, Saxifraga aizoon, Minuartia doerfleri, Thlaspi bellidifolium, Dryas octopetala etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) Josifovic, M. et al. (1972) është e përhapur në Malet e Sharrit (Koritnik, Livadhishitë, Luboten, Kobilicë, Piribreg) dhe në Alpet Shqiptare të Kosovës (Maja e Rusolisë).	Edhe pse në Kosovë ky lloj formon disa popullacione/subpopullacione të vogla në Malet e Sharrit dhe Alpe Shqiptare; popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë janë me areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve/subpopullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.
95	Asperula aristata L. Emri shqip: Njëgjire halëzuar Familja: Rubiaceae	Filizat e rinj të blertë ose të përhimët- të blertë, të drunjëzuar në bazë ose barishtor. Kërcejtë 10-60 cm, shpesh me puprri deri me qime të shkurtra poshtë, zakonisht gati të shogët lart. Gjethet (10-) 15-25 (-40) x 0.5 – 2 mm, në qerthuj prej 4, heshtore deri vizake, me majë të shkurtër hialine zakonisht 0.1 - 0.2 mm. Lulesa e degëzuar lirshëm; braktet të lira. Kurora hipokrateriforme deri gati hinkëngjashme; gypi 2-3 (-4) herë më i gjatë se vrigujt. Fryti me pupërrë, rallëherë leshtor. Lulëzon V-VII. Frytëzon VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996)	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni – Matevski et al. 2011).	Rritet në substrate gëlqerore të zonës malore në kuadër të asoc. DaphneJuniperetum oxycedrii e shoqëruar nga llojet: Ostrya carpinifolia, Daphne oleoides, Coronilla emeroides, Silene saxifraga, Crepis hirsutus, Hieracium wetsteinii, Ramonda serbica, Minuartia verna, Centaurea splendens, Galium lucidum, Stachys recta, Coronilla elegans, Erysimum helveticum, Cotonaster tomentosus, Amelanchier ovalis, Achillea ageratifolia.	Malet e Sharrit (Gryka e Rusenicës).	Popullacioni i këtij lloji në Rusenicë ka një përhapje shumë të kufizuar por ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	I përkeqë-suar
96	Galatella albanica Degen [Aster albanicus (Degen) Degen] Emri shqip: - [Aster shqiptar] Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-35 cm e lartë. Kërçelli i përpjetëm deri i ngritur, me qime të mërimangëta-tufore përposh. Gjethet heshtoret përmbysta deri pallake, gjëndërore, me qime të mërimangëta-leshtore. Kapitnëzat në vastak të çlirët ose të vetmuara, me bisht të gjatë. Braktetë e pështjellës në tre radhë, të jashtmet e të mesit vizake-heshtore, me majë të fëndyellët, të brendshmet majëmprehta, me buzë të gjëra cipëthata. Lulet llapore 12-14, vjollcë. Qimet e xhufkës të pabarabarta. Lulëzon VII-IX, frytëzon IX-X. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike (Subendemike), Kosovë, Shqipëri. Sipas Tutin et al. (1976) është i përhapur në malet midis Shqipërisë dhe Kosovës.	Rritet në substrate serpentine dhe kullota të zonës malore në kuadër të asoc. AsteroJuniperetum oxycedrii e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Forsythia europaea, Aristolochia merxmulleri, Euphorbia glabriflora, Echium rubrum, Halacsya sendtneri, Genista hassertiana, Sedum serpentinum, Sedum hispanicum, Veronica andrazovszkyi, Gladiolus illyricus, Sanguisorba albanica, Linum tauricum, Potentilla astracantha [P. hirta].	Sipas Krasniqi, E. (2003, 2006), Josifovic, M. et al. (1975), Blečić V., et al. (1969), Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. & Millaku, F. (2004), Krasniqi, E. et al. (2012), Rexhepi, F. Foto: Fadil Millaku (2013), Mushtisht (2000) është e përhapur në serpentine të Kosovës (Rajoni i Murrshës, Murrshë, Llapçevës, serpentinët e Mushtishtit (Bokat e Mushtishtit, Grejkocit dhe	Në Kosovë popullacionet e këtij lloji gjenden afër vendbanimeve dhe nën ndikimin e kullotjes intensive. Në lokalitet ku rritet ku lloj shpesh takohen deponi të mbeturinave dhe gurrthyes të cilët dëmtojnë habitatin e këtij lloji.	I përkeqë-suar

					Korishit), Qafë Prush, Pllanik-Morinë. Sipas Rexhepit (2000) është e përhapur në Planik, Çeret, Luginë të Ibrit, Koprivë, Gllanasellë-Godanc, Kramavik, Koznik dhe Çerret.		
97	<i>Gentiana lutea</i> L. Emri shqip: <i>Sanëza</i> Familja: <i>Gentianaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me rizomë shumë të shkurtër e cila degëzohet në 2-10 rrënjë të gjata dhe të trasha. Kërccoli është i thjeshtë 60-90 (100) cm i gjatë. Gjethet janë vezake të mëdha me nervura. Gjethet e poshtme me bisht, të sipërmet pabisht. Lulet të vendosura në qerthuj. Kurora e verdhë, me të ndara shumë më të gjata se tubi. Riprodhohet me fare. Lulëzon VI-VIII. Frytton VII-IX. (Rexhepi,F. 1986).	Evropa, Azia e Vogël.	Rritet në kulllosa, në qafa të maleve të zonave subalpine dhe alpine, në substrat gëlqeror, silikat dhe serpentineror. Është konstatuar në kuadër të asociacioneve të ndryshme e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Onobrychis scardica, Achillea alexandriensis, Polygala major, Senecio wagneri, Pinus mugo, Valeriana officinalis, Veratrum album, Lilium albanicum etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) gjendet në Pashtrik, sipas Millaku, F. (2005) gjendet në Alpet Shqiptare (Gjeravicë), Rexhepi, F. (1986) e përshkruan në Zhleb dhe Mokna. Gjatë viteve 2010-2013 këtë lloj e kemi konstatuar në shumë lokalitete në Alpet Shqiptare(Maja e Rusolisë, Bjeshka e Lumëbardhit, Liqenak, Bjeshkë të Strellcit, Pleçe, Bjeshkët e Istogut (mbi syne, Bjeshkë të Kaliqanit), Lipë, Maja e Vjellakut, LlazBelapaç, dhe në Malet e Sharrit (Brod, Vracë, Rudokë, Gjimbeg, Malet e Mushtishtit, Pashallarrë, Balka e Madhe, Koritnik, Oshlak, Përroi i Durlit, Shtëpia e Malorëve etj.).	Edhe pse ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione; ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në kuadër të Maleve të Sharrit, Popullacioni i këtij lloji në gjendje më të mirë ka qenë në Bjeshkët e Mushtishtit (Pashallarrë). Edhe ky popullacion është dëmtuar si pasojë e zjarreve që kanë ndodhur në dhjetë vitet e fundit. Në kuadër të Alpeve Shqiptare popullacionet e këtij lloji në Majën e Vjellakut, Majën e Rusolisë dhe në Bjeshkën e Lumëbardhit janë me të mirat dhe në dhjetë vitet e fundit vërehet një ripërtëritje natyrore shumë e mirë e këtij lloji.	I përkeqë-suar
98	<i>Gentianella bulgarica</i> (Vel.) Holab. Emri shqip: <i>Gencianëza bullgare</i> Familja: <i>Gentianaceae</i>	Bimë barishtore dyvjeçare, e gjatë 1-7-(-20) cm. Lulet me bisht të shkurtër. Kërcejtë të degëzuar me 4-8 ndërmje. Gjethet kërcellore janë gjatore heshtore, gati shyte. Bishtat e luleve më të gjata se gypi i kupës, vrigujt e kupës gati të barabartë ndërmjet tyre, vizak të sheshtë ose pak të sipërveshur. Kurora është 12-20 mm, e bardhë ose manushaqe e zbehtë. Kapsula është me bisht. Qosja, Xh. et al. (1996)	Karpate (Rumani) dhe Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bullgari).	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me shkurre, kulllosa dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Sempervivum macedonicum, Trifolium alpestre, Dianthus cruentus, Knautia dinarica, Salix retusa, Juncus trifidus, Hieracium pilosella, Trifolium alpestre.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkën e Lumëbardhit, Hajlë, Kurvallë, Majën e Kunorës, Rrasë të Zogut). Në Malet e Sharrit (Koritnik, Shutman, Vracë, Pashallarrë). Millaku, F. me 16.08. 2013 këtë takson e konstatoi edhe në lokalitetin Maja e Çetaive (Kopriynik)	Edhe pse ky takson në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji në Pashallarrë (Ostrovicë) gjendet në substrat serpentini në lartësi 1832 m dhe në vitet e fundit	I përkeqë-suar

				në lartësi mbidetare 2470 m.	është duke u zvogëluar numri i individëve maturë si pasojë e dëmtimit prej zjarreve.		
99	<i>Gypsophila</i> <i>sperguliifolia</i> Griseb. Emri shqip: <i>Gjipsofilë me gjethe</i> <i>spergule</i> Familja: <i>Caryophylla</i> <i>ceae</i>	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), dendësisht tufore. Kërcejtë 5-25 cm, shumë të degëzuar të shogët poshtë. Dendësisht gjëndërore-pushlore në lulesë. Gjethet lineare 5-15 cm të gjata dhe rreth 0.5 mm të gjëra . Këmbëzat gjëndërorepushlore. Kurora 2 herë me e madhe se kupa, e purpurtë, e çelët ose e bardhë. Farat me kokrriza të fryra. Lulëzon VI-VII, Frytton VII-VIII. Papparisto, K. et al. (1988).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Serbi). Sipas Petar D. Marin & Budislav Tatic (2001) ky lloj rritet në serpentinet e Ballkanit.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentini nga 600-800 m lartësi mbidetare në vende gurishtore e shoqëruar nga llojet: Aster albanicus, Juniperus oxycedrus, Polygala doerfleri, Scorsonera austriaca, Saponaria sicula, Fumana bonapartei, Euphorbia glabriflora, Genista hassertiana etj. Sipas Vladimirov, V. et al. (2007) është e përhapur në serpentinet në kuadër të asociacionit Poa molinieriv Plantaginatum holostei.	Nuk ka të dhëna për përhapjen e këtij lloji në Kosovë. Mala, Xh., dhe Millaku, F. gjatë vitit 2012-2013, këtë lloj e konstatuan në serpentinet e Mushishtit (Bokat e Baçevcit) dhe në Guriç (Malishevë). Është lloj i ri i florës së Kosovës.	Popullacioni i këtij lloji në serpentinet e Mushishtit ka areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Në Guriç (Malishevë) ky lloj ka areal shumë të kufizuar (<5 km2) kurse numri i individëve maturë në kuadër të këtij Popullacioni është konsiderueshëm.	I përkeqë-suar
100	<i>Heracleum</i> <i>orphanidis</i> Boiss. Emri shqip: <i>Herakle orfanide</i> Familja: <i>Apiaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të hollë, të brinjëzuar, e lartë deri 50 cm, në pjesën e poshtme e degëzuar pak, me push ose me qimegjëndërore. Gjethet trepjesëshe, rrallë të plota, formë zemre ose të rrumbullakëta me qime të rralla. Vrigujt e gjethëve buzëve të dhëmbëzuara, dy segmentet anësore pykorvezak, i mesmi trepjesësh. Ombrella me 6-9 rreze, rreth 5 cm në diametër. Pa involukrum, involucelumi i përbërë nga gjethe të imta lineare. Petlat të bardha, me të mëdha nga ana e jashtme e luleve në krahasim me lulet e brendshme të ombrellës. Fryti me qime, vezak ose oval, me madhësi rreth 10 mm dhe me shumë brinjë. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë.	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Maqedoni - Pelister)	Në Grykën e Jazhincës ky lloj është konstatuar në kuadër të pyllit të përzier të armenit (Pinus peuce) dhe në lëndina të zonës subalpine nga 1800-2000 m lartësi mbidetare e shoqëruar nga llojet: Senecio nemorensis, Gentiana lutea, Rubus idaeus, Campanula spatulata, Rumex alpinus, Phyteuma pseudorbiculare, Ranunculus platanifolius, Achillea abrotanoides, Trollius europaeus, Viola orphanidis, Pinus peuce, Picea abies etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Prevallë). Me 11.07.2013 Millaku, F., Malaj, Xh., Krasniqi, E., Berisha, N. e bënë vlerësimin e Popullacionit të këtij lloji edhe në Grykën e Jazhincës në zonën subalpine në lartësi mbidetare 1915 m	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Prevallë, Orman dhe në Grykën e Jazhincës) kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni në Grykën e Jazhincës është me stabil në krahasim me Popullacionin e këtij lloji në Prevallë.	I përkeqë-suar

101	<i>Malus florentina</i> (Zucc.) C.K. Schneider [Sorbus florentina Nym.] Emri shqip: Mollë florentine Familja: Rosaceae	Shkurre ose dru i vogël (Fanerofite P), deri 5 m. i lartë, me kurorë të rumbullakët dhe lëvore të plasarit. Degët e reja të kuqe në të kafet, me qime, pa gjemba. Gjethet vezake të gjëra , 3-6 x 2-4 cm, me majë të mprehtë, të cinguar ose si zemër në bazë, me push të bardhë në faqen e poshtme, me bishtak 1,5 – 2,5 cm, me buzë të vrigulluara ose dhëmbë-dhëmbë të parregullt, të ngjashme me gjethet e murrizit dhe të vodhëviçes. Lulesa vastakore me 5-8 lule, me bishta me qime. Lulet me diametër 1,5 – 2 cm, të bardha. Shtrati i lules dhe sepalet me qime të dendura, të përhimë në të bardha; sepalet të gjata 3-4 mm, të rënshme. Shtyllëza 5, të bashkangjitura në bazë. Thëkë rreth 20, të gjatë po aq sa shtyllëzat. Fryti elipsoid i gjërë, rreth 1 cm i gjatë, i kuq të paktën në një anë, me qeliza gurorë. Fara zakonisht 10, ngjyrë gështenje, 2 x 6 mm. Lulëzon:IV-V. Frytton: VIII-IX. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Itali, Maqedoni, Greqi Veriore, Shqipëri, Kosovë (Paleoendemik e e Ballkanit dhe Apenineve)	Rritet në pyje gjethëgjera termofile dhe mezotermofile të dushkut (Quercetum farnetto-cerris scardicum Krasn.) si dhe në pyje të shkroës së zezë (Carpinetum orientalis scardicum Krasn.) e shoqëruar nga llojet: Quercus farnetto, Q. cerris, Q. petraea, Sorbus domestica, S. torminalis, Fraxinus ornus, Colutea arborescens, Viburnum lantana, Cornus Foto: Elez Krasniqi (2011), Pashtrik mas, Comandra elegans, Paeonia decora, Lithospermum purpureocoeruleum, Physospermum aquilegifolium etj.	Sipas Pajazitaj Q. (2012), Krasniqi, F. (1972), Josifovic, M. et al. (1972), është e përhapur në: Gërmi, Gllarevë, Blinajë, Qyqavicë, Malin Drenicë, Carraleve, Malet e Suharekës (Bokat e Baqevcit, Bokat e Korishit), Radavc dhe Pashtrik	Popullacionet e këtij lloji në të gjitha lokalitetet e konstatuara kanë numër shumë të vogël të individëve maturë. Zakonisht në të gjitha lokalitetet takohen individë të vetmuar ose në numër shumë të vogël.	I përkeqë-suar
102	<i>Onosma echinoides</i> L. subsp. javorkae (Sim.) Hayek Emri shqip: Çikllë si ushqerrëz Familja: Boraginaceae	Gati gjysmëshkurre (Kamefite CH), 10-60 cm, me kërcë të drunjëzuar, e të shumtë me pushpak dhe kreshtake –yjure. Gjethet e poshtme 1.5-10 cm, vizake, vizake-heshtore ose pallake, me buzë zakonisht të spërveshura; faqja e sipërme e llapës me zhardhokë që bartin një kreshtë qendrore dhe (8) 10-20 (25) kreshta yjore 0.3-0.6 mm. Qimet e thjeshta ndërmjet zhardhokëve mungojnë. Lulet pabisht. Braktetë me të shkurtra ose gati sa kupa. Kupa 7-14 (15) mm në lulëzim, 8-15 (19) mm në frytëzim, me kreshta të thjeshta dhe me disa yjore me rreze të shkurtra. Kurora 16-23 mm, e verdhë e zbehtë, nga jashtë pak a shumë dendësisht leshtake. Merikarpet 2-3.5 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit.	Ky takson në Kosovë rritet në substrate serpentinore të thata kseroterme e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Teucrium montanum, Aster albanicus, Thesium dolinieri, Fumana bonapartei, Plantago subullata, Sanguisorba minor, Alyssum markgrafi, Chrysopogon gryllus, Convolvulus cantabricus etj.	Bokat e Baqevcit (Mushtisht, Rajoni i Mirushës dhe Koznikut, Bokat e Krevenikut).	Popullacionet e këtij taksoni në Bokat Baqevcit, Rajoni i Mirushës, Koznikut, Bokat e Krevenikut kanë areal të kufizuar dhe pak individë maturë që zakonisht rriten në tufa, rrallë takohen individ të vetmuar. Popullacionet e këtij lloji në Kosovë gjenden afër vendeve rurale dhe janë nën ndikim të faktorit zooantropogjen.	I përkeqë-suar

103	<i>Primula halleri</i> (Gmelin) Honck. Emir shqip: Agulique e Hallerit Familja: Primulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 12-18 cm e lartë, miellore. Gjethet 28 x 0.5-3 cm, gjatore-vezake të përmbysëta deri heshtore të përmbysëta, përposh miellore, me dhëmbëz të imtë. Shtija 8-18 cm, me 2-12 lule. Braktetë 5-10 mm. Këmbëzat 5-10 mm. Kupa 8-12. Kurora me diametër 15-20 mm, ngjyrë jargavani, me gyp 20-30 mm, 2-3 më e gjatë se kupa. Kapsula cilindrike, aq sa ose më e gjatë se kupa. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë dhe në mënyrë vegetative. Qosja, Xh. et al. (1996).	Alpe, Karpate, Ballkan (Endemike Evropjanojug-lindoreKaukaz ike)	Në Kosovë rritet në substrat silikat, kullota ose vende shkëmbore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Dianthus sylvestris, Rhodiola rosea, Lilium albanicum, Potentilla montenegrina, Geranium coeruleum, Knautia dinarica, Gentiana lutea, Veronica orsiniana, Silene roemerii etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e përhapur në Malet e Sharrit (Maja e Zezë, Restelicë, Vracë, Rajoni Brodit 2250 m). Me 21. 07. 2009 Millaku e konstatoi në Gjeravicë në shkëmbinjtë silikat ekspozicion Jugor, në 2370 m lartësi mbi detare. Me 17.07. dhe 18.07. 2013 Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj e konstatuan edhe në Kurvallë (ekspozicion Jugor) dhe Pllaçicë të Junikut (Ekspozicion Verior) në 2150 m lartësi mbidetare. Millaku, F. me 13.08.2013 e konstatoi edhe në Marjash në zonën alpine në lartësi mbidetare 2157 m.	Subpopullacionet në Majën Zezë, Restelicë dhe Vracë, kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është shumë i vogël. Popuacioni në Alpet Shqiptare përbehet nga dy subpopullacione që kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është i vogël.	I përkeqë-suar
104	<i>Ramonda serbica</i> Pancic Emri shqip: Ramondë e Serbisë Familja: Gesneriaceae	Shumëvjeçare me rozetë bazale, 15-20 cm e lartë (Hemikriptofite H). Gjethet 3.5x1.3 cm, të thjeshta, përsipër të kreshpëta, përposh leshtore të murme, pa ndajgjetheza, vezake të përmbysëta, të ngushta, kunjore në bazë, me buzë ura-ura ose dhëmbëdhëmbë; bishtaku zakonisht i shkurtër, me qime. Shtija 6-8 cm, me 1-3 lule, 5 pjesëshe, pothuajse aktinomorfë. Kurora si tas, me diametër 2.5-3 cm, me vriguj të drejtë-të hapur, lila deri manushaqe. Pjalmoret manushaqe-blu. Krezat të kokët. Fryti kapsulë septicide, më i gjatë se kupa. Lulëzon VI. Frynjon VII. (Tutin, T. G. et al. 1972).	Serbi, Maqedoni, Mali i Zi, Shqipëri, Kosovë, Epir dhe Bullgari (Tutin, T. G. et. al. 1972; Josifovic, M. et. al. 1974; Jordanov, D. et al. 1995; Polunin, O. 1997; Vladimirov, V. et al. 2007; Gashi, B. 2013).	Në Kosovë rritet në të çarat e shkëmbinjve gëlqeror me hije të zonave malore deri subalpine (500-1800 m l. m. d.) në shoqëri nga llojet: Achillea ageratifolia, Hieracium racemomum, Hedera helix, Arabis verna, Asplenium ruta-muraria, Ceterach officinarum, Sedum album, Campanula versicolor, Hieracium waldsteini, Arabis caucasica, Phyllitis scolopendrium, Polypodium vulgare, Saxifraga rotundifolia, Oxalis acetosella, Silene saxifraga, Sempervivum tectorum, Pimpinella saxifraga, Saxifraga sempervivum, Valeriana montana, Sedum telephium, Calamintha acinos etj	Alpet Shqiptare-Gryka e Zhlebit, Radac, Gryka e Sushicës, Gryka e Rugovës, Gryka e Koprivnikut, Malet e Sharrit - Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Oshlak, Gryka e Rusenicës, Guri i Matosit, Shkëmbi i Përgjakur, Gryka e Dollocit, Pashtrik, rritet edhe në Luginën e Ibrit (Gashi, B. 2013; Gashi, B. et al. 2012; Josifovic, M. et al. 1974; Zeneli, L. 1975; Krasniqi, F. 1982, 1998; Millaku, F. 1993, 1997, MMPH 2008).	Popullacionet shtrihen në lartësinë mbidetare 530-1651 m. Kanë përhapje të kufizuar. Popullacione me numër të vogël të individëve janë ato në Radac dhe në Grykën e Koprivnikut. Popullacionet në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, Grykën e Rugovës, Radac dhe në Grykën e Zhlebit janë të ndikuara nga urbanizimi dhe ndotja. Këto popullacione mund të rrezikohen edhe nga njeriu, sepse gjenden në zona turistike, ku faktori antropogjen ka ndikim. Popullacionet janë të rrezikuara edhe nga gërryerja e masiveve shkëmbore nga kompanitë që merren me	I përkeqë-suar

						prodhimin e rërës (lokalitetet: Gryka e Rusenicës dhe Gryka e Lumit Sushicë).	
105	<i>Tephroseris papposa</i> subsp. <i>wagneri</i> (Degen) B. Nord. [Senecio <i>wagneri</i> Deg.] Emri shqip: - [Pulith i Wagnerit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur, në fillim me qime të merimangëta leshtore, më vonë pothuaj të shogët. Gjethet nga sipër pak a shumë të lëmuara, me qime të merimangëta leshtore nga poshtë. Gjethet e bazës gjatore – eliptike, gradualisht të ngushtuara në bishtak, të dhëmbëzuara; gjethet e kërcellit gjatore-heshtore, të ngushtuara në bazë, pabishtak; gjethet e sipërme vizake. Kapitina jo rrezore, 1.5 cm në diametër, në vastak të thjeshtë me 5-10 kaptinëza. Pëshjtella purpurtë në të kaftë. Lulet me ngjyrë intensive të verdhë. Lulet llapore mungojnë. Xhufka pakz më e gjatë se kurora. Akenët të shogët. Lulëzon IV-VIII, frytton VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000).	Siujdhesa Ballkanike (Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari)- Endemike Ballkanike.	Në Kosovë rritet në substrat silikat me rrallë në substrat gëlqeror, në vende me barë dhe shkëmbore të zonave të larta subalpine dhe alpine ose në vende me bar dhe lëndina të pyllit të kërclekes (Pinus mugo) e shoqëruar nga llojet: Geranium sylvaticum, Jasione orbiculata, Geum montanum, Juniperus sibirica, Pedicularis verticillata, Armeria alpina, Sesleria nitida, Hypericum alpigenum, Veronica bellidifolia, Dianthus cruentus, Onobrychis scardica, Polygonatum bistorta, Trifolium badium, Stachys alpina etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është e përhapur në Majën e Rusolisë, Kurvallë, Gjeravicë, Liçenak dhe Hajlë. Sipas Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Vracë, Livadhishitë, Luboten, Oshlak, Koritnik).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Popullacioni i këtij lloji në Gjeravicë është në gjendje të mirë dhe i pasur me individ maturë në krahësim me popullacionet e këtij lloji në lokalitetet tjera në Kosovë.	I përkeqë-suar
106	<i>Soldanella pindicola</i> Hausskn. [Soldanella <i>dimonieii</i> Vierh., <i>Soldanella scardica</i> Deg.] Emri shqip: - [Pratish i Dimonieit] Familja: Primulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-15 (-20) cm e lartë. Gjethet në rozetë bazale, me llapë 10-50(-60) mm, rrotullare si veshkë, përposh me ngjyrë blu të përhimët, me pluhurizë, e mbuluar dendësisht me gropëza gjëndërore. Shtija 3-9 cm, me 2-3 lule. Kurora e ndarë në më shumë se ½ e gjatësisë së saj, vjollcë; vrigujt e kurorës të ndarë në 3 vriguj më të vegjël, nga të cilët ai skajori deri 0.5 mm i gjatë. Dhëmbët e kapsulës të cunguar. V-VI. Qosja, Xh. et al. (1996).	Siujdhesa ballkanike (Endemike Ballkanike).	Në Kosovë rritet në substrat serpentine, silikat dhe karbonat. Në Pashallarë dhe në Gjeravicë rritet në kullota alpine ose në vende ku qëndron bora më gjatë. Rritet e shoqëruar nga llojet: Silene asterias, Geum coccineum, Pinus mugo, Dactylorhiza majalis, Cirsium appendiculata, Parnassia palustris etj.	Sipas Mala, Xh. (2010) është e përhapur në Majën e Pashallarëve (Ostrovicë). Sipas Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Gjeravicë. Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) është e përhapur në Oshlak dhe Virovi.	Popullacionet e këtij lloji në Gjeravicë dhe në Majën e Pashallarëve (Ostrovicë) kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve në këto dy popullacione është shumë i vogël. Në shumicën e rasteve takohen individ të rrallë.	I përkeqë-suar

107	Achillea ageratifolia (Sibth.et Sm.) Boiss. Emri shqip: Barpezmi gjetheagjerat e Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare tufore (Kamefite CH), kërcejtë deri 30 cm, të ngritur, secili me nga në kaptinëz. Gjethet të përhimëta-pushbuta; bazalet 2-4 cm, pallake, buzëplota ose ura-ura, rrallë krëhërake-pendore të çara; kërcelloret rreth 1 x 0.2 cm, të pakta. Pështjella 5-15 mm në diametër; braktet rreth 5 mm, të mëndafshita, me buzë të gjëra . Lulet llapore 7-9 mm, vezake, të bardha. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entemofilia). Frytnon VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Mal i Zi.	Rritet në substrat gëlqeror ose serpentiner, ose në vende dhe kullota të thata (Elyno-Seslerietea) duke filluar nga zona kodrinore deri në kullota të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Micromeria albanica, Campanula versicolor, Colutea arborescens, Hyssopus officinalis, Erysimum sylvatica, Seseli rigidum, Anthyllis vulneraria, Rhamnus orbiculatus, Ficus carica, Pistacia terebinthus, Alyssum corymbosum, Jurinea mollis, Scabiosa fumaroides, Convolvulus cantabrica, Convolvulus althaeoides, Scabiosa crenata etj.	Gjatë vitit 2011-2013 Rexhepi, F. Pajazitaj, Q., Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. kanë hulumtuar popullacionet e këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, Luboten, Koritnik, Brod, Oshlak, Rusenicë, dhe Novobërd (Rexhepi, F. 1975).	Popullacione/subpopullacione e këtij lloji janë mjaft të fragmentuara dhe kanë areal të kufizuar me përjashtim të subPopullacionit në NT – Gati i rrezikuar. Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe subPopullacionit në Oshlak që janë afër njeri me tjetrin. Popullacionet në Koritnik, Luboten dhe Rusenicë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve. Popullacioni në Artanë (Novobërdë) ka përhapje të kufizuar dhe në krahësim me popullacionet tjera të Kosovës është Popullacioni me shtrirje me të kufizuar dhe me numër me të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
108	Armeria canescens (Host) Boiss. Emri shqip: Armerie e përhimtë Familja: Plumbaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-60 cm e lartë, me kërcëp pak të degëzuar. Gjethet majëtopitura, dytrajtëshe; të jashtmet 2-3 (-6) mm të gjëra , vizakegatipallake të sheshta; të brendshmet 1-2 mm të gjëra , vizake ose vizake heshtore, të sheshta rrallë buzëkëthyerë. Shtijet të ngritura ose të harkuara, me këllëf 7-30 mm të gjatë. Koka (lulesa) 15-25 cm e gjërë. Braktet e jashtme të pështjelljes me të shkurtra ose aq sa të brendshmet. Të brendshmet shyte ose me thimh me buzë cipëthata. Kallithet pabisht ose gati pabisht; braktet aq sa kupa (6-10 mm). Halëzat 1-2 mm. Kurora e trëndafil të deri e kuqërremtë e purpurtë ose e bardhërreme. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë.	Evropë.	Rritet në substrat gëlqeror ose granit, kullota e livadhe të zonës subalpine e alpine e shoqëruar nga llojet: Stachys alpina, Botrychium lunaria, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Hypericum alpigenum, Juniperus sibirica, Antennaria dioica, Myosotis alpestris etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999) në Alpe Shqiptare është konstatuar në Dervish Kom, Foto: Fadil Millaku (2012), Kurvallë Bogiçë, Liqenak, Rusoli, Gjeravicë, Bjeshka e Lumëbardhit. Sipas Josifovic et al. (1972) rritet në Dervish Kom, Bogiçë, Liqenak. Sipas Saric et al. (1986) në kuadër të Maleve të Sharrit rritet në Majën e Zezë, Guri i Pavilovit dhe Kurvallë.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Dervish Kom, Pllaçicë të Junikut, Bjeshkë të Dobroshit (Rupë), Bogiçë, Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit) dhe në Malet e Sharrit (Majën e Zezë, Guri i Pavilovit dhe Koçinak led) janë të vogla dhe me areal të kufizuar. Zakonisht rritet e vetmuar ose në tufa të vogla. Shpesh rritet në habitate të njëjta me llojin Armeria alpina.	Gati i rrezikuar.

109	Barbarea balcana Panc. Emri shqip: Barbare e Ballkanit Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët. Kërçelli deri 70 cm. Gjethet e poshtme lirake pendore të çara, me vrigullin skajor si zemër-vezak dhe me 0-2 palë vriguj anësor; të sipërmet pendore të çara. Lulet të verdha, në vile vastakore, pa brakte. Petalet 7-15-25 mm; këmbëzat të hapura, 6-8 mm; flegrat jo me nervurën e mesit të dallueshme; shtyllëza 2-4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemike e Ballkanit)	Rritet në vende me lagështi ose pran burimeve dhe përrenjve të zonës alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: <i>Pinguicula</i> sp., <i>Gymnadenia</i> frivaldii, <i>Parnasia</i> palustris, <i>Caltha</i> palustris, <i>Veratrum</i> album, <i>Narthecium</i> scardicum, <i>Cardamine</i> pratensis, <i>Saxifraga</i> stellaris, <i>Saxifraga</i> rotundifolia etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve tona ky lloj është e përhapur në Malet e Gjeravicë Sharrit (Luboten, Bistër, Guri i Zi, Brod, Shtëpia e Malorëve) dhe Alpet Shqiptare (Gryka e Lloqanit, Kurvallë, Pllaçicë e Vokshit, Pllaçicë e Junikut, Gjeravicë, Bjeshka e Dobroshit).	Shumica e popullacioneve/subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël me përjashtim të Popullacionit në Gjeravicë dhe Pllaçicë që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
110	Campanula versicolor Andrews. Emri shqip: Lulekambanë ngjyrë ndryshme Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-40 cm ose më shumë, zakonisht e shogët, me kërcell të përpjetëm ose të ngritur, i degëzuar si melth në pjesën e sipërme ose nganjëherë i thjeshtë. Gjethet e bazës lëkurore, me buzë ura-ura ose dhëmbëdhëmbë, vezake deri si zemër-vezake, me bishtak; të sipërmet pothuajse pabisht, pykore në bazë. Lulet me tufëza, që formojnë lulesë të shkurtër e të dendur skajore. Dhëmbët e kupës heshtore të ngushta. Kurora 15-25 mm, blu, me 5 njolla bazale më të errëta. Lulëzon V. Frytëzon VII (Qosja, Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik (Kosovë, Shqipëri, Greqi, Bullgari, Maqedoni, Serbi), Itali juglindore (Tutin, T. G. et al. 1976, Saric, M. et al. 1986).	Në Republikën e Kosovës ky lloj rritet në substrat gëlqeror, kryesisht në gryka- vende të nxeha shkëmbore të zonës kodrinore-malore (-subalpine) (Asplenietea trichomanis), në shoqëri me llojet: <i>Ficus carica</i> , <i>Pistacia terebinthus</i> , <i>Salvia ringens</i> , <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>Laser trilobum</i> , <i>Micromeria</i> albanica, <i>Onosma stellulata</i> , <i>Ruta graveolens</i> , <i>Convolvulus altheoides</i> , <i>Silene saxifraga</i> , <i>Cerastium decalvans</i> , <i>Potentilla speciosa</i> , <i>Daphne oleoides</i> etj.	Malet e Sharrit (Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Vermicë, Matos, Koxhaballkan, Rusenicë (Krasniqi, F. et al. 1981; Saric, M. et al. 1986). Popullacione të llojit janë konstatuar dhe vlerësuar edhe në Planëj-trëzë Pashtrikut më 01.06.2011 (F. Millaku, F. Rexhepi, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi dhe Xh. Mala) si dhe në Brod më 11.08.2013 (E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Lloji rritet i vetmuar ose në grupe të vogla.	Gati i rrezikuar.
111	Cerastium grandiflorum Waldst. et Kit. [Cerastium. nodosum Buschm.] Emri shqip: Cerast lulemadh Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore, 15-30 (-50) cm, pushbutë e bardhë deri e përhimët. Gjethet 25-70 x 0.5-1.5 mm, vizake të ngushta, gati të mprehta, me buzë shumë të shpërveshura. Lulesa cimë, me degëza tufëzore të ngritura, me 7-15 lule, me këmbëza 1-4 cm. Braktetë vezake deri gjërësisht heshtore, me buzë dhe maje cipëthatë të gjërë. Nënpetlat 6-8 mm, gati shyta, pushbuta, me buzë cipëthatë. Petlat deri 18 mm, të ngushtuara gradualisht drejt bazës, rreth 3 herë sa kupa. Vezorja dhe kapsula pushbuta, të paktën në bazë. Kapsula e drejtë, deri dy herë sa kupa; dhëmbët të sheshtë, të hapur. Lulëzon VI. Frytëzon VII (Paparisto, K. et al. 1988).	Pjesa perëndimore të Gadishullit Ballkanik (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci (Tutin, T. G. et al. 1976; Polunin, O. 1997; Josifovic, M. et al. 1970).	Në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në vende shkëmbore të zonës subalpine, kryesisht në ekspozicione veriore të ftohta dhe nën ndikimin e erërave. Në lokalitetin Shutman (1914 m l.m.d.) gjendet në vende shkëmbore të zonës subalpine në shoqëri me llojet: <i>Dianthus dolitoides</i> , <i>Hieracium pilosella</i> , <i>Euphrasia</i> rotskoviana, <i>Luzula forsteri</i> , <i>Primula veris</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Scabiosa leucophylla</i> , <i>Trifolium alpestre</i> , <i>Gentianella bulgarica</i> , <i>Geranium subcaulescens</i> etj.	Alpet Shqiptare-Zhleb (Millaku, F. 1999, Josifovic, M. et al. 1970, Silic, C. 1988). Në lokalitetin Shutman (Malet e Sharrit) në kullosa subalpine është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e popullacioneve të llojit nga F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala më 01.08.2011). Gjendja e popullacioneve të llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe gjatë viteve 2012-2013 në disa lokalitete në Malet e Sharrit (Livadhishtë, Bistër, Karanikollë dhe	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël. Në veçanti Popullacioni i konstatuar në Shutman ka <50 individë maturë.	Gati i rrezikuar.

				Lumi i Thatë-afer tre kufirit.			
112	<i>Clematis flammula L.</i> Emri shqip: <i>Kulpër e butë</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë kacavjerrëse pak a shumë e drunjëzuar, 3-5 m (Fanerofite P). Gjethet dyfish pendore, me gjethëza gjatore të ngushta deri gati rrotullore, të plota ose me 3 vriguj. Lulet me diametër rreth 2 cm, të verdha, të merme, të vendosura në melth të çlirët. Segmentet e rrethlules shyta, pushlore përposh dhe anash. Thëkët 3-4 mm. Shtrati lulor pushpak deri i shogët. Akenët shumë të shtypur. Shtyllëzat puplore në kohën e frytit. Lulëzon V-VI. Frytton VIII (Paparisto, K. et al. 1988).	Evropë Jugore, Azi Jugperëndimor e, Afrikë Veriore. E bartur edhe në Amerikën Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997; Josifovic, M. et al. 1977). Sipas Matevski, V. et al. (2011) është e përhapur në Maqedoni.	Në Kosovë rritet në zonën e pyjeve gjetherënese termofile në vende shkurre, gjerdhe e pyje, të zonave të ulëta e të nxehta në rrëzat e Pashtrikut dhe të Koritnikut në kuadër të fitocenozës Quercetum trojanae dukagjini dhe Dioscoreo-Carpinetum orientalis. Shoqërohet me llojet: Dioscorea balcanica, Carpinus orientalis, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Ostrya carpinifolia, Juniperus communis, Crataegus monogyna, Rosa canina, Prunus spinosa, Teucrium polium, Teucrium chamaedrys, Cerinthe minor, Convolvulus althaeoides, Herniaria glabra etj.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në Zhur-rrëzë Koritnikut, Gorozhup dhe Kuzhnin-rrëzë Pashtrikut, Prizren-Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Gryka e Drinit të Bardhë afër fshatit Nashec (Krasniqi, F. 1972; Rexhepi, F. 1994; Diklic, N. & Nikolic, V. 1961; Saric, M. et al. 1992).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë fragmentare me gjendje relativisht të mirë por me shtrirje të kufizuar nga Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit deri në kufi me Shqipërinë. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik për dallim nga popullacionet tjera ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë mirëpo sipërfaqja e përhapjes se këtij Popullacioni pas paraqitjes se zjarrit në vitet e fundit ka tendenca të zvogëlimit.	Gati i rrezikuar.
113	<i>Crocus scardicus Kosanin</i> Emri shqip: <i>Shafra i Sharrit</i> Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare rreth 10 cm e gjatë (Gjeofite G). Mbulesa e zhardhokut-qepës është e hollë dhe e ndjeshme rrjetore leshtore ose jo. Gjethet 0.5-1 mm të gjëra , vizake të ngushta, të drejta me në vijë të bardhë në mes, shfaqen së bashku me lulen. Lulet të vetmuara. Perigoni (perianti) i verdhëportokalli, me grykë ngjyrë jorgovani (vjollce); pjesët e periantit 2-3.5 (-4) cm të gjata dhe 0.6-1 cm të gjëra . Kreza ka ngjyrë të verdhë ose portokalli, në pjesën e sipërme zgjerohet dhe është e ndarë në tre segmente. Anterët e tejkalojnë krezën. Bimë mjaft dekorative. Lulëzon VII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 2000; Paiazitaj, Q. 2004).	Shqipëri, Maqedoni, Shqipëri (Rexhepi, F. 1986, 2000; Randjelovic et al. 1990; Tutin, T. G. et al. 1980, Polunin, O. 1997; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë ky lloj rritet në zonën subalpine dhe alpine (Ranunculion crenati), në vende të hapura-ekspozicioni verior, verilindor dhe veriperëndimor, në substrat me bazë shkëmbore kryesisht silikate zakonisht në tokë të thellë në hapësira ku shkrihet bora gjatë verës. Shoqërohet nga llojet: Ranunculus crenatus, Carex pyrenaica, Gnaphalium supinum, Crocus veluchensis, Crocus vernus etj.	Malet e Sharrit-Shtëpia e Malorëve, Livadhishhtë, Crvena Karpa, Bistër, Çukat e Liqenit, Piribreg, Maja e Zezë, Restelicë, Brod, Prevallë (Rexhepi, F. 1986, 1994, 2000, Randjelovic, N. et al. 1990, Krasniqi, F. (1998). Subpopullacione të këtij lloj janë konstatuar edhe në Bjeshkët e Opojes duke filluar nga mali mbi fshatin Kuk deri të Guri i Zi.	Popullacionet/ subpopullacionet e këtij lloji janë me numër të konsiderueshëm të individëve maturë, por kanë areal të kufizuar dhe gjenden vetëm në Malet e Sharrit në vende ku shkrihet bora gjatë verës.	Gati i rrezikuar.

114	<i>Dianthus scardicus</i> Wettst. Emri shqip: Karafil i Sharrit Familja: Caryophylla ceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me buca të rralla. Kërçelli është 1,510 cm i gjatë, me dy tri pale gjethe të gjata afër 15 mm dhe të gjëra 2-3 mm, me tri nervura. Lulet zakonisht janë të vetmuara. Kupa e dytë është me dy luspa, gati sa gjysma e kupës, në majë, me tri nervura. Kupa është 10-12 mm e gjatë, në pjesën e sipërme e zgjeruar. Kurora është 7-8 mm e gjatë ngjyrë trëndafili, pak e dhëmbëzuar. Lulëzon VII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 1986).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni. Endemike e Maleve të Sharrit (Rexhepi, F. 2000; Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë rritet në substrate acidike, në vende shkëmbore gëlqerore-me bar, të zonës subalpine dhe alpine (Festuco-Seslerietea respektivisht Onobrychido-Festucion, në shoqëri me llojet: Pedicularis oederi, Dianthus microlepis, Campanula alpina, Dryas octapetala, Myosotis alpestris, Helianthemum canum, Onobrychis scardica, Edraianthus graminifolius, Poa alpina, Gentiana utriculosa, Polygonum viviparum, Phyteuma orbiculare, Nigritella nigra, Pedicularis verticillata etj.	Sipas Rexhepi, F. (1982, 1986, 1994, 2000), Josifovic, M. et al. (1970), Krasniqi, F. (1982, 1987, 1998), Randjelovic, N. & Rexhepi, F. (1984), MMPH (2008) është përhapur në Malet e Sharrit (Luboten, Prevallë, Bistër, Piribreg, Livadhishhtë, Rudokë) dhe Koritnik. Ky lloj është konstatuar edhe në Vracë (F. Millaku, E. Krasniqi, Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë shtrihen vetëm në Malet e Sharrit. Këto popullacione edhe pse kanë areal të konsiderueshëm numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël, në veçanti Popullacioni i këtij lloji në Vracë.	Gati i rrezikuar.
115	<i>Gentiana dinarica</i> Beck Emri shqip: Gencianë dinarike Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-8 cm e gjatë. Gjethet janë të grupuara drejt bazës së kërçellit, shtija është e ngritur, me një lule të vetme skajore. Gjethet bazale në rozetë, dy të poshtmet eliptike ose vezake-eliptike 19-32×11-19 mm, me 3 nervura. Gjethet në bazë janë qelqore kërçelloret janë 10-13×7-8 mm, vezake të thepëta. Kupa është me gyp me kënde dhe dhëmbë të thimthuar. Kurora blumanushaqe, pa njolla me grykë me gyp 30-40 mm e vriguj shytë të përkulur nga jashtë. Filli 1 cm i zgjeruar në bazë, pjalmoret janë 6 mm, të verdha. Kreza është 1.5-2 mm si elpazë. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi 1986, Qosja, Xh. et al. 1996).	Alpet, Dinariket, Karpatet Jugore, Kosovë, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror dhe silikat, në kuadër të kullotave të thata të zonës alpine rrallë haset edhe në zonën subalpine të Alpeve Shqiptare dhe Malet e Sharrit. Rritet e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum, Gentiana verna, Gentiana utriculosa, Gentiana koschiana, Cerastium decalvans, Veratrum album, Armeria alpina, Onobrychis scardica, Dianthus sylvestris, Dianthus integer etj.	Në bazë të dhënave nga literatura dhe hulumtimeve tona në terren ky lloj është i përhapur në: Koritnik, Bjeshkët e Lumëbardhit, Greben, (Rexhepi, 1986), Gjeravicë, Pllaçicë e Junikut, Kurvallë, Dervish Kom, Bjeshkë e Dobroshit (Çuka e Gërrbave), Bjeshkë te Belegut, Marjash.	Popullacionet /subpopullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare janë me të ruajtura dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Koritnik Popullacioni i këtij lloji ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të Popullacionit.	Gati i rrezikuar.

116	<i>Gymnadenia frivaldii</i> Rchb. Emri shqip: <i>Saleprrëmë i Frivaldit</i> Familja: Orchidaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite H), me zhardhokë të ndarë thellë me vriguj të gjatë dhe rrënjë të holla. Kërccoli i gjatë deri 20 cm në bazë me gjethe të ngjashme me këllëf. Gjethe 3-4 gjatore-heshtore, të sipërmet si brakte. Lulesa e shkurtërboshtore, e ngjeshur. Braktet janë heshtore me 1 nervurë të gjatë sa lulet. Lulet të vogla të bardha ose vjollce të zbehtë. Të gjitha gjethëzat e perigonit përveç buzës njëra kah tjetra të lakuara formojnë helmetën. Gjethëzat e jashtme të perigonit janë gjatore-vezake, të brendshmet janë gjatore, të gjata sa të jashtmet dhe pak më të ngushta. Buza është më e shkurtër se gjethëzat tjera të perigonit e plotë ose tre vrigullore, e lakuar teposhtë. Shpori penjëztor, kah maja i mprehtë, i gjatë sa 1/2 e pistilit. Riprodhohet me farë.	Evropë, Grenlandë, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me lagështirë të zonës subalpine dhe alpine ose me rrallë mund të takohet edhe në kullota ose shkurrat të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë kryesisht rritet në kuadër të asociacionit Pinguiculo Narthecium scardici e shoqëruar nga llojet: Pinguicula balcanica, Narthecium scardicum, Caltha palustris, Eriophorum angustifolia, Alchemilla hybrida, Veratrum album, Phyteuma pseudorbiculare, Orchis maculata, Trollius europaeus, Geum coccineum, Ranunculus platanifolius dhe lloje të ndryshme të gjinisë Carex, etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1976) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Liqenak, Ploçicë) dhe Malet e Sharrit Foto: Fadil Millaku (2012), Liqenet e Jazhincës (Prevallë, Piribreg, Konjushë, Livadhishitë). Millaku, F., Krasniqi, E. Malaj, Xh. me 11.07.2013 e konstatuan edhe mbi Shtëpinë e Malorëve (Brezovicë), dhe në lokalitetin Përroi i Durlit. Millaku, F. me 16.06. 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Malin Mokna në lartësi mbidetare 1445 m. Millaku ,F. gjatë 17-20 korrik 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në: Kurvallë (1974 m lartësi mbidetare), Pllaçicë të Vokshit, Pllaçicë të Junikut (1831 m), Bjeshkë të Tropojës (Kosovë-2259 m), Bjeshkë të Dobroshit (2049 m) dhe në Qafë të Bogiqës (2002 m).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të popullacioneve në Gjeravicë dhe Bjeshkë të Dobroshit (Rupë). Këto dy popullacione te këtij lloji edhe pse kanë areal shumë të kufizuar; kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.
-----	--	---	------------------------------------	--	--	---	--------------------------

05 - Rajoni Zhvillimor Juglindje

Ky rajon ka potencial të madh të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga pesë (5) komuna: **Ferizaj, Kaçanik, Shtërpçë, Hani Elezit, Shtime**. Rajoni Juglindje është rajon i pasur me përhapje dhe llojllojshmëri të florës. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 80 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore shumëvjeçare, shkurre, gjysmëshkurre, shkurrë gjethembajtëse, bimë shumëvjeçare tufore, bimë e vogël me pamje të myshqeve, shumëvjeçare me rozetë bazale, bimë me kërcell zvarritës, etj.

Në formë tabelare është paraqitur lista e aseteve të resurseve natyrore.




Figura 7. Bornmuellera diecki



Tabela 5. Lista e aseteve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Juglindje

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I . Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR – JUGLINDJE							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Aubrieta columnae</i> subsp. <i>croatica</i> (Schott, Nyman & Kotschy) Mattf. Emri shqip: <i>Aubriete shtyllake</i> Familja: <i>Brassicaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pak a shumë tufore. Gjethet rombike-pykore, me qime yjore të pakta, me tre dhëmbë në majë; dhëmbi i mesit më i madh se të tjerët dhe me i gjërë së i gjatë. Vilet me 1-3 lule ngjyrë vjollcë. Sepalet 5.5-8 mm. Petalet 12-18 mm. Silikët 7-16 x 2.5-4.5 mm; flegelat zakonisht me dellëzim të rrjetëzuar, vetëm me qime yjore. Lulëzon V-VI, frytëzon VI-VIII. Riprodhohet me farë. Paparisto, K. et al (1988).	Rumuni dhe Ballkan.	Në Luboten rritet në substrat gëlqeror të zonës alpine në 2110 m lartësi mbi detare. Rritet në kuadër të vegjetacionit të shkëmbinjve e shoqëruar nga llojet: <i>Salix reticulata</i> , <i>Achillea ageratifolia</i> , <i>A. atrata</i> , <i>Oxytropis campestris</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>H. alpestre</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Oxytropis halleri</i> , <i>Dryas octapetala</i> , <i>Sedum</i> sp., <i>Saxifraga sempervivum</i> , <i>Saxifraga marginata</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (1984), Josifovic, M. et al. (1977) është e përhapur në shkëmbinj të Foto: Fadil Millaku (2011), Luboten zonës alpine dhe subalpine në Malet e Sharrit – Luboten, Kobilicë, Kaçanik.	Popullacioni i këtij lloji në Luboten ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve brenda këtij Popullacioni është i vogël. Ky lloj në këtë lokalitet është i përhapur kryesisht në të çara të shkëmbinjve e me rrallë në vende ku shemben shkëmbinjte	I rrezikuar në mënyrë kritike.
2	<i>Convolvulus boissieri</i> subsp. <i>compactus</i> (Boiss.) Stace [Convolvulus compactus Boiss.] Emri shqip: <i>Dredhje e Buasierit</i> Familja: <i>Convolvulaceae</i>	Bimë gjysmë shkurte xhuxhe (Kamefite Ch) me trajtë jastëku, deri 10 cm me bucë të dendur. E tërë bima e mbuluar me qime të argjendta-mëndafshita. Gjethet 4-10 mm të gjata, 4-7 mm të gjërë lineare deri ovale, bishtaku i gjatë aq sa edhe llapa. Lulet të vetmuara, gati të ulura, gati pabisht. Kurora 20-22 mm, e bardhë në vjollcë (purpur). Lulëzon VI-VII. Frytëzon VIII (Tutin, T. G. et al. 1972).	Siujdhesa Ballkanike-Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bullgari Jugore deri në Greqinë qendrore, Azi e Vogël, Turqi (Rexhepi, F. 1994, Tutin, T. G. et al. 1972; Saric, M. et al. 1986).	Në Kosovë ky lloj rritet në subsrat serpentini-kullota të thata e vende shkëmbore e lokalizuar vetëm në territorin e Hanit të Elezit (Guranë) në zonën kufitare me Maqedoninë. Rritet në kuadër të fitocenozës Stipeto-Convolvuletum compacti. Shoqërohet nga llojet: <i>Stipa mayeri</i> , <i>Achillea coarctata</i> , <i>Agropyrum cristatum</i> , <i>Thymus lycae</i> , <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Bromus fibrosus</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Galium lucidum</i> , <i>Astragalus onobrychis</i> , <i>Plantago subulata</i> , <i>Potentilla tommasiniana</i> [P. cinerea], <i>Minuartia verna</i> , <i>Ornithogalum umbellatum</i> , <i>Anthyllis</i>	Gjendet vetëm në Guranë, Hani Elezit. (Rexhepi, F. 1979, 2000; Millaku, F. et al. 2011, 2008; Krasniqi, E. et al. 2008).	Popullacioni i këtij lloji ka shtrirje shumë të kufizuar dhe kërcënohet në mënyrë permanente ngase është i lokalizuar vetëm në rrethinën e Guranës (zona kufitare me Maqedoninë) e cila është zonë me potencial mineral dhe nën ndikim të faktorit antropogjen.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

			vulneraria, Paronychia kapela, Chrysopogon gryllus, Sanguisorba minor, Stachys recta, etj.				
3	Crocus flavus Weston Emri shqip: Shafran Familja: Iridaceae	Bimë shumëvjeçare, deri në 30 cm e lartë. (Gjeofite G).Tunika e qepujkës ngjyrë kafe, e përbërë nga fibra paralele të cilat depërtojnë mbi nivelin e dheut. Gjethet kërcellore 4-5, të mbuluara. Gjethet 4-8, shfaqen bashkë me lule, me pak qime ose leshatake. Nuk ka spatë bazale. Braktet dhe brakteolet me gjatësi të barabartë, më të gjata se gjethet kërcellore. Lulet 1-5 (7), ngjyrë portokalli. Pjesa e jashtme e tubit të perigonit me vija ngjyrë vjollce. Fyti i perigonit me pak qime. Petalet e rrumbullakta, pak të mprehta. Filamentet më të shkurtra se anteret. Shtyllëza ngjyrë portokalli, më e shkurtër se thekët. Fruti me shumë fara, kapsulë, i gjatë. Farat në formë dardhe, leshatake, të kuqe të mbylltë (të errët). Lulëzon III-V. Frytton V-VII (Randjelovic, N. et al. 1990).	Bullgari, Greqi, Serbi, Maqedoni, Rumani, Turqi. (Randjelovic, N. et al. 1990; Tutin, T. G. et al. 1980, Polunin, O. 1997), Shqipëri (Shuka, L.2009).	Në Kosovë (Guranë) ky lloj rritet në zonën kodrinore me dushk (Quercetalia pubescentis respektivisht Quercion frainetto). Në lokalitet, në kohën e lulëzimit të këtij lloji janë konstatuar llojet: Scilla bifolia, Quercus pubescens, Crocus kosaninii dhe Colchicum hungaricum. Bullgari, Greqi, Serbi, Maqedoni, Rumani, Turqi. (Randjelovic, N. et al. 1990; Tutin, T. G. et al. 1980, Polunin, O. 1997), Shqipëri (Shuka, L.2009).	Nuk përmendet për Kosovë (Randjelovic, N. et al. 1990). Lloji është konstatuar dhe vlerësuar në një lokalitet të ri në Kosovë (Guranë, Hani Elezit. 18.03.2011) nga F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala. Është lloj i ri për florën e Kosovës.	Deri tani është konstatuar vetëm një popullacion me shtrirje mjaft të kufizuar dhe me numër shumë të vogël të individëve në Guranë. Individët e këtij lloji në shikim të parë ngjajnë me individët e llojit Crocus chrysanthus të cilët janë mjaft të përhapur në këto terrene.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
4	Ilex aquifolium L. Emri shqip: Ashje, Ashe Familja: Aquifoliaceae	Shkurre ose dru i vogël (2-10m), fanerfoite (P), i shogët me përjashtim të bisqeve të rinj dhe lulesës që janë pushpake. Lëvorja ngjyrë hiri – e çelët. Gjethet 5-12 cm të gjata të përherëblera, të thjeshta, të lëkurta, të këmbëra, pa ndajgjethëza, përsipër të blertë-errëta dhe të shkëlqyeshme, përposh të blerta – çelta me bisht të zgjeruar 2mm të gjatë, me llapë eliptike që ka 6-8 gjemba therës në çdo anë dhe në buzë kërcore të valëzuara të bardheme, lulet njëseksore, Lulet mashkullore kanë gjurmë të dukshme gjineceu, ndërsa lulet femërore gjurmë thekësh, të rregullta. në lulesa cima	Evropa Perëndimore dhe Qendrore. Prej Norvegjisë, Danimarkës dhe në jug deri në Mesdhe.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat silikat në pyje të freskëta të dushkut (Quercetum Foto: Elez Krasniqi (2013), Debëllde petraea) dhe ahut (Fagetum montanum). Rritet e shoqëruar nga llojet: Fagus sylvatica, Populus tremula, Rosa canina, Crataegus monogyna, Pteridium aquilinum, Rubus caesius, Corylus avellana, Clematis vitalba, Quercus petraea, Prunus avium etj.	Koshtanjevë , Debëllde, Shtërpcë.	Popullacionet i këtij lloji në Debëllde (afër kufirit Kosovë-Maqedoni) dhe Kashtanjevë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Është konstatuar edhe në Luboten. Zakonisht takohen individ të rrallë të cilët shpesh nga banoret vendor nxirren dhe shiten në treg si dru dekorativ.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

	sqetullore. Kurora 8-16mm e bardhë në lulet femër, ka buzë të kuqe në lulet mashkullore, sepalet 4 të ngjitura. Petale 4 (-9) të lira ose të ngjitura në bazë, thekë 4 rrallë më shumë. Karpele 4 (-6 ose më shumë) të ngjitura në një vezore të mbiteshme, katër kthinore. Shtyllëza 4 vrigullore – pabisht. Fryti bërthokël gati rruzullor 8-10 mm i kuq me shumë fara me endokarp të ngurtë, zakonisht më i gjatë se bishti i tij. Lulon IV – V. Frytton IXII. (Qosja, Xh. et al. 1992).						
5	<i>Linaria alpina</i> (L.) Mill. Emri shqip: <i>Linaria e alpeve</i> Familja: Plantaginaceae [Scrophulariaceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Rizoma është pejzore me shumë bisqe sterile dhe fertile. Kërçelli është i shtrirë ose i ngritur 5-10 (-25) cm, i shogët. Gjethet në kërçell janë 3-4 në qerthuj, të sipërmet të këmbyera, të shogëta, të mbështjellura me pjesë të kaftë, lineare ose heshtore, kah baza të ngushtuara. Lulet janë në lulesa vile me pak lule në krye të kërçellit. Bishtat e luleve janë cilindrik, gati njësoj të gjata sa kupa. Kupa është thellë e ndarë në 5 pjesë heshtore. Kurora është 1.5-2 cm, zakonisht ngjyrë vjollce, me shporr portokalli rrallë të bardhë ose të verdheme. Buza e sipërme është e ndarë në 2 pjesë të kthyer mbrapa, buza e poshtme 3 pjesësh, me vriguj të njëjtë. Shpori është gjator-kupor, i drejt. Kapsula është ovale-topthore, 5-7 mm me shumë fara. Riprodhohet me farë. Lulëzon VII. Frytton VIII. (Rexhepi, F. 1986).	Malet e Evropës (Pirineje, Alpe, Apenine, Karpate dhe Ballkan).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqeror; në shkëmbinj ose vende gurishtore të zonës alpine në kuadër të asociacionit Aubrietetum alpine croatiaceae e shoqëruar nga llojet: <i>Salix retusa</i>, <i>Trifolium badium</i>, <i>Dryas octopetala</i>, <i>Achillea atrata</i>, <i>A. ageratifolia</i>, <i>Erysimum diffusum</i>, <i>Aubrietia croatica</i>, <i>Saxifraga scardica</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (1986) është përhapur në Luboten, Kaçanik.	Ky lloj në Kosovë formon vetëm një popullacion (Luboten) që ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit. Zakonisht ky lloj haset në grupe shumë të vogla dhe me pak individë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

6	<i>Ruscus hypoglossum</i> L. Emri shqip: <i>Rrushkull nëngjuhës</i> Familja: <i>Asparagaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Kamefite - Gjeofite), me kërcell 30-60 cm, të thjeshtë, rrallë me një degë anësore, të ngitur. Kladodet eliptike (8-9 x 3-4) ose heshtore përmysëse (15-17 x 3-4 cm); gjethet e reduktuara në lupsa heshtore të ngyshta (9-12 x 304 mm). Lulet njëseksore, në tufëza nga 3-6 në qendër të kladodit, me një luspë sqetullore. Këmbëzat 6-11 mm. Sepalet 5 mm, gjelbëroshë. Rrushku 10-15 mm, gatirruzzollor, i kuq i çelët. Lulëzon XII-IV. Frytton V-VI. Vangjeli, J. et al. (2000).	Evropë, Azi, Afrikë Veriore.	Në Kosovë rritet në pyllin e ahut (Fagetum montanum) i shoqëruar nga llojet: <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Cardamine bulbifera</i> , <i>Daphne blagayana</i> , <i>Daphne mezereum</i> , <i>Daphne laureola</i> , <i>Achillea grandifolia</i> , <i>Crocus velochensis</i> , <i>Carpinus betulus</i> , <i>Lilium martagon</i> , etj.	Malet e Sharrit (Luboten, Mala, Xh. & Millaku, F. 16.11.2013). Kaçanik.	Popullacioni e këtij lloji në Luboten ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtij Popullacioni është shumë i vogël.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
7	<i>Sideritis scardica</i> Griseb. Emri shqip: <i>Siderit i Sharrit</i> Familja: <i>Lamiaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Kamefite Ch), zakonisht dendësisht leshtore e bardhë, 15-40 cm. Gjethet e poshtme 40-80 x 6-20 mm, gjatore-heshtore, të plota. Qerthujt e remë të ngjeshur në kallit të dendur; braktetë e mesit 12-20 mm, gatirrotullare si zemër, leshtore me qime të shpërndara, menjëherë të thepësura, thepi 2-4 mm. Kupa 9-12 mm; dhëmbët 3-4 (-6) mm, zakonisht gati sa gjysma e gypit. Lulëzon VI-VII, frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996).	Sipas Rexhepi, F. (2000), Stevanovic, V. et al. (1999) në Kosovë është i përhapur në Malet e Sharrit (Luboten-Tupani i madh).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqeror, në vende shkëmbore ose me bar të zonës subalpine. Është konstatuar një popullacion shumë i vogël në Luboten (Tupani). Kemi hasur edhe fragmente të vogla në zonën subalpine afër kufirit me Maqedoninë. Në Tupanin e poshtëm kemi konstatuar <20 individë të shoqëruar nga llojet: <i>Iris reichenbachii</i> , <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Dianthus cruentus</i> , <i>Anthyllis vulneraria</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Stevanovic, V. et al. (1999) në Kosovë është i përhapur në Malet e Sharrit (Luboten-Tupani i madh). Kaçanik.	Popullacioni i këtij lloji në Luboten shtrihet në lartësi mbidetare nga 1240-2000 m. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është shumë i vogël. Ky lloj në Luboten shtrihet kryesisht në zonën ndërkufitare me Maqedoninë dhe numri më i madh i individëve maturë rritet në vende të zhveshura ku përfundon pylli i ahut dhe fillojnë kullotat subalpine.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
8	<i>Tulipa gesneriana</i> L. [<i>Tulipa scardica</i> Bornm.] Emri shqip: <i>Tulipani i Gesnerit</i> [<i>Tulipani i Sharrit</i>] Familja: <i>Liliaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare 20-25 cm, (Gjeofite G). Gjethet 3 rrallë 4 heshtore deri 20 cm të gjata dhe rreth 2 cm të gjëra të valëzuara. Perigoni kambanor i gjatë 3.5-4.5 cm. Njolla brenda perigonit e zezë e rrethuar me hapësirë të verdhë. Thëkë 6; filli rreth 10-11 mm tri herë më të shkurtër se fletëzat e perigonit, Anterat të verdhëme. Gjineceu 20-22 mm i gjatë. Fruti kapsulë. Lulëzon IV-V. Frytton VI-VII (Stevanovic, V. et al. 1999).	Kosovë, Maqedoni (Stevanovic, V. et al. 1999; Polunin, O. 1997; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë gjendet në vende me shkurre në substrat serpentin-nëpër çeltira pylli në kuadër të rendit Quercetalia pubescentis. Shoqërohet nga llojet: <i>Quercus pubescens</i> , <i>Rhamnus frangula</i> , <i>Cotynus coggygria</i> , <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Convolvulus cantabricus</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Dictamnus albus</i> , <i>Comandra elegans</i> , <i>Iris pallida</i> , <i>Cephalaria leucantha</i> , <i>Scorsonera austriaca</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Asyneuma limonifolium</i> , <i>Euphorbia barbelieri</i> , <i>Silene paradoxa</i> etj.	Krevenik (kufiri me Maqedoni) (Stevanovic, V. et al. 1999; MMPH 2008), Ferizaj.	Është gjetur vetëm një popullacion i këtij lloji që ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. (F. Millaku, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi dhe Xh. Mala, 03.05.2013).	I rrezikuar në mënyrë kritike.

9	<i>Viola herzogii</i> (W. Becker) Bornm. Emri shqip: <i>Manushaqe herzogi</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-30 cm e lartë, e ngritur, e degëzuar nga baza. Degëzat me qime dhe me 1-3 lule. Gjethet të gjelbra-hiri me qime. Gjethet bazale 3-5 cm të gjata dhe 1.5-2.5 mm të gjëra , gjilpërore deri lineare-heshtore, të plota ose me 1-3 dhëmbë. Bishti i lules 3-10 cm i gjatë. Lule të shumta, 18-25 mm të gjata, me pak aromë. Sepalet 7-11 x 1.6-2.8 mm të gjëra , heshtore me majë të mprehtë anash cipëthata, të shogëta ose me qime të rralla. Kurora e verdhë e zbehtë. Shpori i shogët 5.6-7.6 mm i gjatë. Micevski, K. (1995).	Maqedoni, Kosovë .	Në Kosovë është konstatuar në substrat serpentin në vende gurishtore të thata ose në të çara të shkëmbinje të zonës malore (Quercion fraineto) e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Rhamnus frangula, Cotinus coggygria, Euphorbia glabriflora, Convolvulus cantabrica, Juniperus oxycedrus, Fraxinus ornus, Iris pallida, Scorzonera austriaca, Fumana bonapartei, Asyneuma limonifolium, Euphorbia barbelieri etj.	Me 03.05.2013 Millaku,F., Pajazitaj, Q., Krasniqi, E., dhe Mala, Xh. e konstatuan në serpentinin e Krevenikut (afër kufirit me Maqedoni) jo larg nga vendi ku ndodhet lokaliteti i përhapjes së llojit Tulipa scardica. Është lloji i ri i florës së Kosovës.	Në Kosovë është konstatuar vetëm një popullacion i vogël në serpentine e Krevenikut. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtij Popullacioni është shumë i vogël. Han i Elezit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
10	<i>Achillea chrysocoma</i> Friv. Emri shqip: <i>Barpezmi balukeartë</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pushbutë deri e mëndafshhtë. Kërcejtë deri 40 cm, të ngritur të thjeshtë. Gjethet pak a shumë cilindrike me përjashtim të me të sipërmeve; bazalet deri 8 cm, me bishtak të shkurtër, dyfishpendore të prera; vrigujt vizakë; gjethet e sipërme kërcellore pabisht, kryesisht njëfishpendore të ndara. Vastaket me 12-15 ose më shumë kaptina; bishtat 2-5 mm. Pështjella 3-5mm në diametër. Braktetë 3-4 cm, me buzë ngjyrë kafe-të errëta. Lulet llapore rreth 3 mm, të verdha të shndritshme. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frynnon VII-VIII. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës ose insekteve. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Maqedoni, Greqi, Serbi).	Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore ose kullota me bar të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Armeria alpina, Jovibarba heuffeli, Lilium albanicum, Helianthemum canum, Festuca koritniensis, Stachys alpina, Botrychium lunaria, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Myosotis alpestris etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e përhapur në Luboten. Sipas Saric, M. et al. (1986), Josifovic, M. et al. (1977) në Livadhishhtë, Kobilicë, Luboten dhe Koritnik. Millaku,F & Mala, Xh. me 26.07. 2011 e konstatuan në lokalitetin Liqenet e Jazhincës në lartësi mbidetare 1995 m, në kuadër të kullotave alpine dhe subalpine, kurse në Brezovicë me 26.07.2011, në kuadër të kullotave alpine në lartësi 2350 m. Përveç lokaliteteve të cekura në kuadër të Maleve të Sharrit janë hulumtuar edhe popullacionet e këtij lloji në Pashtrik, Restelicë, Vracë, Piribreg, Bistër, Maja e Zezë, Vërtop dhe Karanikollë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura vetëm në kuadër të Maleve të Sharrit. Këto popullacione kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve.	I rrezikuar.

11	<i>Artemisia umbelliformis</i> subsp. <i>eriantha</i> (Ten.) Xirau & Branas [Artemisia petrosae] Emri shqip: Artemisia erianthe Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Kamefite Ch), 8-25 cm e lartë e drejtë, pushbutë, e mëndafshhtë. Gjethet bazale dyfishpendore me vriguj vezak heshtorë, majëmpreht. Kapitina gjysmërruzullore 5-7 mm në diametër, zakonisht në një vile të thjeshtë; të poshtmet me bishta të shkurtër kurse të sipërmet afërsisht pabisht. Braktet e pëshqjellës 3-5 mm, vezake deri heshtore përmbysset, shyte, cipëthata; të brendshmet ngjyrë kafë. Shtrati i kaptinës i shogët. Lule 25-30. Kurora me qime leshtore, e verdhëreme. Akenët leshtorë. Lulëzon VII-VIII, frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë.	Sipas Tutin et al. (1976) është e përhapur në: Ballkan, Karpate, Pirineje, Alpe, Apenine (Suballkanike - Submesdhetar e)	Rritet në substrat silikat-kvarcit ose ndonjëherë edhe në substrate gëlqerore dhe vende gërrisore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Rhodiola rosea, Anthemis montana, Saxifraga scardica, Saxifraga tridactylites, S. aizoides, S. quadridentata, S. exarata, Silene pusilla, Asplenium viride, Gentianella bulgarica, Gnaphalium supinum, Scrophularia laciniata etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është prezent në shkëmbinj silikat të zonës subalpine dhe alpine të gjëra vicës. Sipas Saric et al. (1986) në Malet e Sharrit është konstatuar në: Luboten, Livadhishtë dhe Shtëpi e Malorëve.	Popullacioni i këtij lloji në Gjeravicë ka areal të kufizuar dhe numri i individëve në kuadër të këtij Popullacionit është i vogël. Edhe popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Luboten, Livadhishtë dhe Shtëpi e Malorëve) janë me areal shumë të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
12	<i>Phyllolepidium rupestre</i> (Sweet) Trinajstić [Aurinia rupestris (Sweet) Cullen & T.R.Dudley, Ptilotrichum rupestre (Ten.) Boiss.] Emri shqip: - [Ptilotrik] Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare, tufore. Gjethet të përhitura, bazalet heshtore, të tjerat lineare. Kupa 5 mm e gjatë. Fryti vezak i përmbysset ose i rrumbullakët, 6 mm i gjatë, shpatuk, me qime në formë ylli ose i shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë.	Itali, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror, në vende të thata me gurë ose në shkëmbinj të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Minuartia baldaci subsp. doerfleri, Potentilla apenina, Potentilla speciosa, Viola elegantula, V. grisebachiana etj.	Sipas Josifovic, M. et al (1972), Saric et al. (1986) është e përhapur në Koritnik, Dragash Luboten, Kaçanik.	Popullacionet e këtij lloji në Koritnik dhe Luboten kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Koritnik ky lloj takohet përgjatë kurrizit afër kufirit me Shqipërinë.	I rrezikuar.
13	<i>Bornmuellera dieckii</i> Deg. Emri shqip: Bornmylerë Familja: Brassicaceae	Gjysmëshkurte (Kamefite Ch). Gjethet gjatore-vizake, nga sipër të shogëta, nga poshtë me qime të rralla dykrahëshe. Lulesa e degëzuar, ndërsa e pjekur e dendur. Lulet janë të bardha, thekët në bazë me dhëmbë të zgjeruar. Frytet vezak, pak të shtypur, të shogët, rreth 4 mm të gjatë. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VIII. (Rexhepi, F. 2000).	Kosovë (Rexhepi, F. 2000; Tutin, T. G. et al. 1964).	Në Kosovë rritet në terrene të hapura serpentine (kullosa të thata) në kuadër të fitocenozës Sedo-Bornmuellerietum dieckii, dhe në pyllin e rrobullit (Pinus heldreichii) dhe në pyllin e kërkëkës (Pinus mugo) në shoqëri me llojet: Cerastium neoscardicum, Viola dukadjinica, Plantago subulata, Potentilla astracanica (P. hirta), Bromus fibrosus, Sedum serpentinum, Linum flavum, Pinus mugo, Pinus heldreichii, Lilium albanicum, Gentiana lutea etj.	Malet e Sharrit (Malo Borce, Koxha Ballkan, Malet e Jezercit, Pashallarë) (Millaku, F. et al. 2008, Rexhepi, F. 1982, 1985, 2000; Rexhepi, F. et al. 2008, Krasniqi, F. 1982, 1987, 1998; Blečić, V. et al. 1968, 1969, Diklic, N. & Nikolic, V. 1980).	Popullacioni i këtij lloji në Kosovë ka areal të kufizuar (Pashallarë dhe Koxha-Ballkan) mirëpo numri i individëve maturë është i konsiderueshëm.	I rrezikuar.

14	Campanula albanica Witasek Emri shqip: Lulekambanë shqiptare Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), (6-) 8-15 (-24) cm, të përpjetëm deri ngritur, të shogët. Gjethet e bazës si zemër, të sharruara, që mungojnë gjatë kohës së lulëzimit, kërceloret eliptike të ngushta deri vizake, pak a shumë buzë plota, kryesisht majëmprehta. Lulet të vetmuara, rrallë nga 2-3 së bashku. Vezorja me puprri, rrallë e lëmuar. Dhëmbët e kupës deri 12 mm, trekëndësh të ngushtë deri vizake. Kurora 14-18 (-22) mm, blu deri manushaqe. Kapsula (6-) 7-8 mm, si fugë, e varur. Lulëzon VI. Frytnon VIII (Qosja. Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik-pjesa Jugperëndimore (Tutin, T. G. et al. (1976).	Lulekambana shqiptare (Krasniqi, F. et al. 2003) në Kosovë rritet në shkëmbinj silikat (Crepidetalia dinaricae respektivisht Campanulion albanicae) ose në kullota të thata të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Silene pusilla, Polygonum alpinum, Senecio wagneri, Cryptogramma crispa, Cerastium alpinum, Helianthemum nummularium, Hieracium pilosella, Senecio doronicum subsp. glaberrimus, Geranium subcaulescens, Campanula alpina, Potentilla doerfleri, Armeria alpina, Sempervivum macedonicum, Juncus trifidus, Saxifraga tridactylites etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000, 1986, 1982), Diklic, N. & Nikolic, V. (1981) dhe Saric, M. et al. (1986) gjendet në Malet e Sharrit (Shtëpia e StojkutÇukat e Liqenit), Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Hajlë, Maja e Ropsit). Popullacione të vogla të këtij lloji gjatë viteve 2011-2013 u konstatuan edhe në Brezovicë, Qukat e Jazhincës, Vracë, Pashallarë dhe Koritnik (Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F. Krasniqi, E & Mala, Xh). Shtërpçë,	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Zakonisht rriten në grupe të vogla, ndërsa për nga habitusi ngjajnë shumë me llojin C. scheuchzeri.	I rrezikuar.
15	Crepis albanica (Jav.) Babcock [C. baldacii subsp. albanica Jav.] Emri shqip: Shmangë shqiptare Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare; kërcëjtë 3-4, deri 35 cm, me 1-10 degëza (Hemikriptofite H). Gjethet të shogëta ose pushuake të rralla; gjethet e bazës 10-15x2.5-3 cm, të shumta, heshiore, të përmbysta, majëmprehta, me prerje të thella jo të rregullta të kthyer në drejtim të bazës, pendore të çara deri lirake-pendore, me vriguj të mëdhenj fundorë me dhëmbë të mprehtë dhe me vriguj anësorë të larguar, shumë të reduktuar, majëmprehtë, të ngushtuar në bazë; gjethet e jashtme lëkurore të ngjashme me ato të bazës; të sipërmet vizake-heshiore të thepëta. Kaptinëzat të pakta deri të shumta. Pështjella 11-14x7-9 mm; braktetë vizake-heshiore, majëmprehta, të jashtmet sa 2/3 e gjatësisë së të brendshmeve, të përhimapushbuta dhe me qime të shkurtra gjëndërore, pushlore në faqen e brendshme. Lulet me	Shqipëri, Kosovë, Mali Zi, Greqi (Tutin, T. G. et al. 1976; Josifovic, M. et al. 1975, Rexhepi, F. 1994).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqerorë dhe silikat të zonës subalpine e alpine i shoqëruar nga llojet: Campanula foliosa, Sempervivum macedonicum, Campanula Foto: Elez Krasniqi (2011), Vracë spatulata, Geum montanum, Vaccinium myrtillus, Vaccinium uliginosum, Veratrum album, Jasione orbiculata, Phyteuma pseudorbiculare, Centaurea nervosa, Ajuga pyramidalis, Lilium albanicum, etj.	Alpet Shqiptare (Bjeshkë të Lumëbardhit, Koprivnik, Gryka e Rugovës) (Josifovic, M. et al. 1975, Rexhepi, F. 1982, 1986, 1997, 2000). Konstatimi dhe vlerësimi i gjendjes së llojit është realizuar gjatë viteve 2011-2013 edhe në Malet e Sharrit (Liqenet e Jazhincës, Piribreg, Livadhishhtë, Bistër, Brod, Shutman, Vracë) (F. Millaku, Q. Pajazitaj, E. Krasniqi, Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit edhe pse me shtrirje bukur të gjërë, numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël. Zakonisht takohen individ të vetmuar.	I rrezikuar.

		ngjyrë të verdhë. Akenët 6.57.75 x 0.7-0.8 mm, të kuqërremtë-kafe, boshorë, të holluar në majë, me 20 brinjë. Lulëzon VI-VIII. Frytton IX (Vangjeli, J. et al. 2000).					
16	<i>Crocus kosaninii</i> Pulevic Emri shqip: <i>Shafran i Koshaninit</i> Familja: Iridaceae	Bimë shumëvjeçare, deri në 15 cm (Gjeofite G). Qepujka deri në 1 cm e gjërë, e mbuluar me një tunikë të thurur. Gjethet kërcellore 4(5), gjethë 2(3) deri në 4 mm të gjëra. Spathet bazale në fund të kërcellit dhe me brakte në fundin e lules. Nuk ka brakteole. Lulet të vetme, rrallë dy, ngjyrë vjollce të lehtë, ose krejtësisht të bardhë. Gypi i perigonit deri në 12 cm i gjatë, me shenja ngjyrë vjollce të errët në pjesën e sipërme të cilat vazhdojnë edhe mbi petale. Qafa (Fyti) i perigonit ngjyrë të verdhë. Petalet me 1.5-2.5 cm gjatësi dhe 0.6-1.5 cm gjërësi. Thekët me 1.1-1.7 cm gjatësi: fijet të verdha. Stili (Pjesë e pistilit) zakonisht më i gjatë se thekët. Fryti ka shumë fara në kapsulë, relativisht i plotë (gjërë). Farat të plota, rrethore-vezake, ngjyrë kafe. Lulëzon II-III. Frytton IV-VI (Randjelovic, N. et al. 1990).	Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë (Randjelovic, N. et al. 1990; Tutin, T. G. et al. 1980; Rexhepi, F. 1994).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrate silikate dhe serpentine të zonës së dushkut (Quercetalia pubescentis respektivisht Quercion frainetto) dhe në kullota kodrinore i shoqëruar nga llojet: Quercus frainetto, Quercus cerris, Crataegus monogyna, Viola odorata, Helleborus odorus, Muscari botryoides etj.	Kaçanik, Brezovicë, Blinajë. Sipas Koshaninit (1926) gjendet edhe afër Vushtrrisë (Randjelovic et al. 1990, Krasniqi, F. 1998). Përveç rrethinës së Kaçanikut, ky lloj është konstatuar dhe vlerësuar edhe në një lokalitet të ri (Guranë 18.03.2011) nga F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala.	Popullacionet e llojit janë me numër të konsiderueshëm të individëve maturë, por kanë areal të kufizuar të shtrirjes. Në veçanti areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë ka Popullacioni i këtij lloji në Guranë.	I rrezikuar.

17	<i>Daphne blagayana</i> Freyer Emri shqip: <i>Xerxele e Bllagajt</i> Familja: Thymelaeaceae	Gjysmëshkurre e përherë e blertë deri 30 cm (Kamefite Ch) me kërcëj të gjatë, të shtrirë, të degëzuar e të hapur, me gjethe vetëm në krye. Gjethet 3-6 cm, vezake të përmbysëta deri elliptike të zgjatura, shyte, të pabisht, të shogëta, lëkurore. Lulet të bardha-krem, 15-18 mm, të merme, të pabisht, në kaptinëza, 10-15 së bashku. Braktetë të zbehta e pushbuta përposh, rreth 10 mm. Hipanti 15-20 mm, i ngushtë, me pak qime të mëndafshita. Nënpetlat 6 mm, shyte, të shtrira. Frytet bërthokla të bardhëme. Lulëzon IV-VI. Frytton VIII (IX). (Qosja, Xh. et al. 1992).	Gadishulli Ballkanik, e përhapur në pjesët veriore të Sllovenisë dhe në Karpatet Jugore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat serpentin, në pyje, kullota e shpate me bazë shkëmbore serpentine. Në Morinë (962 m l. m. d.) gjendet në vende shkurre me boshtrë (F. europaea) në substrat serpentin e shoqëruar na llojet: Forsythia europaea, Quercus petraea, Doronicum columnae, Erythronium dens-canis, Galium sylvaticum, Pulmonaria mollissima, Luzula sylvatica, Euphorbia amygdaloides, Primula veris etj. Në lokalitetin Kodra e Lartë (Kopaonik) (1530 m l. m. d.) gjendet në shpatije të zhveshura në substrat serpentin në kuadër të fitocenozës Daphno-Genistetum radiatae [Daphno-Cytisanthetum radiatae Foto: Elez Krasniqi (2011), Morinë serpentinicum. Në këto terrene gjendet në shoqëri me llojet: Genista radiata, Betula verrucosa, Rosa spinosissima, Dorycnium herbaceum, Polygala vulgaris, Polygala comosa, Dianthus cruentus, Euphorbia glabriflora, Echium rubrum, Ornithogalum umbellatum, Helianthemum nummularium, Scorsonera rosea etj.	Kopaonik (Kodra e lartë) (Rexhepi, F. 1994, 1985, 1986; Randjelovic, N. et al. 1979; MMPH 2008). Përpos vlerësimit të gjendjes në Kodrën e lartë (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi-14.06.2013), gjendja e Popullacionit të llojit u konstatua dhe u vlerësua në Morinë-lokaliteti "Lana e Madhe" më 19.04.2013 (F. Millaku dhe E. Krasniqi). Një popullacion i llojit gjendet edhe rreth Lubotenit-Vataj (18.03.2011, F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacionet në Kopaonik dhe Morinë janë më të pasura me individë maturë. Popullacioni në rrëzat e Lubotenit ka areal shumë të kufizuar dhe <100 individë maturë. Konsiderojmë se ky lloj mund të jetë i përhapur edhe në ndonjë lokalitet tjetër të ngushtë në Kosovë.	I rrezikuar.
18	<i>Diphasiastrum alpinum</i> (L.) J. Holub [<i>Diphasium alpinum</i> (L.) Rothm.] Emri shqip: <i>Difaz i alpeve</i> Familja: Lycopodiaceae	Bimë me kërcell zvarmitës, 60-100 cm (Kamefite Ch). Degët anësore rreth drejta, të shpeshta, në formë buce katërfaqësore ose pak të shtypura dhe me gjërësi 1.5-2 mm. Gjethet në degët shterpa i ka në 4 rreshta. Gjethet anësore lineare-ovale janë të ngjitura në mes veti dhe me degë deri në mes. Gjethet e poshtme të palosura për degë, mishtore, lineare me bisht. Sporofilet lineare të mprehta. Strobiluset 5-15 mm të gjata, pabisht, mezi i kalojnë degët anësore sterile. Sporet janë në formë të rjetës. VII-IX (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi Veriore dhe Perëndimore, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Haecupler, H. & Myer, Th. 2007).	Rritet në substrat silikat në vende me barë e më rrallë shkëmbore të zonës subalpine e alpine mbi 1500 m l.m.d. (Bruckenthalio-Juniperetum) në shoqëri me llojet acidofile: Juniperus sibirica, Bruckenthalia spiculifolia, Vaccinium uliginosum, Empetrum nigrum etj.	Alpet Shqiptare (Bogiqë, Bjeshka e Belegut, Maja e Ropsit, Ishtedim), Malet e Foto: Fadil Millaku (2013), Bjeshka e Belegut Sharrit (Vracë, Bistër, Millaku, F. 1999, Rexhepi, F. 1986, Saric, M. et al. 1992). Ky lloj është konstatuar edhe në lokalitetin Përroi i Durlit në lartësi mbidetare 2100 m.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

19	<i>Drypis spinosa</i> L. Emri shqip: <i>Dripis</i> Familja: <i>Caryophyllaceae</i>	Është bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) dendësisht tufore, 8-30 cm. Kërcejtë janë të ngritur, shumë të degëzuar, të shogët, katër-këndorë. Gjethet janë të ngushta lineare, të forta, me majë dhe me ferrë (gjemb) në fund. Lulesa është dikaze, e ulur në formë kaptine. Braktet e sipërme janë heshtore ose ovale me gjemb të gjatë terminal, shumë më të gjata se lulet ose me gjemb të shkurtër, pak më i gjatë se lulet. Kupa ka formë gypore- kambanore me 5 dhëmbë shumë a pak lëkurore. Fletëzat e kurorës janë shumë të ngushta të ndara thellë në dy pjesë, me një parakurorë të ngushtë. Thëkë ka 5. Kapsula është ovale-eliptike, çilet me kapak. Lulëzon VI-VII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 1986).	Shqipëri, Greqi, Itali, (Bimë lliro-Adriatike) (Tutin, T. G. et al. 1964; Rexhepi, F. 1986; Josifovic, M. et al. (1970)).	Në Kosovë (Koritnik dhe Luboten), rritet në shkëmbinj gëlqeror (shëmtira të shkëmbinjve) të zonës subalpine (Drypetum spinosae). Shqërohet nga llojet: Trifolium noricum, Rumex scutatus, Senecio rupestris, Scutellaria alpina etj.	Koritnik, Luboten. (Rexhepi, F. 1986, 1997; Diklic, N. & Nikolic, V. 1961).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar (vetëm në vendet ku shemben shkëmbinjtë).	I rrezikuar.
20	<i>Geum reptans</i> L. Emri shqip: <i>Mëlakë zvarranike</i> Familja: <i>Rosaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 1-1.5 cm me rizomë të drunjëzuar. Stolonet janë zvarritëse me gjethe të larguara. Gjethet bazale janë pendore me shumë brakte gati të njëjta, të sharrëzuara ose të ndara pendore. Brakte terminale nuk është e madhe. Kërçelli është i vogël me një lule. Sepalet janë lineare-heshtore, 14 mm të gjata. Petalet janë 5-8 me ngjyrë të verdhë-ari. Shtyllëza nuk është e artikuluar, ka qime qerpikore. (Rexhepi, 1986). Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII. (Rexhepi, 1986)	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Serbi).	Ky lloj rritet në substrat silikat, në të çara të shkëmbinjve të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Silene lichenfeldiana, Saxifraga scardica, Potentilla doerfleri, Achillea abrotanoides, Arabis alpina, Cardamine acris, Selaginella selaginoides, etj	Sipas Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1977), është e përhapur në Livadhishtë, Bister, Maja e Zezë, Piribreg. Me 07.08. 2012 Krasniqi, E., Millaku, F. & Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan edhe në Vracë në kuadër të shkëmbinjve të zonës Foto: Fadil Millaku (2013), Livadhishtë alpine.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura vetëm në Malet e Sharrit dhe kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

21	<i>Gladiolus palustris</i> Gaudin Emri shqip: <i>Gladiolë kënetash</i> Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 25-50 cm. Milet bazale të gjelbërt, ndonjëherë me nuanca të kuqe zakonisht gjatë nervurave. Gjethet janë 10-40 cm x 4-10 mm të gjata dhe 4-10 mm të gjëra, zakonisht vetëm një gjethe kërcellore braktengjashme me dy gjethe bazale. Kalliri njëanësor deri me 6 lule. Rrëthlulja e kuqe deri e kuqe-purpur. Segmentet e rrëthlules 25 x 40 x 6-16 mm, të sipërmit gati të barabartë, vezakepermbyset, anësoret rombikë, të poshtmit rrëth1/3 e gjatësisë të të sipërmeve, gjatorë-pykorë; thonjëza aq sa llapa. Riprodhohet me farë dhe bulb. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Evropë.	Rritet në livadhe ose kullota me lagështi. Në Brezovicë rritet në livadhe të cilat me parë kanë qen pyje të verrit (Alnetum glutinosae) e shoqëruar nga llojet: Alnus glutinosa, Fraxinus angustifolia, Taraxacum officinale, Galium verum, Bellis perennis, Ranunculus millefoliatus, Trifolium pratensae, Poa pratensis, Plantago major, Equisetum arvensae etj.	Brezovicë, Llabjan (Novobërdë), Rexhepi, F. (1978), Llopshnik (Dragash).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të Popullacionit në Brezovicë që është me i ruajturi në krahësim me popullacionet tjera.	I rrezikuar.
22	<i>Haplophyllum boissierianum</i> Vis. et Panc. Emri shqip: <i>Haplofil i Buasierit</i> Familja: Rutaceae	Bimë gjysmë shkurre (Kamefite Ch). Kërcejtë janë me gjatësi 6-25 cm, me push të përdredhur, pak a shumë leshtore në pjesën e lulesës. Gjethet janë të thjeshta 1040×1.5-3 mm heshtore deri heshtore të përmbysëta, të holluara poshtë me pak qime ose të shogëta. Lulesa është pak a shumë e dendur, sepalet janë vizake-heshtore. Kapsula është pushlore në faqen e brendshme afër majës me gjëndra të rralla pak a shumë zhardhokore poshtë, në çdo vrigull me nga një shtojcë konike me majë, që nganjëherë e ndarë në zhardhokë më të vegjël. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Vendet Ilire (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentinar në vende të thata me barë dhe shkëmbore të zonës kodrinoro-malore. Në pjesën me të madhe të habitateve ku është takuar ky lloj rritet i shoqëruar nga llojet: Fraxinus ornus, Dorycnium pentaphyllum, Campanula lingulata, Alyssum markgrafi, Quercus petraea, Salvia ringens, Polygala doerfleri, Sanguisorba minor, Thalictrum minus, Sedum serpentini, Sedum telephium, Forsythia europaea etj.	Sipas Josifovic, M., et al. (1973) është e përhapur në Luginën e Ibrit, Rogozna, Gubavc, Qafa e Prushit, Koznik. Gjatë viteve 2011-2013, Rexhepi, F. Pajazitaj, Q. Millaku, F. Krasniqi, E. dhe Mala, Xh. e konstatuan edhe në Bokat e Morinës (Ponoshec), Krevenik (Elez Han) Bokat e Baqevcit (Mushtisht), Gubavc (Koprivnik).	Edhe pse ky lloj në Kosovë ka përhapje të gjërë dhe formon disa popullacione; këto popullacione kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël, me përjashtim të popullacioneve në Qafë Prush dhe Bokat e Morinës që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

23	<i>Hesperis dinarica</i> Beck Emri shqip: <i>Hesperidë dinarike</i> Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e gjatë deri 1 m. Kërçelli është i mbuluar me qime të thjeshta gjëndërore. Gjethet janë të blerta të mbuluara me qime gjëndërore. Gjethet e poshtme janë vezake-heshtore me bisht të shkurtër, të sipërmet heshtore në bazë pak të ngushtë. Kurora është 17-20mm e gjatë, e bardhë. Silika është 7-10cm e gjatë, e shogët. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Paparisto, K. et al. (1988).	Ballkan.	Rritet në kuadër të pyllit të ahut ose pyllit të përzier të ahut me bredh (Abieti Fagetum) ose të bredhit me hormoq (Abieti-Picetum). Në Zhleb dhe në Maje të Rusolisë rritet e shoqëruar nga llojet: Acer heldreichii, Senecio othonnae, Fagus sylvatica, Ramnus falax, Tanacetum macrophyllum, Digitalis ambigua	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al (1986), Josifovic, M., et al (1972) ky lloj është i përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb dhe Maje të Rusolisë) dhe në Malet e Sharrit (Ujërat e Humbura).	Ky lloj në Kosovë formon dy popullacione: një në Alpet Shqiptare dhe një në Malet e Sharrit. Popullacioni në Alpet Shqiptare është i përbërë nga dy subpopullacione të vogla. Popullacionet e këtij lloji ë Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare kanë areal shumë të kufizuar, dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre dy popullacioneve është shumë i vogël.	I rrezikuar.
24	<i>Huperzia selago</i> (L.) Bernh. ex Schrank & Mart. Emri shqip: <i>Hupersi selago</i> Familja: Lycopodiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-15 cm. Kërçelli pak a shumë i drejtë, i degëzuar me degë të njëjta të mbuluara me gjethe. Gjethet lineare të holla, të ashpra ose ndonjëherë edhe pak të dhëmbëzuara që krijojnë 8 rreshta. Gjethet sporofile dhe gjethet sterile janë njësoj dhe nuk e formojnë kallirin sporofill. Sporangjet gjenden të vetmuara në sqetullën e sporofitit. Riprodhohet me spore dhe organe vegetative. VIII. (Rexhepi, 1986).	Evropë, Azi, Amerikë, Zelanda e Re, Tasmani.	Rritet në vende shkëmbore të freskëta, pyje të halorëve dhe kullota të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Plantago gentianoides, Valeriana officinalis, Pinus peuce, Juniperus sibirica, Vaccinium myrtillus, Bruckenthalia spiculifolia, Empetrum nigrum, Abies alba, Senecio nemorensis, Veratrum album etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve (Brezovicë, Luboten, Livadhishitë, Piribreg, Përroi i Durlës, Bistër, Kojnak led, Liqenet e Jazhincës). Në kuadër të Alpeve Shqiptare është konstatuar në Gjeravicë (Millaku, F. 18.07.2013).	Edhe pse ky lloj ka një përhapje të gjërë në vende të flohta dhe mesatarisht të flohta të dy hemisferave përveç Afrikës, në Kosovë kjo bimë është pak e përhapur përkatësisht në Foto: Fadil Millaku (2012), Liqenët e Jazhincës lokalitetet e cekura, ka pak individ. Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë me areal të kufizuar dhe kanë numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
25	<i>Minuartia baldaccii</i> (Hal.) Mattf., subsp. doerfleri Hayek Emri shqip: <i>Minuartie e Baldaçit</i> Familja: Caryophyllaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rizoma të trasha, të drunjëzuar, deri 20 cm, të mbushura me gjethe të dendura. Kërcejtë relativisht të shkurtër me ndërnjye shumë të ofruara; ata lulebartës 4-6 cm të gjatë, me push gjëndëror sipër. Gjethet 5-9 mm të gjelbra, vizake të mprehta shpesh të njëanshme, me qerpikë të vegjël, me push gjëndëror ose të shogëta me një nervurë. Lulesa nga 13 lule. Sepalet 4-5 mm të gjata. Petalet vezake të përmbystë; 11-12 mm të gjata. Kapsula sa nënpetlat. Lulëzon VI-	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Greqi).	Ky takson rritet në Kullota dhe substrate shkëmbore gëlqerore të zonave të larta malore. Popullacioni i këtij lloji në Luboten ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve të maturë. Në Koritnik gjendet një popullacion me areal shumë të kufizuar që shtrihet në zonën alpine kryesisht në ekspozicionin verior dhe verilindor. Pjesa më e madhe e individëve të popullacionit shtrihet përgjatë kurritit të Koritnikut në lartësi 2390 m e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Onobrychis	Sipas Rexhepi, F. (2000), Josifovic, M. et al. (1977) subsp. doerfleri është e përhapur në Koritnik dhe Luboten.	Popullacioni i këtij lloji në Koritnik shtrihet në substrate gëlqerore në zonën alpine ka areal shumë të kufizuar dhe numri më i madh i individëve është konstatuar përgjatë kurritit të këtij masivi malor (afër kufirit me Shqipërinë). Popullacioni i këtij lloji në Luboten ka areal me të kufizuar dhe numër më të vogël të individëve, krahasuar me popullacionin në Koritnik.	I rrezikuar.

		VIII. Frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë dhe rizoma. Paparisto, K. et al. (1988).		scardica, Aster alpinus, Helianthemum canum, Ptilotrychum rupestre, Pedicularis, brachyodonta, Edreianthus graminifolia, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum etj.			
26	<i>Narcissus poeticus</i> subsp. <i>radiiflorus</i> (Salisb.) Baker Emri shqip: <i>Selikal, Narcis, Lulëxheneti, lulëdremiqare</i> Familja: <i>Amaryllidaceae</i>	Baristore shumëvjeçare (Gjeofite (G), me bulb të gjatë 50-60 mm dhe të gjërë 15-25 mm,me mbështjellë ngjyrë kafe. Kërçelli 20-40 (60) cm i lartë me dy brinjë të sheshta. Gjethet 2-5 lineare, me 5-8 mm, të gjëra , të sheshta, pak a shumë të rimta ose të gjelbra me të shkurtra se kërçelli. Zakonisht në maje të kërçellit një lule rrallë 2 ose me shumë. Segmentet e rrethlules 22-30 mm, të bardha, në fillim të lulëzimit të bardha në të verdhë, gati vezakepërmbyset-pykore, me thonjëz pak a shumë të dallueshëm pak a shumë me kinde. Korona 2-2.5 x 8-10 mm, cilindrike. Të gjithë thekët gati të një madhësie dalin pjesërisht jashtë rrethlules. Lulëzon V-VI. Frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe bulb. Vangjeli, J. et al. (2000).	Alpe të Evropës, Karpate, Ballkan.	Në Kosovë rritet në livadhe me lagështirë që kositen të zonës kodrinore dhe malore e shoqëruar nga llojet: Taraxacum officinale, Galium verum, Alnus glutinosa, Bellis perenis, Ranunculus millefoliatus, Silene viscaria, Ajuga genevensis, Trifolium pratensis, Plantago mayor, P. lanceolata, Sanguisorba minor, Poa pratensis, Fetuca sp., Galium cruciata, G. palustrae. Në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut) ky lloj është konstatuar në zonën e Ahut dhe rrobullit në 1710 m lartësi mbi detare e shoqëruar nga llojet: Lilium albanicum, Fritillaria messanensis, subsp. gracilis, Asphodelus albus, Achillea abrotanoides, Gentiana lutea, Pinus heldreichi, Acer pseudoplatanus etj.	Sipas Hundozi, B. (1980), Josifovic et al. (1975) dhe Krasniqi, E. et al. (2020) është e përhapur në rrethinën e Kaçanikut, Dumnicë, Ferizaj, Dobroshevc, Miradi e Ulët, livadhe të Llabjanit (afër Artanës), Brezovicë (Rexhepi, F.1978). Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N., me 19.05.2013 e konstatuan një popullacion të këtij lloji në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut - 1710 m). Është lokaliteti i parë i këtij lloji i konstatuar në Alpet Shqiptare.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar. Arealat e këtyre popullacioneve po shkojnë në vazhdimësi duke u zvogëluar si pasojë e ndërtimeve të rrugëve dhe qendrave urbane gjatë 10 vitet e fundit. Popullacioni më interesant i këtij lloji është popullacioni i konstatuar në Majën e Vjellakut - Alpet Shqiptare. Ky popullacion ka një areal shumë të kufizuar dhe dallon nga lokalitetet tjera në aspektin e diversitetit floristik.	I rrezikuar.
27	<i>Pedicularis hoermanniana</i> K. Maly Emri shqip: <i>Pedikulare hoermaniane</i> Familja: <i>Orobanchaceae</i> [Scrophulariaceae]	Baristore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 30-100 cm, me kërçell të ngritur, zakonisht e mbuluar me gjethet. Gjethet dyfishpendore, me vriguj pendor të thellë, dhe të sharrëzuar buzëve të gjethit. Braktet në pjesën e poshtme të lulesës të ngjashme me gjethet e kërçellit dhe shumë me të gjata se lulet. Kupa formë kambane, me 5 dhëmbë të shkurtër, e mbuluar me qime të shkurtra kaçurrele. Kurora e madhe, 2 cm e gjatë, ngjyrë e verdhë e çelët; buza e sipërme gati e drejtë kurse maja e rrumbullakët e topitur, nga	Kosovë, Shqipëri, Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi, Bullgari.	Rritet në substrate gëlqerore dhe kullota të thata të zonës subalpine e shoqëruar nga llojet: Lilium albanicum, Potentilla ternata, Senecio scopoli, Senecio bosniaca, Stachys alpina, Myosotis alpestris, Asphodelus albus, Juniperus sibirica, Ranunculus montanus, Hypochaeris maculata etj.	Millaku, F. me 29.05.2013 e konstatoj në Pashtrikun e Poshtëm në kullota të zonës subalpine. Ekzistojnë shënime se ky lloj është i përhapur edhe në Alpet Shqiptare por nuk ceken lokalitetet. Në Malet e Sharrit është hasur në rajonin e Koxhaballkanit (afër tre kufirit midis komunave; Prizren, Therandë, Shtërpçë)	Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik është shumë i vogël dhe janë konstatuar gjithsej më pak se 20 individë maturë. Edhe Popullacioni në Koxhabalkan ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

		jasthtë e mbuluar me qime të buta. Lulëzon VI-VIII. Josifovic, M. et al. (1974).					
28	Potentilla doerfleri Wettst. Emri shqip: Potentillë e Dorflerit Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 30 cm e lartë, me kërcell të mbuluar me qime të gjata (1-2 mm), shpesh edhe me qime gjëndërore. Gjethet pëllëmbore me 5 gjethëza të gjata 15-40 mm, vezake të dhëmbëzuara ose sharrëzuara, me majë të vogël, me qime ngjyrë të blertë ose të blertë të hirtë. Lulet të shumta. Sepalet trekëndore-heshtore. Nënkupa (kupa e dytë) e ndarë në segmente lineareheshtore, afërsisht e gjatë sa nënpetlat. Petlat 5-7 mm të gjata, të bardha, me të shkurtra se nënpetlat. Fillet e thekëve dendur të mbuluar me qime të palosura. Lulëzon VII-VIII, frytëzon VIII-IX, riprodhohet me farë.	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Maqedoni (Micevski & Matevski, 1987).	Rritet në kuadër të vegjetacionit të shkëmbinje silikat të zonës alpine (Potentillo doerfleri-Juncetum trifidi), e shoqëruar nga llojet: Achillea abrotanoides, Anthemis montana, Saxifraga moschata, Sempervivum macedonicum, Veronica bellidoides, Gentianella bulgarica, Juncus trifidii, Armeria alpina, Saxifraga paniculata, Saxifraga tridactylites, Erigeron alpinus etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Saric, M. et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Prevallë, Maja e zezë, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Përroi i Durlit, Bistra, Maja e Zezë, Luboten). Me 07.08.2011 Millaku, F. & Krasniqi, E. e konstatuan edhe në Vracë në lartësi mbidetare 2200-2350 m. Me 11.07.2013 (Millaku, F., Krasniqi, E., Mala, Xh.) këtë lloj e konstatuan edhe në lokalitetin Liqenet e Jazhincës në 2172 m lartësi mbidetare.	Subpopullacionet e këtij lloji në Bistër dhe Majë të Zezë janë me të mëdha dhe me stabile në krahasim me subpopullacionet tjera në Malet e Sharrit. Popullacioni në Vracë dhe subPopullacioni në Piribreg kanë shtrirje shumë të kufizuar, numëri i individëve maturë në të dy këto lokalitete është i vogël dhe rrezikohen nga shembja e shkëmbinjeve dhe koleksionuesit.	I rrezikuar.
29	Ramonda nathaliae Panc. et Petrov. Emri shqip: Ramondë Familja: Gesneriaceae	Shumëvjeçare me rozetë bazale, 15-20 cm e lartë (Hemikriptofite H). Gjethet 3.5 x 1.3 cm, të thjeshta, përsipër të kreshpëta, përposh leshtore të murrme, pa ndajgjethëza, vezake të përmbysët, të ngushta, kunjore në bazë, me buzë ura-ura ose dhëmbë-dhëmbë; bishtaku zakonisht i shkurtër, me qime. Shtija 6-8 cm, me 1-3 lule. Lobet e kupës 4-6; Kurora me diametër 3-3.5 cm, rrethore, me 4-5 lobe, lila deri manushaqe me qendër të verdhë-porokalli. Pjalmoret 2.5-3 mm të verdhë (nganjëherë me pak nuancë blu). Krezat të kokët 3 mm. Fryti kapsulë septicide 9 mm. Lulëzon VI. Frytton VII. (Tutin, T. G. et al. 1972).	Kosovë, Greqi, Serbi, Maqedoni (Tutin, T. G. et al. 1972; Polunin, O. 1997; Josifovic, M. et al. 1974; Matevski, V. 2001; Gashi, B. 2013).	Në Kosovë rritet në të çarat e shkëmbinjeve gëlqeror me vegjetacion të varfër të zonave malore (Ostryo-Ramondetum nathaliae, Musco-Ramondetum nathaliae). Shoqërohet nga llojet: Fagus sylvatica, Ostrya carpinifolia, Saxifraga sempervivum, Hieracium waldsteinii, Geranium robertianum, Jovibarba heufeli, Asplenium rutamuraria etj.	Në Kosovë formon dy popullacione: Gotovushë (Brezovicë) Shtërpce dhe Gllaboqicë ("Kepi i Mullëzës") - rrëzë Lubotenit, Kaçanik (18.07.2012. Fadil Millaku, Bekim Gashi) (Gashi, B. 2013).	Popullacionet kanë përhapje të kufizuar. Popullacioni në Gotovushë edhe pse ka areal shumë të kufizuar ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë, ndërsa popullacioni në Gllaboqicë ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

30	<i>Rhodiola rosea</i> L. Emri shqip: <i>Rodiola</i> <i>trëndafilore</i> Familja: <i>Crassulaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare 15-20 cm me stolone deri 12 cm (Hemikriptofite H). Rozetat 6-12 cm në diametër. Gjethet e rozetës heshtore me majë të shkurtër 15-30 x 7-9 mm nga të dy anët me qime gjëndërore, mishtore, në buzë gjëndërore deri qerpikore, të blerta, të mbyllta, me majë të kuqe, në bazë pak a shumë të bardha. Kërçelli me qime të dendura gjëndërore. Gjethet e kërçellit lineare, me majë, mishtore, me qime gjëndërore, 20-35x5-8 mm. Lulesa me qime të dendura gjëndërore. Lulet gati pabisht, 13-14 pjesëshe, të purpura. Kupa me qime gjëndërore 7-9 mm të gjata, fletëzat e saj lineare deri lineare-heshtore, gati të mprehta 4-5 mm të gjata. Fletëzat e kurorës lineare 10-12 x 1mm, nga sipër të purpura, buzëve të bardhëme, nga poshtë të blerta, në buzë dhe nga poshtë me qime gjëndërore. Thekët me gjatësi 6-7 mm, fillet me pak qime në bazë, anteret me ngjyrë të kuqe të çelët. Karpelet janë 6-7mm të gjata, të blerta. Shtyllëza është me ngjyrë të kuqe me gjatësi 3-3.5 mm. Lulëzon VI. Frynon VIII. (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Josifovic, M. et al. 1977, Polunin, O. 1997).	Rritet në substrat silikat-kvarcit ose ndonjëherë edhe në substrate gëlqerore dhe vende gurishtore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Anthemis montana</i>, <i>Saxifraga scardica</i>, <i>S. tridactylites</i>, <i>S. aizoides</i>, <i>Silene quadridentata</i>, <i>Silene exarata</i>, <i>Silene pusilla</i>, <i>Asplenium viride</i>, <i>Gentianella bulgarica</i>, <i>Gnaphalium supinum</i>, <i>Scrophularia laciniata</i> etj.	Malet e Sharrit (Prevallë-Bistra, Josifovic, M. et al. 1977, Rexhepi, F. 1986, 1994). Alpet Shqiptare (Gjeravicë dhe Kurvallë). Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) është e përhapur në Livadhishitë, Piribreg, Qukat e Liqenit (Jazhincës) dhe Bistër.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni në Gjeravicë është mjaft mirë i ruajtur dhe ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacionet i këtij lloji në Kurvallë dhe ne Malet e Sharrit kanë areal të kufizuar dhe numër me të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
31	<i>Scutellaria alpina</i> L. Emri shqip: <i>Skutelare e Alpeve</i> Familja: <i>Lamiaceae</i>	Gatë gjysmëshkurre (Kamefite Ch), me kërcej deri 30 cm, të përjetëm, të thjeshtë ose të degëzuar, pak a shumë pushlore. Gjethet 1.5-3 cm, vezake, rrallë heshtore, ura-ura të sharruara, rrallë gati të plota, zakonisht shytë, pak a shumë pushlore; të poshtmet me bishtak 3-8 mm; të sipërmet pak a shumë të pabisht, buzët jo të spërveshura. Lulesa e dendur, gjatore, 204 cm, pak a shumë 4-këndore. Braktetë heshtore të thepëta, 8-13 x 4-6 mm, të	Evropa Qendrore dhe Jugore, Kaukaz, Azi e Vogël.	Në Kosovë janë konstatuar dy popullacione të vogla të këtij lloji që shtrihen në substrate gëlqerore dhe dolomit (në vende gurishtore e shkëmbore të pjerrëta) të zonave të larta malore. Në Luboten është konstatuar në lartësi mbidetare 1987 m e shoqëruar nga llojet: <i>Anthyllis aurea</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Helianthemum alpestre</i>, <i>Onobrychis scardica</i>, <i>Stachys alopecurus</i>, <i>Drypis spinosa</i>, <i>Teucrium</i>	Luboten, Koritnik, Bjeshka e Opojës-Karanikollë (afër majës).	Popullacionet e këtij lloji në Luboten dhe Koritnik kanë areal shumë të kufizuar. Ky lloj në Luboten është i përhapur në ekspozicionin lindor të zonës subalpine-alpine në vende gurishtore. Ky popullacion ka areal shumë të kufizuar dhe individët e këtij lloji zakonisht rriten në tufë në vende ku deponohen gurët e shembur nga maja e Lubotenit.	I rrezikuar.

				plota, e kalojnë kupën, të vendosura si tjegulla, të pabisht, si purpur, rrallë të gjelbra, pak a shumë pushlore. Kupa 5-6 mm. kurora 20-25 mm, purpur ose manushaqe, me gyp pak a shumë pushlore nga jashtë. VI-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996).		montanum, Anthyllis vulneraria, Sedum acre, Trifolium badium etj. Në Koritnik rritet në 2386 m lartësi e shoqëruar nga llojet: Minuartia baldaci, M. verna, Thlaspi bellidoides, Edraianthus graminifolius, Helianthemum canum, Achillea chrysocoma, Jovibarba heuffeli, Saxifraga paniculata, Salix reticulata etj.	
32	Scutellaria orientalis L. Emri shqip: Skutellare e Lindjes Familja: Lamiaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj të shtrirë, pushbutë me qime të shpërndara, 10-30 cm. gjethet (0.5-) 1-1.5 (-3) x 0.5-2 cm, vezake-gjatore deri gjërësisht vezake, thellësisht ura-uradhëmbë-dhëmbë deri pendore të prera, me vriguj vezakësheshtorë ose vizakë, të cinguar në bazë, pushlore përsipër, pushbutë-të hirta përposh, me bishtak; buzët zakonisht të shpërveshura. Lulesa e dendur, gjatore zakonisht katërkëndore. Braktetë 5-12 mm, zakonisht e kalojnë kupën, të vendosura si tjegulla, vezake ose pak a shumë heshtore, të plota, të mprehta, disi cipëthata, si pluhur ose të verdha-të gjelbra, të shogëta deri pushlore. Kurora 15-30 (-35) mm, e verdhë, rrallë e trëndafiltë; buza e poshtme shpesh e kuqërremtë. V-VII. Qosja, Xh. et al. (1996).	Siujdhesa Ballkanike.	Është e përhapur në vende të thata e shkëmbore zakonisht gëlqerore apo serpentine në kuadër të pyllit të degraduar të dushkut Quercetum pubescentis cerris dhe Quercetum trojanae dukagjini e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Quercus cerris, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Salvia ringens, Jurinea mollis, Onosma aucherianum, Anthericum liliago, Campanula lingulata, Sanguisorba minor, Silene vulgaris, Convolvulus cantabrica, Valeriana coronata, Potentilla astracantha, Hypericum barbatum etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Rexhepi, F. (1983, 1977) është e përhapur në Pashtrik, (Gorozhub, Vermicë) dhe Mirushë. Këtë lloj gjatë vitit 2013 e kemi konstatuar edhe në serpentine te Krevenikut (Elez Han).	Në Kosovë janë konstatuar tri popullacione te vogla të këtij lloji. Popullacionet e këtij lloji në Krevenik, Mirushë dhe Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.
33	Selaginella selaginoides (L.) Link [Selaginella spinulosa A. Braun] Emri shqip: Selaginë si selaginëz Familja: Selaginellaceae	Bimë e vogël me pamje të myshqeve, me kërcëj zvarritës e rrënjëlëshues, me degëza të holla, me simetri rrezore, 3-15 cm, të ngritura. Gjethet 1-3 mm, të gjitha të ngjashme, me renditje spiralore, me 1-5 dhëmbë të mëdhenj në çdo anë. Kalliret sporbajtës 1-5 cm, të trasha, të verdheme.	Në malet e Evropës: (Pirineje, Alpeve, Karpate, Ballkan), Kaukazit, Siberisë, Kamçatkës, Amerikës Veriore (Arkto-Alpik).	Në Kosovë ky lloj rritet në vende me lagështirë të zonës alpine, kryesisht në kuadër të pyllit të kërkëkës (Pinus mugo) ose në vende moçalore e shoqëruar nga llojet: Parnasia palustris, Sanguisorba officinalis, Veratrum album Potentilla palustris, Veratrum album dhe lloje nga gjinia Carex sp. ose Juncus sp.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Saric et al. (1986), Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984), Randjelovic, et al. (1983), Josifovic et al. (1977), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit, Koprivnik) dhe Malet e Sharrit (Piribreg,	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Lumëbardhit dhe Koprivnik) dhe Malet e Sharrit (Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Luboten, Guri i Pavlovit, Përroi Durlit) kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.

		Riprodhohet gjatë VII-IX. (Pajazitaj, Q. 2004).			Shtëpia e Malorëve, Luboten, Guri i Pavillovit).		
34	Tozzia alpina L. subsp. carpatica (Woloszczak) Dostal Emri shqip: Tozia Familja: Orobanchacea e	Bimë shumëvjeçare, gjysmëparazite, e degëzuar (Hemikriptofite H). Kërçelli 8-35(50) cm e lartë, e drejtë, lehtë këputet. Gjethet të përkundrejta, të lëmuara, të trasha, në pjesën e sipërme të plota, në pjesën e sipërme të kërçellit me dhëmbëz të imët. Lulet të vetmuara të cilat grumbullohen në lulesë në maje të degëve, bishti i lules 3-6 mm i gjatë, kupa 4-7 mm e verdhë me të bardhë. Thekët 0.5-1 mm të gjatë. Fruti tophthor njëpjesësh me vriguj, ka 1-2 fara. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Stevanovic, V. et al. 1999).	Evropë (Tutin, T. G. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në luginë me rrjedhë uji të zonës subalpine deri alpine. Shogërohet nga llojet: Trollius europaeus, Caltha palustris, Cirsium appendiculatum, Gymnadenia frivaldii, Veratrum album, Geum coccineum etj.	Malet e Sharrit (Gjimibeg, Vracë, Shutman, Piribreg, Përroi i Durlit), Alpet Shqiptare (Kopriwnik) (Stevanovic, V. et al. 1999).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
35	Viola grisebachiana Vis. Emri shqip: Manushaqe e Grisebakut Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pa kërçell 3-10 cm. Gjethet vezake –rrotullare 1.5-3 cm, shytë, të plota ose lehtësisht ura-ura, gati të shogëta, që ngushtohen menjëherë në një bishtak relativisht të gjatë. Ndajgjethëzat si gjethet por me të vogla. Lulet rreth 2 cm, bazale, ngjyrë manushaqe. nënpetlat të gjëra shytë. Petlat anësore të drejtuara nga lartë. Shpori 3-4 mm, shytë me i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërrylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në frytnim, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Ballkanike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Bullgari, Greqi, Serbi).	Në Kosovë ky lloj është i përhapur në shkëmbinj gëlqeror rrallë në kullota të thata të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Potentilla apennina, Saxifraga aizoon, Minuartia doerfleri, Thlaspi bellidifolium, Dryas octopetala etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) Josifovic, M. et al. (1972) është e përhapur në Malet e Sharrit (Koritnik, Livadhishitë, Luboten, Kobilicë, Piribreg) dhe në Alpet Shqiptare të Kosovës (Maja e Rusolisë).	Edhe pse në Kosovë ky lloj formon disa popullacione/subpopullacio ne të vogla në Malet e Sharrit dhe Alpe Shqiptare; popullacionet/subpopullacio net e këtij lloji në Kosovë janë me areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve/ subpopullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.
36	Gentiana lutea L. Emri shqip: Sanëza Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me rizomë shumë të shkurtër e cila degëzohet në 2-10 rrënjë të gjata dhe të trasha.	Evropa, Azia e Vogël.	Rritet në kullosa, në qafa të maleve të zonave subalpine dhe alpine, në substrat gëlqeror, silikat dhe serpentinorë. Është konstatuar në kuadër të asociacioneve të ndrvshm	Sipas Millaku, F. et al. (2012) gjendet në Pashtrik, sipas Millaku, F. (2005) gjendet në Alpet Shqiptare (Gjeravicë), Rexhepi, F. (1986) e	Edhe pse ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacio ne; ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të ponullacioneve.	I përkeqësuar

	Kërcelli është i thjesht 60-90 (100) cm i gjatë. Gjethet janë vezake të mëdha me nervura. Gjethet e poshtëme me bisht, të sipërmet pabisht. Lulet të vendosura në qerthuj. Kurora e verdhë, me të ndara shumë më të gjata se tubi. Riprodhohet me fare. Lulëzon VI-VIII. Frytmon VII-IX. (Rexhepi,F. 1986).		e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Onobrychis scardica, Achillea alexandriensis, Polygala major, Senecio wagneri, Pinus mugo, Valeriana officinalis, Veratrum album, Lilium albanicum etj.	përshkruan në Zhleb dhe Mokna. Gjatë viteve 2010-2013 këtë lloj e kemi konstatuar në shumë lokalitete në Alpet Shqiptare(Maja e Rusolisë, Bjeshka e Lumëbardhit, Liqenak, Bjeshkë të Strellcit, Pleçe, Bjeshkët e Istogut (mbi syne, Bjeshkë të Kaliganit), Lipë, Maja e Vjellakut, LlazBelapaç, dhe në Malet e Sharrit (Brod, Vracë, Rudokë, Gjimbeg, Malet e Mushtishtit, Pashallarë, Balka e Madhe, Koritnik, Oshlak, Përroi i Durlit, Shtëpia e Malorëve etj).	Në kuadër të Maleve të Sharrit, popullacioni i këtij lloji në gjendje më të mirë ka qenë në Bjeshkët e Mushtishtit (Pashallarë). Edhe ky popullacion është dëmtuar si pasojë e zjarreve që kanë ndodhur në dhjetë vitet e fundit. Në kuadër të Alpeve Shqiptare popullacionet e këtij lloji në Majën e Vjellakut, Majën e Rusolisë dhe në Bjeshkën e Lumëbardhit janë më të mirat dhe në dhjetë vitet e fundit vërehet një ripërtëritje natyrore shumë e mirë e këtij lloji.		
37	<i>Onosma echinoides</i> L. subsp. javorkae (Sim.) Hayek Emri shqip: Çikllë si ushqerrëz Familja: Boraginaceae	Gati gjysmëshkurre (Kamefite CH), 10-60 cm, me kërcë të drunjëzuar, e të shumtë me pushpak dhe kreshtake –yjore. Gjethet e poshtme 1.5-10 cm, vizake, vizake-heshtore ose pallake, me buzë zakonisht të spërveshura; faqja e sipërme e llapës me zhardhokë që bartin një kreshtë qendrore dhe (8) 10-20 (25) kreshta yjore 0.3-0.6 mm. Qimet e thjeshta ndërmjet zhardhokëve mungojnë. Lulet pabisht. Braktetë me të shkurtra ose gati sa kupa. Kupa 7-14 (15) mm në lulëzim, 8-15 (19) mm në frytëzim, me kreshta të thjeshta dhe me disa yjore me rreze të shkurtra. Kurora 16-23 mm, e verdhë e zbehtë, nga jashtë pak a shumë dendësisht leshtake. Merikarpet 2-3.5 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit.	Ky takson në Kosovë rritet në substrate serpentinore të thata kserotermë e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Teucrium montanum, Aster albanicus, Thesium dolineri, Fumana bonapartei, Plantago subullata, Sanguisorba minor, Alyssum markgrafi, Chrysopogon gryllus, Convolvulus cantabricus etj.	Bokat e Baqevcit (Mushtisht, Rajoni i Mirushës dhe Koznikut, Bokat e Krevenikut).	Popullacionet e këtij taksoni në Bokat Baqevcit, Rajoni i Mirushës, Koznikut, Bokat e Krevenikut kanë areal të kufizuar dhe pak individ maturë që zakonisht rriten në tufa, rrallë takohen individë të vetmuar. Popullacionet e këtij lloji në Kosovë gjenden afër vendeve rurale dhe janë nën ndikim të faktorit zooantropogjen.	I përkeqësuar

38	<i>Tephroseria papposa</i> subsp. <i>wagneri</i> (Degen) B. Nord. [Senecio <i>wagneri</i> Deg.] Emri shqip: - [Pulith i <i>Wagnerit</i>] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur, në fillim me qime të merimangëta leshtore, më vonë pothuaj të shogët. Gjethet nga sipër pak a shumë të lëmuara, me qime të merimangëta leshtore nga poshtë. Gjethet e bazës gjatore – eliptike, gradualisht të ngushtuara në bishtak, të dhëmbëzuara; gjethet e kërcellit gjatore-heshtore, të ngushtuara në bazë, pabishtak; gjethet e sipërme vizake. Kaptinat jo rrezore, 1.5 cm në diametër, në vastak të thjeshtë me 5-10 kaptinëza. Pështjella e purpurtë në të kaftë. Lulet me ngjyrë intensive të verdhë. Lulet llapore mungojnë. Xhufka pakëz më e gjatë se kurora. Akenët të shogët. Lulëzon IV-VIII, frytton VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000).	Siujdhesa Ballkanike (Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari)- Endemike Ballkanike.	Në Kosovë rritet në substrat silikat me rrallë në substrat gëlqeror, në vende me barë dhe shkëmbore të zonave të larta subalpine dhe alpine ose në vende me bar dhe lëndina të pyllit të kërclekes (Pinus mugo) e shoqëruar nga llojet: Geranium sylvaticum, Jasione orbiculata, Geum montanum, Juniperus sibirica, Pedicularis verticillata, Armeria alpina, Sesleria nitida, Hypericum alpinum, Veronica bellidifolia, Dianthus cruentus, Onobrychis scardica, Polygonatum bistorta, Trifolium badium, Stachys alpina etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është e përhapur në Majën e Rusolisë, Kurvallë, Gjeravicë, Liçenak dhe Hajlë. Sipas Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Vracë, Livadhishitë, Luboten, Oshlak, Koritnik).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Popullacioni i këtij lloji në Gjeravicë është në gjendje të mirë dhe i pasur me individë maturë në krahësim me popullacionet e këtij lloji në lokalitetet tjera në Kosovë.	I përkeqësuar
39	<i>Achillea agetatifolia</i> (Sibth. et Sm.) Boiss. Emri shqip: Barpezmi gjetheagjatore Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare tufore (Kamefite CH), kërcelljtë deri 30 cm, të ngritur, secili me nga në kaptinëz. Gjethet të përhimëta-pushbuta; bazalet 2-4 cm, pallake, buzëplota ose ura-ura, rrallë krëhëake-pendore të çara; kërcelloret rreth 1 x 0.2 cm, të pakta. Pështjella 5-15 mm në diametër; braktet rreth 5 mm, të mëndafshita, me buzë të gjëra. Lulet llapore 7-9 mm, vezake, të bardha. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytton VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapen me anë të erës. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bulgari, Greqi, Maqedoni, Mal i Zi,	Rritet në substrat gëlqeror ose serpentinor, ose në vende dhe kullota të thata (Elyno-Seslerietea) duke filluar nga zona kodrinore deri në kullota të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Micromeria albanica, Campanula versicolor, Colutea arborescens, Hyssopus officinalis, Eryssimum sylvatica, Seseli rigidum, Anthyllis vulneraria, Rhamnus orbiculatus, Ficus carica, Pistacia terebinthus, Alyssum corymbosum, Jurinea mollis, Scabiosa fumaroides, Convolvulus cantabrica, Convolvulus althaeoides, Scabiosa crenata etj.	Gjatë vitit 2011-2013 Rexhepi, F. Pajazitaj, Q., Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. kanë hulumtuar popullacionet e këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, Luboten, Koritnik, Brod, Oshlak, Rusenicë, dhe Novobërd (Rexhepi, F. 1975).	Popullacione/subpopullacione e këtij lloji janë mjaft të fragmentuara dhe kanë areal të kufizuar me përjashtim të subpopullacionit në NT – Gati i rrezikuar. Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe subpopullacionit në Oshlak që janë afër njëri me tjetrin. Popullacionet në Koritnik, Luboten dhe Rusenicë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve. Popullacioni në Artanë (Novobërdë) ka përhapje të kufizuar dhe në krahësim me popullacionet tjera të Kosovës është popullacioni me shtrirje më të kufizuar dhe me numër më të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.

40	<i>Barbarea balcana</i> Panc. Emri shqip: <i>Barbare e Ballkanit</i> Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët. Kërcelli deri 70 cm. Gjethet e poshtme lirake pendore të çara, me vrigullin skajor si zemër-vezak dhe me 0-2 palë vriguj anësor; të sipërmet pendore të çara. Lulet të verdha, në vile vastakore, pa brakte. Petalet 7-15-25 mm; këmbëzat të hapura, 6-8 mm; flegtrat jo me nervurën e mesit të dallueshme; shtyllëza 2-4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemike e Ballkanit)	Rritet në vende me lagështi ose pranë burimeve dhe përranjve të zonës alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: <i>Pinguicula</i> sp., <i>Gymnadenia frivaldii</i> , <i>Parnassia palustris</i> , <i>Caltha palustris</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Narthecium ossifragum</i> , <i>Cardamine pratensis</i> , <i>Saxifraga stellaris</i> , <i>Saxifraga rotundifolia</i> etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve tona ky lloj është e përhapur në Malet e Gjeravicë Sharrit (Luboten, Bistër, Guri i Zi, Brod, Shtëpia e Malorëve) dhe Alpet Shqiptare (Gryka e Lloqanit, Kurvallë, Pllaçicë e Vokshit, Pllaçicë e Junikut, Gjeravicë, Bjeshka e Dobroshit).	Shumica e popullacioneve/subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël me përjashtim të popullacionit në Gjeravicë dhe Pllaçicë që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
41	<i>Cerastium grandiflorum</i> Waldst. et Kit. [<i>Cerastium nodosum</i> Buschm.] Emri shqip: <i>Cerast lulemadh</i> Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore, 15-30 (-50) cm, pushbutë e bardhë deri e përhimët. Gjethet 25-70 x 0.5-1.5 mm, vizake të ngushta, gati të mprehta, me buzë shumë të shpërveshura. Lulesa cimë, me degëza tufëzore të ngritura, me 7-15 lule, me këmbëza 1-4 cm. Braktetë vezake deri gjërësisht heshtore, me buzë dhe maje cipëthatë të gjërë. Nënpetlat 6-8 mm, gati shyta, pushbuta, me buzë cipëthatë. Petlat deri 18 mm, të ngushtuara gradualisht drejt bazës, rreth 3 herë sa kupa. Vezorja dhe kapsula pushbuta, të paktën në bazë. Kapsula e drejtë, deri dy herë sa kupa; dhëmbët të sheshtë, të hapur. Lulëzon VI. Frytëzon VII (Paparisto, K. et al. 1988).	Pjesa perëndimore të Gadishullit Ballkanik (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci (Tutin, T. G. et al. 1976; Polunin, O. 1997; Josifovic, M. et al. 1970).	Në Kosovë rritet në substrat gëlqeror në vende shkëmbore të zonës subalpine, kryesisht në ekspozicione veriore të ftohta dhe në ndikimin e erërave. Në lokalitetin Shutman (1914 m l.m.d.) gjendet në vende shkëmbore të zonës subalpine në shoqëri me llojet: <i>Dianthus dolotoides</i> , <i>Hieracium pilosella</i> , <i>Euphrasia rotskoviana</i> , <i>Luzula forsteri</i> , <i>Primula veris</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Scabiosa leucophylla</i> , <i>Trifolium alpestre</i> , <i>Gentianella bulgarica</i> , <i>Geranium subcaulescens</i> etj.	Alpet Shqiptare-Zhleb (Millaku, F. 1999, Josifovic, M. et al. 1970, Silic, C. 1988). Në lokalitetin Shutman (Malet e Sharrit) në kullosa subalpine është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e popullacioneve të llojit nga F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala më 01.08.2011). Gjendja e popullacioneve të llojit u konstatua dhe u vlerësua edhe gjatë viteve 2012-2013 në disa lokalitete në Malet e Sharrit (Livadhishitë, Bistër, Karanikollë dhe Lumi i Thatë-afer tre kufirit).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël. Në veçanti popullacioni i konstatuar në Shutman ka <50 individë maturë.	Gati i rrezikuar.

42	<i>Crocus scardicus</i> Kosanin Emri shqip: Shafra i Sharrit Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare rreth 10 cm e gjatë (Gjeofite G). Mbulesa e zhardhokut-qepës është e hollë dhe e ndjeshme rrjetore leshtore ose jo. Gjethet 0.5-1 mm të gjëra , vizake të ngushta, të drejta me në vijë të bardhë në mes, shfaqen së bashku me lulen. Lulet të vetmuara. Perigoni (perianti) i verdhëportokalli, me grykë ngjyrë jorgovani (vjollce); pjesët e periantit 2-3.5 (-4) cm të gjata dhe 0.6-1 cm të gjëra . Kreza ka ngjyrë të verdhë ose portokalli, në pjesën e sipërme zgjerohet dhe është e ndarë në tre segmente. Anteret e tejkalojnë krezën. Bimë mjaft dekorative. Lulëzon VII. Frynnon VIII (Rexhepi, F. 2000; Pajazitaj, Q. 2004).	Shqipëri, Maqedoni, Shqipëri (Rexhepi, F. 1986, 2000; Randjelovic et al. 1990; Tutin, T. G. et al. 1980, Polunin, O. 1997; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë ky lloj rritet në zonën subalpine dhe alpine (Ranunculon crenati), në vende të hapura- ekspozicioni verior, verilindor dhe veriperëndimor, në substrat me bazë shkëmbore kryesisht silikate zakonisht në tokë të thellë në hapësira ku shkrihet bora gjatë verës. Shoqërohet nga llojet: Ranunculus crenatus, Carex pyrenaica, Gnaphalium supinum, Crocus veluchensis, Crocus vernus etj.	Malet e Sharrit-Shhtëpia e Malorëve, Livadhishhtë, Crvena Karpa, Bistër, Çukat e Liqenit, Piribreg, Maja e Zezë, Restelicë, Brod, Prevallë (Rexhepi, F. 1986, 1994, 2000, Randjelovic, N. et al. 1990, Krasniqi, F. (1998). Subpullacione të këtij lloj janë konstatuar edhe në Bjeshkët e Opojes duke filluar nga mali mbi fshatin Kuk deri të Guri i Zi.	Popullacionet/ subpopullacionet e këtij lloji janë me numër të konsiderueshëm të individëve maturë, por kanë areal të kufizuar dhe gjenden vetëm në Malet e Sharrit në vende ku shkrihet bora gjatë verës.	Gati i rrezikuar.
43	<i>Dianthus scardicus</i> Wettst. Emri shqip: Karafil i Sharrit Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me buca të rralla. Kërçelli është 1,510 cm i gjatë, me dy-tri palë gjethe të gjata afër 15 mm dhe të gjëra 2-3 mm, me tri nervura. Lulet zakonisht janë të vetmuara. Kupa e dytë është me dy lusa, gati sa gjysma e kupës, në majë, me tri nervura. Kupa është 10-12 mm e gjatë, në pjesën e sipërme e zgjeruar. Kurora është 7-8 mm e gjatë ngjyrë trëndafil, pak e dhëmbëzuar. Lulëzon VII. Frynnon VIII (Rexhepi, F. 1986	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni. Endemike e Maleve të Sharrit (Rexhepi, F. 2000; Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë rritet në substrate acidike, në vende shkëmbore gëlqerore-me bar, të zonës subalpine dhe alpine (Festuco-Seslerietea respektivisht Onobrychido-Festucion, në shoqëri me llojet: Pedicularis oederi, Dianthus microlepis, Campanula alpina, Dryas octapetala, Myosotis alpestris, Helianthemum canum, Onobrychis scardica, Edraianthus graminifolius, Poa alpina, Gentiana utriculosa, Polygonum viviparum, Phyteuma orbiculare, Nigritella nigra, Pedicularis verticillata etj.	Sipas Rexhepi, F. (1982, 1986, 1994, 2000), Josifovic, M. et al. (1970), Krasniqi, F. (1982, 1987, 1998), Randjelovic, N. & Rexhepi, F. (1984), MMPH (2008) është përhapur në Malet e Sharrit (Luboten, Prevallë, Bistër, Piribreg, Livadhishhtë, Rudokë) dhe Koritnik. Ky lloj është konstatuar edhe në Vracë (F. Millaku, E. Krasniqi, Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë shtrihen vetëm në Malet e Sharrit. Këto popullacione edhe pse kanë areal të konsiderueshëm numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël, në veçanti popullacioni i këtij lloji në Vracë.	Gati i rrezikuar.

44	<i>Gymnadenia frivaldii</i> Rehb. Emri shqip: <i>Saleprremë i Frivaldit</i> Familja: Orchidaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite H), me zhardhokë të ndarë thellë me vriguj të gjatë dhe trënjë të holla. Kërcelet i gjatë deri 20 cm në bazë me gjethe të ngjashme me këllëf. Gjethe 3-4 gjatore-heshtore, të sipërmet si brakte. Lulesa e shkurtërbohstare, e ngjeshur. Braktet janë heshtore me 1 nervurë të gjatë sa lulet. Lulet të vogla të bardha ose vjollce të zbehtë. Të gjitha gjethezat e perigonit përveç buzës njëra kah tjetra të lakuara formojnë helmetën. Gjethezat e jashtme të perigonit janë gjatore-vezake, të brendshmet janë gjatore, të gjata sa të jashtmet dhe pak më të ngushta. Buza është më e shkurtër se gjethezat tjera të perigonit e plotë ose tre vrigullore, e lakuar teposhtë. Shpori penjëzor, kah maja i mprehtë, i gjatë sa 1/2 e pistilit. Riprodhohet me farë.	Evropë, Grendlandë, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me lagështirë të zonës subalpine dhe alpine ose me rrallë mund të takohet edhe në kullota ose shkurrë të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë kryesisht rritet në kuadër të asociacionit Pinguicula Narthecium scardici e shoqëruar nga llojet: Pinguicula balcanica, Narthecium scardicum, Caltha palustris, Eriophorum angustifolia, Alchemilla hybrida, Veratrum album, Phyteuma pseudorbiculare, Orchis maculata, Trollius europaeus, Geum coccineum, Ranunculus platanifolius dhe lloje të ndryshme të gjinisë Carex, etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1976) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Liqenak, Ploçicë) dhe Malet e Sharrit Foto: Fadil Millaku (2012), Liqenet e Jazhincës (Prevallë, Piribreg, Konjushë, Livadhishitë). Millaku, F., Krasniqi, E. Malaj, Xh. me 11.07.2013 e konstatuan edhe mbi Shtëpinë e Malorëve (Brezovicë), dhe në lokalitetin Përroi i Durlit. Millaku, F. me 16.06. 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Malin Mokna në lartësi mbidetare 1445 m. Millaku ,F. gjatë 17-20 korrik 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në: Kurvallë (1974 m lartësi mbidetare), Pllaçicë të Vokshit, Pllaçicë të Junikut (1831 m), Bjeshkë të Tropojës (Kosovë- 2259 m), Bjeshkë të Dobroshit (2049 m) dhe në Qafë të Bogiqës (2002 m).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të popullacioneve në Gjeravicë dhe Bjeshkë të Dobroshit (Rupë). Këto dy popullacione te këtij lloji edhe pse kanë areal shumë të kufizuar; kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.
45	<i>Lamium garganicum</i> subsp. <i>striatum</i> (Sm.) Hayek Emri shqip: <i>Hithëbutë e bigezuar</i> Familja: Lamiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-60 cm. Gjethet 19-70×10-40 mm, si zemër-vezake me qime të dendura deri gati të shogëta, ura-ura deri ura-ura të sharrëzuara. Kupa është 7.5-18 mm, me gyp zakonisht gati sa dhëmbët. Kurora 25-40 mm me ngjyrë nga e trëndafil të deri e purpurt rrallë e bardhë. Gypi është 15-25 mm, i drejtë, shumë më i gjatë se kupa, buza e sipërme 10-15 mm e çarë dysh ose zakonisht me dhëmbë të cekët, vrigujt anësorë të shkurtër, trekëndorë. Buza e poshtme 10-15 mm zemër përmbysët. Anteret leshtake. Riprodhohet me farë.	Bimë Ballkanike-Mediterrane (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Bullgari)	Rritet në shkëmbin, pyje të zonës malore (Fagetum montanum), pranë rrugëve malore e shoqëruar nga llojet : Scrophularia bosniaca, Trifolium badium, Anthemis montana, Asplenium rutamuraria, Silene vulgaris, Ceterach officinarum, Fraxinus ornus, etj.	Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Oshlak, Rusenicë, Vracë, Luboten, Kurvallë, Gryka e Deçanit, Koprivnik, Gryka e Sushicës.	Ky lloj në Kosovë formon popullacione në Malet e Sharrit dhe në Alpet Shqiptare. Këto popullacione kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve brenda këtyre popullacioneve është i konsiderueshëm me përjashtim të Popullacionit në Vracë që ka numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.

		Lulëzon IV-VIII. Frytton V-IX. (Qosja, Xh. et al. 1966).					
46	<i>Nartheicum scardicum</i> Kosanin Emri shqip: <i>Nartecë e Sharrit</i> Familja: <i>Nartheceaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e lartë 9-27 cm, me rizomë. Gjethet distike, shpatëngjashme, me 4-10 deje, të sipërmet më të vogla se të poshtmet. Vilet të dendura, fundore, me 5-13 lule të vogla. Segmentet e rrethlules të verdhë, 4-5 mm, të lirë, të qëndrueshëm yllorë gjatë lulëzimit dhe të ngritura gjatë frytëzimit. Këmbëzat 47 mm. Thekët me pjalmore vizake, bazëngjitur; fillet leshtake. Vezorja ngushtohet në një shtyllëz të shkurtër e me një krezë të vogël trevrigujshe. Kapsula 8-10 mm, ovoide, me çahje lokulicide. Farat të shumta. Lulëzon V-VII. Frytton VII-VIII. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mali Zi, dhe Maqedoni (Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996), Micevski & Matevski (1987).	Në Malet e Sharrit dhe Alpe Shqiptare rritet në vende me lagështirë, afër burimeve (vende moçalike) të zonës alpine në kuadër të asociacionit Pinguicula Nartheicum scardici dhe Carici-Nartheicum scardici e shoqëruar nga llojet: Pinguicula balcanica, Pinguicula vulgaris, Barbarea balcana, Juncus trifidus, Cardamine pratensis, Carex caryophylla, Carex goodenowii, Alchemilla hybrida, Veratrum album etj.	Sipas Millakut (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) në kuadër të Alpeve Shqiptare është prezent në: Kurvallë, Pllaçicë, Bogiçë, Maja e Rusolisë, Gjeravicë, Stanet e Erenikut, Qafa malore në mes të Ishteditit dhe Hajlës, Kroi i Mbretit (B. e Belegut). Në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Livadhishitë, Liqenet e Jazhincës). Me 16.07.2011 Millaku,F., Krasniqi,E., Rexhepi,F. & Mala,Xh. e konstatuan në Luboten. Millaku, F. me 19.07.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në disa lokalitete të Alpeve Shqiptare (Bjeshka e Dobroshit-Rupë (2049 m) dhe Qafa e Bogiqës (2120m).	Në kuadër të Alpeve Shqiptare është konstatuar në 8 lokalitete. Popullacioni në Gjeravicë përbëhet nga 4 subpopullacione të cilat janë të pasura edhe me lloje tjera endemike. Popullacionet tjera në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar mirëpo janë të pasura me individë maturë.	Gati i rrezikuar.
47	<i>Paramoltkia doerfleri</i> (Wettst.) Greuter & Burdet [Moltkia doerfleri Wettst.] Emri shqip: <i>Moltkë e Dërflerit</i> Familja: <i>Boraginaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 30-50 cm, të ngritur, të thjeshtë, të mbuluara me kreshtëza të rrasura; kërcëjtë dalin nga një rizomë simpodiale horizontale të trashë. Gjethet heshtore të mprehta të mbuluara me kreshtëza të shpërndara të rrasura, si edhe me qerpikë; kupa rreth 10 mm, me vriguj rënës. Kurora 19-25 mm, e zgjeruar gradualisht në pjesën e sipërme, e purpurt e errët. Fijet 1.5-2 mm; pjalmoret 2.5-3 mm, me dy majucë, të përmbyllura brenda gypit. Akenet rreth 4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë dhe rizomë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Pjesa jugore e Ballkanit. Sipas Carni, A. et al. (2009) është e përhapur në pyjet termofile gjethërënëse të Evropës jugore (Quercion confertae dhe Carpinion orientalis).	Në Kosovë ky lloj rritet në kuadër të disa asociacioneve që i takojnë aleances Quercion frainetto. Në rajonin e Mirushës dhe në Bokat e Morinës është konstatuar edhe në kuadër të asociacionit Forsythio Quercetum petraeae si dhe Polygalo Forsythietum europaeae e shoqëruar nga llojet: Quercus frainetto, Quercus petraeae, Forsythia europaea, Polygala doerfleri, Gladiolus illyricus, Potentilla alba, Juniperus oxycedrys etj.	Boka të Baqevcit, Duhel, Blinaj, afër Kaçanikut, Guri i Zi, Novobërdë, Rajoni i Mirushës, Koznik, Bokat e Morinës. Bleçic et al. (1968).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë, me përjashtim të popullacionit të këtij lloji në Blinaj dhe rajonin e Mirushës që janë të pasura me individë maturë dhe të rinj. Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës numëron <100 individ maturë.	Gati i rrezikuar.

48	<i>Pinguicula balcanica</i> Casper Emri shqip: <i>Pinguikulë e Ballkanit</i> Familja: Lentibulariaceae	Baristore shumëvjeçare dimëruese (Hemikriptofite H), me sythe. Gjethet pranverore 20-30 x 15-20 mm, vezake të gjëra ; gjethet e verës 20-50 x 10-20 mm, eliptike-gjatore. Këmbëzat 1-5, gjëndërore, 4-8 (10) cm. Vrigujt e kupës vezakë të gjërë, sa të gjatë dhe të gjërë, rrallë më të gjatë se të gjërë, buza e poshtme e ndarë dysh deri 1/3 e gjatësisë së saj. Kurora 14-19 mm, blu lila, me njolla të bardha në bazë; vrigujt e buzës së poshtme vezake-gjatore. Shpori 3-4 (7) mm, cilindrik, i drejtë. Kapsula ovoide. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit.	Rritet në vende me lagështirë (afër burimeve) të zonave subalpine dhe alpine në kuadër të asociacionit <i>Pinguiculo-Narthecietum scardici</i> dhe <i>Orphanideo-Cirsietum appendiculati</i> shoqëruar nga llojet: <i>Narthecium scardicum</i> , <i>Gymnadenia frivaldii</i> , <i>Parnasia palustris</i> , <i>Polygonatum bistorta</i> , <i>Alchemilla hybrida</i> , <i>Saxifraga rotundifolia</i> , <i>Barbarea balcana</i> , <i>Cardamina pratensis</i> , <i>Veratrum album</i> dhe lloje nga gjinia <i>Carex</i> sp. dhe <i>Juncus</i> sp.	Sipas Millaku, F. (1999) në Alpe Shqiptare është e përhapur në Majën e Rusolisë, NT – Gati I rrezikuar. Koprivnik dhe Gjeravicë. Sipas Rexhepi, F. (2000) dhe Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare (nuk ceken lokalitetet). Gjatë vitit 2011-2012; Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F., Mala, Xh. dhe Krasniqi, E. i hulumtuan popullacionet e këtij lloji në: Luboten (1894 m), Bistër (2186 m), Brezovicë (2010 m) Përoi i Durlit, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Liqenet e Jazhincës, Livadhishtë.	Popullacionet në kuadër të Alpeve Shqiptare janë të vogla dhe me areal shumë të kufizuar por kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Edhe në Malet e Sharrit janë disa popullacione që kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Në shumicën e popullacioneve ky lloj rritet së bashku me llojin <i>Narthecium scardicum</i> dhe <i>Gymnadenia frivaldi</i> .	Gati i rrezikuar.
49	<i>Plantago reniformis</i> Beck. Emri shqip: <i>Gjethedell si veshkë</i> Familja: Plantaginaceae	Baristore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me një rozetë gjethesh. Gjethet 5-17 (30) x 2.5 -10 cm, lapa vezake si zemër gati rrotullore dhe e cunguar në bazë ura -ura deri më dhëmb pak a shumë me qime të përdredhura, bishtaku 1/2 -2 herë me i gjatë së llapa. Shtijet i kalojnë gjethet përposh gati të shogëta, përsipër me qime të dendura të shtrira, kallinj të 2-6 cm të dredhura. Braktetë 2-2.5 mm, vezake-heshtore zakonisht pushlore. Sepalet 2-2.5 mm gati të barabarta, pothuaj të lira gjelberoshe-kafë ose purpur. Gypi i kurorës 2 mm, i shogët, vrigujt 1-1.5 mm, vezak, majëmprehtë ose shyt. Thëkët 4 mm dalin mbi kurorë. Kapsula 3 mm. Lulëzon V-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit (Ks, Al, B&H, Mz)	Rritet në kullota, vende me lagështirë dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Trifolium repens</i> , <i>Lotus corniculatus</i> , <i>Alchemilla hybrida</i> , <i>Pimpinella saxifraga</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Pedicularis verticillata</i> , <i>Gentiana nivalis</i> , <i>Ranunculus montanus</i> , <i>R. oreophyllus</i> , <i>Geum montanum</i> , <i>Potentilla crantzii</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është prezent në Rrasë të Zogut dhe Liqenak. Sipas Josifovic et al. (1974), Lakusuc, R. (1970) është prezentë në Alpe Shqiptare (Liqenak, Hajlë dhe Koprivnik). Millaku, F. me 30.06.2012 e konstatoi edhe në Pleçe në lartësi 1884 m, me 18-19 07. 2013 në Gjeravicë (1870 m), dhe Pllaçicë të Junikut. Është e përhapur edhe në Luboten.	Popullacionet në Liqenak, Koprivnik, Gjeravicë, Pllaçicë e Junikut kanë areal shumë të kufizuar, dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël.	Gati i rrezikuar.

50	<i>Saponaria sicula</i> Rafin. subsp. <i>intermedia</i> (Simmler) Chater. Emri shqip: <i>Sapunqyqe me spica</i> Familja: <i>Caryophyllaceae</i>	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H), e drunjëzuar në bazë. Kërcejtë 5-60 cm, të shogët poshtë. Gjethet 1-4 cm, ngushtësisht pallake deri vizake-heshtore të përmbysta, me 1 dell, zakonisht të ashpër anash. Lulesa zakonisht me degëza të këmbëra, leshtake. Kupa 20-30 mm, pushlore, jogjëndërore, me ngjyrë si të kuqërremtë, me dhëmbë trekëndësh të mprehtë ose të thepët. Llapa e petales 5-8 mm, e kuqe. Kapsula gjatore, më e shkurtër se kupa. VI-VII. Paparisto, K. et al. (1988).	Siujdhësa Ballkanike (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Greqi), Apenine, Sicili.	Në Kosovë rritet në kullota të thata dhe shkurre mbi substrat serpentinor në kuadër të asociacionit: <i>Astero-Juniperetum oxycedri</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Teucrium montanum</i> , <i>Aster albanicus</i> , <i>Thesium dolinieri</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Genista hasertiana</i> , <i>Plantago subullata</i> , <i>Medicago prostrate</i> , <i>Alyssum</i> sp., <i>Chrysopogon gryllus</i> , <i>Convolvulus cantabricus</i> etj.	Sipas Josifovic et al. (1977), Blečić et al. (1968), Rexhepi, F. (1992) është e përhapur në Brezovicë, Maja e Pishës, Pllanik (Ponoshec). Gjatë viteve 2011-2012 kemi konstatuar edhe një popullacion në Bokat e Baçevcit (Mushishtit), rajonin e Mirushës dhe Bokat e Morinës.	Popullacioni i këtij taksoni në serpentinet e Mushishtit (Bokat e Baçevcit) ka areal shumë të kufizuar por individët brenda popuacionit janë të zhvilluar dhe të përshtatur mirë kushteve të thatësisë që dominojnë në këto biotope. Popullacionet në rajonin e Mirushës, Bokat e Morinës dhe Brezovicës janë me areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël.	Gati i rrezikuar.
51	<i>Saxifraga pedemontana</i> All. subsp. <i>cymosa</i> (Waldst. et Kit.) Engl. Emri shqip: <i>Iriqëz me anë</i> Familja: <i>Saxifragaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore, me qime gjëndërore. Kërçelli i përpjetë ose i lakuar, 5-20 cm, zakonisht i pajisur me gjethe, me 3-10 lule. Gjethet e poshtme me bishtak, gjatore-pykore-trekëndore, të zgjeruara kah maja dhe me 3-5 segmente gishtore, me majë të rrumbullakuar, pak a shumë të prerë thellë, me dejë të dalur, në të dy faqet pak a shumë me gjëndra të dendura; gjethet e kërçellit më të vogla, me 3-7 segmente të prerë thellë. Lulet me bisht të gjatë pothuaj aq sa kupa; sepalet heshtore-vizake, me gjëndra, gati 2 herë më të gjata se tub i kupës; petalet të bardha, 10-15 mm të gjata, gjatore-vezake përmbysta, 2-3 herë më të gjata se dhëmbët e kupës. Kapsula tophore; farat vezake, të zeza, 8 mm të gjata. VI-VII. Pajazitaj, Q. (2004).	Alpe Perëndimore, Karpate, Siujdhësa Ballkanike.	Në Kosovë ky takson rritet në substrat shkëmbor silikat (në të çara të shkëmbinjve) të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Arabis alpina</i> , <i>Lamium garganicum</i> , <i>Geum reptans</i> , <i>Saxifraga stellaris</i> , <i>Alchemilla flabella</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Krivosej, Z., & Randjelkovic (1996), Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Bistër, Maja e Zezë, Livadhishitë). Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. me 07.08. 2011 këtë takson e konstatuan në Vracë në shkëmbinj të zonës alpine afër kufirit me Maqedoninë. Me 29.06.2013 Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. e konstatuan edhe në vendin e quajtur Përroi i Durlit në 2000 m lartësi mbi detare.	Popullacionet e këtij taksoni në Gjeravicë, Piribreg, Bistër, Maja e Zezë, Livadhishitë, Përroi i Durlit dhe Vracë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve .	Gati i rrezikuar.

52	<i>Sedum serpentini</i> Janch. Emri shqip: <i>Rrushaqye serpentinite</i> Familja: <i>Crassulaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore hollake, e shogët, me kërcëj shterpë. Kërcelli lulor 8-12 cm. Gjethet gjatore-cilindrike, 2-4 mm, shyta. Lulesa vastakore. Sepalet vezake-heshtore, pak shyta deri gati të mprehta. Petalet 3.5-4 mm, të mprehta, ngjyrë purpur. Thëkë 10. Rrëshikthet të ngritura, të trëndafilta. V-VIII. (Paparisto et al. 1988).	Shqipëri, Kosovë, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemike-Balkanike).	Ky lloj është i përhapur në substrat serpentinor nga zona kodrinore deri të zona alpine (Maja e Pashallarëve). Zakonisht rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Centaurea kosaninii</i>, <i>Juniperus oxycedrus</i>, <i>Fraxinus ornus</i>, <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Halacsya sendtneri</i>, <i>Alyssum sp.</i>, <i>Stachys scardica</i>, <i>Campanula lingulata</i>, <i>Stipa sp.</i>, <i>Haplophyllum boeserianum</i>, <i>Thesium dolineri</i>, <i>Scorsonera austriaca</i>, <i>Vincetoxicum sp.</i>, <i>Astragalus onobrychis</i>, <i>Potentilla visiani</i>. Në Pashallarë rritet së bashku me llojin endemik <i>Bornmuellera dieckii</i>.	Brezovicë, Ostrovicë, Pllanik, Bokat e Morinë, Llapçevë, Mrasor, Koznik, Gubave (Koprivnik), Lugina e Ibrit.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura në shumicën masivëve malor me natyrë serpentine. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i vogël.	Gati i rrezikuar.
53	<i>Sempervivum kosaninii</i> Praeger Emri shqip: <i>Burgull i Koshaninit</i> Familja: <i>Crassulaceae</i>	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-20 cm, me stolone deri 12 cm të gjata. Rozeta me diametër 6-8 cm. Gjethet e rozetës heshtore përmbysët, me majucë, 15-30 x 7-9 mm, në të dy faqet me qime gjëndërore, shumë të trasha, në buzë me qepalla gjëndërore, të gjelbra-errët, me majë të kuqe, në bazë të bardhërreme. Kërcelli lulor i fuqishëm, me qime të dendura gjëndërore. Gjethet e kërcellit vizake, me majë, mishtake, me qime gjëndërore, 20-35 x 5-8 mm. lulesa e dendur, me qime gjëndërore. Lulet gati pabishtak, 13-14 anëtarëshe, purpur. Kupa me qime gjëndërore, 7-9 mm, segmentet heshtore-vizake, gati të mprehë, 4-5 mm. Petalet vizake, 10-12 x 1 mm, nga sipër purpur, buzët të bardhërreme, poshtë të gjelbra, në buzë dhe faqen e poshtme me qime gjëndërore. Thëkët 6-7 mm, fillet në bazë pakëz të zgjeruar, anterët të kuqe-të hapët. Karpelet 6-7 mm, shtyllëza e kuqërreme, 3-3.5 mm. VI-VII.	Kosovë, Maqedoni (Endemike), Micevski & Matevski (1987). Foto: Fadil Millaku (2013), Dervish Kom	gëlqerorë dhe silikate të zonave të larta subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Vaccinium uliginosum</i>, <i>V. myrtilus</i>, <i>Luzula sylvatica</i>, <i>Sedum sp.</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005), Krasniqi, F. (1987), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Bogiçë, Pllaçicë, Gjeravicë, Dervish Kom, Zhleb, Koprivnik, Rusoli, Liqenak, Lumbardhë. Është konstatuar edhe në mes Lubotenit dhe Livadhishës.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare janë të vogla dhe kanë areal të kufizuar. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Në rajonin e Gjeravicës gjenden tri subpopullacione (Gjeravicë, Pllaçicë dhe Dervish Kom). Popullacioni në Bogiçë ka areal shumë të kufizuar. Në kaudër të popullacioneve të këtij lloji në Alpet Shqiptare janë takuar edhe forma hibride.	Gati i rrezikuar.

54	<i>Silene asterias</i> Griseb. Emri shqip: Klokëz yllorë Familja: Caryophyllaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët, e rímtë. Kërcejtë deri 100 cm, të thjeshtë, veshullorë sipër. Gjethet e bazës pallake; kërcelloret të pakta, heshlore, zakonisht të kundërngjitura. Lulesa rruzullore, me brakte vemesore. Kupa 12-15 mm, cilindrike-si çomangë, e shogët, e kuqërremtë, me dhëmbë të mprehtë. Petalet me llapë gjatore, të plotë, purpur të mbyllët. Kapsula 7-10 mm, gjatore, aq ose pak më e gjatë se karpofori i shogët. VI-VII. Paparisto, K. et al. (1988).	Siujdhesa Ballkanike (Endemike Ballkanike).	Në Kosovë ky lloj është konstatuar në zonën e pyllit të kërkëkës (Pinion mugji), në vende me lagështi të zonës subalpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: Rumex alpinus, Veratrum album, Alchemilla hybrida, Heracleum sp., Mentha longifolia, Cardamine tuberosa, Cardamine pratensis, Ajuga pyramidalis, Geum coccineum, Geum rivale, Valeriana officinalis etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Stevanovic, V. Jankovic, M. (1984), Josifovic et al. (1970), është e përhapur në Alpet Shqiptare (Koprivnik), Malet e Sharrit (Piribreg, Ujërat e Humbura, Liqenet e Jazhincës, Livadhishitë, Maja e Pashallarëve, Studenicë (Therandë).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar. Popullacioni në Studenicë (Therandë afër antenës) është mjaft mirë i zhvilluar dhe ka mjaft individë maturë në kuadër të popullacionit. Popullacionet tjera në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në Alpet shqiptare (Koprivnik) është konstatuar vetëm një popullacion me areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
55	<i>Asperula doerfleri</i> Wettst. Emri shqip: Njëgjire e Dorflerit Familja: Rubiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë 2-9 cm, tufor të shogët ose rrallë leshtor në bazë. Gjethet 5-8x1-2 mm, heshtorë, me qime leshtore të hapura e të rralla veçanërisht në buzë dhe nervurën qendrore. Bishti lulor i kaptinëzës zakonisht sa gjysma e gjetheve mbajtëse. Kurora gjërësisht gypore-hinkëngjashme, e trëndafilte; gypi 2-3.5 mm; vrigujt 1-2 mm, leshtorë ose të shogët. Fryti rreth 2 mm, i shogët. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et. al. (1996).	Endemike (Subendemike): Kosovë, Shqipëri, Mali Zi, Maqedoni. Sipas Qosja, Xh. et. al. (1996) është e përhapur në kullota ose shkëmbinjtë gjëqeror të zonës subalpine dhe alpine të Shqipërisë së Veriut. Sipas Tutin et al. (1976) është e përhapur në Shqipëri dhe Mal të Zi. Sipas Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996), Micevski & Matevski (1987) është e përhapur edhe në Maqedoni.	Rritet në substrate gëlqerore (në të çara të shkëmbinjve) të zonës alpine dhe në kullota të thata, e shoqëruar nga llojet: Dryas octopetala, Minuartia baldaci subsp. doerfleri, Minuartia verna, Edraianthus graminifolius, Potentilla speciosa, Helianthemum canum, Armeria alpina, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Thlaspi bellidioides etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e pranishme në Zhleb dhe Luboten. Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Zhleb, Maje të Rusolisë, dhe LC – Më pak i rrezikuar. Rrasë të Zogut. Sipas Josifovic et al. (1973) është prezent në vende shkëmbore të zonave të larta malore në Zhleb. Sipas Saric et al. (1986) në Oshlak dhe Konjushka. Millaku, F., Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Krasniqi, E. & Mala, Xh. gjatë vitit 2012 i hulumtuan popullacionet e këtij lloji edhe në Koritnik, dhe Balkë të Madhe, Pleçe, Bjeshkë të Lumëbardhit, Liqenak dhe Milishevcë.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maje të Rusolisë, dhe Rrasë të Zogut) kanë areal shumë të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë në disa nga këto popullacione është në numër të konsiderueshëm. Në Malet e Sharrit (Koritnik, Oshlak dhe Konjushkë) popullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar, dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është më i vogël në krahasim me popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare.	Më pak i rrezikuar.

56	<i>Campanula alpina</i> Jacq. Emri shqip: <i>Lulekambanë e Alpeve</i> Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të shëndoshë e pa stolone. (Hemikriptofite H). Kërçelli 5-10 cm, i ngritur, i thjeshtë, me hulliza. Gjethet vizake-heshtore, me buzë urëza-urëza, leshtore, bazale me rozetë e të ngushtuara në bazë, kërçelloret vizake. Lulet të shumta në vile pak a shumë të përbërë. Vezorja leshtore. Dhëmbët e kupës majëhollë, leshtore, qartësisht më të shkurtër se kurora; shtojcat vezake, majëmprehta, heshtore, më të shkurtra se vezorja. Kurora 15-20 mm, kambanor. Lulëzon VI. Frytton VIII (Qosja, Xh. et al. 1996).	Alpet lindore, Karpate, Malet e gadishullit Ballkanik (Tutin, T. G. et al. 1976).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrate silikate në Malet e Sharrit në kullota të zonës malore deri alpine, kryesisht në kuadër të aleancës Seslerion comosae. Shohërohet nga llojet: <i>Salix herbacea</i> , <i>Juncus trifidus</i> , <i>Homogyne alpina</i> , <i>Dianthus scardicus</i> , <i>Arctostaphylos uva-ursi</i> , <i>Pedicularis verticillata</i> , <i>Phyteuma pseudorbiculare</i> , <i>Jasione orbiculata</i> , <i>Potentilla ternata</i> , <i>Geum montanum</i> , <i>Sempervivum macedonicum</i> , <i>Dryas octopetala</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Cerastium alpinum</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Veronica bellidioides</i> , <i>Gentiana verna</i> etj.	Malet e Sharrit-Kobilicë, Piribreg, Livadhishitë, Liqenet e Jazhincës, Përroi i Durlit, Bistra, Vracë (Rexhepi, 1986, F. 1984, Josifovic, M. 1974).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji kanë shtrirje të gjërë në Malet e Sharrit (zona malore-alpine), mirëpo në shumicën e subpopullacioneve takohen individ të vetmuar ose rrallë grupe të vogla. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
57	<i>Campanula foliosa</i> Ten. Emri shqip: <i>Lulekambanë gjetheshumë</i> Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-50 cm kërçell të ngritur, të thjeshtë, cilindrik, pushlor përposh. Gjethet pak a shumë pushlore; të bazës me llapë 3-6 x 2.5 cm, vezake të gjëra, si zemër ose rrotullare në bazë, me buzë të sharruara e me bishtak 4-8 cm pak të flatruar; kërçelloret zakonisht të ngushtuara në bazë, eliptike-vezake, me buzë të sharruara, të gjata sa lulet, me bishtak të shkurtër, ndërsa kërçelloret më të sipërme pothuajse pabisht. Lulesa kaptinëz skajore. Dhëmbët e kupës si fëndyell, të qerpikët, më të shkurtër se gypi i kurorës. Kurora 20-35 mm, manushaqe. Lulëzon VI. Frytton VIII (Qosja, Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik, Apenine-pjesa qendrore dhe jugore (Tutin, T. G. et al. 1976).	Në Kosovë rritet në substrate silikate, serpentine dhe gëlqerore në pyje, livadhe malore, kullota subalpine e alpine e shoqëruar me llojet: <i>Fagus sylvatica</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Pinus mugo</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Centaurea nervosa</i> , <i>Ajuga pyramidalis</i> , <i>Geranium sylvaticum</i> , <i>Ranunculus platanifolius</i> , <i>Trollius europaeus</i> , <i>Knautia dinarica</i> etj.	Alpet Shqiptare (Liqenak, Maja e Rusolisë, Ishtedim, Hajllë, Bogaj, Maja e Strellcit, Gjeravicë, Bjeshka e Tropojës, Pllaçicë e Vokshit, Pleçe, Malet male e Deçanit, Kurvallë) dhe Malet e Sharrit (Bistër, Luboten, Brezovicë, Oshlak, Vracë, Shtëpia e Malorëve, Gryka e Durlit (Durlvo potok) (Rexhepi, 2000, 1986, 1982, 1994; Millaku, F. 2005, 1999, 1993; Josifovic, M. et al. 1974, Diklic, N. & Nikolic, V. 1961, 1978; Zeneli, L. 1975).	Popullacionet/subpopullacionet kanë shtrirje të gjërë në Alpet shqiptare dhe në Malet e Sharrit. Popullacionet/subpopullacionet edhe pse kanë shtrirje të gjërë, rritet në grupe me numër të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

58	<i>Campanula spathulata</i> Sibth. et Sm. Emri shqip: Lulekambanë shpatullore Familja: Campanulacea e	Bimë barishtore shumëvjeçare me rrënjë zhardhokore (Gjeofite G). Stolonet të shkurtra. Kërcejtë 15-50 cm, me 1-5 lule, të ngritur, të degëzuar. Gjethet me pupri ose të lëmuara, me buzë pak a shumë ura-ura; bazalet heshtore të përmbysta, me bishtak, ndërsa kërcelloret zakonisht heshtore e pabisht. Dhëmbët e kupës heshtorë, si fëndyell, lehtësisht të karenuar, 3-6 herë më të gjatë se vezorja. Vezorja konpërmbysëse, e gjatë. Kurora 25-30 mm, blu, si hinkë, më e gjatë se vrigujt e kupës. Kapsula konpërmbysëse, me hulliza. Lulëzon VI. Frytnon VIII (Qosja, Xh. et al. 1996).	Siujdhesa Ballkanike (pjesa jugore), Kretë (Tutin, T. G. et al. 1976).	Në Kosovë rritet në substrat silikat dhe karbonat, në kuadër të formacioneve-kullotave acidofile (<i>Juncetea trifidi</i>) e më rrallë në vende shkëmbore të zonave malore, subalpine dhe alpine. Në Luboten (1890 m) në kullota subalpine rritet me llojet: <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Campanula scheuchzeri</i> , <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>Hypericum alpinum</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Luzula sylvatica</i> , <i>Silene vulgaris</i> , <i>Hieracium sylvatica</i> , <i>Hieracium pilosella</i> , <i>Silene roemerii</i> , <i>Rhododendron ferrugineum</i> etj. Në lokalitetin Balka e Madhe (1900 m. l. M. d.) në kullota subalpine rritet bashkë me llojet <i>Lilium albanicum</i> , <i>Knaulia midzorensis</i> , <i>Pancicia serbica</i> , <i>Dianthus integer</i> , <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>Trifolium medium</i> , <i>Geum montanum</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (1982, 1986, 1994), Diklic, N. & Nikolic, V. (1978) dhe Saric, M. et al. (1986) gjendet në Malet e Sharrit (Oshlak, Luboten, Shtëpia e Malorëve, Brezovicë, Maja e Rrobullit, Cerevacki vrh). Popullacionet të llojit u konstatuan edhe në Malet e Mushtishtit (Lokaliteti Balka e Madhe) më 04.07.2012 nga F. Rexhepi, Q. Pajazitaj, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala. F. Millaku, me 24.05.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrikun e Poshtëm në lartësi mbidetare 1122 m).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë shtrirje në Malet e Sharrit, Alpet Shqiptare dhe në Pashtrik. Lloji rritet në grupe të vogla dhe me numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të Popullacionit në Pashtrikun e Poshtëm që edhe pse ka areal të kufizua numri i individëve maturë në kuadër të popullacionit është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
59	<i>Centaurea kosaninii</i> Hayek. Emri shqip: Kokoçel i Koshaninit Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë deri 70 cm, pak të degëzuar në pjesën e sipërme. Gjethet të shogëta, zakonisht dyfish pendore të çara; segmentet jo më shumë se 1 mm të gjërë, ngushtësisht vizakë. Pështjella me diametër rreth 15 mm; shtojcat të ngushta, kinde-kinde deri me dhëmbë të shkurtër, të verdhërremte. Lulet manushaqe ose të kuqe të errëta. Akenët 3.5 mm, sa 1/2 e gjatësisë së xhufkës. Lulëzon VI. Frytnon VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni-endemike (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Rexhepi, F. 1994, 2000; Krasniqi, F. 1982, 1987, Tutin, T. G. et al. 1976; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë rritet në vende të thata shkëmbore e kullota me natyrë serpentinore (<i>Halacsyetalia sendneri</i>) por edhe gëlqerore të zonave malore. Shogërohet nga llojet: <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Stachys recta</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Halacsya sendneri</i> , <i>Stachys scardica</i> , <i>Campanula lingulata</i> , <i>Astragalus onobrychis</i> , <i>Potentilla visianii</i> , <i>Melanpyrum cristatum</i> , <i>Plantago argentea</i> , <i>Veronica andrasovszkyi</i> , <i>Aster albanicus</i> subsp. <i>albanicus</i> , <i>Scabiosa fumaroides</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Sanguisorba albanica</i> , <i>Genista hassertiana</i> , <i>Serratula radiata</i> , <i>Jurinea mollis</i> , <i>Dianthus cruentus</i> etj. Foto: Elez Krasniqi (2013), Pashtrik.	Brezovicë, Koznik, Godanc, Gllanasellë, Badovc (Rexhepi, F. 1978, 1979, 1985, 1994, 2000), Josifovic, M. et al. 1975, Blecic, V. et al. 1969, 1971; Silic, C. 1988), Rajoni i Mirushës, Mali Drenicë (Krasniqi, E. 2003, 2006, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua edhe në Gubavc më 06.06.2011 (F. Millaku, Xh. Mala), në Pashtrik më 21.07.2011 (F. Millaku, E. Krasniqi, Xh. Mala) dhe në lokalitetin Qafa e Prushit më 18.06.2011 dhe 18.09.2012 (F. Millaku, F. Rexhepi, Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Bokat e Morinës dhe rritet në bashkësi me llojin <i>Sanguisorba albanica</i> .	Popullacionet kanë përhapje të kufizuar por me numër të madh të individëve me përjashtim të popullacionit në Malin Drenicë (Javor-Luzhnicë) i cili paraqet popullacion me numër shumë të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile me përjashtim të lokalitetit Badovc.	Më pak i rrezikuar.

60	<i>Dianthus superbus</i> L. Fl. Suec. Emri shqip: Karafil me balluke Familja: Caryophyllaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me kërcell të gjatë 30-65 (90) cm me buca te rralla dhe me bisqe sterile dhe fertile. Kërcelli në pjesën e poshtme është pak i kërrusur, cilindrik i shogët, në pjesën e sipërme është i degëzuar. Gjethet janë lineare të gjata, të gjelbra, te shogëta. Lulet janë në melthe të rralla, shumë aromatike. Luspat e kupës së dytë janë 2-4, lëkurore, ovale, me maje, arrijnë 1/4-1/3 e gjatësisë së kupës. Kupa është 15-30 mm e gjatë dhe 3-6 mm e gjërë, gradualisht ngushtohet kah maja. Fletëzat e kurorës janë 20 mm të gjata, me ngjyrë të bardhë, trëndafilë deri në të kuqe, rrallë e bardhë, në formë të ç'rregullt. E ndarë në pjesë që arrijnë deri te më tepër se gjysma e saj (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi deri në Kore dhe Japoni (Tutin, T. G. et al. 1964; Josifovic, M. et al. 1970, Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet në në kuadër të klasës Vaccinio-Piceetea ose në vende të hapura barishtore-kullota me lagështi të zonës subalpine dhe alpine në shoqëri me llojet: <i>Deschampsia flexuosa</i>, <i>Veratrum album</i>, <i>Plantago gentianoides</i>, <i>Valeriana officinalis</i>, <i>Parnasia palustris</i>, <i>Eriophorum angustifolium</i>, <i>Sanguisorba officinalis</i> etj.	Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Guri i Zi, Liqenet e Jazhincës, Vracë, Oshlak), Alpe Shqiptare-Hajlë, Ishtedim, Mokna (Josifovic, M. et al. 1970; Rexhepi, F. 1986; Millaku, F. 1999).	Popullacionet kanë përhapje të gjërë por me numër të vogël të individëve maturë. Lloji rritet në grupe, zakonisht në vende të lagështa. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
61	<i>Gentiana punctata</i> L. Emri shqip: Genciana me pika Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) me rizomë të trashë dhe rrënjë të degëzuar të gjatë deri 1 m. Kërcelli është 20-60 cm i thjeshtë pak këndorë. Gjethet e poshtme janë të shkurtra deri 2 cm të gjata, me bisht. Gjethet në pjesën e sipërme të kërcellit janë të kundrejta, pabisht ovale ose eliptike, të gjata 6-9(-12-29) cm, të gjëra 2-6 cm, në bazë janë të ngjitura në këllëf të shkurtër, zakonisht me 3-7 (5) nervura. Lulet janë të dallueshme, pabisht, të vendosura në krye të kërcellit, në formë kapinore ose formë qerthullore, në sqetullen e gjetheve të sipërme. Kupa është këmbanore, kurora gjithashtu këmbanore me 5-8 vriguj të shkurtër, oval të rrumbullakët të gjatë 8-11 mm. Kurora e bardhë-verdhë me njolla vjollce të mbyllta. Riprodhohet me	Evropë.	Rritet në substrate silikate, karbonate dhe serpentine; në vende me barë, kullosa, shkurra ose çeltira të pyjeve halore e shoqëruar nga llojet: <i>Geum montanum</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Vaccinium myrtillus</i>, <i>Pinus mugo</i>, <i>Gentiana lutea</i>, <i>Armeria alpina</i>, <i>Sempervivum macedonicum</i>, <i>Scabiosa leucophylla</i>, <i>Knautia dinarica</i>, <i>Anemone narcissiflora</i>, <i>Phyteuma pseudorbiculare</i>, <i>Senecio subalpinus</i> etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve në terren, ky lloj është i përhapur gjërësisht në Alpet Shqiptare (Zhleb, Rusoli, Lipë, Bjeshkët e Rugovës, Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit, Roshkodol, Bjeshka e Strelleit, Koprivnik, Bjeshkë të Belegut, Bjeshkë të Dobroshit, Rupë, Bjeshkë të Junikut, Baballoçit, Gjeravicë, Rrasë të Zogut etj.) dhe Malet e Sharrit (Luboten, Livadhishitë, Piribreg, Brezovicë, Përroi i Durlit, Bister, Oshlak, Koritnik, Bjeshkët e Opojes etj.).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal mjaft të gjërë si në Malet e Sharrit ashtu edhe në Alpet Shqiptare të Kosovës. Numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është duke rënë si pasojë e grumbullimit si bimë mjekësore për treg. Në bazë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë brenda 10 viteve të fundit popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë zvogëluar mirëpo shumica e subpopullacioneve për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

	fare. Lulëzon VIII-X. Frytmon IX-X. (Rexhepi, 1986).						
62	<i>Geranium subcaulescens</i> L'Hér. ex DC. Emri shqip: <i>Kamarosha pa kërcell</i> Familja: Geraniaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 8-20 cm, me rizomë vertikale të shkurtyr. Kërçelli është pa gjethe. Gjethet janë 2-3 cm të gjëra, pushlore në të dyja faqet nganjëherë si të hirta- të mëndafshta, me lllapë të ndarë, zakonisht me 5-7 vriguj vezake përmbyshtë ose trekëndor përmbyshtë, gati të brinjëzuar, edhe vrigujt me 3 segmente deri 5 mm, shyt ose me thimth ose me dhëmbë në maje. Bishtat me nga dy lule, braktetë të vogla, eliptike. Sepalet janë me halë të paktën disa prej tyre zakonisht me qime të bardha e të gjata. Petalet janë rreth 15 mm vezake përmbysëse, majëmprehta, zakonisht të kuqërremta në purpur. Merikarpet janë të mëndafshta me 1-3 brinjë poshtë shtyllëzës. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frytmon VII-IX. (Rexhepi, 1986).	Endemike e Ballkanit	Rritet në kullosa të thata dhe shkëmbinj silikat të zonës subalpine dhe alpine në kuadër të asociacionit Geranio-Poetum violaceae e shoqëruar nga llojet: Rhododendron ferrugineum, Juniperus sibirica, Geranium sylvaticum, Campanula alpina, Lilium albanicum, Empetrum nigrum, Viola elegantula, Festuca paniculata, Polygonum alpinum, Vaccinium myrtillus etj.	Sipas Hayek, (1925), Rexhepi,F.(1986), Josifovic, M., et al. (1977), është i përhapur në Malet e Sharrit në lokalitetet: Guri i Zi, (mbi Restelicë), Ujrat e Humbura, Jazhincë, Brezovicë, Luboten, Shutman, Vracë, Piribreg, Shtepia e Malorëve.	Popullacionet në Brezovicë dhe Guri i Zi (Restelicë) janë në një gjendje jashtëzakonisht të mirë, ndërsa në lokalitete tjera popullacionet përkatësisht subpopullacionet e këtij lloji janë më të vogla. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
63	<i>Iberis sempervirens</i> L. Emri shqip: <i>Iberis gjithmonblertë</i> Familja: Brassicaceae	Bimë gjysmëshkurre 10-25 (-30) cm e gjatë (Kamefite Ch). Gjethet 2.5-5 mm të gjëra, shyte me buzë të plota, të zgjatura, mishtake. Lulesat vile, bishtat e luleve pa qime. Petalet të bardha. Silikëzat në vile rrotullore-vezake, 6-7 mm të gjata me vriguj gati shyt. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frytmon VII-IX. (Mitrushi, 1966).	Evropa Jugore (Mediterran – Submediteran)	Rritet në substrat gëlqeror në të çara shkëmbinjsh ose në vende gurishtore prej zonës malore deri në atë alpine. Rritet e shoqëruar nga llojet: Anthyllis aurea, Lilium albanicum, Aster alpinus, Juniperus sibirica, Helianthemum alpestre, Onobrychis scardica, Dryas octopetala, Antennaria dioica, Scutellaria alpina etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Josifovic, M. et al. (1972), ky lloj është i përhapur në: Koprivnik, Rrasë të Zogut, Bjeshkë të Belegut, Qafë të Bogiçës, Leqinak, Bjeshkë të Deçanit, afër Pejës (Gryka e Rugovës) dhe në Malet e Sharrit (Luboten, Oshlak, Koxhabalkan, Koritnik). Millaku, F. me 19.07. 2013 e konstatoi edhe në Bjeshkën e Dobroshit (Quka e Gërrbave) në lartësi mbidetare 2250 m, pastaj në Pllaçicë të Junikut në 2352 m e shoqëruar nga Potentilla speciosa dhe Saxifraga scardica. Millaku, F.	Ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare. Këto popullacione/subpopullacione kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë me përjashtim të popullacionit në Pashtrik dhe Koritnik. Këto dy popullacione edhe pse kanë areal të kufizuar kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacioni në Pllaçicë të Junikut shtrihet në lartësi 2352 m lartësi mbidetare dhe ka areal shumë të kufizuar. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

				gjatë 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrik në lartësi mbidetare 1570 m dhe në Majën e Rusolisë (2100 m)			
64	<i>Knautia dinarica</i> (Murb.) Borb. Emri shqip: <i>Knaucia e Dinarideve</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli është i mbuluar me qime të dendura të kthyer teposhtë. Gjethet e poshtme janë në rozetë eliptike deri eliptikeheshtore. Gjethet e kërçellit janë heshtore ose lineare-heshtore me buzë të dhëmbëzuara ose të sharrëzuara të mbuluara me qime të palosura. Bishtat e lulesave janë të mbuluara me qime dhe gjëndra. Gjethëzat që përshtjellin lulesën janë ovale heshtore dhe gjëndërore. Lulesa është e gjërë 2-3 mm. Lulet janë të kuqe-vjollcë ose të ngjyrë hirta. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).	Ballkan (Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrate të ndryshme; në livadhe, kullosa, vende me shkurrë dhe çeltira pyjesh të zonës subalpike dhe alpike. Në shumicën e lokaliteteve rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea multifida</i>, <i>Geum montanum</i>, <i>Leucanthemum vulgare</i>, <i>Pinus heldreichii</i>, <i>Linum capitatum</i>, <i>Pinus mugo</i>, <i>Lilium albanicum</i>, <i>Gentiana lutea</i>, <i>Campanula glomerata</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Vaccinium uliginosum</i>, <i>V. myrtillus</i> etj..	Sipas Rexhepi, F. (1986), Saric et al (1986), Josifovic, M., et al. (1973), Lakusic, R. (1970) është e përhapur në: Alpet Shqiptare (Koprivnik, Hajlë, Kurvallë, Mokna) dhe në Malet e Sharrit (Liqenet e Jazhincës dhe Prevallë). Ky lloj është i përhapur edhe në lokalitetin Përroi i Durlit dhe Piribreg.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Zakonisht takohen individë të vetmuar ose grupe të vogla. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

65	<i>Lilium albanicum</i> Griseb. [<i>Lilium carniolicum</i> subsp. <i>albanicum</i> (Griseb.) Hayek] Emri shqip: <i>Zambaku shqiptar</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G). Bulbi (qepa) ka madhësi mesatare ngjyrë të mishit. Kërcelet është i drejtë 20-50(-60) cm, në bazë i shogët, pa gjethe, në majë me 1 lule rrallë më shumë. Gjethet kanë vendosje të këmbyer, shumë a pak janë të afuara mes veti, lineare-heshtore, në majë të mprehta, të gjata 7 cm, me qerpik vetëm në buzë. Lulet janë të verdha-ari ose portokalli (pa njolla) me diametër 3.5 cm. Gjethëzat e perigonit janë heshtore. Kapsula është 2.5-3.5 cm. Riprodhohet me fara dhe bulb. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).	Bimë endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Bullgari, Serbi)	Rritet në vende me bar, shkurre, shpate shkëmbore të freskëta të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet : Sempervivum macedonicum, Geum montanum, Vaccinium myrtillus, Pinus peuce, Vaccinium uliginosum, Polygala major, Achillea alexandri-regis, Gentiana lutea, Trollius europaeus, Rubus idaeus etj. Në Bokat e Morinës ky lloj është konstatuar në substrat serpentin në kuadër të disa asociacioneve nga 630-1100 m lartësi mbidetare e shoqëruar nga llojet: Gladiolus illyricus, Forsythia europaea, Asphodelus albus, Potentilla alba, Polygala doerfleri, Plantago argentea, Sanguisorba albanica etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999), Rexhepi, F. (2000), Saric, et al. (1986) është e përhapur në: Koritnik, Luboten, Malet e Sharrit (Shtepia e malorëve, Bistra-Prevallë, Pashallarë, Oshlak, Orman, Piribreg, Ujërat e Humbura, Konjushkë, Qukat e Jezercit), Alpet Shqiptare (Mokna, Koprivnik, Zhleb, Bjeshket e Lumëbardhit, Rusoli, Pllacicë, Gjeravicë, Liçenak, Stanet e Erenikut dhe në Majën e Kunorës). Gjatë viteve 20112012 këtë lloj e kemi takuar edhe në Pashtrik, Pleçe, Milishevc, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Kurvallë, Dervish Kom, Bjeshkë të Dobroshit, pastaj në Malet e Sharrit(Përroi i Durlit, Liqenet e Jazhincës, Livadhishtë, Studenicë (Therandë), Bjeshkë të Bukoshit, Bjeshkë të Opojës etj. Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj me 16.05.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Bokat e Morinës në ekspozicion verior nga 630- 1100 m lartësi mbidetare. Është rasti i parë i njohur deri me tani që ky lloj të konstatohet në lartësi mbidetare 630 m.	Ky lloj gati në të gjitha lokalitetet e cekura formon popullacione-subpopullacione që kanë pak a shumë një areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve-subpopullacioneve. Është bimë dekorative andaj edhe popullacionet e saj shpesh herë dëmtohen nga adhuresit e natyrës. Rritet në kuadër të kullotave subalpine dhe alpine me përjashtim të Popullacionit të këtij lloji në Bokat e Morinës andaj shpesh dëmtohen nga bagëtia si dhe nga barinjtë të cilët i kallin shkurret e kësaj zone për të krijuar kullota të reja. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	---	--	---	---	--	---	----------------------------

66	<i>Linum flavum</i> L. Emri shqip: <i>Lin i verdhë</i> Familja: Linaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me kërcëj të ngritur pak të degëzuar sipër, që dalin nga një rozetë e ngjeshur 20-60 cm dhe me pak ose pa rozeta jo lulembajtëse. Gjethet me 3 (-5) nervura, të poshtmet heshtore të përmbysta-pallake, 40-60×10-12 mm, të sipërmet heshtore, pabisht 20-40×7-11 mm, me 2 gjëndra në bazë. Lulesa e degëzuar, zakonisht me 25-40 lule. Sepalet 5-6 (-8) mm, heshtore, të thepëta me karenë e gjëndra në bazë. Petalet të verdha, 20-22×11-13 mm, me llapë vezake të përmbysta dhe me thonjëz relativisht të shkurtër. Kapsula 5-6 mm me sqep afër 1 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1992).	Juglindore-Pontike.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në substrate serpentinore në kuadër të rendit Halascietalia sendtneri. Në Bokat e Morinës, Koznik dhe Mirush ky lloj takohet në biotope të njëjta me llojet <i>Linum tauricum</i> e me rrallë me llojin <i>Linum elegans</i> . Lloje tjera bimore që e shoqërojnë këtë lloj janë edhe: <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Halascia sendtneri</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Gladiolus illyricus</i> , <i>Linaria dalmatica</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Fraxinus ornus</i> etj.	Sipas literaturës ekzistuese (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021) etj. është e përhapur në: Koznik, Mirushë, Brezovicë, Novobërdë, Gërmi, Oshlak. Gjatë vitit 2012-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Pashtrikun e Poshtëm, Bokat e Krenenikut, Bokat e Morinës, Gubavc dhe në Qafë Prush.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në Bokat e Morinës dhe në Koznik. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
67	<i>Pedicularis brachyodonta</i> Schlos.et Vuk. Emri shqip: <i>Pedikulare dhëmbëshkurte</i> Familja: Orobanchaceae e [Scrophulariaceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur ose të përprjetëm. Gjethet pushlore, heshtore, dyfishpendore te prera me segmente vizake gjatore, me majucë e të sharruara. Braktetë pendore pak a shumë leshtore të prera deri në tre vriguj. Gypi i kupës leshtor vetëm në nervura; dhëmbët e kupës si deltë, buzëplotë, të qerpikët. Kurora 20-25 cm, e verdhë e zbehtë; buza e poshtme e shogët, me vriguj të sharrëzuar dhe 2 zhardhokë pranë buzës. Kapsula ovoide, me majucë, që del pak nga kupa. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi)	Rritet në kullota të zonës subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea chrysocoma</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Jovibarba heuffelii</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>H. Alpestre</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Senecio wagneri</i> <i>Stachys alpina</i> , <i>Botrychium lunaria</i> , <i>Nigritella nigra</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Daphne cneorum</i> , <i>Myosotis alpestris</i> , <i>Achillea atrata</i> , <i>Hypericum alpinum</i> etj.	Sipas Millaku,F.(1999) dhe Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Alpe Foto: Xhavit Mala (2012), Luboten Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë, Bjeshkë të Lloçanit, Maja e Rusolisë), sipas Saric et al. 1986 është e përhapur në Malet e Sharrit (Oshlak, Piribreg, Luboten, Konjushë). Ky lloj është konstatuar edhe në Bjeshkë të Lumëbardhit, Koritnik dhe Pashtrik.	Popullacionet në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë, Bjeshkë të Lloçanit, Maja e Rusolisë) dhe Malet e Sharrit (Oshlak, Piribreg, Luboten, Konjushë) kanë areal të kufizuar, por numër të konsiderueshëm të individëve brenda popullacioneve. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

68	<i>Phyteuma pseudorbicular e</i> Pant Emri shqip: <i>Fiteumë e rrumbullakët e rreme</i> Familja: <i>Campanulaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-50 cm, me kërcell të ngritur ose të përpijetëm, i shogët, rrëvaga-rrëvaga. Gjethet bazale pak a shumë gatirrotullore, me bishtak të shkurtër; kërcelloret eliptike të gjëra , të sipërmet me bishtak. Lulesa kaptinëz gjysmërruzullore, me diametër 3 cm. Braktetë vezake të gjëra , shpesh si zemër në bazë , me buzë të sharruara. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit. Sipas Matevski, V. & Kostadinovski , M. (1996) është e përhapur në Maqedoni.	Ky lloj në Kosovë rritet në kullota e shkëmbinj të zonës subalpine e alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit e shoqëruar nga llojet: <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Oxytropis campestris</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>Aster alpinus</i> , <i>Achillea chrysocoma</i> , <i>Helianthemum alpestre</i> , <i>Alchemilla plicatula</i> , <i>Campanula patula</i> , <i>Geum coccineum</i> , <i>Nigritella nigra</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Campanula foliosa</i> , <i>Trifolium badium</i> etj.	Sipas Millakut (1999) rritet në Alpe Shqiptare (Maja e Rusolisë, Kurvallë, Pllaçicë, Liqenak, Gjeravicë) sipas Josifovic et al. (1974) është prezentë Pllaçicë, Majë të Rusolisë. Sipas Saric et al. (1986) është prezentë në Malet e Sharrit (Luboten, Piribreg, Bistra, Liqenet e Jazhinces, Kobilicë) dhe Alpe Shqiptare (Liqenak dhe Dervish Kom).	Në kuadër të Alpeve Shqiptare janë konstatuar 6 subpopullacione të vogla që kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Edhe në Malet e Sharrit janë konstatuar 5 subpopullacione me areal të kufizuar por me numër të konsiderueshëm të individëve në kuadër të popullacioneve. Në shumicën e popullacioneve takohen edhe individë të vetmuar. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
69	<i>Pimpinella serbica</i> (Vis.) Benth Emri shqip: <i>Pancicia serbica</i> Vis.] Emri shqip: <i>Pimpinellë e Serbisë</i> Familja: <i>Apiaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), rreth 50 cm, e shogët, me kërcell të rrumbullakët, rrëvaga-rrëvaga, të degëzuar në pjesën e sipërme. Gjethet e poshtme si zemër, të sharruara, me bishtak të gjatë; të tjerat vijuese thellësisht të vrigullta; të sipërme pëllëmbore të ndara deri në bazë në segmente të shumta kreshtake. Ombrëllat me 10-15 rreze. Brakte 5-8, vizake, të ashpra. Brakteza 5. Fryti 3-4 mm, ovoid, me brinjë me flatra shumë të ngushta. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë ose rizomë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit. Sipas Vladimirov, V. et al. (2007) është e përhapur edhe në Maqedoni.	Ky lloj në Kosovë rritet në kullota dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Helianthemum nummularium</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>Anthyllis vulneraria</i> , <i>Dianthus integer</i> , <i>Cerastium decalvans</i> subsp. <i>dolineri</i> , <i>Scorsonera villosa</i> , <i>Polygala major</i> , <i>Dianthus cruentus</i> , <i>Gentiana utriculosa</i> , <i>Pinus heldreichii</i> , <i>Stachys alpina</i> , <i>Ranunculus montanus</i> , <i>Campanula patula</i> , <i>Trifolium velenovskii</i> , <i>Nigritella nigra</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liqenak, Bjeshkë te Lumëbardhit), sipas Josifovic, M. et al. (1973) në Zhleb, Mali Mokna, Koritnik dhe Malet e Sharrit (Oshlak). Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Ujërat e Humbura, Liqenet e Jazhincës, Jallovarnik). Në Malet e Sharrit është konstatuar edhe në: Balkë e Madhe, Lëndina e Staneve (1448 m), Përroi i Durlit etj.	Popullacionet në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liqenak, Bjeshkë te Lumëbardhit, Mali Mokna), Koritnik dhe Oshlak kanë areal të kufizuar. Edhe pse popullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar edhe në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare janë të pasura me individë maturë. Konsiderojmë se ky lloj mund të jetë i përhapur edhe në ndonjë lokalitet tjetër. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
70	<i>Plantago gentianoides</i> Sibth. et. Sm. Emri shqip: <i>Gjethedell si sanzë</i> Familja: <i>Plantaginaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me një rozetë gjethesh. Gjethet 2-6 (10) x 1-3.5 cm, llapa vezake deri eliptike, gati e plotë me 3-5 (7) nervura, e shogët ose me qime të rralla, bishtaku sa 1/2 e gjatësisë së llapës. Shtijet shumë me të gjata së gjethet. Kallinjët 1-3.5 (4) cm. Braktetë rreth 2 mm, vezake-rotullare, të shogëta, nganjëherë me qerpikë të imët. Nënpetlat 2 mm pothuaj të lira. Gypi i kurorës rreth 2 mm, i shogët; vrigujt 1-1.5 mm, vezakë, shyte. Thekët	Evropë Qendrore dhe Ballkan.	Rritet në kullota subalpine dhe alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit e shoqëruar nga llojet: <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>V. uliginosum</i> , <i>Bruckenthalia spiculifolia</i> , <i>Senecio nemorensis</i> , <i>Antennaria dioica</i> , <i>Polygonatum bistorta</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Jasione orbiculata</i> , <i>Achillea chrysocoma</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1974) është i përhapur në Alpe Shqiptaret (Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Dervish Kom). Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Luboten, Qukat e Jezercit, Liqenet e Jazhinces, Konjushë, Bistër, Karanikollë (Opojë).	Në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit popullacionet e këtij lloji janë të vogla, kanë areal të kufizuar por numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

		dalën 3-5 mm jashtë kurorës, pjalmoret të verdha. Kapsula 3 mm. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).					
71	Polygala doerfleri Hayek Emri shqip: Poligalë e Dërflerit Familja: Polygalaceae	Barishore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e ngritur me kërcëp të drunjëzuar. Kërcejtë rreth 40 cm, të padegëzuar. Gjethet vizake heshtore, të mprehta , të shogëta. Vilet skajore ovoide-gjatore, të dendura në frytëzim të sheshta. Braktet pak me të gjata se këmbëzat. Lulet të trëndafilit. Flatrat 7-9 mm (11 mm në frytëzim), vezake përmbysët të gjëra me nervatura të ndërthurura. Gypi i kurorës rreth 6 mm, gati i barabartë me petlat e sipërme. Gjinofori shumë i shkurtër. Kapsula me e shkurtër dhe më e ngushtë së flatrat. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit.	Rritet në substrate serpentinore, kullota dhe vende me bar, shpesh edhe në çeltira të pyllit të zonës malore në kuadër të asociacioneve: Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea dhe Polygalo-Genistetum hassertianae e shoqëruar nga llojet: Forsythia europaea, Aster albanicus, Euphorbia glabriflora, Hypericum barbatum, Potentilla visianii, Euphorbia barrelieri, Linum tauricum, Plantago argentea, Artemisia lobelii, Salvia ringens, Quercus pubescens, Forsythia europaea, Stachys scardica, Juniperus oxycedrus, Centaurea kosaninii, Scabiosa fumaroides, Genista hassertiana, Sanguisorba albanica etj	Sipas Millaku, F. et al. (2008), Josifovic et al. (1973), Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. (2003, 2021) është e përhapur në serpentine në rajonin e Mitrovicës dhe Koznikut, Alpe Shqiptaret (Gubavc), Bokat e Morinës, Qafë Prush, Rajoni i Mirushës, Koznik, Golesh, Rajoni i Mushtishtit (Greikoc, Korishë, Manastir), Guranë, Gradicë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë në afërsi të vendeve urbane dhe janë nën ndikim të faktorit zoootropogjen. Popullacionet në rajonin e Mirushes-Koznikut dhe rajonin e Morinës-Qafë Prush janë me areal me të gjërë dhe me numër të madh të individëve maturë. Popullacionet tjera kanë areal me të kufizuar dhe janë me shumë të ndikuara nga faktorët negativ që dëmtojnë habitatin dhe zvogëlojnë sipërfaqen e banimit të këtij lloji. Për momentin shumica e popullacioneve/subpopullac i-oneve të këtij lloji në Kosovë janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
72	Rhododendron myrtifolium Schott et Kotschy [Rhododendron ferrugineum L.] Emri shqip: Rododendroni gjethemërsinë Familja: Ericaceae	Shkurre gjethembajtës (Fanerofite P), deri 1 (-2) m, me degë të gjata, pakz të ndara. Degët e reja me ngjyrë ndryshku. Gjethet vezake, eliptike-gjatore ose heshtore-eliptike, 2-4(-5) x 0,5-1 cm, me buzë të përvjelura, të plota; përsipër të gjelbra, të shogëta, të lëmuara, për poshtë me gjëndra kaçurrele ngjyrë ndryshku; bishtaku 0,3-1 cm. Lulet nga 6-12 (20) në grumbuj, mbi bishta gjëndëror, të gjatë sa kupa ose më të shkurtër; kupa me vriguj jo të dallueshëm; kurora ngjyrë të kuqe- trëndafili, 1,5-2 x 1-2 cm, me 5 vriguj në majë. Thëkë 10, më të shkurtër se kurora. Vezorja me gjëndra kaçurrele. Kapsula çahet në 5 pjesë. VII-VIII.	Pirineje, Apenine, Ballkan, Himalaje.	Në Kosovë rritet në shkurre subalpine dhe alpine kryesisht në substrate silikate të shpatijevë veriore të Maleve të Sharrit (në lartësi mbidetare 1850-2000 m). Në Luboten rritet në substrate karbonate, në toka të thella ku bëhet shpëlarja e bazave. Është konstatuar në kuadër të asociacioneve: Rhododendro-Pinetum peucis, Rhododendro-Vaccinietum dhe Rododendro-Juniperetum e shoqëruar me llojet: Sorbus aucuparia, Luzula sylvatica, Juniperus sibirica, Geranium sylvaticum, Campanula alpina, Jasione orbiculata, Lilium albanicum, Vaccinium myrtillus,	Sipas Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M. et al.(1972) është e përhapur në Malet e Sharrit. Gjatë viteve 2011-2013 i kemi hulumtuar popullacionet e këtij lloji në lokalitetet: Brezovicë, Shtëpia e Malorëve, Liqenet e Jazhincës, Përroi i Durlit (Durlvo Potok), Pribreg, Livadhishitë dhe Luboten.	Popullacionet/subpopullaci onet e këtij lloji në Malet e Sharrit kanë areal bukur të gjërë dhe numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Këto subpopullacione janë afër në aspektin e shtrirjes gjeografike, Popullacioni në Luboten ka areal të kufizuar dhe numër më të vogël të individëve maturë në krahasim me subpopullacionet tjera. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë mjaft mirë të ruajtura dhe mund të dëmtohen vetëm nga zjarret. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

				Vaccinium uliginosum, Empetrum nigrum, Veronica bellidioides, Gentiana verna, Phyteum orbiculare, Trifolium badium, Trollius europaeus.			
73	Salix reticulata L. Emri shqip: Shelg i rrjetëzuar Familja: Salicaceae	Gjysmëshkurre (Kamefite CH) 30-40 cm, me kërcell zvarritës, rrënjëzues. Degëzat me kënde, të shogëta dhe më pak gjethe. Gjethet eliptike deri vezake- rrotullare, shyte ose lehtësisht majëngrëna, në bazë si zemër ose më rrallë pykore, të plota, lëkurore, përsipër të gjelbra të errtë, gati të shogëta, me nervurë të futur, përposh të bardheme, gati të shogëta, me nervurë të dala të rrjetëzuara, me llapë 1.5-5 cm, me bishtak 5-15 mm. Ndajgjethëzat mungojnë. Gathët në krye të degëve me gjethe, me bishta deri 25 cm, dalin pas gjetheve. Gathët 2-3 cm; ato mashkull rreth 2 cm, ato femër deri 3 cm. Braktet të murrme të çelëta, vezake, të përmbystë, me qime të gjata përbrenda. Thekë 2, me qime nga mesi e poshtë; vezorja pushbutë, pa këmbëz dhe me shtyllëz të shkurtër. Lul. VI-VII; Fryt. VII- VIII. 9. Paparisto. K. et al. (1988).	Në malet e larta të Evropës, deri në zonën polare, Azi Qendrore, Amerikë Veriore.	Në Kosovë ky lloj është i përhapur kryesisht në substrate silikate, me rrallë në substrate gëlqerore, në vende shkëmbore, kullota dhe çakëllishite të zonës subalpine dhe alpine, ku shpesh formon fitocenoza me bimët tjera alpine dhe mbron tokën nga erozioni. Në Kosovë rritet e shoqëruar nga llojet: Salix herbacea, S. retusa, Juncus trifidus, Homogyne alpine, Vaccinium myrtillus, Geum montanum, Hypericum alpigenum, Achillea abrotanoides, Veratrum album, Pedicularis verticillata, Phyteuma confusum, Jasione orbiculata, Arctostaphylos uva-ursi, Alliaria petiolata, Sempervivum macedonicum, Plantago media, Centaurea nervosa etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Hajlë , sipas Saric et al. (1986) & Josifovic, M. et, al. (1972) në Koritnik, Luboten, Bister, Shtëpia e Malorëve, Piribreg dhe Livadhishtë. Me 18.08.2013 Millaku, F., dhe Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan edhe në Vracë në lartësi mbidetare 2210 m.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar, mirëpo janë të pasura më individë maturë që dominojnë në këto biotope dhe kanë rëndësi shumë të madhe në mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

74	<i>Saxifraga scardica</i> Griseb. Emri shqip: Iriqëz e Sharrit Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H) e dendur, me kërcëj gjethorë, 4-7 cm, gati të drunjëzuar në bazë, shumë të degëzuar, si rozeta ose si shtylla, me gjethe të ngjeshura. Kërcëjtë lulorë të ngritur ose të përpjetëm, 3-10 cm, me gjethe të çlirëta me qime gjëndërore. Gjethet e kërcëjve të hapura të shpërveshura; në faqen e sipërme konkave; në faqen e poshtme konvekse - me karenë; në gjysmën e sipërme të plota, të shogëta; në gjysmën e poshtme me dhëmbë të imët ose me qerpikë, gjatore-pallake ose heshtore-gjatore, 4-16 x 1.5-4.5 mm, me majë të mprehtë, shpesh me hidatoda. Gjethet e kërcëjve lulorë gjatore-pallake, 4-8 x 1.3-2 mm, të mprehta me thumb. Lulesa vastakore ose vastakore-melthore, me 3-11 lule. Sepalet vezake ose vezake-gjatore, 2.3-4 x 1.5-1.9 mm, shpesh majëmprehta, me qime gjëndërore, si purpur. Petalet gjërësisht vezake të përmbysëta, 5-9 x 2.5-4.5 mm, të bardha ose trëndafil. Thëkët më të shkurtër se petalet. Vezorja e nëntëshme, me qime gjëndërore. Karpelet 4-6 mm. farat 0.8 mm, të murrme, me rrudha. VI-VIII. (Paparisto, K. et al. 1988).	Siujdhesa ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinj gëlqeror të zonave alpine e shoqëruar nga llojet: Minuartia baldaci, Minuartia verna, Edraianthus graminifolius, Armeria alpina, Achillea chrysocoma, Asperula doerfleri, Jovibarba heuffeli, Saxifraga paniculata, Saxifraga sempervivum, Thlaspi bellidioides, etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Krasniqi, F. (1987) është prezentë në Koprivnik, Guri i Kuq (Bjeshka e Lumëbardhit), Dervish Kom dhe Liçenak. Sipas Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1977) është prezentë edhe në Malet e Sharrit (Livadhishtë, Luboten, Brod, Balka e Madhe), Koritnik. Millaku, LC – Më pak i rrezikuar. . F. me 30.06. 2012 e konstatoi edhe në Pleçe (Alpe Shqiptare) në të çara të shkëmbinjve në ekspozicion verior në lartësi mbidetare 2467 m. Më 19.05.2013 Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N. e konstatuan edhe nën Majën e Vjellakut (Pejë) dhe mbi grykën e Shushicës nga 1710-1913 m lartësi mbidetare.	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Livadhishtë, Luboten, Koritnik) dhe në Alpet Shqiptare(Koprivnik, Liçenak, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Pleçe, Maja e Vjellakut, Gryka e Sushicës) kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është i vogël. Popullacionet e këtij lloji për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	---	---	--	--	---	---	----------------------------

75	<i>Saxifraga sempervivum</i> C. Koch [<i>Saxifraga media</i> S.S.] Emri shqip: <i>Iriqëz përherë e gjelbër</i> Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore e dendur, me kërcëj gjethorë shterpë, që mbarojnë me rozeta gjethore. Kërcëjtë lulorë pak dredhakë, 5-12 (-15) cm, me gjethe të dendura, me qime të hapura gjëndërore. Gjethet e bazës në rozeta me diametër 1-2 cm, shumë a pak me karenë në anën e poshtme, të rimta, të shogëta, ose vetëm me pak qërpikë në fund, vizake ose vizake-heshore, të mprehta ose gati majëgjata-të fëndyellta, 0.8-1.6 cm, me buzë kërcore, me shumë hidatoda anëve. Kërcelli lulor 8-14 mm, lulet purpur të hapur, 2-2.5 x 1-1.5 mm. VI- VII.	Pjesët jugore të Siujdhesa Ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinjtë gëlqeror, silikat dhe serpentin të zonave malore shoqëruar nga llojet: Ramonda nathalie, Saxifraga scardica, Minuartia baldacii, Minuartia verna, Edraianthus graminifolius, Armeria alpina, Achillea chrysocoma, Asperula doerfleri, Jovibarba heuffeli, Globularia cardifolia etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999) është e përhapur në Gjeravicë, Rrasë te Zogut, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Majën e Strelleit, Bjeshkën e Lybeniqit, Bjeshkën e Lumëbardhit dhe në Liçenak. Sipas Saric et al. (1986) në Malet e Sharrit është prezentë në: Piribreg, Oshlak, Koxhaballkan, Kobilicë, Livadhishitë, Luboten, Rusenicë. Millaku, F. dhe Gashi, B. me 11.05.2013 e konstatuan edhe në Gotovush (Shterrpcë) në 1134 m lartësi mbi detare dhe në afërsi të Gllaboqicës (Elez Han) si lloj shoqërues i bimës endemike Ramonda nathalie.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë shtrirje të gjërë. Edhe pse ky lloj në kuadër të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit ka një shtrirje të gjërë, popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar por në disa lokalitete të pasura me individë maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
76	<i>Jovibarba heuffelii</i> (Schott) Á. Löve & D. Löve [<i>Sempervivum heuffelii</i> Schott.] Emri shqip: <i>Burgull i Heufelit</i> Familja: Crassulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rozetë 5-7 (-12) cm në diametër, pa stolone. Gjethet janë 25-60 mm të gjata dhe 10-15 mm të gjëra, gjatore vezake përmbysta në maje në formë gjembi të blertambyllë ose të blertapërhimëta, me buzë të verdha dhe të mbuluara me qime të forta-qerpikore. Kërcelli lulorë është 10-20 cm i gjatë në pjesën e sipërme me qime gjëndërore. Gjethet në kërcell janë ovale në bazë formë zemre, pak e mbështjellin, kërcelli me vijë dhe qime gjëndërore. Sepalet janë pjatore-lineare me gjëndra dhe qime. Petalet janë 10-12 mm të gjata, dy herë me të gjata se sepalet, te verdhazbehta, në buzë kanë qerpik. Shtyllëza është 2 mm e gjatë. Josifovic, M., et. al. (1972).	Ballkan, Rumani (Sub-Ballkanike)	Ky lloj rritet në vende të thata me bar ose në shkëmbinjtë të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Achillea chrysocoma, Armeria alpina, Helianthemum canum, Pedicularis brachyodonta, Globularia cardifolia, Festuca koritniensis, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Juniperus sibirica, Daphne cneorum, Myosotis alpestris etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liçenak, Bjeshkë të Lumbardhit dhe Koprivnik), është konstatuar edhe në Kurvallë. Në Malet e Sharrit është e përhapur në Koxhaballkan (Rusenicë, Pashallarë, Livadhet e Çhajës), Luboten.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

77	<i>Sempervivum macedonicum</i> Praeger Emri shqip: <i>Burgull macedonas</i> Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rozeta 2-5 cm, gati pllakore, me stolone 4-7 cm të gjata. Gjethet e rozetës heshtorepërmbysta—të gjëra , në të dy faqet me qime të imta të dendura gjëndërore, me majë të shkurtër, në bazë shkurtësisht vizake, 6-7 x 1.5-2 cm, shumë sukulente, të gjelbra të përlyera, afër majës të kuqe, në bazë të bardhërreme, në buzët me gjëndra qepallore, 2.5 mm të gjata, dyfish më të gjata se qimet. Lulesa me 11 ose 12 lule. Petalet 8-10 mm të gjata, të kuqe-trëndafil. Thëkët ngjyrë vjollce, gati të shogët. VI-VII	Kosovë, Maqedoni (Matevski, V. & Kostadinovski , M. 1996, Micevski & Matevski, 1987) (endemike).	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrate shkëmbore gëlqerore, silikate dhe serpentine. Rritet në shkëmbinj dhe vende me bar (kullota) të zonave subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Helianthemum canum</i> , <i>Edraianthus graminifolius</i> , <i>Senecio carpatica</i> , <i>Myosotis alpestre</i> , <i>Poa alpina</i> , <i>Achillea chrysocoma</i> , <i>Ptilotrychum rupestre</i> , <i>Senecio carpatica</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Minuartia verna</i> , <i>Vaccinium uliginosus</i> , <i>Juncus trifidus</i> , <i>Jasione orbiculata</i> , <i>Antennaria dioica</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është e përhapur në Gjeravicë, Dervish Kom. Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Bistra, Shtëpia e Malorëve, Përroi i Durlit). Gjatë vitit 2011-2013 e kemi konstatuar edhe në Vracë, Luboten, Liqenet e Jazhincës, Brezovicë.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Malet e Sharrit ky lloj ka përhapje mjaft të gjërë. Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit janë mirë të zhvilluara dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
78	<i>Trollius europaeus</i> L. Emri shqip: <i>Trol evropian</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10—70 cm e lartë me kërcell zakonisht të padegëzuar, të shogët, me një lule (rrallë me 2-3 lule). Gjethet janë pëllëmbore, të çara në 3-5 pjesë, të poshtmet janë me bisht, të sipërmet pabisht. Lulet janë relativisht të mëdha, ruzullore, me fletëza të kupës si petale të verdha. Lulëzon VII. Frynnon VIII (Rexhepi, F. 1986; Paparisto, K., et al. 1988).	Evropë, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Saric, M. et al. 1992; Polunin, O. 1997, Jordanov, D. et al. (1970).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat gëlqeror, silikat dhe serpentin. Zakonisht takohet në çeltira pyjesh, vende me lagështi, buzë burimeve të zonave të larta në Malet e Sharrit dhe në Alpet Shqiptare. Është mjaft i përhapur në kuadër të fitocenozave të ndryshme si: <i>Wulfenio-Pinetum mugi</i> , <i>Abieti-Fagetum</i> , <i>Seslerio-Pinetum heldreichii</i> , <i>Achilleo-Pinetum mugi</i> dhe <i>Pinetum mugo serpentinicum</i> . Gjendet në shoqëri me llojet: <i>Valeriana officinalis</i> , <i>Geum coccineum</i> , <i>Pinus mugo</i> , <i>Pinus peuce</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Polygala major</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Linum capitatum</i> , <i>Anthyllis vulneraria</i> , <i>Lilium albanicum</i> etj.	Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut, Pleçe , Mokna, Koritnik, Malet e Sharrit (Përroi i Durlit, Brezovicë, Shtëpia e Malorëve, Oshlak, Pashallarë, Livadhishtë (Josifovic, M. et al. 1970; Rexhepi, F. 1986, 1994; MMPH 2008).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura kryesisht në vende me lagështi apo me rrjedha uji. Edhe pse lloji ka shtrirje mjaft të gjërë, popullacionet nuk janë shumë të mëdha dhe janë nën ndikim të faktorit antropogjen. Popullacionet me të pasura me individ maturë në kuadër të Alpeve Shqiptare janë: në Malin Mokna dhe Pleçe. Në Malet e Sharrit janë disa subpopullacione të cilat janë të pasura me individ maturë.	Më pak i rrezikuar.

79	<i>Viola elegantula</i> Schott. Emri shqip: <i>Manushaqe pak elegante</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-30 cm, e shogët ose pak pushlore. Gjethet 1-2 (-3) cm, të poshtmet rrotullare, të sipërmet vezake-heshlore ose heshtore. Ndajgjethëzat sa 1/2-3/4 e gjatësisë së gjethëve, vezake, të ndara pendore, me 4-10 segmente në anën e jashtme dhe 2-4 segmente në anën e brendshme. Lulet 2-2.5 cm. Petlat jo shumë të gjëra, ngjyrë manushaqe ose të verdha, rrallë të bardha ose të trëndafilta, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 5-8 mm, i drejtë ose lehtësisht i përkulur. Hollak, tri herë më i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërnylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Gadishulli Ballkanik (Subendemike)	Në Kosovë Ky lloj është konstatuar në kullota të thata, dhe vende gurishtore të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Campanula spatulata, Veratrum album, Geranium subcaulescens, Poa violacea, Juniperus sibirica, Rumex alpinus, Chenopodium bonus-henricus etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Malet e Sharrit (Koritnik, Bistër, Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Livadhishtë, Luboten) dhe në Alpet Shqiptare të Kosovës (Maja e Rusolisë, Zhleb, Liqenak, Gjeravicë, Pllaçicë, Kurvallë).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar por numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve/subpopullacioneve është i konsiderueshem. Edhe pse këto popullacione kanë areal të kufizuar për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
80	<i>Viola orphanidis</i> Boiss. Emri shqip: <i>Manushaqe e Orfanidit</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) leshtake deri 50 cm me kërcëj të shumtë, të përpjetëm. Gjethet 2-4 cm, vezake ose rrotullare, nganjëherë gati si zemër, me buzë ura-ura ose të sharruara, leshtake kryesisht gjatë nervurave dhe në buzët; llapa e barabartë ose më e gjatë se bishtaku. Ndajgjethëzat 1-2 cm, vezake të pjerrëta, thellësisht të dhëmbëzuara ose të ndara gati-pendore me segmentin skajor me të madh se të tjerat. Lulet rreth 2 cm. Petlat blu, e poshtmjia me një njollë të verdhë, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 4-5 mm, hollak i përkulur, dy herë më i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërnylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Gadishulli Ballkanik (endemike Ballkanike)	Në Kosovë është konstatuar në livadhe, afër tëbanëve dhe buzë pyjeve halore, të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Cyrsium appendiculatum, Geranium sylvaticum, Veratrum album, Rubus idaeus, Potentilla hirta, Juniperus sibirica, Rhododendron ferrugineum, Rumex alpinus, Geum coccineum etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Liqenet e Jazhincës, Ujrat e Humbura dhe Livadhishtë). Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Bjeshkën e Deçanit, Koprivnik (Pejë), Gryka e Lloqanit, Kurvallë. Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur edhe në Majën e Rusolisë. Millaku, F., Krasniqi, F. Mala, Xh. Berisha, N. me 11.07.2013 kanë lloj e konstatuar edhe në Perroin e Durlit dhe mbi Shtëpinë e Malorëve në 2052 m lartësi mbidetare.	Ky lloj formon disa popullacione/subpopullacione në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare që kanë areal shumë të kufizuar, mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i konsiderueshem. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

06-Rajoni Zhvillimor Lindje

Ky rajon ka potencial të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga shtatë (7) komuna: **Gjilan, Novobërdë, Kamenicë, Viti, Klokot, Ranillugë, Partesh.**

Rajoni Lindje për dallim nga rajonet tjera ka përhapje më të vogël me llojllojshmëri të florës. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 12 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore shumëvjeçare, shkurre, dru, etj.

Në formë tabelare është paraqitur lista e aseteve të resurseve natyrore.




Figura 8. Achillea ageratifolia



Tabela 6. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Lindje

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I . Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR - LINDJE							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Kategoria e kërcenueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Galium rhodopeum</i> Vel. Emri shqip: Ngjitësja e Rodopeve Familja: Rubiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli është i gjatë 1-30 (-55)cm, nga baza, i mbuluar me qime të shkurtra dhe me degë sterile. Gjethet janë nga 6 në njëje, të gjata 6-15 cm, të holla lineare deri gjilpërore. Lulesa është melth i rrallë me degë të drejta, të shkurtra. Lulet janë të vogla, kurora ka ngjyrë të verdhë në të bardhë me diametër 3.5-5 mm. Frytet janë të thata nga dy akenë në formë veshkore. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Polenizimi kryhet me anë të erës. Frytton VI-VII. (Rexhepi, F., 1986).	Kosovë, Bullgari, Greqi.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në substrat gëlqeror; në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinoro-malore. Zakonisht takohet në kuadër të asociacionit TeucroArtemisietum camphoratae e shoqëruar nga llojet: Teucrium montanum, Artemisia camphorata, Achilleae ageratifolia, Dianthus gracilis, Hypochaeris radicata, etj	Artanë (Novobërdë) – (Mali i Madh dhe Mali i Vogël), Rexhepi, F. (1975,1977, 2000).	Në Kosovë deri me tani është konstatuar vetëm një popullacion i vogël i këtij lloji, që ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
2	<i>Laburnum alpinum</i> (Mill.) Bercht. & J.Presl Emri shqip: Aides alpin Familja: Fabaceae	Bimë shkurte ose dru (Fanerofite P), (6)7-10 m. Bisqet janë të shogëta ose me qime të mëndafshita, të rralla, të blerta. Gjethet janë me bisht 2-5 cm, me 3 gjethëza, 3-6 x 2-3 cm. me maje të mprehta, eliptike e gjatore. Lulet janë në lulesa vile, pa gjethë, të varura në kohën e lulëzimit. Kupa është kambanore, lehtësisht dybuzore, me buzë të pandara ose pak të dhëmbëzuara. Kurora është e verdhë, 1.9 deri 2 cm. Bishtaja është 4 -5 cm, e shogët, nervura e sipërme është me flatër 1-2 mm të gjërë. Farat janë të murme e të shumta, të shtypura. Riprodhohet me farë, lulëzon VI-VII, kurse frytëzon VIII-IX. (Qosja, Xh. et. al. 1992).	Sipas Flora Europaea (1968) është e përhapur në Shqipëri. Sipas Em, H. (1967) rritet edhe në Kroaci dhe Maqedoni. Polunin, O. (1980) e përmend edhe për Greqinë Veriore.	Në Kosovë (Artanë - Novobërdë) rritet në substrat silikat në pyje të ahut submontan, e shoqëruar nga llojet: Fagus moesiaca, Populus tremula, Acer platanoides, Viburnum lantana, Prunus avium, Hedera helix, Knautia drymeia etj.	Sipas Rexhepi, F. (1975, 1977, 1986), Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Artanë (Novobërdë).	Në Kosovë (Artanë) ky lloj bimor formon vetëm një popullacion të vogël që ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

3	<i>Adonis vernalis</i> L. Emri shqip: <i>Adonisi pranveror</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-40 cm e lartë, me rizomë të fuqishme me ngjyrë gështenje të mbyllët. Kërçelli i drejtë i padegëzuar ose i degëzuar pa qime në pjesën e poshtme me hulli. Gjethet e kërçellit pabisht, 2-4 herë pendore të ndara me rezhdë të holla lineare pa qime ose rrallë me qime. Lulet e vetmuar, të verdha më diametër 3-7 cm. Sepale 5, petale 10-20 të ngushta pykore të plota anash ose të dhëmbëzuara. Fryti 4-5 mm i gjatë gati i rumbullakët, i rrudhur në formë rjetore, me qime, afër bazës i zgjatur dhe me errëm. Lulëzon V-VI. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. (Rexhepi, F.2003).	Evropë, Azi Perëndimor e	Rritet në çeltira pyjesh termofile dhe në kullota të thata në kuadër të asoc. Carpinetum orientalis scardicum, dhe Quercetum pubescentis cerris e shoqëruar nga llojet: Iris reichenbachii, Iris florentina, Carpinus orientalis, Quercus pubescens, Paeonia decora, Malus florentina, Acer tataricum etj	Rajoni i Gllarevës, (Krasniqi, E. 2003), Gazimestan, Gllamë (Gjilan)	Popullacioni më i rëndësishëm i këtij lloji në Kosovë shtrihet në substrat gëlqeror në rrethinën e Gllarevës. Ky popullacion shtrihet në rrethinën e Gllarevës, Gjurgjevikut të Madhë, Pogragjë dhe shkon deri afër fshatit Buroj (Skënderaj). Ky lloj është i përhapur nëpër çeltira të pyllit të dushkut dhe shkozës si individ ose shpesh në tufa. Në disa lokalitete e kemi konstatuar afër rrugës gjë që dëshmon se është bartur fara gjatë ndërtimeve të rrugëve. Popullacionet në Gazimestan dhe Gllamë (Gjilan) kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
4	<i>Gladiolus palustris</i> Gaudin Emri shqip: <i>Gladiolë kënetash</i> Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 25-50 cm. Millet bazale të gjelbërt, ndonjëherë me nuanca të kuqe zakonisht gjatë nervurave. Gjethet janë 10-40 cm x 4-10 mm të gjata dhe 4-10 mm të gjëra, zakonisht vetëm një gjethe kërcellore braktëngjashme me dy gjethe bazale. Kalliri njëanësor deri me 6 lule. Rrëthlulja e kuqe deri e kuqe-purpur. Segmentet e rrethlules 25 x 40 x 6-16 mm, të sipërmit gati të barabartë, vezake përmbysët, anësoret rombikë, të poshtmit rreth 1/3 e gjatësisë të të sipërmeve, gjatë pykore; thonjëza aq sa llapa. Riprodhohet me farë dhe bulb. Lulëzon V-VI. Frytëzon VII. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Evropë.	Rritet në livadhe ose kullota me lagështi. Në Brezovicë rritet në livadhe të cilat me parë kanë qenë pyje të verit (Alnetum glutinosae) e shoqëruar nga llojet: Alnus glutinosa, Fraxinus angustifolia, Taraxacum officinale, Galium verum, Bellis perennis, Ranunculus millefoliatus, Trifolium pratense, Poa pratensis, Plantago major, Equisetum arvense etj.	Brezovicë, Llabjan (Novobërdë), Rexhepi, F. (1978), Llopshnik (Dragash).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të popullacionit në Brezovicë që është me i ruajturi në krahasim me popullacionet tjera.	I rrezikuar.
5	<i>Knautia macedonica</i> Griseb. Emri shqip: <i>Knaute e Maqedonisë</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore e çlirët, me rozetë gjethesh dhe kërcej lulore, zakonisht me stolone nëntokësore. Kërçelli është deri 70 cm i lartë, pak a shumë i kreshpat me pak qime. Gjethet janë të vendosura të kreshpëta, bazalet të gjelbra, të përmbysta që zakonisht thahen në kohën e lulëzimit, ndërsa gjethet kërcellore janë heshtore deri vezake të ngushta. Zakonisht lirake-pendore me 4-12 vriguj anësor dhe një vrigull skajor vezak e me buzë ura-ura si sharrë. Kaptinëzat janë me diametër 1.5-3 cm. Kupa është si gishtje me (6-) -8 (-10)	Ballkan, Rumani, Turqi.	Rritet në livadhe kodrinore (Thymo- Knautietum macedonica, Rexhepi, F. (1978), Hundozi, B. (1980), e shoqëruar nga llojet: Thymus tosevi, Primula columnae, Trifolium alperstre, Knautia arvensis, Polygala comosa, Leucanthemum vulgare, Leontodon hispidus, Lotus corniculatus, Onobrychis arenaria, Filipendula vulgaris.	Sipas Saric et al. (1986), Hundozi, B. (1980), Rexhepi, F. (1978) është e përhapur në: Përlepnice, Mirushë, Oshlak, Virovi, Liqenet e Jazhincës	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni i këtij lloji në afërsi të Mirushës është afër zhdukjes si pasojë e ndërtimeve në habitatin e këtij lloji.	I rrezikuar.

halëza. Kurora është zakonisht e kuqe e errët, nganjëherë blu ose trëndafili. Lulëzon V-VII. Frymon VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996).
Rexhepi, F. (1978).


6	<i>Narcissus poeticus</i> subsp. <i>radiiflorus</i> (Salisb.) Baker Emri shqip: <i>Selikal, Narcis, Lulëxheneti, lulëdremitqare</i> Familja: Amaryllidaceae	Baristore shumëvjeçare (Gjeofite (G), me bulb të gjatë 50-60 mm dhe të gjërë 15-25 mm, me mbështjellë ngjyrë kafë. Kërceili 20-40 (60) cm i lartë me dy brinjë të sheshta. Gjethet 2-5 lineare, me 5-8 mm, të gjëra, të sheshta, pak a shumë të imta ose të gjelbërta me të shkurtra se kërcelli. Zakonisht në majë të kërcellit një lule rrallë 2 ose më shumë. Segmentet e rrethlules 22-30 mm, të bardha, në fillim të lulëzimit të bardha në të verdhë, gati vezake përmbysët-pykore, me thonjzë pak a shumë të dallueshëm pak a shumë me kinde. Korona 2-2.5 x 8-10 mm, cilindrike. Të gjithë thekët gati të një madhësie dalin pjesërisht jashtë rrethlules. Lulëzon V-VI. Frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe bulb. Vangjeli, J. et al. (2000).	Alpe të Evropës, Karpate, Ballkan.	Në Kosovë rritet në livadhe me lagështirë që kositen të zonës kodrinore dhe malore e shoqëruar nga llojet: Taraxacum officinale, Galium verum, Alnus glutinosa, Bellis perenis, Ranunculus millefoliatus, Silene viscaria, Ajuga genevensis, Trifolium pratensae, Plantago mayor, P. lanceolata, Sanguisorba minor, Poa pratensis, Fetuca sp., Galium cruciata, G. palustrae. Në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut) ky lloj është konstatuar në zonën e Ahut dhe rrobullit në 1710 m lartësi mbi detare e shoqëruar nga llojet: Lilium albanicum, Fritillaria messanensis, subsp. gracilis, Asphodelus albus, Achillea abrotanoides, Gentiana lutea, Pinus heldreichi, Acer pseudoplatanus etj.	Sipas Hundozi, B. (1980), Josifovic et al. (1975) dhe Krasniqi, E. et al. (2020) është e përhapur në rrethinën e Kaçanikut, Dumnicë, Ferizaj, Dobroshevc, Miradi e Ulët, livadhe të Llabjanit (afër Artanës), Brezovicë (Rexhepi, F.1978). Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N., me 19.05.2013 e konstatuan një popullacion të këtij lloji në Alpet Shqiptare (Maja e Vjellakut - 1710 m). Është lokaliteti i parë i këtij lloji i konstatuar në Alpet Shqiptare.	Popullacionet e këtij lloji Kosovë kanë areal të kufizuar. Areali e këtyre popullacioneve po shkojnë në vazhdimësi duke u zvogëluar si pasojë e ndërtimeve të rrugëve dhe qendrave urbane gjatë 10 vitet e fundit. Popullacioni më interesant i këtij lloji është popullacioni i konstatuar në Majën e Vjellakut - Alpet Shqiptare. Ky popullacion ka një areal shumë të kufizuar dhe dallon nga lokalitetet tjera në aspektin e diversitetit floristik.	I rrezikuar.
---	--	---	---	--	--	---	---------------------

7	<i>Quercus robur</i> L. subsp. <i>robur</i> Emri shqip: Rrënjë Familja: Fagaceae	Dru 30-40 (-45) m i lartë (Fanerofite P) me lëvore të murrme të errët, me brazda të gjëra për së gjati dhe të çara të cekëta të tërthorta, me kurorë vezë - konngjashme. Degët njëvjeçare të shogëta, rrallë me pak qime, të blerta, të përhimë ose të murrme të kuqërreme. Sythet vezëgjashëm ose gati rrozullor, shytë, rrallë majëmprehtë, 5-7 mm. Gjethet rrëno, zakonisht vezake të përmbysët ose gjatore-vezake të përmbysët, të shogëta, ose kur janë të reja rrethim me push të paktë, me 5-7 palë vriguj, me po aq nervura kryesore si dhe me mjaft nervura të ndërmjetme, 5-15(-20) x 2.5-5(-10) cm me bishtak 2-5(10) mm. Lulet mashkull me 4-7(8) thekë, në lulesa 2-5 cm; lulet femër me nga 3 kreza të kuqe të zezërreme në lulesa me bishta 4-5 cm. Frytet piqen në vitin e parë, të vetmuara ose 2-5 në një bisht të përbashkët me gjatësi 3-6(-10) cm. Gishtja e lëmuar me mëlluga të sheshta, pushpaka, të ngjitura, me përjashtim të majave. Lëndët 2-4x 2-3 cm. Lulëzon IV-V. Frytëzon IX-X (Paparisto, K., et al. 1988).	Native dhe dominonte kryesisht në tokat e kafta ("brown soils") në pjesën më të madhe të Evropës duke përfshirë edhe disa pjesë veriore si dhe disa pjesë të Mesdheut (Tutin, T. G. et al. 1964; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet vetëm në ultësira të lumenjve (Drini i Bardhë, Morava e Binçës) në substrat aluvial i shoqëruar nga llojet: Acer campestre, Ulmus campestris, Prunus ameniaca, Prunus spinosa, Crataegus monogyna, Lonicera caprifolium, Clematis vitalba, Ranunculus millefoliatus, Melanpyrum arvense, Trifolium pratense, Trifolium campestre, Galium verum, Phleum pratense, Rumex crispus, Verbascum phoeniceum, Centaurea cyanus, Sambucus ebulus etj.	Zallq, Terbuhoc, Saradran, Klinë, Nashec, Zllakuqan, Klinë Drobesh (Krasniqi, E. et al. 2011; Isufi, F. et al. 2011, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua më 21.05.2011 në Drobesh (E. Krasniqi); gjithashtu në Zllakuqan dhe Zallq më 21.05.2011 (E. Krasniqi). Viti.	Lloji gjendet shumë rrallë, vetëm si individë në pesë lokalitete në Rrafshin e Dukagjinit dhe në një lokalitet në Anamoravë. Në lokalitetet e lartpërmendura numri i individëve maturë është 1 me përjashtim në Zallq ku janë hasur më shumë se një individ.	I rrezikuar.
8	<i>Ranunculus illyricus</i> L. Emri shqip: Zhabinë ilirike Familja: Ranunculaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rrënjë të shumta, disa me trashime vezake, disa të holla. Kërçelli 20-50 cm, i hollë, i padegëzuar ose me degë të pakta. E gjithë bima ka qime të shtrira, të hirta të argjendta. Gjethet e bazës me bishtak të gjatë, me tri segmente vizake heshtore, të plotë ose të ndarë në 2-3 vriguj. Gjethet e kërçellit të ndarë në tre segmente; të sipërmet të plota, heshtore vizake. Lulet të verdha, me diametër 1,5-3 cm. sepale 5 vezake të ngushta, me qime të dendura të hirta të argjendta, në kohën e lulëzimit të këtyre poshtë. Petalet 8-15 mm të gjata, vezakepërmbysta deri të rrumbulluara, me nektarie të gjatë në bazë. Shtrati i lules gjatë, i shogët. Akenët të shumtë, deri 3 mm të gjatë, sqepthi i mprehtë, i drejtë. V-VI.	Europa, Azia jugperëndi more. Submediter ane- Pontike.	Në Kosovë rritet në vende të thata ranore, shpatije të thata, kullota dhe shkurreta, kryesisht në substrat serpentin dhe karbonat. Në pjesën lindore të Pashtrikut rritet në kuadër të asociacionit: Quercetum trojanae dukagjinii, e shoqëruar nga llojet: Veronica jacquini, Artemisia lobeli, Sanguisorba minor, Pyrus eleagrifolia, Cerinthe minor, Astragalus onobrychis, Alyssum desertorum, Asphodelus albus, Helianthemum nummularium, Linum tenuifolium, Euphorbia myrsinites, Scabiosa fumaroides, Calamintha acinos, Stachys recta etj. Në Pashtrikun e Poshtëm (Qafa e Mullarit) në 1487 m lartësi mbidetare rritet në kullota subalpine të thata së bashku	Gjatë vitit 2012 Pajazitaj, Q, Millaku, F., Krasniqi, E. & Mala, Xh. këtë lloj e konstatuan në Pashtrik, në vende të degraduara të pyllit Quercetum trojanae dukagjinii ose pyllit të ahut në lartësi 800-1430 m. Me 29.05.2013 Millaku, F. e konstatoi në Pashtrikun e Poshtëm (Qafa e Mullarit) në kuadër të kullotave subalpine në 1487 m lartësi mbi detare. Mala, Xh. dhe Rexhepi F. (25.05.2012) këtë lloj e konstatuan edhe në Gallushë (Theranë) dhe	Dy subpopulacionet e këtij lloji në Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre dy subpopulacioneve është shumë i vogël, në veçanti në Pashtrikun e Poshtëm ku janë konstatuar < 40 individë maturë. Populacioni me i ruajturi i këtij lloji dhe me numër të konsiderueshëm të individëve maturë gjendet në Gallushë (Theranë). Populacionet tjera të këtij lloji kanë numër relativisht të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

			me llojet: Onosma visianii, Centaurea kosaninii, C. atropurpurea dhe Jurinea mollis.	Artanë (Novobërd).			
9	Armeria cariensis var. rumelica (Boiss.) Boiss. Emri shqip: Armerie Familja: Plumbaginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me rozetë. Rrënja e drejtë. Rizoma mbitokësore e drunjëzuar. Gjethet e jashtme të rozetës lineare, 2-3.5 mm të gjëra , buzëve të valëzuara; gjethet e brendshme me të ngushta dhe më të gjata, 1-1.5 mm të gjëra, të sheshta. Shtijet lulore 20-45 cm të larta, të shogëta. Kaptina 2-2.5 cm e gjërë. Gjethet e involukrumit ngjyrë gështenje, me buzë të përhitura-cipëthata. Kupa me halëza, 8 mm të gjata. Kurora ngjyrë vjollcë e çelur ose rozë. Lulëzon V-VI, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe rizomë.	Ballkan (Kosovë, Maqedoni Bullgari, Greqi, Turqi).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat silikat, në livadhe dhe kullota të zonës malore në kuadër të asociacionit: Armerio-Trisetetum flavescentis e shoqëruar nga llojet: Achillea millefolium, Bromus mollis, Crepis biennis, Festuca pratensis, Moenchia mantica, Plantago lanceolata, Poa pratensis, Ranunculus bulbosus, Rhinanthus rumelicus, Rumex acetosa, Rumex acetosella, Trifolium campestre, Trifolium repens, Trisetum flavescentis, Viola tricolor etj.	Sipas Rexhepi, F. (1974) është e përhapur në Artanë (Novobërdë).	Në Kosovë ky lloj formon vetëm një popullacion (Novobërdë) që ka areal shumë të Foto: Ferat Rexhepi (2013), Artanë (Novobërdë) kufizuar. Ky popullacion është nën ndikim të madh të faktorit njëri i cili po shkon duke e zvogëluar habitatin e këtij lloji.	I përkeqësuar.
10	Achillea ageratifolia (Sibth.et Sm.) Boiss. Emri shqip: Barpezmi gjetheagjerrate Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare tufore (Kamefite CH), kërcëjtë deri 30 cm, të ngritur, secili me nga në kaptinëz. gjethet të përhimëta-pushbuta; bazalet 2-4 cm, pallake, buzëplota ose ura-ura, rrallë krëhërake-pendore të çara; kërcelloret rreth 1 x 0.2 cm, të pakta. Pështjella 5-15 mm në diametër; braktet rreth 5 mm, të mëndafshita, me buzë të gjëra. Lulet llapore 7-9 mm, vezake, të bardha. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entemofilia). Frytton VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Mal i Zi,	Rritet në substrat gëlqeror ose serpentinor, ose në vende dhe kullota të thata (Elyno-Seslerietea) duke filluar nga zona kodrinore deri në kullota të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Micromeria albanica, Campanula versicolor, Colutea arborescens, Hyssopus officinalis, Eryssimum sylvatica, Seseli rigidum, Anthyllis vulneraria, Rhamnus orbiculatus, Ficus carica, Pistacia terebinthus, Alyssum corymbosum, Jurinea mollis, Scabiosa fumaroides, Convolvulus cantabrica, Convolvulus althaeoides, Scabiosa crenata etj.	Gjatë vitit 2011-2013 Rexhepi,F. Pajazitaj,Q., Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. kanë hulumtuar popullacionet e këtij lloji në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit, Luboten, Koritnik, Brod, Oshlak, Rusenicë, dhe Novobërd (Rexhepi, F. 1975).	Popullacione/subpopullacione e këtij lloji janë mjaft të fragmentuara dhe kanë areal të kufizuar me përjashtim të subPopullacionit në NT – Gati i rrezikuar. Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit dhe subpopullacionit në Oshlak që janë afër njëri me tjetrin. Popullacionet në Koritnik, Luboten dhe Rusenicë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve. Popullacioni në Artanë (Novobërdë) ka përhapje të kufizuar dhe në krahësim me popullacionet tjera të Kosovës është popullacioni me shtrirje më të kufizuar dhe me numër me të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.

11	<i>Paramoltkia doerfleri</i> (Wettst.) Greuter & Burdet [Moltkia doerfleri Wettst.] Emri shqip: - [Moltke e Dërflerit] Familja: Boraginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 30-50 cm, të ngritur, të thjeshtë, të mbuluara me kreshtëza të rrasura; kërcëjtë dalin nga një rizomë simpodial horizontal të trashë. Gjethet heshtore të mprehta të mbuluara me kreshtëza të shpërndara të rrasura, si edhe me qerpikë; kupa rreth 10 mm, me vriguj rënës. Kurora 19-25 mm, e zgjeruar gradualisht në pjesën e sipërme, e purpurt e errët. Fijet 1.5-2 mm; pjalmoret 2.5-3 mm, me dy majucë, të përmbyllura brenda gypit. Akenet rreth 4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë dhe rizomë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Pjesa jugore e Ballkanit. Sipas Carni, A. et al. (2009) është e përhapur në pyjet termofile gjetherënëse të Evropës jugore (Quercion confertae dhe Carpinion orientalis).	Në Kosovë ky lloj rritet në kuadër të disa asociacioneve që i takojnë aleances Quercion frainetto. Në rajonin e Mirushës dhe në Bokat e Morinës është konstatuar edhe në kuadër të asociacionit Forsythio Quercetum petraeae si dhe Polygalo Forsythietum europaeae e shoqëruar nga llojet: Quercus frainetto, Quercus petraeae, Forsythia europaea, Polygala doerfleri, Gladiolus illyricus, Potentilla alba, Juniperus oxycedrys etj.	Boka të Bagevcit, Duhel, Blinaj, afër Kaçanikut, Guri i Zi, Novobërdë, Rajoni i Mirushës, Koznik, Bokat e Morinës. Blecic et al. (1968).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë, me përjashtim të Popullacionit të këtij lloji në Blinaj dhe rajonin e Mirushës që janë të pasura me individë maturë dhe të rinj. Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës numëron <100 individë maturë.	Gati i rrezikuar.
12	<i>Linum flavum</i> L. Emri shqip: Lin i verdhë Familja: Linaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me kërcëj të ngritur pak të degëzuar sipër, që dalin nga një rozetë e ngjeshur 20-60 cm dhe me pak ose pa rozeta jo lulembajtëse. Gjethet me 3 (-5) nervura, të poshtmet heshtore të përmbysta- pallake, 40-60×10-12 mm, të sipërmet heshtore, pabisht 20-40×7-11 mm, me 2 gjëndra në bazë. Lulesa e degëzuar, zakonisht me 25-40 lule. Sepalet 5-6 (-8) mm, heshtore, të thepëta me karenë e gjëndra në bazë. Petalet të verdha, 20-22×11-13 mm, me llapë vezake të përmbysta dhe me thonjëz relativisht të shkurtër. Kapsula 5-6 mm me sqep afër 1 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1992).	Juglindore-Pontike.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në substrate serpentinore në kuadër të rendit Halascietalia sendtneri. Në Bokat e Morinës, Koznik dhe Mirush ky lloj takohet në biotope të njëjta me llojet Linum tauricum e me rrallë me llojin Linum elegans. Lloje tjera bimore që e shoqërojnë këtë lloj janë edhe: Polygala doerfleri, Halascia sendtneri, Forsythia europaea, Fumana bonapartei, Gladiolus illyricus, Linaria dalmatica, Quercus pubescens, Fraxinus ornus etj.	Sipas literaturës ekzistuese (Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021) etj. është e përhapur në: Koznik, Mirushë, Brezovicë, Novobërdë, Gërmi, Oshlak. Gjatë vitit 2012-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Pashtrikun e Poshtëm, Bokat e Krevenikut, Bokat e Morinës, Gubavc dhe në Qafë Prush.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në Bokat e Morinës dhe në Koznik. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

07- Rajoni Zhvillimor Jugperëndim



Ky rajon ka potencial të zhvillimit socio-ekonomik të resurseve natyrore. Përbëhet nga katër (4) komuna: **Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik**. Rajoni Jugperëndim është rajon i pasur me përhapje dhe llojllojshmëri të florës. Bazuar në “Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës”, në këtë rajon gjenden rreth 87 lloje të përhapjes së florës si: bimë barishtore njëvjeçare, shumëvjeçare, bimë drurore-shkurre, bimë shumëvjeçare tufore, etj.

Në formë tabelare është paraqitur lista e aseteve të resurseve natyrore.

Figura 9. Centaurea alberti



Tabela 7. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) - Rajoni Zhvillimor Jugperëndim

PASQYRIMI I RESURSEVE NATYRORE SIPAS (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE							
I. Kategoria: Resurset Natyrore (Flora)							
RAJONI ZHVILLIMOR – JUGPERENDIM							
Nr.	Emërtimi i bimës	Përshkrimi botanik	Përhapja e përgjithshme	Lloji i habitatit	Përhapja në Kosovë	Trendi i popullatës	Kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1	<i>Aristolochia merxmuelleri</i> Greuter & E.Mayer Emri shqip: <i>Petriku i Merxmuellertit</i> Familja: Aristolochiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) me zhardhok të rumbullakët 1-2 cm në diametër. Kërçelli nëntokësor i hollë me luspa. Kërçelli mbi tokësor 5-15 cm i padegëzuar ose në bazë i degëzuar. E tërë bima e përhimët në të blertë, pjesa e poshtme e shogët pjesa e sipërme me qime të dobëta të kthyera teposhtë. Gjethet e mesme të kërçellit trekëndore me bazë si zemër të prerë. Lulet të vetmuara, me bishta shumë të shkurtër, në sqetullën e gjethit. Perianti 21-28 mm i gjatë, i errët në pjesën e poshtme. Gryka e periantit ngjyrë të verdhë në të blertë dhe përgjatë dejeve vjollcë e mbyllet. Lulëzon IV-V, frytëzon VI-VII. Riprodhohet me farë dhe qepujkë.	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri). Sipas Shuka et al. (2012) është e përhapur edhe në VL të Shqipërisë në rrethinën e Kukësit (Surroj).	Ky lloj rritet në substrat serpentiner, në kuadër të asociacionit Quercetum pubescentis cerris, Astero-Juniperetum oxycedri dhe Polygalo-Genistetum hassertianae e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Quercus cerris, Fraxinus ornus, Acer monspessulanum, Frangula alnus, Aster albanicus, Juniperus oxycedrus, Stachys scardica, Forsythia europaea, Comandra elegans, Anthemis montana, Minuartia verna, Genista hassertiana, Halacsya sendtneri, Sedum serpentinum, Malus florentina, Asyneuma limonifolium, Tulipa kosovarica, Veronica andrazovszkyi, Salvia ringens, Potentilla visianii, Paramoltkia doerfleri (Moltkia doerfleri), etj	Sipas Mayer E & Greuter W. (1985), Krasniqi, E. (2003), Rexhepi, F. & Krasniqi, E. (2004), Krasniqi, E. 2021 është e përhapur në rrethinën e Mirushës (Koznik në afërsi të fshatit Llapçevë), Malishevë.	Në Kosovë gjendet vetëm një popullacion i këtij lloji në rrethinën e Mirushës, Llapçevës dhe Koznikut që ka areal shumë të kufizuar. Afër fshatit Llapçevë është duke u zvogëluar habitat i këtij lloji si pasojë e shkatërrimit të pyllit nga fshataret, hedhja e mbeturinave dhe nga nxjerrja e mineraleve.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

2	<i>Cytisus purpureus</i> Scop. [<i>Chamaecytisus purpureus</i> (Scop.) Link.] Emri shqip: - [<i>Kamecetizë e purpurt</i>] Familja: Fabaceae	Gjysmëshkurre e shtrirë deri 30 cm (Kamefite Ch). Degët gati të shogëta, pa gjemba. Gjethet me bishtak; Braktet vezake të përmbysëta, me thimth, të shogëta, gati të rimta. Lulet me tufa me nga 2-3 bashkë, që formojnë vile me gjethe. Këmbëzat të shkurtra, me brakteza të vogla. Kupa gypore-kambanore, me qime leshtore të rralla e të hapura. Kurora lila-trëndafil deri e purpurtë. Flamuri 1525 mm, me një njollë të zezë në qendër; flatrat dhe karena më të shkurtra se flamuri. Bishtaja vizake, 15-25x 4-6 mm, e shogët. Farat të verdha të errëta. Lulëzon IV-VI. Frytton VI-VIII. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Evropë Jugore dhe juglindore (Alpe, Shqipëri Veriore, Slloveni, Kroaci, Kosovë) (Tutin, T. G. et al. 1968; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë rritet në çeltira të pyllit të Bungëbutës (<i>Quercetum pubescentis cerris</i>) dhe në kuadër të formacioneve me Boshtër (<i>Polygalo-Forsythietum europaeae</i>) në substrat serpentini. Shohërohet nga llojet: <i>Quercus pubescens</i>, <i>Quercus cerris</i>, <i>Fraxinus ornus</i>, <i>Frangula alnus</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Juniperus communis</i>, <i>Juniperus oxycedrus</i>, <i>Cotynus coggygia</i>, <i>Aster albanicus</i>, <i>Dictamnus albus</i>, <i>Potentilla astracanea</i> [P. hirta], <i>Iris graminea</i>, <i>Stachys scardica</i>, <i>Stachys recta</i>, <i>Filipendula hexapetala</i>, <i>Comandra elegans</i>, <i>Anthemis montana</i>, <i>Euphorbia glabriflora</i>, <i>Euphorbia barrelieri</i>, <i>Gadiolus illyricus</i>, <i>Echium rubrum</i>, <i>Linum tauricum</i>, <i>Minuartia verna</i>, <i>Genista hassertiana</i>, <i>Stipa</i> sp., <i>Halacsya sendtneri</i>, <i>Malus florentina</i>, <i>Sanguisorba minor</i>, <i>Primula acaulis</i>, <i>Erythronium dens-canis</i>, <i>Lotus corniculatus</i>, <i>Veronica andrasovszkyi</i>, <i>Paramoltkia doerfleri</i> (<i>Moltkia doerfleri</i>), etj.	Gjendet vetëm në Koznik (Llapçevë-Mrasor, Malishevë), (Blecic, V. et al. 1968, 1971; Josifovic, M. et al. 1972; Stevanovic, V. et al. 1999, Krasniqi, E 2021).	Popullacioni deri tani është i vetëm dhe ka përhapje të kufizuar vetëm në rrezat e Koznikut edhe pse haset në numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
3	<i>Lupinus micranthus</i> Guss. Emri shqip: <i>Lupini lulevogël</i> Familja: Fabaceae	Bimë barishtore njëvjëçare (Terofitë T), e gjatë 5-15 cm e kreshpet, me qime të argjendta, 2-3 mm të gjata - Gjethet janë me bisht 3-6 cm të gjata, me 7 gjethëza vizakepallake, 25-35×6-8 mm me thimth e qime të kreshpëta të rralla. Ndajgjethëzat janë vizake si fëndyell. Vilet janë në trajtë koke që në frytëzim zgjaten. Bishti lulor është deri 15 cm. Buza e sipërme e kupës është 5 mm dhe e ndarë dysh, kurse buza e poshtme është 10-12 mm, me 3 dhëmbë. Kurora është blu-manushaqe 10 mm. Bishtaja është 25-35×8 mm, leshtore e kuqe intensive. Farat janë 3-4, 5-8 mm të rrumbullakëta-katërkëndëshe, të shtypura. Riprodhohet me farë. Lulëzon IV-V. Frytton VI. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Vendet Mediterane (Kosovë, Shqipëri, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari).	Në Kosovë ky lloj rritet në vende të thata, në shkurre dhe pyje të zonës kodrinore (<i>Quercion frainetto</i>) e shohëruar nga llojet: <i>Juniperus oxycedrus</i>, <i>Carpinus orientalis</i>, <i>Centaurium erythraea</i>, <i>Hypericum perforatum</i>, <i>Poa bulbosa</i>, <i>Fraxinus ornus</i>, <i>Quercus pubescens</i>, <i>Quercus cerris</i>.	Millaku, F. me 27.05.2011 e konstatoi në zonën e Dushkajës në afërsi të fshatit Nepole, Gjakovë. Është lloj i ri për florën e Kosovës	Ky lloj në Kosovë formon një popullacion shumë te vogël (pak individë) dhe ka shpërndarje shumë të kufizuar. Disa individ të këtij lloji kanë arritur të përhapen edhe në disa lëndina që dikur janë punuar dhe mbjellë me kultura bujqësore.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

4	<i>Lysimachia atropurpurea</i> L. Emri shqip: <i>Lisimake e purpurtë e errët</i> Familja: Primulaceae	Bimë barishtore me pak push, me rizomë (Hemikriptofite H). Kërcejtë janë të ngritur, 2565 cm me pak degë në bazë. Gjethet janë 3.5-8 (-10)×0.5-1 (-1.5) cm, vizake, heshtore deri pallake, të këmbëra, të imta, të poshtmet me një bisht të shkurtër, të sipërmet pabisht. Lulesat janë në kallinj skajorë. Kupa është rreth 4 mm. Kurora është 6-7 mm e purpurt e errët me vriguj të zgjatur, pallake. Thëkët janë më të gjatë se kurora. Kapsula është 3-5 mm, shtyllëza është 3-5 mm e qëndrueshme. Riprodhohet me farë. Lulëzon VII. Frytmon VI-VIII.	Ballkan.	Ky lloj rritet në vende të thata mbi substrat serpentini në kuadër të asociacionit Potentillo-Fumanetum bonapartei, Rexhepi, F. (1979), Krasniqi, E. (2003, 2021). Shohërohet nga llojet: Potentilla arenaria, Dianthus sylvestris, Alyssum markgraffii, Bromus fibrosus, Plantago subulata, Poa badensis, Halascya sendtneri, Sedum serpentini etj.	Zatriq, Koznik. Rahovec	Ky lloj në Kosovë formon dy subpopulacione: në Zatriq dhe Koznik. Këto subpopulacione kanë areal shumë të kufizuar (dhjetëra hektarë) dhe numri i individëve maturë brenda këtyre subpopulacioneve është shumë i vogël.	I rezikuar në mënyrë kritike.
5	<i>Plantago dardanae</i> Rexhepi et Dim. Emri shqip: <i>Gjethedell i Dardanisë</i> Familja: Plantaginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), pa kërcell të zhvilluar normalisht. Gjethet janë të vendosura në bazën e kërcellit në rozetë. Shtija lulore është e gjatë 70 – 75 mm. Gjethet e ngushta lineare deri 24 mm të gjata dhe të gjëra deri në 0.8 mm. Braktet janë ngjyrë kafe të çeltë, 2.1 mm të gjata – nuk janë më të gjata se lulet dhe nuk i mbulojnë ato. Pjesët e përparme të kupës janë të lira më gjatë se gjysma e gjatësisë së tyre. Gypi i kurorës është i shogët. Lulëzon VII, frytëzon VIII. (R Rexhepi, F. & Dimitrov D. 2001).	Kosovë (Stendoendemike)	Rritet në substrat silikat në kullota të thata dhe vende gurishtore të zonës alpine, e shoqëruar nga llojet: Sempervivum macedonicum, Alchemilla alpina, Senecio carpatius, Hieracium wagneri, Vaccinium uliginosum etj	Sipas Rexhepi, F. (Leg. Rexhepi, F., Millaku, F. 14.07.1997) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë). Junik.	Ky lloj në Kosovë formon vetëm një populacion shumë të vogël në masivin e Gjeravicës (2500m). Populacioni i këtij lloji në këtë lokalitet ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë.	I rezikuar në mënyrë kritike.

6	Ranunculus degenii Kümmerle et Jav. Emri shqip: Zhabinë e Degenit Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rizomë zvarritëse. Kërçelli I shogët, me 1-3 lule. Gjethet e jashtme të bazës me buzë ura-ura, veshkore; të brendshmet të ndara deri në 2/3 e llapës. Kërçelloret gjithnjë të ndara thellë, me segmente të plota ngushtësisht heshlore të përmbysta. Nënpetlat leshtake. Shtirati lulor pushlor ose i shogët, jo i zgjatur në kohën e frytit. Akenët të shogët, paksa të shtypur, me Karenë me, me sqep të gremçuar. Lulëzon VII-VII, Frytton VII-VIII. Shumëzohet me rizomë dhe me farë. Paparisto, K. et al.(1988).	Shqipëri (Malet e Korabit), Kosovë (Alpet Shqiptare), Maqedoni (Melovski Lj. et al. 2012).	Ky lloj në Kosovë rritet pranë burimeve të zonës alpine ose në vende me lagështirë të zonës alpine. Habitati ku është gjetur ky lloj ka qenë i mbuluar me ujë të cekët dhe numri i llojeve shoqëruese ka qenë shumë i vogël. Në afërsi të këtij lloji ishin prezentë: Pinguicula sp., Gymnadenia frivaldii, Eriophorum angustifolium, Cardamine pratensis, Parnassia palustris dhe disa lloje nga gjinia Juncus sp. dhe Carex sp.	Nuk kemi gjetur shënime për përhapjen e këtij lloji në Kosovë. Millaku, F. me Foto: Fadil Millaku (2013).Bjeshka e Dobroshit (Rupë) Junik. 19.07.2013 këtë lloj e konstatoi në Bjeshkën e Dobroshit (Rup), në lartësi mbidetare 2252 m. Është lloj i ri për florën e Kosovës.	Popullacioni i këtij lloji në Alpet Shqiptare (Bjeshka e Dobroshit) ka areal shumë të kufizuar (< 500 m2), dhe numër shumë të vogël të individëve maturë (< 50).	I rrezikuar në mënyrë kritike.
7	Romulea bulbocodium (L.) Sebastiani & Mauri Emri shqip: Lulekabuni Familja: Iridaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare me bulb-zhardhok në trajtë dardhe (Gjeofite G), me luspa si kartë, kafe. Gjethet dalin para luleve; gjethet bazale 2.5-30 cm x 0.8-2 mm, të përkulura dhe të shtrira ose të drejta dhe të përjetëme me 4 hulliza. Gjethet kërçellore deri 5, të ngjashme me gjethet bazale, zakonisht më të shkurtra. Shtija me 1-6 lule. Bishtat e luleve gjysmë cilindrike. Braktet 1-2.1 cm, të purpurta, ose me pika të kuqërreme kafe dhe me buzë qelqore; braktezat sa braktetë, por me të gjëra , cipëthata ose me një karen të ngushtë të gjelbertë. Lulet me ngjyra të ndryshme; gypi dhe gryka zakonisht të verdha; segmentet të bardha deri vjollcë, të gjelbërreme ose me 1-5 vijza të errëta nga jashtë. Rrethlulja (1) 2-3.5 (-5.5) cm; gypi 3.5-8 mm. Fillet me qime leshtore përposhtë. Krezat zakonisht i kalojnë pjalmoret. Lulëzon III-IV. Frytëzon IV-V. Polenizimin e kryen me insekte. Riprodhohet me farë dhe bulb. Vangjeli, J. et al.	Spanjë, Portugali, Francë, Itali, Sicili, Sardenjë, Bregdeti i Adriatikut, Shqipëri,Kosovë, Maqedoni (Cami et al. 2010), Greqi, Mali Zi.	Ky lloj në Kosovë rritet në livadhet e egra të Babajve të Bokës (afër fshatit Nec) në lartësi mbidetare 358 m. Këto livadhe vërshohen nga uji në pranverën e hershme, mirëpo gjatë verës janë mjaft të thata. Në këtë lokalitet ky lloj është i përhapur në habitatin i cili në të kaluarën ka qenë i mbuluar me pyllin e bungut dhe qarrit (Quercion fraineto). Ky pyll nën ndikimin e faktorit antropogjen është shndërruar në livadh. Rritet e shoqëruar nga llojet: Ranunculus millefoliatus, Orchis morio, Sanguisorba minor, Potentilla hirta, Poa bulbosa, P. annua, Bellis perennis, Trifolium repens dhe Myosotis arvensis.	Sipas Stevanovic, V. et al. (1999) është e përhapur në Rrethinën e Ponohecit Nec (Gjakovë). Për ta gjetur këtë lloj ka ndihmuar shumë edhe Isa Elezaj i cili është i rajonit ku është gjetur ky lloj.	Ky lloj në Kosovë (Livadhet e Babajve të Bokës) formon një popullacion që ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtij Popullacioni është shumë i vogël.	I rrezikuar në mënyrë kritike.

8	<i>Tulipa kosovarica</i> Shuka, L., Tan, K.& Krasniqi, E. Emri shqip: <i>Tulipani</i> Kosovar Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G), 15-30 (40) cm mbi tokë. Bulbi (qepujka) 34 x 1.5 cm. Tunika ngjyrë kafe e shogët. Kërcelet i shogët, i drejtë, i pa degëzuar me 3-5 gjethe. Gjethet heshtore, të këmbëra 10-15 cm X 0.8-2cm me këllëf në bazë. Lulet e vetmuara, me periant ngjyrë të kuqe të përbërë nga 6 fletëza (Tepale). Bazat e fletëzave e bardhë pa njollë të zezë, nganjëherë ngjyrë gështenjë dhe e purpurtë, të jashtmet 3.5–5.0 × 1.5–2.3 cm, të brendshmet vezake me madhësi 3.0–4.7 × 1–2 cm, me majucë. Thëkë 6; filli rreth 1 cm (10-13 mm) i bardhë ndërsa antera gjithashtu rreth 1 cm (8-12 mm) e gjatë gështenjë e mbylltë. Gineceu tri pjesësh me gjatësi gati sa thëkët. Fruti kapsulë (3.0-3.5 x 1.5-2.2 cm). Farat 7-8x6 mm. Për herë të parë është gjetur në rajonin e Mirushës në terrene serpentine nga E. Krasniqi më 11.05.2002. Lulëzon V-VI. Frytmon VI-VIII (Shuka, L. et al. 2012).	Kosovë (Stenoendemike).	Ky lloj në Kosovë është i përhapur vetëm në substrat serpentinor në kuadër të pyllit të përzier të bungëbutës-Quercus pubescens dhe boshtres-Forsythia europaea (Quercetalia pubescentis) si dhe në kullota serpentine (Halacsyetalia sendtneri). Në Rajonin e Mirushës (400 m l. m. d.) gjendet në kuadër të pyllit të dushkut (Quercetum pubescentis cerris) në shoqëri me llojet: Quercus pubescens, Forsythia europaea, Juniperus oxycedrus, Aristolochia merxmuelleri, Potentilla astracana [P. hirta], Filipendula hexapetala, Euphorbia glabriflora, Genista hassertiana, Sanguisorba minor, Plantago subulata, Paramoltkia doerfleri (Moltkia doerfleri), etj. Në Guriq (660 m l. m. d.) dhe në Llapushnik (732 m l. m. d.) gjendet në kullosa serpentine (Halacsyetalia sendtneri) bashkë me llojet: Tulipa sylvestris, Sanguisorba minor, Plantago subulata etj.	Rajoni i Mirushës (Llapqevë - Mrasor), Guriq. (Shuka, L. et al. 2012, Krasniqi, E. 2021), Llapushnik (Mali Drenicë)- lokalitet i ri për Kosovë (E. Krasniqi 27.04.2013).	Ky lloj në Kosovë formon tri popullacione që kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë brenda këtyre popullacioneve. Sipërfaqja e përhapjes së këtij lloji në rajonin i Mirushës është <2700 m² kurse numri i individëve maturë është < 65. Sipërfaqja e përhapjes së këtij lloji në lokalitetin Guriq është <4000 m², kurse numri i individëve maturë është <30. Në lokalitetin Llapushnik janë konstatuar <20 individë maturë në kuadër të popullacionit.	I rrezikuar në mënyrë kritike.
9	<i>Alkanna scardica</i> Griseb. Emri shqip: <i>Alkënë e Sharrit</i> Familja: Boraginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), jo gjëndërore, kreshtake – e grathët me qime të shkurtra. Kërcejt 10-30 cm, të përprjetëm ose të ngritur. Gjethet bazale 4-5 x 0.8-1.2 cm, heshtore të përmbysëta; kërcelloret gjatore-heshtore. Braktetë afërsisht 2 herë me të gjata së kupa, heshtore. Kupa rreth 5 mm në frytëzim. Kurora blu e shogët ose leshtake nga ana e jashtme; gypi 2 herë me i gjatë se kupa; llapa me diametër 8-11 mm. Akenët me diametër rreth 2 mm, të rrjetëzuar, me kokrriza të imta. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi).	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat, në vende shkëmbore dhe me barë të zonave subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Lilium albanicum, Gentiana lutea, Veronica orsiniana, Vaccinium myrtillus, Anthemis montana, Silene roemerii, Geranium coeruleum, Potentilla montenegrina, Silene parnassica etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Kurvallë (Alpe Shqiptare). Millaku, F. me 18. 06. 2013 e konstatoi edhe në Dervish Kom në lartësi 2190 m. Në Malet e Sharrit është e përhapur në lokalitetin e quajtur Qafa e Hormoqit (afër Përroit të Durlit), Gjakovë.	Popullacioni i këtij lloji në Kurvallë dhe subpopullacioni në Dervish Kom shtrihen në lartësi mbidetare nga 1980 - 2300 m. Popullacionet i këtij lloji lokalitetin Qafa e Hormoqit dhe në Kurvallë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë. Subpopullacioni i këtij lloji në Dervish Kom ka areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është shumë i vogël.	I rrezikuar.

10	Artemisia umbelliformis subsp. eriantha (Ten.) Xirau & Branas [Artemisia petrosae] Emri shqip: Artemisia eriante Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Kamefite Ch), 8-25 cm e lartë e drejtë, pushbutë, e mëndafshhtë. Gjethet bazale dyfishpendore me vriguj vezak heshtorë, majëmprehtë. Kaptina gjysmërruzullore 5-7 mm në diametër, zakonisht në një vile të thjeshtë; të poshtmet me bishta të shkurtër kurse të sipërmet afërsisht pabisht. Braktet e pështjelles 3-5 mm, vezake deri heshtore përmbysset, shyte, cipëthata; të brendshmet ngjyrë kafe. Shtrati i kaptinës i shogët. Lule 25-30. Kurora me qime leshtore, e verdhëreme. Akenët leshtorë. Lulëzon VII-VIII, frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë.	Sipas Tutin et al. (1976) është e përhapur në: Ballkan, Karpate, Pirineje, Alpe, Apenine (Suballkanike-Submesdhetare)	Rritet në substrat silikat-kvarcit ose ndonjëherë edhe në substrate gëlqerore dhe vende gurishtore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Rhodiola rosea, Anthemis montona, Saxifraga scardica, Saxifraga tridactylites, S. aizoides, S. quadridentata, S. exarata, Silene pusilla, Asplenium viride, Gentianella bulgarica, Gnaphalium supinum, Scrophularia laciniata etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është prezent në shkëmbinj silikat të zonës subalpine dhe alpine të gjëra vicës. Sipas Saric et al. (1986) në Malet e Sharrit është konstatuar në: Luboten, Livadhishtë dhe Shtëpi e Malorëve.	Popullacioni i këtij lloji në Gjeravicë ka areal të kufizuar dhe numri i individëve në kuadër të këtij Popullacionit është i vogël. Edhe popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Luboten, Livadhishtë dhe Shtëpi e Malorëve) janë me areal shumë të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
11	Campanula albanica Witasek Emri shqip: Lulekambanë shqiptare Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), (6-) 8-15 (-24) cm, të përpjetëm deri ngritur, të shogët. Gjethet e bazës si zemër, të sharruara, që mungojnë gjatë kohës së lulëzimit, kërcelloret eliptike të ngushta deri vizake, pak a shumë buzë plota, kryesisht majëmprehta. Lulet të vetmuara, rrallë nga 2-3 së bashku. Vezorja me puprri, rrallë e lëmuar. Dhëmbët e kupës deri 12 mm, trekëndësh të ngushtë deri vizake. Kurora 14-18 (-22) mm, blu deri manushaqe. Kapsula (6-) 7-8 mm, si fugë, e varur. Lulëzon VI. Frytton VIII (Qosja. Xh. et al. 1996).	Gadishulli Ballkanik-pjesa Jugperëndimore (Tutin, T. G. et al. (1976).	Lulekambana shqiptare (Krasniqi, F. et al. 2003) në Kosovë rritet në shkëmbinj silikat (Crepidetalia dinaricae respektivisht Campanulion albanicae) ose në kullota të thata të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Silene pusilla, Polygonum alpinum, Senecio wagneri, Cryptogramma crispa, Cerastium alpinum, Helianthemum nummularium, Hieracium pilosella, Senecio doronicum subsp. glaberrimus, Geranium subcaulescens, Campanula alpina, Potentilla doerfleri, Armeria alpina, Sempervivum macedonicum, Juncus trifidus, Saxifraga tridactylites etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000, 1986, 1982), Diklic, N. & Nikolic, V. (1981) dhe Saric, M. et al. (1986) gjendet në Malet e Sharrit (Shtëpia e StojkutÇukat e Liqenit), Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Hajllë, Maja e Ropsit). Popullacione të vogla të këtij lloji gjatë viteve 2011-2013 u konstatuan edhe në Brezovicë, Qukat e Jazhincës, Vracë, Pashallarë dhe Koritnik (Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F., Krasniqi, E & Mala, Xh). Junik.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë. Zakonisht rriten në grupe të vogla, ndërsa për nga habitusi ngjajnë shumë me llojin C. scheuchzeri.	I rrezikuar.

12	<i>Daphne blagayana</i> Freyer Emri shqip: <i>Xerxele e Bllagajt</i> Familja: Thymelaeaceae	Gjysmëshkurre e përherë e blertë deri 30 cm (Kamefite Ch) me kërcëj të gjatë, të shtrirë, të degëzuar e të hapur, me gjethe vetëm në krye. Gjethet 3-6 cm, vezake të përmbysëta deri eliptike të zgjatura, shyte, të pabisht, të shogëta, lëkurore. Lulet të bardhakrem, 15-18 mm, të merme, të pabisht, në kaptinëza, 10-15 së bashku. Braktetë të zbehta e pushbuta përposhtë, rreth 10 mm. Hipanti 15-20 mm, i ngushtë, me pak qime të mëndafsha. Nënpetlat 6 mm, shyte, të shtrira. Frytet bërthokla të bardhëme. Lulëzon IV-VI. Frytton VIII (IX). (Qosja, Xh. et al. 1992).	Gadishulli Ballkanik, e përhapur në pjesët veriore të Sllovenisë dhe në Karpatet Jugore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1972; Polunin, O. 1997).	Në Kosovë ky lloj rritet në substrat serpentini, në pyje, kullota e shpate me bazë shkëmbore serpentine. Në Morinë (962 m l. m. d.) gjendet në vende shkurre me boshtrë (F. europaea) në substrat serpentini e shoqëruar na llojet: Forsythia europaea, Quercus petraea, Doronicum columnae, Erythronium dens-canis, Galium sylvaticum, Pulmonaria mollissima, Luzula sylvatica, Euphorbia amygdaloides, Primula veris etj. Në lokalitetin Kodra e Lartë (Kopaonik) (1530 m l. m. d.) gjendet në shpatije të zhveshura në substrat serpentini në kuadër të fitocenozës Daphno-Genistetum radiatae [Daphno-Cytisanthetum radiatae Foto: Elez Krasniqi (2011), Morinë serpentinitum. Në këto terrene gjendet në shoqëri me llojet: Genista radiata, Betula verrucosa, Rosa spinosissima, Dorycnium herbaceum, Polygala vulgaris, Polygala comosa, Dianthus cruentus, Euphorbia glabriflora, Echium rubrum, Ornithogalum umbellatum, Helianthemum nummularium, Scorsonera rosea etj.	Kopaonik (Kodra e lartë) (Rexhepi, F. 1994, 1985, 1986; Randjelovic, N. et al. 1979; MMPH 2008). Përpos vlerësimit të gjendjes në Kodrën e lartë (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi-14.06.2013), gjendja e Popullacionit të llojit u konstatua dhe u vlerësua në Morinë-lokaliteti "Lana e Madhe" më 19.04.2013 (F. Millaku dhe E. Krasniqi). Një popullacion i llojit gjendet edhe rrëzë Lubotenit-Vataj (18.03.2011, F. Rexhepi, F. Millaku, E. Krasniqi dhe Xh. Mala).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacionet në Kopaonik dhe Morinë janë më të pasura me individë maturë. Popullacioni në rrëzat e Lubotenit ka areal shumë të kufizuar dhe <100 individë maturë. Konsiderojmë se ky lloj mund të jetë i përhapur edhe në ndonjë lokalitet tjetër të ngushtë në Kosovë.	I rrezikuar.
13	<i>Genista hassertiana</i> (Bald.) Buchegger Emri shqip: <i>Gjineshtra e Hasertit</i> Familja: Fabaceae	Bimë gjysmëshkurre (Kamefite Ch), deri 40 cm e lartë e degëzuar dendur. Degët janë të shkurtra të mbuluara me qime të palosura. Braktet janë 1-2 mm të gjëra gati vizake. Lulesat janë në vile skajore, nga 2-4. Braktëzat janë 1 mm ose më të shkurtra. "Flamuri" është rreth 8 mm, nga poshtë i mbuluar me qime të dendura mëndafshi. Riprodhohet me farë, Lulëzon VI-VII. Frytton VIII. (Rexhepi, F. 2000).	Badlacci, ex Busheger (1912), në punimin e tyre e përmendin për Shqipërinë dhe Kosovën.	Ky lloj është i përhapur mbi substrat serpentini, në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore-malore, në kuadër të asociacionit Polygalo-Genistetum hassertianae Rritet në shoqërim nga llojet: Forsythia europaea, Polygala doerfleri, Aster albanicus, Echium rubrum, Tulipa sylvestris, Sedum serpentinum, Salvia ringens, Gladiolus illyricus, Fumana bonapartei, Plantago subulata, Stachys scardica, Potentilla astracanica, Quercus pubescens, Centaurea kosaninii.	Sipas Krasniqi, E. (2003), Rexhepi, F. (1979, 2000), është e përhapur në Luginën e Ibrit, Koznik, Mrasor dhe Llapçevë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në lokalitetet Koznik, dhe në Luginë të Ibrit.	I rrezikuar.

14	<i>Gentiana pneumonanthe</i> L. subsp. <i>nopcsae</i> (Jav.) T. Wraber Emri shqip: <i>Gencianë pneumonanta, Gencianë e Nopçes</i> Familja: <i>Gentianaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-65 cm, pa gjethe bazale, me rizomë të shkurtër. Gjethet lëkurore, pabisht (2.5-3.5X1-1.5 cm), vezake-heshtore maje mprehta, me vendosje të kundrejt dhe pak më të gjata se ndërnjat. Lulet në lulesa ose rrallë në sjetulla të brakteve, me këmbëza të shkurtër ose gati të pabisht; kupa me gyp deri 1 cm me dhëmbë gati heshtorë majëmprehtë ose të thepët 1/2 deri 2/3 më e shkurtë së kurora. Kurora kambanore blu-manushaqe e errët, me gyp konik dhe me vriguj të mprehtë. Theket të bashkuara, pushlore. Pistili nga dy thela. Fruti kapsulë. Farat jo të flatruara. Lulëzon VI-IX; polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. (1994).	Sipas Javorka et al. (1926) ky takson është i përhapur në Shqipëri. Sipas Vangjeli, etj.	Ky takson në Kosovë rritet në substrat serpentinor. Në lokalitetin Qafa e Morinës lajmërohet në substrate serpentinore në lartësi rreth 500-600 m, ku dominojnë llojet si: <i>Forsythia europaea</i>, <i>Acer tataricum</i> dhe <i>Sanguisorba albanica</i>. Në Gubavc (afër Pejës) rritet në vende me lagështirë në ekspozicion lindor nga 800-1053 m; në kuadër të pyllit të përzier të dushkut (<i>Quercus petraea</i>, <i>Q. Cerris</i>), lajthisë (<i>Coryllus avellana</i> dhe boshtrës (<i>Forsythia europaea</i>). al. (1995) është i përhapur në Rrethin i Tropojës. Në Kosovë është konstatuar në Boka të Morinës dhe Gubavc (Koprivnik). Endemike e Kosovës dhe Shqipërisë.	Sipas Wraber, T. (1990) është e përhapur në serpentine të rrethit të Qafës së Morinës (Përroi i Begut dhe Gropa e Zezë), sipas Amidjic, L. & Pankovic, B. (2003), është e përhapur në Alpet Shqiptare. Me 16.08.2013, Millaku, F., dhe Berisha, N. konstatuan një popullacion të vogël të këtij lloji në Gubavc. <i>Gentiana pneumonanthe</i> L. është konstatuar edhe në serpentine e Mushtishtit (Mala, XH., Millaku, F. 21.09. 2012) por në këtë lokalitet nuk ishte prezent <i>Gentiana pneumonanthe</i> L. subsp. <i>nopcsae</i> (Jav.) T. Wraber.	Në Kosovë janë konstatuar dy popullacione, në lokalitetet Bokat e Morinës dhe Gubavc. Këto popullacione kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë brenda popullacioneve.	I rrezikuar.
15	<i>Gladiolus illyricus</i> W.D.J. Koch Emri shqip: <i>Gladiolë e Ilirisë</i> Familja: <i>Iridaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) 25-50 cm. Këllëfet bazale të gjelbërt, ndonjëherë me nuanca të kuqe zakonisht gjatë nervurave. Gjethet 4-5 (-10-40) cm të gjata dhe 4-10 mm të gjëra. Kallinj të me 3-10 lule, nganjëherë të degëzuar pak a shumë. Rreth lulja është e kuqe deri e kuqërremte e purpurtë, segmentet 25-40×616 cm vezake përmbysët, rombikë ose heshtore përmbysët. Anteret më të shkurtra se fillet në lule me segmente vezake përmbysët, por të barabarta me ato në lulet me segmente rombikë ose heshtorë përmbysët. Kapsula vezake përmbysët ose eliptike, farat me flatra. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytmon VII. (Vangjeli, J. et al. 2000).	Evropë, Kaukaz.	Rritet në livadhe, kullota dhe vende me shkurre në kuader të asociacioneve: <i>Polygalo-Forythietum europaea</i> dhe <i>Astero-Juniperetum Oxycedri</i>. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: <i>Quercus pubescens</i>, <i>Acer monspessulanum</i>, <i>Fraxinus ornus</i>, <i>Anthemis montana</i>, <i>Tulipa sylvestris</i>, <i>Minuartia verna</i>, <i>Linum tauricum</i>, <i>Cotinus coggygria</i>, <i>Forsythia europaea</i> etj.	Sipas Josifovic, M., et al.(1976) ky lloj është i përhapur në Obrançë (Podujevë). Gjatë viteve 2011-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Llapçevë, Bokat e Morinës dhe Maja e Zezë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të Popullacionit në Bokat e Morinës që ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	I rrezikuar.

16	<i>Haplophyllum boissierianum</i> Vis. et Panc. Emri shqip: <i>Haplofil i Buasierit</i> Familja: Rutaceae	Bimë gjysmë shkurre (Kamefitë Ch). Kërcejtë janë me gjatësi 6-25 cm, me push të përdredhur, pak a shumë leshtore në pjesën e luleshës. Gjethet janë të thjeshta 1040×1.5-3 mm heshtore deri heshtore të përmbysta, të holluara poshtë me pak qime ose të shogëta. Lulesa është pak a shumë e dendur, sepalet janë vizake-heshtore. Kapsula është pushlore në faqen e brendshme afër majës me gjëndra të rralla pak a shumë zhardhokore poshtë, në çdo vrigull me nga një shtojcë konike me majë, që nganjëherë e ndarë në zhardhokë më të vegjël. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Vendet Ilire (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë)	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat serpentitor në vende të thata me barë dhe shkëmbore të zonës kodrinoro-malore. Në pjesën me të madhe të habitateve ku është takuar ky lloj rritet i shoqëruar nga llojet: Fraxinus ornus, Dorycnium pentaphyllum, Campanula lingulata, Alyssum markgrafi, Quercus petraea, Salvia ringens, Polygala doerfleri, Sanguisorba minor, Thalictrum minus, Sedum serpentini, Sedum telephium, Forsythia europaea etj.	Sipas Josifovic, M., et al. (1973) është e përhapur në Luginën e Ibrit, Rogozna, Gubave, Qafa e Prushit, Koznik. Gjatë viteve 2011-2013, Rexhepi, F. Pajazitaj, Q. Millaku, F. Krasniqi, E. dhe Mala, Xh. e konstatuan edhe në Bokat e Morinës (Ponoshec), Krevenik (Elez Han) Bokat e Baqevcit (Mushtisht), Gubave (Koprivnik).	Edhe pse ky lloj në Kosovë ka përhapje të gjërë dhe formon disa popullacione; këto popullacione kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël, me përjashtim të popullacioneve në Qafë Prush dhe Bokat e Morinës që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
17	<i>Huperzia selago</i> (L.) Bernh. ex Schrank & Mart. Emri shqip: <i>Huperzi selago</i> Familja: Lycopodiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-15 cm. Kërçelli pak a shumë i drejtë, i degëzuar me degë të njëjta të mbuluara me gjethe. Gjethet lineare të holla, të ashpër ose ndonjëherë edhe pak të dhëmbëzuara që krijojnë 8 reshta. Gjethet sporofile dhe gjethet sterile janë njësoj dhe nuk e formojnë kallirin sporofill. Sporangjet gjenden të vetmuara në sqetullën e sporofitit. Riprodhohet me spore dhe organe vegjetative. VIII. (Rexhepi, 1986).	Evropë, Azi, Amerikë, Zelanda e Re, Tasmani.	Rritet në vende shkëmbore të freskëta, pyje të halorëve dhe kullota të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Plantago gentianoides, Valeriana officinalis, Pinus peuce, Juniperus sibirica, Vaccinium myrtillus, Bruckenthalia spiculifolia, Empetrum nigrum, Abies alba, Senecio nemorensis, Veratrum album etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve (Brezovicë, Luboten, Livadhishtë, Piribreg, Përroi i Durlës, Bistër, Koqinak led, Liqenet e Jazhincës). Në kuadër të Alpeve Shqiptare është konstatuar në Gjeravicë (Millaku, F. 18.07.2013).	Edhe pse ky lloj ka një përhapje të gjërë në vende të ftohta dhe mesatarisht të ftohta të dy hemisferave përveç Afrikës, në Kosovë kjo bimë është pak e përhapur përkatësisht në Foto: Fadil Millaku (2012). Liqenët e Jazhincës lokalitetet e cekura, ka pak individë. Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë me areal të kufizuar dhe kanë numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.
18	<i>Knaulia macedonica</i> Griseb. Emri shqip: <i>Knaute e Maqedonisë</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore e çlirët, me rozetë gjethesh dhe kërcej lulore, zakonisht me stolone nëntokësore. Kërçelli është deri 70 cm i lartë, pak a shumë i kreshpat me pak qime. Gjethet janë të vendosura të kreshpëta, bazalet të gjelbra, të përmbysta që zakonisht thahen në kohën e lulëzimit, ndërsa gjethet kërcellore janë heshtore deri vezake të ngushta. Zakonisht lirake-pendore me 4-12 vriguj anësor dhe	Ballkan, Rumani, Turqi.	Rritet në livadhe kodrinore (Thymo- Knautietum macedonicae, Rexhepi, F. (1978), Hundozi, B. (1980), e shoqëruar nga llojet: Thymus tosevi, Primula columnae, Trifolium alperstre, Knautia arvensis, Polygalla comosa, Leucanthemum vulgare, Leontodon hispidus, Lotus corniculatus, Onobrychis arenaria, Filipendula vulgaris.	Sipas Saric et al. (1986), Hundozi, B. (1980), Rexhepi, F. (1978) është e përhapur në: Përlepnicë, Mirushë, Oshlak, Virovi, Liqenet e Jazhincës	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Popullacioni i këtij lloji në afërsi të Mirushës është afër zhdukjes si pasojë e ndërtimeve në habitatin e këtij lloji.	I rrezikuar.

		një vrigull skajor vezak e me buzë ura-ura si sharrë. Kapitinëzat janë me diametër 1.5-3 cm. Kupa është si gishtje me (6-) -8 (-10) halëza. Kurora është zakonisht e kuqe e errët, nganjëherë blu ose trëndafil. Lulëzon V-VII. Frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1996). Rexhepi, F. (1978).					
19	<i>Knautia midzorensis</i> Formánek Emri shqip: <i>Knautia e Mixhorensit</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Rrënja vertikale e fortë. Kërçelli i drejtë në pjesën e poshtme i mbuluar me qime të kthyer teposhtë, rrallë i shogët, në pjesën e sipërme me qime të gjata ose rrallë i shogët. Gjethet janë shumë a pak lëkurore eliptike-heshtore, të ngushta heshtore, të plota në majë janë të mprehta. Gjethet e poshtme janë me qime, më të gjera në mesin e tyre. Gjethet e sipërme janë të shogëta. Kërçelli është i mbuluar me qime dhe gjëndra. Lulesat janë të mëdha të gjëra 3-4 cm. Lulet të purpura, të verdha. (Rexhepi, 1986).	Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgari).	Rritet në livadhe, kullosa, shkurre, pyje të zonës subalpine dhe alpine (Seslerio-Pinetum heldreichii). Rritet në shoqëri me llojet: Fagus moesiaca, Abies alba, Ulmus montana, Sorbus aucuparia, Lonicera nigra, Betula pendula, Acer platanoides, Ribes alpinum, Rhamnus fallax.	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M., et al. (1973) është e përhapur në Malin Mokna, Bjeshkët e Lumëbardhit, Liqenak, Rrasë të Zogut, Zhleb. Në Malet e Sharrit gjendet në Oshlak dhe Malet e Mushtishtit (Pashallarë).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Mushtishtit (Pashallarë) dhe në Oshlak janë në gjendje të mirë, ndërsa popullacionet e këtij lloji në Malin Mokna dhe Alpet Shqiptare kanë një shtrirje më të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	I rrezikuar.
20	<i>Micromeria albanica</i> (K. Maly) Silic Emri shqip: Bishtmju shqiptar Familja: Lamiaceae	Barishtore shumëvjeçare (Kamefitë Ch), me rrënjë dhe pjesë të poshtme të kërçellit të drunjëzuar. Kërcej shumë dhe të degëzuar, 20-40 cm. E tërë bima e mbuluar me qime të bardha të hirta. Gjethet ovale, shyte, (10-21 x 5,5-12 mm), të ngushtuara në bisht të shkurtër 3-8 mm. Gjethet me 3 (4) nervura, në të dy anët mbuluar me qime të shpeshta dhe të shkurtra kurse në kundërfaqe qime gjëndërore shumë të imta. Lulet në lulesa terminale të degëzuara në pjesën e poshtme. Bishtat e luleve 2,5-4 mm. Braktet lineare, me majë. Kupa e përhitur, rreth 3 mm e gjatë me 5 dhëmbë dhe 13 nervura. Kurora 6-7 mm, me tub pak të lakuar, nga jashtë me qime ngjyrë të bardhë. Akenët me ngjyrë të murrme në të verdhë, në	Subendemike (Shqipëri, Kosovë).	Ky lloj rritet në substrate shkëmbore gëlqerore të nxehta. Në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit takohet edhe në mjedise ku është prezent fiku (Ficus carica). Rritet e shoqëruar nga llojet: Achillea ageratifolia, Amelanchier ovalis, Campanula versicolor, Carpinus orientalis, Colutea arborescens, Hieracium waldsteinii, Convolvulus cantabrica, Corydalis ochroleuca, Euphorbia myrsinites, Iris reichenbachii, Laser trilobum, Petrorhagia saxifraga, Pistacia terebinthus, Ruta graveolens, Salvia ringens, Scabiosa crenata, Scabiosa fumaroides, Teucrium montanum, Teucrium polium, Tremastelma palestinum etj.	Sipas Krasniqi, E. et al. (2011), Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Mala, Xh. me 15.08.2012 këtë lloj e konstatoi në shkëmbinj gëlqeror të Ura e fshejtë (Xërxë).	Sipas Krasniqi, E. et al. (2011), Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në grykën e Lumëbardhit të Prizrenit. Mala, Xh. me 15.08.2012 këtë lloj e konstatoi në shkëmbinj gëlqeror të Ura e fshejtë (Xërxë).	I rrezikuar.

		maje me qime (1-1.3 mm). Lulëzon VII-IX. Frytëzon IX-X. Riprodhohet me farë.					
21	<i>Minuartia baldaccii</i> (Hal.) Mattf., subsp. <i>baldacci</i> Emri shqip: <i>Minuarte e Baldoçit</i> Familja: <i>Caryophyllaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rizoma të trasha, të drunjëzuar, deri 20 cm, të mbushura me gjethe të dendura. Kërcejtë relativisht të shkurtër me ndëmyje shumë të ofruara; ata lulebartës 4-6 cm të gjatë, me push gjëndëror sipër. Gjethet 5-9 mm të gjata, të gjelbra, vizake të mprehta shpesh të njëanshme, me qerpikë të vegjël, të shogëta me një nervurë. Lulesa nga 1-6 lule. Sepalet 5-7 mm të gjata me tri nervura. Petalet vezake të pëmbystë; 16-20 mm të gjata. Kapsula sa nënpetlat. Lulëzon VI-VIII. Frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë dhe rizomë. Paparisto, K. et al. (1988).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Greqi).	Në Kosovë rritet në substrate shkëmbore serpentinore. Në Bokat e Morinës rritet në kuadër të asociacioneve: Polygalo Forsythietum europeae, Quercetum montanum, Fagetum montanum etj. Në pjesën e Pashtrikut të Poshtëm (Qafa e Murrizit, Guri i Kishës, të Stanet dhe mbi Karakollë) rritet në lëndina, buzë pyllit të dushkut (Quercutum nontanum), dhe pyllit të përzier, në 1122 m lartësi mbidetare e shoqëruar nga lloji Erica herbacea.	Me 24.05.2013 Millaku, F. këtë takson e konstatoi në Lokalitetin Bokat e Morinës dhe në lokalitetin Pashtriku i Poshtëm që janë lokalitete afër njëra tjetrës. Sipas Stevanovic, V. et al. (1993) bazuar në herbarin e BEOU (10.06. 1923), ky takson është i përhapur në brigjet e lumit Drini i Bardhë, afër fshatit Zerrë. Duke u bazuar në hulumtimin tonë dhe në argumentin se afër fshatit Zerrë nuk ka ndonjë urë me emrin “Svanski Most” konsiderojmë së materiali bimor i mbledhur nga autori i cekur me lartë është nga ndonjë lokalitet nga Shqipëria e Veriut. Nuk kemi arritur ta konstatojmë këtë takson në këtë lokalitet. Është takson i ri për florën e Kosovës.	Popullacioni i këtij taksoni në Bokat e Morinës shtrihet në substrate serpentinore nga 600-1000 m dhe ka areal të kufizuar. Popullacioni shtrihet afër kufirit me Shqipërinë dhe vazhdon deri të Pashtriku i Poshtem ku gjendet një subpopullacion me i vogël në Krahasin me Popullacionin në Bokat e Morinës. Popullacioni në Bokat e Morinës shtrihet kryesisht në serpentine, ndërsa subPopullacioni në Pashtrikun e Poshtëm haset edhe në vende ku ka përzierje shkëmbinjsh serpentin dhe gëlqeror.	I rrezikuar.
22	<i>Pinguicula crystallina</i> Sm. subsp. <i>hirtiflora</i> (Ten.) Strid. Emri shqip: <i>Pinguiculë lulekreshtë</i> Familja: <i>Lentibulariaceae</i>	Barishtore shumëvjeçare dimëruese (Hemikriptofite H), me rozetë me 6 gjethe. Gjethet 3-4 x 1-2 cm, eliptike-gjatore, deri vezake gjatore, të cinguar ose majëngrëna, pak veshulllore përsipër. Këmbëzat 1-3, hollake, 50-110 (140) mm. Kupa me një gyp kambanor (1.5 mm) dhe vrigujt pallakë (2.5 mm). Kurora 18-25 (30) mm, me vrigujt buzës së sipërme vezakë, të përmbyset; ato të buzës së poshtme kunjore. Shpori 6-10 (13)mm, si fëndyell, i verdhemë. Kapsula gati rruzullore. Lulëzon V-VII. Frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë.	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Greqi, Bosnjë dhe Hercegovinë), Itali, Azi e vogël.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me lagështirë, në afërsi të burimeve me ujë, kryesisht në substrat serpentinor e shoqëruar nga llojet: Parnasia palustris, Lythrum salicaria, Frangula alnus, Sanguisorba albanica, Butomus umbellatus, Acer tataricum, Carex sp., Tamarix sp., Mentha longifolia, M. pulegium etj.	Sipas Krasniqi, E. (2003, 2021), Blecic, V. et al. (1968) rritet në Rajonin i Mirushës (Koznik), sipas Wraber, T. (1990) rritet në substrate serpentine në Qafë Morinë Foto: Fadil Millaku (2013), Bokat e Morinës (Kroi i Gropës së Zezë dhe Përroi i Begut).	Popullacioni në rajonin e Mirushës (Koznik) shtrihet në afërsi të fshatit Llapçevë dhe ka areal shumë të kufizuar. Dy subpopullacione shumë të EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) - I rrezikuar. E vogla me <30 individë maturë hasen përgjatë përroit të Mirushës. Popullacioni në Qafë Morinë ka areal shumë të kufizuar dhe përbëhet nga tri subpopullacione që kanë areal shumë të kufizuar por janë të pasura me individë maturë.	I rrezikuar.

23	<i>Pulsatilla alpina</i> (L.) Delarbre Emri shqip: <i>Pulsatillë alpine</i> Familja: Ranunculaceae	Bimë barishtore (Hemikriptofite H), me një gjatësi mesatare prej 20 – 25cm. Kërcejtë janë të shogëdt dhe pjesërisht të vrazhdët. Gjethet e sipërme janë kërcellpushtuese, njësoj edhe gjethet bazale. Gjethet janë të ndara trishe në formë shpate. Lulesa është e bardhë, me një gjërësi prej 3 – 6 cm në diametër. Hauëpler, H. & Muer, T. (2007).	Evropë, Azi.	Në Alpet Shqiptare rritet në kullota, shkurre ose vende shkëmbore të zonës alpine (2000-2300 m). Është konstatuar e shoqëruar nga llojet: Anemone narcisiflora, Dianthus sylvestris, Scorsonera rosea, Lilium albanicum, Vaccinium uliginosum, Vaccinium myrtillus, Veratrum album, Hypericum alpigenum, Dianthus sylvestris, Empetrum nigrum, Juniperus sibirica, Viola actolica, Gentiana punctata etj.	Millaku, F. më 19.07. 2013 i shoqëruar nga Isa Elezaj këtë lloj e konstatoi në Alpet Shqiptare (Pllaçicë të Jumikut, Dervish Kom, Kurvallë dhe Gjeravicë).	Popullacioni i këtij lloji në Alpet Shqiptare është me areal të kufizuar, përbëhet nga katër subpopullacione (Dervish Kom, Kurvallë, Pllaçicë dhe Gjeravicë) që kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre subpopullacioneve është shumë i vogël. Individët brenda subpopullacioneve janë të rrallë dhe gati çdo herë takohen individë të vetmuar dhe në distancë nga njëri tjetri.	I rrezikuar.
24	<i>Rhodiola rosea</i> L. Emri shqip: <i>Rodiola trëndafillore</i> Familja: Crassulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare 15-20 cm me stolone deri 12 cm (Hemikriptofite H). Rozetat 6-12 cm në diametër. Gjethet e rozetës heshtore me majë të shkurtër 15-30 x 7-9 mm nga të dy anët me qime gjëndërore, mishtore, në buzë gjëndërore deri qerpikore, të blerta, të mbyllta, me majë të kuqe, në bazë pak a shumë të bardha. Kërcelet me qime të dendura gjëndërore. Gjethet e kërcellit lineare, me majë, mishtore, me qime gjëndërore, 20-35x5-8 mm. Lulesa me qime të dendura gjëndërore. Lulet gati pabisht, 13-14 pjesëshe, të purpurta. Kupa me qime gjëndërore 7-9 mm të gjata, fletëzat e saj lineare deri lineare-heshtore, gati të mprehta 4-5 mm të gjata. Fletëzat e kurores lineare 10-12 x 1mm, nga sipër të purpurta, buzëve të bardhëme, nga poshtë të blerta, në buzë dhe nga poshtë me qime gjëndërore. Thekët me gjatësi 6-7 mm, fillet me pak qime në bazë, anteret me ngjyrë të kuqe të çelët. Karpelet janë 6-7mm të gjata, të blerta. Shtyllëza është me ngjyrë të kuqe me gjatësi 3-3.5 mm. Lulëzon VI. Frynon VIII. (Rexhepi, F. 1986).	Evropë, Azi, Amerikë Veriore (Tutin, T. G. et al. 1964; Josifovic, M. et al. 1977, Polunin, O. 1997).	Rritet në substrat silikat-kvarcit ose ndonjëherë edhe në substrate gëlqerore dhe vende gurishtore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: Anthemis montana, Saxifraga scardica, S. tridactylites, S. aizoides, Silene quadridentata, Silene exarata, Silene pusilla, Asplenium viride, Gentianella bulgarica, Gnaphalium supinum, Scrophularia laciniata etj.	Malet e Sharrit (Prevallë-Bistra, Josifovic, M. et al. 1977, Rexhepi, F. 1986, 1994). Alpet Shqiptare (Gjeravicë dhe Kurvallë). Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) është e përhapur në Livadhishtë, Piribreg, Qukat e Liqenit (Jazhincës) dhe Bistër.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni në Gjeravicë është mjaft mirë i ruajtur dhe ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacionet i këtij lloji në Kurvallë dhe në Malet e Sharrit kanë areal të kufizuar dhe numër me të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

25	<i>Sanguisorba albanica</i> Andrasovzky et Jav. Emri shqip: <i>Sanguisorbë shqiptare</i> Familja: Rosaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët, me kërcë 20-100 cm, të ngritur, të degëzuar. Gjethet lëkurore, të shndritshme; ato bazalet dhe kërcellore të poshtme me 3-7 çifte gjethëzash; këto të fundit vezake ose gjatore-vezake, 3-7 cm, me bishtak, dhëmbë-dhëmbë, pak a shumë si zemër në bazë. Lulesat 2-8 cm, cilindrike, shpesh të ndërprera në bazë, të ngritura. Lulet dysekso. Sepalet të gjelbra, të ngritura-të hapura. Thëkë 4, më të gjatë se kupa, me antere të verdha. Shtyllëz 1, e thjeshtë. Hipianti frutor me 4 flatra të ngushta, i lëmuar ndërmjet flatrave. Karpele 2. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII. (Qosja, Xh. et al.1992).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë). Sipas Vangjeli, J. et al.(2000), është e përhapur në Tropojë dhe Dobrejë.	Në Kosovë është konstatuar në substrate serpentimore, në shkurreta e vende më lagështirë (Molinion coeruleae) nga 450-1181 m. Në Rajonin e Mirushës (Koznik) rritet në vende serpentimore me lagështirë, në të dy brigjet e lumit Mirusha e shoqëruar nga llojet: Tamarix tetandra, Parnassia palustris Pinguicula crystallina, subs. hirtiflora, Forsythia europaea, Acer tataricum, Aster albanicus etj. Në rajonin e Qafë Prushit dhe në Bokat e Morinës rritet në toka të thella me lagështirë mbi substrat serpentinar në zonën e dushkut (Quercion frainetto) dhe boshtres (PolygaloForsythietum europaea) deri në zonën e ahut përgjatë kufirit me Shqipërinë e shoqëruar nga llojet: Salvia ringens, Gentiana pneumonanthe subsp. nopsce, Potentilla erecta, Quercus petraea, Acer tataricum, Forsythia europae, Centaurea alberti, Veronica androzovsky, Polygala doerfleri, Betonica officinalis, Stachys scardica etj.	Sipas Stevanivic, V. et al. (1999), Wraber,T. (1990), Rexhepi,F. (1986), është e përhapur në rajonin e Gjakovës (Morinë, Qafa e Prushit). Sipas Blečić et al. (1968, Krasniqi, E. 2021) ky lloj është i përhapur edhe në Koznik.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Popullacioni në Koznik gjenden afër burimit dhe rrjedhës së lumit Mirusha dhe ka shumë pak individ maturë në kuadër të popullacionit. Në Rajonin e Gjakovës (Bokat e Morinës, Qafë Prush) ky lloj formon një popullacion mjaft stabil që shtrihet nga 543-1181 m, kryesisht përgjatë zonës kufitare me Shqipëri.	I rrezikuar.
26	<i>Saxifraga taygetea</i> Boiss.et Heldr. Emri shqip: <i>Iriqëz e Tajgetit</i> Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëp të shkurtër, pa filiza shterpë. Kërcelet rreth 20 cm, i ngritur, i degëzuar sipër, me qime gjëndërore. Gjethet e bazës 15-25 mm të gjëra , me 5-11 ura të gjëra ose vriguj, veshkore-rrrotullore, ose pesëkëndore, me bisht; kërcelloret të pakta. Lulesa vastakore. Sepalet të ngritura të hapura, të ndara deri në fund, jo të ngjitura me vezoren. Petalet rreth 8 mm, eliptike-heshtore, të bardha me pika të kuqe, tri herë sa kupa. Vezorja e lirë; kapsula vezake-gjatore, me shtyllëza divergjente. VI-VII. (Paparisto, K. et al. 1988	Pjesët jugore të Siujdhesës Ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Ky lloj në Kosovë është e përhapur në shkëmbinjtë silikat të freskët të zonave alpine në kuadër të vegetacionit të shkëmbinjve silikat e shoqëruar nga llojet: Gnaphalium sylvaticum, Ranunculus crenatus, Saxifraga carpatica, S. aizoides, S. sempervivum, Silene macrantha, Edraianthus graminifolius etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic et al. (1977) në Alpet Shqiptare është e përhapur në Gjeravicë, dhe Dervish Kom kurse në Malet e Sharrit mbi fshatin Brod.	EN - B1ab(i,ii,iii,iv) + 2ab(i,ii,iii,iv) – I rrezikuar. Popullacionin i këtij lloji në Alpet Shqiptare e përbëjnë dy subpopullacione të vogla Foto: Fadil Millaku (2013), Gjeravicë (Gjeravicë dhe Dervish Kom) të cilat kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni mbi fshatin Brod ka areal shumë të kufizuar dhe gjithashtu numër të vogël të individëve maturë.	I rrezikuar.

27	<i>Scutellaria orientalis</i> L. Emri shqip: <i>Skutelare e Lindjes</i> Familja: Lamiaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj të shtrirë, pushbutë me qime të shpërndara, 10-30 cm. gjethet (0.5-) 1-1.5 (-3) x 0.5-2 cm, vezake-gjatore deri gjërësisht vezake, thellësisht ura-ura, dhëmbë-dhëmbë deri pendore të prera, me vriguj vezakësheshtorë ose vizakë, të cunguar në bazë, pushlore përsipër, pushbutë-të hirta përposh, me bishtak; buzët zakonisht të shpërveshura. Lulesa e dendur, gjatore zakonisht katërkëndore. Braktetë 5-12 mm, zakonisht e kalojnë kupën, të vendosura si tjegulla, vezake ose pak a shumë heshtore, të plota, të mprehta, disi cipëthata, si pluhur ose të verdha, të gjelbërta, të shogëta deri pushlore. Kurora 15-30 (-35) mm, e verdhë, rrallë e trëndafilit; buza e poshtme shpesh e kuqërremtë. V-VII. Qosja, Xh. et al. (1996).	Siujdhesa Ballkanike.	Është e përhapur në vende të thata e shkëmbore zakonisht gëlqerore apo serpentine në kuadër të pyllit të degraduar të dushkut Quercetum pubescentis cerris dhe Quercetum trojanae dukagjini e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Quercus cerris, Acer monspessulanum, Fraxinus omus, Salvia ringens, Jurinea mollis, Onosma aucherianum, Anthericum liliago, Campanula lingulata, Sanguisorba minor, Silene vulgaris, Convolvulus cantabrica, Valerianella coronata, Potentilla astracanica, Hypericum barbatum etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Rexhepi, F. (1983, 1977) është e përhapur në Pashtrik, (Gorozhub, Vermicë) dhe Mirushë. Këtë lloj gjatë vitit 2013 e kemi konstatuar edhe në serpentine të Krevenikut (Elez Han).	Në Kosovë janë konstatuar tri popullacione te vogla të këtij lloji. Popullacionet e këtij lloji në Krevenik, Mirushë dhe Pashtrik kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël.	I rrezikuar.
28	<i>Sparganium natans</i> L. Emri shqip: <i>Spargane notuese</i> Familja: Typhaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare ujore (Hidrofite-Gjeofite G), me rizomë horizontale. Kërccoli deri 40 cm i gjatë, notuese rrallë e drejtë. Gjethet në të shumtën e rasteve notuese, të blerta të çelta formë shiriti, 2-5 mm të gjëra . Dorëza e butë, membranore që gradualisht kalon në llapë. Lulesa gati pabisht, e pa degëzuar me 1 (rrallë 2) kokëza mashkullore, 2-3 kokëza femërore. Thëkët relativisht të gjatë. Fryti vezako-elipsoid, shtyllëza e shkurtër. Vezorja vezake ose heshtore. Fryti kapsollë. Lulëzon VI-VIII, polenizohet me anë të erës. Frytton VIII.	Evropë, Siberi, Amerikë Veriore.	Në Kosovë ky lloj është konstatuar në vende me ujë të cekët (moçale, kënetë, liqenjë) të zonës alpine. Në këto habitate ky lloj dominon gati 100 %. Afër këtij lloji janë konstatuar llojet: Narthecium scardicum, Gymnadenia frivaldi, Barbarea balcana dhe Pinguicula sp.	Alpet Shqiptare: (Pllaçicë, Liqenet e Dobroshit, Gjeravicë dhe Bogiçë (Mali i Zi). (Lakusic, Pavlovic, 1974, Stevanovic, V. et al. 1999). Bjeshka e Tropojës (Millaku, F. 19.07.2013).	Popullacionet e këtij lloji në Gjeravicë, Pllaçicë dhe Bjeshkë të Dobroshit kanë areal shumë të kufizuar mirëpo në kuadër të këtyre popullacioneve ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Popullacioni në Bjeshkën e Dobroshit përbëhet nga 3 subpopullacione të cilat kanë areale shumë të kufizuara. Edhe subPopullacioni në Bjeshkën e Tropojës (Kosovë) ka areal shumë të kufizuar. Popullacioni në Gjeravicë është në gjendje të mirë dhe nuk është shumë I rrezikuar sepse ka ujë të mjaftueshëm për zhvillimin e ciklit jetësor të këtij lloji.	I rrezikuar.

29	<i>Galatella albanica</i> Degen [Aster albanicus (Degen) Degen] Emri shqip: - [Aster shqiptar] Familja: Compositae [Asteraceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-35 cm e lartë. Kërcelli i përpijetëm deri i ngritur, me qime të mërimangëta-tufore përposh. Gjethet heshtoret përmbysta deri pallake, gjëndërore, me qime të mërimangëta-leshstore. Kaptinëzat në vastak të çlirët ose të vetmuara, me bisht të gjatë. Braktetë e pësthtjellës në tri radhë, të jashtmet e të mesit vizake-heshtore, me majë të fëndyelltë, të brendshmet majëmprehta, me buzë të gjëra cipëthata. Lulet llapore 12-14, vjollcë. Qimet e xhufkës të pabarabarta. Lulëzon VII-IX, frytëzon IX-X. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike (Subendemike), Kosovë, Shqipëri. Sipas Tutin et al. (1976) është i përhapur në malet midis Shqipërisë dhe Kosovës.	Rritet në substrate serpentine dhe kullota të zonës malore në kuadër të asoc. AsteroJuniperetum oxycedrii e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Forsythia europaea, Aristolochia merxmulleri, Euphorbia glabriflora, Echium rubrum, Halacsya sendtneri, Genista hassertiana, Sedum serpentinum, Sedum hispanicum, Veronica andrazovszkyi, Gladiolus illyricus, Sanguisorba albanica, Linum tauricum, Potentilla astracantha [P. hirta].	Sipas Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021), Josifovic, M. et al. (1975), Blecic V., et al. (1969), Blecic et al. (1968), Krasniqi, E. & Millaku, F. (2004), Krasniqi, E. et al. (2012), Rexhepi, F. Foto: Fadil Millaku (2013), Mushtisht (2000) është e përhapur në serpentine të Kosovës (Rajoni i Mirushës, Mrasorit, Llapçevës, serpentinët e Mushtishtit (Bokat e Mushtishtit, Grejkocit dhe Korishit), Qafë Prush, Planik-Morinë. Sipas Rexhepit (2000) është e përhapur në Planik, Çeret, Luginë të Ibrit, Koprivë, Gllanasellë-Godanc, Kramavik, Koznik dhe Çeret.	Në Kosovë popullacionet e këtij lloji gjenden afër vendbanimeve dhe nën ndikimin e kullotjes intensive. Në lokalitet ku rritet ku lloji shpesh takohen deponi të mbeturinave dhe gurthyes të cilët dëmtojnë habitatet e këtij lloji.	I përkeqësuar
30	<i>Centaurea albertii</i> Rexhepi Emri shqip: Kokoçeli i Albertit Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), deri 150 cm e gjatë, me trënjë të fuqishme boshtore. Kërcelli i drejtë, cilindrik, me qime të pakta, pak i degëzuar vetëm në pjesën e sipërme. Çdo degë përfundon me kaptinë të rumbullakët-vezake, të gjatë 6-3 cm dhe të gjërë 1.8-2.6 cm. Gjethet e poshtme janë në rozetë 10-27 cm të gjata, dy herë të ndara, segmentet janë lineare dhe të gjëra 1.5-2.5 mm. Në fund të kërcellit mbesin pjesë të gjetheve të vjetra. Në pjesën e sipërme të kërcellit gjethet janë pabisht. Kaptinat janë të vetmuara (rallë 1-4) në bishta të gjatë. Invokrumi është i rumbullakët-vezak, 1.5-2.0 cm i gjatë dhe po aq i gjërë. Braktet e involukrumit janë të blerta verdhake, 7-10 mm të gjata, me pak qime, në buzë dhe	Kosovë, Stenoendemike (Rexhepi, F. 2000).	Rritet në vende të thata shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore deri në 1000 m lartësi mbidetare, vetëm në substrate serpentine (Halacsyetalia sendtneri). Shoqërohet nga llojet: Stachys scardica, Hypericum barbatum, Euphorbia glabriflora, Galium gerardii, Plantago subulata, Bromus fibrosus, Linum tauricum, Filipendula vulgaris, Brachypodium pinnatum, Stipa pennata, Potentilla visianii, Iris reichenbachii, Artemisia lobelii, Potentilla australis, Euphorbia barelieri, Polygala doerfleri, Plantago argentea, Podospermum laciniatum [Scorsonera laciniata] etj.	Devë, Golesh, Koznik (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Millaku, F. et al. 2008, Rexhepi, F. 1982, 1985, 1986, 2000, Saric, M. et al. 1986, Krasniqi, E. 2003, 2021, Krasniqi, F. 1998). Është konstatuar dhe vlerësuar gjendja e llojit edhe në Bokat e Morinës më 18.09.2012 (F. Rexhepi dhe E. Krasniqi). Konsiderojmë se ky lloj është i përhapur edhe në serpentinët e Shqipërisë (ndoshta e përshkruar si <i>Centaurea candalebrum</i> ?).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje më të mirë në Golesh, ndërsa përhapje të kufizuar dhe me numër të vogël të individëve maturë në veçanti popullacionet në Koznik dhe Devë-Morinë (Çafa e Morinës).	I përkeqësuar

		në maje të murme, me shtojcë trekëndore-heshtore ngjyrë të zezë, nga çdo anë me 10-15 qerpikë të murmë të mbuluar me qime të shkurtra. Shtojca (appendix) përfundon me një qerpik gjëmbor të gjatë deri 3 mm. Lulet janë të purpurta, ato skajore nuk janë radiale. Akeni është i mbuluar me qime, më i shkurtër se xhufka, i gjatë 2.5-4 mm. Xhufka e gjatë 5-6 mm, e bardhë. Lulëzon VI-VII. Frytmon VIII (Rexhepi, F. 1986, 2000).					
31	<i>Epimedium alpinum</i> L. Emri shqip: <i>Epimedë alpine</i> Familja: Berberidaceae	Bimë shumëvjeçare nga një gjethe të vetme dyfish-deri trefish, treshe; gjethëzat 5-10, vezake, si zemër, të mprehta, të qerpikëta, në fillim pushlore, me pas të shogëta. Lulet të vogla, në melth. Segmente të rrethlules 8; 4 të jashtmet nënpetëlnjëshme trëndafil-në ngjyrë hiri, rënëse; 4 të brendshmet petëlnjëshme, të kuqe të errëta, pa shkëlqim. Gjethe mjaltoze 4, të verdha, të çelëta dhe të shkëlqyeshme, në formë pantofle. Thëkë 4. Fryti me shumë fara, i thatë. Lulëzon IV-V, frytmon VI-VIII. Riprodhohet me farë dhe rizomë. Papparisto, K. et al. (1988).	Alpe të Evropës, Itali veriore dhe pjesërisht në Ballkan.	Në Kosovë rritet në substrat serpentinë nga 500 – 1181 m. Është konstatuar në kuadër të asociacionit Quercetum frainetto cerris ku dominon plotësisht në katin përdhes e shoqëruar nga llojet: Quercus frainetto, Q. cerris. Kurse në kuader të asociacionit Polygalo – Forsythietum euroaea është e shoqëruar nga llojet: Forsythia europaea, Quercetum montanum, Acer tataricum, Polygala doerfleri, Halacsia sendtneri, Daphne blagayana, Doronicum columnae, Pulmonaria mollissima, Agrimonia eupatoria, Primula veris, Potentilla alba, Minuartia baldacci subsp. baldacci dhe lloji Lilium albanicum që përherë të parë është konstatuar në këtë lokalitet në lartësi 630 m sëbashku me llojin Gladiolus illyricus.	Bokat e Morinës dhe një pjesë e vogël e Pashtrikut të Poshtëm janë lokalitete të vetmet të konstatuara të këtij lloji	Popullacioni e këtij lloji në Kosovë që shtrihet nga Bokat e Morinës deri të Pashtriku i Poshtëm ka areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të këtij popullacioni është i madh me përjashtim të zonave që janë shkatërruar nga zjarri.	I përkeqësuar
32	<i>Gentiana lutea</i> L. Emri shqip: <i>Sanëza</i> Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me rizomë shumë të shkurtër e cila degëzohet në 2-10 rrënjë të gjata dhe të trasha. Kërçelli është i thjesht 60-90 (100) cm i gjatë. Gjethet janë vezake të mëdha me nervura. Gjethet e poshtëme me bisht, të sipërmet pabisht. Lulet të vendosura në qerthuj. Kurora e verdhë, me të ndara shumë më të gjata se tubi. Riprodhohet me fare. Lulëzon VI-VIII. Frytmon VII-IX. (Rexhepi, F. 1986).	Evropa, Azia e Vogël.	Rritet në kulllosa, në qafa të maleve të zonave subalpine dhe alpine, në substrat gëlqeror, silikat dhe serpentinorë. Është konstatuar në kuadër të asociacioneve të ndryshme e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Onobrychis scardica, Achillea alexandriensis, Polygala major, Senecio wagneri, Pinus mugo, Valeriana officinalis, Veratrum album, Lilium albanicum etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012) gjendet në Pashtrik, sipas Millaku, F. (2005) gjendet në Alpet Shqiptare (Gjëravicë), Rexhepi, F. (1986) e përshkruan në Zhleb dhe Mokna. Gjatë viteve 2010-2013 këtë lloj e kemi konstatuar në shumë lokalitete në Alpet Shqiptare(Maja e Rusolisë, Bjeshka e Lumëbardhit, Liqenak, Bjeshkë të Strellcit, Pleçe,	Edhe pse ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione ; ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në kuadër të Maleve të Sharrit, popullacioni i këtij lloji në gjendje më të mirë ka qenë në Bjeshkët e Mushtishtit (Pashallarë). Edhe ky popullacion është dëmtuar si pasojë e zjarreve që kanë ndodhur në dhjetë vitet e fundit. Në kuadër të Alpeve Shqiptare popullacionet e këtij lloji në Majën e Vjellakut, Majën e Rusolisë dhe në Bjeshkën e	I përkeqësuar

					Bjeshkët e Istogut (mbi synë, Bjeshkë të Kalikanit), Lipë, Maja e Vjellakut, Llaz Belapaç, dhe në Malet e Sharrit (Brod, Vracë, Rudokë, Gjimbeg, Malet e Mushtishtit, Pashallarë, Balka e Madhe, Koritnik, Oshlak, Përroi i Durlit, Shtëpia e Malorëve etj.).	Lumbardhit janë më të mirat dhe në dhjetë vitet e fundit vërehet një ripërtëritje natyrore shumë e mirë e këtij lloji.	
33	<i>Gentianella bulgarica</i> (Vel.) Holab. Emri shqip: <i>Gencianëza bullgare</i> Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore dyvjeçare, e gjatë 1-7(-20) cm. Lulet me bisht të shkurtër. Kërcejtë të degëzuar me 4-8 ndëmyje. Gjethet kërcellore janë gjatore heshtore, gati shyte. Bishtat e luleve më të gjata se gypi i kupës, vrigujt e kupës gati të barabartë ndërmjet tyre, vizak të sheshtë ose pak të sipërveshur. Kurora është 12-20 mm, e bardhë ose manushaqe e zbehtë. Kapsula është me bisht. Qosja, Xh. et al. (1996)	Karpate (Rumani) dhe Ballkan (Kosovë, Shqipëri, Bullgari).	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me shkurre, kullosa dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Sempervivum macedonicum, Trifolium alpestre, Dianthus cruentus, Knautia dinarica, Salix retusa, Juncus trifidus, Hieracium pilosella, Trifolium alpestre.	Sipas Rexhepi, F. (2000), Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Bjeshkën e Lumëbardhit, Hajlë, Kurvallë, Majën e Kunorës, Rrasë te Zogut). Në Malet e Sharrit (Koritnik, Shutman, Vracë, Pashallarë). Millaku, F. me 16.08. 2013 këtë takson e konstatoi edhe në lokalitetin Maja e Çetajve (Koprivnik) në lartësi mbidetare 2470 m.	Edhe pse ky takson në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit ato kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Popullacioni i këtij lloji në Pashallarë (Ostrovicë) gjendet në substrat serpentini në lartësi 1832 m dhe në vitet e fundit është duke u zvogëluar numri i individëve maturë si pasojë e dëmtimit prej zjarreve.	I përkeqësuar
34	<i>Geranium sylvaticum</i> L., subsp. <i>coeruleatum</i> Schur. Emri shqip: Kamaroshe pylli Familja: Gerniaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), zakonisht gjëndërore-pushlore me rizomë të trashë tërthore. Kërcejtë zakonisht 20-60 cm të ngritur përpjetë me mbulesë qimesh të ndryshme. Gjethet me llapë të ndarë në më shumë se 90 % të rrezes; vrigujt thellësisht pendor të çarë ose pendor të prerë. Petlat 13-18 mm, manushaqe-blu të ndritshme. Lulëzon VI-VIII. Frytton VII-IX. Qosja, Xh. et al. (1992).	Ballkan, Rumani.	Në Kosovë ky takson rritet në çeltira pyjesh, kullota dhe shkurre të zonës subalpine dhe alpine. Zakonisht haset në substrate silikate rrallë në substrat karbonat në kuadër të pyllit të kërkles (Pinion mug) e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Vaccinium myrtillus, Senecio subalpinus, Senecio wagneri, Juniperus sibirica, Lilium albanicum, Gentiana punctata etj.	Sipas Josifovic et al. (1977) ky takson është i përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë). Ky lloj është konstatuar edhe në Pllaçicë të Junikut (Millaku, F. 19.07.2013).	Ky takson në Kosovë, në kuadër të Alpeve Shqiptare formon 3 subpopullacione (Gjeravicë, Kurvallë, Pllaçicë e Junikut.). Këto subpopullacione kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	I përkeqësuar

35	<i>Linum elegans</i> Spruner ex Boiss. Emri shqip: <i>Lini i hijshëm</i> Familja: Linaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) me kërcell të drunjëzuar dhe të degëzuar. Kërçelli është më i vogël se 15 cm me një rozetë gjithësh të dendura. Gjethet e poshtme janë vezake- të përmbysta deri pllakore me tri nervura. Braktet e kupës janë 7-8 (-10) mm, heshore të ngushta. Petalet janë 15-20 mm të gjëra vezake-të përmbysta, me një thua relativisht të shkurtër. Lulesa është me (1-) 3-7 lule. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton IX. (Rexhepi, F. 2000).	Ballkan, endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Bullgari, Kretë, Greqi,	Në Kosovë ky lloj rritet në toka të cekëta serpentinore të zonës kodrinoro-malore në kuadër të asociacioneve: Astero-Juniperetum oxycedri, Polygalo-Genistetum hassertianae dhe Polygalo-Forsythietum europaeae. Zakonisht haset e shoqëruar nga llojet: Euphorbia glabriflora, Dorycnium pentaphyllum, Halacsya sendtneri, Inula ensifolia, Stachys scardica, Galium gerardi, Genista hassertiana, Plantago argentea, Plantago subulata, Polygala doerfleri etj.	Sipas Rexhepi, F. (1992), Krasniqi, E. 2021 është e përhapur në Koznik, Kramavik, Ponoshec. Millaku, F. me 16.05.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Bokat e Morinës në zonën kufitare me Shqipërinë.	Popullacionet e këtij lloji në Koznik, Kramavik dhe Ponoshec kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i kufizuar. Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës ka areal me të gjërë në krahasim me popullacionet tjera në Kosovë dhe numër me të madh të individëve maturë.	I përkeqësuar
36	<i>Malus florentina</i> (Zucc.) C.K. Schneider [Syn.: Sorbus florentina Nym.] Emri shqip: <i>Mollë florentine</i> Familja: Rosaceae	Shkurre ose dru i vogël (Fanerofite P), deri 5 m. i lartë, me kurorë të rumbullakët dhe lëvore të plasarit. Degët e reja të kuqe në të kafet, me qime, pa gjemba. Gjethet vezake të gjëra , 3-6 x 2-4 cm, me majë të mprehtë, të cunguara ose si zemër në bazë, me push të bardhë në faqen e poshtme, me bishtak 1,5 – 2,5 cm, me buzë të vrigulluara ose dhëmbë-dhëmbë të parregullt, të ngjashme me gjethet e murrizit dhe të vodhëvices. Lulesa vastakore me 5-8 lule, me bishta me qime. Lulet me diametër 1,5 – 2 cm, të bardha. Shtrati i lules dhe sepalet me qime të dendura, të përhimë në të bardha; sepalet të gjata 3-4 mm, të rënshme. Shtyllëza 5, të bashkangjitura në bazë. Thëkë rreth 20, të gjatë po aq sa shtyllëzat. Fryti elipsoid i gjërë, rreth 1 cm i gjatë, i kuq të paktën në një anë, me qeliza gurore. Fara zakonisht 10, ngjyrë gështenje, 2 x 6 mm. Lulëzon: IV-V. Frytton: VIII-IX. (Qosja, Xh. et al. 1992).	Itali, Maqedoni, Greqi Veriore, Shqipëri, Kosovë (Paleoendemike e Ballkanit dhe Apenineve)	Rritet në pyje gjethegjera termofile dhe mezotermofile të dushkut (Quercetum farnetocerris scardicum Krasn.) si dhe në pyje të shkroçës së zezë (Carpinetum orientalis scardicum Krasn.) e shoqëruar nga llojet: Quercus farnetto, Q. cerris, Q. petraea, Sorbus domestica, S. torminalis, Fraxinus ornus, Colutea arborescens, Viburnum lantana, Cornus Foto: Elez Krasniqi (2011), Pashtrik mas, Comandra elegans, Paeonia decora, Lithospermum purpureocoeruleum, Physospermum aquilegifolium etj.	Sipas Pajazitaj Q. (2012), Krasniqi, F. (1972), Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021), Josifovic, M. et al. (1972), është e përhapur në: Gërmi, Gllarevë, Blinajë, Qyqavicë, Malin Drenicë, Carralevë, Malet e Suharekës (Bokat e Baçevcit, Bokat e Korishit), Radavc dhe Pashtrik	Popullacionet e këtij lloji në të gjitha lokalitetet e konstatuara kanë numër shumë të vogël të individëve maturë. Zakonisht në të gjitha lokalitetet takohen individë të vetmuar ose në numër shumë të vogël.	I përkeqësuar

37	<i>Onosma echinoides</i> L. subsp. javorkae (Sim.) Hayek Emri shqip: <i>Çikllë si ushqerëz</i> Familja: Boraginaceae	Gati gjysmëshkurre (Kamefite CH), 10-60 cm, me kërcëz të drunjëzuar, e të shumtë me pushpak dhe kreshtake –ylore. Gjethet e poshtme 1.5-10 cm, vizake, vizake-heshore ose pallake, me buzë zakonisht të spërveshura; faqja e sipërme e llapës me zhardhokë që bartin një kreshtë qendrore dhe (8) 10-20 (25) kreshta ylore 0.3-0.6 mm. Qimet e thjeshta ndërmjet zhardhokëve mungojnë. Lulet pabisht. Braktetë me të shkurtra ose gati sa kupa. Kupa 7-14 (15) mm në lulëzim, 8-15 (19) mm në frytëzim, me kreshta të thjeshta dhe me disa ylore me rreze të shkurtra. Kurora 16-23 mm, e verdhë e zbehtë, nga jashtë pak a shumë dendësisht leshtake. Merikarpet 2-3.5 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit.	Ky takson në Kosovë rritet në substrate serpentinore të thata kseroterme e shoqëruar nga llojet: <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Teucrium montanum</i> , <i>Aster albanicus</i> , <i>Thesium dolineri</i> , <i>Fumana bonapartei</i> , <i>Plantago subullata</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Alyssum markgrafi</i> , <i>Chrysopogon gryllus</i> , <i>Convolvulus cantabricus</i> etj.	Bokat e Baqevcit (Mushtisht, Rajoni i Mirushës dhe Koznikut (Krasniqi, E. 2003, 2021), Bokat e Krevenikut).	Popullacionet e këtij taksoni në Bokat Baqevcit, Rajoni i Mirushës, Koznikut, Bokat e Krevenikut kanë areal të kufizuar dhe pak individë maturë që zakonisht rriten në tufa, rrallë takohen individ të vetmuar. Popullacionet e këtij lloji në Kosovë gjenden afër vendeve rurale dhe janë nën ndikim të faktorit zooantropogjen.	I përkeqësuar
38	<i>Primula halleri</i> (Gmelin) Honck. Emri shqip: <i>Aguliqe e Hallerit</i> Familja: Primulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 12-18 cm e lartë, miellore. Gjethet 28 x 0.5-3 cm, gjatore-vezake të pëmbysëta deri heshore të pëmbysëta, përposh miellore, me dhëmbëz të imtë. Shtija 8-18 cm, me 2-12 lule. Braktetë 5-10 mm. Këmbëzat 5-10 mm. Kupa 8-12. Kurora me diametër 15-20 mm, ngjyrë jargavani, me gyp 20-30 mm, 2-3 më e gjatë se kupa. Kapsula cilindrike, aq sa ose më e gjatë se kupa. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë dhe në mënyrë vegetative. Qosja, Xh. et al. (1996).	Alpe, Karpate, Ballkan (Endemike Evropiano-juglindore, Kaukazike)	Në Kosovë rritet në substrat silikat, kullota ose vende shkëmbore të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Rhodiola rosea</i> , <i>Lilium albanicum</i> , <i>Potentilla montenegrina</i> , <i>Geranium coeruleum</i> , <i>Knautia dinarica</i> , <i>Gentiana lutea</i> , <i>Veronica orsiniana</i> , <i>Silene roemerii</i> etj.	Sipas Rexhepi, F. (2000) është e përhapur në Malet e Sharrit (Maja e Zezë, Restelicë, Vracë, Rajoni Brodit 2250 m). Me 21. 07. 2009 Millaku e konstatoi në Gjeravicë në shkëmbinj silikat ekspozicion Jugor, në 2370 m lartësi mbi detare. Me 17.07. dhe 18.07. 2013 Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj e konstatuan edhe në Kurvallë (ekspozicion Jugor) dhe Pllacicë të Junikut (Ekspozicion Verior) në 2150 m lartësi mbidetare. Millaku, F. me 13.08.2013 e konstatoi edhe në Marjash në zonën alpine në lartësi mbidetare 2157 m.	Subpopullacionet në Majën Zezë, Restelicë dhe Vracë, kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është shumë i vogël. Popullacioni në Alpet Shqiptare përbëhet nga dy subpopullacione që kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë është i vogël.	I përkeqësuar

39	<i>Tephroseria papposa</i> subsp. <i>wagneri</i> (Degen) B. Nord. [Senecio <i>wagneri</i> Deg.] Emri shqip: - [Pulith i Wagnerit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur, në fillim me qime të merimangëta leshtore, më vonë pothuaj të shogët. Gjethet nga sipër pak a shumë të lëmuara, me qime të merimangëta leshtore nga poshtë. Gjethet e bazës gjatore – eliptike, gradualisht të ngushtuara në bishtak, të dhëmbëzuara; gjethet e kërcellit gjatore-heshtore, të ngushtuara në bazë, pabishtak; gjethet e sipërme vizake. Kaptinat jo rrezore, 1.5 cm në diametër, në vastak të thjeshtë me 5-10 kaptinëza. Pështjella purpur-në të kafet. Lulet me ngjyrë intensive të verdhë. Lulet llapore mungojnë. Xhufka pakz më e gjatë se kurora. Akenët të shogët. Lulëzon IV-VIII, frytton VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000).	Siujdhesa Ballkanike (Kosovë, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari)- Endemike Ballkanike.	Në Kosovë rritet në substrat silikat me rrallë në substrat gëlqeror, në vende me barë dhe shkëmbore të zonave të larta subalpine dhe alpine ose në vende me bar dhe lëndina të pyllit të kërcelës (Pinus mugo) e shoqëruar nga llojet: Geranium sylvaticum, Jasione orbiculata, Geum montanum, Juniperus sibirica, Pedicularis verticillata, Armeria alpina, Sesleria nitida, Hypericum alpinum, Veronica bellidifolia, Dianthus cruentus, Onobrychis scardica, Polygonatum bistorta, Trifolium badium, Stachys alpina etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është e përhapur në Majën e Rusolisë, Kurvallë, Gjeravicë, Liçenak dhe Hajllë. Sipas Rexhepi, F. (2000), Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Vracë, Livadhishtë, Luboten, Oshlak, Koritnik).	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Popullacioni i këtij lloji në Gjeravicë është në gjendje të mirë dhe i pasur me individë maturë në krahasim me popullacionet e këtij lloji në lokalitetet tjera në Kosovë.	I përkeqësuar
40	<i>Soldanella pindicola</i> Hausskn. [Soldanella dimonie Vierh., Soldanella scardica Deg.] Emri shqip: - [Pratish i Dimonieit] Familja: Primulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-15 (-20) cm e lartë. Gjethet në rozetë bazale, me llapë 10-50(-60) mm, rrotullare si veshkë, përposh me ngjyrë blu të përhimët, me pluhurizë, e mbuluar dendësisht me gropëza gjëndërore. Shtija 3-9 cm, me 2-3 lule. Kurora e ndarë në më shumë se ½ e gjatësisë së saj, vjollcë; vrigujt e kurorës të ndarë në 3 vriguj më të vegjël, nga të cilët ai skajori deri 0.5 mm i gjatë. Dhëmbët e kapsulës të cunguar. V-VI. Qosja, Xh. et al. (1996).	Siujdhesa ballkanike (Endemike Ballkanike).	Në Kosovë rritet në substrat serpentine, silikat dhe karbonat. Në Pashallarë dhe në Gjeravicë rritet në kullota alpine ose në vende ku qëndron bora më gjatë. Rritet e shoqëruar nga llojet: Silene asterias, Geum coccineum, Pinus mugo, Dactylorhiza majalis, Cirsium appendiculata, Parnassia palustris etj.	Sipas Mala, Xh. (2010) është e përhapur në Majën e Pashallarëve (Ostroviçë). Sipas Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Gjeravicë. Sipas Stevanovic, V., Jankovic, M. (1984) është e përhapur në Oshlak dhe Virovi.	Popullacionet e këtij lloji në Gjeravicë dhe në Majën e Pashallarëve (Ostroviçë) kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve në këto dy popullacione është shumë i vogël. Në shumicën e rasteve takohen individë të rrallë.	I përkeqësuar

41	<i>Achillea clavenae</i> L., var. <i>argentea</i> Vis., [<i>Ptarmica clavenae</i> DC.] Emri shqip: <i>Barpezmi çomage e argjendte</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) pak a shumë pushbutë e mëndafshhtë. Kërcejtë deri 40 cm, të thjeshtë, të ngritur ose të përpjetëm. Gjethet pendore të çara, vriguj pak (2-4 në të dy anët), kryesisht të plotë, shytë; gjethet bazale deri 8 cm, me bishtak të gjatë, kërceloret rreth 2 x 1 cm, pabisht. Vastakët me 6-25 kaptinëza. Pështjella 4-8 mm në diametër; braktet 3-5 mm, vezake, shyte ose majëmprehta, me buzë të gjëra, kafe. Lulet llapore 4-6 mm, vezake, të bardha. Akenët 2 mm të përhimëta. Lulëzon VI-VII. Polenizimi kryhet me insekte (entomofilia). Frytton VII-IX. Riprodhohet me farë që përhapën me anë të erës. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike Alpino-Dinarike (Kosovë, Shqipëri, Greqi, Mali Zi, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Slloveni). Sipas Tutin et al. (1976) lloji është i përhapur edhe në Itali.	Rritet në substrat gëlqeror të zonës subalpine dhe alpine në kuadër të Rendit Amphoricarpetalia dhe Aleances Potentillion caulescens e shoqëruar nga llojet: Cerastium decalvans, Saxifraga scardica, Valeriana panicii, Valeriana montana, Armeria canescens, Geum bulgaricum, Achillea abrotanoides, Silene micrantha, Saxifraga aizoides, Edraianthus graminifolius, Ranunculus thora etj.	Sipas Millaku, F. (1999) ky takson është e përhapur në Alpe Shqiptare (Maja e Rusolisë, Liqenak, Rrasë e Zogut, Hajlë), në Bjeshkën e Lumëbardhit gjendet var. intercondens. Sipas Josifovic et. al. (1986, 1975) var. argentea është i përhapur në Liqenak dhe Malin Mokna, kurse var. intercondens në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Oshlak). Me 16.08.2013, Millaku, F. këtë takson e konstatoi edhe në Pleçe (2200 m) dhe në Majën e Çetës (Koprivnik, 2470 m)	Popullacionet e këtij taksoni në Kosovë kanë përhapje mjaft të gjërë në kuadër të Alpeve Shqiptare mirëpo taksoni A. clavenae, var. argentea ka areal më të kufizuar. Ky takson haset kryesisht në tufë rrallë si individë në të çara të shkëmbinjve së bashku me mjaft lloje të rralla dhe endemike. Në Malet e Sharrit subpopullacionet e taksonit Achillea clavenae, var. intercondens kanë areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël individëve maturë.	Gati i rrezikuar
42	<i>Armeria canescens</i> (Host) Boiss. Emri shqip: <i>Armerie e përhimtë</i> Familja: Plumbaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-60 cm e lartë, me kërcëp pak të degëzuar. Gjethet majëtopitura, dytrajtëshe; të jashtmet 2-3 (-6) mm të gjëra, vizakegatipallake të sheshta; të brendshmet 1-2 mm të gjëra, vizake ose vizake heshtore, të sheshta rrallë buzëkëthyer. Shtijet të ngritura ose të harkuara, me këllëf 7-30 mm të gjatë. Koka (lulesa) 15-25 cm e gjërë. Braktet e jashtme të pështjelljes më të shkurtra ose aq sa të brendshmet. Të brendshmet shyte ose me thimth me buzë cipëthata. Kallithet pabisht ose gati pabisht; braktet aq sa kupa (6-10 mm). Halëzat 1-2 mm. Kurora e trëndafilte deri e kuqërremtë e purpurt ose e bardhërreme. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë.	Evropë.	Rritet në substrat gëlqeror ose granit, kullota e livadhe të zonës subalpine e alpine e shoqëruar nga llojet: Stachys alpina, Botrychium lunaria, Nigritella nigra, Helianthemum alpestre, Hypericum alpinum, Juniperus sibirica, Antennaria dioica, Myosotis alpestris etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) në Alpe Shqiptare është konstatuar në Dervish Kom, Foto: Fadil Millaku (2012), Kurvallë Bogiçë, Liqenak, Rusoli, Gjeravicë, Bjeshka e Lumëbardhit. Sipas Josifovic et al. (1972) rritet në Dervish Kom, Bogiçë, Liqenak. Sipas Saric et al. (1986) në kuadër të Maleve të Sharrit rritet në Majën e Zezë, Guri i Pavllorit dhe Koçinak led. Millaku, F. me 17.07.2013 këtë lloj e konstatoi në Kurvallë.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Dervish Kom, Pllaçicë të Junikut, Bjeshkë të Dobroshit (Rupë), Bogiçë, Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit) dhe në Malet e Sharrit (Majën e Zezë, Guri i Pavllorit dhe Koçinak led) janë të vogla dhe me areal të kufizuar. Zakonisht rritet e vetmuar ose në tufa të vogla. Shpesh rritet në habitate të njëjta me llojin Armeria alpina.	Gati i rrezikuar.

43	<i>Barbarea balcana</i> Panc. Emri shqip: <i>Barbare e Ballkanit</i> Familja: Brassicaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët. Kërccoli deri 70 cm. Gjethet e poshtme lirake pendore të çara, me vrigullin skajor si zemër-vezak dhe me 0-2 palë vriguj anësor; të sipërmet pendore të çara. Lulet të verdha, në vile vastakore, pa brakte. Petalet 7-15-25 mm; këmbëzat të hapura, 6-8 mm; flegelat jo me nervurën e mesit të dallueshme; shtyllëza 2-4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemike e Ballkanit)	Rritet në vende me lagështi ose pranë burimeve dhe përrënje të zonës alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare. Zakonisht takohet e shoqëruar nga llojet: <i>Pinguicula</i> sp., <i>Gymnadenia frivaldii</i> , <i>Parnassia palustris</i> , <i>Caltha palustris</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Narthecium ossifragum</i> , <i>Cardamine pratensis</i> , <i>Saxifraga stellaris</i> , <i>Saxifraga rotundifolia</i> etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve tona ky lloj është e përhapur në Malet e Gjeravicë Sharrit (Luboten, Bistër, Guri i Zi, Brod, Shtëpia e Malorëve) dhe Alpet Shqiptare (Gryka e Lloqanit, Kurvallë, Pllaçicë e Vokshit, Pllaçicë e Junikut, Gjeravicë, Bjeshka e Dobroshit).	Shumica e popullacioneve/subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël me përjashtim të popullacionit në Gjeravicë dhe Pllaçicë që kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
44	<i>Crepis incarnata</i> (Wulf.) Tausch subsp. <i>dinarica</i> (Beck) Hayek [<i>Crepis froelichiana</i> subsp. <i>dinarica</i> (Beck) Gutermann, <i>Crepis rubra</i> L.] Emri shqip: Shmangë Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare 8-30 (-60) cm e gjatë. Rizoma e shtrirë, e shkurtër, cilindrike. Kërccoli i shogët ose me pak qime, i drejtë, pa gjethë ose rrallë me një gjethë heshtore deri ovale. Gjethet të blu-jeshile, pak të trasha, në të dy faqet me qime, formojnë rozetë, deri 8 cm të gjata, ovale-heshtore më të ngushta afër bazës. Kapinëzat 2-5 (subsp. <i>dinarica</i> 1-4). Invulokrumi cilindrik 12-15 mm i gjatë (subsp. <i>dinarica</i> 10-12 mm), braktet shumë të ngushta me vijë të bardhë, të jashtmet të holla pykore trekëndore përgjysmë më të shkurtra se të brendshmet. Lulet jargavan i zbehtë, të kuqe ose të bardha (nganjëherë të verdha), më të gjata se involokrumi. Papusi i bardhë. Akenët pak të ngushtë në majë me brinjë, 4-5 mm të gjatë të gjelbër-ulliri. Lulëzon V-. Fryton VI-VII (Josifovic, M. et al. 1975).	Alpe (ish-Jugosllavi), Vendet Ilire (Millaku, F. 1999; Josifovic, M. et al. 1975). Sipas Vladimirov, V. et al. (2006) është e përhapur në Alpet Shqiptare.	Në Kosovë ky takson rritet në livadhe-kulloza të freskëta në zonat e larta malore. Shoqërohet nga llojet: <i>Linum capitatum</i> , <i>Polygala major</i> , <i>Achillea linguata</i> , <i>Scabiosa columbaria</i> , <i>Silene roemerii</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Lotus corniculatus</i> etj.	Alpet Shqiptare (Zhleb, Bjeshkët e Lumëbardhit, Pllaçicë, Kurvallë, Maja e Liqenakut, Bjeshkët e Lloqanit, Maja e Rusolisë, Ishtedim, Koprivnik, Rrasë e Zogut) (Millaku, F. 1999; Rexhepi, F. 1997; Diklic, N. & Nikolic, V. 1961; Josifovic, M. et al. 1975, Silic, C.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij taksoni në Kosovë kanë përhapje vetëm në Alpet Shqiptare. Ky takson edhe pse në Alpet Shqiptare ka përhapje të gjërë; subpopullacionet kanë numër të vogël të individëve maturë. Zakonisht takohen pak individë të cilët mund të jenë në tufë ose të vetmuar.	Gati i rrezikuar.
45	<i>Erigeron epiroticus</i> (Vierh) Halacsy Emri shqip: <i>Erigeroni i Epirit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 3-8 cm, me kërcell të përjetshëm leshtor, pa gjëndra, i thjesht me një kapinë. Gjethet bazale janë 3-8×0.3-1.4 cm vizake deri pallake me bisht dhe pak a shumë majëmprehta. Gjethet në	Bimë endemike e Ballkanit.	Ky lloj në Kosovë rritet në kulloza të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Cerastium decalvans</i> , <i>Pimpinella saxifraga</i> , <i>Onobrychis scardica</i> , <i>Valeriana montana</i> , <i>Edraianthus graminifolius</i> , <i>Achillea abrotanoides</i> , <i>Valeriana tripteris</i> , <i>Erigeron uniflorus</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Gentiana nivalis</i> .	Sipas Millaku, F. (1999), Rexhepi, F. (1986), Josifovic, M. et al. (1975) është e përhapur në Koprivnik, Majë të Rusolisë, Marjash, Pllaçicë, Kurvallë, Gjeravicë.	Popullacioni i këtij lloji në Alpet Shqiptare përbëhet nga gjashtë subpopullacione të cilat kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.

		kërccell 1.22.5×0.3 cm, vizake, pabisht, majëmprehta. Kaptina është me diametër 1.5 mm me pësthtjellë kambanore 7×6 cm. Lulet janë tri trajtëshe ato llapore të purpura, 9 mm të gjata. Braktet e pësthtjellës janë shumë pushlore. Riprodhohet me fare. Lulëzon VI-VIII. Frytmon VII-VIII. (Rexhepi, 1986).					
46	Gentiana dinarica Beck Emri shqip: Gencianë dinarike Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 5-8 cm e gjatë. Gjethet janë të grupuara drejt bazës së kërcellit, shtija është e ngritur, me një lule të vetme skajore. Gjethet bazale në rozetë, dy të poshtmet eliptike ose vezake-eliptike 19-32×11-19 mm, me 3 nervura. Gjethet në bazë janë qelqore kërcelloret janë 10-13×7-8 mm, vezake të thepëta. Kupa është me gyp me kënde dhe dhëmbë të thimthuar. Kurora blu-manushaqe, pa njolla me grykë me gyp 30-40 mm e vriguj shytë të përkulur nga jashtë. Filli 1 cm i zgjeruar në bazë, pjalmoret janë 6 mm, të verdha. Kreza është 1.5-2 mm si elpazë. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytmon VII-VIII. (Rexhepi 1986, Qosja, Xh. et al. 1996).	Alpet, Dinariket, Karpatet Jugore, Kosovë, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në substrat gëlqeror dhe silikat, në kuadër të kullotave të thata të zonës alpine rrallë haset edhe në zonën subalpine të Alpeve Shqiptare dhe Malet e Sharrit. Rritet e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum, Gentiana verna, Gentiana utriculosa, Gentiana koschiana, Cerastium decalvans, Veratrum album, Armeria alpina, Onobrychis scardica, Dianthus sylvestris, Dianthus integer etj.	Në bazë të dhënave nga literatura dhe hulumtimeve tona në terren ky lloj është i përhapur në: Koritnik, Bjeshkët e Lumëbardhit, Greben, (Rexhepi, 1986), Gjeravicë, Pllaçicë e Junikut, Kurvallë, Dervish Kom, Bjeshkë e Dobroshit (Çuka e Gërrbave), Bjeshkë te Belegut, Marjash.	Popullacionet /subpopullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare janë me të ruajtura dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Koritnik popullacioni i këtij lloji ka areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacionit.	Gati i rrezikuar.

47	<i>Gnaphalium pichleri</i> Murb. [Omalotheca pichleri (Murb.) .] Emri shqip: - [Omalotekë e Piklerit] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 5-20 cm. Gjethet gjatore të pëmbysëta deri vizake-heshtore; gjethet kërcellore 40-100 x 2-4 mm, me një dell, që ngushtohen gradualisht në drejtim të majës. Lulesa shumë e çlirët dhe e ndërprerë. Kapitëza 4 mm, me të poshtmet me bisht me të gjatë se kapitëzat. Braktetë e pështjellës shytë; të jashtmet sa 1/3 e gjatësisë së pështjellës majëmprehta; të brendshmet me push të butë e të dendur nga ana kurrizore, si yll në kohën e pjekjes së fryteve. Lulet femër të pakta, hermafroditet 3-3.5 mm, të shumta, me vriguj të kurorës deri 0.5 mm. Akenet 1.5 mm, me qime të dendura dhe të rrasura, që shtrihen rreth majës dhe mbulojnë bazën e xhufkës. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Greqi).	Ky lloj në Kosovë rritet në shkëmbinj të zonës subalpine dhe alpine. Në Koprivnik ky lloj është konstatuar në substrat gëlqeror në vendin e quajtur shkëmbi i dallëndyshe në lartësi 2100 e shoqëruar nga llojet: <i>Cerastium decalvans</i>, <i>Silene macrantha</i>, <i>Saxifraga scardica</i>, <i>Saxifraga sempervivum</i>, <i>Potentilla apennina</i>, <i>Valeriana panicii</i>, <i>Edraianthus</i> Foto: Fadil Millaku (2012), Pllaçicë e Junikut graminifolius, <i>Achillea abrotanoides</i>, <i>Salix retusa</i> etj. Në Grykën e Milishevcit është konstatuar në shkëmbinj gëlqeror së bashku me llojet: <i>Ramonda serbica</i>, <i>Amphoricarpus neumayeri</i>, <i>Silene macrantha</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1975) në kuadër të Alpeve Shqiptare është prezent në: Kurvallë, Pllaçicë, Dervish Kom dhe Koprivnik. Millaku, F. & Krasniqi, E. me 09.08.2012 e konstatuan një popullacion të vogël të këtij lloji edhe në Grykën e Milishevcit.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda këtyre popullacioneve është i vogël. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile në shumicën e lokaliteteve.	Gati i rrezikuar.
48	<i>Gymnadenia frivaldii</i> Rchb. Emri shqip: Saleprremë i Frivaldit Familja: Orchidaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite H), me zhardhokë të ndarë thellë me vriguj të gjatë dhe rrënjë të holla. Kërcelli i gjatë deri 20 cm në bazë me gjete të ngjashme me këllëf. Gjete 3-4 gjatore-heshtore, të sipërmet si brakte. Lulesa e shkurtër, boshtore, e ngjeshur. Braktet janë heshtore me 1 nervurë të gjatë sa lulet. Lulet të vogla të bardha ose vjollce të zbehtë. Të gjitha gjethëzat e perigonit përveç buzës njëra kah tjetra të lakuara formojnë helmetën. Gjethëzat e jashtme të perigonit janë gjatore-vezake, të brendshmet janë gjatore, të gjata sa të jashtmet dhe pak më të ngushta. Buza është më e shkurtër se gjethëzat tjera të perigonit e plotë ose tre vrigullore, e lakuar teposhtë. Shpori penjzëzor, kah maja i mprehtë, i gjatë	Evropë, Grenlandë, Ballkan.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende me lagështirë të zonës subalpine dhe alpine ose me rrallë mund të takohet edhe në kullota ose shkurrë të zonës subalpine dhe alpine. Në Kosovë kryesisht rritet në kuadër të asociacionit <i>Pinguicula Narthecium scardici</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Pinguicula balcanica</i>, <i>Narthecium scardicum</i>, <i>Caltha palustris</i>, <i>Eriophorum angustifolia</i>, <i>Alchemilla hybrida</i>, <i>Veratrum album</i>, <i>Phyteuma pseudorbiculare</i>, <i>Orchis maculata</i>, <i>Trollius europaeus</i>, <i>Geum coccineum</i>, <i>Ranunculus plataniifolius</i> dhe lloje të ndryshme të gjinisë <i>Carex</i>, etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1976) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Liqenak, Ploçicë) dhe Malet e Sharrit Foto: Fadil Millaku (2012), Liqenet e Jazhincës (Prevallë, Piribreg, Konjushë, Livadhishtë). Millaku, F., Krasniqi, E. Malaj, Xh. me 11.07.2013 e konstatuan edhe mbi Shtëpinë e Malorëve (Brezovicë), dhe në lokalitetin Përroi i Durlit. Millaku, F. me 16.06. 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Malin Mokna në lartësi mbidetare 1445 m. Millaku, F.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve me përjashtim të popullacioneve në Gjeravicë dhe Bjeshkë të Dobroshit (Rupë). Këto dy popullacione të këtij lloji edhe pse kanë areal shumë të kufizuar; kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.

		sa 1/2 e pistilit. Riprodhohet me farë.			gjatë 17-20 korrik 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në: Kurvallë (1974 m lartësi mbidetare), Pllaçicë të Vokshit, Pllaçicë të Junikut (1831 m), Bjeshkë të Tropojës (Kosovë- 2259 m), Bjeshkë të Dobroshtit (2049 m) dhe në Qafë të Bogiqës (2002 m).		
49	Haplophyllum suaveolens (De Cand.) G. Don Emri shqip: Haplofil erëmirë Familja: Rutaceae	Shumëvjeçare (Kamefite Ch). Kërcejtë barishtor të drejtë ose gati të drejtë, të padegëzuar, me gjatësi 10-40 cm, të gjelbër ose gjelbër-kaltër, të mbuluar ose jo me qime kaçurrele. Gjethet e poshtme me bisht të shkurtër, tjerat të ulura, të shogëta, të mbuluara me qime të shkurtra, heshtore, të ngushta heshtore ose ovale eliptike, në majë kreshtake, me numër të madh të gjëndrave. Lulesa vastak. Bishtat e luleve me qime të shkurtra. Kupa pesë anëtarëshe. Setalet zakonisht ovale, të dhëmbëzuara ose jo, kreshtake në majë, të shogëta ose të mbuluara me qime, leshtore përgjatë buzëve, të gjata 2-2.5 mm, mbeten në bimë. Kurora qëndron gjatë e lulëzuar, e verdheme. Petalet 7-10 mm, ovale, në majë të rrumbullakëta, buzë të plota, të shogëta ose në anën e jashtme me vija (linja) të zeza dhe të mbuluara me qime dhe gjëndra. Thëkë 10, me filamente të lira. Fryti i ndarë në 5 pjesë, në secilën pjesë nga 4 fara. Lulëzon VII. Frynon VIII (Josifovic, M. et al. 1973).	Evropë Juglindore nga Maqedonia deri në Ukrainën lindore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1973).	Në Kosovë rritet në vende të thata me bazë shkëmbore serpentine por edhe Vojtesh gëlqerore. Gjendet në shoqëri me llojet: Convolvulus cantabricus, Sideritis montana, Potentilla tommasiniana, Orlaya grandiflora, Crupina vulgaris, Silene vulgaris, Sedum ochroleucum, Artemisia lobelii, Vincetoxicum huteri, Scleranthus perennis, Fumana bonapartei, Onosma aucherianum, Sedum acre, Sedum serpentinum, Sanguisorba minor, Ziziphora capitata, Orlaya grandiflora, Asyneuma limonifolium etj.	Për herë të parë prezencën e këtij lloji në Kosovë (Zatriq) shënohet si H. suaveolens f. ciliatum më 1990 (Krasniqi, F. et al. 1990). Gjendja e një Popullacioni është vlerësuar në lokalitetin Vojtesh (relacioni Braboniq-Skënderaj) më 25.06.2013 (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Gërmi dhe Gallushë (Suharekë).	Popullacionet e këtij lloji kanë përhapje të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në veçanti numri i individëve është shumë i vogël në lokalitetin Vojtesh. Për momentin subpopullacionet e tjera të këtij lloji janë stabile.	Gati i rrezikuar.

50	<i>Lamium garganicum</i> subsp. <i>striatum</i> (Sm.) Hayek Emri shqip: <i>Hithëbutë e bigezuar</i> Familja: Lamiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-60 cm. Gjethet 19-70×10-40 mm, si zemër-vezake me qime të dendura deri gati të shogëta, ura-ura deri ura-ura të sharrëzuara. Kupa është 7.5-18 mm, me gyp zakonisht gati sa dhëmbët. Kurora 25-40 mm me ngjyrë nga e trëndafiltë deri e purpurtë rrallë e bardhë. Gypi është 15-25 mm, i drejtë, shumë më i gjatë se kupa, buza e sipërme 10-15 mm e çarë dysh ose zakonisht me dhëmbë të cekët, vrigujt anësorë të shkurtër, trekëndorë. Buza e poshtme 10-15 mm zemër përmbysët. Anteret leshtake. Riprodhohet me farë. Lulëzon IV-VIII. Frynnon V-IX. (Qosja, Xh. et al. 1966).	Bimë Ballkanike-Mediterrane (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Bullgari)	Rritet në shkëmbinj, pyje të zonës malore (Fagetum montanum), pranë rrugëve malore e shoqëruar nga llojet : <i>Scrophularia bosniaca</i> , <i>Trifolium badium</i> , <i>Anthemis montana</i> , <i>Asplenium rutamuraria</i> , <i>Silene vulgaris</i> , <i>Ceterach officinarum</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , etj.	Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Oshlak, Rusenice, Vracë, Luboten, Kurvallë, Gryka e Deçanit, Koprivnik, Gryka e Sushicës.	Ky lloj në Kosovë formon popullacione në Malet e Sharrit dhe në Alpet Shqiptare. Këto popullacione kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve brenda këtyre popullacioneve është i konsiderueshëm me përjashtim të popullacionit në Vracë që ka numër të vogël të individëve maturë.	Gati i rrezikuar.
51	<i>Linaria genistifolia</i> subsp. <i>dalmatica</i> (L.) Maire & Petitm. Emri shqip: <i>Linarie gjethegjineshtre</i> Familja: Plantaginaceae [Scrophulariaceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 30-100 cm e shogët dhe e rimitë. Kërcejtë janë të ngritur, të shëndoshë, të degëzuar. Gjethet janë heshtore kryesisht më pak se 4 herë më të gjata se të gjëra, vizake deri vezake me bazë kërcell-pëstjtjellësh. Gjethet e mesit janë 25-35×7-25 mm, të sipërmet 25-30×5-6 mm, të gjitha me 3 (-5) nervure, majëmprehta, të këmbjera. Lulesa vile janë të zgjatura, bishtat e luleve 1-13 mm. Kupa (-2) 4-6 (-7) mm. Kurora është e verdhë 15-37 mm, ndërsa shpori 5-10 mm. Kapsula është 3-7 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-IX. Frynnon IX. Qosja, Xh. et al. (1966)	Evropë (Itali, Ballkan, Rumani, Azi e Vogël, Kaukaz).	Në Kosovë ky lloj është konstatuar në substrat gëlqeror, serpentin dhe silikat. Rritet në livadhe të thata, pranë rrugëve, kullosa dhe çeltira pyjesh. Në Pashtrik është konstatuar në kuadër të asociacioneve: <i>Ostryo-Carpinetum orientalis</i> , <i>Ostry Fagetum</i> dhe Foto: Fadil Millaku (2013), Pashtrik <i>Quercetum trojanae</i> dukagjini e shoqëruar nga llojet: <i>Silene vulgaris</i> , <i>Veronica jacquinii</i> , <i>Geranium sanguineum</i> , <i>Jurinea mollis</i> , <i>Isatis tinctoria</i> , <i>Verbascum lychnitis</i> , <i>Carduus candicans</i> , <i>Rosa spinosissima</i> , <i>Quercus trojana</i> , <i>Carpinus orientalis</i> , <i>Centaurea kotschyana</i> , <i>Eryngium palmatum</i> , <i>Serratula radiata</i> etj. Në Bokat e Morinës është konstatuar në kuadër të asociacionit <i>Quercetum pubescentis cerris</i> dhe <i>Polygalo Forsythietum europaea</i> .	Millaku, F., Mala, Xh., Rexhepi, F., Pajazitaj, Q. , Krasniqi, E. me 01.06.2011 e konstatuan në Pashtrik (mbi fshatin Plane dhe Gorozhup) në lartësi mbidetare 850-1300 m. Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj me 16.05 2013 e konstatoi edhe në Bokat e Morinës në lartësi mbidetare 630 m. Millaku, F. me 24.05.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrikun e Poshtëm në lartësi mbidetare 1065 m. Millaku, F. dhe Malaj, Xh. me 18.08.2013 këtë lloj e konstatuan edhe në afërsi të Dragashit (ruga Gragash-Restelicë) në lartësi mbidetare 1256 m. Me 01.09. 2013 Millaku, F dhe Mala, Xh. këtë	Popullacionet e këtij lloji në të gjitha lokalitetet e konstatuara në Kosovë kanë areal shumë të kufizuar dhe numër shumë të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	Gati i rrezikuar.

					lloj e konstatuan edhe në afërsi të fshatit Brod (Dragash), afër rrugës në lartësi mbidetare 1382 m. Ky lloj është i përhapur edhe në Malet e Mushtishtit (Mala, Xh. 2010).		
52	<i>Narthecium scardicum</i> Kosanin Emri shqip: <i>Nartecë e Sharrit</i> Familja: <i>Nartheciaceae</i>	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e lartë 9-27 cm, me rizomë. Gjethet distike, shpatëngjashme, me 4-10 deje, të sipërmet më të vogla se të poshtmet. Vilet të dendura, fundore, me 5-13 lule të vogla. Segmentet e rrethlules të verdhë, 4-5 mm, të lirë, të qëndrueshem yllorë gjatë lulëzimit dhe të ngritura gjatë frytëzimit. Këmbëzat 47 mm. Thëkët me pjalmore vizake, bazëngjitur, fillet leshtake. Vezorja ngushtohet në një shtyllëz të shkurtër e me një krezë të vogël trevrigujshe. Kapsula 8-10 mm, ovoide, me çahje lokulicide. Farat të shumta. Lulëzon V-VII. Frytton VII-VIII. Vangjeli, J. et al. (2000).	Endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mali Zi, dhe Maqedoni (Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996), Micevski & Matevski (1987).	Në Malet e Sharrit dhe Alpe Shqiptare rritet në vende me lagështirë, afër burimeve (vende moçalike) të zonës alpine në kuadër të asociacionit Pinguiculo <i>Narthecium scardici</i> dhe <i>Carici-Narthecium scardici</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Pinguicula balcanica</i>, <i>Pinguicula vulgaris</i>, <i>Barbarea balcana</i>, <i>Juncus trifidus</i>, <i>Cardamine pratensis</i>, <i>Carex caryophylla</i>, <i>Carex goodenowii</i>, <i>Alchemilla hybrida</i>, <i>Veratrum album</i> etj.	Sipas Millakut (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) në kuadër të Alpeve Shqiptare është prezent në: Kurvallë, Pllaçicë, Bogiçë, Maja e Rusolisë, Gjeravicë, Stanet e Erenikut, Qafa malore në mes të Ishtedimit dhe Hajlës, Kroj i Mbretit (B. e Belegut). Në Malet e Sharrit (Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Livadhishtë, Liqenet e Jazhincës). Me 16.07. 2011 Millaku, F., Krasniqi, E., Rexhepi, F. & Mala, Xh. e konstatuan në Luboten. Millaku, F. me 19.07.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në disa lokalitete të Alpeve Shqiptare (Bjeshka e Dobroshit- Rupë (2049 m) dhe Qafa e Bogiqës (2120m).	Në kuadër të Alpeve Shqiptare është konstatuar në 8 lokalitete. Popullacioni në Gjeravicë përbëhet nga 4 subpopullacione të cilat janë të pasura edhe me lloje tjera endemike. Popullacionet tjera në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit kanë areal shumë të kufizuar mirëpo janë të pasura me individë maturë.	Gati i rrezikuar.

53	<i>Paramoltkia doerfleri</i> (Wettst.) Greuter & Burdet [<i>Moltkia doerfleri</i> Wettst.] Emri shqip: - [<i>Moltke e Dërflerit</i>] Familja: Boraginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcëj 30-50 cm, të ngritur, të thjeshtë, të mbuluara me kreshtëza të rrasura; kërcëjtë dalin nga një rizomë simpodiale horizontale të trashë. Gjethet heshtore të mprehta të mbuluara me kreshtëza të shpërndara të rrasura, si edhe me qerpikë; kupa rreth 10 mm, me vriguj rënës. Kurora 19-25 mm, e zgjeruar gradualisht në pjesën e sipërme, e purpurt e errët. Fijet 1.5-2 mm; pjalmoret 2.5-3 mm, me dy majucë, të përmbyllura brenda gypit. Akenet rreth 4 mm. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë dhe rizomë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Pjesa jugore e Ballkanit. Sipas Carni, A. et al. (2009) është e përhapur në pyjet termofile gjetherënëse të Evropës jugore (Quercion confertae dhe Carpinion orientalis).	Në Kosovë ky lloj rritet në kuadër të disa asociacioneve që i takojnë aleances Quercion frainetto. Në rajonin e Mirushës dhe në Bokat e Morinës është konstatuar edhe në kuadër të asociacionit Forsythio Quercetum petraeae si dhe Polygalo Forsythietum europaeae e shoqëruar nga llojet: Quercus frainetto, Quercus petraeae, Forsythia europaea, Polygala doerfleri, Gladiolus illyricus, Potentilla alba, Juniperus oxycedrys etj.	Boka të Baqevcit, Duhel, Blinaj, afër Kaçanikut, Guri i Zi, Novobërdë, Rajoni i Mirushës, Koznik, Bokat e Morinës. Blečić et al. (1968).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë, me përjashtim të Popullacionit të këtij lloji në Blinaj dhe rajonin e Mirushës që janë të pasura me individë maturë dhe të rinj. Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës numëron <100 individë maturë.	Gati i rrezikuar.
54	<i>Pinguicula balcanica</i> Casper Emri shqip: <i>Pinguikulë e Ballkanit</i> Familja: Lentibulariaceae	Barishtore shumëvjeçare dimëruese (Hemikriptofite H), me sythe. Gjethet pranverore 20-30 x 15-20 mm, vezake të gjëra ; gjethet e verës 20-50 x 10-20 mm, eliptike-gjatore. Këmbëzat 1-5, gjëndërore, 4-8 (10) cm. Vrigujt e kupës vezakë të gjërë, sa të gjatë dhe të gjërë, rrallë me të gjatë se të gjërë, buza e poshtme e ndarë dysh deri 1/3 e gjatësisë së saj. Kurora 14-19 mm, blu lila, me njolla të bardha në bazë; vrigujt e buzës së poshtme vezake-gjatore. Shpori 3-4 (7) mm, cilindrik, i drejtë. Kapsula ovoide. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit.	Rritet në vende me lagështirë (afër burimeve) të zonave subalpine dhe alpine në kuadër të asociacionit Pinguiculo-Narthecietum scardici dhe Orphanideo-Cirsietum appendiculati shoqëruar nga llojet: Narthecium scardicum, Gymnadenia frivaldii, Parnassia palustris, Polygonatum bistorta, Alchemilla hybrida, Saxifraga rotundifolia, Barbarea balcana, Cardamina pratensis, Veratrum album dhe lloje nga gjinia Carex sp. dhe Juncus sp.	Sipas Millaku, F. (1999) në Alpe Shqiptare është e përhapur në Majën e Rusolisë, NT – Gati I rrezikuar. Koprivnik dhe Gjeravicë. Sipas Rexhepi, F. (2000) dhe Josifovic et al. (1977) është e përhapur në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare (nuk ceken lokalitetet). Gjatë vitit 2011-2012; Rexhepi, F., Pajazitaj, Q., Millaku, F., Mala, Xh. dhe Krasniqi, E. i hulumtuan popullacionet e këtij lloji në: Luboten (1894 m), Bistër (2186 m), Brezovicë (2010 m) Përroi i Durlit, Shtëpia e Malorëve, Piribreg, Liqenet e Jazhincës, Livadhnishtë.	Popullacionet në kuadër të Alpeve Shqiptare janë të vogla dhe me areal shumë të kufizuar por kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Edhe në Malet e Sharrit janë disa popullacione që kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Në shumicën e popullacioneve ky lloj rritet së bashku me llojin Narthecium scardicum dhe Gymnadenia frivaldi.	Gati i rrezikuar.

55	<i>Plantago reniformis</i> Beck. Emri shqip: Gjethedell si veshkë Familja: Plantaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me një rozetë gjethesh. Gjethet 5-17 (30) x 2.5 -10 cm, llapa vezake si zemër gati rrotullore dhe e cinguar në bazë ura -ura deri në dhëmb pak a shumë me qime të përdredhura, bishtaku 1/2 -2 herë me i gjatë së llapa. Shtijet i kalojnë gjethet përposh gati të shogëta, përsipër me qime të dendura të shtrira, kallinjtë 2-6 cm të dredhura. Braktetë 2-2.5 mm, vezake-heshtore zakonisht pushlore. Sepalet 2-2.5 mm gati të barabarta, pothuaj të lira gjelbëroshe, kafë ose të purpurtë. Gypi i kurorës 2 mm, i shogët, vrigujt 1-1.5 mm, vezak, majëmpeht ose shyt. Thëkët 4 mm dalin mbi kurorë. Kapsula 3 mm. Lulëzon V-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit (Ks, Al, B&H, Mz)	Rritet në kullota, vende me lagështirë dhe livadhe të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Trifolium repens, Lotus comiculotus, Alchemila hybrida, Pimpinella saxifraga, Onobrychis scardica, Pedicularis verticillata, Gentiana nivalis, Ranunculus montanus, R. oreophyllus, Geum montanum, Potentilla crantzii etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është prezent në Rrasë të Zogut dhe Liqenak. Sipas Josifovic et al. (1974), Lakusuc, R. (1970) është prezentë në Alpe Shqiptare (Liqenak, Hajlë dhe Koprivnik). Millaku, F. me 30.06.2012 e konstatoi edhe në Pleçe në lartësi 1884 m, me 18-19 07. 2013 në Gjeravicë (1870 m), dhe Pllaçicë të Junikut. Është e përhapur edhe në Luboten.	Popullacionet në Liqenak, Koprivnik, Gjeravicë, Pllaçicë e Junikut kanë areal shumë të kufizuar, dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është shumë i vogël.	Gati i rrezikuar.
56	<i>Potentilla visianii</i> Panc. Emri shqip: Potentillë e Visianit Familja: Rosaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcej lulorë deri 40 cm, pushlore me qime të gjata e të hapura dhe gjëndërore. Gjethet pendore me 11-17 gjethëza; gjethëzat pykore-vezake të përmbysta, 4-25 x 3.5-16 mm, me 2-7 dhëmbë. Lulet zakonisht të shumta, në cima të çlirëta skajore. Këmbëzat zakonisht 10 mm ose me shumë. Nënpetlat trekëndëshe-heshtore. Kupëza me vriguj. Lulëzon VII-VIII. Fytënon VIII-IX, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1994).	Endemike e Ballkanit (Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi)	Në Kosovë rritet mbi substrat serpentitor, rrallë gëlqeror (Pashtrik), në kuadër të asociacioneve: Quercetum pubescentis ceris, Hyperico-Euphorbietum glabriflorae, Polygalo-Forsythietum europaea, Astero-Juniperetum oxycedrii; e shoqëruar nga llojet: Quercus pubescens, Juniperus oxycedrus, Forsythia europaea, Halacsya sendtneri, Euphorbia glabriflora, Polygala doerfleri, Stachys scardica, Centaurea kosanini, Alyssum markgrafii, Prunus mahaleb, Thesium dollineri etj. Në Pashtrik rritet në shkëmbinj gëlqeror ose në kullota subalpine e shoqëruar nga llojet: Achillea holosericea, Isatis tinctoria, Dianthus cruentus, Dianthus sylvestris, Helianthemum canum, Medicago sp., Anthemis montana, Anthyllis aurea, Stachys alpina, Gentiana lutea, Globularia cardifolia, Aster alpinus etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2012), Krasniqi, E. (2003), Krasniqi, E. & Millaku, F. (2007), Rexhepi, F.(2000) është e përhapur në Pashtrik, Koprivnik, Rogozna, Lugina e Ibrit dhe rajon të Mirushës. Sipas Josifovic et al.(1972) gjendet në Koprivnik. Sipas Saric et al. Foto: Fadil Millaku (2013), Pashtrik (1986) në Kopaonik, Golesh, Pashtrik. Janë konstatuar edhe popullacione me areal të kufizuar (të vogla) edhe në Badovc, Gubavc, Bokac e Baqevcit, Korishit (Mushtisht) dhe Koznik (Llapçevë).	Të gjitha popullacionet në këtë lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël. Shumica e popullacioneve gjenden në substrate serpentimore ku verat janë të nxehta dhe të thata. Popullacioni në Koprivnik (Gubavc) ka areal shumë të kufizuar dhe numër të vogël të individëve. Popullacioni i këtij lloji në Pashtrik shtrihet mbi substrat karbonat dhe ka areal të kufizuar, është me stabil dhe më i pasuri me individë maturë në krahasim me lokalitetet tjera.	Gati i rrezikuar.

57	<i>Salvia ringens</i> Sibth. et Sm. Emri shqip: <i>Sherbelë</i> <i>kurorëhapur</i> Familja: Lamiaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 25-60 (-100) cm, e drunjëzuar në bazë. Kërcejtë të ngritur përpjetë, pak të degëzuar dhe zakonisht pa gjethë në pjesën e sipërme. Gjethet pendore të prera ose pendore me 3-6 çifte segmentesh anësore të vogla dhe me një segment skajor vezak ose eliptik, me bishtëz, të rrudhosura dhe të mbuluara me qime të rrasura. Qerthujt të rremë me nga 2-4 lule; cimat jo ose paksa me bisht. Kupa 10-17 mm, dendësisht gjëndërore-pushlore. Kurora deri 40 mm, manushaqe-blu ose blu. V-VII. Qosja, Xh. et al. (1996).	Siujdhesa Ballkanike, Azi e Vogël. Sipas Sekovski et al. (1999) është e përhapur në Maqedoni (Endemike Ballkanike).	Ky lloj në Kosovë rritet në vende të thata shkëmbore dhe shkurreta, në substrate karbonate dhe serpentinore. Është konstatuar në kuadër të asociacioneve: PolygaloForsythietum europaea dhe Polygalo-Genistetum hassertianae e shoqëruar nga llojet: Polygala doerfleri, Centaurea kosaninii, Fraxinus ornus, Quercus pubescens, Fumana bonapartei, Stachys scardica, Juniperus oxycedrus, Veronica andrazovszkyi, Aster albanicus, Scabiosa fumaroides, Euphorbia glabriflora, Forsythia europaea, Alyssum sp., Brachypodium pinnatum, Thalictrum minus, Genista hassertiana, Plantago argentea, Cotynus coggygria, Galium gerardi etj.	Koznik, Mirushë (Krasniqi, E. 2003, 2021), Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Bokat e Morinës.	Popullacioni në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit zënë një sipërfaqe mjaft të vogël dhe është i zhvilluar në brigjet e lumit kryesisht në ekspozicion jugor. Në rajonin e Mirushes dhe Koznikut gjenden dy subpopullacione të vogla të këtij lloji (Mirushë dhe Koznik). Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të Popullacionit.	Gati i rrezikuar.
58	<i>Saponaria sicula</i> Rafin. subsp. <i>intermedia</i> (Simmler) Chater. Emri shqip: <i>Sapunqyqe me spica</i> Familja: Caryophyllaceae	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H), e drunjëzuar në bazë. Kërcejtë 5-60 cm, të shogët poshtë. Gjethet 1-4 cm, ngushtësisht pallake deri vizake-heshtore të përmbysta, me 1 dell, zakonisht të ashpra anash. Lulesa zakonisht me degëza të këmbyera, leshtake. Kupa 20-30 mm, pushlore, jogjëndërore, me ngjyrë si të kuqërremtë, me dhëmbë trekëndësh të mprehtë ose të thepët. Llapa e petales 5-8 mm, e kuqe. Kapsula gjatore, më e shkurtër se kupa. VI-VII. Paparisto, K. et al. (1988).	Siujdhesa Ballkanike (Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Greqi), Apenine, Sicili.	Në Kosovë rritet në kullota të thata dhe shkurre mbi substrat serpentinor në kuadër të asociacionit: Astero-Juniperetum oxycedrii e shoqëruar nga llojet: Juniperus oxycedrus, Teucrium montanum, Aster albanicus, Thesium dolinieri, Fumana bonapartei, Genista hasertiana, Plantago subullata, Medicago prostrate, Alyssum sp., Chrysopogon gryllus, Convolvulus cantabricus etj.	Sipas Josifovic et al. (1977), Blečić et al. (1968), Rexhepi, F. (1992) është e përhapur në Brezovicë, Maja e Pishës, Pllanik (Ponoshëc). Gjatë viteve 2011-2012 kemi konstatuar edhe një popullacion në Bokat e Baçevcit (Mushtisht), rajonin e Mirushës dhe Bokat e Morinës.	Popullacioni i këtij taksoni në serpentinet e Mushtishtit (Bokat e Baçevcit) ka areal shumë të kufizuar por individët brenda popullacionit janë të zhvilluar dhe të përshtatur mirë kushteve të thatësisë që dominojnë në këto biotope. Popullacionet në rajonin e Mirushës, Bokat e Morinës dhe Brezovicës janë me areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i vogël.	Gati i rrezikuar.

59	<i>Saxifraga pedemontana</i> All. subsp. <i>cymosa</i> (Waldst.et Kit.) Engl. Emri shqip: <i>Iriqëz me anë</i> Familja: Saxifragaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore, me qime gjëndërore. Kërçelli i përpjetë ose i lakuar, 5-20 cm, zakonisht i pajisur me gjethe, me 3-10 lule. Gjethet e poshtme me bishtak, gjatore-pykore-trekëndore, të zgjeruara kah maja dhe me 3-5 segmente gishtore, me majë të rrumbullakuar, pak a shumë të prerë thellë, me dejë të dalur, në të dy faqet pak a shumë me gjëndra të dendura; gjethet e kërçellit më të vogla, me 3-7 segmente të prerë thellë. Lulet me bisht të gjatë pothuaj aq sa kupa; sepalet heshtore-vizake, me gjëndra, gati 2 herë më të gjata se tub i kupës; petalet të bardha, 10-15 mm të gjata, gjatore-vezake përmbysta, 2-3 herë më të gjata se dhëmbët e kupës. Kapsula toptshore; farat vezake, të zeza, 8 mm të gjata. VI-VII. Pajazitaj, Q. (2004).	Alpe Perëndimore, Karpate, Siudhesa Ballkanike.	Në Kosovë ky takson rritet në substrat shkëmbor silikat (në të çara të shkëmbinjve) të zonës alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Arabis alpina</i> , <i>Lamium garganicum</i> , <i>Geum reptans</i> , <i>Saxifraga stellaris</i> , <i>Alchemilla flabella</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Krivosej, Z., & Randjelkovic (1996), rritet në Alpet Shqiptare (Gjaravicë). Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Bistër, Maja e Zezë, Livadhishtë). Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. me 07.08.2011 këtë takson e konstatuan në Vracë në shkëmbinj të zonës alpine afër kufirit me Maqedoninë. Me 29.06.2013 Millaku, F. Krasniqi, E. & Mala, Xh. e konstatuan edhe në vendin e quajtur Përroi i Durlit në 2000 m lartësi mbi detare.	Popullacionet e këtij taksoni në Gjeravicë, Piribreg, Bistër, Maja e Zezë, Livadhishtë, Përroi i Durlit dhe Vracë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve.	Gati i rrezikuar.
60	<i>Sedum serpentinum</i> Janch. Emri shqip: <i>Rrushqyqe serpentine</i> Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore hollake, e shogët, me kërcej shterpë. Kërçelli lulor 8-12 cm. gjethet gjatore-cilindrike, 2-4 mm, shyta. Lulesa vastakore. Sepalet vezake-heshtore, pak shyta deri gati të mprehta. Petalet 3.5-4 mm, të mprehta, ngjyrë purpur. Thëkë 10. Rrëshikthet të ngritura, të trëndafilta. V-VIII. (Paparisto et al. 1988).	Shqipëri, Kosovë, Greqi, Maqedoni, Serbi (Endemike-Ballkanike).	Ky lloj është i përhapur në substrat serpentinor nga zona kodrinore deri të zona alpine (Maja e Pashallarëve). Zakonisht rritet e shoqëruar nga llojet: <i>Centaurea kosaninii</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Halacsya sendtneri</i> , <i>Alyssum</i> sp., <i>Stachys scardica</i> , <i>Campanula lingulata</i> , <i>Stipa</i> sp., <i>Haplophyllum boesierianum</i> , <i>Thesium dolineri</i> , <i>Scorsonera austriaca</i> , <i>Vincetoxicum</i> sp., <i>Astragalus onobrychis</i> , <i>Potentilla visiani</i> . Në Pashallarë rritet së bashku me llojin endemik <i>Bommuellera dieckii</i> .	Brezovicë, Ostrovicë, Pllanik, Bokati e Morinës, Llapçevë, Mrasor, Koznik (Krasniqi, E. 2003, 2021), Gubavc (Koprivnik), Lugina e Ibrit.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura në shumicën masiveve malor me natyrë serpentine. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i vogël.	Gati i rrezikuar.

61	<i>Sempervivum kosaninii</i> Praeger Emri shqip: <i>Burgull i Koshaninit</i> Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 15-20 cm, me stolone deri 12 cm të gjata. Rozeta me diametër 6-8 cm. Gjethet e rozetës heshtorepërmbysët, me majucë, 15-30 x 7-9 mm, në të dy faqet me qime gjëndërore, shumë të trasha, në buzë me qepalla gjëndërore, të gjelbra-errët, me majë të kuqe, në bazë të bardhërreme. Kërçelli lulor i fuqishëm, me qime të dendura gjëndërore. Gjethet e kërçellit vizake, me majë, mishake, me qime gjëndërore, 20-35 x 5-8 mm. Lulesa e dendur, me qime gjëndërore. Lulet gati pabishtak, 13-14 anëtarësh, purpur. Kupa me qime gjëndërore, 7-9 mm, segmentet heshtore-vizake, gati të mprehë, 4-5 mm. Petalet vizake, 10-12 x 1 mm, nga sipër purpur, buzët të bardhërreme, poshtë të gjelbra, në buzë dhe faqen e poshtme me qime gjëndërore. Thekët 6-7 mm, fillet në bazë pakz të zgjeruar, anterët të kuqe-të hapët. Karpelet 6-7 mm, shtyllëza e kuqërreme, 3-3.5 mm.VI-VII.	Kosovë, Maqedoni (Endemike), Micevski & Matevski (1987). Foto: Fadil Millaku (2013), Dervish Kom	gëlqerorë dhe silikate të zonave të larta subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum, V. myrtillus, Luzula sylvatica, Sedum sp. etj.	Sipas Millaku, F. (2005), Krasniqi, F. (1987), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Bogiçë, Pllaçicë, Gjeravicë, Dervish Kom, Zhleb, Koprivnik, Rusoli, Liqenak, Lumbardhë. Është konstatuar edhe në mes Lubotenit dhe Livadhishës.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare janë të vogla dhe kanë areal të kufizuar. Numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është shumë i vogël. Në rajonin e Gjeravicës gjenden tri subpopullacione (Gjeravicë, Pllaçicë dhe Dervish Kom). Popullacioni në Bogiçë ka areal shumë të kufizuar. Në kaudër të popullacioneve të këtij lloji në Alpet Shqiptare janë takuar edhe forma hibride.	Gati i rrezikuar.
62	<i>Veronica barrelieri</i> Roem. & Schult. [<i>Veronica andrasovszkyi</i> Jav., <i>Veronica spicata</i> L. subsp. <i>barrelieri</i> (Schott ex Roemer & Schultes) Murb.] Emri shqip: <i>Veronikë e Andrazovskit</i>, <i>Veronikë si kalli</i> Familja: Plantaginaceae [Scrophulariaceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare, e shogët, e blertë (Hemikriptofite H). Gjethet të trasha, të poshtmet me bishta, ovale ose gjatore-ovale, buzëve me dhëmbë shytë, të sipërmet me dhëmbë shytë. Lulet të grupuara nga 3-5 në lulesë vastak. Kupa e shogët ose me pak qime, zgjatimet e kupës ovale-gjatore. Kurora në fillim e bardhërreme ose e bardhë-murrme. Kapsula në formë veshkore, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytmon VIII-VIII (Rexhepi, F. 2000).	Kosovë, Shqipëri (Josifovic, M. et al. 1974, Rexhepi, F. 2000; Tutin, T. G. et al. (1972).	Në Kosovë rritet në kullosa serpentine (Halacsyetalia sendtneri) në zonën kodrinoremalore. Gjendet në kuadër të fitocenozës Polygalo-Genistetum hassertianae në shoqëri me llojet: Polygala doerfleri, Potentilla astracanica, Aster albanicus, Euphorbia glabriflora, Plantago subullata, Sanguisorba albanica, Sanguisorba officinalis, Linum tauricum, Stachys recta, Minuartia verna, Tulipa sylvestris, Scabiosa fumaroides, Genista hassertiana, Halacsya sendtneri, Centaurium erythraea, Teucrium montanum etj.	Koznik, Devë, Çafa e Morinës (Rexhepi, F. 2000, Krasniqi, E. 2003, 2021, Krasniqi, E. et al. 2012, Blečić, V. et al. 1968, 1971).	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë përhapje të kufizuar, vetëm në terrene me natyrë serpentine. Popullacioni i këtij lloji në Bokat e Morinës është mjaft i pasur me individë maturë. Në këtë lokalitet ky lloj zakonisht haset në afërsi të llojit Sanguisorba albanica.	Gati i rrezikuar.

63	Wulfenia bleicii Lak. Emri shqip: Vulfenie e Bleqiqit Familja: Plantaginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare me rizomë të fortë horizontale (Gjeofite G). Gjethet bazale me formë të ndryshme- të rumbullakëta, të përmbysta-ovale, lopatore, të përmbusta-vezake, eliptike ose heshtore, buzëve dy herë të dhëmbëzuara deri cekët të çara, nga ana e sipërme të shogëta ose me qime të rralla, nga poshtë e sidomos në nervura të mbuluara me qime. Gjethet në kërcell janë shumë më të vogla, gjatore-vizake. Lulesa është terminale, e ngjeshur ose e rrallë, me shumë lule në bishta të shkurtër. Kupa dy herë më e shkurtër se kurora, me pak qime ose e shogët, me 5 segmente linearo-heshtore, pa maje. Kurora ngjyrë vjollce të errët ose vjollce të çeltë. Gypi i kurorës 3-9 mm, i shogët. Thëkët janë 2 të vendosur në krye të gypit të kurorës. Pistili me krezë të zgjeruar. Fryti është kapsulë katërkthine e shogët ose me qime gjëndërore. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII (Rexhepi, F. 2000).	Kosovë - endemike e Alpeve Shqiptare (Rexhepi, F. 2000).	Në Kosovë rritet në vende barishtore, pyje e shkurre të zonës subalpine dhe alpine në kuadër të fitocenozës Wulfenio-Pinetum mugii, në shoqëri me llojet: Pinus mugo, Pinus peuce, Aquilegia vulgaris, Valeriana pancicii, Geum bulgaricum, Anthemis montana, Achillea abrotanoides, Arabis alpina, Valeriana montana, Pedicularis brachyodonta, Trifolium noricum, Aconitum vulparia, Dianthus sylvestris, Hypericum alpigenum etj.	Alpet Shqiptare (Bogiqë, Gjeravicë, Dervish Kom, Ishtedim, Hajlë, Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Milishevc, Pleçe, Maja e Rusolisë, Koprivnik , Maja e Vjellakut (Saric, M. et al. 1986; Millaku, F. 1993, 1997, 1999, 2005; Rexhepi, F. 2000).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë janë të përhapura vetëm në kuadër të Alpeve Shqiptare. Subpopullacionet në lokalitetet Rusoli, Hajlë, Liqenak dhe Gjeravicë kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacionet tjera kanë numër më të vogël të individëve maturë në kuadër të subpopullacioneve.	Gati i rrezikuar.
64	Campanula foliosa Ten. Emri shqip: Lulekambanë gjetheshumë Familja: Campanulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 20-50 cm kërcell të ngritur, të thjeshtë, cilindrik, pushlor përposh. Gjethet pak a shumë pushlore; të bazës me llapë 3-6 x 2.5 cm, vezake të gjëra , si zemër ose rrotullare në bazë, me buzë të sharruara e me bishtak 4-8 cm pak të flatruar; kërcelloret zakonisht të ngushtuara në bazë, eliptike-vezake, me buzë të sharruara, të gjata sa lulet, me bishtak të shkurtër, ndërsa kërcelloret më të sipërme pothuajse pabisht. Lulesa kapteinëz skajore. Dhëmbët e kupës si fëndyell , të qerpikët, më të shkurtër se gypi i kurorës. Kurora 20-35 mm, manushaqe. Lulëzon VI. Frytton VIII (Qosja, Xh. et al 1996).	Gadishulli Ballkanik, Apenine-pjesa qendrore dhe jugore (Tutin, T. G. et al. 1976).	Në Kosovë rritet në substrate silikate, serpentine dhe gëlqerore në pyje, livadhe malore, kullota subalpine e alpine e shoqëruar me llojet: Fagus sylvatica, Pinus peuce, Pinus mugo, Juniperus sibirica, Veratrum album, Centaurea nervosa, Ajuga pyramidalis, Geranium sylvaticum, Ranunculus platanifolius, Trollius europaeus, Knautia dimarica etj.	Alpet Shqiptare (Liqenak, Maja e Rusolisë, Ishtedim, Hajlë, Bogaj, Maja e Strellcit, Gjeravicë, Bjeshka e Tropojës, Pllaçicë e Vokshit, Pleçe, Malet male e Deçanit, Kurvallë) dhe Malet e Sharrit (Bistër, Luboten, Brezovicë, Oshlak, Vracë, Shtëpia e Malorëve, Gryka e Durlit (Durllov potok) (Rexhepi, 2000, 1986, 1982, 1994; Millaku, F. 2005, 1999, 1993; Josifovic, M. et al. 1974, Diklic, N. & Nikolic, V. 1961, 1978; Zeneli, L. 1975).	Popullacionet/subpopullacionet kanë shtrirje të gjërë në Alpet shqiptare dhe në Malet e Sharrit. Popullacionet/subpopullacionet edhe pse kanë shtrirje të gjërë, rritet në grupe me numër të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

65	<i>Centaurea kosaninii</i> Hayek. Emri shqip: <i>Kokoçel i Koshaninit</i> Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërcejtë deri 70 cm, pak të degëzuar në pjesën e sipërme. Gjethet të shogëta, zakonisht dyfish pendore të çara; segmentet jo më shumë se 1 mm të gjërë, ngushtësisht vizakë. Pëstijella me diametër rreth 15 mm; shtojcat të ngushta, kinde-kinde deri me dhëmbë të shkurtër, të verdhërreme. Lulet manushaqe ose të kuqe të errëta. Akenët 3.5 mm, sa 1/2 e gjatësisë së xhufkës. Lulëzon VI. Frytmon VIII (Vangjeli, J. et al. 2000).	Kosovë, Shqipëri, Maqedoni-endemike (Greuter, W. & E. von Raab-Straube 2008; Rexhepi, F. 1994, 2000; Krasniqi, F. 1982, 1987, Tutin, T. G. et al. 1976; Micevski, K. & Matevski, V. 1987).	Në Kosovë rritet në vende të thata shkëmbore e kullota me natyrë serpentinore (Halacsyetalia sendtneri) por edhe gëlqerore të zonave malore. Shogërohet nga llojet: Euphorbia glabriflora, Stachys recta, Polygala doerfleri, Halacsya sendtneri, Stachys scardica, Campanula lingulata, Astragalus onobrychis, Potentilla visianii, Melanpyrum cristatum, Plantago argentea, Veronica andrasovszkyi, Aster albanicus subsp. albanicus, Scabiosa fumaroides, Forsythia europaea, Sanguisorba albanica, Genista hassertiana, Serratula radiata, Jurinea mollis, Dianthus cruentus etj. Foto: Elez Krasniqi (2013), Pashtrik.	Brezovicë, Koznik, Godanc, Gllanasellë, Badovc (Rexhepi, F. 1978, 1979, 1985, 1994, 2000, Josifovic, M. et al. 1975, Blecic, V. et al. 1969, 1971; Silic, C. 1988), Rajoni i Mirushës, Mali Drenicë (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2011, Krasniqi, E. et al. 2008). Gjendja e llojit u vlerësua edhe në Gubavc më 06.06.2011 (F. Millaku, Xh. Mala), në Pashtrik më 21.07.2011 (F. Millaku, E. Krasniqi, Xh. Mala) dhe në lokalitetin Qafa e Prushit më 18.06.2011 dhe 18.09.2012 (F. Millaku, F. Rexhepi, Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Bokat e Morinës dhe rritet në bashkësi me llojin Sanguisorba albanica.	Popullacionet kanë përhapje të kufizuar por me numër të madh të individëve me përjashtim të popullacionit në Malin Drenicë (Javor-Luzhnicë) i cili paraqet popullacion me numër shumë të vogël të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile me përjashtim të lokalitetit Badovc.	Më pak i rrezikuar.
66	<i>Forsythia europaea</i> Deg. et Bald. Emri shqip: <i>Boshtër e Evropës</i> Familja: Oleaceae	Bimë durore-shkurre (Fanerofite P), e lartë deri 3m. Degëzat dhe nyjet janë me palcë dhe kthina. Gjethet të thjeshta dhe eliptike ose vezake të shogëta. Gjethet e degëve pa lule të dhëmbëzuara deri në ura, ato të degëve me lule buzëplota, 5-8 cm të gjata. Lulet të verdha me kupë rreth 3 mm dhe me kurorë -15 mm të gjatë. Kapsula 1.2-1.5 cm. Riprodhohet me farë, Lulëzon IV-V, Frytmon VIII-IX. (Rexhepi, F. 2000)	Kosovë, Shqipëri.	Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore-serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Zakonisht rritet në shoqërim me llojet: Cornus mas, Quercus pubescens, Quercus cerris, Acer monspessulanum, Fraxinus ornus, Sanguisorba minor, Centaurea montana, Viola sylvestris, Popygala doerfleri, Filipendula hexapetala, Crataegus monogyna.	Sipas Deg. et Doerfler (1897), Rexhepi (2000), Josifovic, M. et al. (1973), Blecic et Krasniqi (1971) Krasniqi, E. (2021), ky lloj është i përhapur në serpentinete e Shqipërisë veriore (regjioni i Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi dhe në këto lokalitete të Kosovës: Gubavc, Koznik, rajoni i Mirushës deri afër Rahovecit, Qafa e Prushit, Bokat e Morinës dhe Golesh.	Popullacionet e këtij lloji në Golesh dhe në rrethinën e Koznikut (Zatriq, Mirushë) janë në gjendje më të mirë në krahasim me popullacionet e këtij lloji në Qafë Prush, Qafë të Morinës dhe Gubavc. Popullacionet më të degraduara dhe më me pak individë maturë janë popullacionet në Gubavc (Pejë) dhe Bokat e Morinës. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

67	<i>Gentiana punctata</i> L. Emri shqip: <i>Genciana me pika</i> Familja: Gentianaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G) me rizomë të trashë dhe rrënjë të degëzuar të gjatë deri 1 m. Kërcellit është 20-60 cm i thjeshtë pak këndorë. Gjethet e poshtme janë të shkurtra deri 2 cm të gjata, me bisht. Gjethet në pjesën e sipërme të kërcellit janë të kundrejta, pabisht ovale ose eliptike, të gjata 6-9(-12-29) cm, të gjëra 2-6 cm, në bazë janë të ngjitura në këllëf të shkurtër, zakonisht me 3-7 (5) nervura. Lulet janë të dallueshme, pabisht, të vendosura në krye të kërcellit, në formë kaptinore ose formë qerthullore, në sqetullen e gjetheve të sipërme. Kupa është këmbanore, kurora gjithashtu këmbanore me 5-8 vriguj të shkurtër, oval të rumbullakët të gjatë 8-11 mm. Kurora e bardhë-verdhë me njolla vjollce të mbyllta. Riprodhohet me fare. Lulëzon VIII-X. Frytton IX-X. (Rexhepi, 1986).	Evropë.	Rritet në substrate silikate, karbonate dhe serpentine; në vende me barë, kulllosa, shkurrat ose çeltira të pyjeve halore e shoqëruar nga llojet: Geum montanum, Juniperus sibirica, Vaccinium myrtillus, Pinus mugo, Gentiana lutea, Armeria alpina, Sempervivum macedonicum, Scabiosa leucophylla, Knautia dinarica, Anemone narcissiflora, Phyteuma pseudorbiculare, Senecio subalpinus etj.	Sipas literaturës ekzistuese dhe hulumtimeve në terren, ky lloj është i përhapur gjerësisht në Alpet Shqiptare (Zhleb, Rusoli, Lipë, Bjeshkët e Rugovës, Liqenak, Bjeshka e Lumëbardhit, Roshkodol, Bjeshkët e Strelcit, Koprivnik, Bjeshkët të Belegut, Bjeshkët të Dobroshit, Rupë, Bjeshkët të Junikut, Baballoçit, Gjeravicë, Rrasë të Zogut etj.) dhe Malet e Sharrit (Luboten, Livadhishtë, Piribreg, Brezovicë, Përroi i Durlit, Bister, Oshlak, Koritnik, Bjeshkët e Opojes etj.).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal mjaft të gjerë si në Malet e Sharrit ashtu edhe në Alpet Shqiptare të Kosovës. Numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është duke rënë si pasojë e grumbullimit si bimë mjekësore për treg. Në bazë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë brenda 10 viteve të fundit popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë zvogëluar mirëpo shumica e subpopullacioneve për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
68	<i>Halacsya sendtneri</i> (Boiss.) Dorbl. Emri shqip: <i>Halaçë e Sendtnerit</i> Familja: Boraginaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-25 cm, me sistem rrënjor të gjatë dhe të fuqishëm. Kërcellit është i ngritur i padegëzuar i mbuluar me qime të ashpra dhe mbaron me një lulesë cimoziqe. Gjethet janë të thjeshta, me buzë të plota, në bazë të kërcellit janë lineare-heshtore, ato të kërcellit janë më të vogla të mbuluara me qime të ashpra. Lulet janë hermafrodite diçka zigomorfe. Kupa me 5 gjetheza të ngjitura. Kurora është e verdhë-ari në formë hinke, në bazë 5 kupore. Thëkë janë 5 të ngjitur për gypin e kurorës. Pistili me 1 shtyllë dhe 1 vezore të mbitëshme, katër kthinore dhe në çdo kthinë nga 1 ovulë. Fryti është tetra-aken. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VI. Frytton VII. (Rexhepi, F. 2000)	Bimë endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi, Kabas, et al. 2013).	Ky lloj rritet në vende me bar dhe shkëmbore mbi substrat serpentinor, e shoqëruar nga llojet: Euphorbia glabriflora, Euphorbia borrellieri, Hypericum barbatum, Polygala doerfleri, Juniperus oxycedrus, Fraxinus ornus, Quercus petraea, Silene vulgaris, Centaurea kasaninii, Stachys recta, Prunus mahaleb etj.	Sipas Rexhepi, F. (1978, 1979), Krasniqi, E. (2003, 2006, 2021) është e përhapur në Golesh, Gubavc, Koznik dhe Llapçevë. Është konstatuar edhe në Bokat e Morinës, Qafë Prush, Guriq, Serpentinët e Mushtishtit (Bokat e Baçevcit, Bokat e Grejkovcit, Bokat e Korishit).	Popullacionet e këtij lloji në Golesh, Llapçevë, Koznik, Bokat e Morinës dhe Qafë Prush janë në gjendje të mirë dhe mjaft të pasura me individë maturë. Popullacioni i këtij lloji në Gubavc ka areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

69	<i>Iberis sempervirens</i> L. Emri shqip: <i>Iberis gjithmonblertë</i> Familja: Brassicaceae	Bimë gjysmëshkurre 10-25 (-30) cm e gjatë (Kamefite Ch). Gjethet 2.5-5 mm të gjëra, shyte me buzë të plota, të zgjatura, mishtake. Lulesat vile, bishtat e luleve pa qime. Petalet të bardha. Silikëzat në vile rrotullore-vezake, 6-7 mm të gjata me vriguj gati shyt. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VIII. Frytton VII-IX. (Mitrushi, 1966).	Evropa Jugore (Mediteran – Submediteran)	Rritet në substrat gëlqeror në të çara shkëmbinjsh ose në vende gurishtore prej zonës malore deri në atë alpine. Rritet e shoqëruar nga llojet: Anthyllis aurea, Lilium albanicum, Aster alpinus, Juniperus sibirica, Helianthemum alpestre, Onobrychis scardica, Dryas octopetala, Antennaria dioica, Scutellaria alpina etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Saric et al. (1986), Josifovic, M. et al. (1972), ky lloj është i përhapur në: Koprivnik, Rrasë të Zogut, Bjeshkë të Belegut, Qafë të Bogiçës, Leqinak, Bjeshkë të Deçanit, afër Pejës (Gryka e Rugovës) dhe në Malet e Sharrit (Luboten, Oshlak, Koxhabalkan, Koritnik). Millaku, F. me 19.07. 2013 e konstatoi edhe në Bjeshkën e Dobroshit (Quka e Gërrbave) në lartësi mbidetare 2250 m, pastaj në Pllaçicë të Junikut në 2352 m e shoqëruar nga Potentilla speciosa dhe Saxifraga scardica. Millaku, F. gjatë 2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Pashtrik në lartësi mbidetare 1570 m dhe në Majën e Rusolisë (2100 m)	Ky lloj në Kosovë formon disa popullacione/subpopullacione në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare. Këto popullacione/subpopullacione kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë me përjashtim të popullacionit në Pashtrik dhe Koritnik. Këto dy popullacione edhe pse kanë areal të kufizuar kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Subpopullacioni në Pllaçicë të Junikut shtrihet në lartësi 2352 m lartësi mbidetare dhe ka areal shumë të kufizuar. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
70	<i>Knautia dinarica</i> (Murb.) Borb. Emri shqip: <i>Knautia e Dinarideve</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H). Kërçelli është i mbuluar me qime të dendura të kthyera teposhtë. Gjethet e poshtme janë në rozetë eliptike deri eliptikeheshtore. Gjethet e kërçellit janë heshtore ose lineare-heshtore me buzë të dhëmbëzuara ose të sharrëzuara të mbuluara me qime të palosura. Bishtat e lulesave janë të mbuluara me qime dhe gjëndra. Gjethëzat që pëstjellin lulesën janë ovale heshtore dhe gjëndërore. Lulesa është e gjërë 2-3 mm. Lulet janë të kuqe-vjollcë ose të ngjyrë hirta. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).	Ballkan (Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi).	Ky lloj në Kosovë rritet në substrate të ndryshme; në livadhe, kullosa, vende me shkurrë dhe çeltira pyjesh të zonës subalpike dhe alpike. Në shumicën e lokaliteteve rritet e shoqëruar nga llojet: Achillea multifida, Geum montanum, Leucanthemum vulgare, Pinus heldreichii, Linum capitatum, Pinus mugo, Lilium albanicum, Gentiana lutea, Campanula glomerata, Juniperus sibirica, Vaccinium uliginosum, V. myrtillus etj..	Sipas Rexhepi, F. (1986), Saric et al (1986), Josifovic, M., et al. (1973), Lakusic, R. (1970) është e përhapur në: Alpet Shqiptare (Koprivnik, Hajlë, Kurvallë, Mokna) dhe në Malet e Sharrit (Liqenet e Jazhincës dhe Prevallë). Ky lloj është i përhapur edhe në lokalitetin Përroi i Durlit dhe Piribreg.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Zakonisht takohen individ të vetmuar ose grupe të vogla. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

71	<i>Lilium albanicum</i> Griseb. [<i>Lilium carniolicum</i> subsp. <i>albanicum</i> (Griseb.) Hayek] Emri shqip: <i>Zambaku shqiptar</i> Familja: Liliaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Gjeofite G). Bulbi (qepa) ka madhësi mesatare ngjyrë të mishit. Kërcelet është i drejtë 20-50(-60) cm, në bazë i shogët, pa gjethe, në majë me 1 lule rrallë me shumë. Gjethet kanë vendosje të këmbyer, shumë a pak janë të afuara mes veti, lineare-heshtore, në majë të mprehta, të gjata 7 cm, me qerpik vetëm në buzë. Lulet janë të verdha-ari ose portokalli (pa njolla) me diametër 3.5 cm. Gjethëzat e perigonit janë heshtore. Kapsula është 2.5-3.5 cm. Riprodhohet me fara dhe bulb. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. (Rexhepi, 1986).	Bimë endemike e Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi, Bullgari, Serbi)	Rritet në vende me bar, shkurre, shpate shkëmbore të freskëta të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet : <i>Sempervivum macedonicum</i>, <i>Geum montanum</i>, <i>Vaccinium myrtillus</i>, <i>Pinus peuce</i>, <i>Vaccinium uliginosum</i>, <i>Polygala major</i>, <i>Achillea alexandri-regis</i>, <i>Gentiana lutea</i>, <i>Trollius europaeus</i>, <i>Rubus idaeus</i> etj. Në Bokat e Morinës ky lloj është konstatuar në substrat serpentin në kuadër të disa asociacioneve nga 630-1100 m lartësi mbidetare e shoqëruar nga llojet: <i>Gladiolus illyricus</i>, <i>Forsythia europaea</i>, <i>Asphodelus albus</i>, <i>Potentilla alba</i>, <i>Polygala doerfleri</i>, <i>Plantago argentea</i>, <i>Sanguisorba albanica</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999), Rexhepi, F. (2000), Saric, et al. (1986) është e përhapur në: Koritnik, Luboten, Malet e Sharrit (Shtepia e malorëve, Bistra-Prevallë, Pashallarë, Oshlak, Orman, Piribreg, Ujërat e Humbura, Konjushkë, Qukat e Jezercit), Alpet Shqiptare (Mokna, Koprivnik, Zhleb, Bjeshket e Lumëbardhit, Rusoli, Pllacicë, Gjeravicë, Liçenak, Stanet e Erenikut dhe në Majën e Kunorës). Gjatë viteve 2011-2012 këtë lloj e kemi takuar edhe në Pashtrik, Pleçe, Milishevc, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Kurvallë, Dervish Kom, Bjeshkë të Dobroshit, pastaj në Malet e Sharrit (Përroi i Durlit, Liqenet e Jazhincës, Livadhishtë, Studenicë (Therandë), Bjeshkë të Bukoshit, Bjeshkë të Opojës etj. Millaku, F. i shoqëruar nga Isa Elezaj me 16.05.2013 këtë lloj e konstatoi edhe në Bokat e Morinës në ekspozicion verior nga 630- 1100 m lartësi mbidetare. Është rasti i parë i njohur deri me tani që ky lloj të konstatohet në lartësi mbidetare 630 m.	Ky lloj gati në të gjitha lokalitetet e cekura formon popullacione-subpopullacione që kanë pak a shumë një areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve-subpopullacioneve . Është bimë dekorative andaj edhe popullacionet e saj shpesh herë dëmtohen nga adhuruesit e natyrës. Rritet në kuadër të kullotave subalpine dhe alpine me përjashtim të popullacionit të këtij lloji në Bokat e Morinës andaj shpesh dëmtohen nga bagëtia si dhe nga barinjët të cilët i kallin shkurret e kësaj zone për të krijuar kullota të reja. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	--	--	---	--	--	---	----------------------------

72	<i>Linum flavum</i> L. Emri shqip: Lin i verdhë Familja: Linaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e shogët me kërcëj të ngritur pak të degëzuar sipër, që dalin nga një rozetë e ngjeshur 20-60 cm dhe me pak ose pa rozeta jo lulembajtëse. Gjethet me 3 (-5) nervura, të poshtmet heshtore të përmbysta-pallake, 40-60×10-12 mm, të sipërmet heshtore, pabisht 20-40×7-11 mm, me 2 gjëndra në bazë. Lulesa e degëzuar, zakonisht me 25-40 lule. Sepalet 5-6 (-8) mm, heshtore, të thepëta me karenë e gjëndra në bazë. Petalet të verdha, 20-22×1113 mm, me llapë vezake të përmbysta dhe me thonjëz relativisht të shkurtër. Kapsula 5-6 mm me sqep afër 1 mm. Riprodhohet me farë. Lulëzon VI-VII. Frytton VII-VIII. Qosja, Xh. et al. (1992).	Juglindore-Pontike.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në substrate serpentimore në kuadër të rendit Halascietalia sendtneri. Në Bokat e Morinës, Koznik dhe Mirush ky lloj takohet në biotope të njëjta me llojet Linum tauricum e me rrallë me llojin Linum elegans. Lloje tjera bimore që e shoqërojnë këtë lloj janë edhe: Polygala doerfleri, Halascia sendtneri, Forsythia europaea, Fumana bonapartei, Gladiolus illyricus, Linaria dalmatica, Quercus pubescens, Fraxinus ornus etj.	Sipas literaturës ekzistuese (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021) etj. është e përhapur në: Koznik, Mirushë, Brezovicë, Novobërdë, Gërmi, Oshlak. Gjatë vitit 2012-2013 këtë lloj e kemi konstatuar edhe në Pashtrikun e Poshtëm, Bokat e Krevenikut, Bokat e Morinës, Gubavc dhe në Qafë Prush.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar mirëpo numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm sidomos në Bokat e Morinës dhe në Koznik. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
73	<i>Melampyrum scardicum</i> Wettst. Emri shqip: Grurëzi i Sharrit Familja: Orobanchaceae [Scrophulariaceae]	Bimë barishtore njëvjeçare (Terrofite T), e butë (15) 20-40 cm, me kërcell të ngritur të pa degëzuar, rrallë të degëzuar. Gjethet në pjesën e poshtme gjatore heshtore, buzë plota 20-30 mm, në pjesën e sipërme gati trekëndore, me majë dhe me dhëmbë. Lulet në lulesa të shpërndara në vile njëanësore; nervurat e kupës me qime të ashpra shumëqelizore, ndërsa midis nervurave e shogët ose me qime të shkurtra. Dhëmbët e kupës 6-7 mm të gjatë gati sa gypi i kurorës. Kurora 10-17 mm e gjatë, e verdhë; mbi bazë qartë e shtrembëruar anash, me grykë gjysmë të hapur. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VIII-IX, riprodhohet me farë.	Endemik i Ballkanit Jugor. Sipas Hayek, (1929), Soo & Webb. (1972), Tutin, T. G. et al. (1964-1980) është e përhapur në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Bullgari dhe Maqedoni (Matevski, V. & A. Teofilovski, 2004)	Në Kosovë është konstatuar në substrat silikat në vende me shkurre (Vaccinium myrtillus dhe Juniperus sibirica), dhe pyje të armenit (Pinus peuce) ose në pyje të përzierera të halorëve. Në Alpet Shqiptare (Kosovë) rritet e shoqëruar nga llojet: Juniperus sibirica, Vaccinium myrtillus, V. uliginosum, Pinus peuce, Dianthus integer, Silene roemer, Campanula foliosa, Cerastium decalvans, Lilium albanicum etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Rexhepi, F. (2000), Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Bogiçë, Gryka e Lloçanit, Liqenak). Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur edhe në Malet e Sharrit (Maja e zezë). Sipas Matevski & Teofilovski (2004), Soo (1927), Mayer (1969) është e përhapur në Rudokë. Millaku, F. me 18.07.2013 e konstatoi në Dervish Kom, kurse me 19.07.2013 në Bjeshkë të Tropojës (Kosovë) dhe Bjeshkë të Dobroshit (Rupë).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Dervish Kom, Bjeshkë të Tropojës (Kosovë), Bjeshkë të Dobroshit, Gryka e Lloçanit dhe Liqenak) kanë areal të kufizuar mirëpo janë të pasura me individë maturë. Në Malet e Sharrit (Maja e Zezë) gjendet vetëm një popullacion që ka areal të kufizuar mirëpo ka numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

74	<i>Pedicularis brachyodonta</i> Schlos.et Vuk. Emri shqip: <i>Pedikulare dhëmbëshkurter</i> Familja: Orobanchaceae [Scrophulariaceae]	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcell të ngritur ose të përjetëm. Gjethet pushlore, heshtore, dyfishpendore te prera me segmente vizake gjatore, me majucë e të sharruara. Braktetë pendore pak a shumë leshtore të prera deri në tre vriguj. Gypi i kupës leshtor vetëm në nervura; dhëmbët e kupës si deltë, buzëplotë, të qerpikët. Kurora 20-25 cm, e verdhë e zbehtë; buza e poshtme e shogët, me vriguj të sharrëzuar dhe 2 zardhokë pranë buzës. Kapsula ovoide, me majucë, që del pak nga kupa. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Ballkan (Shqipëri, Kosovë, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali i Zi)	Rritet në kullota të zonës subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea chrysocoma</i>, <i>Armeria alpina</i>, <i>Jovibarba heuffelii</i>, <i>Helianthemum canum</i>, H. <i>Alpestre</i>, <i>Lilium albanicum</i>, <i>Senecio wagneri</i> <i>Stachys alpina</i>, <i>Botrychium lunaria</i>, <i>Nigritella nigra</i>, <i>Juniperus sibirica</i>, <i>Daphne cneorum</i>, <i>Myosotis alpestris</i>, <i>Achillea atrata</i>, <i>Hypericum alpinum</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999) dhe Josifovic et al. (1974) është e përhapur në Alpe Foto: Xhavit Mala (2012), Luboten Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë, Bjeshkë të Lloçanit, Maja e Rusolisë), sipas Saric et al. 1986 është e përhapur në Malet e Sharrit (Oshlak, Piribreg, Luboten, Konjushë). Ky lloj është konstatuar edhe në Bjeshkë të Lumëbardhit, Koritnik dhe Pashtrik.	Popullacionet në Alpet Shqiptare (Gjeravicë, Kurvallë, Bjeshkë të Lloçanit, Maja e Rusolisë) dhe Malet e Sharrit (Oshlak, Piribreg, Luboten, Konjushë) kanë areal të kufizuar, por numër të konsiderueshëm të individëve brenda popullacioneve. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
75	<i>Phyteuma pseudorbiculare</i> Pant Emri shqip: <i>Fiteumë e rrumbullakët e rreme</i> Familja: Campanulaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-50 cm, me kërcell të ngritur ose të përjetëm, i shogët, rrëvaga-rrëvaga. Gjethet bazale pak a shumë gatirrotullore, me bishtak të shkurtër; kërceloret eliptike të gjëra, të sipërmet me bishtak. Lulesa kaptinëz gjysmërruzullore, me diametër 3 cm. Braktetë vezake të gjëra, shpesh si zemër në bazë, me buzë të sharruara. Lulëzon VI-VII, frytëzon VII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Endemike e Ballkanit. Sipas Matevski, V. & Kostadinovski, M. (1996) është e përhapur në Maqedoni.	Ky lloj në Kosovë rritet në kullota e shkëmbinj të zonës subalpine e alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit e shoqëruar nga llojet: <i>Dianthus sylvestris</i>, <i>Oxytropis campestris</i>, <i>Helianthemum canum</i>, <i>Aster alpinus</i>, <i>Achillea chrysocoma</i>, <i>Helianthemum alpestre</i>, <i>Alchemilla plicatula</i>, <i>Campanula patula</i>, <i>Geum coccineum</i>, <i>Nigritella nigra</i>, <i>Stachys alpina</i>, <i>Campanula foliosa</i>, <i>Trifolium badium</i> etj.	Sipas Millakut (1999) rritet në Alpe Shqiptare (Maja e Rusolisë, Kurvallë, Pllaçicë, Liqenak, Gjeravicë) sipas Josifovic et al. (1974) është prezentë Pllaçicë, Majë të Rusolisë. Sipas Saric et al. (1986) është prezentë në Malet e Sharrit (Luboten, Piribreg, Bistra, Liqenet e Jzhinces, Kobilicë) dhe Alpe Shqiptare (Liqenak dhe Dervish Kom).	Në kuadër të Alpeve Shqiptare janë konstatuar subpopullacione të vogla që kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Edhe në Malet e Sharrit janë konstatuar 5 subpopullacione me areal të kufizuar por me numër të konsiderueshëm të individëve në kuadër të popullacioneve. Në shumicën e popullacioneve takohen edhe individë të vetmuar. Për momentin popullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

76	<i>Plantago gentianoides</i> Sibth. et. Sm. Emri shqip: <i>Gjethedell si sanzë</i> Familja: Plantaginaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me një rozetë gjethesh. Gjethet 2-6 (10) x 1-3.5 cm, llapa vezake deri eliptike, gati e plotë me 3-5 (7) nervura, e shogët ose me qime të rralla, bishtaku sa 1/2 e gjatësisë së llapës. Shtijet shumë me të gjata së gjethet. Kallinj të 1-3.5 (4) cm. Braktetë rreth 2 mm, vezake-rotullare, të shogëta, nganjëherë me qerpikë të imët. Nënpetlat 2 mm pothuaj të lira. Gypi i kurorës rreth 2 mm, i shogët; vrigujt 1-1.5 mm, vezakë, shyte. Thëkët dalin 3-5 mm jashtë kurorës, pjalmoret të verdheme. Kapsula 3 mm. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1996).	Evropë Qendrore dhe Lindore, Ballkan.	Rritet në kullota subalpine dhe alpine të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit e shoqëruar nga llojet: <i>Vaccinium myrtillus</i> , <i>V. uliginosum</i> , <i>Bruckenthalia spiculifolia</i> , <i>Senecio nemorensis</i> , <i>Antennaria dioica</i> , <i>Polygonatum bistorta</i> , <i>Veratrum album</i> , <i>Dianthus sylvestris</i> , <i>Jasione orbiculata</i> , <i>Achillea chrysocoma</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Josifovic et al. (1974) është i përhapur në Alpe Shqiptare (Liqenak, Bjeshkë të Lumëbardhit, Dervish Kom). Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Luboten, Qukat e Jezercit, Liqenet e Jazhincës, Konjushë, Bistër, Karanikollë (Opojë).	Në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit popullacionet e këtij lloji janë të vogla, kanë areal të kufizuar por numri i individëve maturë brenda popullacioneve është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
77	<i>Polygala doerfleri</i> Hayek Emri shqip: <i>Poligalë e Dërflerit</i> Familja: Polygalaceae	Barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), e ngritur me kërcëp të drunjëzuar. Kërcej të rreth 40 cm, të padegëzuar. Gjethet vizake heshtore, të mprehta , të shogëta. Vilet skajore ovoide-gjatore, të dendura në frytëzim të sheshta. Braktet pak me të gjata se këmbëzat. Lulet të trëndafilita. Flatrat 7-9 mm (11 mm në frytëzim), vezake përmbysët të gjëra me nervaturë të ndërthurura. Gypi i kurorës rreth 6 mm, gati i barabartë me petlat e sipërme. Gjinofoori shumë i shkurtër. Kapsula më e shkurtër dhe më e ngushtë së flatrat. Lulëzon V-VII, frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Endemike e Ballkanit.	Rritet në substrate serpentinore, kullota dhe vende me bar, shpesh edhe në çeltira të pyllit të zonës malore në kuadër të asociacioneve: <i>Hyperico-Euphorbietum glabriflorae</i> , <i>Polygalo-Forsythietum europaea</i> dhe <i>Polygalo-Genistetum hassertianae</i> e shoqëruar nga llojet: <i>Forsythia europaea</i> , <i>Aster albanicus</i> , <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Hypericum barbatum</i> , <i>Potentilla visianii</i> , <i>Euphorbia barbelieri</i> , <i>Linum tauricum</i> , <i>Plantago argentea</i> , <i>Artemisia lobelii</i> , <i>Salvia ringens</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Forsythia europaea</i> , <i>Stachys scardica</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> , <i>Centaurea kosaninii</i> , <i>Scabiosa fumaroides</i> , <i>Genista hassertiana</i> , <i>Sanguisorba albanica</i> etj.	Sipas Millaku, F. et al. (2008), Josifovic et al. (1973), Blečić et al. (1968), Krasniqi, E. (2003, 2021) është e përhapur në serpentine në rajonin e Mitrovicës dhe Koznikut, Alpe Shqiptaret (Gubave), Bokat e Morinës, Qafë Prush, Rajoni i Mirushës, Koznik, Golesh, Rajoni i Mushtishtit (Greikoc, Korishë, Manastir), Guranë, Gradicë.	Popullacionet e këtij lloji në Kosovë janë në afërsi të vendeve urbane dhe janë nën ndikim të faktorit zoantropogjen. Popullacionet në rajonin e Mirushës-Koznikut dhe rajonin e Morinës-Qafë Prush janë me areal më të gjërë dhe me numër të madh të individëve maturë. Popullacionet tjera kanë areal me të kufizuar dhe janë me shumë të ndikuara nga faktorët negativ që dëmtojnë habitatin dhe zvogëlojnë sipërfaqen e banimit të këtij lloji. Për momentin shumica e popullacioneve /subpopullacioneve të këtij lloji në Kosovë janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

78	Potentilla apennina Ten. Emri shqip: Potentillë e Apenineve Familja: Rosaceae	Barishtore shumëvjeçare (Kamefite CH), me kërcëj lulorë deri 20 cm, me qime pushlore të bardha. Gjethet trishe; gjithëzat gjatore-vezake të përmbysta, 7-15 x 3-5 mm, gati të plota ose me 2-3 dhëmbë në majë, përsipër me qime të mëndafshita. Lulet 1-5 (7) gati pabisht. Nënpetlat vezake. Petlat 8-10 mm, më të gjata se nënpetlat, të bardha. Pjalmoret gjatore. Shtyllëza gati skajore, konike si fill, e shogët, e rëshme. Shtrati lulor shumë leshtor. Akenët zakonisht pushlor. Lulëzon VII-VIII, frytëzon VIII-IX. Riprodhohet me farë. Qosja, Xh. et al. (1992).	Apenine Qendrore, Ballkan.	Rritet në vende shkëmbore (të çara të shkëmbinjve) ose në vende me gur të zonës alpine dhe subalpine e shoqëruar nga llojet: Aster alpinus, Helianthemum canum, Ptilotrichum rupestre, Edraianthus graminifolius, Saxifraga scardica, Saxifraga sempervivum, Anthyllis aurea, Anthyllis vulneraria, Minuartia baldacii subsp. doerfleri, Potentilla speciosa dhe Amphoricarpus neumayeri.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpe Shqiptare (Liqenak, Bjeshkë te Lumëbardhit, Bjeshkë te Strellcit, Bjeshkë te Lybeniqit, Marjash, Rrasë të Zogut, Bogiçë, Koprivnik, Sushicë, Hajlë). Sipas Saric et al. (1986) rritet në Koprivnik. Sipas Josifovic et al. (1972) është prezentë në Bogiçë dhe Liqenak. Është e përhapur edhe në Pleçe dhe Koritnik.	Popullacionet në Alpe Shqiptare kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë por për momentin janë mjaft stabile. Në Koritnik Popullacioni është me areal të kufizuar por numri i individëve brenda këtij Popullacioni është i konsiderueshëm. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
79	Saxifraga scardica Griseb. Emri shqip: Iriqëz e Sharrit Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare tufore (Hemikriptofite H) e dendur, me kërcëj gjethorë, 4-7 cm, gati të drunjëzuar në bazë, shumë të degëzuar, si rozeta ose si shtylla, me gjethe të ngjeshura. Kërcëjtë lulorë të ngritur ose të përpijetëm, 3-10 cm, me gjethe të çlirëta me qime gjëndërore. Gjethet e kërcëjve të hapura të shpërvësura; në faqen e sipërme konkave; në faqen e poshtme konvekse - me karenë; në gjysmën e sipërme të plota, të shogëta; në gjysmën e poshtme me dhëmbë të imët ose me qerpikë, gjatore-pallake ose heshtore-gjatore, 4-16 x 1.5-4.5 mm, me majë të mprehtë, shpesh me hidatoda. Gjethet e kërcëjve lulorë gjatore-pallake, 4-8 x 1.3-2 mm, të mprehta me thumb. Lulesa vastakore ose vastakore-melthore, me 3-11 lule. Sepalet vezake ose vezake-gjatore, 2.3-4 x 1.5-1.9 mm, shpesh majëmprehta, me qime gjëndërore, si purpur. Petalet gjërësisht vezake të përmbysta, 5-9 x 2.5-4.5 mm, të bardha ose trëndafil. Thëkët më të shkurtyr se petalet. Vezorja e nëntëshme, me qime gjëndërore. Karpellet 4-6 mm. farat 0.8 mm, të murme, me rrudha. VI-VIII. (Paparisto, K. et al. 1988).	Siujdhesa ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinjtë gëlqeror të zonave alpine e shoqëruar nga llojet: Minuartia baldaci, Minuartia verna, Edraianthus graminifolius, Armeria alpina, Achillea chrysocoma, Asperula doerfleri, Jovibarba heuffeli, Saxifraga paniculata, Saxifraga sempervivum, Thlaspi bellidioides, etj.	Sipas Millaku, F. (1999), Krasniqi, F. (1987) është prezentë në Koprivnik, Guri i Kuq (Bjeshka e Lumëbardhit), Dervish Kom dhe Liqenak. Sipas Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1977) është prezentë edhe në Malet e Sharrit (Livadhishtë, Luboten, Brod, Balka e Madhe), Koritnik. Millaku, LC – Më pak i rrezikuar. F. me 30.06. 2012 e konstatoi edhe në Pleçe (Alpe Shqiptare) në të çara të shkëmbinjve në ekspozicion verior në lartësi mbidetare 2467 m. Më 19.05.2013 Millaku, F., Gashi, B. dhe Berisha, N. e konstatuan edhe nën Majën e Vjellakut (Pejë) dhe mbi grykën e Shushicës nga 1710-1913 m lartësi mbidetare.	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit (Livadhishtë, Luboten, Koritnik) dhe në Alpet Shqiptare (Koprivnik, Liqenak, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Pleçe, Maja e Vjellakut, Gryka e Sushicës) kanë areal të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të këtyre popullacioneve është i vogël. Popullacionet e këtij lloji për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

80	<i>Saxifraga sempervivum</i> C. Koch [Saxifraga media S.S.] Emri shqip: <i>Iriqëz përherë e gjelbër</i> Familja: Saxifragaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), tufore e dendur, me kërcëj gjethorë shterpë, që mbarojnë me rozeta gjethore. Kërcejtë lulorë pak dredhakë, 5-12 (-15) cm, me gjethe të dendura, me qime të hapura gjëndërore. Gjethet e bazës në rozeta me diametër 1-2 cm, shumë a pak me karenë në anën e poshtme, të rimta, të shogëta, ose vetëm me pak qerpikë në fund, vizake ose vizake-heshore, të mprehta ose gati majëgjatë të fëndyellta, 0.8-1.6 cm, me buzë kërcore, me shumë hidatoda anëve. Kërccelli lulor 8-14 mm, lulet e purpurta dhe të hapura, 2-2.5 x 1-1.5 mm. VI- VII.	Pjesët jugore të Stujdhës Ballkanike (Endemike-Ballkanike).	Në Kosovë ky lloj rritet në shkëmbinj gëlqeror, silikat dhe serpentin të zonave malore shoqëruar nga llojet: Ramonda nathalie, Saxifraga scardica, Minuartia baldacii, Minuartia verna, Edraianthus graminifolius, Armeria alpina, Achillea chrysocoma, Asperula doerfleri, Jovibarba heuffeli, Globularia cardifolia etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999) është e përhapur në Gjeravicë, Rrasë te Zogut, Bjeshkë të Belegut, Marjash, Majën e Strellcit, Bjeshkën e Lybeniqit, Bjeshkën e Lumëbardhit dhe në Liçenak. Sipas Saric et al. (1986) në Malet e Sharrit është prezentë në: Piribreg, Oshlak, Koxhaballkan, Koblicë, Livadhishtë, Luboten, Rusenicë. Millaku, F. dhe Gashi, B. me 11.05.2013 e konstatuan edhe në Gotovush (Shterrpçë) në 1134 m lartësi mbi detare dhe në afërsi të Gllloboqicës (Elez Han) si lloj shoqërues i bimës endemike Ramonda nathalie.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë shtrirje të gjërë. Edhe pse ky lloj në kuadër të Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit ka një shtrirje të gjërë, popullacionet /subpopullacionet e këtij lloji kanë areal të kufizuar por në disa lokalitete të pasura me individë maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	--	---	--	---	--	--	----------------------------

81	<i>Scabiosa fumarioides</i> Vis. et Panc. Emri shqip: <i>Skabiozë si fomi</i> Familja: Dipsacaceae	Bimë shumëvjeçare (Kamefite CH) me rrënjë të trasha, gati të drunjëzuara, nga dalin disa kërcëjë të përprjetë, disa herë të degëzuar; degët të gjata, të gjelbërta - kaltroshe, poshtë me qime të mbështetura ose të shogëta. Gjethet e poshtme në rozetë bazale të dendura, me bishtak, të prera në segmente rezhdore-trishe-pendore; segmentet gjatore-vizake, shytë, me një kreshtë pak a shumë të gjatë në majë, me buzë të përvelur, me një dell; gjethet e kërcellit pabishtak me segmente pendore ose dyfish pendore të ndara thellësisht, segmentet të gjata dhe të qëndrueshme. Këmbëzat e kaptinëzave të gjata, të holla dhe pa gjethe. Braktetë e përshtjellës vizake-gjatore, më të shkurtra se kaptinëzat, shumë a pak me qime të shkurtra të mbështetura. Kaptinëzat toptnore, në kohen e frytënimit vezake. Lulet të verdha, së jashtmi me qime të rralla. Korona me 8 brinjë gjator, të mbuluar me qime të rralla, në bazë me qime të dendura, me majë cipëthatë, të zgjeruar, me 30 dejë. Kupa pa këmbëz, e murrme, me 5 dhëmbë, dhëmbët trekëndorë të ngushtë, me kreshtë shumë të shkurtër ose pa te. Lulëzon VI-VII. Frytmon VII-VIII. (Qosja, Xh. et al.1996).	Siujdhesa Ballkanike (Endemike-Ballkanike)	Ky lloj në Kosovë gjendet i përhapur në substrate shkëmbore serpentinore dhe gëlqerore. Në substrate serpentinore të Kosovës gjendet në kuadër të asociacioneve Astero-Juniperetum oxycedri, Polygalo-Forsythietum europaea, Polygalo-Genistetum hassertianae (Blecic, V., Krasniqi, F. 1972) dhe Onosma-Scabietosum fumaroides (Rexhepi, 1978). Në Pashtrik gjendet në substrat gëlqeror në kullota të zones malore (1450 m) e shoqëruar nga llojet: Centaurea kosaninii, Serratula radiata, Plantago argentea, Koeleria gracilis, Ostrya carpinifolia, Amelanchier ovalis, Trifolium alpestre, Asphodelus albus, Jurinea mollis, Veratrum nigrum, Teucrium montanum, Eryngium palmatum, Dianthus cruentus, etj.	Ky lloj në Kosovë është i përhapur në Koznik, Mirushë, Mali i Drenicës (Krasniqi, E. 2003, 2006, 2021), Gryka e Duvnes, Gryka e Lumëbardhit të Prizrenit, Lugina e Ibrit (Mitrovicë), Bokat e Morinës, Brod (shpati jugor i lumit).	Popullacionet e këtij lloji në Pashtrik, Grykë te Lumëbardhit të Prizrenit dhe Mirushë edhe pse kanë areal të kufizuar janë më të pasura me individë maturë krahasuar me popullacionet tjera prezentë në Kosovë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
----	---	--	---	--	--	---	----------------------------

82	<i>Sempervivum macedonicum</i> Praeger Emri shqip: <i>Burgull macedonas</i> Familja: Crassulaceae	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rozeta 2-5 cm, gati pllakore, me stolone 4-7 cm të gjata. Gjethet e rozetës heshtore të përmbysta, të gjëra, në të dy faqet me qime të imta të dendura gjëndërore, me majë të shkurtër, në bazë të shkurtësisë vizake, 6-7 x 1.5-2 cm, shumë sukulente, të gjelbërta të përlyera, afër majës të kuqe, në bazë të bardhërreme, në buzët me gjëndra qepallore, 2.5 mm të gjata, dyfish më të gjata se qimet. Lulesa me 11 ose 12 lule. Petalet 8-10 mm të gjata, të kuqe-trëndafil. Thekë të ngjyrë vjollce, gati të shogët. VI-VII	Kosovë, Maqedoni (Matevski, V. & Kostadinovski, M. 1996, Micevski & Matevski, 1987) (endemike).	Ky lloj në Kosovë është konstatuar në substrate shkëmbore gëlqerore, silikate dhe serpentine. Rritet në shkëmbinj dhe vende me bar (kullota) të zonën subalpine dhe alpine të Maleve të Sharrit dhe Alpeve Shqiptare e shoqëruar nga llojet: <i>Helianthemum canum</i>, <i>Edraianthus graminifolius</i>, <i>Senecio carpatica</i>, <i>Myosotis alpestre</i>, <i>Poa alpina</i>, <i>Achillea chrysocoma</i>, <i>Ptilotrychum rupestre</i>, <i>Senecio carpatica</i>, <i>Armeria alpina</i>, <i>Minuartia verna</i>, <i>Vaccinium uliginosus</i>, <i>Juncus trifidus</i>, <i>Jasione orbiculata</i>, <i>Antennaria dioica</i> etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999) është e përhapur në Gjeravicë, Dervish Kom. Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Bistra, Shtëpia e Malorëve, Përroi i Durlit). Gjatë vitit 2011-2013 e kemi konstatuar edhe në Vracë, Luboten, Liqenet e Jazhincës, Brezovicë.	Popullacionet e këtij lloji në Alpet Shqiptare kanë areal të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë në kuadër të popullacioneve. Në Malet e Sharrit ky lloj ka përhapje mjaft të gjërë. Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit janë mirë të zhvilluara dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
83	<i>Jacobaea subalpina</i> (W. D. J. Koch) Pelzer & Veldkamp [Senecio subalpinus Koch.] Emri shqip: - [Pulith subalpin] Familja: Compositae [Asteraceae]	Bimë shumëvjeçare (Hemikriptofite H) 30-70 cm, me kërcëj të ngritur, zakonisht të degëzuar vetëm në lulesë, me gjethë kudo, gati të shogëta. Gjethet gradualisht të zvogëluara në madhësi në drejtim të kërcellit; gjethet e bazës dhe ato të poshtme kërcellore 3-6 (-10) x 3-6 (-8) cm, si zemër-deri trekëndore-vezake, të shogëta përsipër, të shogëta ose me qime të rralla dhe të blerta përposh; gjethet kërcellore të mesit shpesh me 1 ose më shumë çifte vrigujsh në bishtak ose pak a shumë lirake; gjethet e sipërme kërcellore të rripëzuara ose gati pendore të prera dhe me veshëza në bazë. Kaptinëza (3-)5-20, me diametër 25-40 mm, në vastak. Pështjella 6-8 mm, me qime të merimangëta leshtore ose gati e shogët, me 5-10 brakte shtesë afërsisht sa 1/3 e gjatësisë së pështjellës. Lulet llapore 12-21, 10-15 mm, të verdha ose portokalli-të verdha. Akenët rreth 3.5 mm, të shogët. Lulëzon VI-VIII. Frytton VIII-IX. Vangjeli, J. et al. (2000)	Siujdhesa Ballkanike (me përjashtim të Maqedonisë), Alpet Lindore, Karpate (AlpikëKarpatik e).	Në Kosovë është e përhapur në substrat silikat rrallë në substrat karbonat në çeltira të pyllit dredhakut (Pinus mugo), ose në vende me lagështi, buzë përrenjeve, burimeve të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Pinus mugo, Campanula foliosa, Ranunculus montanus, Geum montanu, Alchemilla hybrida etj.	Sipas Millaku, F. (2005,1999) Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1975) është e përhapur në Malet e Sharrit (Kobilicë) dhe Alpe Shqiptare (Gjeravicë, Ishtedim, Liqenak, Gryka e Lloçanit, Koprivnik (Maja e Qetes), Roshkodol).	Popullacionet e këtij lloji në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare kanë areal të kufizuar por shumica e subpopullacioneve janë stabile dhe kanë numër të konsiderueshëm të individëve maturë.	Më pak i rrezikuar.

84	<i>Jovibarba heuffelii (Schott)</i> Ä. Löve & D. Löve [<i>Sempervivum heuffelii Schott.</i>] Emri shqip: <i>Burgull i Heufelit</i> Familja: Crassulaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me rozetë 5-7 (-12) cm në diametër, pa stolone. Gjethet janë 25-60 mm të gjata dhe 10-15 mm të gjëra, gjatore, vezake, të përmbysta në maje në formë gjembi të blerta, të mbylltë ose të blerta, të përhimëta, me buzë të verdha dhe të mbuluara me qime të forta-qerpikore. Kërçelli lulorë është 10-20 cm i gjatë në pjesën e sipërme me qime gjëndërore. Gjethet në kërçell janë ovale në bazë formë zemre, pak e mbështjellin, kërçelli me vijë dhe qime gjëndërore. Sepalet janë pjatore-lineare me gjëndra dhe qime. Petalet janë 10-12 mm të gjata, dy herë me të gjata se sepalet, të verdha të zbehta, në buzë kanë qerpikë. Shtyllëza është 2 mm e gjatë. Josifovic, M., et. al. (1972).	Ballkan, Rumani (Sub-Ballkanike)	Ky lloj rritet në vende të thata me bar ose në shkëmbinj të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Achillea chrysocoma</i> , <i>Armeria alpina</i> , <i>Helianthemum canum</i> , <i>Pedicularis brachyodonta</i> , <i>Globularia cardifolia</i> , <i>Festuca koritniensis</i> , <i>Nigritella nigra</i> , <i>Helianthemum alpestre</i> , <i>Juniperus sibirica</i> , <i>Daphne cneorum</i> , <i>Myosotis alpestris</i> etj.	Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur në Alpet Shqiptare (Zhleb, Maja e Rusolisë, Liçenak, Bjeshkë të Lumbardhit dhe Koprivnik), është konstatuar edhe në Kurvallë. Në Malet e Sharrit është e përhapur në Koxhaballkan (Rusenice, Pashallarë, Livadhet e Çhajës), Luboten.	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar por numër të konsiderueshëm të individëve maturë. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
85	<i>Viola calcarata L. subsp. zoysii (Wulfen) Murb.</i> Emri shqip: <i>Manushaqe e Zoisit</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), me kërcej shumë të shkurtër. Gjethet vezake të gjëra deri rrotullare, 1-4 cm, me buzë ura-ura, të shogëta ose lehtësisht leshtore të buzët. Bishtaku aq sa ose më i gjatë se llapa e gjethes. Ndajgjethëza 0.5-1.5 cm gjatore, të plota ose dhëmë-dhëmbë, me 1-2 ripëza të shkurtra në majë. Bishtat lulorë shumë të shkurtër; kërcejtë njëlulësh. Lulet 2-4 cm të gjata dhe deri 3 cm të gjëra, zakonisht të verdha. Petlat shumë të gjëra, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 8-15 mm, gati i barabartë me petlat, i drejtë ose i përkulur nga sipër. Shtyllëza bërnylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezoze. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon V-VI. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Alpe (Karavane), Kosovë, Shqipëri, Malet Dinarike, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi.	Në Kosovë është konstatuar në kullota të thata, shkëmbinj dhe vende gurishtore të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: <i>Plantago argentea</i> , <i>Iris reichenbachii</i> , <i>Euphorbia myrsinites</i> , <i>Achillea fraasii</i> , <i>Onosma sp.</i> <i>Genista radiata</i> , <i>Fritillaria gracilis</i> etj,	Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Majën e Rusolisë, Koprivnik, Dervish Kom dhe Gjeravicë. Sipas Millaku, F. (2005, 1999) përveç këtyre lokaliteteve të njohura është e përhapur edhe në: Majën e Qenit, Bjeshkën e Lumëbardhit dhe në Grykën e Sushicës. Millaku, F. me 19.05.2013 e konstatoi edhe në pjesën juglindore të Majës së Vjellakut në lartësi 1878	Edhe pse në Kosovë ky lloj formon disa popullacione/subpopullacione; ato kanë areal shumë të kufizuar dhe numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i vogël. Edhe pse këto popullacione/subpopullacione kanë areal të kufizuar për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

86	<i>Viola elegantula</i> Schott. Emri shqip: <i>Manushaqe pak elegante</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H), 10-30 cm, e shogët ose pak pushlore. Gjethet 1-2 (-3) cm, të poshtmet rrotullare, të sipërmet vezake-heshtore ose heshtore. Ndajgjethëzat sa 1/2-3/4 e gjatësisë së gjethëve, vezake, të ndara pendore, me 4-10 segmente në anën e jashtme dhe 2-4 segmente në anën e brendshme. Lulet 2-2.5 cm. Petlat jo shumë të gjëra, ngjyrë manushaqe ose të verdha, rrallë të bardha ose të trëndafilta, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 5-8 mm, i drejtë ose lehtësisht i përkulur. Hollak, tri herë më i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërrylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Gadishulli Ballkanik (Subendemike).	Në Kosovë Ky lloj është konstatuar në kullota të thata, dhe vende gurishtore të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Campanula spatulata, Veratrum album, Geranium subcaulescens, Poa violacea, Juniperus sibirica, Rumex alpines, Chenopodium bonus-henricus etj.	Sipas Millaku, F. (2005, 1999), Saric et al. (1986), Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Malet e Sharrit (Koritnik, Bistër, Piribreg, Shtëpia e Malorëve, Livadhishtë, Luboten) dhe në Alpet Shqiptare të Kosovës (Maja e Rusolisë, Zhleb, Liqenak, Gjeravicë, Pllaçicë, Kurvallë).	Popullacionet/subpopullacionet e këtij lloji në Kosovë kanë areal të kufizuar por numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve/subpopullacioneve është i konsiderueshem. Edhe pse këto popullacione kanë areal të kufizuar për momentin janë stabile.	Më pak i rrezikuar.
87	<i>Viola orphanidis</i> Boiss. Emri shqip: <i>Manushaqe e Orfanidit</i> Familja: Violaceae	Bimë barishtore shumëvjeçare (Hemikriptofite H) leshtake deri 50 cm me kërcë të shumtë, të përjetëm. Gjethet 2-4 cm, vezake ose rrotullare, nganjëherë gati si zemër, me buzë ura-ura ose të sharruara, leshtake kryesisht gjatë nervurave dhe në buzët; llapa e barabartë ose me e gjatë se bishtaku. Ndajgjethëzat 1-2 cm, vezake të pjerrëta, thellësisht të dhëmbëzuara ose të ndara gati-pendore me segmentin skajor me të madh se të tjerat. Lulet rreth 2 cm. Petlat blu, e poshtmtja me një njollë të verdhë, anësoret të drejtuara nga lart. Shpori 4-5 mm, hollak i përkulur, dy herë me i gjatë se shtojcat e kupës. Shtyllëza bërrylake në bazë, e kokët, me një të hapur të gjërë krezore. Kapsula e ngritur në pjekuri, e shogët. Lulëzon VI-VII. Frytëzon VII-VIII, riprodhohet me farë. Vangjeli, J. et al. (1992).	Gadishulli Ballkanik (endemike Ballkanike)	Në Kosovë është konstatuar në livadhe, afër tëbanëve dhe buzë pyjeve halore, të zonës subalpine dhe alpine e shoqëruar nga llojet: Cyrsium appendiculatum, Geranium sylvaticum, Veratrum album, Rubus idaeus, Potentilla hirta, Juniperus sibirica, Rhododendron ferrugineum, Rumex alpinus, Geum coccineum etj.	Sipas Saric et al. (1986) është e përhapur në Malet e Sharrit (Piribreg, Liqenet e Jazhincës, Ujrat e Humbura dhe Livadhishtë). Sipas Josifovic et al. (1972) është e përhapur në Bjeshkën e Deçanit, Koprivnik (Pejë), Gryka e Lloqanit, Kurvallë. Sipas Millaku, F. (1999) është e përhapur edhe në Majën e Rusolisë. Millaku, F., Krasniqi, E. Mala, Xh. Berisha, N. me 11.07.2013 ketë lloj e konstatuan edhe në Perroin e Durlit dhe mbi Shtëpinë e Malorëve në 2052 m lartësi mbidetare.	Ky lloj formon disa popullacione /subpopullacione në Malet e Sharrit dhe Alpet Shqiptare që kanë areal shumë të kufizuar, mirëpo numri i individëve maturë në kuadër të popullacioneve është i konsiderueshem. Për momentin subpopullacionet e këtij lloji janë stabile.	Më pak i rrezikuar.

Tabela 8. Lista e asetëve të resurseve natyrore (Flora) vetëm në Kosovë

Llojet bimore nga Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës prezente vetëm në Kosovë (bazuar në të dhënat e deritanishme):

Nr.	Lloji bimor	Përhapja në Kosovë	Kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN
1.	<i>Achillea alexandri-regis</i> Bornm. & Rudsky	Malet e Sharrit (Oshlak), Pashtrik	CR (I rrezikuar në mënyrë kritike)
2.	<i>Cerastium neoscardicum</i> Niketic	Malet e Sharrit (Maja e Pashallarëve (Ostrovicë)	CR (I rrezikuar në mënyrë kritike)
3.	<i>Plantago dardanae</i> Rexhepi et Dim.	Alpet Shqiptare (Gjeravicë)	CR (I rrezikuar në mënyrë kritike)
4.	<i>Bornmuellera dieckii</i> Deg.	Malet e Sharrit (Maja e Pashallarëve (Ostrovicë)	EN (I rrezikuar)
5.	<i>Centaurea albertii</i> Rexhepi	Devë-Morinë, Golesh, Kaznik	VU (I përkeqësuar)

Referencat

Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

Millaku, F., Rexhepi, F., Krasniqi, E., Pajazitaj, Q., Mala, X. & Berisha, N. (2013): Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës. MMPH&GIZ. Prishtinë.

Krasniqi, E., Berisha, N., Millaku, F., Rexhepi, F. (2019): Contribution to the knowledge on the flora of Mt. Golesh, Central Kosovo. *Natura Croatica*. 28/2:423-440. Zagreb.

Krasniqi, E., Ukaj, Sh., Paçarizi, E. (2020): The presence of endemic plant species *Achillea alexandri-regis* Bornm&Rudsky in Pashtrik, added value for the flora and vegetation of Kosovo. *IJEES*. Vol. 10(4):657-660 (2020).

Krasniqi, E., Berisha, N., Bytyçi, S., Millaku, F. (2020): New data on distribution and ecology of *Narcissus* L. (Amaryllidaceae) from Kosovo. *Wulfenia* 27 (2020): 65-85. Klagenfurt.

Berisha, N., Krasniqi, E., Millaku F. (2020): A quantative approach for conservation of endangered and endemic plants from Kosovo, SE Europe. *Folia Oecologica*. Vol. 47. Nr. 1 (2020).

Krasniqi, E. (2021): Flora dhe vegjetacioni i Kosovës 1 (Malet e Kaznikut). Monografi. Botime Artini. Prishtinë.

Krasniqi, E. & Berisha, N. (2023). Contribution to the knowledge of serpentine flora in western Kosovo, with comparisons of the western, central and northern serpentine massifs. *Natura Croatica*, 32 (2), 305-332.

EDIT- Euro+Med Plant Base [continuously updated]. Published at https://europlusmed.org/cdm_dataportal/taxon/ [accessed 18.07.2025].

Euro+Med (2006+) [continuously updated]. Euro+Med Plant Base-the information resource for Euro-Mediterranean plant diversity. – Published at <http://ww2.bgbm.org/EuroPlusMed/> [accessed 18.07.2025].

FloraVeg.Eu [continuously updated]. Published at <https://floraveg.eu/taxon> [accessed 18.07.2025].

Krasniqi, F., Ruci, B., Vangjeli, J., Susuri, L., Mullaj, A. & Pajazitaj, Q. (2003): Fjalor i emrave të bimëve. ASHSH&ASHAK. Tiranë-Prishtinë.



Adresa:
Rr. "Luan Haradinaj", Ndërtesa e Re e Qeverisë
(ish ndërtesa e Rilindjes) Kati III, 10000 Prishtinë.
e-mail: info-mzhr@rks-gov.net
ueb faqe: <https://mzhr.rks-gov.net>